



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 16 korrik 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit dhe Dënimit

me një shtojcë konfidenciale

---

**T'u njoftohet:**

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

Filipo de Miniçis

Gaia Pergolo

Eva Viler

**Zyrës Administrative**

Fidelma Donlon

**Mbrojtjes së Pjetër Shalës**

Zhan-Lui Zhilisen

Hedi Auini

Leto Kariolu

**Mbrojtjes së Viktimave**

Sajmon Loz

Maria Raxhievovska

## PËRMBAJTJA

I.	HISTORIKU PROCEDURAL .....	3
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE .....	6
III.	AKUZAT KUNDËR PJETËR SHALËS.....	6
IV.	ANKESAT E MBROJTJES NË LIDHJE ME TË DREJTAT PËR GJYKIM TË DREJTË .....	8
A.	Juridiksioni mbi NKP-në .....	9
B.	Njoftimi paraprak i pamjaftueshëm dhe ndryshimet në argumentet e ZPS-së 9	
C.	Hetimi i padrejtë .....	11
D.	Imuniteti [REDAKTUAR].....	14
E.	Shkeljet në nxjerrjen e materialit.....	16
F.	Shkelja e së drejtës së z. Shala për ndihmë juridike të efektshme dhe për mbrojtje nga vetinkriminimi.....	18
G.	Pabarazia e palëve .....	19
H.	Shkelja e së drejtës për proces publik .....	23
I.	Dëmi nga pasiguria lidhur me provat e administruara kundër z. Shala.....	23
J.	Kufizime të papërligjura të së drejtës për ballafaqimin e dëshmitarëve kundër z. Shala .....	24
K.	Përfundim .....	27
V.	ASPEKTE TË PROVAVE .....	27
A.	Prezumimi i pafajësisë dhe standardi i vërtetimit .....	27
B.	Provat e administruara prej Trupit Gjykses.....	28
C.	Metodologjia e përdorur nga Trupi Gjykses në lidhje me provat .....	30
D.	Faktet që nuk është e nevojshme të vërtetohen.....	39
E.	Atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë .....	40
F.	Vlerësim i përgjithshëm i besueshmërisë së dëshmitarëve të ZPS-së.....	41
G.	Vlerësim i përgjithshëm i besueshmërisë së dëshmitarëve të thirrur nga Mbrojtësi i Viktimave: Karin Duhne-Prinsen dhe Shajen Lozano Parra (Chayén Lozano Parra).....	85
H.	Vlerësim i përgjithshëm i besueshmërisë së dëshmitarëve të mbrojtjes.....	86
VI.	KONSTATIMET FAKTIKE.....	107
A.	Pjetër Shala.....	107
B.	Fabrika e metalit në Kukës .....	111
C.	Mbajtja në ndalim nga UÇK-ja në FMK .....	128
D.	Ndalimi arbitrar (Pika 1).....	138
E.	Trajtimi mizor dhe tortura (Pikat 2 dhe 3) .....	229
F.	Vrasja e paligjshme (Pika 4) .....	296
G.	Analizë e përgjithshme e mbajtjeve në ndalim nga UÇK-ja në FMK dhe rrethina .....	321
H.	Vendndodhja e z. Shala gjatë periudhës së akuzave.....	323

I.	Pozita dhe roli i z. Shala në fabrikën e metalit në Kukës .....	347
VII.	KONSTATIMET LIGJORE .....	353
A.	Konflikti i armatosur .....	353
B.	Ndalimi arbitrar (Pika 1).....	361
C.	Trajtimi mizor (Pika 2) .....	370
D.	Tortura (Pika 3) .....	374
E.	Vrasja e paligjshme (Pika 4) .....	382
F.	Përgjegjësia penale individuale .....	385
G.	Përfundim .....	403
VIII.	PËRCAKTIMI I DËNIMIT .....	404
A.	Parashtrimet .....	405
B.	Kuadri ligjor.....	412
C.	Konstatime .....	420
IX.	VENDIM.....	432

## TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) lëshon këtë aktgjykim dhe dënim.

### I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Pjetër Shalës (z. Shala).<sup>1</sup>
2. Më 16 mars 2021, z. Shala u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”)<sup>2</sup> dhe më 15 prill 2021 u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.<sup>3</sup>
3. Më 19 prill 2021 u mbajt seanca e paraqitjes së parë të z. Shala para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, në të cilën z. Shala u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha krimet e paraqitura në aktakuzë.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës* (“Vendimi i Konfirmimit”), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik, përkatësisht F00007/CONF/RED dhe [F00007/RED](#), u dorëzuan më 6 maj 2021.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Pjetër Shalës sipas Rregullës 55(4)* (“Njoftimi i Arrestimit”), 16 mars 2021, publik, para. 1, 5.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit* (“Njoftimi i Pranimin në Objektin e Paraburgimit”), 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 26 prill 2021, F00019/RED.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04, F00020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision Setting the Date for the Initial Appearance of Pjetër Shala and Related Matters](#) (Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Pjetër Shalës dhe Çështjet lidhur me Të), 15 prill 2021, publik, para. 22(a); T. 19 prill 2021, publik, f. 11, rreshti 11.

4. Më 1 nëntor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të korrigjuar ("Aktakuza e Konfirmuar")<sup>5</sup> në vijim të kundërshtimeve ndaj formës së aktakuzës.<sup>6</sup>
5. Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykses dosjen e çështjes gjyqësore.<sup>7</sup>
6. Gjykimi filloi më 21 shkurt 2023, me deklaratat hyrëse të ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave, kurse Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") bëri deklaratën hyrëse më 22 shkurt 2023.<sup>8</sup>
7. ZPS-ja paraqiti provat e veta prej 27 marsit 2023 deri më 6 korrik 2023.<sup>9</sup> ZPS-ja paraqiti 17 dëshmitarë (10 dëshmitarë dëshmuan para Trupit Gjykses, në selinë e Dhomave të Specializuara ose përmes videokonferencës, dhe deklaratat me shkrim të 7 dëshmitarëve të tjerë u paraqitën si prova në vend të dëshmimeve gojore).

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-04, F00098/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojcë 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar*, 1 nëntor 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 nëntor 2021, [F00107/A01](#).

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-04, F00089, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës* ("Vendimi mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës"), 18 tetor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [F00089/RED](#).

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-04, F00284, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision Transmitting the Case File to Trial Panel I](#) (Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Trupit Gjykses I) (Vendimi mbi Kalimin e Çështjes Gjyqësore për Gjykim), 21 shtator 2022, publik, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-04, F00405, Trupi Gjykses I, [Decision on the date for the commencement of the trial, evidence presentation and related matters](#) (Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit, Paraqitjen e Provave dhe Çështje të lidhura me Të ("Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjykimit")), 26 janar 2023, publik, para. 18(a)-(b); T. 21 shkurt 2023, publik, f. 497, rreshtat 11-12; f. 502, rreshti 21 deri në f. 503, rreshti 9; T. 22 shkurt 2023, publik, f. 570, rreshtat 17-20.

<sup>9</sup> T. 27 mars 2023, publik, f. 609, rreshtat 11-13; KSC-BC-2020-04, F00570, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Mbylljen e Paraqitjes së Provave të Saj në përputhje me Rregullën 129*, 6 korrik 2023, publik.

8. Më 21 gusht 2023, Mbrojtësi i Viktimave thirri dy dëshmitarë ekspertë me lejen e Trupit Gjykses.<sup>10</sup>
9. Mbrojtja paraqiti provat e veta prej 20 shtatorit 2023 deri më 15 janar 2024.<sup>11</sup> Mbrojtja paraqiti 14 dëshmitarë (10 dëshmitarë dëshmuar para Trupit Gjykses, në selinë e Dhomave të Specializuara ose përmes videokonferencës, dhe deklaratat ose raportet me shkrim të 4 dëshmitarëve të tjerë u paraqitën si prova në vend të dëshmimeve gojore).
10. Më 9 shkurt 2024, Trupi Gjykses mbylli procedurën e paraqitjes së provave.<sup>12</sup>
11. Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave dorëzuan dosjet gjyqësore përfundimtare dhe deklaratën mbi pasojat më 25 dhe 26 mars 2024.<sup>13</sup> Deklaratat përmbyllëse u bënë midis 15 dhe 17 prillit 2024.<sup>14</sup>
12. Më 17 prill 2024, Kryegjykatësja e deklaroi çështjen të mbyllur.<sup>15</sup>

---

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-04, F00598, Trupi Gjykses I, [Decision on Victims' Counsel's request to call expert witnesses to testify](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për të Thirrur Dëshmitarë Ekspertë për të Dëshmuar ), 21 korrik 2023, publik, para. 12(a); T. 21 gusht 2023, publik, f. 2249, rreshtat 13-16.

<sup>11</sup> T. 20 shtator 2023, publik, f. 2450, rreshtat 12-14; KSC-BC-2020-04, F00772, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes për Mbylljen e Paraqitjes së Provave në përputhje me Rregullën 131 të Rregullores*, 15 janar 2024, publik.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-04, F00795, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Vizitë në Vendin e Krimit, Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Udhëzime në lidhje me Dosjet Përfundimtare, Kërkesën për Zhdëmtime dhe Deklaratat Përmbyllëse*, 9 shkurt 2024, konfidencial, para. 23, 52(b). Versioni i redaktuar publik u lëshua më 20 shkurt 2024, [F00795/RED](#).

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-04, F00815, Mbrojtësi i Viktimave, *Deklaratë e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve të Pretenduara për Viktimat Pjesëmarrëse në Procesin e Çështjes Gjyqësore 04* ("Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat"), 25 mars 2024, konfidenciale; F00818, Prokurori i Specializuar, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë* ("Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së"), 25 mars 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1 dhe 3, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike; F00821, Mbrojtja, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes* ("Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes"), 26 mars 2023, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>14</sup> T. 15 prill 2024, konfidencial, f. 4080-4168; T. 16 prill 2024, konfidencial, f. 4172-4280; T. 17 prill 2024, konfidencial, f. 4283-4374.

<sup>15</sup> T. 17 prill 2024, publik, f. 4374, rreshtat 9-10.

13. Gjatë fazës së procedurës paraprake dhe të gjykimit të çështjes, tetë viktimë morën pjesë në proces.<sup>16</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

14. Trupi Gjykes bazohet në nenin 31(5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (përkatësisht, “Kushtetuta” dhe “Kosova”), nenet 3(2), 14(1)(c) dhe (2), 16(1)(a), 21, 23(1), 34, 40(5), 43 dhe 44(1), (2) dhe (5) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 23(1), 24(1)-(3), 138, 139, 140, 158, 159(1)-(4) dhe (6), dhe 163(1), (3), (4) dhe (6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).

## III. AKUZAT KUNDËR PJETËR SHALËS

15. ZPS-ja pretendon se për të gjitha periudhat që kanë lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar, z. Shala ishte anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), në anglishte, *Kosovo Liberation Army (KLA)*.<sup>17</sup> ZPS-ja ngre kundër z. Shala katër akuza për krime lufte në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit: ndalim arbitrar (Pika 1), trajtim mizor (Pika 2), torturë (Pika 3), dhe vrasje e paligjshme (Pika 4).<sup>18</sup>

---

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-04, F00123, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 15 dhjetor 2021, konfidencial, para. 50(a). Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, [F00123/RED](#); F00249, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 11 gusht 2022, konfidencial, para. 43(b). Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, [F00249/RED](#); F00279, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 19 shtator 2022, konfidencial, para. 43(a). Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, [F00279/RED](#).

<sup>17</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 2.

<sup>18</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 31.

16. Sipas ZPS-së, krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar ndodhën në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe kishin lidhje me këtë konflikt midis UÇK-së, në njëri anë, dhe, në anën tjetër, forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë ("Serbia"), ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe grupe të tjera që luftonin në emër të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Serbisë (bashkërisht, "forcat serbe").<sup>19</sup> ZPS-ja më tej pretendon se z. Shala ishte në dijeni të rrethanave faktike që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe e dinte se viktimat ishin persona të cilët nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime.<sup>20</sup>

17. Sipas Aktakuzës së Konfirmuar, të gjitha krimet e paraqitura në të u kryen kundër personave të ndaluar në fabrikën e mëparshme të përpunimit të metaleve në Kukës, në Republikën e Shqipërisë (përkatesisht, "fabrika e metalit në Kukës" ose "FMK" dhe "Shqipëria"), që u përdor për qëllime të ndryshme ushtarake, ndër të tjera, për marrjen, magazinimin dhe shpërndarjen e pajisjeve dhe furnizimeve, regjistrimin e vullnetarëve dhe si pikë përgatitore dhe tranzitore për anëtarët e UÇK-së që shkonin e ktheheshin nga pozicionet pararojë.<sup>21</sup> Sipas Aktakuzës së Konfirmuar, FMK-ja gjithashtu u përdor edhe si qendër për ndalimin dhe marrjen në pyetje të personave të cilët dyshoheshin se kishin bashkëpunuar me Republikën Federale të Jugosllavisë dhe Serbinë, apo se nuk përkrahnin UÇK-në.<sup>22</sup>

18. ZPS-ja pretendon se z. Shala mban përgjegjësi penale individuale për ndalimin arbitrar, trajtimin mizor dhe torturimin e së paku nëntë personave në FMK, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, dhe vrasjen e paligjshme të një personi,

---

<sup>19</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 3.

<sup>20</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 7.

<sup>21</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 6.

<sup>22</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 6.



[REDAKTUAR] (“viktima e vrasjes së paligjshme”), më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date.<sup>23</sup>

19. Sipas ZPS-së, z. Shala mban përgjegjësi penale individuale në bazë të nenit 16(1)(a) të Ligjit se kreu fizikisht krimet e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturës sipas Pikave 1-3.<sup>24</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se z. Shala mban përgjegjësi penale individuale përmes pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje kriminale të përbashkët (“NKP”) dhe/ose se ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme sipas Pikave 1-4.<sup>25</sup>

20. Mbrojtja kërkon që z. Shala të shpallet i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës së Konfirmuar.<sup>26</sup>

#### IV. ANKESAT E MBROJTJES NË LIDHJE ME TË DREJTAT PËR GJYKIM TË DREJTË

21. Mbrojtja paraqiti disa kundërshtime që lidhen me të drejtat e z. Shala për gjykim të drejtë,<sup>27</sup> të cilat Trupi Gjykes do t'i trajtojë para vlerësimit të provave. Trupi Gjykes vëren se disa nga argumentet e Mbrojtjes lidhen më shumë me aspektet juridiksionale të krimeve dhe/ose format e përgjegjësisë penale në Aktakuzën e Konfirmuar, ose me besueshmërinë e dëshmitarëve, mbështetshmërinë e dëshmive të tyre, dhe/ose vlerën provuese që duhet t'u jepet provave të paraqitura gjatë gjykimit. Për këtë arsye, Trupi Gjykes vendosi që disa nga këto kundërshtime t'i trajtojë në pjesë të tjera të Aktgjykimit. Në pjesën më poshtë, Trupi Gjykes do t'i trajtojë kundërshtimet e Mbrojtjes në qoftë se ato kanë të bëjnë me drejtësinë e gjykimit.

---

<sup>23</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 14-29, 31.

<sup>24</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 30-31.

<sup>25</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 30-31.

<sup>26</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 381; T. 17 prill 2024, publik, f. 4312, rreshtat 14-17.

<sup>27</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 266-352.

A. JURIDIKSIONI MBI NKP-NË

22. Trupi Gjykses i ka trajtuar argumentet e Mbrojtjes lidhur me NKP-në në konstatimet e veta për përgjegjësinë penale individuale të z. Shala, mbi bazën se ato ngrenë shqetësime për aspekte juridiksionale që kanë të bëjnë me format e përgjegjësisë penale në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>28</sup>

B. NJOFTIMI PARAPRAK I PAMJAFTUESHËM DHE NDRYSHIMET NË ARGUMENTET E ZPS-SË

23. Mbrojtja parashtron se ZPS-ja në mënyrë të palejueshme ndryshoi akuzat e veta gjatë gjykimit, veçanërisht në lidhje me pesë aspekte kyçe: (i) praninë e z. Shala në FMK gjatë periudhës së akuzave; (ii) pretendimin se z. Shala ishte anëtar i Brigadës 128 të UÇK-së; (iii) praninë dhe pjesëmarrjen e z. Shala në njërin nga incidentet e përshkruara në Aktakuzën e Konfirmuar; (iv) numrin dhe identitetet e të ndaluarve të pretenduar; dhe (v) identitetet e bashkëkryerësve të pretenduar 'Bedriut' dhe 'Van Damit', që mbetet i panjohur. Sipas Mbrojtjes, këto ndryshime në akuzat e ZPS-së ndikuan në hetimet e Mbrojtjes, përgatitjen e argumenteve të saj dhe përgjithësisht mundësinë e z. Shala për të përgatitur mbrojtje të efektshme.<sup>29</sup>

24. Trupi Gjykses vëren se në parashtrimet e saj, Mbrojtja duket se ngre pretendime për mospërputhshmëri midis, nga njëra anë, Aktakuzës së Konfirmuar, dhe, nga ana tjetër, Dosjes Paraprake të ZPS-së, deklaratave hyrëse të ZPS-së në gjykim dhe parashtrimeve të tjera dhe llojit të pyetjeve që ZPS-ja iu bëri dëshmitarëve gjatë gjykimit.<sup>30</sup>

---

<sup>28</sup> *Shih* para. 995-997 më poshtë.

<sup>29</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 275.

<sup>30</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 275, poshtëshënimet 637-640.

25. Së pari, Trupi Gjykses vëren se parashtrimet e Mbrojtjes janë përgjithësisht të pabaza dhe të pasakta. Për shembull, në kundërshtim me atë që pohon Mbrojtja, pretendimet e ZPS-së lidhur me praninë e z. Shala në FMK gjatë periudhës që mbulojnë akuzat mbetën të pandryshuara gjatë gjithë procesit, sikurse edhe pretendimet e ZPS-së lidhur me praninë dhe rolin e z. Shala gjatë incidenteve përkatëse. Këto aspekte u shqyrtuan nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në Vendimin mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës, u qartësuan gjatë fazës paraprake dhe mbetën të pandryshuara gjatë gjithë gjykimit.<sup>31</sup>

26. Së dyti, Trupi Gjykses rikujton se, në bazë të neneve 38(4) dhe 39(2) të Ligjit, akuzat përfshihen në Aktakuzën e Konfirmuar sikurse paraqiten nga ZPS-ja dhe konfirmohen nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Nga ana tjetër, Dosja Paraprake apo qoftë edhe Dosja Gjyqësore Përfundimtare, janë dokumente në të cilat palët kanë mundësi të shtjellojnë më tej provat dhe argumentet e tyre, për t'ia paraqitur njëra-tjetrës dhe për ta ndihmuar Trupin Gjykses në marrjen e vendimit mbi fajësinë ose pafajësinë e personit të akuzuar.<sup>32</sup> Po ashtu, parashtrimet që mund të bëjë ZPS-ja gjatë gjykimit, përfshirë llojet e pyetjeve për dëshmitarët, duhen parë në kontekstin e argumenteve që ZPS-ja synon të vërtetojë, sikurse paraqiten në akuzat e përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar, e cila gjatë gjithë kohës mbetet i vetmi dokument autoritativ që përcakton kuadrin e gjykimit. Në këtë Aktgjykim, Trupi Gjykses është bazuar në akuzat ashtu si janë paraqitur në Aktakuzën e Konfirmuar.

---

<sup>31</sup> [Decision on Motion Challenging the Form of the Indictment](#) (Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës); *shih gjithashtu*, IA004/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës* ("Vendimi mbi Apelin kundër Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës"), 22 shkurt 2022, konfidencial, që konfirmon vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, [IA004/F00008/RED](#).

<sup>32</sup> *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-05, F00494/RED3/COR, Trupi Gjykses I, [Further redacted version of Corrected version of Public redacted version of Trial Judgment](#) (Version i Redaktuar më Tej i Versionit të Korrigjuar të Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit)("Aktgjykimi *Mustafa*"), 16 dhjetor 2022, publik, para. 432.

27. Së fundi, Mbrojtja nuk ka vërtetuar se si janë ndikuar hetimet dhe përgatitjet e saj. Mbrojtja thjesht pretendon se është ndikuar e drejta e z. Shala për mbrojtje të efektshme, pa paraqitur fakte në mbështetje të këtyre parashtrimeve.

28. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes nuk bindet nga argumentet e Mbrojtjes dhe hedh poshtë këtë kundërshtim.

### C. HETIMI I PADREJTË

29. Mbrojtja parashtron se ZPS-ja nuk kreu hetime të balancuara dhe të fokusuara në përcaktimin e së vërtetës, meqenëse nuk thirri dëshmitarë relevantë për të dhënë dëshmi në gjykim dhe tërhoqi disa dëshmitarë të tjerë.<sup>33</sup> Mbrojtja gjithashtu ngre kundërshtime për aspekte të besueshmërisë dhe vlerës provuese në lidhje me disa dëshmitarë dhe dëshmitë e tyre. Për shkak se kanë të bëjnë me provat, këto aspekte trajtohen në pjesë të tjera të këtij Aktgjykimi.

30. Kur pretendon se ZPS-ja nuk kreu hetime të plota që përfshin mosmarrjen parasysh të “rrethanave shfajësuese” dhe të “hetimit të informacionit shfajësues”, Mbrojtja ngatërron kompetencat dhe përgjegjësitë e ZPS-së në bazë të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara. Sipas nenit 35(1)-(2) të Ligjit, ZPS-ja është autoriteti i pavarur përgjegjës për hetimin dhe ngritjen e akuzave për procedim penal. Në bazë të nenit 21(6) të Ligjit dhe rregullës 103 të Rregullores, ZPS-ja i vë “menjëherë” në dispozicion Mbrojtjes çfarëdo prove shfajësuese, sapo një provë e tillë të jetë nën “ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike” të ZPS-së.<sup>34</sup> Krahas kësaj, në bazë të

---

<sup>33</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 276-289; *shih gjithashtu*, T. 16 prill 2024, publik, f. 4223, rreshti 17 deri në f. 4235, rreshti 10.

<sup>34</sup> KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#) (Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To) (“Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave”), 30 prill 2021, publik, para. 54.

rregullës 102(3) të Rregullores, ZPS-ja gjithashtu nxjerr çdo material që posedon, të cilin Mbrojtja e konsideron juridikisht thelbësor për përgatitjen e vet.

31. Mbrojtja, nga ana e saj, mund të kryejë hetimet e veta, përfshirë mbi bazën e materialit dhe provave që i janë vënë në dispozicion nga ZPS-ja. Sipas neneve 21(4)(c) dhe (f), 39(10), 40(2), (6) dhe 42 të Ligjit dhe rregullave 121(3), 201(2) dhe 208(2) të Rregullores, Mbrojtja mund t'i kërkojë Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose Trupit Gjykses të lëshojnë urdhra që mund të jenë të nevojshëm për ta ndihmuar në përgatitjen e mbrojtjes së të akuzuarit. Trupi Gjykses ka për detyrë të sigurojë që të dyja palëve t'u jepet mundësi e arsyeshme të paraqesin argumentet dhe provat e veta dhe të kundërshtojnë dëshmitarët dhe provat e palës tjetër dhe të ruhet drejtësia e përgjithshme e procesit gjatë të gjithë kohës.<sup>35</sup> Mbrojtja në këtë çështje gjyqësore i kërkoi Trupit Gjykses disa herë ndihmë lidhur me hetimet, përgatitjen dhe paraqitjen e argumenteve dhe provave të veta dhe vlen të theksohet se, si rezultat, siguroi praninë e dëshmitarëve për z. Shala.<sup>36</sup>

32. Kur parashtron se ZPS-ja nuk hetoi më tej disa persona, ose nuk thirri si dëshmitarë disa të tjerë – mbi bazën e pretendimeve të mjegullta për relevancën e mundshme të dëshmive të tyre për këtë çështje gjyqësore – duket se Mbrojtja ndërhyr në mënyrën që ZPS-ja i kryen hetimet dhe administron provat e veta. Trupi Gjykses rikujton se është e drejtë e ZPS-së – nën mbikëqyrjen e Trupit Gjykses – të vendosë sa dëshmitarë do të thërrasë, cilët dëshmitarë dhe si do t'i paraqesë dëshmitë e tyre.<sup>37</sup>

---

<sup>35</sup> *Shih, ngjashëm*, Extraordinary Chambers in the Courts of Cambodia (ECCC), 002/19-09-2007/ECCC/TC, E465, Trial Chamber, [Case 002/02 Judgment](#), 16 November 2018, para. 119.

<sup>36</sup> *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-04, F00683, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes sipas Rregullës 121(3) të Rregullores për Thirrje të Dëshmitarëve W04405, W04441, W04280 dhe W04440* ("Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Thirrjen e Dëshmitarëve"), 5 tetor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 5-8, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i vendimit u lëshua më 16 nëntor 2023, [F00683/RED](#).

<sup>37</sup> T. 31 maj 2023, publik, f. 1486, rreshtat 13-18.

33. Mbrojtja shpërfill faktin se vendimet që lidhen me administrimin e provave, përfshirë tërheqjen e dëshmitarëve, sado potencialisht relevante që mund të jenë dëshmitë e tyre, ndihmojnë në efikasitetin dhe shpejtësinë e përgjithshme të gjykimit dhe mbështesin të drejtën e z. Shala për t'u gjykuar brenda një periudhe kohore të arsyeshme sipas nenit 21(4)(d) të Ligjit. Edhe sikur ndonjëri prej këtyre dëshmitarëve të kishte qenë i rëndësishëm kyçe për Mbrojtjen, ajo mund të kishte ndërmarrë hapa për t'i thirrur dhe, në rast se nuk do të ishin të disponueshëm për t'u paraqitur në gjykatë, mund të kishte thirrur dëshmitarë me prova të barasvlershme, ose të dorëzonte materiale me shkrim për këtë qëllim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykoës nuk bindet nga argumentet e Mbrojtjes në lidhje me këtë aspekt.

34. Sa i përket argumentit se ka kaluar kohë tepër e gjatë midis krimeve për të cilat janë ngritur akuzat dhe procedimit penal të z. Shala, Trupi Gjykoës gjykon se aspekti qendror është nëse provat e paraqitura në këtë çështje gjyqësore janë të mjaftueshme për vërtetimin e përgjegjësisë penale individuale të personit të akuzuar. Më konkretisht, Trupi Gjykoës vlerëson se, pavarësisht nga koha që ka kaluar midis krimeve për të cilat janë ngritur akuzat dhe procedimit penal të z. Shala, garanci mbrojtëse të forta kundër një procedimi penal ose dënimi të paligjshëm ose të padrejtë, janë sa vijon: (i) verifikimi i provave në sallën e gjyqit përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve, nën mbikëqyrjen e gjykatësve profesionistë; (ii) argumentimi me gojë dhe me shkrim lidhur me pranueshmërinë dhe vlerën provuese të provave gojore dhe dokumentare; (iii) roli i gjykatësve në vlerësimin e provave, brenda një kornize ligjore të përcaktuar qartë, duke mbajtur parasysh standardin *jashtë dyshimit të arsyeshëm* sipas nenit 21(3) të Ligjit dhe rregullës 140(1) të Rregullores; dhe (iv) mjetet juridike që mundësojnë Ligji dhe Rregullorja për rishqyrtim në apel dhe në shkallë të tjera.

35. Për këto arsye, argumentet e Mbrojtjes lidhur me këtë aspekt janë të pabaza dhe rrjedhimisht, hidhen poshtë.

## D. IMUNITETI [REDAKTUAR]

36. Mbrojtja parashtron kundërshtim lidhur me procesin në çështjen KSC-BC-2021-08 ("Çështja 08"), [REDAKTUAR].<sup>38</sup> Procesi penal në Çështjen 08 filloi në [REDAKTUAR], iu transferua Dhomave të Specializuara me kërkesë të ZPS-së dhe në fund ZPS-ja mori vendim për pushimin e tij.<sup>39</sup>

37. Mbrojtja parashtron se z. Shala iu cenuan të drejtat për gjykim të drejtë kur: (i) iu refuzua qasja në materiale shfajësuese në Çështjen 08; (ii) Mbrojtjes nuk iu lejua që të përmendte publikisht faktin se [REDAKTUAR]; dhe (iii) ZPS-ja vendosi të pushonte procesin në Çështjen 08, me çka Mbrojtjes iu hoq e drejta për një konstatim juridikisht thelbësor mbi besueshmërinë [REDAKTUAR].<sup>40</sup>

38. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se iu refuzua qasja në materiale shfajësuese, Paneli rikujton se kjo pikë është ngritur dhe trajtuar më herët<sup>41</sup> dhe se Mbrojtjes i është miratuar qasje në të gjithë informacionin e kërkuar që ZPS-ja ka detyrimin të nxjerrë, në përputhje me kufizimet e parapara në Ligj dhe në Rregullore.<sup>42</sup> [REDAKTUAR] u pyet në mënyrë shteruese nga palët për aspektet e besueshmërisë, mbi bazën e materialit dhe informacionit që u nxorën për Mbrojtjen sipas rregullave. Në veçanti, Mbrojtja pati mundësinë që dëshmitarit t'i bënte pyetje për tema që janë pjesë e këtij kundërshtimi.<sup>43</sup>

---

<sup>38</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 290-293; T. 17 prill 2024, konfidencial, f. 4293, rreshti 23 deri në f. 4298, rreshti 20.

<sup>39</sup> 104141-104146 RED; 104147-104149; 108602-108608 RED.

<sup>40</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 293; T. 17 prill 2024, konfidencial, f. 4293, rreshti 23 deri në f. 4298, rreshti 20.

<sup>41</sup> T. 20 tetor 2022, konfidencial dhe *ex parte* vetëm me Mbrojtjen, f. 459, rreshti 13 deri në f. 461, rreshti 21; T. 20 tetor 2022, konfidencial dhe *ex parte* vetëm me ZPS-në, f. 487, rreshti 14 deri në f. 493, rreshti 19.

<sup>42</sup> KSC-BC-2020-04, F00337, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listave të Materialeve të Nxjerra në lidhje me KSC-BC-2021-08*, 4 nëntor 2022, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>43</sup> [REDAKTUAR].

39. Sa i përket mundësisë së paraqitjes së provave dhe argumenteve të Mbrojtjes në lidhje me [REDAKTUAR] në seancë publike në ndryshim nga seanca private, sikurse shtjellohet më poshtë edhe në lidhje me kundërshtimet për barazinë e palëve,<sup>44</sup> Trupi Gjykses gjykon se ushtrimi i së drejtës së të akuzuarit për gjykim publik sipas nenit 21 të Ligjit duhet të balancohet me detyrën për të mbrojtur dëshmitarët, viktimat dhe personat e tjerë të rrezikuar. Në rrethanat konkrete, Trupi Gjykses nuk mund të lejonte Mbrojtjen që t'i bënte pyetje [REDAKTUAR] për aspektet në fjalë në seancë publike, thjesht për arsye se ato lehtësisht do të identifikonin dëshmitarin. Mbrojtjes iu dha mundësia që të paraqiste provat e nevojshme për argumentet e saj në seancë private, pa komprometuar identitetin e dëshmitarit. Argumenti se përdorimi i seancës private për ato lloj pyetjesh automatikisht cenoi të drejtën e z. Shala për gjykim publik, shpërfill plotësisht faktin se parimi i procesit publik duhet peshuar kundrejt nevojës për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, që, sipas nevojës, mund të diktojë përdorimin e seancave private ose të mbyllura. Këto seanca ruajnë masat mbrojtëse të autorizuara nga gjykata dhe njëkohësisht i lejojnë palës që bën pyetjet të marrë provat që kërkon të paraqesë për argumentet e veta.

40. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se me vendimin e ZPS-së për pushimin e procesit penal në Çështjen 08, ajo u privua nga konstatime thelbësore lidhur me besueshmërinë e [REDAKTUAR], Trupi Gjykses vëren se [REDAKTUAR].<sup>45</sup> Ky fakt ka qenë i pakundërshtuar në këtë gjykim, është trajtuar gjerësisht gjatë pyetjeve të palës thirrëse dhe palës tjetër,<sup>46</sup> dhe Trupi Gjykses e ka shqyrtuar si duhet në vlerësimin e vet të besueshmërisë së dëshmitarit.<sup>47</sup> Fakti që ZPS-ja pushoi procesin penal në Çështjen 08 është juridikisht jothelbësor në këto rrethana dhe kjo nuk ndikoi te Mbrojtja në paraqitjen e provave dhe argumenteve të saj.

---

<sup>44</sup> *Shih* para. 53 më poshtë.

<sup>45</sup> [REDAKTUAR].

<sup>46</sup> [REDAKTUAR].

<sup>47</sup> [REDAKTUAR].



41. Kundërshtimet e Mbrojtjes lidhur me këtë pikë hidhen poshtë.

E. SHKELJET NË NXJERRJEN E MATERIALIT

42. Mbrojtja parashtron se pati shkelje në nxjerrjen e materialit gjatë fazës paraprake dhe atë të gjykimit, në formën e nxjerrjes me vonesë të materialit, përshkrimit të pamjaftueshëm të materialeve dhe redaktimeve të tepruara të informacionit, duke përfshirë identitetet e dëshmitarëve.<sup>48</sup>

43. Sa u përket shkeljeve të pretenduara në nxjerrjen e materialit në fazën paraprake të procesit, Trupi Gjyqësor gjykon se Mbrojtja duhej t'i kishte ngritur ato probleme para Gjykatësit të Procedurës Paraprake gjatë asaj kohe, ndër të tjera, duke përdorur mjetet juridike të përcaktuara në kornizën ligjore, si për shembull përmes kundërshtimit të vendimeve përkatëse që përcaktojnë kornizën e nxjerrjes së materialeve dhe vendimeve të mëpashme lidhur me nxjerrjen e materialeve dhe/ose masat mbrojtëse, sipas rastit. Trupi Gjyqësor gjithashtu vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk konstatoi asnjëherë mangësi në procesin e nxjerrjes së materialeve. Në fakt, Mbrojtja i referohet vetëm një rasti kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se vonesa në nxjerrjen e materialeve shfajësuese nga Prokuroria ishte “e konsiderueshme”, dhe ndërmori menjëherë masa ndreqëse, duke i zgjatur Mbrojtjes afatet për parashtrimin e kundërshtimeve ndaj pranueshmërisë së materialit provues dhe dorëzimin e Dosjes Paraprake, si edhe afatin për kalimin e çështjes për gjykim.<sup>49</sup>

44. Në shembujt e tjerë të shkeljeve të pretenduara në nxjerrjen e materialeve që përmend,<sup>50</sup> Mbrojtja shtrembëron ose nuk merr parasysh kornizën ligjore lidhur me nxjerrjen e materialeve në Dhomat e Specializuara. Për shembull, kur pretendon se

---

<sup>48</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 294-301.

<sup>49</sup> KSC-BC-2020-04, F00234, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2) dhe Kërkesat në lidhje me Të*, 20 korrik 2022, konfidencial, para. 30-31, 46(d)-(f). Versioni i redaktuar publik u protokollua më 8 gusht 2022, [F00234/RED](#).

<sup>50</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 294, poshtëshënimi 662.

ZPS-ja nxori me vonesë materialin 110670-110674, i cili u nxor më 24 shkurt 2023, Mbrojtja nuk përmend faktin që ky dokument iu dërgua ZPS-së vetëm katër javë para asaj date, përkatësisht më 27 janar 2023, dhe ka të bëjë me një aspekt mjaft të kufizuar të çështjes gjyqësore, që për mendimin e Trupit Gjyqësor nuk mund të ndikojë në të drejtat e z. Shala për gjykim të drejtë. Po kështu, Mbrojtja i referohet nxjerrjes me vonesë, sikurse pretendohet, të datës 11 gusht 2022 (domethënë, gjatë fazës paraprake) të 57 materialeve, në paketën 77 të materialeve të nxjerra sipas rregullës 103 të Rregullores, por shpërfill faktin se dispozita, ashtu sikurse interpretohet, përcakton qartësisht detyrimin në vijimësi të nxjerrjes së materialit shfajësues gjatë gjithë procesit.<sup>51</sup>

45. Mbrojtja u referohet edhe disa rasteve të tjera të nxjerrjes me vonesë të provave të cilat Trupi Gjyqësor i ka shqyrtuar më herët dhe konstatoi se Mbrojtjes nuk i është shkaktuar asnjë dëm.<sup>52</sup>

46. Trupi Gjyqësor vlerëson se shembujt e rastësishëm që zgjodhi Mbrojtja në mbështetje të pretendimeve se ZPS-ja kreu shkelje në nxjerrjen e provave gjatë gjithë procesit, janë të pamjaftueshëm për të përmbushur ndonjë kriter për konstatimin e shkeljes së të drejtave të z. Shala për gjykim të drejtë.

47. Kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me këtë pikë hidhen poshtë.

---

<sup>51</sup> [Framework Decision on Disclosure](#) (Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave), para. 54 dhe referencat aty.

<sup>52</sup> KSC-BC-2020-04, F00813, Trupi Gjyqësor I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Rihapjen e Paraqitjes së Provave të Saj*, 19 mars 2024, konfidencial, para. 21. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, [F00813/RED](#).

F. SHKELJA E SË DREJTËS SË Z. SHALA PËR NDIHMË JURIDIKE TË EFEKTSHME DHE PËR MBROJTJE NGA VETINKRIMINIMI

48. Mbrojtja parashton se të gjitha transkriptet e intervistave me z. Shala duhet të mos merren parasysh në kuvendimet e Trupit Gjykses për Aktgjykimin, mbi bazën se këto deklaratat u morën në shkelje të së drejtave të z. Shala për gjykim të drejtë.<sup>53</sup> Z. Shala i dha dy deklaratat Zyrës së Prokurorisë së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), më 2005 dhe 2007 (“deklaratat e 2005-ës dhe 2007-ës”), dhe dy deklaratat Policisë Gjyqsore Federale të Belgjikës më 2016 dhe 2019 (deklaratat e 2016-ës dhe 2019-ës).<sup>54</sup>

49. Trupi Gjykses rikujton se kjo pikë është debatuar gjerësisht para Trupit Gjykses<sup>55</sup> dhe është shqyrtuar gjithashtu edhe nga Paneli i Gjykatës së Apelit dhe nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese. Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi vendimin e parë të Trupit Gjykses për ta konsideruar deklaratën e 2016-ës si jo të papranueshme në bazë të rregullës 138(2) të Rregullores dhe rrëzoi apelin e z. Shala në lidhje me deklaratat e tjera.<sup>56</sup> Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese e deklaroi të parakohshme dhe rrjedhimisht, të papranueshme kërkesën referuese dhe e hodhi poshtë tërësisht.<sup>57</sup>

---

<sup>53</sup> Dosja Gjyqsore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 302-310; T. 17 prill 2024, publik, f. 4290, rreshti 13 deri në f. 4293, rreshti 22.

<sup>54</sup> KSC-BC-2020-04, F00364, Trupi Gjykses I, *Vendim në Lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala* (Vendimi mbi Deklaratat e Mëparshme), 6 dhjetor 2022, konfidencial, para. 11. Versioni i korrigjuar dhe versioni i redaktuar publik i versionit të korrigjuar, përkatësisht F00264/COR dhe F00364/COR/RED, u protokolluan më 8 dhjetor 2022 dhe 26 janar 2023.

<sup>55</sup> [Decision on Prior Statements](#) (Vendimi mbi Deklaratat e Mëparshme).

<sup>56</sup> KSC-BC-2020-04, IA006-F00007, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Shala's Appeal Against Decision Concerning Prior Statements](#) (Vendim mbi Apelin e Shalës kundër Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë) (Vendimi i Apelit kundër Vendimit mbi Deklaratat e Mëparshme), 5 maj 2023, publik, para. 109.

<sup>57</sup> KSC-CC-2023-21, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Decision on the Referral of Pjetër Shala to the Constitutional Court Panel Concerning the Violation of Mr Shala's Fundamental Rights Guaranteed by Articles 31, 32, and 54 of the Kosovo Constitution and Articles 6 and 13 of the European](#)

50. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues vlerëson se Mbrojtja thjesht përpiqet të ngrejë edhe një herë juridikisht këtë pikë dhe nuk e sheh të arsyeshme të shqyrtojë më tej këtë kundërshtim të Mbrojtjes, i cili hidhet poshtë.

#### G. PABARAZIA E PALËVE

51. Mbrojtja parashtron se parimi i barazisë së palëve i mishëruar në nenin 21 të Ligjit u shkel si vijon: (i) Mbrojtja nuk mundi t'i kundërshtonte provat e disa dëshmitarëve të ZPS-së përmes marrjes së tyre në pyetje, për arsye se nuk ishin të disponueshëm për të dëshmuar dhe disa prej tyre kishin ndërruar jetë; (ii) redaktimet e zbatuara në materialet që u nxorën për Mbrojtjen ishin të tepruara; (iii) masat mbrojtëse kufizuan qasjen e Mbrojtjes në informacion relevant dhe i hoqën mundësinë që t'i ballafaqonte me efektivitet dëshmitarët e ZPS-së; dhe (iv) Mbrojtjes iu bë presion për kalimin e çështjes në fazën e gjykimit para përfundimit të hetimeve të saj.<sup>58</sup>

52. Së pari, sa i përket pamundësisë së Mbrojtjes për t'i ballafaquar disa dëshmitarë të cilët nuk mund të dëshmonin, Trupi Gjykues rikujton se Rregullorja ofron mundësi alternative për paraqitjen e provave të ndryshme nga dëshmia gojore në rast se dëshmitarët janë të padisponueshëm, ndër të tjera, për shkak se kanë ndërruar jetë.<sup>59</sup> Sikurse ka konfirmuar Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, këto mundësi alternative janë në përputhje me Kushtetutën dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht të gjykimit të drejtë.<sup>60</sup> Gjithashtu, sikurse përcaktohet në

---

[Convention on Human Rights](#) (Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut), 29 gusht 2023, publik, f. 12.

<sup>58</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 311-326.

<sup>59</sup> Rregulla 155 e Rregullores.

<sup>60</sup> KSC-CC-PR-17-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, [Judgment on the Referral of the Rules of Procedure and Evidence Adopted by Plenary on 17 March 2017 to the Specialist Chamber of the Constitutional Court Pursuant to Article 19\(5\) of Law no. 05-L-053 on Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office, 26 April 2017](#), (Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave

rregullën 140(4)(a) të Rregullores, vendimi i fajësisë nuk mund të bazohet vetëm, ose në një masë vendimtare, në deklaratën e një dëshmitari të cilin Mbrojtja nuk kishte mundësi ta merrte në pyetje, duke ofruar kështu garanci për mbrojtjen e të drejtave të akuzuarit. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton se, pavarësisht nga modaliteti i paraqitjes së një prove për përfshirje në dokumentacionin e gjykimit, në bazë të rregullës 139(2) të Rregullores, Trupi Gjykses duhet çdo herë të vlerësojë të gjitha provat në mënyrë tërësore, dhe t'i peshojë ato gjatë vlerësimit nëse ZPS-ja ka përmbushur detyrimin e vërtetimit *jashtë dyshimit të arsyeshëm*. Kalimi i kohës dhe përkeqësimi i mundshëm i cilësisë së provave nuk përbëjnë arsye, në vetvete, që e bëjnë të padrejtë procesin, por janë faktorë që mund të vlerësohen kur shqyrtohet mbështetshmëria, vlera provuese dhe përfundimisht, pesha e provave.<sup>61</sup>

53. Së dyti, sa u përket argumenteve se masat mbrojtëse, përfshirë redaktimet, i cenuan Mbrojtjes aftësinë për të kryer hetimet, për t'u përgatitur për gjykim dhe për t'i ballafaquar dëshmitarët gjatë gjykimit,<sup>62</sup> Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja përpiqet, pjesërisht, të ngrejë edhe një herë juridikisht aspekte të shqyrtuara më parë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykses.<sup>63</sup> Disa argumente të tjera përkojnë me parashtrimin e Mbrojtjes se nuk pati kohë të mjaftueshme për të kryer hetime dhe ato trajtohen në mënyrë më të përshtatshme më poshtë.<sup>64</sup> Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se iu cenua aftësia për ballafaqimin e dëshmitarëve, Trupi

---

miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar) publik, para. 206.

<sup>61</sup> *Shih, ngjashëm, [Mustafa Trial Judgment](#), (Aktgjykimi Mustafa), para. 36.*

<sup>62</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 314-321.

<sup>63</sup> *Shih, për shembull, KSC-BC-2020-04, F00053, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendimi i Dytë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse ("Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse"), 12 korrik 2021, rreptësisht konfidencial dhe ex parte, para. 15. Versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më të njëjtën ditë, F00053/CONF/RED; F00439, Trupi Gjykses I, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Vazhdimin e Masave Mbrojtëse sipas Rregullës 81, 27 shkurt 2023, para. 39-42. Versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më 9 mars 2023, F00439/CONF/RED.*

<sup>64</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 316, 318.

Gjykues rikujton se në bazë të nenit 21(6) të Ligjit, mund të vendosen kufizime të nxjerrjes së provave për të mbrojtur dëshmitarët, viktimat dhe personat e tjerë të rrezikuar, sikurse përcaktohet në nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullat 80 dhe 108 të Rregullores. Ndërveprimi midis këtyre dispozitave ka për qëllim të arrijë balancën midis të drejtave të të akuzuarit dhe detyrimit për të mbrojtur dëshmitarët, viktimat dhe personat e tjerë të rrezikuar.<sup>65</sup>

54. Duke mbajtur këtë parasysh, Trupi Gjykues thekson se ZPS-ja, Mbrojtja, Mbrojtësi i Viktimave, si edhe vetë Trupi Gjykues, kishin mundësinë që t'u bënin pyetje të shumta dëshmitarëve të ZPS-së me masa mbrojtëse të miratuara dhe morën dëshmi prej tyre gjatë gjithë gjykimit, kur ishte e nevojshme në seancë private për të mbrojtur dëshmitarët, por edhe për t'u mundësuar palëve që t'i bënin pyetjet më lirshëm. Si rezultat i kësaj, palët bënë parashtrime materiale gjatë vetë gjykimit, në dosjet gjyqësore përfundimtare dhe deklaratat përmbyllëse të tyre, që shërbyen si bazë për vendimin e Trupit Gjykues në Aktgjykim. Në rast se Mbrojtja do të ishte dëmtuar nga masat mbrojtëse në masën që pretendon, të gjitha këto parashtrime nuk do të ishin bërë ashtu si u bënë.

55. Për mendimin e Trupit Gjykues, gjatë gjithë gjykimit është arritur balanca midis mbrojtjes së dëshmitarëve, viktimave dhe personave të tjerë të rrezikuar dhe detyrimit për të garantuar të drejtën e z. Shala për gjykim të drejtë. Argumentet e Mbrojtjes lidhur me këtë pikë janë rrjedhimisht, të pathemelta.

56. Së fundi, sa i takon argumentit të Mbrojtjes se iu bë presion që çështja të kalohej për gjykim kur ende nuk i kishte përfunduar hetimet,<sup>66</sup> Trupi Gjykues thekson se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk përcakton si kriter që gjykimi mund të fillojë vetëm pasi të kenë përfunduar hetimet e Mbrojtjes. Arsyeja për këtë është

---

<sup>65</sup> [Framework Decision on Disclosure](#) (Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave), para. 28, 77.

<sup>66</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 322-326.

pikërisht që të mbrohet e drejta e Mbrojtjes për të vazhduar me hetimet gjatë kohës që ZPS-ja paraqet provat e veta në gjykim, në mënyrë që i akuzuari të mund të përshtatë provat dhe argumentet e veta, të cilat paraqiten të fundit.

57. Në rrethanat konkrete, Trupi Gjykses gjithashtu nënvizon se, pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen Trupit Gjykses më 21 shtator 2022,<sup>67</sup> Mbrojtja bëri të ditur se do të ishte e përgatitur për gjykim në janar 2023.<sup>68</sup> Gjykimi filloi më vonë, më 21 shkurt 2023.<sup>69</sup> Më pas, me mbylljen e paraqitjes së provave të ZPS-së më 6 korrik 2023, Trupi Gjykses i miratoi Mbrojtjes edhe një muaj shtesë për të kryer hetime të mëtejshme dhe për të dorëzuar listën e dëshmitarëve të vet,<sup>70</sup> krahas zgjatjes së afatit për dorëzimin e mocionit sipas rregullës 130<sup>71</sup> dhe të përgjigjes ndaj mocionit të ZPS-së për pranimin e provave dokumentare.<sup>72</sup>

58. Duke mbajtur parasysh masat që mori për t'i mundësuar Mbrojtjes që të vazhdonte hetimet dhe përgatitjet gjatë gjithë gjykimit, Trupi Gjykses i gjykon si të pathemelta argumentet e Mbrojtjes se iu bë presion që çështja të kalohej për gjykim.

---

<sup>67</sup> [Decision Transmitting the Case File to Trial](#) (Vendimi mbi Kalimin e Çështjes Gjyqësore për Gjykim), para. 10.

<sup>68</sup> [Decision on Date for the Commencement of the Trial](#) (Vendimi mbi Datën e Fillimit të Gjykimit), para. 6, u referohet parashtrimeve të Mbrojtjes në lidhje me gatishmërinë e saj për gjykim: KSC-BC-2020-04, F00305, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes sipas Urdhrit për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin*, 10 tetor 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 10. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F00305/RED.

<sup>69</sup> T. 21 shkurt 2023, publik, f. 497, rreshtat 11-12.

<sup>70</sup> KSC-BC-2020-04, F00591, Trupi Gjykses I, [Decision on the Defence request for an extension of time for the submission of its lists of witnesses and exhibits \(F00583\)](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Paraqitjen e Listave të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale), 14 korrik 2023, publik, para. 14(a)-(b).

<sup>71</sup> KSC-BC-2020-04, F00580, Trupi Gjykses I, [Decision on the Defence request for an extension of time and word limit for its motion under Rule 130 of the Rules](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatje Afati dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve për Mocionin e Saj sipas Rregullës 130 të Rregullores), 11 korrik 2023, publik, para. 12(a)-(b).

<sup>72</sup> KSC-BC-2020-04, F00586, Trupi Gjykses I, [Decision on the Defence Requests for an Extension of Time \(F00582\)](#) (Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Zgjatje Afati), 13 korrik 2023, publik, para. 16(b)-(c).

## H. SHKELJA E SË DREJTËS PËR PROCES PUBLIK

59. Mbrojtja parashton se e drejta e z. Shala për proces publik u cenua për shkak të përdorimit të tepruar të seancave private gjatë gjykimit.<sup>73</sup>

60. Trupi Gjykses vë në dukje se përdorimi i seancave private (ose të mbyllura) përfshihet në masat e disponueshme për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, në përputhje me rregullën 80(4)(b) të Rregullores. Trupi Gjykses më lart qartësoi se masat mbrojtëse miratohen për të arritur balancën midis detyrimit për të mbrojtur dëshmitarët, viktimat dhe personat e tjerë të rrezikuar dhe detyrimit për të garantuar të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21 të Ligjit.<sup>74</sup>

61. Duke mbajtur parasysh rëndësinë e së drejtës së z. Shala për gjykim të drejtë, Trupi Gjykses urdhëroi palët dhe Mbrojtësin e Viktimave që të kryenin rishikime të rregullta të transkripteve me synimin e heqjes së redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e tyre në publike.<sup>75</sup> Këto masa kompensuese më vete mjaftojnë për t'iu përgjigjur shqetësimeve të Mbrojtjes dhe njëkohësisht garantojnë mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

62. Në bazë të sa më lart, argumentet e Mbrojtjes duhen hedhur poshtë.

## I. DËMI NGA PASIGURIA LIDHUR ME PROVAT E ADMINISTRUARA KUNDËR Z. SHALA

63. Mbrojtja parashton se sistemi i pranimit të provave jोगojore që miratoi Trupi Gjykses në Vendimin mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave Jोगojore

---

<sup>73</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 327-330.

<sup>74</sup> *Shih* para. 53 më lart.

<sup>75</sup> *Shih* KSC-BC-2020-04, F00476, Trupi Gjykses I, [Order for submissions on the lifting of redactions and/or the reclassification of transcripts of trial hearings](#) (Urdhër për Parashtrime lidhur me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore), 4 prill 2023, publik; F00510, Trupi Gjykses I, [Second order for submissions on the lifting of redactions and/or reclassification of transcripts of trial hearings](#) (Urdhri i Dytë për Parashtrime lidhur me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore), 15 maj 2023, publik.



(“Vendimi Kornizë mbi Provat”)<sup>76</sup> shkel të drejtën e z. Shala për të ditur me siguri provat kundër tij dhe për të pasur mundësi efektive t’u përgjigjet atyre.<sup>77</sup>

64. Trupi Gjykses thekson se argumentet që aktualisht paraqet Mbrojtja i ka shqyrtuar më parë në Vendimin Kornizë mbi Provat.<sup>78</sup> Në qoftë se ka gjykuar se sistemi i pranimit të provave jogojore i miratuar nga Trupi Gjykses dëmton të drejtat e z. Shala për gjykim të drejtë, Mbrojtja duhej dhe mund të kishte kërkuar rishikimin e Vendimit Kornizë mbi Provat, ose leje për ta apeluar atë. Në vend të kësaj, Mbrojtja iu përmbajt atij sistemi gjatë gjithë gjykimit, ndër të tjera duke bërë parashtrime në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare<sup>79</sup> dhe deklaratat përmbyllëse<sup>80</sup> lidhur me provat e disponueshme për shqyrtim nga Trupi Gjykses. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se argumentet e Mbrojtjes në lidhje me këtë aspekt janë thjesht përpjekje për ta ngritur edhe një herë këtë pikë.

65. Rrjedhimisht, ky kundërshtim hidhet poshtë.

J. KUFIZIME TË PAPËRLIGJURA TË SË DREJTËS PËR BALLAFAQIMIN E  
DËSHMITARËVE KUNDËR Z. SHALA

66. Mbrojtja parashtron se, pavarësisht nga kufizimet e përcaktuara në nenin 31(4) të Kushtetutës dhe rregullat 141 dhe 153 të Rregullores në lidhje me pranimin e deklaratave me shkrim të dëshmitarëve, Trupi Gjykses pranoi si prova deklaratat me

---

<sup>76</sup> KSC-BC-2020-04, F00461, Trupi Gjykses I, [Decision on the submission and admissibility of non-oral evidence](#), (Vendim mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave Jogojore), 17 mars 2023, publik.

<sup>77</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 331-343.

<sup>78</sup> [Framework Decision on Evidence](#) (Vendimi Kornizë mbi Provat), para. 15-20.

<sup>79</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 34-265.

<sup>80</sup> *Shih, për shembull*, T. 16 prill 2024, konfidencial, f. 4235, rreshti 18 deri në f. 4263, rreshti 24.

shkrim të dëshmitarëve TW4-02 dhe TW4-04, pa mundësinë që Mbrojtja t'i ballafaqonte ata.<sup>81</sup>

67. Në mënyrë të ngjashme, Mbrojtja ankohet në lidhje me pranimin e deklaratave me shkrim të W04733-shit dhe W01448-ës, të cilët kanë ndërruar jetë, dhe kërkon që provave të tilla t'u jepet pak ose aspak vlerë provuese dhe se ato duhet të përjashtohen si jo të mbështetshme.<sup>82</sup>

68. Mbrojtja më tej parashtron se udhëzimet e Trupit Gjykses për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të ZPS-së përmes pyetjeve të hapura, së bashku me udhëzime të tjera se si t'i ballafaqojë dëshmitarët, e vunë Mbrojtjen në pozitë të pafavorshme kundrejt ZPS-së, të cilës nuk iu dhanë udhëzime të ngjashme gjatë pyetjeve të saj për dëshmitarët.<sup>83</sup>

69. Trupi Gjykses rikujton se pranimi i deklaratave me shkrim të dëshmitarëve është një nga mekanizmat përmes të cilëve palët mund të paraqesin provat e tyre, të përcaktuar në rregullat 153 dhe 155 të Rregullores, të cilat janë formuluar për të siguruar procedura të shpejta.<sup>84</sup> Kur bën vlerësimin e tërësisë së provave të disponueshme për aktgjykim, Trupi Gjykses ka për detyrë të vlerësojë peshën që do t'u japë deklaratave të tilla duke mbajtur parasysh provat e tjera të administruara, si dhe pamundësinë e palëve, Mbrojtësit të Viktimave dhe Trupit Gjykses për ballafaqimin e atyre dëshmitarëve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk gjykon se pranimi si provë i deklaratave përkatëse me shkrim më vete cenon të drejtat e z. Shala për gjykim të drejtë. Në nxjerrjen e konstatimeve faktike në këtë Aktgjykim, Trupi Gjykses ka vlerësuar besueshmërinë dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e këtyre

---

<sup>81</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 344-345; T. 17 prill 2024, publik, f. 4299, rreshtat 6-15.

<sup>82</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 346; T. 17 prill 2024, publik, f. 4299, rreshti 16 deri në f. 4300, rreshti 21.

<sup>83</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 347-352.

<sup>84</sup> [Framework Decision on Evidence](#) (Vendimi Kornizë mbi Provat), para. 32.

dëshmitarëve dhe i ka peshuar ato duke mbajtur parasysh të gjitha provat e administruara në këtë çështje gjyqësore dhe në përputhje me parimet e mishëruara në Rregullore.

70. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se u vu në pozitë të pafavorshme si pasojë e udhëzimeve të Trupit Gjyqësor për mënyrën e pyetjes së dëshmitarëve të ZPS-së, Trupi Gjyqësor rikujton se udhëzimet që jep për mënyrën e pyetjes së dëshmitarëve vlejné për të dy palët dhe Mbrojtësin e Viktimave dhe bazohen, para së gjithash, në parimin e efikasitetit.<sup>85</sup> Në përputhje me këtë, kur gjykohe se pyetjet janë joefikase, ato kufizohen nga Kryegjykatësi në përputhje me kompetencat që ka në bazë të rregullës 143(4) të Rregullores.<sup>86</sup> Po kështu, pyetjet sugjeruese nuk ndalohen, por mund të parashtrihen vetëm kur ndihmojnë në kryerjen e shpejtë të gjykimit dhe përcaktimin e të vërtetës, përsëri nën kompetencën e Kryegjykatësit për të ushtruar kontroll mbi mënyrën e pyetjes së dëshmitarëve.<sup>87</sup>

71. Kur jep shembuj të kufizimit të pretenduar të saj në mënyrën e pyetjes së TW4-01-shit, Mbrojtja shpërfill kornizën ligjore të sipërpërmendur dhe udhëzimet sipas të cilave vepruan të dyja palët dhe Mbrojtësi i Viktimave gjatë gjykimit. Trupi Gjyqësor ka vlerësuar dëshminë e marrë nga TW4-01 duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të disponueshme për vendimin e aktgjykimit, në kontekst të parashtrimeve të palëve në lidhje me këtë dëshmitar, dhe asaj i ka dhënë peshën që e gjykoi të arsyeshme në këtë Aktgjykim.

72. Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes lidhur me këtë pikë hidhen poshtë.

---

<sup>85</sup> KSC-BC-2020-04, F00434, Trupi Gjyqësor I, *Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit* ("Vendimi mbi Zhvillimin e Gjykimit"), 24 shkurt 2023, konfidencial, para. 41. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, [F00434/RED](#).

<sup>86</sup> [Decision on Conduct of Proceedings](#) (Vendimi mbi Zhvillimin e Gjykimit), para. 41.

<sup>87</sup> [Decision on Conduct of Proceedings](#) (Vendimi mbi Zhvillimin e Gjykimit), para. 41.

## K. PËRFUNDIM

73. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se asnjë nga shembujt që paraqet Mbrojtja, marrë veç e veç ose bashkërisht, nuk ndikojnë në drejtësinë e procesit, të drejtat e z. Shala apo përgatitjen e Mbrojtjes.

## V. ASPEKTE TË PROVAVE

### A. PREZUMIMI I PAFAJËSISË DHE STANDARDI I VËRTETIMIT

74. Trupi Gjykses në vijim do të përcaktojë parimet lidhur me provat mbi të cilat i ka mbështetur konstatimet e veta në këtë Aktgjykim.<sup>88</sup> Sikurse garantohet në nenin 31(5) të Kushtetutës dhe nenin 21(3) të Ligjit, i akuzuari konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij. Në përputhje me nenin 21(3) të Ligjit dhe rregullat 140(1) dhe 158(3) të Rregullores, trupi gjykses mund ta shpallë një të akuzuar fajtor në qoftë se fajësia vërtetohet jashtë dyshimit të arsyeshëm. Dyshimi i arsyeshëm duhet të bazohet në arsye dhe nuk mund të jetë dyshim imagjinar ose i kotë, por duhet të ketë lidhje racionale me provat, mungesën e provave ose mospërputhjet në prova.<sup>89</sup> Detyrimin e vërtetimit e ka vetëm ZPS-ja.<sup>90</sup>

75. Sikurse përcaktohet në rregullën 140 të Rregullores, standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm zbatohet për faktet që përbëjnë elementet e veprës penale dhe

---

<sup>88</sup> [Mustafa Trial Judgment](#), (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 27-48.

<sup>89</sup> KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjykses II, [Public Redacted Version of the Trial Judgment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit) (“Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*”), 18 maj 2022, publik, para. 36. Ngjashëm, International Criminal Court (ICC), *Prosecutor v. Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-02/12-271-Corr, Appeals Chamber, [Judgment on the Prosecutor’s appeal against the decision of Trial Chamber II entitled “Judgment pursuant to article 74 of the Statute”](#) (Ngudjolo Chui Appeal Judgment), 7 April 2015, para. 109, citon International Criminal Tribunal for Rwanda (ICTR), *Rutaganda v. Prosecutor*, ICTR-96-3-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 26 May 2003, para. 488.

<sup>90</sup> *Shih gjithashtu, Gucati and Haradinaj Trial Judgment*, (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 34.

të formave të përgjegjësive penale që përmban aktakuza, si dhe për fakte të tjera nga të cilat varet vendimi i fajësisë.<sup>91</sup> Çka është e rëndësishme, standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm nuk zbatohet veças për secilën provë. Përkundrazi, Trupi Gjykses bën vlerësim dhe peshim tërësor të të gjitha provave të marra në tërësi, sikurse theksohet në rregullën 139(2) të Rregullores, për të përcaktuar nëse janë vërtetuar ose jo faktet në fjalë.

76. Në lidhje me provat rrethore (që janë prova për fakte dytësore nga të cilat mund të deduktohet në mënyrë të arsyeshme një fakt juridikisht thelbësor),<sup>92</sup> standardi i vërtetimit, sipas rregullës 140(3) të Rregullores, përmbushet vetëm në qoftë se përfundimi që nxirret prej këtyre provave është i vetmi përfundim i arsyeshëm.

#### B. PROVAT E ADMINISTRUARA PREJ TRUPIT GJYKUES

77. Provat që disponon Trupi Gjykses për kuvendimet e veta përfshijnë: (i) dëshmitë gojore të 16 dëshmitarëve (ku nuk përfshihen dëshmitarët ekspertë) – 7 prej tyre të thirrur nga ZPS-ja dhe 9 të thirrur nga Mbrojtja – të cilët dhanë dëshmi para Trupit Gjykses (ose në selinë e Dhomave të Specializuara, ose përmes videokonferencës),<sup>93</sup> së bashku me pjesë të deklaratave të tyre me shkrim të cilat iu lexuan dëshmitarëve dhe u diskutuan me ta në sallën e gjyqit, të cilat janë pjesë

---

<sup>91</sup> KSC-CA-2023-02, F00038/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Appeal Judgment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), 14 dhjetor 2023, publik, para. 368 dhe referencat aty.

<sup>92</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 29; [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 42.

<sup>93</sup> KSC-BC-2020-04, F00482, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Dëshmi përmes Videokonferencës për TW4-04-ën, TW4-10-n dhe TW4-11-shin*, 13 prill 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik, përkatësisht F00482/CONF/RED dhe [F00482/RED](#), u lëshuan më të njëjtën ditë (dëshmia e TW4-04-ës në fund u paraqit me shkrim në bazë të rregullës 153 të Rregullores); Urdhër Gojor, T. 24 nëntor 2023, konfidencial, f. 3625, rreshti 16 deri në f. 3626, rreshti 15.

përbërëse e dëshmime të tyre;<sup>94</sup> (ii) deklaratat me shkrim të 10 dëshmitarëve (7 dëshmitarë të ZPS-së dhe 3 dëshmitarë të Mbrojtjes), të cilat u pranuan në vend të dëshmime gojore të tyre në bazë të rregullës 153 të Rregullores (4 dëshmitarë) dhe rregullës 155 të Rregullores (6 dëshmitarë), së bashku me dokumente që lidhen me to, ose prova materiale shoqëruese;<sup>95</sup> (iii) katër deklarata me shkrim të z. Shala, së bashku me material shoqëruar;<sup>96</sup> (iv) prova dokumentare, që përfshijnë, ndër të tjera, fotografi, audiomateriale, videomateriale, dokumente të brendshme të UÇK-së, raporte, harta (kadastrale), artikuj mediash, materiale nga rrjetet sociale dhe pjesë të nxjerra nga libra; dhe (v) dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë dhe/ose aktekspertizat e 7 ekspertëve – 3 të thirrur prej ZPS-së, 2 të thirrur prej Mbrojtësit të Viktimave, me lejen e Trupit Gjykses, dhe 2 të thirrur prej Mbrojtjes.<sup>97</sup>

<sup>94</sup> [Framework Decision on Evidence](#) (Vendimi Kornizë mbi Provat), para. 59.

<sup>95</sup> KSC-BC-2020-04, F00556, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesat e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës sipas Rregullës 153 të Rregullores* (“Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153”), 23 qershor 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 17 korrik 2023, [F00556/RED](#); F00562, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155 të Rregullores* (“Vendimi mbi Pranimin e Provave sipas Rregullës 155”), 4 korrik 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më 16 gusht 2023, [F00562/RED](#); F00703, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Pranimin e Provave të W03881-shit sipas Rregullës 153 të Rregullores (F00656) ose, si alternativë, për Thirrjen e Dëshmitarit W03881 sipas Rregullës 121(3) të Rregullores (F00657)* (“Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153”), 1 nëntor 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar u lëshua më 13 dhjetor 2023, [F00703/RED](#); F00759, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Pranimin e Provave të DW4-01-shit sipas Rregullave 153 dhe 155 të Rregullores dhe Çështje që lidhen me To*, 8 janar 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, [F00759/RED](#); F00784, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Pranimin e Provave (F00770/COR e F00771) dhe Provat e Kërkuara nga Trupi Gjykses* (“Vendimi mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155”), 24 janar 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, [F00784/RED](#).

<sup>96</sup> [Decision on Prior Statements](#) (Vendimi mbi Deklaratat e Mëparshme); [Decision on Appeal against Decision on Prior Statements](#) (Vendimi mbi Apelin kundër Vendimit mbi Deklaratat e Mëparshme), para. 109.

<sup>97</sup> KSC-BC-2020-04, F00639, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionet e Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtjes për Pranimin e Materialeve që lidhen me Dëshmitarët Ekspertë W04887, W04826 dhe W04875* (“Vendimi mbi Pranimin e Aktekspertizave të ZPS-së”), 6 shtator 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, publike. Versioni i redaktuar publik i vendimit u lëshua më 26 shtator 2023, [F00639/RED](#); Urdhër Gojor: T. 25 tetor 2023, publik, f. 3151, rreshti 9 deri në f. 3153, rreshti 8; F00794, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesat për Pranimin e Materialeve të Përdorura me Dëshmitarët W03887, W04441, W04440, DW4-03, W04280 dhe*

### C. METODOLOGJIA E PËRDORUR NGA TRUPI GJYKUES NË LIDHJE ME PROVAT

78. Në bazë të rregullës 138(1) të Rregullores, gjatë kuvendimeve, Trupi Gjykses shqyrtoi provat në dosjen e çështjes gjyqësore në përputhje me sistemin e paraqitjes dhe pranueshmërisë së provave, të vendosur nga Trupi Gjykses para fillimit të gjykimit.<sup>98</sup>

79. Trupi Gjykses ka për detyrë të nxjerrë përfundime vetëm për ato fakte të cilat janë thelbësore për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarit në lidhje me secilën prej akuzave. Rrjedhimisht, në nxjerrjen e konstatimeve faktike, Trupi Gjykses i ka diskutuar provat vetëm atë sa ishte e nevojshme për të përcaktuar nëse është përmbushur ose jo standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm në lidhje me elementet përbërëse të krimeve, format e përgjegjësisë penale dhe fakte të tjera relevante. Po kështu, Trupi Gjykses nuk ka analizuar shprehimisht çdo mospërputhje të mundshme brenda një prove, apo ndërmjet provave të ndryshme, por e ka bërë këtë *proprio motu* ose mbi bazën e kundërshtimeve të paraqitura, kur e gjykoi të nevojshme të përcaktonte nëse ishte përmbushur standardi i duhur i vërtetimit në lidhje me një element ose fakt të caktuar. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses nënvizon rëndësinë e vlerësimit të besueshmërisë, mbështetshmërisë dhe vlerës provuese të provave duke mbajtur parasysh dokumentacionin e çështjes gjyqësore në tërësi. Trupi Gjykses nuk ka trajtuar shprehimisht çdo argument të ngritur nga palët dhe pjesëmarrësit në proces, as nuk i është referuar shprehimisht asnjë dëshmie konkrete të dëshmitarëve në rastet kur në dokumentacionin e çështjes kishte prova të konsiderueshme për të kundërtën. Kur ishte e nevojshme, Trupi Gjykses shpjegoi më në hollësi arsyet dhe faktorët mbi të cilët u bazua për vlerësimin e provave. E gjithë kjo është në përputhje

---

W04405 (“Vendim mbi Pranimin e Aktekspertizës së Mbrojtjes”), 9 shkurt 2024, konfidencial, para. 41-42, 56, me Shtojcën 1, publike; Urdhër Gojor: T. 10 janar 2024, publik, f. 4072, rreshti 21 deri në f. 4074, rreshti 10.

<sup>98</sup> [Framework Decision on Evidence](#) (Vendimi Kornizë mbi Provat).

me parimin e vlerësimit lirisht të provave nga ana e Trupit Gjykses, sikurse mishërohet në rregullën 137(2) të Rregullores.<sup>99</sup>

80. Në vijim, Trupi Gjykses do të shtjellojë më në hollësi parimet kryesore mbi të cilët u bazua gjatë vlerësimit të provave, në përputhje me dispozitat e rregullave 139 dhe 140 të Rregullores.

## 1. Dëshmitë gojore

81. **Dëshmitë gojore të dëshmitarëve.** Trupi Gjykses vë në dukje rregullën 139(4) të Rregullores, sipas së cilës, gjatë përcaktimit të rëndësisë që do t'i kushtohet dëshmisë së një dëshmitari, trupi gjykses vlerëson besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në dëshminë e atij dëshmitari. Besueshmëria ka të bëjë me aspektin nëse një dëshmitar ka dëshmuar me vërtetësi, kurse mbështetshmëria, nëse dëshmia, në rast se pranohet, vërteton faktin për të cilin paraqitet, ose nëse mund të vihet në dyshim nga prova të tjera ose nga rrethana të lidhura me to.<sup>100</sup> Për këtë arsye, edhe kur një dëshmitar është i sinqertë dhe i besueshëm, ndonjëherë nuk mund të mbështetesh në dëshminë e atij dëshmitari.<sup>101</sup>

82. Trupi Gjykses ka kompetencë të plotë diskrecionale për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre, para se të mbështetet në ato dëshmi.<sup>102</sup> Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Trupi Gjykses ka marrë

---

<sup>99</sup> Ngjashëm, [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 32.

<sup>100</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit Mustafa), para. 229.

<sup>101</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit Mustafa), para. 229. *Shih gjithashtu, ICC, Prosecutor v. Lubanga, ICC-01/04-01/06-3121-Red, Appeals Chamber, Judgment on the appeal of Mr Thomas Lubanga Dyilo against his conviction* (Lubanga Appeal Judgment), 1 December 2014, para. 239.

<sup>102</sup> *Shih ICTR, Kanyarukiga v. Prosecutor, ICTR-02-78-A, Appeals Chamber, Judgment* (Kanyarukiga Appeal Judgment), 8 May 2012, para. 121 dhe referencat aty.



parasysh një numër faktorësh joshterues,<sup>103</sup> relevanca e të cilëve duhet të vlerësohet rast pas rasti.<sup>104</sup> Ndër këta faktorë përfshihen: (i) hollësitë e dhëna nga dëshmitari, të cilat tregojnë se dëshmitari i përjetoi ngjarjet personalisht;<sup>105</sup> (ii) lidhja e brendshme logjike dhe përputhshmëria e dëshmimeve të dëshmitarëve, përfshirë përputhshmëria e dëshmimeve gojore me deklaratën/deklaratat e tyre me shkrim, dhe shpjegimet e dhëna prej tyre për mospërputhjet që u diskutuan me ta në sallën e gjyqit;<sup>106</sup> (iii) lidhja e brendshme logjike dhe përputhshmëria e dëshmimeve të dëshmitarëve me prova të tjera të administruara prej Trupit Gjykses;<sup>107</sup> (iv) gjasat që dëshmia e dëshmitarit të jetë e vërtetë;<sup>108</sup> (v) orvatjet ose përpjekjet e dëshmitarit për të qenë i saktë (për shembull, pranimi se e ka të vështirë t'i kujtojë disa ngjarje ose hollësi, ose bërja e dallimit midis asaj që ka përjetuar vetë dhe asaj që ka dëgjuar nga të tjerët);<sup>109</sup> (vi) ndikimi i kalimit

<sup>103</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 35. *Shih, ngjashëm, ICC, Prosecutor v. Ongwen, ICC-02/04-01/15-1762-Red, Trial Chamber IX, Trial Judgment (Ongwen Trial Judgment), 4 February 2021, para. 260.*

<sup>104</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 233.

<sup>105</sup> *Shih, ngjashëm, ICC, Ongwen Trial Judgment, paras 255, 395; shih gjithashtu, Prosecutor v. Ntaganda, ICC-01/04-02/06-2359, Trial Chamber VI, Judgment (Ntaganda Trial Judgment), 8 July 2019, para. 78, i referohet saktësisë së informacionit të dhënë.*

<sup>106</sup> *Shih, ngjashëm, Gucati and Haradinaj Trial Judgment (Aktgjykimi Gucati dhe Haradinaj), para. 44 dhe referencat aty; ICC, Ongwen Trial Judgment, para. 256; ICTY, Prosecutor v. Prlić et al., IT-04-74-A, Appeals Chamber, Judgment, Vol. I (Prlić et al. Appeal Judgement), 29 November 2017, para. 200; ICTR, Kanyarukiga Appeal Judgement, para. 121.*

<sup>107</sup> *Shih, ngjashëm, Gucati and Haradinaj Trial Judgment (Aktgjykimi Gucati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, Prosecutor v. Bemba et al., ICC-01/05-01/13-2275-Red, Appeals Chamber, Judgment on the appeals of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo, Mr Aimé Kilolo Musamba, Mr Jean-Jacques Mangenda Kabongo, Mr Fidèle Babala Wandu and Mr Narcisse Arido against the decision of Trial Chamber VII entitled "Judgment pursuant to Article 74 of the Statute" (Bemba et al. Appeal Judgment), 8 March 2018, para. 1084, ku theksohet se konfirmimi është një nga faktorët e shumtë të mundshëm që janë relevantë për vlerësimin prej trupit gjykses të besueshmërisë dhe mbështetshmërisë në dëshminë e një dëshmitari; Ngudjolo Chui Appeal Judgment, para. 2, 170, ku thuhet se "Trupi Gjykses duhet [...] të vlerësojë besueshmërinë e një dëshmitari pjesërisht duke vlerësuar nëse përmbajtja e dëshmisë së tij konfirmohet nga dëshmi të tjera"; ICTY, Prlić et al. Appeal Judgement, para. 200; ICTR, Kanyarukiga Appeal Judgement, para. 121.*

<sup>108</sup> *Shih, ngjashëm, Gucati and Haradinaj Trial Judgment (Aktgjykimi Gucati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, Ntaganda Trial Judgment, para. 78; ICTY, Prlić et al. Appeal Judgement, para. 200; ICTR, Kanyarukiga Appeal Judgement, para. 121.*

<sup>109</sup> *Shih, ngjashëm, ICC, Prosecutor v. Bemba et al., ICC-01/05-01/13-1989-Red, Trial Chamber VII, Judgment pursuant to Article 74 of the Statute (Bemba et al. Trial Judgment), 19 October 2016, para. 203.*

të kohës dhe të traumës mbi kujtesën e dëshmitarit, që mund të ndikojnë në aftësinë e dëshmitarit për t'i rikujtuar ngjarjet siç ndodhën;<sup>110</sup> (vii) sjellja e dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë në gjyq, përfshirë gatishmëria dhe vullneti i dëshmitarit për t'iu përgjigjur pyetjeve, si dhe çdo ndryshim në qëndrim gjatë pyetjeve të palës kundërshtare;<sup>111</sup> (viii) marrëdhënia midis dëshmitarit dhe secilës palë ose Mbrojtësit të Viktimave, përfshirë ekzistencën e lidhjeve, anshmërisë, apo motiveve për ta implikuar ose shfajësuar të akuzuarin, lidhjes me anëtarë të UÇK-së, me vetë UÇK-në ose degë të saj, çfarëdo përfshirje në ngjarjet nën shqyrtim apo shtysë ose motiv tjetër për të gënjer, trilluar, për të shtrembëruar apo për të mos dhënë informacion;<sup>112</sup> (ix) qëndrimi i njëanshëm ndaj Dhomave të Specializuara dhe/ose ZPS-së që mund të ketë pasur ndikim negativ mbi vullnetin e dëshmitarit dhe ndjenjën e tij të detyrës për t'i dhënë Trupit Gjykses dëshmi që e ndihmon në përcaktimin e të vërtetës; dhe (x) tregues se dëshmitari mund të ketë qenë objekt i frikësimit, kërcënimit, trysnisë ose ndikimit, ose se është marrë vesh me dëshmitarë të tjerë.<sup>113</sup>

83. Trupi Gjykses thekson se ka kompetencë të gjerë diskrecionale gjatë vlerësimit të mospërputhjeve në dëshmi.<sup>114</sup> Në kryerjen e këtij vlerësimi, Trupi Gjykses ka mbajtur parasysh, ndër të tjera, llojin, shkallën dhe peshën e mospërputhjeve,

<sup>110</sup> *Shih, ngjashëm*, ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 79; [Bemba et al. Trial Judgment](#), para. 203; *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-3436-tENG, Trial Chamber II, [Judgment pursuant to article 74 of the Statute](#) (Katanga Trial Judgment), 7 March 2014, para. 83; *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-2842, Trial Chamber I, [Judgment pursuant to Article 74 of the Statute](#), 14 March 2012, para. 103.

<sup>111</sup> *Shih, ngjashëm*, [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 259; ICTY, [Prlić et al. Appeal Judgement](#), para. 200; ICTR, [Kanyarukiga Appeal Judgement](#), para. 121.

<sup>112</sup> *Shih, ngjashëm*, [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-2666-Red, Appeals Chamber, [Judgment on the appeals of Mr Bosco Ntaganda and the Prosecutor against the decision of Trial Chamber VI of 8 korrik 2019 entitled 'Judgment'](#) (Ntaganda Appeal Judgment), 30 March 2021, para. 17; [Ongwen Trial Judgment](#), para. 258; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 77; ICTY, [Prlić et al. Appeal Judgement](#), para. 200; ICTR, [Kanyarukiga Appeal Judgement](#), para. 121.

<sup>113</sup> *Shih, ngjashëm*, ICC, [Katanga Trial Judgment](#), para. 87.

<sup>114</sup> *Shih gjithashtu*, ICC, [Ntaganda Appeal Judgment](#), para. 18.

shpjegimet e dëshmitarëve për këto mospërputhje, faktin që dëshmitarët i përjetojnë dhe kujtojnë ngjarjet e kaluara në mënyra të ndryshme (për arsye se fizikisht nuk janë në gjendje t'i perceptojnë të gjitha hollësitë, ose sepse i kushtojnë rëndësi të ndryshme asaj që perceptojnë),<sup>115</sup> dhe ndikimin e traumës dhe të kalimit të kohës.<sup>116</sup> Në mënyrë të ngjashme, fakti që dëshmitarët mund të japin hollësi të ndryshme në momente të ndryshme gjatë dëshmive të tyre, duke përfshirë kur ballafaqohen me deklaratat e tyre të mëparshme, nuk i bën ata automatikisht mospërputhës, jo të besueshëm, apo diskrediton dëshminë e tyre. E njëjta gjë vlen edhe kur dëshmitarët nuk përmendin emrat e njëjtë të kryesve, pasi kjo mund të varet nga linjat e ndryshme të hetimit prej autoriteteve të ndryshme që kryejnë marrjen në pyetje. Po kështu është e arsyeshme të pritet që dëshmitarët të japin më shumë hollësi gjatë dëshmive të tyre në sallë të gjyqit sesa në deklaratat e mëparshme të tyre. Përfundimisht, mospërputhjet, kundërshtitë dhe pasaktësitë nuk e bëjnë automatikisht jo të mbështetshme dëshminë e një dëshmitari.<sup>117</sup>

84. Në përputhje me rregullën 139(6) të Rregullores, në disa raste, Trupi Gjykes ka pranuar pjesë të një dëshmie dhe nuk ka pranuar pjesë të tjera të saj, duke qenë i vetëdijshëm se është e mundshme që për disa aspekte dëshmia e një dëshmitari të jetë e saktë dhe e mbështetshme, dhe për aspekte të tjera e pambështetshme.<sup>118</sup> Kur kishte rezerva në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarëve, Trupi Gjykes u mbështet në

---

<sup>115</sup> Dëshmitarët mund t'u japin peshë të konsiderueshme hollësive që ishin të rëndësishme për ta dhe më pak peshë hollësive të rëndësishme më të vogël; *Shih, ngjashëm, ICC, [Bemba et al. Trial Judgment](#), para. 204; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 80.*

<sup>116</sup> Kujtimet për hollësitë kryesore të një ngjarjeje traumatike janë shpesh më të sakta dhe më të plota se kujtimet për hollësitë rastësore ose dytësore.

<sup>117</sup> *Shih, ngjashëm, [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#), (Aktgjykimi Gucati dhe Haradinaj), para. 44 dhe referencat aty, ku theksohet se "[n]ë pajtim me rregullën 139(6) të Rregullores, mospërputhjet e vogla midis dëshmive të dëshmitarëve të ndryshëm, ose midis dëshmisë së një dëshmitari të caktuar dhe deklaratave të mëparshme me shkrim të tij ose të saj, nuk u konsideruan se i zhvlerësonin këto dëshmi".*

<sup>118</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit Mustafa), para. 307; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 37. *Shih, ngjashëm, ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 260.*

dëshmitë e tyre në qoftë se ato konfirmoheshin nga prova të tjera të besueshme dhe të mbështetshme, ose kur faktorët, që përndryshe ndikonin në besueshmërinë e dëshmitarëve, nuk kishin ndikim në aspekte të veçanta të dëshmimeve të tyre. Megjithatë, në disa raste të tjera, Trupi Gjykses konstatoi se besueshmëria dhe/ose mbështetshmëria në dëshmitë e dëshmitarëve u vunë aq shumë në dyshim, sa që nuk mund të mbështetej në to edhe kur dukej se prova të tjera konfirmonin pjesë të tyre.<sup>119</sup>

85. Gjatë vlerësimit të dëshmimeve të dëshmitarëve në lidhje me identifikimin e personave ose vendndodhjeve, Trupi Gjykses mori parasysh faktorë si: (i) rrethanat në të cilat dëshmitari e kishte vëzhguar vendndodhjen ose personin; (ii) kohëzgjatjen e vëzhgimit; (iii) largësinë midis vendndodhjes apo personit të identifikuar dhe dëshmitarit; (iv) pengesat e mundshme gjatë vëzhgimit; (v) faktorë të tjerë që ndikojnë në identifikimin; (vi) kontakte të dëshmitarit me personin e identifikuar; (vii) mënyrën e përshkrimit të një vendndodhjeje ose personi nga dëshmitari; dhe (viii) nëse kishte mospërputhje, identifikime të pasakta që më pas u korrigjuan, momente harrese dhe ndikim të mundshëm nga të tjerët.<sup>120</sup>

86. Gjatë vlerësimit të dëshmimeve të dëshmitarëve në lidhje me identifikimin e z. Shala dhe/ose kryesve të tjerë, Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh: (i) pozitën, rolin dhe pushtetin e z. Shala/kryesve të tjerë në atë kohë; (ii) nofkat e përdorura nga z. Shala/kryesit e tjerë, përfshirë kur ato lidhen me ndonjë zë specifik dhe identifikues që bënin; (iii) anëtarësinë e tyre në UÇK; (iv) praninë e UÇK-së në një zonë dhe kontrollin e saj mbi atë zonë; (v) uniformat, shenjat, pajimet që mbanin; (vi) automjetet e përdorura; (vii) gjuhën e përdorur nga kryesit; (viii) sjelljen e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e veprimit; dhe (ix) identifikimin në bazë të karakteristikave fizike

---

<sup>119</sup> *Shih, ngjashëm, ICC, [Ngudjolo Chui Appeal Judgment](#), paras 1, 168.*

<sup>120</sup> *[Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 38. Shih, ngjashëm, ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 72; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3343, Trial Chamber III, [Judgment pursuant to Article 74 of the Statute](#) (Bemba Trial Judgment), 21 March 2016, para. 242 dhe referencat aty.*

dhe/ose fotografive që iu treguan dëshmitarëve në gjyq.<sup>121</sup> Trupi Gjykses i ka trajtuar me kujdes rastet kur identifikimi është bërë vetëm nga një dëshmitar në kushte të vështira, si për shembull, në errësirë, gjatë kohës që po e rrihnin disa persona, gjatë kohës që ishte i sëmurë apo pa vetëdije, ose në një çast kalimtar.<sup>122</sup> Sidoqoftë, këto dëshmi Trupi Gjykses nuk i ka përjashtuar, por i ka vlerësuar duke marrë parasysh të gjithë faktorët e lartpërmendur dhe duke mbajtur parasysh provat e tjera në dokumentacionin e çështjes. Së fundi, edhe pse njohja e mëparshme ose shkalla e njohjes së mëparshme të një dëshmitari me z. Shala është faktor relevant, fakti që një dëshmitar nuk e njohte personalisht z. Shala para ngjarjeve jo domosdoshmërisht cenon mbështetshmërinë në dëshminë identifikuese të atij dëshmitari.<sup>123</sup>

87. **Deklaratat me shkrim.** Trupi Gjykses thekson se i njëjti vlerësim i besueshmërisë dhe mbështetshmërisë vlen *mutatis mutandis* edhe për deklaratat me shkrim të paraqitura në vend të dëshmisë gojore në bazë të rregullave 153 dhe 155 të Rregullores. Megjithatë, në këto raste, Trupi Gjykses i ka kushtuar vëmendjen e duhur faktit që këta dëshmitarë nuk dëshmuuan në sallën e gjyqit dhe se palët, Mbrojtësi i Viktimave dhe Trupi Gjykses nuk patën mundësinë t'u bënin pyetje. Gjithashtu, fakti që dëshmitarët mund të japin hollësi të ndryshme në deklarata (të mëparshme) me shkrim nuk i diskrediton automatikisht dëshmitë e tyre. Sikurse u theksua më parë, e njëjta gjë vlen edhe kur dëshmitarët nuk përmendin emrat e njëjtë të kryesve, pasi kjo

---

<sup>121</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 39. *Shih, ngjashëm*, ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 73; [Bemba Trial Judgment](#), para. 243 dhe referencat aty.

<sup>122</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 39. *Shih, ngjashëm*, ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Popović et al. Appeal Judgement*), 30 January 2015, para. 382; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-A, Dhoma e Apelit, [Judgement](#) (Aktgjykim), 19 korrik 2010, para. 152-156; *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-A, Appeals Chamber, [Appeal Judgement](#), 23 October 2001, paras 39-40.

<sup>123</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 39. *Shih, ngjashëm*, ICTR, *Prosecutor v. Nyiramasuhuko et al.*, ICTR-98-42-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), Vol. I, 14 December 2015, para. 1616; *Renzaho v. Prosecutor*, ICTR-97-31-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 1 April 2011, para. 530; *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-A, Appeals Chamber, [Judgment \(Reasons\)](#), 1 June 2001, paras 327-328.

mund të varet nga linjat e ndryshme të hetimit prej autoriteteve të ndryshme që kryejnë marrjen në pyetje. Sikurse përcaktohet në rregullën 140(4) të Rregullores, Trupi Gjykses nuk e bazoi vendimin e vet vetëm, apo në masë vendimtare, në dëshmitë e këtyre dëshmitarëve.<sup>124</sup>

88. **Aktekspertizat.** Sa u përket aktekspertizave, Trupi Gjykses mori parasysh faktorë si kompetencën e vërtetuar të ekspertëve në fushën e ekspertizës së tyre, metodologjitë e përdorura, masën në të cilën konstatimet e tyre përputheshin me provat e tjera në këtë çështje gjyqësore dhe mbështetshmërinë e përgjithshme në provat e ekspertëve.<sup>125</sup>

## 2. Provat dokumentare

89. Trupi Gjykses vë në dukje se Ligji nuk përcakton kusht absolut që provat të paraqiten vetëm përmes dëshmitarëve. Gjatë vlerësimit të provave dokumentare që iu paraqitën, Trupi Gjykses mori parasysh treguesit e autenticitetit dhe mbështetshmërisë, kur kishte të tillë, si për shembull, prejardhja, autorësia ose burimi, kronologjia e mbajtjes në ruajtje, përmendja konkrete e emrave dhe vendeve, prania e stemave ose shenjave apo simboleve të tjera identifikuese dhe informacione të tjera relevante.<sup>126</sup> Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh edhe lidhjen e brendshme logjike ose përputhshmërinë e provave dokumentare me prova të tjera në këtë çështje gjyqësore. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që Trupi Gjykses nuk pranoi provat dokumentare të cilave u mungonin treguesit e mësipërm; ato u pranuan kur përmbajtja e tyre përputhej me provat që kishin lidhje me një aspekt të caktuar, në pajtim me vlerësimin tërësor të provave nga Trupi Gjykses.<sup>127</sup>

---

<sup>124</sup> *Shih* [Decision on Admission of Evidence Pursuant to Rule 155](#) (Vendimi mbi Pranimin e Provave sipas Rregullës 155), para. 26.

<sup>125</sup> *Shih, ngjashëm*, ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 54.

<sup>126</sup> *Shih, ngjashëm*, ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 57; *Bemba et al. Trial Judgment*, para. 208.

<sup>127</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 42.

### 3. Konfirmimi nga prova të tjera

90. Në përputhje me rregullën 139(3) të Rregullores, Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale të vlerësojë nëse një provë e vetme, apo disa prova të marra së bashku, mjaftojnë për vërtetimin e një fakti specifik.<sup>128</sup> Nuk ekziston një kriter i përgjithshëm që dëshmia e një dëshmitari të konfirmohet nga prova të tjera, në qoftë se ajo konsiderohet e besueshme; në fakt, konfirmimi nuk është as kusht, as garanci e mbështetshmërisë në një dëshmi të vetme.<sup>129</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ka diskrecionin që të vendosë nëse është e nevojshme që dëshmia të konfirmohet nga prova të tjera dhe të mbështetet në dëshmi të pakonfirmuara, por të besueshme të dëshmitarëve.<sup>130</sup>

### 4. Dëshmitë e dorës së dytë

91. Trupi Gjykses rikujton se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk ndalon përdorimin e dëshmimeve të dorës së dytë.<sup>131</sup> Trupi Gjykses gjithashtu vlerëson se dëshmi të tilla jo domosdoshmërisht kanë vlerë më të vogël provuese se dëshmitë e drejtpërdrejta (domethënë dëshmitë e drejtpërdrejta për çfarë panë, përjetuan ose bënë vetë dëshmitarët). Kjo, në fund të fundit, varet nga rrethanat e secilës dëshmi të dorës së dytë.<sup>132</sup> Në përgjithësi, Trupi Gjykses është treguar i kujdesshëm në vlerësimin e dëshmimeve të dorës së dytë, për të minimizuar dëmin që mund t'i

---

<sup>128</sup> Ngjashëm, [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#), (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 39.

<sup>129</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#), (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 38 dhe referencat aty.

<sup>130</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#), (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 38 dhe referencat aty.

<sup>131</sup> [Mustafa Trial Judgment](#), (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 44; [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#), (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 24.

<sup>132</sup> Ngjashëm, ICC, [Ngudjolo Chui Appeal Judgment](#), para. 226; [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 874; ICTY, [Popović et al. Appeal Judgment](#), para. 1307.

shkaktohej z. Shala nga pamundësia e ballafaqimit me burimin parësor të informacionit.<sup>133</sup>

## 5. Provat rrethanore

92. Në përputhje me rregullën 139(5) të Rregullores, Trupi Gjykses është treguar i kujdesshëm në trajtimin e provave rrethanore, si dhe ka vlerësuar me kujdes përputhshmërinë dhe lidhjen e brendshme logjike të këtyre provave përpara se të mbështetej në to.<sup>134</sup>

### D. FAKTET QË NUK ËSHTË E NEVOJSHME TË VËRTETOHEN

93. **Faktet e njohura gjerësisht.** Në bazë të rregullës 157(1) të Rregullores, Trupi gjykses nuk kërkon vërtetimin e fakteve të njohura gjerësisht, por bën konstatim gjyqësor të tyre. Në këtë çështje gjyqësore, me kërkesë të ZPS-së, Trupi Gjykses bëri konstatim gjyqësor në lidhje me 17 fakte të njohura gjerësisht.<sup>135</sup>

94. **Faktet e shqyrtuara në procese të tjera.** Në bazë të rregullës 157(2) të Rregullores, Trupi Gjykses mund të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të Specializuara, ose në procese të përfunduara të gjykatave të tjera në Kosovë, apo në sisteme gjyqësore të tjera. Megjithëse nuk ka

---

<sup>133</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#), (Aktgjykimi i Apelit Mustafa), para. 125, poshtëshënimi 296; [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#), (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 25, 43.

<sup>134</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 45.

<sup>135</sup> KSC-BC-2020-04, F00538, Trupi Gjykses I, [Decision on the Prosecution motion for judicial notice of facts of common knowledge and adjudicated facts](#) (Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Njohura Gjerësisht dhe Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera) (Vendimi mbi Faktet e Njohura dhe Faktet e Shqyrtuara), 8 qershor 2023, publik, para. 16-19, 33(b), me [Annex 1](#) (Shtojcën 1) (Lista e Fakteve të Njohura), publike, dhe Shtojcën 2 (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i Listës së Fakteve të Shqyrtuara u lëshua më 13 korrik 2023, [F00538/A02/RED](#). *Shih, në veçanti*, [List of Facts of Common Knowledge](#) (Lista e Fakteve të Njohura), f. 2-5.



nevojë që faktet e shqyrtuara në procese të tjera të vërtetohen në gjykim, një palë gjithsesi mund të paraqesë prova që kundërshtojnë saktësinë e fakteve.<sup>136</sup>

95. Në këtë çështje gjyqësore, me kërkesë të ZPS-së, Trupi Gjykes bëri konstatim gjyqësor në lidhje me 56 fakte të shqyrtuara në procese të përfunduara të TPNJ-së dhe të gjykatave në Kosovë. Faktet kanë të bëjnë kryesisht me ekzistencën e konfliktit të armatosur midis UÇK-së dhe forcave serbe.<sup>137</sup> Mbrojtja nuk paraqiti prova për të kundërshtuar saktësinë e këtyre fakteve.

#### E. ATMOSFERA E FRIKËSIMIT TË DËSHMITARËVE NË KOSOVË

96. Ky gjykim u zhvillua në një atmosferë të vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve.<sup>138</sup> Gjatë dëshmisë së vet, TW4-01 deklaroi se nuk ndihet kurrë i sigurt dhe se nuk shkon askund [REDAKTUAR].<sup>139</sup> Edhe dëshmitarët ekspertë që ekzaminuan shëndetin mendor të tij arritën në përfundimin se dëshmitari ka shqetësime për sigurinë e familjes së tij.<sup>140</sup> Gjithashtu edhe TW4-02 ishte i shqetësuar se bashkëpunimi me ZPS-në do të kishte pasoja negative për familjen e tij.<sup>141</sup> Anëtarët e familjes së W04733-shit përshkruan qartë se si ndiheshin të pasigurt dhe të stigmatizuar pas ngjarjeve në FMK të vitit 1999; kjo frikë vazhdon edhe sot e kësaj

<sup>136</sup> [Decision on Facts of Common Knowledge and Adjudicated Facts](#) (Vendimi mbi Faktet e Njohura dhe Faktet e Shqyrtuara), para. 23-24.

<sup>137</sup> [Decision on Facts of Common Knowledge and Adjudicated Facts](#), para. 25-32, 33(c); *shih, në veçanti, List of Adjudicated Facts* (Vendimi mbi Faktet e Njohura dhe Faktet e Shqyrtuara), f. 2-12.

<sup>138</sup> *Shih Mustafa Trial Judgment* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 50-57; [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#), (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 576-579; KSC-BC-2020-06, PL001/F00008, Paneli i Gjykatës Supreme, [Decision on Kadri Veseli's Request for Protection of Legality](#), (Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Mbrojtje të Ligjshmërisë), 15 gusht 2022, publik, para. 41; IA022/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Periodic Review of Detention](#), (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit), 22 gusht 2022, publik, para. 28.

<sup>139</sup> [REDAKTUAR].

<sup>140</sup> **Aktekspertiza** V4010023-V4010044, f. V4010034 [REDAKTUAR].

<sup>141</sup> **TW4-02**: 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 21, rreshti 19 deri në f. 22, rreshti 11 [REDAKTUAR].

dite.<sup>142</sup> Së fundi, kur u intervistua nga ZPS-ja në vitin 2018, W04820 konfirmoi frikën që kishte për familjen për shkak të bashkëpunimit të tij me ZPS-në.<sup>143</sup>

97. Dëshmitë e përshkruara më lart tregojnë se vazhdon të ekzistojë një atmosferë e përgjithshme e frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të Dhomave të Specializuara, familjeve të tyre dhe më gjerësisht, kundër atyre që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet të jenë kryer nga ish-anëtarë të UÇK-së. Kjo atmosferë ka pasur ndikim të dukshëm, ndonëse në masë të ndryshme, te dëshmitë e disa dëshmitarëve që u paraqitën para Trupit Gjykses. Trupi Gjykses e ka mbajtur parasysh këtë faktor gjatë vlerësimit të besueshmërisë së tyre dhe mbështetshmërisë në to.

## F. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I BESUESHMËRISË SË DËSHMITARËVE TË ZPS-SË

### 1. TW4-01

98. TW4-01 dëshmoi para Trupit Gjykses midis 30 majit dhe 6 qershorit 2023,<sup>144</sup> me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.<sup>145</sup>

99. TW4-01 është shqiptar i Kosovës, [REDAKTUAR].<sup>146</sup> [REDAKTUAR].<sup>147</sup> [REDAKTUAR].<sup>148</sup>

<sup>142</sup> *Shih* para. 700-705 më poshtë.

<sup>143</sup> **W04820**: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3814, rreshtat 20-25, *i referohet* Deklaratës së Mëparshme: 054757-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 8, rreshtat 13-17 ("PY: A jeni i shqetësuar që gjërat që mund të na thoni ne mund t'ju shkaktojnë juve, familjes tuaj probleme në të ardhmen? PË: Po, normal.").

<sup>144</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1365-1479; T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1480-1603; T. 2 qershor 2023, konfidencial, f. 1604-1728; T. 5 qershor 2023, konfidencial, f. 1729-1857; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1858-1942.

<sup>145</sup> KSC-BC-2020-04, F00036, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 17 maj 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 5-6. Versioni i redaktuar konfidencial u protokollua më të njëjtën ditë, F00036/CONF/RED.

<sup>146</sup> [REDAKTUAR].

<sup>147</sup> [REDAKTUAR].

<sup>148</sup> [REDAKTUAR].

100. Ai dëshmoi në veçanti për: (i) arrestimin e tij, [REDAKTUAR] nga anëtarë të UÇK-së, në maj të vitit 1999; (ii) ndalimin e mëpasshëm të tyre në FMK; (iii) keqtrajtimin që ata dhe të ndaluar të tjerë pësuan atje; dhe (iv) [REDAKTUAR].

101. TW4-01 dha dëshmi tejet të hollësishme, me përshkrime të imtësishme dhe të gjalla të ngjarjeve që pa dhe viktimë e të cilave ishte.<sup>149</sup> Ai i përshkroi bindshëm dhe me emocione të forta vuajtjet fizike dhe mendore që përjetoi.<sup>150</sup> Ai dëshmoi në mënyrë të qartë, koherente dhe narrative, si dhe ishte i vendosur dhe përputhës kur u mor në pyetje nga Mbrojtja. Rrëfimi i tij kishte shumë hollësi,<sup>151</sup> që të gjitha tregues për Trupin Gjykues se dëshmia e tij bazohej në ngjarje që i kishte përjetuar vetë, të gdhendura në kujtesën e tij.

102. Gjithashtu, TW4-01 ishte tejet i vendosur për të dhënë dëshmi dhe për t'i rrëfyer përjetimet e veta,<sup>152</sup> pavarësisht nga frika se (ish)anëtarë të UÇK-së mund ta dëmtonin atë ose familjen e tij.<sup>153</sup> Faktikisht, për mendimin e Trupit Gjykues, TW4-01 ishte i singertë dhe u përpoq qartësisht të jepte dëshmi të saktë. Ai pranoi menjëherë kur nuk i dinte ose nuk i kujtoheshin disa hollësi të ngjarjeve.<sup>154</sup> Kjo vihet re veçanërisht kur bëhet fjalë për z. Shala: TW4-01 bëri të qartë kur nuk i kujtohej nëse z. Shala kishte

<sup>149</sup> *Shih, për shembull*, përshkrimin prej tij të keqtrajtimit që pësoi: **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial f. 1457, rreshti 17 deri në f. 1459, rreshti 15 (“Më kanë rreh sikur qenin”); f. 1465, rreshtat 7-18; [REDAKTUAR].

<sup>150</sup> *Shih, për shembull*, **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1464, rreshtat 21-24 (“PY. A [REDAKTUAR]? PË. Po, kanë qitur normal. Ato gjona nuk i harroj kurrë se i kam në kry sa të jem gjallë”; T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1528, rreshtat 3-9; f. 1359, rreshtat 5-14; f. 1569, rreshti 8 deri në f. 1571, rreshti 15.

<sup>151</sup> [REDAKTUAR].

<sup>152</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1477, rreshtat 8-16 (“Kam ardhë për vete”); T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1572, rreshtat 8-12 (“Jo, s’muj kurrë përjetë me i lanë [kujtimet e asaj që ndodhi në Kukës] [...] M’e pas mujt, s’më kishe parë as këtu”).

<sup>153</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1574, rreshtat 3-17; **Aktekspertiza** V4010023-V4010044, f. V4010036.

<sup>154</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1465, rreshtat 19-22; f. 1469, rreshtat 19-25.

qenë i pranishëm në disa incidente<sup>155</sup> dhe dha përshkrim të nuancuar të rolit të tij, pa e mbivlerësuar pjesëmarrjen e z. Shala në ngjarjet në FMK.<sup>156</sup> Krahas kësaj, dëshmitari bëri dallim të qartë midis çfarë kishte parë dhe dëgjuar vetë dhe çfarë kishte dëgjuar nga të tjerët<sup>157</sup> dhe këmbënguli për korrigjimin e aspekteve të dëshmive të mëparshme të tij që iu lexuan.<sup>158</sup>

103. TW4-01 dha përgjithësisht dëshmi përputhëse në lidhje me keqtrajtimin që pësoi [REDAKTUAR] gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar, lëndimet që iu shkaktuan, identitetet e anëtarëve të UÇK-së që morën pjesë në keqtrajtimin e tij [REDAKTUAR] dhe praninë, identitetet dhe keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë në FMK. Çka është më e rëndësishme, sikurse shtjellohet me hollësi në analizën e provave prej Trupit Gjykues, dëshmia e TW4-01-shit konfirmohet nga dëshmi që përforcojnë njëra-tjetrën të dëshmitarëve të tjerë, ndër të cilët TW4-10, TW4-11, W04733, W01448, si edhe nga dëshmia e ekspertit mjekoligjor dr. Marek Gasior (dr. Gasior).

104. Trupi Gjykues është i vetëdijshëm se ka disa mospërputhje midis dëshmisë së TW4-01-shit dhe deklaratave të tij të mëparshme, por gjithashtu mban parasysh: (i) se dëshmitari ka dhënë deklaratat dhe intervista të shumta gjatë viteve dhe është marrë në pyetje në mënyrë të përsëritur për të njëjtat ngjarje; (ii) se autoritetet e ndryshme kanë ndjekur linja të ndryshme hetimi dhe deklaratat janë marrë dhe evidentuar në mënyra të ndryshme; (iii) llojin veçanërisht traumatik të ngjarjeve që përjetoi TW4-01 gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, [REDAKTUAR]; (iv) vështirësinë e përshkrimit të ngjarjeve të dhimbshme në mënyrë të përsëritur, veçanërisht autoriteteve të huaja; dhe (v) ndikimin e kalimit të kohës në kujtesën e TW4-01-shit. Pasi ka marrë parasysh të

---

<sup>155</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1498, rreshtat 18-20; f. 1505 rreshti 13 deri në f. 1510, rreshti 3; f. 1537, rreshtat 2-10.

<sup>156</sup> **TW4-01**: T. 2 qershor 2023, konfidencial, f. 1692, rreshtat 4-19; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1932, rreshti 19 deri në f. 1933, rreshti 14 ("Se mua 10, 12 [...] nuk më ka rreh 10, 12 herë. Se s'un ja shpifi një gjë se s'është.", i referohet z. Shala).

<sup>157</sup> Për shembull, **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1453, rreshti 18 deri në f. 1456, rreshti 6.

<sup>158</sup> Për shembull, **TW4-01**: T. 2 qershor 2023, konfidencial, f. 1677, rreshti 24 deri në f. 1679, rreshti 2.

gjithë këta faktorë, Trupi Gjykses nuk gjykon se mospërputhjet ndikojnë në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit. Trupi Gjykses i ka shqyrtuar mospërputhjet në analizën e provave, për aq sa është e nevojshme.

105. Mbrojtja kundërshton besueshmërinë e TW4-01-shit, dhe parashtron se: (i) dëshmitari nuk është në gjendje të japë dëshmi që mund të mbështetesh, meqenëse vuan nga simptoma të rënda dhe të patrajtuara të çrregullimit të stresit pastraumatik ("ÇSPT");<sup>159</sup> (ii) ka dosje penale të gjatë që përfshin dënime për vepra penale të dhunshme;<sup>160</sup> (iii) [REDAKTUAR];<sup>161</sup> (iv) ka mëri personale ndaj z. Shala dhe qëllimisht trilloi dëshmi për ta inkriminuar atë;<sup>162</sup> (v) dëshmia dhe deklaratat e tij të mëparshme përmbajnë mospërputhje thelbësore të shumta, për të cilat nuk dha arsye të besueshme;<sup>163</sup> (vi) dëshmia e tij është në mospërputhje me prova të tjera të administruara;<sup>164</sup> (vii) shumë elemente të dëshmisë së tij janë jo të besueshme dhe tejet të ekzagjeruara;<sup>165</sup> (viii) i shtoi dëshmisë së vet elemente të dëshmive të dorës së dytë, duke i paraqitur ato si dëshmi të drejtpërdrejta;<sup>166</sup> (ix) [REDAKTUAR] ka motivin për të gënjyer dhe për "ta paraqitur sa më keq" rolin dhe përgjegjësinë e z. Shala; dhe (x) u përpoq të ushtronte ndikim te dëshmitarë të tjerë duke u dhënë informacion të rremë që implikon z. Shala.<sup>167</sup> Mbrojtja parashtron se dëshmia e TW4-01-shit nuk ka

---

<sup>159</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 181-190.

<sup>160</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 191.

<sup>161</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 192-197, *i referohet* SITF00431831-SITF00431886 RED2.

<sup>162</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 198-205.

<sup>163</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 206-210.

<sup>164</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 211-222.

<sup>165</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 223-224.

<sup>166</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 227.

<sup>167</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 228-230, 259-265; *shih gjithashtu*, T. 16 prill 2024, konfidencial, f. 4253, rreshti 10 deri në f. 4262, rreshti 16.

vërtetësi, nuk është e besueshme, nuk mund të mbështetesh në të dhe duhet të hidhet poshtë në tërësi.<sup>168</sup>

106. Trupi Gjykses do t'i trajtojë me radhë argumentet e Mbrojtjes. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se TW4-01 nuk mund të japë dëshmi që mund të mbështetesh për arsye se vuan nga ÇSPT-ja,<sup>169</sup> Trupi Gjykses thekson se, megjithëse pasojat e traumës janë faktor që duhet mbajtur parasysh – sikurse vihet në dukje më lart<sup>170</sup> – trauma nuk e bën dëshminë e një dëshmitari automatikisht jo të besueshme apo të pambështetshme. Në rastin e TW4-01-shit, Trupi Gjykses mban parasysh aktekspertizën dhe dëshminë e znj. Karin Duhne-Prinsen (znj. Duhne-Prinsen) dhe dr. Shajen Lozano Parra (dr. Lozano Parra) – respektivisht psikologe dhe psikiatre<sup>171</sup> – të cilat e ekzaminuan dëshmitarin dhe deklaruan se nuk evidentuan shenja të problemeve me kujtesën.<sup>172</sup> As Trupi Gjykses nuk vërejtë probleme me kujtesën kur dëshmitari dëshmoi në sallën e gjyqit. Përkundrazi, dëshmitari ishte i qartë, koherent dhe i fokusuar, si dhe bënte dallim midis asaj që i kujtohej dhe asaj që nuk i kujtohej.<sup>173</sup> Në rast se aspekte të veçanta të dëshmisë së dëshmitarit dukej se ishin ndikuar nga trauma, Trupi Gjykses i ka shqyrtuar ato në analizën e provave.

107. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se TW4-01 nuk është i besueshëm për shkak se ka dosje të gjatë penale, Trupi Gjykses gjykon se si parim, dosja penale në vetvete nuk ndikon në besueshmërinë e dëshmitarit apo mbështetshmërinë në dëshminë e tij.

---

<sup>168</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 187.

<sup>169</sup> Duket se Mbrojtja ngatërron argumentet lidhur me ndikimin e traumës me argumentet lidhur me përputhshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit me deklaratat e tij të mëparshme dhe prova të tjera. Argumentet lidhur me ndikimin e traumës trajtohen në këtë pjesë. Argumentet lidhur me mospërputhjet (e mundshme) në dëshminë e dëshmitarit trajtohen gjetiu në këtë pjesë, ose në pjesë të tjera të këtij Aktgjykimi.

<sup>170</sup> *Shih* para. 82 më lart.

<sup>171</sup> CV: V4010045-V4010048.

<sup>172</sup> Aktekspertiza: V4010023-V4010044, f. V4010036; **Znj. Duhne-Prinsen dhe dr. Lozano Parra**: T. 21 gusht 2023, konfidencial, f. 2330, rreshti 4 deri në f. 2331, rreshti 6.

<sup>173</sup> *Shih* para. 101-102 më lart.

Duhet të vërtetohet se dosja penale e dëshmitarit është tregues i pavërtetësisë nga ana e tij, që Mbrojtja nuk e vërtetoi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e gjykon të pathemeltë këtë argument të Mbrojtjes.

108. Sa i përket [REDAKTUAR].<sup>174</sup> [REDAKTUAR].<sup>175</sup> [REDAKTUAR].<sup>176</sup>

109. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se asnjë dëshmitar nuk është domosdoshmërisht jo i besueshëm, përfshirë edhe dëshmitarë që [REDAKTUAR].<sup>177</sup> Duke iu kthyer rrethanave në fjalë, Trupi Gjykses vëren, së pari, se TW4-01 pranoi menjëherë dhe pa mëdyshje se [REDAKTUAR]. Ai ishte plotësisht i hapur në lidhje me këtë pikë dhe Trupi Gjykses i jep peshë pranimi të tij.

110. Së dyti, prova të tjera të administruara konfirmojnë dëshminë e dëshmitarit [REDAKTUAR].<sup>178</sup> [REDAKTUAR].<sup>179</sup> [REDAKTUAR];<sup>180</sup> [REDAKTUAR].<sup>181</sup>

111. Së treti, shpjegimi i TW4-01-shit [REDAKTUAR] mbështetet fuqimisht nga dëshmitë e eksperteve. [REDAKTUAR].<sup>182</sup>

112. Së katërti, vlen të përmendet se [REDAKTUAR].<sup>183</sup> [REDAKTUAR].<sup>184</sup> [REDAKTUAR] para këtij Trupi Gjykses, TW4-01 dukshëm u përpoq të jepte dëshmi të saktë, ishte i hapur dhe përgjithësisht përputhës në dëshminë e vet.<sup>185</sup>

---

<sup>174</sup> [REDAKTUAR].

<sup>175</sup> [REDAKTUAR].

<sup>176</sup> [REDAKTUAR].

<sup>177</sup> KSC-BC-2020-04, F00652, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes sipas Rregullës 130 për Rrëzimin e Akuzës së Vrasjes së Paligjshme në Aktakuzë*, 15 shtator 2023, konfidencial, para. 31. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, [F00652/RED](#); [REDAKTUAR].

<sup>178</sup> [REDAKTUAR].

<sup>179</sup> [REDAKTUAR].

<sup>180</sup> [REDAKTUAR].

<sup>181</sup> [REDAKTUAR].

<sup>182</sup> [REDAKTUAR].

<sup>183</sup> [REDAKTUAR].

<sup>184</sup> [REDAKTUAR].

<sup>185</sup> *Shih* para. 102-103 më lart.

113. [REDAKTUAR],<sup>186</sup> [REDAKTUAR].<sup>187</sup>

114. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk gjykon se [REDAKTUAR] ndikon në besueshmërinë e tij në këtë proces gjyqësor apo e bën dëshminë e tij të pambështetshme.

115. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se TW4-01 ka motivin për ta inkriminuar në mënyrë të rreme z. Shala, Trupi Gjykses nuk ka konstatuar asnjë provë në mbështetje të këtij argumenti. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses u referohet konstatimeve të veta, ku trajtohet hollësisht ky aspekt.<sup>188</sup> Pasi ka konstatuar se TW4-01 nuk kishte motivin për ta implikuar në mënyrë të rreme z. Shala, Trupi Gjykses gjithashtu e konstaton të pathemeltë parashtrimin e Mbrojtjes se ai u përpoq të ushtronte ndikim të dëshmitarët e tjerë duke u dhënë informacion të rremë kundër z. Shala. Parashtrimet e Mbrojtjes se TW4-01 u morr vesh me dëshmitarë të tjerë, trajtohen në pikat përkatëse të vlerësimit të besueshmërisë së atyre dëshmitarëve, ose në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

116. Sa i përket parashtrimit të Mbrojtjes se dëshmia e TW4-01-shit bie ndesh me deklaratat e tij të mëparshme dhe prova të tjera të administruara, Trupi Gjykses u referohet konstatimeve të veta më lart.<sup>189</sup>

117. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se dëshmia e TW4-01-shit është jo e besueshme dhe tejet e ekzagjeruar, Trupi Gjykses konstaton se është argument i pabazë. Shembujt që jep Mbrojtja nxjerrin dëshminë e TW4-01-shit jashtë kontekstit, nuk mbështesin argumentin e Mbrojtjes dhe/ose nuk janë juridikisht thelbësore për akuzat. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e konstaton të pathemeltë argumentin e Mbrojtjes.

---

<sup>186</sup> [REDAKTUAR].

<sup>187</sup> [REDAKTUAR].

<sup>188</sup> *Shih* para. 793-794 më poshtë.

<sup>189</sup> *Shih* para. 104 më lart.



118. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se TW4-01 paraqiti elemente të dëshmime të dorës së dytë si dëshmi të drejtpërdrejtë, Trupi Gjykses e konstaton atë të pathemeltë. Sikurse theksohet më lart, dëshmitari bëri dallim të qartë midis çfarë kishte parë vetë dhe çfarë kishte dëgjuar nga të tjerët. Shembulli që paraqet Mbrojtja në fakt e vërteton këtë.

119. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se TW4-01 ishte i besueshëm dhe është mbështetur në dëshminë e tij aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

## 2. TW4-02

120. Deklaratat me shkrim të TW4-02-shit dhënë ZPS-së u paraqitën si prova në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 153 të Rregullores.<sup>190</sup>

121. Dëshmitari është shqiptar i Kosovës [REDAKTUAR].<sup>191</sup>

122. Në deklaratat e tij, dëshmitari dëshmoi për: (i) arrestimin e tij nga UÇK-ja, [REDAKTUAR]; (ii) përdorimin (dhe rëndësinë) e FMK-së si bazë e UÇK-së; (iii) planimetrinë e FMK-së; (iv) keqtrajtimin dhe marrjen e tij në pyetje në FMK; (v) kushtet e ndalimit në FMK; (vi) praninë dhe identitetet e të ndaluarve të tjerë në FMK dhe keqtrajtimin e tyre; (vii) rrethanat e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme; (viii) identitetet dhe rolet e anëtarëve të UÇK-së të pranishëm në FMK, ndër të cilët Xhemshit Krasniqi dhe Osman Kryeziu; dhe (ix) lirimimin e tij nga FMK-ja.

123. Trupi Gjykses vëren se dëshmia e TW4-02-shit në vetvete është përgjithësisht përputhëse, e hollësishme dhe e gjallë sa i përket arrestimit të tij [REDAKTUAR], planimetrisë së FMK-së, përfshirë dhomat ku u mbajtën ai dhe persona të tjerë,

---

<sup>190</sup> [Decision on SPO Request for Admission of Evidence Pursuant to Rule 153](#) (Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153), para. 54(b).

<sup>191</sup> TW4-02: 060664-TR-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 4.

kushteve të ndalimit, pranisë dhe keqtrajtimit të ndaluarve të tjerë në FMK dhe rolit të anëtarëve të UÇK-së në FMK, veçanërisht të Xhemshit Krasniqit dhe Osman Kryeziut. Çka është e rëndësishme, deklaratat e tij konfirmohen mjaftueshëm nga dëshmi gojore dhe deklarata që përforcojnë njëra-tjetrën, të dhëna nga disa dëshmitarëve të tjerë, ndër të cilët TW4-01, W01448 dhe TW4-04.

124. E njëjta nuk mund të thuhet për disa aspekte të tjera kyçe të dëshmisë së dëshmitarit. Trupi Gjykses vëren se dëshmia e dëshmitarit në vetvete nuk është përputhëse dhe është jo e besueshme në lidhje me: (i) datën e mbërritjes së tij në FMK dhe kohëzgjatjen e ndalimit të tij atje; (ii) mënyrën si mësoi për identitetet e të ndaluarve të tjerë dhe keqtrajtimin që ata pësuan; dhe (iii) rrethanat e lirimit të tij. Gjithashtu, Trupi Gjykses është i mendimit se, megjithëse ishte i sinqertë për keqtrajtimin që pësuan të ndaluarit e tjerë, TW4-02 dukshëm e minimizoi keqtrajtimin e vet në FMK. Si ilustrim i kundërthënive në dëshminë e tij, Trupi Gjykses i referohet, për shembull, pretendimit të dëshmitarit se asnjëherë nuk u keqtrajtua fizikisht në FMK, por vetëm psikologjikisht,<sup>192</sup> kur në të njëjtën kohë deklaroi se ishte i bindur që “ata” donin ta “eliminonin” dhe “vrisnin”.<sup>193</sup> Ai gjithashtu deklaroi se sa herë që kalon pranë FMK-së, “nuk ndihem mirë”,<sup>194</sup> dhe se për tetë vjet rresht “kam jetu pa fjet fare nga stresi”.<sup>195</sup> Gjithashtu, dëshmia e tij bie ndesh me atë të [REDAKTUAR], i cili dëshmoi se TW4-02 u keqtrajtua fizikisht gjatë kohës që u mbajt i ndaluar.<sup>196</sup>

125. Trupi Gjykses është i vëmendshëm ndaj shqetësimeve të dëshmitarit dhe mungesës së dëshirës për të dëshmuar në këtë proces nga frika se dëshmia e tij mund

---

<sup>192</sup> TW4-02: 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 3, rreshtat 21-22.

<sup>193</sup> TW4-02: 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 4, rreshtat 11-15.

<sup>194</sup> TW4-02: 108850-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 5, rreshtat 20-21.

<sup>195</sup> TW4-02: 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 19, rreshtat 22-23.

<sup>196</sup> [REDAKTUAR]. Lidhur me keqtrajtimin e TW4-02-shit, *shih* më tej konstatimet e Trupit Gjykses në para. 728 më poshtë.

të ketë pasoja negative për [REDAKTUAR].<sup>197</sup> Dëshmitari gjithashtu shpjegoi gjerësisht shqetësimet për sigurinë e tij, [REDAKTUAR].<sup>198</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, këto shqetësime mund të shpjegojnë arsyen pse dëshmitari dha deklaratat jo të besueshme dhe mospërputhëse në lidhje me disa aspekte të dëshmisë së vet.

126. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e ka trajtuar me kujdes dëshminë e TW4-02-shit dhe është mbështetur në të aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

### 3. TW4-04

127. Deklaratat me shkrim të TW4-04-ës u paraqitën si prova në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 153 të Rregullores.<sup>199</sup>

128. TW4-04 është shqiptar i Kosovës [REDAKTUAR].<sup>200</sup>

129. Në deklaratat e tij, dëshmitari dëshmoi për: (i) arrestimin e tij [REDAKTUAR] anëtar [REDAKTUAR] i UÇK-së [REDAKTUAR]; (ii) ndalimin [REDAKTUAR] në FMK; (iii) planimetrinë e FMK-së; (iv) keqtrajtimin dhe marrjen e tij në pyetje në FMK; (v) kushtet e ndalimit në FMK; (vi) praninë dhe identitetet e të ndaluarve të tjerë në FMK dhe keqtrajtimin e tyre; (vii) identitetet dhe rolet e anëtarëve të UÇK-së të pranishëm në FMK, ndër të cilët Osman Kryeziu dhe Xhemshit Krasniqi; dhe (viii) lirimimin e tij nga FMK-ja.

130. Trupi Gjykses vëren se dëshmia e TW4-04-ës në vetvete është përgjithësisht përputhëse, e hollësishme dhe e gjallë sa i përket arrestimit të tij nga [REDAKTUAR] anëtar [REDAKTUAR] i UÇK-së, [REDAKTUAR], planimetrisë së FMK-së, vendeve

---

<sup>197</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 21-22.

<sup>198</sup> **TW4-02:** 108850- TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 13-15.

<sup>199</sup> [Decision on SPO Request for Admission of Evidence Pursuant to Rule 153](#) (Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153), para. 54(c).

<sup>200</sup> **TW4-04:** SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014673; 064716-TR-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 5-7.

brenda FMK-së ku u mbajt i ndaluar, kushteve të ndalimit dhe pranisë dhe identiteteve të të ndaluarve të tjerë në FMK. Çka është e rëndësishme, në lidhje me këto aspekte, deklaratat e tij konfirmohen mjaftueshëm nga dëshmi gojore dhe deklarata që përforcojnë njëra-tjetrën, të dhëna nga disa dëshmitarë të tjerë, ndër të cilët TW4-01, W04733, W01448 dhe TW4-02.

131. E njëjta nuk mund të thuhet për aspekte të tjera kyçe të dëshmisë së dëshmitarit. Katër aspekte ilustronë shqetësimet e Trupit Gjykses në lidhje me dëshminë e TW4-04-ës.

132. Së pari, Trupi Gjykses është i mendimit se dëshmitari minimizoi mënyrën si u trajtua gjatë kohës që u mbajt i ndaluar në FMK, kur tha se nuk u torturua asnjëherë në FMK.<sup>201</sup> Kjo bie ndesh me dëshminë e [REDAKTUAR] tha se TW4-04-ën “shumë e kanë torturu”.<sup>202</sup> [REDAKTUAR] se TW4-04 u keqtrajtua gjatë kohës që u mbajt i ndaluar në FMK gjithashtu përputhet me dëshmi të shumta të dëshmitarëve të tjerë, të cilët u mbajtën dhe u keqtrajtuuan në atë kompleks gjatë të njëjtës periudhë, dhe të cilët dëshmuuan se të gjithë të ndaluarit në FMK u keqtrajtuuan.<sup>203</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk u jep peshë deklaratave të TW4-04-ës në të cilat mohon keqtrajtimin.

133. Së dyti, Trupi Gjykses është gjithashtu i mendimit se TW4-04 shtrembëroi në masë të skajshme rolin e Xhemshit Krasniqit në FMK. Në deklaratën që i dha ZPS-së në vitin 2022, ai pretendoi se Xhemshit Krasniqi e trajtoi mirë, [REDAKTUAR].<sup>204</sup> Trupi Gjykses gjithashtu vëren se [REDAKTUAR] dëshmitari pretendoi se nuk kishte dëgjuar nga askush, as e kishte parë ndonjëherë Xhemshit Krasniqin duke keqtrajtuar apo vrarë ndonjë person gjatë periudhës mars-qershor 1999.<sup>205</sup> Megjithatë, Trupi

---

<sup>201</sup> **TW4-04:** SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013339.

<sup>202</sup> [REDAKTUAR].

<sup>203</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2.

<sup>204</sup> **TW4-04:** 108826-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 12.

<sup>205</sup> **TW4-04:** SPOE00014669-00014751 RED, f. SPO00014700.

Gjykues vëren se, sipas provave të administruara, [REDAKTUAR].<sup>206</sup> Sa i përket mënyrës se si Xhemshit Krasniqi i trajtoi të ndaluarit, Trupi Gjykues po kështu vëren se dëshmia e TW4-04-ës është qartësisht në kundërshtim me dëshmitë e disa dëshmitarëve të besueshëm në këtë çështje gjyqësore, të cilët konfirmuan përfshirjen e Xhemshit Krasniqit në keqtrajtimin e të ndaluarve.<sup>207</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykues vëren se, [REDAKTUAR].<sup>208</sup> [REDAKTUAR].<sup>209</sup> [REDAKTUAR].<sup>210</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykues, [REDAKTUAR] qartësisht vënë në dukje një vendim strategjik për të mbrojtur interesat e këtij të fundit. Për këtë arsye, Trupi Gjykues nuk i ka dhënë peshë dëshmisë së TW4-04-ës në lidhje me Xhemshit Krasniqin dhe është mbështetur në dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të besueshëm.

134. Së treti, Trupi Gjykues vëren se gjatë viteve, dëshmitari ka dhënë informacion mospërputhës në deklaratat e veta, duke minimizuar [REDAKTUAR] atë që u ndodhi të ndaluarve të tjerë në FMK. Trupi Gjykues vëren se në deklaratën e vitit 2009, dëshmitari deklaroi se [REDAKTUAR] i kishte rrëfyer për rrahjet dhe se ai personalisht kishte parë mavijosje në [REDAKTUAR].<sup>211</sup> Dëshmitari gjithashtu konfirmoi se personalisht dëgjoi britma të njerëzve, veçanërisht natën, dhe se dëgjoi të shtëna që vinin nga brendia e ndërtesës së ndalimit.<sup>212</sup> TW4-04 gjithashtu deklaroi se pas luftës, “dy romë” që u mbajtën të ndaluar aty i treguan “për torturat e tyre në Kukës”.<sup>213</sup> Nga ana tjetër, Trupi Gjykues vëren se [REDAKTUAR], dëshmitari dha

---

<sup>206</sup> *Shih* Pjesën VI.D.8(a).

<sup>207</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2.

<sup>208</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 15, 18-19

<sup>209</sup> **TW4-04:** SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014698.

<sup>210</sup> **TW4-04:** SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014705.

<sup>211</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013273.

<sup>212</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013273, SITF00013276; SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013340.

<sup>213</sup> **TW4-04:** SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013340. Trupi Gjykues vëren se në deklaratat e tij të mëpashme, TW4-04 përmend “tre jevgjë” që “gjindeshin aty për të pastruar” (SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013273) dhe ishin muzikantë (SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014694). Trupi Gjykues është bindur se në të gjitha deklaratat e tij, dëshmitari u referohet [REDAKTUAR],

dëshmi dukshëm të ndryshme, ku i mohoi [REDAKTUAR] dhe vazhdoi t'i mohonte edhe pas ballafaqimit me deklaratat e tij të mëparshme, pa dhënë arsye apo shpjegim për ndryshimin e dëshmisë. Kjo sjellje evidentohet, për shembull, në [REDAKTUAR], kur mohoi që kishte parë mavijosje në [REDAKTUAR].<sup>214</sup> E njëjta sjellje evidentohet edhe në [REDAKTUAR] e TW4-04-ës [REDAKTUAR], kur e mohoi që kishte folur me [REDAKTUAR] për torturimin e tyre në FMK.<sup>215</sup> Po kështu, [REDAKTUAR] TW4-04 deklaroi sërish se kishte dëgjuar të shtëna me armë zjarri, por mohoi se të shtënat kishin ardhur nga brendia e ndërtesës së ndalimit, dhe në vend të kësaj dëshmoi se nuk e dinte prej nga erdhën ato. Gjithashtu, TW4-04 mohoi se kishte dëgjuar britma të njerëzve gjatë kohës që ishte në ndërtesën e ndalimit.<sup>216</sup> Trupi Gjykses e interpreton këtë ndryshim të qëllimshëm të dëshmisë si përpjekje për të mos dhënë informacion që do të mund të bënte lidhjen midis anëtarëve të UÇK-së, ndër të cilët Xhemshit Krasniqi, dhe kryerjes së krimeve në FMK, në kundërshtim me numrin e konsiderueshëm të provave që ka marrë Trupi Gjykses.

135. Së katërti, deklarata e TW4-04-ës dhënë ZPS-së në vitin 2019 është, në disa aspekte, jo e besueshme dhe plot me përgjigje të mjegullta dhe absurde, si për shembull kur pretendon në mënyrë të përsëritur se: (i) nuk ishte në gjendje të shihte, sepse ishte shumë terr;<sup>217</sup> (ii) [REDAKTUAR];<sup>218</sup> dhe se (iii) [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom “ma qef kanë pas me dal me punu se me nejt mbyllët”.<sup>219</sup>

---

[REDAKTUAR] dhe muzikantit të tretë rom të cilët, sikurse konstaton Trupi Gjykses më poshtë, u mbajtën të ndaluar FMK gjatë periudhës që mbulojnë akuzat. *Shih* para. *Shih* Pjesën VI.D.10(a).

<sup>214</sup> **TW4-04:** SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015845; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014693.

<sup>215</sup> [REDAKTUAR].

<sup>216</sup> **TW4-04:** SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014695-00014696.

<sup>217</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 10, rreshtat 24-25; f. 12, rreshtat 1-2; f. 15, rreshtat 18-19; f. 17, rreshtat 18-20; f. 18, rreshti 20; f. 19, rreshtat 1-6.

<sup>218</sup> [REDAKTUAR].

<sup>219</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 27, rreshtat 22-24.

136. Bazuar në sa më lart, duke mbajtur parasysh mospërputhjet e theksuara midis pjesëve të shumta të dëshmisë së TW4-04-ës dhe provave të tjera të besueshme të administruara në këtë gjykim, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e tij ka shumë pak vlerë dhe nuk i jep peshë sa i përket kohëzgjatjes së ndalimit të tij në FMK, keqtrajtimit të tij, rolit të Xhemshit Krasniqit në FMK, dhe keqtrajtimit që pësuan apo punës së detyruar që bënë të ndaluarit e tjerë. Nga ana tjetër, Trupi Gjykses i konstaton të besueshme disa aspekte të veçanta të deklaratave të dëshmitarit dhe mbështetet në to aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

#### 4. TW4-05

137. Deklaratat me shkrim të TW4-05-ës u paraqitën si prova në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 153 të Rregullores (bashkërisht, “deklaratat e TW4-05-ës”), [REDAKTUAR].<sup>220</sup>

138. TW4-05 është shqiptar i Kosovës, [REDAKTUAR],<sup>221</sup> [REDAKTUAR].<sup>222</sup>

139. Në deklaratat e tij, TW4-05 dëshmoi për: (i) arrestimin nga anëtarë të UÇK-së dhe më pas ndalimin e tij në FMK, duke përfshirë kushtet e ndalimit që mbizotëronin atje; (ii) praninë dhe identitetet e të ndaluarve të tjerë në FMK; (iii) marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin psikologjik të tij nga anëtarë të UÇK-së; (iv) [REDAKTUAR]; (v) identitetet dhe rolet e anëtarëve të UÇK-së të pranishëm në FMK, ndër të cilët Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi dhe z. Mark Shala; (vi) për çfarë e përdorte UÇK-ja FMK-në; dhe (vii) lirimimin e tij.

---

<sup>220</sup> [Decision on Admission of Evidence Pursuant to Rule 155](#) (Vendimi mbi Pranimin e Provave sipas Rregullës 155), para. 54, 70(b).

<sup>221</sup> **TW4-05**: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013123-SITF00013124; SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

<sup>222</sup> **TW4-05**: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013124.

140. Trupi Gjykses thekson se TW4-05 dha dëshmi përgjithësisht përrputhëse, të hollësisht dhe në vetvete koherente për arrestimin nga anëtarë të UÇK-së dhe lirimn e tij nga FMK-ja, identitetin e të ndaluarve të tjerë, [REDAKTUAR], dhe identitetet dhe rolet e anëtarëve të UÇK-së të pranishëm në FMK, ndër të cilët Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi dhe z. Mark Shala. Çka është me rëndësi, këto aspekte të dëshmisë së TW4-05-ës konfirmohen nga dëshmi të dëshmitarëve të tjerë që përrforcojnë njëra-tjetrën, përkatësisht të TW4-01-shit, TW4-11-shit, W01148-ës dhe W04733-shit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se TW4-05 i përrshkroi me vërtetësi ngjarjet që përrjetoi.

141. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se TW4-05 minimizoi shkallën e keqtrajtimit që pësuan ai dhe të ndaluarit e tjerë, si dhe papërrshtatshmërinë e kushteve të ndalimit. Përr shembull, në lidhje me keqtrajtimin e të ndaluarve, dëshmitari tha se gjatë periudhës që u mbajt i ndaluar në FMK, nuk u keqtrajtua fizikisht asnjëherë, dhe mohoi se i kishte parë të ndaluarit e tjerë duke u rrahur apo se kishte dëggjuar britmat e tyre.<sup>223</sup> TW4-05 pretendoi se e trajtuan shumë mirë.<sup>224</sup> Trupi Gjykses vlerëson se kjo nuk pajtohet me deklaratën e dëshmitarit se, njëkohësisht, ai priste të vritej në FMK.<sup>225</sup> Kjo tregon se dëshmia e dëshmitarit në vetvete nuk është përrputhëse sa i përrket mënyrës si u trajtuan ai dhe të ndaluarit e tjerë në FMK. Përr më tepër, sikurse shtjellohet me hollësi në analizën e provave,<sup>226</sup> dëshmia e TW4-05-ës në këtë aspekt bie ndesh me dëshmi të dëshmitarëve të tjerë që përrforcojnë njëra-tjetrën, si ajo e TW4-01-shit, W04733-shit, W01448-ës dhe TW4-11-shit. Trupi Gjykses vëren mospërrputhje të ngjashme edhe në lidhje me kushtet e ndalimit. Përr shembull, TW4-05 deklaroi se hante të njëjtin ushqim si anëtarët e UÇK-së, se mund të pastrohej me ujë

---

<sup>223</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500-SITF00372502; SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013131-SITF00013132, SITF00013134.

<sup>224</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

<sup>225</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013134.

<sup>226</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2.



të ngrohtë çdo tri ditë dhe se berberi rregullisht ia qethte flokët.<sup>227</sup> Dëshmia e TW4-05-ës në këtë aspekt bie në kundërshtim me dëshmitë e disa dëshmitarëve të cilët dhanë dëshmi të besueshme dhe përputhëse, të cilat konfirmojnë kushtet e pamjaftueshme dhe të mjerueshme të ndalimit në FMK, përfshirë ushqimin dhe ujin e pamjaftueshëm dhe kushtet e këqija higjienike.<sup>228</sup> Duke qenë se dëshmitarë të tjerë që u mbajtën në kushte të ngjashme dhanë një pasqyrë krejtësisht të ndryshme të kushteve të vështira të ndalimit, Trupi Gjykses u jep më shumë peshë dëshmimeve të tyre. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses nuk i gjykon si të besueshme deklaratat e TW4-05-ës në lidhje me keqtrajtimin që pësuan ai dhe të ndaluarit e tjerë dhe kushtet e ndalimit, dhe nuk mbështetet në dëshminë e tij në lidhje me këtë aspekt.

142. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se TW4-05 deklaroi se megjithëse priste të vritej në FMK, “nuk më kanë vra” falë Xhemshit Krasniqit dhe Sabit Gecit dhe se, për këtë arsye “u falënderohem që të dyve”.<sup>229</sup> Asnjë dëshmitar tjetër nuk dha dëshmi në mbështetje të këtij pretendimi. Duke mbajtur parasysh dëshmitë kryesisht përputhëse dhe mbështetëse të administruara në këtë çështje gjyqësore në lidhje me përfshirjen e Xhemshit Krasniqit dhe Sabit Gecit në arrestimin, ndalimin dhe keqtrajtimin e civilëve në FMK, Trupi Gjykses nuk merr parasysh deklaratën e TW4-05-ës në lidhje me këtë aspekt.

143. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses ka shqyrtuar me kujdes dëshminë e dëshmitarit dhe është mbështetur në të aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.<sup>230</sup>

---

<sup>227</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013130.

<sup>228</sup> *Shih* Pjesën VI.E.1.

<sup>229</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013134.

<sup>230</sup> Në lidhje me pretendimin e Mbrojtjes se TW4-05 dhe W01448 ishin marrë vesh mes tyre, *shih* konstatimet e Trupit Gjykses në para. 174 më poshtë.

5. **TW4-06, TW4-07, TW4-08 dhe TW4-09 (anëtarët e familjes së W04733-shit)**

144. TW4-06, TW4-07, TW4-08 dhe TW4-09 dëshmuar para Trupit Gjykses nga 27 marsi deri më 30 mars 2023,<sup>231</sup> me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.<sup>232</sup>

145. TW4-06 është gruaja e W04733-shit, kurse TW4-07, TW4-08 dhe TW4-09 janë fëmijët e tij (bashkërisht “anëtarët e familjes”).

146. Katër dëshmitarët dëshmuar për: (i) periudhën para ndalimit të W04733-shit në FMK (përkatësisht për punën e tij si polic, për një varg incidentesh që ndodhën në maj 1998 dhe në prill/maj 1999, në të cilat u përfshi (gjithashtu edhe) z. Shala, dhe për zhvendosjen e familjes fillimisht brenda Kosovës dhe më pas në Shqipëri); (ii) rrethanat e arrestimit të W04733-shit; (iii) keqtrajtimin e W04733-shit dhe të ndaluarve të tjerë në FMK; (iv) gjendjen fizike dhe psikologjike të W04733-shit pas lirimit të tij; dhe (v) ndikimin e ndalimit dhe keqtrajtimin të W04733-shit mbi W04733-shin dhe familjen e tij.

147. Para së gjithash, Trupi Gjykses i kushton rëndësi të madhe parashtrimit të Mbrojtjes se TW4-06, TW4-07, TW4-08 dhe TW4-09 gjatë viteve mund t'i kenë diskutuar mes veti aspektet që po trajtohen dhe për rrjedhojë, t'i kenë përshtatur dëshmitë e tyre me njëra-tjetrën.<sup>233</sup> Trupi Gjykses vëren se dëshmitë e anëtarëve të familjes janë përgjithësisht përputhëse, që Trupi Gjykses e kupton se është rezultat i përjetimeve të përbashkëta të tyre. Sidoqoftë, Trupi Gjykses nuk vuri re ndonjë shenjë se ishin marrë vesh mes tyre. Ata i përshkruan ngjarjet nga këndvështrime të

---

<sup>231</sup> **Anëtarët e Familjes:** T. 27 mars 2023, konfidencial, f. 608-731; T. 28 mars 2023, konfidencial, f. 732-831; T. 29 mars 2023, konfidencial, f. 832-955; T. 30 mars 2023, konfidencial, f. 956-1020.

<sup>232</sup> [REDAKTUAR].

<sup>233</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 254.

ndryshme, duke dhënë hollësi të ndryshme.<sup>234</sup> Kjo tregon se dëshmitarët nuk i përshtatën ose mësuan përmendësh dëshmitë e tyre para se të dëshmonin para Trupit Gjykses.

148. Dëshmitë e dëshmitarëve ishin të pasura në detaje, të gjalla dhe të rrëfyera me emocion, që tregon se bazoheshin në përjetimet personale të tyre. Për shembull, të katër dëshmitarët i përshkruan me hollësi lëndimet fizike që panë në trupin e W04733-shit, si dhe gjendjen mendore të tij pas lirimit nga FMK-ja.<sup>235</sup> Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se dëshmitarët ishin të qartë dhe të sinqertë në përgjigjet e tyre, dhe se dëshmitë e tyre ishin përputhëse. Gjithashtu, të katër dëshmitarët bënë përpjekje të dukshme për të dhënë dëshmi të sakta, duke bërë dallim të qartë midis ngjarjeve që i kishin parë vetë dhe atyre për të cilat kishin dëgjuar nga të tjerët, veçanërisht nga W04733.<sup>236</sup> Ata gjithashtu pranuan pa mëdyshje kur nuk i dinin ose nuk u kujtoheshin disa aspekte të ngjarjeve.<sup>237</sup> Gjithashtu, anëtarët e familjes ndërhyjnë në disa raste, për t'u siguruar se i kishin kuptuar si duhet pyetjet që iu drejtuan,<sup>238</sup> ose për të dhënë

---

<sup>234</sup> Për shembull, TW4-06 rrëfeu më me hollësi zhvendosjen e familjes nga fshati i tyre në një qytezë tjetër në Kosovë dhe më pas në Shqipëri, dhe përpjekjet e familjes për të gjetur vendstrehim më të përshtatshëm gjatë luftës; *shih TW4-06*: T. 28 mars 2023, publik, f. 786, rreshtat 5-22; T. 28 mars 2023, konfidencial, f. 788, rreshti 3 deri në f. 789, rreshti 15. Dëshmia e saj e imtësishme për këto ngjarje pasqyron rolin e saj si nënë dhe si më e moshuara në atë kohë, krahasuar me TW4-07-ën, TW4-08-ën dhe TW4-09-ën.

<sup>235</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(c).

<sup>236</sup> Trupi Gjykses vëren se dëshmitë e anëtarëve të familjes janë plot me fraza që vënë në dukje përpjekjet e tyre për të dhënë dëshmi të saktë dhe të vërtetë: "kështu sipas babës", "këto fjali m'i ka thënë burri", "çka kam dëgju prej babës", "si më ka tregu nëna". *Shih, për shembull, TW4-08*: T. 27 mars 2023, publik, f. 648, rreshtat 3-7; **TW4-06**: T. 28 mars 2023, konfidencial, f. 805, rreshtat 19-20; publik, f. 815, rreshtat 9-11; **TW4-07**: T. 29 mars 2023, publik, f. 902, rreshtat 24-25; f. 903, rreshtat 5, 13-14; **TW4-09**: T. 30 mars 2023, publik, f. 975, rreshtat 12, 15-16; f. 978, rreshti 10.

<sup>237</sup> *Shih, për shembull, TW4-08*: T. 27 mars 2023, publik, f. 646, rreshti 24 deri në f. 647, rreshti 2; **TW4-06**: T. 28 mars 2023, konfidencial, f. 824, rreshtat 1-3; **TW4-07**: T. 29 mars 2023, konfidencial, f. 891, rreshtat 1-3; f. 909, rreshtat 6-8; **TW4-09**: T. 30 mars 2023, publik, f. 978, rreshti 23 deri në f. 979, rreshti 2.

<sup>238</sup> *Shih, për shembull, TW4-08*: T. 27 mars 2023, konfidencial, f. 620, rreshtat 11-15; T. 27 mars 2023, publik, f. 632, rreshti 20; T. 27 mars 2023, konfidencial, f. 750, rreshtat 13-14; **TW4-06**: T. 28 mars 2023, publik, f. 845, rreshti 14; **TW4-09**: T. 30 mars 2023, publik, f. 975, rreshtat 7-8; f. 1011, rreshtat 15-17.

informacion apo sqarime të mëtejshme edhe pa iu kërkuar.<sup>239</sup> Kjo, së bashku me përpjekjet e dukshme për të qenë të saktë, tregon gatishmërinë e tyre për të dëshmuar me vërtetësi.

149. Në mënyrë të ngjashme, kur Mbrojtja i ballafaqoi me mospërputhjet e pretenduara midis dëshmisë në sallë të gjyqit dhe deklaratave të mëparshme të tyre, dëshmitarët u përgjigjën me qetësi dhe spontanisht, duke dhënë shpjegime të besueshme dhe bindëse.<sup>240</sup> Trupi Gjyqësor i ka shqyrtuar mospërputhjet në analizën e provave, aty ku e ka gjykuar të nevojshme. Të gjitha më lart përforcojnë përshtypjen e përgjithshme të Trupit Gjyqësor se dëshmitarët i përshkruan me vërtetësi përvojat e tyre personale.

150. Mbrojtja kundërshtoi mbështetshmërinë në dëshmitë e anëtarëve të familjes mbi bazën e mungesës së lidhjes së brendshme logjike dhe përputhshmërisë.<sup>241</sup> Mbrojtja gjithashtu pretendoi se ata i mbështetën dëshmitë e veta në dëshmi të dorës së dytë, të cilat duhen trajtuar me kujdes.<sup>242</sup> Veçanërisht në lidhje me TW4-08-ën, Mbrojtja i qëndroi mendimit se dëshmia e tij u ndikua nga fakti që ishte i pranishëm në intervistën e W04733-shit me hetuesit e [REDAKTUAR] vitin 2009, çka ndikoi në dëshminë e TW4-08-ës dhe i mundësoi ta përshtaste atë me dëshminë e W04733-shit.<sup>243</sup>

---

<sup>239</sup> *Shih, për shembull, TW4-08*: T. 27 mars 2023, publik, f. 630, rreshti 4; *TW4-07*: T. 29 mars 2023, publik, f. 902, rreshtat 15-18.

<sup>240</sup> *Shih, për shembull, TW4-08*: T. 27 mars 2023, publik, f. 643, rreshti 16 deri në f. 644, rreshti 3; f. 650, rreshti 8 deri në f. 651, rreshti 9; *TW4-07*: T. 29 mars 2023, publik, f. 945, rreshti 11 deri në f. 946, rreshti 18; f. 947, rreshti 23 deri në f. 948, rreshti 8.

<sup>241</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 244.

<sup>242</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 99, 100, 136, 248. Sipas Mbrojtjes, dëshmia e dorës së dytë veçanërisht ka të bëjë me: (i) përfshirjen e z. Shala në keqtrajtimin e W04733-shit në FMK; dhe (ii) praninë e z. Shala në një incident që ndodhi në maj 1998 në Kosovë (“incidenti i majit 1998”).

<sup>243</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 245, 258, i referohet SPOE00185335-00185363 RED3. Trupi Gjyqësor vëren se Mbrojtja e përmend TW4-07-ën si të pranishëm në intervistën e W04733-shit me hetuesit e TPNJ-së. Megjithatë, Trupi Gjyqësor thekson se në fakt TW4-08 ishte i pranishëm në atë intervistë, sikurse del qartë nga SPOE00185335-00185363 RED3, SPOE00185336. Në lidhje me këtë, *shih gjithashtu, TW4-07*: T. 29 mars 2023, publik, f. 948, rreshtat 9-18.

Lidhur me dëshmitë e TW4-07-ës dhe TW4-08-ës, Mbrojtja pretendon se ato komprometohen nga fakti se, në kundërshtim me dëshmitë e tyre në sallë të gjyqit, në deklaratat e tyre të mëparshme<sup>244</sup> nuk përmendën se z. Shala u përfshi përkatësisht në keqtrajtimin e W04733-shit në FMK dhe në incidentin e majit 1998.<sup>245</sup>

151. Sa i përket mospërputhjeve të mundshme dhe mungesës së lidhjes së brendshme logjike, Trupi Gjykses i shqyrtoi këto pika në analizën e provave, aty ky e gjykoi të arsyeshme. Sa i përket pretendimit se dëshmitë e tyre ishin të dorës së dytë, Trupi Gjykses rikujton se dëshmi të tilla nuk përjashtohen domosdoshmërisht dhe se ato duhet të peshohen siç duhet duke mbajtur parasysh tërësinë e provave që iu paraqitën Trupit Gjykses.<sup>246</sup>

152. Sa i përket dëshmisë së TW4-08-ës në veçanti, Trupi Gjykses u ka kushtuar vëmendjen e duhur pretendimeve të Mbrojtjes. Sidoqoftë, Trupi Gjykses nuk eidenton asnjë ndikim të palejueshëm si pasojë e pranisë së tij në intervistën e W04733-shit me [REDAKTUAR] të vitit 2009, që do të përlligjte mosmarrjen parasysh të dëshmisë së tij para Trupit Gjykses. Për më tepër, parashtrimet e Mbrojtjes janë hipotetike dhe hamendësuese dhe nuk i referohen konkretisht asnjë deklaratë në dëshminë e TW4-08-ës të ndikuar nga intervista e babait të tij e vitit 2009. Përveç kësaj, Trupi Gjykses rikujton se TW4-08 i kishte dëgjuar nga W04733 të gjitha hollësitë e ndalimit dhe keqtrajtimin të W04733-shit në FMK, që në vitin 1999. Ngjarjet e tjera, si arrestimin e W04733-shit dhe gjendjen fizike dhe mendore të tij pas liritimit, TW4-08 i pa vetë. Çka është e rëndësishme, dëshmia e tij në lidhje me këtë aspekt përgjithësisht konfirmohet nga anëtarë të tjerë të familjes së tij. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses konstaton se parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me TW4-08-ën janë të pathemelta.

---

<sup>244</sup> **Deklarata e mëparshme e TW4-07-ës:** SPOE00047605-00047612; **Deklarata e mëparshme e TW4-08-ës:** U017-4052-U017-4057 RED2.

<sup>245</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 98, 99, 250.

<sup>246</sup> *Shih* Pjesën V.C.4.

153. Sa u përket dëshmime të TW4-07-ës dhe TW4-08-ës, Trupi Gjykses vëren se të dy dëshmitarët mospërmendjen e z. Shala në deklaratat e tyre të mëparshme ia atribuuan faktit se: (i) ata u dhanë deklarata autoriteteve të ndryshme; dhe (ii) pyetjet e hetuesve ishin të përqendruara në kryes të tjerë.<sup>247</sup> Trupi Gjykses i gjykon shpjegimet që dhanë TW4-07 dhe TW4-08 si bindëse dhe të sinqerta. Është krejt e natyrshme për dëshmitarë të cilët gjatë viteve kanë dhënë më shumë deklarata para autoriteteve të ndryshme me linja të ndryshme hetimi, të përmendin emra dhe hollësi të tjera shtesë gjatë dëshmime të tyre. Asnjë dëshmitar nuk mund t'i rrëfejë ngjarjet në mënyrë gjithëpërfshirëse me të njëjtën gjuhën, radhitje, strukturë dhe hollësi me kalimin e më shumë viteve. Trupi Gjykses nuk gjykon se mospërmendja e z. Shala në deklaratat e mëparshme hedh dyshim mbi besueshmërinë e TW4-07-ës dhe TW4-08-ës. Mbi këtë bazë, kundërshtimet e Mbrojtjes lidhur me besueshmërinë e TW4-07-ës dhe TW4-08-ës hidhen poshtë.

154. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se katër dëshmitarët janë të besueshëm dhe është mbështetur në dëshmitë e tyre, sikurse shtjellohet në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

## 6. TW4-10

155. TW4-10 dëshmoi para Trupit Gjykses më 1 dhe 2 maj 2023,<sup>248</sup> me anë të videokonferencës, me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit,<sup>249</sup> [REDAKTUAR].<sup>250</sup>

---

<sup>247</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 651, rreshtat 6-9; **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 945, rreshti 18 deri në f. 946, rreshti 8; f. 948, rreshtat 4-8 ("Ka patë raste kur më kanë pyet veç për Xhemshit Krasniqin. Ka patë rast kur më kanë pyet për Sabit Gecin. Ka pat rast, po, kam patë me -- shumë e kem ndjekë gjithkund drejtësinë. Ka patë rast që jam kanë në Prizren. Ka patë rast që kanë ardhë te shtëpia në pyetje më kanë marrë. E tash s'mundem me i cek unë për çka më kanë pyet ashtu jua kam dhanë përgjigjen").

<sup>248</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, konfidencial, f. 1021-1135; T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1136-1175.

<sup>249</sup> Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 30(c).

<sup>250</sup> [REDAKTUAR].

156. Dëshmitari ishte anëtar i UÇK-së dhe, gjatë periudhës që lidhet me akuzat, e kishte bazën në FMK ku shërbente si rojë në hyrje të kompleksit.

157. TW4-10 dëshmoi për: (i) anëtarësimin në UÇK dhe detyrat e tij gjatë kohës që ishte në FMK; (ii) planimetrinë e kompleksit të FMK-së; (iii) veprimet e UÇK-së në FMK; (iv) praninë dhe rolin e anëtarëve të UÇK-së, ndër të cilët anëtarë të lartë të UÇK-së dhe z. Shala; (iv) praninë e të ndaluarve në FMK, [REDAKTUAR], kushtet e ndalimit të tyre, si edhe keqtrajtimin dhe marrjen e tyre në pyetje nga anëtarë të UÇK-së.

158. Trupi Gjykses vëren se dëshmitari dha dëshmi të hollësishme dhe përgjithësisht informacion koherent lidhur me planimetrinë e kompleksit të FMK-së, praninë dhe rolin e z. Shala dhe të anëtarëve të lartë të UÇK-së, dhe praninë [REDAKTUAR] në FMK, që përforcohet edhe nga prova të tjera të administruara në këtë gjykim. Duke qenë se gjatë periudhës që lidhet me akuzat shërbeu si rojë në hyrjen e FMK-së, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e tij për këto aspekte u bazua në njohuritë dhe përvojën personale të tij.

159. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se TW4-10 nuk ishte i sqartë në përgjigjet e tij dhe tregoi një mungesë të fortë dëshire për të folur për aspektet që lidhen drejtpërdrejt me akuzat, si mbajtja, marrja në pyetje dhe keqtrajtimi i të ndaluarve në FMK. Kur u pyet për këto aspekte, dëshmitari ishte i paqartë, ndonjëherë kundërthënës, dhe ngurrues në përgjigjet e tij. Për shembull, ai iu përgjigj pyetjeve të ndryshme vetëm pasi u ballafaqua me deklaratat e tij të mëparshme, dha përgjigje që nuk lidheshin me pyetjet që iu drejtuan, pretendoi se nuk i kuptonte disa nga pyetjet ose kërkoi që disa pyetje t'i përsëriteshin, edhe pse pyetjet ishin objektivisht të qarta dhe të kuptueshme.<sup>251</sup> Trupi Gjykses fitoi përshtypje të fortë se dëshmitari këtë e bënte për

---

<sup>251</sup> *Shih, për shembull, TW4-10*: T. 1 maj 2023, publik, f. 1036, rreshtat 5-9; f. 1038, rreshti 23 deri në f. 1039, rreshti 19; f. 1060, rreshti 21 deri në f. 1063, rreshti 1; konfidencial, f. 1071, rreshti 23 deri në f. 1074, rreshti 5; T. 2 maj 2023, publik, f. 1164, rreshti 24 deri në f. 1166, rreshti 6.

të fituar kohë ose për t'iu ikur përgjigjeve. Një element tjetër i dëshmisë së TW4-10-s që bie në sy është se, kur u ballafaqua nga ZPS-ja ose Trupi Gjykues lidhur me mospërputhjet e perceptuara midis dëshmisë në sallën e gjyqit dhe deklaratat e tij të mëparshme, dëshmitari vazhdimisht këmbënguli se deklaratat e tij të mëparshme nuk ishin përkthyer siç duhej, ose se kishte harruar se kishte dhënë deklaratën përkatëse.<sup>252</sup>

160. Për shembull, TW4-10 në fillim dëshmoi se personat mbaheshim vetëm për dy ose tre orë në FMK para se të liroheshin,<sup>253</sup> por më pas e ndryshoi dëshminë dhe e pranoi se [REDAKTUAR] u mbajtën në ndërtesën e ndalimit për disa ditë.<sup>254</sup> Dëshmitari ishte i mjegullt edhe kur dëshmoi për kushtet e ndalimit në ndërtesën e ndalimit dhe minimizoi pamjaftueshmërinë e kushteve për të ndaluarit, duke thënë se “s’janë kanë edhe bash në gjendje të këqija”, “si për persona [anëtarë të UÇK-së] në [ndërtesën e komandës], si për ne, njëjtë ka qenë.”<sup>255</sup> Gjithashtu, TW4-10 mohoi se kishte pasur keqtrajtime në FMK gjatë kohës që ishte atje.<sup>256</sup> Edhe kur ZPS-ja e ballafaqoi me deklaratën e tij të mëhershme, ku kishte thënë të kundërtën, ai këmbënguli: “unë as kam pa, as kam dëgju”.<sup>257</sup> Megjithatë, kur u pyet nga Trupi Gjykues, dëshmitari pranoi se kishte dëgjuar nga anëtarë të tjerë të UÇK-ës se të ndaluarit keqtrajtoheshin në FMK, por këmbënguli se ai vetë nuk kishte parë asgjë.<sup>258</sup> Duke mbajtur parasysh provat e besueshme dhe përputhëse të administruara prej Trupit Gjykues të cilat konfirmojnë keqtrajtimin e vazhdueshëm dhe të rëndë të të

---

<sup>252</sup> *Shih, për shembull, TW4-10*: T. 1 maj 2023, publik, f. 1061, rreshtat 19-22; f. 1065, rreshti 5 deri në f. 1066, rreshti 11; f. 1084, rreshti 19 deri në f. 1085, rreshti 16; f. 1086, rreshtat 2-19; konfidencial, f. 1102, rreshtat 2-25; T. 2 maj 2023, publik, f. 1167, rreshtat 8-25.

<sup>253</sup> *TW4-10*: T. 1 maj 2023, publik, f. 1052, rreshtat 13-16; f. 1053, rreshti 8 deri në f. 1054, rreshti 15.

<sup>254</sup> *TW4-10*: T. 1 maj 2023, konfidencial, f. 1096, rreshti 14 deri në f. 1098, rreshti 20.

<sup>255</sup> *TW4-10*: T. 1 maj 2023, publik, f. 1056, rreshti 4 deri në f. 1057, rreshti 8; T. 2 maj 2023, publik, f. 1168, rreshti 4 deri në f. 1169, rreshti 24.

<sup>256</sup> *TW4-10*: T. 1 maj 2023, konfidencial, f. 1102, rreshtat 2-5

<sup>257</sup> *TW4-10*: T. 1 maj 2023, konfidencial, f. 1102, rreshtat 6-25.

<sup>258</sup> *TW4-10*: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1170, rreshtat 10-16.



ndaluarve në FMK,<sup>259</sup> Trupi Gjykses e gjykon si jo të besueshme që TW4-10, i cili e kishte bazën në FMK dhe shërbente te hyrja e kompleksit dhe i cili flinte në ndërtesën e komandës,<sup>260</sup> nuk dëgjoi e pa asgjë nga këto. Trupi Gjykses po ashtu e gjykon si jo të besueshme që dëshmitari nuk pa lëndime te të ndaluarit gjatë kohës që ecnin ose punonin në oborr, ose kur i pa të ndaluarit nga dritaret e ndërtesës së ndalimit.<sup>261</sup>

161. Trupi Gjykses e gjykon përgjithësisht kundërthënëse dhe jobindëse dëshminë e TW4-10-s për ndalimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve. Për mendimin e Trupit Gjykses, përmbajtja e përgjigjeve të TW4-10-s dhe mënyra si ato u dhanë, tregojnë se dëshmitari u përpoq ta distancoje veten nga krimet e kryera në FMK dhe t'i minimizonte kushtet e mjerueshme në të cilat u mbajtën të ndaluarit në FMK dhe ashpërsinë e keqtrajtitimit që pësuan. Për këto arsye, Trupi Gjykses gjykon se dëshmia e TW4-10-s për këto aspekte ka shumë pak vlerë dhe nuk i jep peshë asaj.

162. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e ka shqyrtuar me kujdes dëshminë e dëshmitarit dhe është mbështetur në të aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

## 7. TW4-11

163. TW4-11 dëshmoi para Trupit Gjykses më 2 dhe 3 maj 2023,<sup>262</sup> me anë të videokonferencës, me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.<sup>263</sup>

164. Dëshmitari është shqiptar i Kosovës, [REDAKTUAR].<sup>264</sup>

---

<sup>259</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2.

<sup>260</sup> **TW4-10**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1041, rreshti 25 deri në f. 1042, rreshti 1 dhe f. 1045, rreshtat 15-21, *i referohet* REG00947.

<sup>261</sup> **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1064, rreshti 19 deri në f. 1065, rreshti 4; f. 1066, rreshti 12 deri në f. 1067, rreshti 17.

<sup>262</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1176-1236; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1237-1348.

<sup>263</sup> Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse.

<sup>264</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1183, rreshti 23.

165. Dëshmitari dëshmoi për: (i) arrestimin e tij nga UÇK-ja; (ii) kushtet e ndalimit në FMK; (iii) keqtrajtimin dhe marrjen në pyetje që ai dhe të ndaluarit e tjerë pësuan; (iv) rrethanat e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme; (v) identitetet dhe rolet e anëtarëve të UÇK-së të pranishëm në FMK; dhe (vi) lirimimin e tij nga FMK-ja.

166. Trupi Gjykses vëren se gjatë dëshmisë, TW4-11 dukej i stresuar dhe herë pas here duhej t'i freskohej kujtesa me deklaratat e tij të mëparshme. Megjithatë, në përgjithësi, dëshmia e tij ishte përgjithësisht përputhëse dhe koherente kur rrëfeu për arrestimin nga UÇK-ja dhe ndalimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e tij në FMK. Çka është e rëndësishme, në lidhje me këto aspekte, dëshmia e tij konfirmohet mjaftueshëm nga dëshmitë dhe deklaratat e disa dëshmitarëve të tjerë, përkatësisht të TW4-01-shit, W04733-shit, W01448-ës dhe Osman Kryeziut. Gjithashtu, dëshmitari dukshëm u përpoq t'i kujtonte emrat e të ndaluarve të tjerë apo hollësi në lidhje me ta dhe, kur nuk i kujtoheshin datat e sakta, jepte referenca të tjera kohore.<sup>265</sup> Trupi Gjykses i konsideron ato si përpjekje të njëmendta për të qenë i saktë dhe si tregues se dëshmia e dëshmitarit bazohet në përvojën personale të tij.

167. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se dëshmia e TW4-11-shit ishte kundërthënëse dhe në disa raste e mjegullt kur u pyet për identitetet e anëtarëve të UÇK-së që keqtrajtuuan atë dhe të ndaluarit e tjerë dhe për hollësi në lidhje me keqtrajtimin që pa gjatë kohës që u mbajt i ndaluar në FMK.<sup>266</sup> Për shembull, dëshmitari dëshmoi se nuk i kishte parë personat që e rrahën atë dhe të ndaluarit e tjerë sepse e mbante kokën ulur, ishte i kthyer me fytyrë nga muri, apo ishte errët.<sup>267</sup> Trupi Gjykses e kupton që kushtet e përmendura vërtet mund të pengojnë njohjen e fytyrave. Megjithatë, është e vështirë të pranohet se TW4-11 nuk ishte në gjendje të jepte *kurrfarë* informacioni për

---

<sup>265</sup> *Shih* Pjesën VI.D.4(a) dhe (c).

<sup>266</sup> *Shih, për shembull, TW4-11*: T. 2 maj 2023, publik, f. 1233, rreshtat 9-20; f. 1231, rreshtat 2-24; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1243, rreshti 5 deri në f. 1344, rreshti 19.

<sup>267</sup> *Shih, për shembull, TW4-11*: T. 2 maj 2023, publik, f. 1220, rreshtat 8-10; f. 1231, rreshtat 2-24; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1249, rreshtat 16-19.

anëtarët e UÇK-së që kryen rrahjet kur të ndaluar të tjerë, të cilët u mbajtën dhe keqtrajtuar në kushte të ngjashme, ishin në gjendje të jepnin këtë informacion pa iu kërkuar. Së fundi, Trupi Gjykses vëren se TW4-11 ngurroi të fliste për rrethanat e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme dhe se, veçanërisht në lidhje me këtë pikë, ZPS-ja duhej t'i freskonte kujtesën me deklaratat e tij të mëparshme.<sup>268</sup> Gjithsesi, kur u ballafaqua me deklaratat e veta të mëparshme, TW4-11 konfirmoi saktësinë e tyre.<sup>269</sup> Duke mbajtur të gjitha këto parasysh, Trupi Gjykses gjykon se ngurrimi fillestar i dëshmitarit për të qenë i sigurtë në dhënien e hollësive për kryesit nga radhët e UÇK-së dhe nevoja për t'i freskuar vazhdimisht kujtesën për ngjarjet që çuan në vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, nuk kanë ndikim të madh mbi besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit. Dëshmia e TW4-11-shit do të vlerësohet duke mbajtur parasysh tërësinë e provave.

168. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitari është i besueshëm dhe është mbështetur në dëshminë e tij aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

## 8. W01448

169. Deklaratat me shkrim të W01448-ës u paraqitën si prova në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 155 të Rregullores (bashkërisht, "deklaratat e W01448-ës"), meqenëse dëshmitari kishte ndërruar jetë.<sup>270</sup>

170. Dëshmitari ishte shqiptar i Kosovës, punëtor emigrant në Gjermani.<sup>271</sup>

---

<sup>268</sup> *Shih, për shembull, TW4-11*: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1246, rreshti 3 deri në f. 1248, rreshti 18; f. 1254, rreshti 2 deri në f. 1255, rreshti 11.

<sup>269</sup> *Shih, për shembull, TW4-11*: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1256, rreshtat 10-23.

<sup>270</sup> [Decision on Admission of Evidence Pursuant to Rule 155](#) (Vendimi mbi Pranimin e Provave sipas Rregullës 155), para. 19, 70(b).

<sup>271</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013853-SITF00013854; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016227.

171. Në deklaratat e tij, W01448 dëshmoi për: (i) arrestimin e tij nga anëtarë të UÇK-së; (ii) ndalimin e tij në vendndodhje të ndryshme në Durrës, Kukës (Shqipëri) dhe Prizren (Kosovë), dhe lirimimin e mëpasshëm; (iii) planimetrinë e FMK-së; (iv) marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e tij në FMK nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala; (v) identitetet e të ndaluarve të tjerë dhe marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e tyre nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala; (vi) vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme; dhe (vii) identitetet dhe rolet e anëtarëve të UÇK-së që ishin të pranishëm në FMK.

172. Trupi Gjykses vëren se W01448 ishte jashtëzakonisht i hollësishëm, gjithëpërfshirës dhe i sinqertë në përshkrimin koherent të ngjarjeve përkatëse, si arrestimi dhe në fund lirimi i tij, mbajtja e tij në vende të ndryshme brenda FMK-së dhe prania dhe identitetet e të ndaluarve të tjerë dhe të anëtarëve të UÇK-së që i keqtrajtuuan. Konkretisht, ai përshkroi në mënyrë të sinqertë dhe të gjallë keqtrajtimin që ai dhe të ndaluarit e tjerë pësuan nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, dhe shpjegoi në mënyrë bindëse se si ndihej gjatë kohës që u mbajt i ndaluar.<sup>272</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vëren se dëshmia e W01448-ës përforcohet edhe më tej nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, ndër të cilët TW4-01, TW4-11, W04733, TW4-05, TW4-04 dhe TW4-02.<sup>273</sup> Në përpjekjet e tij për të dhënë dëshmi të saktë, W01448 gjithashtu bëri dallim të qartë midis ngjarjeve që i kishte parë vetë dhe informacionit që i dhanë të ndaluarit e tjerë, duke dhënë shpjegim për burimin e informacionit dhe hollësi në mbështetje të atij informacioni.<sup>274</sup> Trupi Gjykses është bindur se dëshmitari dëshmoi për përjetimet personale dhe se këtë e bëri me vërtetësi.

173. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se ka disa mospërputhje në deklaratat e W01448-ës, por gjithashtu mban parasysht: (i) faktin që W01448 dha më shumë dëshmi

---

<sup>272</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2.(d).

<sup>273</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2.(d).

<sup>274</sup> *Shih, për shembull*, para. 713 më poshtë.

para autoriteteve të ndryshme me pista të ndryshme hetimi; (ii) ngjarjet veçanërisht traumatike që përjetoi W01448 gjatë kohës që u mbajt i ndaluar; (iii) vështirësinë e përshkrimit të ngjarjeve të dhimbshme në mënyrë të përsëritur; dhe (iv) ndikimin e kalimit të kohës në kujtesën e W01448-ës. Pasi ka shqyrtuar të gjithë faktorët në tërësi, Trupi Gjykses nuk gjykon se mospërputhjet ndikojnë në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit. Trupi Gjykses i ka shqyrtuar këto mospërputhje, aty ku është e nevojshme, në analizën e provave.<sup>275</sup>

174. Mbrojtja kundërshtoi besueshmërinë e W01448-ës, duke argumentuar se dëshmitari u kontaktua nga TW4-09 dhe bisedoi me të, dhe se gjithashtu u takua me TW4-05-ën dhe TW4-01-shin.<sup>276</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja thjesht deklaroi se TW4-01, TW4-09 dhe TW4-05 biseduan ose u takuan me W01448-ën, pa dhënë prova në mbështetje të pretendimit të vet se dëshmitarët diskutuan “aspekte të kontestuara” në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjykses vëren se, veçanërisht në lidhje me TW4-01-shin, në mbështetje të argumentit të vet, Mbrojtja përdor një deklaratë të mëparshme të TW4-01-shit<sup>277</sup> që nuk është pjesë e provave të administruara në këtë gjykim. Sido që të jetë, kur krahason dëshmitë e tyre, veçanërisht përmbajtjen dhe gjuhën e përdorur, Trupi Gjykses nuk eidenton ndonjë tregues se W01448 dhe TW4-01 u morën vesh mes tyre. Sa i përket TW4-05-ës, Trupi Gjykses vë në dukje se W01448 e pranoi haptas se u takua rastësisht me TW4-05-ën një herë, dhe nuk e fshehu këtë kontakt [dhe as nuk u përpoq].<sup>278</sup> E njëjta gjë mund të thuhet edhe për TW4-09-ën, [REDAKTUAR].<sup>279</sup> Trupi Gjykses nënvizon se, megjithëse përputhëse në pikat kryesore, dëshmitë e dëshmitarëve lidhur me aspekte

---

<sup>275</sup> *Shih, për shembull*, para. 713 më poshtë.

<sup>276</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 257, 262, 265. Argumenti i Mbrojtjes se W01448 dhe W04733 u morën vesh mes tyre trajtohet në vlerësimin e përgjithshëm të besueshmërisë së W04733-shit.

<sup>277</sup> *Shih* Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Mbrojtjes, para. 262, dhe, në veçanti, poshtëshënimin 613 që i referohet 083219-TR-ET Part 9 Revised RED (Pjesa 9, e rishikuar, RED), f. 20.

<sup>278</sup> **W01448**: SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016156; i referohet TW4-05-ës si “dëshmitari G”.

<sup>279</sup> [REDAKTUAR].

të veçanta të ngjarjeve janë prapëseprapë të ndryshme. Trupi Gjykses nuk evidenton asnjë tregues të ndonjë marrëveshjeje mes dëshmitarëve në përmbajtjen apo llojin e dëshmimeve të tyre (për shembull, në mënyrën si i dhanë deklaratat, përdorimin e gjuhës së njëjtë gjatë përshkrimit të fakteve të njëjta, dhe rrethana të tjera relevante). Fakti që W01448 bisedoi apo u takua një herë me TW4-05-ën dhe TW4-09-ën në vetvete nuk mjafton për të vërtetuar se ka pasur marrëveshje apo ndikim të palejueshëm. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses hedh poshtë si të pabazë pretendimin e Mbrojtjes se W01448 dhe TW4-01, TW4-05 dhe TW4-09, u morën vesh mes tyre.

175. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitari është i besueshëm dhe është mbështetur në dëshminë e tij aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

## 9. W04733

176. Deklaratat me shkrim të W04733-shit u paraqitën si prova në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 155 të Rregullores (bashkërisht, “deklaratat e W04733-shit”), meqenëse dëshmitari kishte ndërruar jetë.<sup>280</sup>

177. Dëshmitari ishte shqiptar i Kosovës [REDAKTUAR], i cili kishte punuar si polic nga viti 1968 deri në largimin e tij nga puna në vitin 1997, [REDAKTUAR].<sup>281</sup>

178. Në deklaratat e tij, W04733 dëshmoi për: (i) një varg incidentesh që ndodhën në maj 1998 dhe prill/maj 1999, në të cilat ishte përfshirë (gjithashtu edhe) z. Shala; (ii) arrestimin e tij në Durrës nga anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së dhe ndalimin e mëpasshëm në Romanat (Shqipëri)<sup>282</sup> dhe më pas në Kukës; (iii) marrjen në pyetje

<sup>280</sup> [Decision on Admission of Evidence Pursuant to Rule 155](#) (Vendimi mbi Pranimin e Provave sipas Rregullës 155), para. 33, 70(b).

<sup>281</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 1 (Pjesa 1), f. 17, 25.

<sup>282</sup> Ky vend është shkruar në mënyra të ndryshme në të gjithë dëshminë: “Rramallak”, “Ramalak”, “Romanak”, “Ramanak”, “Romanat”. Trupi Gjykses e ka të qartë se bëhet fjalë për të njëjtin vend, të cilit më tej do t’i referohet me “Romanat”.

dhe keqtrajtimin e tij nga anëtarë të UÇK-së në FMK, ndër të cilët z. Shala; (iv) praninë dhe identitetin e të ndaluarve të tjerë dhe keqtrajtimin e tyre nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala; (v) identitetet dhe rolet e anëtarëve të tjerë të UÇK-së të pranishëm në FMK, ndër të cilët Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi; (vi) lirimin e tij nga FMK-ja; dhe (vii) lëndimet fizike dhe psikologjike që pësoi si rezultat i ndalimit dhe keqtrajtimit.

179. Trupi Gjykes vëren se në të gjitha deklaratat e tij, W04733 i rrëfeu ngjarjet me shumë imtësi, me përshkrime të shumta të gjalla dhe hollësi të ndërlikuara dhe të panevojshme, çka tregon se dëshmia e W04733-shit bazohej në përjetimet personale të tij.<sup>283</sup> Fakti që dha më shumë deklarata pavarësisht nga frika e dëmit që mund të pësonte nga (ish) anëtarë të UÇK-së,<sup>284</sup> tregon vendosmërinë e fortë të dëshmitarit për të dhënë dëshmi dhe për t'i rrëfyer përjetimet e veta.<sup>285</sup> Për mendimin e Trupit Gjykes, W04733 ishte i sinqertë në deklaratat e tij dhe u përpoq qartësisht të jepte dëshmi të saktë.<sup>286</sup> Ai bëri qartësime dhe korrigjime të deklaratave të mëparshme,

<sup>283</sup> Për shembull, W04733 përshkroi në mënyrë të gjallë sesi Xhemshit Krasniqi ia theu dhëmbët, diçka që i kujtohej veçanërisht dhe që e ka përmendur vazhdimisht gjatë viteve (*shih, për shembull*, SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186-SITF00013187: "Xhemshit KRASNIQI m'i theu të gjithë dhëmbët dhe më futi thellë në fyt një shkop gome që filloi ta tundë brenda gojës sime. Filloi të më dalë gjak edhe nga fyti"). Dëshmitari dha dëshmi po aq të gjallë edhe në lidhje me keqtrajtimin që pësuan të ndaluarit e tjerë, *shih, për shembull*, 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 5 (në lidhje me keqtrajtimin e [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantit të tretë rom); SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018744 (në lidhje me keqtrajtimin e W01448-ës). E njëjta vlen edhe për dëshminë e hollësishme të W04733-shit në lidhje me karakteristikat fizike të dhomës së parë në të cilën u mbajt në FMK: SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019829-00019830; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013808-SPOE00013809; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 20, rreshti 18 deri në f. 21, rreshti 3.

<sup>284</sup> **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185337, SPOE00185342, SPOE00185344; 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 23, rreshtat 15-20 dhe f. 24, rreshtat 5-9.

<sup>285</sup> **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185337; 106978-107020, f. 106983, 106991.

<sup>286</sup> Për shembull, dëshmitari sqaroi se ishte natën vonë edhe kur mbërriti në FMK, edhe kur u lirua, dhe për këtë arsye nuk mundi të vizatonte një skicë të kompleksit. Megjithatë, ai shpjegoi se e njëjta mirë ndërtesën ku u mbajt i ndaluar dhe e përshkroi atë, *shih* SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185342.

madje edhe pa i kërkuar.<sup>287</sup> Për më tepër, ai bëri dallim të qartë midis çfarë kishte parë vetë dhe çfarë kishte dëgjuar nga të tjerët.<sup>288</sup> Po ashtu, W04733 pranonte menjëherë kur nuk i kujtoheshin ose nuk i dinte disa hollësi të ngjarjeve,<sup>289</sup> si emrat e disa anëtarëve të UÇK-së ose të personave të ndaluar dhe, kur ishte e mundshme, jepte informacion identifikues tjetër apo përshkrime të tyre.<sup>290</sup>

180. Çka është e rëndësishme, dëshmia e dëshmitarit ishte kryesisht përputhëse dhe në vetvete koherente sa i përket keqtrajtimit që iu bë gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, lëndimeve që pësoi si rezultat i keqtrajtimit, identiteteve të anëtarëve të UÇK-së që morën pjesë në keqtrajtimin e tij dhe pranisë, identiteteve dhe keqtrajtimit të të ndaluarve të tjerë në FMK.<sup>291</sup> Në lidhje me këto aspekte, dëshmia e tij gjithashtu konfirmohet nga dëshmi të dëshmitarëve të tjerë që përforcojnë njëra-tjetrën, si ajo e TW4-01-shit, TW4-11-shit, W01448-ës, TW4-08-ës, TW4-06-ës, TW4-07-ës, TW4-09-ës, TW4-05-ës, si edhe dëshmia e ekspertit mjekoligjor dr. Gasior.<sup>292</sup>

181. Trupi Gjykues është i vetëdijshëm se ka disa mospërputhje në deklaratat e W04733-shit, por gjithashtu mban parasysht: (i) faktin që W04733 dha një numër deklaratash dhe intervistash brenda një periudhe prej gjashtëmbëdhjetë (16) vitesh;

<sup>287</sup> **W04733:** SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185336; 106978-107020, f. 106980.

<sup>288</sup> **W04733:** SPO00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013844-SPOE00013845 (në lidhje me informacionin që dha për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme); SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741-SITF00018742 (në lidhje me identifikimin e disa anëtarëve të UÇK-së, sikurse i kishin treguar të ndaluarit e tjerë).

<sup>289</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745-00018746; 106978-107020, f. 106981; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019835; 106978-107020, f. 106981-106982, 107001.

<sup>290</sup> **W04733:** SPOE00185341-00185342; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745-00018746; U003-2283-U003-2289 RED2, f. U003-2286; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019830-00019831; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013813.

<sup>291</sup> *Për shembull*, Trupi Gjykues vëren se, që nga viti 2002, dëshmitari në vazhdimësi ka theksuar se gjatë keqtrajtimit, anëtarët e UÇK-së ia thyen dhëmbët dhe ia prenë kyçin e dorës me thikë. *Shih* SITF00390625-00390626, f. SITF00390626; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186-SITF00013187; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018743-00018744; 106978-107020, f. 106982-106984; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 2, rreshtat 14-18, f. 7, rreshti 20 deri në f. 8, rreshti 4. *Shih më tej* Pjesët VI.D.5 dhe VI.E.2.(c).

<sup>292</sup> *Shih, për shembull*, para. 449, 456, 462, 470, 694, 697 më poshtë.



(ii) ngjarjet veçanërisht traumatike që përjetoi W04733 gjatë kohës që u mbajt i ndaluar; (iii) vështirësinë e përshkrimit të ngjarjeve të dhimbshme në mënyrë të përsëritur, veçanërisht autoriteteve të huaja; (iv) ndikimin e kalimit të kohës në kujtesën e W04733-shit, së bashku me moshën e thyer në kohën kur dha disa deklaratat dhe intervista;<sup>293</sup> dhe (v) gjendjen shëndetësore të dëshmitarit që u përkeqësua edhe më shumë pas [REDAKTUAR].<sup>294</sup> Pasi ka shqyrtuar të gjithë faktorët në tërësi, Trupi Gjykses nuk gjykon se këto mospërputhje ndikojnë në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit. Trupi Gjykses i ka shqyrtuar këto mospërputhje, aty ku është e nevojshme, në analizën e provave.

182. Mbrojtja kundërshton besueshmërinë e W04733-shit,<sup>295</sup> duke argumentuar se nuk mund të mbështetesh në provat e W04733-shit dhe/ose ato duhet të shqyrtohen me kujdes për arsyet në vijim: (i) identifikimi prej W04733-shit i disa kryesve nga radhët e UÇK-së bazohet në dëshmi të dorës së dytë ose përmendjes së tyre në media, është bërë vetëm në deklaratat e tij më të fundit në vitin 2018, ose nuk konfirmohet nga dëshmi të dëshmitarëve të tjerë.<sup>296</sup> Në këtë kontekst, Mbrojtja parashton se, në kundërshtim me dëshminë e W04733-shit, tre dëshmitarë të Mbrojtjes, përkatësisht Time Kadrijaj, Safete Hadërgjonaj dhe Bardhyl Mahmuti, dëshmuan në sallë të gjyqit se ata nuk ishin të pranishëm në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat;<sup>297</sup> (ii) disa aspekte të dëshmisë së W04733-shit nuk konfirmohen nga anëtarët e familjes së tij, përkatësisht TW4-06, TW4-07, TW4-08 dhe TW4-09, ose bien ndesh me dëshmitë e

---

<sup>293</sup> [REDAKTUAR].

<sup>294</sup> **W04733**: SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019841, SITF00019846; 106978-107020, f. 107012; 082892-TR-AT-ET Part 8 RED2 (Pjesa 8 RED2), f. 14, rreshtat 10-11; 082892-TR-AT-ET Part 10 RED 2 (Pjesa 10 RED 2), f. 31, rreshti 19 deri në f. 32, rreshti 2.

<sup>295</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 231-254, 257, 263, 265; T. 16 prill 2024, konfidencial, f. 4247, rreshti 21 deri në f. 4253, rreshti 9.

<sup>296</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 234, 240-241.

<sup>297</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 234, 240.

tyre;<sup>298</sup> dhe (iii) pas lirimimit nga FMK-ja, dëshmitari ishte në kontakt me W01448-ën dhe u takua një herë me TW4-01-shin.<sup>299</sup>

183. Sa u përket argumenteve të Mbrojtjes në lidhje me, në përgjithësi, identifikimin prej W04733-shit të kryesve nga radhët e UÇK-së në FMK, Trupi Gjykses fillimisht nënvizon se Aktgjykimi nuk bazohet vetëm, apo në masë vendimtare, në dëshminë e W04733-shit, të cilin Mbrojtja nuk pati mundësi ta merrte në pyetje.<sup>300</sup> Trupi Gjykses vlerëson dëshmitë në tërësinë e tyre, duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të paraqitura.<sup>301</sup> Fakti se identifikimi prej dëshmitarit i anëtarëve të UÇK-së bazohet në dëshmi të dorës së dytë që burojnë nga të ndaluar të tjerë në FMK apo mediat, ose se identifikimi nuk konfirmohet nga dëshmitarë të tjerë, ka të bëjë me peshën që i jepet provës duke mbajtur parasysh tërësinë e provave në dispozicion të Trupit Gjykses, dhe nuk zvogëlon besueshmërinë e deklaratave të W04733-shit.

184. Sa i përket mbështetjes së dëshmisë së tij në dëshmi të dorës së dytë, Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitari ishte i sigurtë në lidhje me si i njihnte anëtarët e UÇK-së që përmendi me emër. Ai bëri dallim midis atyre që i njihnte që para luftës dhe atyre për të cilët mësoi se kush ishin gjatë kohës që u mbajt në FMK, ose më pas.<sup>302</sup> Ai gjithashtu shpjegoi qartë burimin e informacionit, duke dhënë hollësi që mbështesin besueshmërinë e atij informacioni.<sup>303</sup> Trupi Gjykses rikujton se dëshmitë e dorës së

---

<sup>298</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 246-248, 250-253.

<sup>299</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 243, 257, 263, 265.

<sup>300</sup> *Shih* [Decision on Admission of Evidence Pursuant to Rule 155](#) (Vendimi mbi Pranimin e Provave sipas Rregullës 155), para. 26, 38.

<sup>301</sup> Rregulla 139(2) e Rregullores.

<sup>302</sup> *Shih*, për *shembull*, SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186-SITF00013187; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013833-SPOE00013834.

<sup>303</sup> *Për shembull*, W04733 deklaroi se emrat e disa anëtarëve të UÇK-së i mësoi nga [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një muzikant tjetër rom, të cilët ishin të ndaluar bashkë me të; ai shpjegoi që ata ishin muzikantë, kishin marrë pjesë në shumë dasma dhe rrjedhimisht njihnin shumë njerëz, përfshirë anëtarë të UÇK-së. *Shih* **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341-00185342 (“Ata i njihnin të gjithë në atë kamp”, “Ata e njihnin Xhemshit KRASNIQIN. Romët na treguan emrin e tij.

dytë nuk përjashtohen domosdoshmërisht.<sup>304</sup> Sa i përket argumentit se disa emra dëshmitari i përmendi vetëm në deklaratën e vitit 2018, Trupi Gjykses thekson se deklaratat e një dëshmitari dhënë autoriteteve të ndryshme me pista të ndryshme hetimi, brenda një periudhe prej më shumë vitesh, nuk janë kurrë të njëjta. Asnjë dëshmitar nuk mund t'i rrëfejë ngjarjet në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe më vonë, në deklaratat të mëpasshme t'i rrëfejë ato në të njëjtën mënyrë, me të njëjtën gjuhë, radhitje, strukturë dhe hollësi. Individualiteti i secilës deklaratë është tregues i mbështetshmërisë dhe duhet të vlerësohet plotësisht duke mbajtur parasysh provat e tjera të disponueshme.

185. Së fundi, sa u përket dëshmimeve të Time Kadrijajt, Safete Hadërgjonajt dhe Bardhyl Mahmutit, dhe sikurse shtjellohet me më shumë hollësi më poshtë, Trupi Gjykses i konsideron tre dëshmitarët e Mbrojtjes jo të besueshëm dhe nuk u jep peshë dëshmimeve të tyre se nuk ishin të pranishëm në FMK.<sup>305</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes për dëshminë e W04733-shit në lidhje me identifikimin shqyrtohen, sipas nevojës, në pikat përkatëse të analizës së provave.

186. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se disa aspekte të dëshmisë së W04733-shit nuk konfirmohen nga dëshmitë e TW4-06-ës, TW4-07-ës, TW4-08-ës dhe TW4-09-ës, ose bien ndesh me to, Trupi Gjykses vëren se anëtarët e familjes së W04733-shit nuk ishin të pranishëm dhe nuk kishin dijeni të drejtpërdrejtë për disa incidente për të cilat dëshmoi W04733. Për këtë arsye, është krejt e natyrshme që dëshmitë e TW4-06-ës, TW4-07-ës, TW4-08-ës dhe TW4-09-ës nuk konfirmojnë çdo aspekt të dëshmisë së W04733-shit. Mospërputhjet, nëse ka, midis dëshmisë së W04733-shit dhe dëshmimeve të anëtarëve të familjes së tij, shqyrtohen në pjesët përkatëse të analizës së provave.

---

Përmes tyre ne mund t'i gjejmë të gjithë emrat", "Ata na treguan se bënë muzikë në dasma. Ata njihnin shumë njerëz të UÇK-së").

<sup>304</sup> *Shih* para. 91.

<sup>305</sup> *Shih* para. 248, 259, 273 më poshtë.

187. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se dëshmitarët u morën vesh midis tyre, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja thjesht deklaroi se W01448 dhe TW4-01 ishin në kontakt ose u takuan me W04733-shin, dhe nuk paraqet asnjë provë në mbështetje të pretendimit se ata biseduan për “aspekte të kontestuara në këtë çështje gjyqësore”.<sup>306</sup> Provat tregojnë se W04733 dhe TW4-01 pranuan haptas se u takuan dhe nuk fshehën (e as u përpoqën të fshihnin) kontaktin që patën.<sup>307</sup> E njëjta vlen edhe për kontaktet e W04733-shit me W01448-ën.<sup>308</sup> Çka është e rëndësishme, megjithëse përputhëse në pikat kryesore, dëshmitë e dëshmitarëve gjithsesi ndryshonin në disa aspekte të veçanta të ngjarjeve. Nga përmbajtja ose tiparet e dëshmisë (për shembull, mënyra si dhanë deklaratat, përdorimi i gjuhës së njëjtë gjatë përshkrimit të ngjarjeve dhe rrethana të tjera relevante), Trupi Gjykses nuk evidentoi asnjë tregues se dëshmitarët u morën vesh mes tyre. Fakti që W04733 bisedoi ose u takua me W01448-ën dhe TW4-01-shin në vetvete nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar marrëveshje ose ndikim të palejueshëm. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses hedh poshtë si të pabazë pretendimin e Mbrojtjes se dëshmitarët u morën vesh mes tyre.

188. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se W04733 është i besueshëm dhe është mbështetur në dëshminë e tij aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

---

<sup>306</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 265.

<sup>307</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1492, rreshtat 12-18. **W04733**: 106978-107020, f. 106997-106998.

<sup>308</sup> **W04733**: SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745; SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185340, SPOE00185343; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019837-00019838.

## 10. Zbinjek Dolejshi (Zbyněk Dolejší - W04887)

189. Kolonel Zbinjek Dolejshi (kol. Dolejshi) dëshmoi para Trupit Gjykses më 16 qershor 2023.<sup>309</sup> Krahas dëshmisë gojore, ai paraqiti edhe dy aktekspertiza të cilat u pranuan si prova në bazë të rregullës 149 të Rregullores.<sup>310</sup>

190. Kol. Dolejshi është ekspert i biologjisë molekulare dhe gjenetikës. Ai punon në Institutin e Policisë Kriminale të Republikës Çeke dhe aktualisht është drejtor i Departamentit të Gjenetikës.<sup>311</sup> Ai dëshmoi për analizën e ADN-së që kreu në lidhje me lidhjen biologjike midis viktimës së vrasjes së paligjshme dhe [REDAKTUAR]. Mbrojtja nuk kundërshtoi besueshmërinë e provave të ekspertit dhe ekspertizës së kol. Dolejshit.<sup>312</sup> Sikurse shtjellohet me hollësi në analizën e provave, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e ekspertit dhe aktekspertizat e tij janë plotësisht të besueshme dhe të mbështetshme.<sup>313</sup>

## 11. Asllan Elezaj (W04379)

191. Deklaratat me shkrim të Asllan Elezajt ("z. Elezaj") dhënë ZPS-së u paraqitën si prova në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 155 të Rregullores, meqenëse dëshmitari kishte ndërruar jetë.<sup>314</sup>

---

<sup>309</sup> **Kol. Dolejshi:** T. 16 qershor 2023, konfidencial, f. 1943-2025.

<sup>310</sup> **Aktekspertizat:** SITF00012456-SITF00012458-ET, i përgatitur në vitin 2009; 110670-110674, i përgatitur në vitin 2023; [Decision on Admission of SPO Expert Reports](#), (Vendimi mbi Pranimin e Aktekspertizave të ZPS-së) para. 6, 24-25, 49.

<sup>311</sup> **Biografia:** 108634-108634 RED; **Kol. Dolejshi:** T. 16 qershor 2023, publik, f. 1952, rreshti 14 deri në f. 1956, rreshti 6.

<sup>312</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 173-177; KSC-BC-2020-04, F00348, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes në lidhje me Provat e Dëshmitarëve Ekspertë të Prokurorisë*, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale, para. 7.

<sup>313</sup> *Shih* para. 768, 774-(e) më poshtë.

<sup>314</sup> [Decision on Admission of Evidence Pursuant to Rule 155](#) (Vendimi mbi Pranimin e Provave sipas Rregullës 155), para. 62, 70(b).

192. Z. Elezaj ishte shtetas i Shqipërisë, i lindur në Kukës.<sup>315</sup> Dëshmitari ishte pronari i FMK-së,<sup>316</sup> të cilën ia dha për përdorim UÇK-së.<sup>317</sup> Gjatë periudhës që lidhet me akuzat, ai punoi në logjistikë si anëtar i UÇK-së në FMK.<sup>318</sup>

193. Në deklaratat e tij, z. Elezaj dëshmoi për: (i) pronësinë dhe planimetrinë e FMK-së; (ii) funksionimin dhe përdorimin e FMK-së nga UÇK-ja; (iii) praninë e disa anëtarëve të UÇK-së në FMK; dhe (iv) vendndodhjen e z. Shala gjatë luftës.

194. Trupi Gjykses vëren se z. Elezaj dha informacion të hollësishëm dhe kryesisht koherent në lidhje me disa aspekte të përdorimit, funksionimit dhe planimetrisë së FMK-së dhe ndërtesave në FMK,<sup>319</sup> si dhe me nofkën, statusin dhe vendndodhjen e z. Shala (në veçanti praninë e tij në FMK në fund të majit 1999). Në këtë kontekst, dëshmia e dëshmitarit është përputhëse me dëshmi të tjera ku mund të mbështetesh, që iu paraqitën Trupit Gjykses.

195. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren gjithashtu ngurrimin dhe/ose drojën e dëshmitarit për të dhënë dëshmi në lidhje me disa aspekte kyçe që lidhen drejtpërdrejt me akuzat. Pyetjet në lidhje me krimet duhej të përsëriteshin disa herë para se dëshmitari t'iu përgjigjej. Për shembull, megjithëse vizatoi një skicë përgjithësisht të plotë të FMK-së,<sup>320</sup> z. Elezaj nuk e vizatoi ndërtesën në mes të oborrit,<sup>321</sup> në të cilën u mbajtën dhe keqtrajtuat të ndaluarit.<sup>322</sup> Trupi Gjykses dyshon në dëshminë e dëshmitarit në lidhje me këtë aspekt kur mund të pritet që ai ishte në dijeni të ekzistencës dhe përdorimit të kësaj ndërtese, duke mbajtur parasysh se ishte pronari

---

<sup>315</sup> **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 2, rreshtat 5-6; f. 3, rreshtat 2-7.

<sup>316</sup> **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 5, rreshtat 6-20.

<sup>317</sup> **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 25, rreshtat 5-20.

<sup>318</sup> **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar RED4), f. 4, rreshtat 15-19.

<sup>319</sup> Dëshmitari vizatoi një skicë, *shih* 065435-065435-ET.

<sup>320</sup> **Skica:** 065435-065435-ET.

<sup>321</sup> *Shih* para. 312-318 më poshtë.

<sup>322</sup> *Shih* para. 335, 588, 748-750 më poshtë.

i FMK-së dhe i pranishëm në FMK gjatë asaj periudhe. Gjithashtu, dëshmitari fillimisht u bëri bisht pyetjeve për praninë dhe/ose ndalimin e civilëve në FMK,<sup>323</sup> dhe më pas e mohoi kategorikisht këtë.<sup>324</sup> Për mendimin e Trupit Gjykses, kjo deklaratë e tij është e papajtueshme me: (i) faktin që z. Elezaj ishte i pranishëm në FMK gjatë kuadrit kohor të akuzave; dhe (ii) provat e shumta reciprokisht konfirmuese në dispozicion të Trupit Gjykses, të cilat tregojnë se persona u ndaluan dhe keqtrajtuuan në FMK.<sup>325</sup> Kjo sjellje tregon qartë se dëshmitari nuk dëshiron që ai dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së të pranishëm në FMK gjatë periudhës së akuzave të konsiderohen se kishin lidhje me krimet që ndodhën në FMK. Dëshmitari gjithashtu dha një numër përgjigjesh jo të besueshme dhe/ose bishtnuese dhe të mjegullta në lidhje me anëtarësinë e tij në UÇK dhe praninë e anëtarëve të tjerë të UÇK-së në FMK.<sup>326</sup> Një shembull tipik për këtë është pretendimi i tij se nuk e dinte rolin e z. Mark Shala,<sup>327</sup> i cili – sipas provave të mbështetshme të administruara në këtë gjykim, veçanërisht dëshmisë së vetë z. Mark Shala – ishte shef i logjistikës, me bazë në FMK,<sup>328</sup> gjatë kohës kur edhe z. Elezaj punonte në logjistikë, që do të thotë, siç duket, nën mbikëqyrjen e z. Mark Shala. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, dëshmia e z. Elezaj në lidhje me aspektin e mësipërm nuk është bindëse dhe tregon qartë vendimin strategjik të tij për të mbrojtur interesat e veta dhe të anëtarëve të tjerë të UÇK-së në FMK duke mohuar çdo pretendim në lidhje me praktikën e ndalimit atje.

---

<sup>323</sup> **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar RED4), f. 51, rreshti 23 deri në f. 55, rreshti 4.

<sup>324</sup> **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar RED4), f. 92, rreshti 17 deri në f. 95, rreshti 10.

<sup>325</sup> *Shih* konstatimet në Pjesët VI.D, VI.E., dhe VI.H.

<sup>326</sup> *Shih, për shembull, z. Elezaj:* 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar RED4), f. 4, rreshti 23 deri në f. 8, rreshti 15; f. 30, rreshti 1 deri në f. 36, rreshti 5; f. 131, rreshti 2 deri në f. 132, rreshti 13.

<sup>327</sup> **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar RED4), f. 86, rreshti 3 deri në f. 92, rreshti 14.

<sup>328</sup> *Shih* para. 277 më poshtë.

196. Aspektet e lartpërmendura të dëshmisë së dëshmitarit vënë në dukje një mungesë shumë të fortë dëshire nga ana e dëshmitarit për të dhënë informacion të dobishëm në lidhje me akuzat nën shqyrtim, me synimin e mbrojtjes së interesave të veta dhe të z. Shala.

197. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e ka shqyrtuar me kujdes deklaratën e z. Elezaj dhe është mbështetur në të aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

## 12. Marek Gasior (W04826)

198. Dr. Gasiori dëshmoi para Trupit Gjykses midis 26 qershorit dhe 3 korrikut 2023.<sup>329</sup> Krahas dëshmisë gojore, dr. Gasiori paraqiti tri aktekspertiza, të cilat u pranuan si prova në bazë të rregullës 149 të Rregullores.<sup>330</sup>

199. Dr. Gasiori është ekspert mjekoligjor i cili kreu autopsinë e kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme dhe ekzaminimin fizik të TW4-01-shit dhe W04733-shit më 2009 dhe 2010.<sup>331</sup> Ai dëshmoi në lidhje me: (i) lëndimet që pësoi viktimja e vrasjes së paligjshme para vdekjes; (ii) shkaqet e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme; (iii) kufomën e viktimës së vrasjes së paligjshme; dhe (iv) lëndimet që pësuan TW4-01 dhe W04733. Mbrojtja nuk kundërshtoi ekspertizën e tij.<sup>332</sup> Trupi Gjykses konstaton

---

<sup>329</sup> **Dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, konfidencial, f. 2026-2100; T. 27 qershor 2023, konfidencial, f. 2101-2142; T. 3 korrik 2023, konfidencial, f. 2157-2207.

<sup>330</sup> Aktekspertizat: 031049-031095 RED2; SITF00019134-SITF00019147 RED2; SITF00372709-00372732 RED; SITF00019793-00019810; [Decision on Admission of SPO Expert Reports](#) (Vendimi mbi Pranimin e Aktekspertizave të ZPS-së), para. 11, 32, 49.

<sup>331</sup> **Biografia:** 103409-103410 RED; **Dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, konfidencial, f. 2064, rreshti 8 deri në f. 2071, rreshti 6; T. 27 qershor 2023, konfidencial, f. 2114, rreshti 6 deri në f. 2117, rreshti 5; f. 2125, rreshti 21 deri në f. 2127, rreshti 15; **Raportet:** 031049-031095 RED2; SITF00019134-SITF00019147 RED2; SITF00372709-00372732 RED; SITF00019793-00019810.

<sup>332</sup> KSC-BC-2020-04, F00348, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes në lidhje me Provat e Dëshmitarëve Ekspertë të Prokurorisë*, konfidencial, me Shtojcën 1 konfidenciale, para. 5.



se dëshmia e ekspertit dhe aktekspertizat e tij janë tërësisht të besueshme dhe të mbështetshme.

### 13. Uilliam Guduin (William Goodwin - W04875)

200. Dr. Uilliam Guduin (dr. Guduin) dëshmoi para Trupit Gjykses më 4 korrik 2023.<sup>333</sup> Krahas dëshmisë gojore, ai paraqiti dy aktekspertiza, të cilat u pranuan si prova në bazë të rregullës 149 të Rregullores.<sup>334</sup>

201. Dr. Guduin është gjenetist mjekoligjor dhe ligjërues i gjenetikës mjekoligjore në Universitetin e Lankashirit Qendror (*Central Lancashire*), në Preston të Britanisë së Madhe.<sup>335</sup> Atij iu kërkua që të komentonte aktekspertizat e kol. Dolejshit.<sup>336</sup> Ai dëshmoi për procesin e përzgjedhjes së mostrave të ADN-së, analizën dhe metodologjinë, dhe interpretimin e të dhënave. Mbrojtja nuk e kundërshtoi ekspertizën e tij.<sup>337</sup> Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e ekspertit dhe aktekspertizat e tij janë tërësisht të besueshme dhe të mbështetshme.

### 14. Osman Kryeziu (W04848)

202. Deklaratat me shkrim të Osman Kryeziut ("z. Kryeziu") u pranuan si prova në bazë të rregullës 155 të Rregullores, meqenëse dëshmitari ka ndërruar jetë.<sup>338</sup>

---

<sup>333</sup> **Dr. Guduin:** T. 4 korrik 2023, publik, f. 2208-2247.

<sup>334</sup> **Aktekspertizat:** 103373-103387 RED, e përgatitur më 2021; 111160-111162, e përgatitur më 2023; [Decision on Admission of SPO Expert Reports](#), (Vendi mbi Pranimin e Aktekspertizave të ZPS-së), para. 14, 39, 49.

<sup>335</sup> **Biografia:** 103392-103400 RED; **Dr. Guduin:** T. 4 korrik 2023, publik, f. 2214, rreshti 11 deri në f. 2215, rreshti 23.

<sup>336</sup> **Aktekspertiza:** 111160-111162; **Dr. Guduin:** T. 4 korrik 2023, publik, f. 2218, rreshtat 4-8.

<sup>337</sup> KSC-BC-2020-04, F00348, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes në lidhje me Provat e Dëshmitarëve Ekspertë të Prokurorisë*, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale, para. 9.

<sup>338</sup> [Decision on Admission of Evidence Pursuant to Rule 155](#) (Vendimi mbi Pranimin e Provave sipas Rregullës 155), para. 46, 70(b).

203. Para periudhës që lidhet me akuzat, z. Kryeziu ishte prokuror në Prishtinë deri në vitin 1990.<sup>339</sup> Ai iu bashkua UÇK-së në prill 1999, ose rreth kësaj date,<sup>340</sup> dhe, gjatë periudhës që lidhet me akuzat kishte për detyrë të kryente hetime dhe marrje në pyetje, përfshirë në FMK.<sup>341</sup> Sipas dëshmisë së tij, ai u caktua me detyrë në FMK nga Xhemshit Krasniqi dhe Sabit Geci.<sup>342</sup>

204. Në deklaratat e veta, z. Kryeziu dëshmoi, ndër të tjera, për: (i) rrethanat e anëtarësimit të tij në UÇK në Kukës, afërsisht në prill 1999; (ii) caktimin e tij me detyrë në FMK;<sup>343</sup> (iii) pjesëmarrjen e tij në marrjen në pyetje të TW4-04-ës dhe TW4-11-shit ([REDAKTUAR]);<sup>344</sup> (iv) hierarkinë komanduese në FMK në atë kohë,<sup>345</sup> dhe (v) arrestimin, marrjen në pyetje dhe ndalimin në FMK të atyre që dyshoheshin se ishin “kolaboratorë” të forcave serbe.<sup>346</sup>

205. Trupi Gjykses thekson se z. Kryeziu dha dëshmi përgjithësisht përputhëse dhe koherente për periudhën e pranisë dhe detyrës së tij në FMK në atë kohë. Ai gjithashtu dha informacion të hollësishëm lidhur me funksionimin e vetë FMK-së.<sup>347</sup> Në këtë aspekt, dëshmia e tij konfirmohet nga shumë dëshmitarë të tjerë. Gjithashtu, për

<sup>339</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016910; SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100.

<sup>340</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014091.

<sup>341</sup> Roli i z. Kryeziu përfshinte hetime dhe “seanca dëgjimore” në lidhje me shkelje administrative që pretendohet se ishin kryer nga anëtarë të UÇK-së (*shih, z. Kryeziu:* SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014095-SITF00014096; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016913-SITF00016914), si dhe hetimin dhe marrjen në pyetje të të ndaluarve civilë, sikurse shtjellohet më poshtë.

<sup>342</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014097-SITF00014098; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016912 dhe SITF00016920.

<sup>343</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014099.

<sup>344</sup> *Shih* para. 422-423, 433, 521 më poshtë.

<sup>345</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014098- SITF00014099.

<sup>346</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100-SITF00014101.

<sup>347</sup> Trupi Gjykses vëren, për shembull, dallimin që bëri z. Kryeziu midis asaj që e quajti “Shtabi 2” (FMK) dhe “Shtabi 1” që gjendej aty afër, ku ishte i vendosur Ruzhdi Saramati; *shih, z. Kryeziu:* SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016912; SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014092-SITF00014093. Kjo është karakteristikë kyçe e organizimit në Kukës, në lidhje me të cilën deklaratat e dëshmitarit konfirmohen nga dëshmia gojore e një anëtarit tjetër të UÇK-së – dëshmitarit TW4-10, **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1092, rreshtat 13-24.

mendimin e Trupit Gjykses, z. Kryeziu ishte i hapur në dëshminë e tij për praninë në FMK të një numri personash kyç nga hierarkia komanduese, ndër të cilët Xhemshit Krasniqi dhe Sabit Geci,<sup>348</sup> si edhe anëtarë të tjerë të UÇK-së,<sup>349</sup> gjatë periudhës që lidhet me akuzat, sikurse konfirmohet nga shumë prova të tjera të administruara në këtë gjykim.<sup>350</sup> Po kështu, z. Kryeziu pranoi se të ndaluarit TW4-04 dhe TW4-11, si edhe TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme, ishin të pranishëm në FMK në atë kohë,<sup>351</sup> çka konfirmohet edhe nga prova të tjera.<sup>352</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e gjykon dëshminë e z. Kryeziu si të dhënë me vërtetësi dhe të besueshme në lidhje me këto aspekte.

206. Megjithatë, Trupi Gjykses konstatoi se disa aspekte kyçe të deklaratave të dëshmitarit nuk ishin të besueshme, veçanërisht sa i përket ushtrimit të detyrave të tij në FMK në lidhje me civilët e ndaluar.

207. Së pari, Trupi Gjykses vëren se në deklaratat e veta, z. Kryeziu ngurroi të pranonte, ose u përpoq të mohonte, përfshirjen e tij në marrjen në pyetje të personave që akuzoheshin se ishin “kolaboratorë” të forcave serbe. Për shembull, ai fillimisht mohoi se kishte intervistuar apo marrë në pyetje civilë, por më pas pranoi se e kishte intervistuar TW4-04-ën dhe TW4-11-shin.<sup>353</sup> Dëshmitë e TW4-04-ës dhe TW4-11-shit konfirmojnë se z. Kryeziu mbajti “seanca dëgjimore” dhe i “mori në pyetje”, dhe se u prezantua si “gjykatës” ose “prokuror”.<sup>354</sup> Po ashtu edhe TW4-02, i cili personalisht e

---

<sup>348</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014098.

<sup>349</sup> Trupi Gjykses vëren se dëshmitari është i besueshëm edhe në lidhje me një numër aspektesh dytësore, si njohja e tij me Ruzhdi Saramatin, vajtja e këtij të fundit në Burrel së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së dhe kthimi i mëpasshëm i tyre në Kukës në fillim të majit 1999; *shih*, **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014093-SITF00014094. *Shih gjithashtu* konstatimet në Pjesën VI.H.2.

<sup>350</sup> *Shih gjithashtu* konstatimet në Pjesën VI.C.

<sup>351</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100.

<sup>352</sup> *Shih* konstatimet në Pjesët VI.D.2., VI.D.4., VI.D.8.

<sup>353</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100; *shih* para. 423-424, 521 më poshtë.

<sup>354</sup> *Shih* para. 422, 433-436 më poshtë.

njihte z. Kryeziu, konfirmoi se u mor në pyetje prej tij në FMK.<sup>355</sup> Duke mbajtur parasysh provat e shumta të administruara në këtë gjykim që bien ndesh me dëshminë e z. Kryeziu lidhur me përfshirjen e tij në marrjen në pyetje të të ndaluarve në FMK, Trupi Gjykses nuk i jep shumë peshë deklaratës së tij në lidhje me këtë aspekt.

208. Së dyti, përgjithësisht në deklaratat e tij, Trupi Gjykses vëren dëshirën e z. Kryeziu për ta distancuar veten nga *çdo* pretendim që lidhet me praktikën e ndalimit dhe keqtrajtimit në FMK.<sup>356</sup> Është domethënëse se, kur u pyet nëse i kujtohej të kishte dëgjuar për një person që ishte mbajtur dhe qëlluar me armë zjarri në FMK, z. Kryeziu u përgjigj: “nëse diçka e tillë ka ndodhur kjo duhet të ketë ndodhur natën dhe unë nuk isha aty natën”, duke shtuar se natën e kalonte me familjen.<sup>357</sup> Dëshmitari nuk dha asnjë shpjegim të besueshëm se pse përmendi shprehimisht që nuk ishte i pranishëm në FMK gjatë natës. Shembull tjetër është kur pohon, pa ndonjë nevojë dhe pa iu kërkuar, se kurrë nuk keqtrajtoi askënd.<sup>358</sup> Trupi Gjykses gjykon se shembujt e mësipërm vënë në dukje dëshirën e z. Kryeziu për të dhënë versionin e vet të ngjarjeve dhe për t’i paraprirë interpretimit të sjelljes së vet. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses u jep shumë pak peshë këtyre aspekteve të dëshmisë së dëshmitarit.

209. Së fundi, Trupi Gjykses vëren se dy herë në deklaratat e tij, z. Kryeziu u orvat të minimizonte nivelin e organizimit apo strukturën komanduese të UÇK-së në FMK në maj të vitit 1999. Sidoqoftë, ai ra në kundërshtim me veten kur theksoi se: (i) Xhemshit Krasniqi ishte “një nga më të lartët” në FMK;<sup>359</sup>(ii) Bislim Zyrapri ishte

---

<sup>355</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016916; *shih gjithashtu* para. 541 më poshtë.

<sup>356</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100.

<sup>357</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100.

<sup>358</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100.

<sup>359</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014097.

“personi më i rëndësishëm”<sup>360</sup> dhe “shefi i Shtabit të Përgjithshëm”;<sup>361</sup> dhe se (iii) Fatmir Limaj ishte drejtuesi i operacionit *Shigjeta*.<sup>362</sup> Trupi Gjykses gjithashtu vëren se dëshmia e tij bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me provat e shumta dokumentare dhe gojore që iu paraqitën Trupit Gjykses, veçanërisht për rolin e Xhemshit Krasniqit dhe të Sabit Gecit.<sup>363</sup>

210. Aspektet e lartpërmendura të dëshmisë së z. Kryeziu tregojnë një mungesë të fortë dëshire nga ana e tij për t’iu përgjigjur në mënyrë të sinqertë dhe të drejtpërdrejtë pyetjeve në lidhje me përfshirjen e mundshme të tij në krimet e kryera në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Deklaratat e dëshmitarit kishin synimin strategjik për të mbrojtur interesat e tij dhe për të mos dhënë asnjë informacion të dobishëm që mund të implikonte anëtarët e UÇK-së, si Xhemshit Krasniqi apo Sabit Geci, në kryerjen e krimeve në FMK. Ka shumë të ngjarë që ky synim të ketë ndikuar në gatishmërinë e tij të përgjithshme për të dhënë dëshmi me vërtetësi, çka ndikon negativisht në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses i ka trajtuar me kujdes deklaratat e z. Kryeziu dhe është mbështetur vetëm në ato aspekte të dëshmisë së dëshmitarit që konfirmohen nga prova të tjera të administruara në këtë gjykim, sikurse shtjellohet në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

---

<sup>360</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014102.

<sup>361</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014094; *Shih për ngjashmëri*, SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016923.

<sup>362</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014096; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016923.

<sup>363</sup> *Shih* konstatimet në Pjesën VI.C.

G. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I BESUESHMËRISË SË DËSHMITARËVE TË THIRRUR NGA MBROJTËSI I VIKTIMAVE: KARIN DUHNE-PRINSEN DHE SHAJEN LOZANO PARRA (CHAYÉN LOZANO PARRA)

211. Znj. Duhne-Prinsen dhe dr. Lozano Parra dëshmuar para Trupit Gjykses më 21 gusht 2023.<sup>364</sup> Krahas dëshmisë gojore, ato paraqitën një aktekspertizë e cila u pranua si provë në bazë të rregullës 149 të Rregullores.<sup>365</sup>

212. Znj. Duhne-Prinsen është psikologe e specializuar në ekzaminimin e viktimave (të prezumuara) të torturës dhe trajtimit çnjerëzor. Dr. Lozano Parra është psikiatre. Të dy ekspertet punojnë në Institutin Holandez për të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor ("iMMO").<sup>366</sup> Më 2023, ato kryen ekzaminim mjeko-ligjor të TW4-01-shit. Znj. Duhne-Prinsen dhe dr. Lozano Parra dëshmuar për: (i) pasojat tipike (ose të mundshme) psikologjike të ndalimit arbitrar dhe keqtrajtimit; (ii) shëndetin mendor dhe problemet psikologjike të TW4-01-shit; (iii) lidhjen shkakore midis problemeve psikologjike të TW4-01-shit dhe ndalimit dhe keqtrajtimit të tij në FMK më 1999; (iv) [REDAKTUAR]; dhe (v) ndikimin e traumës në kujtesë. Mbrojtja nuk kundërshtoi ekspertizën e tyre.<sup>367</sup> Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë dhe aktekspertiza e tyre janë tërësisht të besueshme dhe të mbështetshme.

---

<sup>364</sup> **Znj. Duhne-Prinsen dhe dr. Lozano Parra:** T. 21 gusht 2023, konfidencial, f. 2248-2342.

<sup>365</sup> **Aktekspertiza:** V4010023-V4010044; Urdhër Gojor: T. 25 tetor 2023, publik, f. 3151, rreshti 9 deri në f. 3153, rreshti 8.

<sup>366</sup> **Biografite:** V4010045-V4010048.

<sup>367</sup> KSC-BC-2020-04, F00578, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes në lidhje me Provat e Dëshmitarëve Ekspertë të Mbrojtësit të Viktimave në zbatim të Urdhrit të Trupit Gjykses të 4 Majit 2023*, 10 korrik 2023, konfidencial, para. 3. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 13 korrik 2023, F00578/RED.

## H. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I BESUESHMËRISË SË DËSHMITARËVE TË MBROJTJES<sup>368</sup>

### 1. DW4-09

213. Deklaratat me shkrim të DW4-09-ës u paraqitën si prova në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 155 të Rregullores (bashkërisht, “deklaratat e DW4-09-ës”)<sup>369</sup> meqenëse dëshmitari kishte ndërruar jetë.<sup>370</sup>

214. DW4-09, shqiptar i Kosovës, ishte [REDAKTUAR].<sup>371</sup>

215. Në deklaratat e tij, DW4-09 dëshmoi për: (i) [REDAKTUAR]; (ii) [REDAKTUAR]; dhe (iii) [REDAKTUAR].

216. Trupi Gjykses vëren se dëshmitari dha dëshmi kryesisht përputhëse dhe në vetvete koherente. Ai bëri dallim të qartë midis asaj që pa vetë dhe asaj që mësoi nga të tjerët. Dëshmia e tij gjithashtu konfirmohet nga dëshmia e TW4-01-shit dhe prova dokumentare që përforcojnë njëra-tjetrën.

217. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se ka disa mospërputhje në deklaratat e DW4-09-ës, por gjithashtu mban parasysh: (i) traumën që përjetoi dëshmitari [REDAKTUAR]; (ii) vështirësinë e përshkrimit të ngjarjeve të dhimbshme në mënyrë të përsëritur, veçanërisht autoriteteve të huaja; (iii) ndikimin e kalimit të kohës në kujtesën e dëshmitarit; dhe (iv) frikën që ai shprehu për dhënien e dëshmisë.<sup>372</sup> Pasi ka shqyrtuar të gjithë faktorët në tërësi, Trupi Gjykses konstaton se mospërputhjet nuk ndikojnë në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit.

---

<sup>368</sup> Trupi Gjykses vendosi të mos bëjë vlerësim të përgjithshëm të besueshmërisë së DW4-01-shit dhe përfundimisht konstatoi se deklaratat me shkrim të tij, të paraqitura si prova në bazë të rregullës 153 të Rregullores, nuk ishin relevante.

<sup>369</sup> DW4-09: SITF00374132-00374148 RED2; SPOE00014640-00014668 RED2.

<sup>370</sup> [Decision on Defence Requests for Admission of Evidence Pursuant to Rule 155](#) (Vendimi mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155), para. 12, 29(a)-(b).

<sup>371</sup> DW4-09: SPOE00014640-00014668 RED2, f. SPOE00014643-SPOE00014644.

<sup>372</sup> DW4-09: SITF00374132-00374148 RED2, f. SITF00374137.

218. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e DW4-09-ës është përgjithësisht e besueshme dhe e mbështetshme, sikurse shtjellohet në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

## 2. W04280

219. W04280 u thirr për të dhënë dëshmi para Trupit Gjykses më 28 dhe 29 nëntor 2023, me masa mbrojtëse.<sup>373</sup> W04280 është shqiptar i Kosovës [REDAKTUAR].<sup>374</sup>

220. Në qershor 1999, dëshmitari ishte anëtar i UÇK-së [REDAKTUAR].<sup>375</sup>

221. W04280 dëshmoi për: (i) anëtarësinë e tij në UÇK; (ii) planimetrinë e kompleksit të FMK-së dhe objektet në FMK, përfshirë infermierinë dhe banjat; dhe (iii) anëtarët e UÇK-së të pranishëm në FMK.<sup>376</sup>

222. Trupi Gjykses vëren se dëshmitari ishte i mjegullt dhe mjaft ngurrues për të dhënë dëshmi relevante në lidhje me z. Shala dhe akuzat në këtë çështje gjyqësore: ai pretendoi se nuk e njohte dhe nuk e kishte takuar z. Shala apo ndonjë person me nofkën Ujku gjatë asaj periudhe.<sup>377</sup> Gjithashtu, ishte e dukshme për Trupin Gjykses se dëshmitari nuk ishte i gatshëm të jepte informacion apo hollësi domethënëse në lidhje me FMK-në, objektet në FMK dhe si funksiononte FMK-ja. Kur palët i treguan prova për identifikimin e FMK-së (skica ose fotografi), dëshmitari thjesht u përgjigj se nuk e

---

<sup>373</sup> [Decision on Defence Request to Summons Witnesses](#) (Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Thirrjen e Dëshmitarëve), para. 16, 21(b); **W04280**: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3738-3828; T. 29 nëntor 2023, konfidencial, f. 3833-3870; *shih gjithashtu* Urdhrin Gojor: T. 27 nëntor 2023, konfidencial, f. 3721, rreshtat 8-17; T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3732, rreshti 2 deri në f. 3733, rreshti 6.

<sup>374</sup> **W04280**: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3807, rreshtat 13-22, f. 3808, rreshtat 1-5.

<sup>375</sup> **W4280**: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3750, rreshti 20 deri në f. 3751, rreshti 6; f. 3769, rreshtat 14-18.

<sup>376</sup> **W4280**: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3780, rreshti 25 deri në f. 3781, rreshti 21; f. 3824, rreshti 18 deri në f. 3825, rreshti 4; T. 29 nëntor 2023, publik, f. 3843, rreshtat 1-2.

<sup>377</sup> **W4280**: T. 28 nëntor 2023, publik, f. 3778, rreshti 20 deri në f. 3779, rreshti 2.



njihte ose nuk i kujtohej.<sup>378</sup> Në reagim ndaj kësaj praktike të dhënies së përgjigjeve të mjegullta, Kryegjykatësja i kujtoi dëshmitarit betimin dhe se nuk duhej të mbante të fshehtë informacionin për të cilin kishte dijeni.<sup>379</sup> Në këtë kontekst, dëshmia e tij qartë nuk përputhej me atë që Trupi Gjykses priste nga një dëshmitar me pozitë të tillë në FMK.

223. Po ashtu, ai mohoi menjëherë dhe në mënyrë të prerë se kishte njohuri për persona që ishin mbajtur të ndaluar, marrë në pyetje, kryer punë krahu, apo që kishin vdekur në FMK.<sup>380</sup> Kur u ballafaqua nga të dy palët me argumentin se ka prova që tregojnë se ai kishte njohuri për kushtet e ndalimit, [REDAKTUAR],<sup>381</sup> W04280 vazhdoi të mohonte se kishte njohuri dhe përgjigjej me “jo” dhe “nuk më kujtohet, nuk e di”.<sup>382</sup> Dëshmitari megjithatë konfirmoi se në atë kohë në FMK nuk kishte asnjë person tjetër me emrin e njëjtë si i tij.<sup>383</sup> E njëjta vlen edhe për një numër aspektesh të tjera që lidhen me anëtarësinë dhe rolin e W04280-s në UÇK dhe njohuritë për, ose kontaktet e tij me, anëtarë të tjerë të UÇK-së në FMK, si Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi: dëshmitari vazhdoi të ishte i paqartë, i mjegullt dhe t'i ikte dhënies së përgjigjes. Ai në mënyrë të përsëritur dhe në vazhdimësi përgjigjej se nuk i kujtohej,<sup>384</sup> edhe kur i freskohej kujtesa me deklaratat që kishte dhënë më parë.<sup>385</sup>

---

<sup>378</sup> *Shih, për shembull, W4280*: T. 28 nëntor 2023, publik, f. 3775, rreshti 19 deri në f. 3776, rreshti 10; T. 29 nëntor 2023, konfidencial, f. 3843, rreshtat 8-15; f. 3844, rreshtat 13-15.

<sup>379</sup> *W4280*: T. 29 nëntor 2023, publik, f. 3842, rreshtat 14-19.

<sup>380</sup> *W4280*: T. 28 nëntor 2023, publik, f. 3787, rreshtat 20-23.

<sup>381</sup> [REDAKTUAR].

<sup>382</sup> *W4280*: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3785, rreshtat 4-9; T. 29 nëntor 2023, konfidencial, f. 3846, rreshtat 1-23.

<sup>383</sup> *W4280*: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3824, rreshtat 14-17.

<sup>384</sup> *Shih, për shembull, W4280*: T. 28 nëntor 2023, konfidencial; f. 3776, rreshti 15 deri në f. 3777, rreshti 19; f. 3780, rreshtat 5-8, 22-24; f. 3781, rreshtat 2-22; f. 3824, rreshti 18 deri në f. 3825, rreshti 4; T. 29 nëntor 2023, konfidencial, f. 3837, rreshtat 13-16; f. 3840, rreshtat 11-23.

<sup>385</sup> *Shih, për shembull, W4280*: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3810, rreshti 17 deri në f. 3813, rreshti 6; f. 3819, rreshti 21 deri në f. 3820, rreshti 25; f. 3822, rreshtat 8-25; T. 29 nëntor 2023, konfidencial, f. 3840, rreshtat 11-23.

224. Trupi Gjykses vëren te dëshmitari një mosinteresim të përgjithshëm, mungesë të fortë dëshire dhe ngurrim të hapur për të dhënë informacion të dobishëm në lidhje me krimet e kryera në FMK gjatë asaj kohe dhe një tendencë sistematike për të minimizuar ose mohuar sa më shumë kujtesën për ngjarjet dhe personat. Trupi Gjykses veçse mund të konstatojë se faktikisht, dëshmitari vendosi qëllimisht të përgjigjej me “nuk më kujtohet” sa herë që mundi, pavarësisht nga përmbajtja e pyetjes, aspektet në diskutim, apo kush i bënte pyetjet. Për më tepër, duke mbajtur parasysh sjelljen e tij në gjykatë, arsyetimi i përsëritur se nuk është mirë me shëndet<sup>386</sup> apo se ka kaluar shumë kohë<sup>387</sup> dukej se ishte vetëm pretekst, meqenëse ai nuk bëri asnjë përpjekje të njëmendtë për t’iu përgjigjur pyetjeve.

225. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e ka trajtuar me kujdes dëshminë e dëshmitarit dhe është mbështetur në të në masë shumë të kufizuar, aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

### 3. Andre De Viliers Horne (André De Villiers Horne - DW4-03)

226. Andre De Viliers Horne (z. De Viliers Horne) dëshmoi para Trupit Gjykses më 27 nëntor 2023.<sup>388</sup> Krahas dëshmisë gojore, ai paraqiti edhe një aktekspertizë, e cila u pranua si provë në bazë të rregullës 149 të Rregullores.<sup>389</sup>

---

<sup>386</sup> **W4280:** T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3740, rreshtat 11-13 (“ Gjendja ime shëndetësore është mjaft e keqësuar, e posaçërisht sot. Brenda mundësive, [...] ta merrni parasysh deklaratën time të fundit”), 18-22 (“që unë të jem [...], që deklarata ime, e fundit që e kam dhanë të jetë baza edhe bazohem në të.”); f. 3752, rreshtat 2-3.

<sup>387</sup> **W4280:** T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3751, rreshti 25 deri në f. 3752, rreshti 1; f. 3754, rreshtat 3-5; f. 3822, rreshtat 23-25; T. 28 nëntor 2023, publik, f. 3775, rreshti 6; T. 29 nëntor 2023, konfidencial, f. 3837, rreshtat 16-17; f. 3844, rreshtat 15-16; f. 3865, rreshtat 8-9.

<sup>388</sup> **Z. De Viliers Horne:** T. 27 nëntor 2023, konfidencial, f. 3628-3727.

<sup>389</sup> **Aktekspertiza:** DPS00864-DPS00875; Vendim mbi Pranimin e Aktekspertizës së Mbrojtjes, para. 41-42, 56.

227. Z. De Viliers Horne është ekspert kriminalistik për armë zjarri.<sup>390</sup> Ai dëshmoi lidhur me dy incidente të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar: (i) [REDAKTUAR]; dhe (ii) qëllimi i [REDAKTUAR] viktimës së vrasjes së paligjshme me armë zjarri më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date (“incidenti i qëllimit me armë zjarri në këmbë”).<sup>391</sup> Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e ekspertit dhe aktekspertiza e tij janë plotësisht të besueshme dhe të mbështetshme.

#### 4. Bedri Dervishaj (DW4-02)

228. Bedri Dervishaj (z. Dervishaj) dëshmoi para Trupit Gjykses më 2 tetor 2023, pa masa mbrojtëse.<sup>392</sup>

229. Z. Dervishaj iu bashkua UÇK-së në shkurt 1999 dhe ishte ushtar i thjeshtë i Brigadës 128.<sup>393</sup> Dëshmitari dëshmoi për: (i) vendndodhjen dhe rolin e tij gjatë luftës; (ii) ekzistencën e dy bazave të UÇK-së në Kukës; dhe (iii) infermierinë në FMK.

230. Trupi Gjykses vë në dukje se z. Dervishaj dha informacion të hollësishëm dhe përgjithësisht koherent në lidhje me përfshirjen e tij në UÇK, edhe pse pretendoi se vuan pasojat e përvojave traumatike nga lufta. Informacioni në veçanti ka të bëjë me anëtarësimin e tij në UÇK, stërvitjen në Burrel (Shqipëri), lëvizjet e grupit të tij të UÇK-së, themelimin e Brigadës 128, bazën e dytë të UÇK-së në Kukës (të cilën dëshmitari e quajti “reparti 1”), dhe infermierinë në FMK. Është me rëndësi se, kur nuk i kujtoheshin datat e sakta, ai bënte krahasime me ngjarje ose periudha të përafërta (*p.sh.* qëndrimi i tij në Kalimash dhe në vijën e frontit). Trupi Gjykses vëren se, megjithëse shumica e këtyre pretendimeve faktike janë jashtë kuadrit kohor të

---

<sup>390</sup> Aktekspertiza: DPS00864-DPS00875, f. DPS00865, që përmban biografinë e tij.

<sup>391</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 22-23, 28.

<sup>392</sup> Z. Dervishaj: T. 2 tetor 2023, konfidencial, f. 2734-2804.

<sup>393</sup> Z. Dervishaj: T. 2 tetor 2023, publik, f. 2735, rreshti 25 deri në f. 2737, rreshti 10; f. 2738, rreshti 24 deri në f. 2739, rreshti 2; f. 2753, rreshtat 12-25; f. 2773, rreshtat 11-25.

akuzave, dëshmia përputhet me dëshmi të tjera të mbështetshme të dhëna në këtë gjykim.

231. Sidoqoftë, Trupi Gjykes vëren se dëshmitari nuk dha dëshmi relevante për akuzat: ai tha se nuk e njihnte dhe se nuk e kishte takuar z. Shala gjatë asaj kohe dhe, me përjashtim të infermierisë, nuk ishte në gjendje të jepte informacion tjetër lidhur me FMK-në.

232. Trupi Gjykes gjithashtu vëren se z. Dervishaj ka lidhje të ngushta me UÇK-në edhe sot e kësaj dite. Më konkretisht, kur ZPS-ja e ballafaqoi me dy postime në *Facebook* që kishin bërë dy të njohur të tij – të cilët shprehnin mbështetjen e tyre të fuqishme për dëshminë e z. Dervishaj para Dhomave të Specializuara dhe respektin për kontributin e tij në luftë si anëtar i UÇK-së<sup>394</sup> – z. Dervishaj filloi të jepte përgjigje të mjegullta, si duket në përpjekje për të zhvendosur vëmendjen nga lidhjet e tij me ish-anëtarë të tjerë të UÇK-së. Ai iu përgjigj pyetjes vetëm pasi iu bë për të tretën herë, pas ndërhyrjes së Kryegjykatëses.<sup>395</sup> Z. Dervishaj gjithashtu pranoi se ishte takuar dhe kishte folur për dëshminë që do të jepte para Dhomave të Specializuara me Naser Koçinajn (z. Koçinaj) – me të cilin ka lidhje familjare dhe shoqërore – pak para dhënies së dëshmisë, sikurse konfirmoi edhe vetë z. Koçinaj.

233. Në bazë të sa më lart, Trupi Gjykes vëren mungesë të fortë dëshire nga ana e dëshmitarit për të dhënë informacion të dobishëm në lidhje me z. Shala dhe akuzat nën shqyrtim. Përmbajtja e përgjigjeve të z. Dervishaj dhe mënyra si ato u dhanë

---

<sup>394</sup> **Z. Dervishaj:** T. 2 tetor 2023, publik, f. 2794, rreshtat 1-3; f. 2795, rreshti 24 deri në f. 2796, rreshti 19 (në postimin e z. Faruk Hoxha në *Facebook* thuhej: “Shoku Bedri Dervishaj udhëton për në Gjykatën Speciale të Hagës. Ne shpresojmë me bindje të plotë në pafajësinë tande, Bedri. Të kthehesh ma i fortë dhe faqebardhë. Lufta e UÇK-së është themeli i lirisë dhe e ardhmja e Kosovës. Respekt, shok, si gjithmonë i pathyer”; *shih* SPOE00341624-SPOE00341624-ET); f. 2797, rreshti 13 deri në f. 2798, rreshti 1; f. 2799, rreshti 12 deri në f. 2800, rreshti 12 (në postimin e z. Hamit Bytyqi në *Facebook* thuhej: ““Qofsh faqe bardh qlirimtar ashtu siq ke qen ne luft ashtu edhe ne liri u kthefsh me koken lart prej hage Bedri dervishaj”; *shih* SPOE00341629-SPOE00341629-ET).

<sup>395</sup> **Z. Dervishaj:** T. 2 tetor 2023, publik, f. 2796, rreshti 20 deri në f. 2797, rreshti 12.

tregojnë se dëshmia e tij kishte synimin strategjik për të mbrojtur interesat e tij dhe të z. Shala dhe për të mos dhënë informacion që do të mund të bënte lidhjen midis anëtarëve të UÇK-së dhe kryerjes së krimeve.

234. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e ka shqyrtuar me kujdes dëshminë e dëshmitarit dhe është mbështetur në të aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

## 5. [REDAKTUAR] (W03881)

235. Deklaratat e [REDAKTUAR] u pranuan si prova në bazë të rregullës 153 të Rregullores.<sup>396</sup>

236. [REDAKTUAR].<sup>397</sup> [REDAKTUAR].<sup>398</sup>

237. Deklaratat e dëshmitarit kanë të bëjnë, ndër të tjera, me [REDAKTUAR].<sup>399</sup>

238. Trupi Gjykses konstaton se deklaratat e dëshmitarit janë përgjithësisht të besueshme dhe mbështetëse sa u përket ngjarjeve [REDAKTUAR], pasi ai ishte dëshmitar okular i atyre ngjarjeve dhe mbajti ditar me shënime dhe fotografi, ndër të tjera edhe për atë ditë.<sup>400</sup> Në ditarin dhe deklaratat e tij, [REDAKTUAR] përshkroi në mënyrë koherente dhe metodike [REDAKTUAR]: (i) [REDAKTUAR]; dhe se (ii) [REDAKTUAR].<sup>401</sup> Në lidhje me këto dy pika, Trupi Gjykses konstaton se [REDAKTUAR] është në vetvete përputhëse dhe përgjithësisht konfirmohet nga

---

<sup>396</sup> [Decision on Defence Request for Admission of Evidence Pursuant to Rule 153](#), (Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153), para. 23(a)-(b).

<sup>397</sup> [REDAKTUAR].

<sup>398</sup> [REDAKTUAR].

<sup>399</sup> DPS00125-DPS00141, f. DPS00125; 071142-071313-ET Revised 1 RED (E rishikuar 1 RED), f. 071180-071182; 071107-071127-ET RED, f. 071110.

<sup>400</sup> 071142-071313-ET Revised 1 RED (E rishikuar 1 RED), f. 071180.

<sup>401</sup> 071142-071313-ET Revised 1 RED (E rishikuar 1 RED), f. 071182; *shih për ngjashmëri*, 071136-TR-ET Part 2 RED (Pjesa 2 RED), f. 11-12, 16-17.

dëshmia e TW4-01-shit.<sup>402</sup> [REDAKTUAR] konfirmohet gjithashtu edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, përkatësisht të W01448-ës, TW4-05-ës dhe TW4-04-ës, [REDAKTUAR].<sup>403</sup>

239. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses është mbështetur në dëshminë e W03881-shit, sikurse shtjellohet në analizën e provave.

## 6. Safet Gashi (W04405)

240. Safet Gashi (z. Gashi) u thirr për të dëshmuar para Trupit Gjykses më 9-10 janar 2024, pa masa mbrojtëse.<sup>404</sup>

241. Z. Gashi është qytetar shqiptar i Kosovës. Ai iu bashkua UÇK-së në mars 1999 dhe, sipas dëshmisë së tij, ishte anëtar i Brigadës 128.<sup>405</sup>

242. Gjatë dëshmisë, z. Gashi ishte kundërthënës, i mjegullt, i paqartë dhe jo i sigurtë.<sup>406</sup> Dëshmitari mezi i pranoi disa detaje, vetëm pas ballafaqimit me deklaratat e mëparshme dhënë ZPS-së. Megjithëse pyetjet që iu bënë ishin objektivisht të qarta dhe të kuptueshme, ndonjëherë kërkonte t'i përsëriteshin (siç duket, në një përpjekje për të fituar kohë), ose pretendonte se nuk ishin të qarta, për të justifikuar kundërthëniet në dëshminë e tij.<sup>407</sup>

243. Trupi Gjykses vëren se dëshmia e z. Gashi nuk përputhej me deklaratat e tij të mëparshme në disa aspekte, ndër të cilat roli i tij në UÇK, vendndodhja e tij dhe prania

<sup>402</sup> [REDAKTUAR].

<sup>403</sup> [REDAKTUAR].

<sup>404</sup> [Decision on Defence Request to Summons Witnesses](#) (Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Thirrjen e Dëshmitarëve), para. 16, 21(b); **z. Gashi**: T. 9 janar 2024, konfidencial, f. 3896-3998; T. 10 janar 2024, konfidencial, f. 4003-4067.

<sup>405</sup> **Z. Gashi**: T. 9 janar 2024, publik, f. 3896, rreshtat 15-20; f. 3899, rreshti 5 deri në f. 3900, rreshti 9; f. 3906, rreshtat 13-15; f. 3907, rreshtat 9-12; T. 10 janar 2024, publik, f. 4006, rreshtat 4-8.

<sup>406</sup> *Shih, në veçanti, z. Gashi*: T. 10 janar 2024, konfidencial, f. 4030, rreshti 14 deri në f. 4034, rreshti 11; f. 4049, rreshti 11 deri në f. 4060, rreshti 2; f. 4062, rreshti 1 deri në f. 4066, rreshti 14.

<sup>407</sup> **Z. Gashi**: T. 9 janar 2024, publik, f. 3903, rreshtat 4-7; T. 10 janar 2024, publik, f. 4009, rreshtat 3-16.

në FMK. Në veçanti, gjatë gjithë dëshmisë, si edhe në deklaratat e tij të mëparshme, dëshmitari pretendoi ose se qëndroi në Kukës për një kohë të kufizuar,<sup>408</sup> ose se nuk kishte qenë asnjëherë atje dhe “nuk kam shkelë [...] në tokë shqiptare”.<sup>409</sup> Në lidhje me FMK-në, dëshmitari pohoi se “s’kam pasur punë me magazinë apo çfarë përshkruani ju këtu”,<sup>410</sup> që tregon qartë se kishte dijeni për FMK-në. Për më tepër, dëshmitari ishte mospërputhës (lidhur me këtë aspekt dhe aspekte të tjera) jo vetëm me deklaratën e vet të mëparshme, por edhe gjatë gjithë dëshmisë së vet, të cilën e ndryshoi vazhdimisht gjatë pyetjeve të palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave. Kur u ballafaqua me këto mospërputhje, ai ose përshtati dëshminë, ose i mohoi mospërputhjet.<sup>411</sup> Dëshmitari nuk dha asnjë shpjegim bindës ose të besueshëm për mospërputhjet<sup>412</sup> dhe Kryegjykatëses iu desh t’ia rikujtonte disa herë betimin për të thënë të vërtetën.<sup>413</sup> Çka është e rëndësishme, Trupi Gjykses vëren se dëshmia e z. Gashi qartë bie ndesh me dëshmi të tjera të besueshme që iu paraqitën Trupit Gjykses, të cilat vërtetojnë, për shembull, se ai ishte në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat dhe se e dinte se atje mbaheshin persona të ndaluar ([REDAKTUAR]).<sup>414</sup>

<sup>408</sup> **Z. Gashi:** T. 9 janar 2024, publik, f. 3901, rreshtat 5-11 (ku thotë se iu bashku UÇK-së në Kukës dhe më pas u dërgua në Kolsh apo Kalimash); f. 3911, rreshti 16 deri në f. 3912, rreshti 2 (ku thotë se shkoi në Kukës për të marrë armë, por nuk qëndroi atje); f. 3956, rreshti 8 deri në f. 3958, rreshti 17.

<sup>409</sup> **Z. Gashi:** T. 9 janar 2024, publik, f. 3901, rreshti 12 deri në f. 3903, rreshti 3, *i referohet* deklaratës së mëparshme: 063317-TR-ET PART 1 RED2 (Pjesa 1 RED2), f. 8, rreshtat 8-14 (ku thotë se iu bashkua UÇK-së në Gorozhup, Kosovë); f. 3912, rreshti 16 deri në f. 3913, rreshti 25, *që i referohet* deklaratës së mëparshme: 063317-TR-ET PART 2 RED2 (Pjesa 2 RED2), f. 13, rreshtat 3-8; f. 14, rreshtat 6-13 (ku thotë se kurrë nuk kishte qenë në Kukës); T. 10 janar 2024, publik, f. 4010, rreshti 19 deri në f. 4011, rreshti 6, *i referohet* deklaratës së mëparshme: 063317-TR-ET PART 2 RED2 (Pjesa 2 RED2), f. 10, rreshtat 11-15 (ku thotë. “Kurrë nuk kam shkelë me këto dy këmbë në tokë shqiptare.”

<sup>410</sup> **Z. Gashi:** T. 10 janar 2024, konfidencial, f. 4040, rreshtat 14-16; f. 4064-4066.

<sup>411</sup> **Z. Gashi:** T. 9 janar 2024, publik, f. 3905, rreshti 16 deri në f. 3906, rreshti 5 (ku ndryshon dëshminë dhe thotë se UÇK-së iu bashkua në Gorozhup dhe jo në Kukës); f. 3913, rreshti 15 deri në f. 3914, rreshti 1; T. 9 janar 2024, konfidencial, f. 3932, rreshti 14 deri në f. 3937, rreshti 19; T. 10 janar 2024, publik, f. 4003, rreshti 23 deri në f. 4013, rreshti 3; f. 4019, rreshti 21 deri në f. 4021, rreshti 24.

<sup>412</sup> *Shih, për shembull, z. Gashi:* T. 10 janar 2024, publik, f. 4015, rreshti 20 deri në f. 4018, rreshti 20.

<sup>413</sup> **Z. Gashi:** T. 10 janar 2024, publik, f. 4005, rreshtat 20-22; f. 4013, rreshtat 13-25.

<sup>414</sup> [REDAKTUAR].

244. Aspektet e lartpërmendura të dëshmisë së z. Gashi vënë në dukje mungesën shumë të fortë të dëshirës nga ana e dëshmitarit për të dhënë informacion të dobishëm në lidhje me akuzat nën shqyrtim. Trupi Gjykses gjykon se përmbajtja e përgjigjeve të z. Gashi dhe mënyra si ato u dhanë, tregojnë qartë se ai u përpoq të mohonte çdo lidhje të mundshme të tij me FMK-në për ta distancuar veten nga pretendimet në lidhje me praktikën e ndalimit atje. Kjo zvogëlon ndjeshëm besueshmërinë që ndryshe mund të kishte pasur dëshmia e tij. Për pasojë, Trupi Gjykses konstaton se nuk do të mbështetet aspak në dëshminë e z. Gashi.

## 7. Safete Hadërgjonaj (W04441)

245. Safete Hadërgjonaj (znj. Hadërgjonaj) u thirr për të dëshmuar para këtij Trupi Gjykses më 22 dhe 23 nëntor 2023, pa masa mbrojtëse.<sup>415</sup>

246. Znj. Hadërgjonaj është qytetare shqiptare e Kosovës. Ajo është me profesion ekonomiste.<sup>416</sup>

247. Trupi Gjykses vë në dukje se znj. Hadërgjonaj haptas kundërshtoi dhe ngurroi të jepte informacion të dobishëm në lidhje me akuzat dhe z. Shala. Përgjigjet e saj u përshkuan nga ekzagjerime dhe ishin plot me pretendime konspiracioni.<sup>417</sup> Dëshmitarja nuk fshehu qëndrimin e vet tejet të njëanshëm kundër Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, që i cilësoi si “qesharake”,<sup>418</sup> as përkrahjen e pakursyer për

---

<sup>415</sup> [Decision on Defence Request to Summons Witnesses](#) (Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Thirrjen e Dëshmitarëve), para. 16, 21(b); **znj. Hadërgjonaj**: T. 22 nëntor 2023, konfidencial, f. 3477-3517; T. 23 nëntor 2023, publik, f. 3524-3539.

<sup>416</sup> **Znj. Hadërgjonaj**: T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3486, rreshtat 6-10.

<sup>417</sup> **Znj. Hadërgjonaj**: T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3486, rreshtat 6-14; f. 3507, rreshti 15 deri në f. 3508, rreshti 19; f. 3515, rreshtat 8-12; T. 23 nëntor 2023, publik, f. 3525, rreshti 4 deri në f. 3526, rreshti 9.

<sup>418</sup> **Znj. Hadërgjonaj**: T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3512, rreshtat 1-7.



UÇK-në,<sup>419</sup> përfshirë z. Shala, edhe pse pretendoi se nuk e kishte njohur para arrestimit dhe transferimit të tij në Dhomat e Specializuara dhe se nuk ishte njohur me akuzat kundër tij.<sup>420</sup> Përmbajtja e përgjigjeve të znj. Hadërgjonaj dhe mënyra si ato u dhanë, tregojnë se dëshmia e saj kishte synimin strategjik për të mbrojtur interesat e veta dhe ato të z. Shala.

248. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk mund të mbështetet aspak në dëshminë e znj. Hadërgjonaj.

## 8. Zijadin Hoxha (W03887)

249. Zijadin Hoxha (z. Hoxha) dëshmoi para Trupit Gjykses nga 20 nëntori deri më 22 nëntor 2023,<sup>421</sup> pa masa mbrojtëse.

250. Z. Hoxha është qytetar shqiptar i Kosovës.<sup>422</sup> Ai iu bashkua UÇK-së në pranverë të vitit 1999. Gjatë periudhës që lidhet me akuzat, ai e kishte bazën në FMK ku riparonte armë.<sup>423</sup>

251. Z. Hoxha dëshmoi në lidhje me: (i) përdorimin e FMK-së në atë kohë; (ii) planimetrinë e FMK-së dhe përdorimin e ndërtesave të ndryshme nga UÇK-ja; (iii) rolin e tij në FMK dhe vendndodhjen; (iv) praninë e disa anëtarëve të caktuar të UÇK-së në FMK dhe/ose njohuritë e tij për ta; (v) betejën e Gorozhupit dhe humbjet që pësoi UÇK-ja atje; dhe (vi) disa videoincizime që i kishte bërë në FMK dhe gjetiu.

---

<sup>419</sup> **Znj. Hadërgjonaj:** T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3484, rreshtat 13-15: "Për fat të keq nuk e kam pasë atë fat me qenë ushtar e UÇK-së dhe me mbajtë krenarinë e të qenit ushtar e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës."

<sup>420</sup> **Znj. Hadërgjonaj:** T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3489, rreshti 23 deri në f. 3490, rreshti 9; f. 3512, rreshti 25 deri në f. 3513, rreshti 5.

<sup>421</sup> **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, konfidencial, f. 3171-3282; T. 21 nëntor 2023, konfidencial, f. 3288-3405; T. 22 nëntor 2023, konfidencial, f. 3417-3463.

<sup>422</sup> **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3172, rreshti 4.

<sup>423</sup> **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3172, rreshti 23 deri në f. 3175, rreshti 15; T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3317, rreshti 9 deri në f. 3319, rreshti 18.

252. Trupi Gjykses vëren se z. Hoxha dha informacion të hollësishëm dhe përgjithësisht koherent për rolin e tij, funksionimin dhe planimetrinë e FMK-së, përdorimin e ndërtesave të ndryshme (ndër të tjera për praninë e një infermierie dhe personelit mjekësor), kushtet e jetesës dhe të fjetjes, dhe humbjet që pësoi UÇK-ja në betejën e Gorozhupit dhe ngjarjet që lidhen me të. Konkretisht, dëshmia e tij për këto aspekte është përgjithësisht përputhëse me dëshmi të tjera të mbështetshme, të administruara në këtë gjykim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se z. Hoxha i përshkroi me vërtetësi ngjarjet që përjetoj vetë.

253. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren mungesën e dukshme të dëshirës dhe/ose druajtjen e dëshmitarit për të dhënë dëshmi për disa aspekte kyçe në lidhje me akuzat. Për shembull, dëshmitari mohoi se kishte parë ndonjë ndërtesë në mes të oborrit të FMK-së ku mbaheshin të ndaluarit, apo se e dinte ku ndodheshin banjat në FMK.<sup>424</sup> Sikurse shtjellohet me hollësi në analizën e provave, duke mbajtur parasysh prova të tjera të besueshme, të administruara në këtë gjykim, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitari nuk dëshmoi me vërtetësi për këtë aspekt.<sup>425</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren mospërputhje midis dëshmisë gojore të dëshmitarit dhe deklaratave të mëparshme të tij. <sup>426</sup> Z. Hoxha nuk dha asnjë shpjegim të besueshëm për mospërputhjet për të cilat u pyet. Faktikisht, ai ose ndryshoi dëshminë, ose këmbënguli se nuk kishte mospërputhje. Sjellja e z. Hoxha – të cilit Kryegjykatësja u desh t'ia kujtonte betimin për të thënë të vërtetën<sup>427</sup> – tregon qartë se ai donte ta distanconte veten nga çdo pretendim që lidhej me praktikat e ndalimit në FMK. Këto aspekte të dëshmisë së z. Hoxha vënë në dukje një mungesë shumë të fortë dëshire nga ana e tij për të dhënë informacion të dobishëm në lidhje me akuzat nën shqyrtim.

---

<sup>424</sup> *Shih* para. 313, 323 më poshtë.

<sup>425</sup> *Shih* para. 315, 324 më poshtë.

<sup>426</sup> **Z. Hoxha:** T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3317, rreshti 9 deri në f. 3319, rreshti 18; f. 3401, rreshti 18 deri në f. 3403, rreshti 5; T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3437, rreshti 25 deri në f. 3439, rreshti 22.

<sup>427</sup> **Z. Hoxha:** T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3377, rreshtat 12-15.

Në të vërtetë, dëshmitari kishte synimin strategjik që me dëshminë e vet t'i mbronte interesat e tij dhe të z. Shala dhe të mos jepte informacion që do të mund të bënte lidhjen midis anëtarëve të UÇK-së në FMK dhe kryerjes së krimeve. Ka shumë të ngjarë që ky synim të ketë ndikuar përgjithësisht në gatishmërinë e tij për t'iu përgjigjur me vërtetësi pyetjeve në lidhje me praktikën e ndalimit në FMK, z. Shala dhe veprimet e anëtarëve të tjerë të UÇK-së.

254. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjyqësor e ka shqyrtuar me kujdes dëshminë e z. Hoxha dhe është mbështetur në të aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

## 9. Time Kadrijaj (W04440)

255. Time Kadrijaj (znj. Kadrijaj) u thirr për të dëshmuar para Trupit Gjyqësor më 23 dhe 24 nëntor 2023, pa masa mbrojtëse.<sup>428</sup>

256. Znj. Kadrijaj është qytetare shqiptare e Kosovës. Ajo u anëtarësua në UÇK në mars/prill 1998 si mjeke.<sup>429</sup>

257. Trupi Gjyqësor vëren qëndrimin dukshëm bishtnues të dëshmitares kur iu përgjigj pyetjeve, veçanërisht kur ZPS-ja e ballafaqoi me prova që binin ndesh me dëshminë e saj.<sup>430</sup> Trupi Gjyqësor gjithashtu vëren mospërputhje të mëdha midis dëshmisë që dha znj. Kadrijaj dhe dëshmime të tjera të mbështetshme që iu paraqitën Trupit Gjyqësor (përfshirë të dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes) në lidhje me praninë e

---

<sup>428</sup> [Decision on Defence Request to Summons Witnesses](#) (Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Thirrjen e Dëshmitarëve) para. 16, 21(b); **Znj. Kadrijaj**: T. 23 nëntor 2023, konfidencial, f. 3549-3610; T. 24 nëntor 2023, publik, f. 3616-3624.

<sup>429</sup> **Znj. Kadrijaj**: T. 23 nëntor 2023, publik, f. 3551, rreshtat 5-17.

<sup>430</sup> **Znj. Kadrijaj**: T. 23 nëntor 2023, publik, f. 3581, rreshti 3 deri në f. 3582, rreshti 9; T. 23 nëntor 2023, konfidencial, f. 3591, rreshti 5 deri në f. 3593, rreshti 3; T. 24 nëntor 2023, publik, f. 3621, rreshtat 5-19.

saj në FMK,<sup>431</sup> që ajo e mohoi kategorikisht. Trupi Gjykses vëren përkrahjen e pakusht të znj. Kadrijaj për UÇK-në dhe njëanshmërinë e shprehur kundër Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së.<sup>432</sup> Është e qartë se znj. Kadrijaj u përpoq të mohonte çfarëdo lidhje të mundshme të saj me FMK-në dhe praktikën e ndalimit aty.

258. Aspektet e lartpërmendura të dëshmisë së dëshmitares vënë në dukje mungesën e fortë të dëshirës nga ana e saj për të dhënë informacion të dobishëm në lidhje me z. Shala dhe akuzat nën shqyrtim. Trupi Gjykses konstaton se përmbajtja e përgjigjeve të znj. Kadrijaj dhe mënyra si ato u dhanë tregojnë se dëshmia e saj kishte synimin strategjik që të mbronte interesat e saj dhe të z. Shala që zvogëlon ndjeshëm besueshmërinë që mund të kishte pasur dëshmia e saj.

259. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk mund të mbështetet aspak në dëshminë e znj. Kadrijaj.

#### 10. Naser Koçinaj (DW4-05)

260. Z. Koçinaj dëshmoi para Trupit Gjykses më 3 tetor 2023, pa masa mbrojtëse.<sup>433</sup>

261. Z. Koçinaj iu bashkua UÇK-së në vitin 1998<sup>434</sup> dhe gjatë periudhës që lidhet me akuzat e kishte bazën në FMK, ku punonte në logjistikë në një magazinë në FMK.<sup>435</sup> Ai ishte përgjegjës për shpërndarjen e uniformave luftëtarëve të UÇK-së.<sup>436</sup>

---

<sup>431</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2937, rreshti 11 deri në f. 2942, rreshti 23; **W4733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 29, rreshti 15 deri në f. 32, rreshti 15; 082892-TR-AT-ET Part 5 (Pjesa 5), f. 15, rreshtat 4-13; f. 27, rreshti 8 deri në f. 28, rreshti 24; 082892-TR-AT-ET Part 8 (Pjesa 8), f. 7, rreshtat 1-18.

<sup>432</sup> **Znj. Kadrijaj:** T. 23 nëntor 2023, konfidencial, f. 3607, rreshtat 11-14 (dëshmitarja deklaroi se ishte "shumë krenare" që mori pjesë në luftë si mjeke e UÇK-së); T. 24 nëntor 2023, publik, f. 3616, rreshti 24 deri në f. 3622, rreshti 4 (dëshmitarja deklaroi se akuzat kundër anëtarëve të lartë të UÇK-së para Dhomave të Specializuara janë "padrejtësi", sepse bazohen në fakte të trilluara.

<sup>433</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, konfidencial, f. 2813-2903.

<sup>434</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2814, rreshti 8 deri në f. 2815, rreshti 6.

<sup>435</sup> *Shih* para. 886 më poshtë; **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2816, rreshtat 5-7; f. 2817, rreshtat 19-22.

<sup>436</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2816, rreshtat 8-10; f. 2817, rreshtat 19-22; f. 2825, rreshtat 9-13.

262. Dëshmitari dëshmoi për: (i) funksionin e magazinës së FMK-së ku punonte dhe rolin e tij aty; (ii) planimetrinë e kompleksit të FMK-së; (iii) praninë (ose mospraninë) e anëtarëve të tjerë të UÇK-së dhe të të ndaluarve në FMK; dhe (iv) Brigadën 128.

263. Trupi Gjykes vë në duke se z. Koçinaj dha informacion të hollësishëm dhe përgjithësisht koherent për periudhën dhe rolin e tij në UÇK (veçanërisht për detyrën e shpërndarjes së uniformave anëtarëve të UÇK-së dhe themelimin e Brigadës 128), ekzistencën dhe vendndodhjen e magazinës ku punonte dhe hyrjen e FMK-së, dhe për praninë e një mjeku, sikurse konfirmohet nga prova të tjera të administruara në këtë gjykim.

264. Megjithatë, Trupi Gjykes vëren mungesën e dukshme të dëshirës dhe/ose hezitimin e dëshmitarit për të dhënë dëshmi për disa aspekte kyçe. Për shembull, edhe pse konfirmoi ekzistencën e magazinës dhe praninë e tij aty, dëshmitari nuk ishte në gjendje të identifikonte asnjë nga ndërtesat e tjera në kompleksin e FMK-së, duke theksuar në mënyrë të përsëritur se kishte qëndruar vetëm në magazinë dhe se “nuk kam dalë kështu nëpër repart me këqyrë se s’më ka interesu ajo punë mu”.<sup>437</sup> Ai madje dëshmoi se nuk i kujtohej asnjë ndërtesë në mes të oborrit të FMK-së,<sup>438</sup> ku, sipas provave në këtë çështje gjyqësore, mbaheshin personat e ndaluar. Këto deklaratat nuk janë të besueshme duke mbajtur parasysht faktin se ai ishte në FMK për disa muaj rresht<sup>439</sup> dhe, sipas vetë dëshmisë së tij, largohej dhe kthehej në objekt disa herë në ditë.<sup>440</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykes, sjellja e z. Koçinaj – të cilit Kryegjykatësja u desh t’ia kujtonte betimin për të thënë të vërtetën<sup>441</sup> – tregon qartë se donte ta

---

<sup>437</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2870, rreshtat 18-25; f. 2881, rreshtat 18-22.

<sup>438</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2283, rreshti 14 deri në f. 2284, rreshti 16, që i referohet **fotografisë:** 074390-074391, f. 074390. Trupi Gjykes ka marrë prova reciprokisht konfirmuese se ndërtesa në mes të oborrit përdorej për mbajtjen dhe keqtrajtimin e personave (*shih* para. 335, 588, 750 më poshtë).

<sup>439</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2816, rreshti 5 deri në f. 2817, rreshti 10; f. 2835, rreshtat 2-6; f. 2839, rreshtat 18-21; f. 2847, rreshti 16 deri në f. 2848, rreshti 2.

<sup>440</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2843, rreshtat 4-15; f. 2844, rreshti 5 deri në f. 2845, rreshti 1.

<sup>441</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2844, rreshti 20; f. 2845, rreshtat 7-9; f. 2884, rreshtat 6-8.

distanconte veten nga çdo pretendim që lidhej me praktikat e ndalimit në FMK. Dëshmitari gjithashtu dëshmoi, për shembull, se nuk e njihte z. Mark Shala, i cili, sipas provave në këtë çështje gjyqësore, ishte eprori i tij.<sup>442</sup> Trupi Gjyqësor e gjykon këtë si aspak të besueshme. Për mendimin e Trupit Gjyqësor, dëshmitari ishte jobindës dhe i mjegullt kur shpjegoi kohën që kaloi në FMK.

265. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor vëren mospërputhje midis dëshmisë së dëshmitarit dhe provave të tjera të disponueshme. Një shembull ilustrues i këtyre mospërputhjeve është pretendimi i vazhdueshëm i z. Koçinaj se në magazinën ku punonte kishte vetëm uniforma,<sup>443</sup> ndërkohë që prova të tjera që iu paraqitën Trupit Gjyqësor dhe të cilat konfirmojnë njëra-tjetrën, tregojnë qartë të kundërtën.<sup>444</sup> Kjo zvogëlon ndjeshëm besueshmërinë që ndryshe mund të kishte pasur dëshmia e z. Koçinaj.

266. Një element tjetër i dëshmisë së z. Koçinaj që bie në sy është paaftësia sistematike e tij gjatë gjithës dëshmisë për të dhënë data, apo të paktën periudha të përafërta, çka në disa raste diktoi ndërhyrjen e Kryegjykatëses.<sup>445</sup> Megjithëse Trupi Gjyqësor pranon së dëshmitarët mund ta kenë të vështirë t'i mbajnë mend datat e sakta, është e habitshme që z. Koçinaj vazhdimisht mohoi se i kujtoheshin datat, ose nuk bëri kurrfarë përpjekje për të dhënë ndonjë periudhë kohore të përafërt (për shembull, kohëzgjatjen e shërbimit të tij në magazinën e FMK-së, ose datat historike të luftës së Kosovës, në të cilën mori pjesë aktivisht).<sup>446</sup> E njëjta mund të thuhet edhe për anëtarët

---

<sup>442</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2880, rreshtat 23-24.

<sup>443</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2818, rreshtat 3-4; f. 2846, rreshtat 18-24; f. 2848, rreshtat 3-8; f. 2868, rreshtat 1-23.

<sup>444</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 100, rreshtat 15-17; **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3198, rreshtat 13-16, *i referohet fotografisë* SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010274; **Z. Dervishaj:** T. 2 tetor 2023, konfidencial, f. 2757, rreshti 15 deri në f. 2758, rreshti 5 (dëshmitari dëshmoi shprehimisht se z. Koçinaj ishte përgjegjës për shpërndarjen e teshave dhe furnizimeve të ushqimit në magazinë).

<sup>445</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2847, rreshti 16 deri në f. 2848, rreshti 25.

<sup>446</sup> **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2816, rreshti 11 deri në f. 2817, rreshti 10; f. 2830, rreshtat 2-13; f. 2847, rreshti 16 deri në f. 2848, rreshti 2.

e UÇK-së, përfshirë z. Shala, për të cilin z. Koçinaj mohoi se kishte dëgjuar ndonjëherë. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues vë në dukje dy postime të asokohshme në *Facebook* që përmbajnë lëvdata për luftën e UÇK-së dhe përkrahje për dëshmitarin për dëshminë e tij të pritshme në Dhomat e Specializuara, të cilat i dënojnë ashpër.<sup>447</sup> Gjithashtu, z. Koçinaj ka lidhje familjare me z. Dervishaj dhe pranoi se u takua me të para ardhjes për të dhënë dëshmi, gjë që e konfirmoi edhe z. Dervishaj. Edhe pse z. Koçinaj nuk mund të jetë përgjegjës për veprimet e të tjerëve, kjo gjithsesi vë në dukje lidhjen e vazhdueshme dhe të ngushtë të tij me (ish-)anëtarë të UÇK-së dhe shpjegon ngurrimin për të dhënë informacion në lidhje me kohën e tij në UÇK, zotën Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së të përfshirë në veprimet e asaj kohe.

267. Mbështetur në sa më lart, duke mbajtur parasysh numrin e përgjigjeve jo të besueshme, mospërputhëse, të paqarta dhe të mjegullta që dha z. Koçinaj gjatë dëshmisë së vet, Trupi Gjykues vëren mungesë të fortë dëshire dhe ngurrim nga ana e dëshmitarit për të dhënë informacion të dobishëm apo me vërtetësi në lidhje me bazën e UÇK-së në FMK. Faktikisht, z. Koçinaj përpiket të japë dëshmi të favorshme për UÇK-në në përgjithësi, dhe për z. Shala në veçanti. Ka shumë të ngjarë që ky synim të ketë ndikuar përgjithësisht në gatishmërinë e tij për t'iu përgjigjur me vërtetësi pyetjeve në lidhje me FMK-në, z. Shala dhe veprimet e anëtarëve të tjerë të UÇK-së, çka ka ndikuar negativisht në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit.

268. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues e ka shqyrtuar me kujdesin më të madh dëshminë e dëshmitarit dhe është mbështetur në të aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

---

<sup>447</sup> SPOE00341607-SPOE00341607-ET; SPOE00341648-SPOE00341648-ET.

## 11. Bardhyl Mahmuti (DW4-06)

269. Bardhyl Mahmuti ("z. Mahmuti") dëshmoi para Trupit Gjykses më 20 dhe 21 shtator 2023, pa masa mbrojtëse.<sup>448</sup>

270. Gjatë luftës, z. Mahmuti ishte përfaqësues politik i UÇK-së dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Lëvizjes Popullore të Kosovës.<sup>449</sup>

271. Trupi Gjykses gjykon se dëshmitari nuk dha dëshmi relevante për çështjen gjyqësore: ai pretendoi se nuk e njihnte dhe se nuk e kishte takuar z. Shala në atë kohë dhe nuk ishte në gjendje të jepte informacion për FMK-në, për të cilën tha që nuk kishte dijeni dhe asnjëherë nuk e kishte vizituar. Duke mbajtur parasysh provat e tjera të besueshme të administruara në këtë gjykim, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e dëshmitarit është qartësisht jo e besueshme. Çka është me rëndësi, Trupi Gjykses vuri re përpjekjet e dëshmitarit për të fituar kohë, duke mos u dhënë përgjigje pyetjeve të shumta, ose duke dhënë shpjegime të gjerësishme për aspekte dytësore dhe jorelevante. Në këtë kontekst, z. Mahmuti iu tërhoq vëmendja vazhdimisht nga Kryegjykatësja.<sup>450</sup> Kjo ndërlikohet më tej nga qëndrimi tejet i njëanshëm i z. Mahmuti kundër Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, të cilat i quajti "ndërmarrje politike kriminale",<sup>451</sup> duke pretenduar se akuzat kundër z. Shala u bazuan në prova të falsifikuara nga shërbimet sekrete serbe.<sup>452</sup>

---

<sup>448</sup> **Z. Mahmuti:** T. 20 shtator 2023, konfidencial, f. 2483-2574; T. 21 shtator 2023, konfidencial, f. 2599-2720.

<sup>449</sup> **Z. Mahmuti:** T. 20 shtator 2023, publik, f. 2503, rreshtat 2-5; T. 21 shtator 2023, publik, f. 2614, rreshtat 6-9.

<sup>450</sup> **Z. Mahmuti:** T. 20 shtator 2023, publik, f. 2565, rreshtat 23-24; f. 2568, rreshtat 15-17; T. 21 shtator 2023, konfidencial, f. 2650, rreshtat 16-20; f. 2656, rreshti 23 deri në f. 2657, rreshti 9.

<sup>451</sup> **Z. Mahmuti:** T. 21 shtator 2023, publik, f. 2693, rreshti 19 deri në f. 2696, rreshti 3 (*i referohet* SPOE00341067-SPOE00341067-ET).

<sup>452</sup> *Shih, për shembull, z. Mahmuti:* T. 21 shtator 2023, publik, f. 2635, rreshti 23 deri në f. 2336, rreshti 9; f. 2719, rreshti 16 deri në f. 2720, rreshti 7.



272. Faktorët e lartpërmendur tregojnë mungesën e fortë të dëshirës nga ana e dëshmitarit për të dhënë informacion të dobishëm në lidhje me z. Shala dhe akuzat nën shqyrtim. Përmbajtja e përgjigjeve të z. Mahmuti dhe mënyra si ato u dhanë, tregojnë se dëshmia e tij kishte synimin strategjik që të mbronte interesat e tij dhe të z. Shala.

273. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk mund të mbështetet aspak në dëshminë e z. Mahmuti.

## 12. Vanesa Milaco (Vanessa Milazzo)

274. Vanesa Milaco (znj. Milaco) nuk dëshmoi para Trupit Gjykses.<sup>453</sup> Ajo dorëzoi një aktekspertizë, e cila u pranua si provë në bazë të rregullës 149 të Rregullores.<sup>454</sup>

275. Znj. Milaco është psikologe. Në dhjetor 2023, ajo bëri vlerësimin psikologjik të zotit Shala. Mbrojtja dorëzoi aktekspertizën e saj për t'u marrë parasysh në përcaktimin e dënimit, në rast të një verdikti fajësie. Sikurse shtjellohet në pjesën për dënimin, Trupi Gjykses mori parasysh aktekspertizën e saj.

## 13. Mark Shala (W04754)

276. Z. Mark Shala dëshmoi para Trupit Gjykses më 23 dhe 25 tetor 2023, pa masa mbrojtëse.<sup>455</sup>

---

<sup>453</sup> Urdhër Gojor: T. 10 janar 2024, publik, f. 4072, rreshti 21 deri në f. 4074 rreshti 10.

<sup>454</sup> **Aktekspertiza:** DPS01735-DPS01757; Urdhër Gojor: T. 10 janar 2024, publik, f. 4072, rreshti 21 deri në f. 4074 rreshti 10.

<sup>455</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, konfidencial, f. 2912-3006; T. 24 tetor 2023, konfidencial, f. 3011-3127; T. 25 tetor 2023, konfidencial, f. 3130-3150.

277. Z. Mark Shala ishte oficer ushtarak para luftës.<sup>456</sup> Ai iu bashkua UÇK-së në mars 1999 dhe e kishte bazën në FMK si shef i logjistikës për operacionin Shigjeta.<sup>457</sup>

278. Dëshmitari dëshmoi për: (i) rolin dhe vendndodhjen e tij gjatë luftës; (ii) funksionimin dhe planimetrinë e FMK-së dhe ndërtesave në FMK; (iii) vendndodhjen e z. Shala dhe takimet midis tyre gjatë luftës; dhe (iv) operacionin Shigjeta.

279. Trupi Gjykses vëren se z. Mark Shala dha informacion të hollësishëm dhe përgjithësisht koherent për kohën dhe rolin e tij në UÇK (në veçanti për detyrat dhe ku ishte i vendosur si komandant i logjistikës), funksionimin e FMK-së si bazë e logjistikës dhe mobilizimit, dhe vendndodhjen dhe (pjesërisht) planimetrinë e FMK-së dhe ndërtesave në FMK,<sup>458</sup> sikurse konfirmohet edhe nga prova të tjera të administruara në këtë gjykim. Dëshmitari iu përgjigj pyetjeve, ishte i sinqertë dhe mund t'i kujtonte datat dhe emrat relevantë. Dëshmia e tij ishte e plotë, me hollësi të shumta që tregonin qartë se kishte njohuri të dorës së parë për aspektet e lartpërmendura, duke mbajtur parasysh rolin e tij si komandant me bazë në FMK.

280. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren mungesë të dukshme të dëshirës dhe ngurrim nga ana e dëshmitarit për të dhënë dëshmi për disa aspekte kyçe që lidhen drejtpërdrejt me akuzat dhe z. Shala. Për shembull, edhe pse e përshkroi me hollësi kompleksin e FMK-së dhe ndërtesat brenda atij kompleksi, z. Mark Shala mohoi se kishte dijeni për ndërtesën ku mbaheshin dhe keqtrajtoheshin të ndaluarit<sup>459</sup> dhe nuk e përfshiu atë në skicën e tij, që përndryshe ishte mjaft e hollësishme.<sup>460</sup> Dëshmia e tij

---

<sup>456</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2915, rreshti 2 deri në f. 2917, rreshti 17.

<sup>457</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2918, rreshti 16 deri në f. 2920, rreshti 17; f. 2921, rreshtat 3-8; f. 2982, rreshtat 12-24.

<sup>458</sup> Dëshmitari vizatoi një skicë, *shih* 083525-083534 RED, f. 083525.

<sup>459</sup> **Z. Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3048, rreshti 3 deri në f. 3049, rreshti 12; f. 3052, rreshti 20 deri në f. 3055, rreshti 20.

<sup>460</sup> **Skica** 083525-083534 RED, f. 083525.

bie plotësisht në kundërshtim me dëshmi të tjera reciprokisht konfirmuese që dëgjoji Trupi Gjykses.<sup>461</sup> Gjithashtu, dëshmitari mohoi kategorikisht se kishte dijeni për praktikat e ndalimit në FMK.<sup>462</sup> Sipas Trupit Gjykses, deklarata të tilla nuk janë të besueshme, duke marrë parasysh rolin e dëshmitarit si komandant me bazë në FMK dhe renditjen e ndërtesave në FMK,<sup>463</sup> që e bën të pagjasë që ai të mos ketë qenë në dijeni të ndërtesës ku mbaheshin dhe keqtrajtoheshin të ndaluarit.<sup>464</sup> Trupi Gjykses vlerëson se dëshmia e z. Mark Shala është jobindëse dhe tregon qartë dëshirën për ta distancuar veten nga çfarëdo pretendimi që lidhet me praktikat e ndalimit në FMK.

281. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren mospërputhje të dukshme midis deklaratave të mëparshme të dëshmitarit dhënë ZPS-së<sup>465</sup> dhe dëshmisë gojore të tij sa i përket vendndodhjes së z. Shala gjatë luftës.<sup>466</sup> Dëshmitari nuk dha asnjë shpjegim të besueshëm se pse ndryshoi aspekte kyçe të dëshmisë së vet në lidhje me këtë aspekt.<sup>467</sup> Këtë ndryshim të qëllimshëm në dëshminë e dëshmitarit, Trupi Gjykses e interpreton si përpjekje për ta distancuar z. Shala – të cilin dëshmitari e lavdëroi si anëtar të përkushtuar, të shquar dhe të ndershëm të UÇK-së<sup>468</sup> – nga FMK-ja dhe krimet për të cilat u ngritën akuza, në kundërshtim me dëshmitë që dëgjoji Trupi Gjykses, përfshirë dëshminë e vetë z. Shala.<sup>469</sup>

---

<sup>461</sup> *Shih* konstatimet në Pjesën VI.D. dhe VI.E.

<sup>462</sup> **Z. Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3055, rreshtat 1-10; f. 3056, rreshtat 20-22.

<sup>463</sup> *Shih* para. 297 më poshtë dhe më përgjithësisht konstatimet në Pjesën VI.B.4-5.

<sup>464</sup> Ndërtesa ku mbaheshin dhe keqtrajtoheshin të ndaluarit gjendej në mes të oborrit dhe dritarja e zyrës së z. Mark Shala ishte pikërisht përballë saj, *shih* z. Mark Shala: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2949, rreshtat 6-17 (dëshmitari shënoi me numër 4 dritaren e zyrës së tij në **fotografinë:** 083525-083534 RED, f. 083527 (e ruajtur si REG00974)).

<sup>465</sup> **Z. Mark Shala:** 083524-TR-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2).

<sup>466</sup> Kjo lidhet veçanërisht me rrethanat, vendin dhe datat e takimeve të dëshmitarit me z. Shala, momentin kur dëshmitari i dha armën z. Shala dhe nëse dëshmitari e dinte se ku u nis të shkonte z. Shala pas këtyre dy takimeve, *shih* z. **Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3061, rreshti 1 deri në f. 3080, rreshti 24; f. 3084, rreshti 17 deri në f. 3086, rreshti 25; f. 3089, rreshti 6 deri në f. 3091, rreshti 14.

<sup>467</sup> *Shih, për shembull,* z. **Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3069, rreshtat 2-12; f. 3072, rreshti 11-18; f. 3089, rreshti 19 deri në f. 3091, rreshti 14.

<sup>468</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2968, rreshti 23 deri në f. 2969, rreshti 3.

<sup>469</sup> *Shih* konstatimet në Pjesën VI.H.

282. Aspektet e lartpërmendura të dëshmisë së dëshmitarit vënë në pah mungesën e fortë të dëshirës nga ana e dëshmitarit për të dhënë informacion të dobishëm në lidhje me z. Shala dhe akuzat nën shqyrtim. Përmbajtja e përgjigjeve të z. Mark Shala dhe mënyra si ato u dhanë, tregojnë se dëshmia e tij kishte synimin strategjik që të mbronte interesat e tij dhe të z. Shala dhe të mos jepej informacion që do të mund të bënte lidhjen midis anëtarëve të UÇK-së dhe kryerjes së krimeve në FMK.

283. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses ka shqyrtuar me kujdes dëshminë e dëshmitarit dhe është mbështetur në të aty ku është e arsyeshme, sikurse shtjellohet në pikat përkatëse të analizës së provave.

## VI. KONSTATIMET FAKTIKE

### A. PJETËR SHALA

#### 1. Informacion bazë

284. Z. Shala u lind më 17 shtator 1963, në Prizren, Kosovë, dhe është katolik.<sup>470</sup> Si përkrahës i pavarësisë së Kosovës përmes luftës së armatosur,<sup>471</sup> ai iu bashkua UÇK-së në mars 1998.<sup>472</sup>

---

<sup>470</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht – A, f. 10; T001-0105-1-A-TR, f. 9-10; 066864-TR-ET Part 1 Revised 1 (Pjesa 1, e rishikuar 1), f. 3, rreshtat 15-16; 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 165, rreshtat 3-9.

<sup>471</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 1 Revised 1 (Pjesa 1, e rishikuar 1), f. 59, rreshtat 5-11; f. 62, rreshti 13 deri në f. 64, rreshti 7.

<sup>472</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht – A, f. 30-35; T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht-3 – B, f. 5; T001-0105-1-A-TR, f. 31-33; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 13, rreshti 21 deri në f. 14, rreshti 9.

285. Gjatë gjithë konfliktit të armatosur, ai njihej gjithashtu edhe me nofkën “Ujku”<sup>473</sup> Sipas vetë z. Shala si dhe W04733-shit dhe zotit Elezaj, z. Shala ulërinte si ujk, sjellje kjo që e përshkroi si pjesë të personalitetit të tij.<sup>474</sup> Trupi Gjykues gjykon se z. Shala, W04733 dhe z. Elezaj janë të besueshëm në lidhje me këtë pikë, meqenëse konfirmojnë dëshmitë e njëri-tjetrit dhe, në rastin e z. Shala dhe W04733-shit, dëshmitë e tyre janë për diçka që është ose personale (z. Shala), ose diçka që e kanë parë vetë (W04733).

## 2. Anëtarësia në UÇK në vitin 1998

286. Z. Shala dha dëshmi të hollësishme, koherente dhe të besueshme për rolin e tij në UÇK pas anëtarësimit në mars 1998. Në deklaratat e viteve 2005, 2007 dhe 2019, ai dëshmoi se ishte i vendosur në Jabllanicë (Kosovë) dhe se, një apo dy muaj pas anëtarësimit në UÇK, u emërua komandant/oficer në policinë ushtarake të UÇK-së në Jabllanicë, në Rrafshin e Dukagjinit.<sup>475</sup> Ai rikujtoi se u emërua nga Nazmi Brahimaj, i cili kishte marrë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për të formuar njësit të policisë ushtarake.<sup>476</sup> Z. Shala deklaroi se pas emërimit iu dha një uniformë e zezë, e cila ishte uniforma e policisë ushtarake dhe kishte shenjën e UÇK-së dhe të policisë ushtarake, e cila zëvendësoi uniformën e kamuflimit.<sup>477</sup> Atij gjithashtu iu dhanë dy dokumente që përmbanin rregulloren e brendshme dhe detyrat e policisë ushtarake

---

<sup>473</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti në shqip dhe anglisht - A, f. 9-10, 28; 066864-TR-ET Part 1 Revised 1 (Pjesa 1, e rishikuar 1), f. 22, rreshtat 23-24; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 77-78; **Dokument i UÇK-së:** U009-9398-U009-9398-ET; **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1408, rreshtat 8-11; **Z. Mark Shala:** T. 25 tetor 2023, publik, f. 3138, rreshtat 13-18.

<sup>474</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 132, rreshti 14 deri në f. 133, rreshti 2; **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 3 RED2 (Pjesa 3 RED2), f. 12, rreshtat 14-24; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019836-SITF00019837; **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar RED4), f. 146, rreshtat 1-9; f. 147, rreshtat 10-16.

<sup>475</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti në shqip dhe anglishte-3 - B, f. 6-8, 11-12, 18-19; T000-2745-T000-2745-Transkripti në shqip dhe anglishte-A, f. 16-17; 066864-TR-ET Part 1 Revised 1 (Pjesa 1, e rishikuar 1), f. 22.

<sup>476</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 82-85; T001-0105-1-A-TR, f. 71-72.

<sup>477</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti në shqip dhe anglishte-3 - B, f. 23-24; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 82-85, 87-88.

në Jabllanicë.<sup>478</sup> Njëri nga këto dy dokumente – Rregullorja e Policisë Ushtarake e UÇK-së e lëshuar nga Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit më 21 qershor 1998 – është provë që iu paraqit Trupit Gjykues (“Rregullorja e UÇK-së” ose “Rregullorja”).<sup>479</sup>

287. Sa u përket detyrave, z. Shala dëshmoi se ato përfshinin, ndër të tjera,<sup>480</sup> verifikimin e rekrutëve që donin të anëtarësoheshin në UÇK.<sup>481</sup> Z. Shala deklaroi se merrte paraprakisht lista me emra dhe duhej të verifikonte nëse emrat e atyre që vinin për t’u anëtarësuar në UÇK ishin në ato lista. Në rast se nuk ishin, ata persona nuk lejoheshin të anëtarësoheshin. Z. Shala shpjegoi se qëllimi i verifikimit ishte që të parandaloheshin infiltrimi në radhët e UÇK-së i personave që punonin me autoritetet serbe.<sup>482</sup>

288. Së fundi, ai shpjegoi se në fund u shkarkua nga policia ushtarake<sup>483</sup> dhe se në verë të vitit 1998 vendosi të largohej nga Kosova për në Shqipëri dhe më pas për në Belgjikë.<sup>484</sup>

289. Dëshmia e z. Shala në lidhje me periudhën e kaluar në policinë ushtarake të UÇK-së në vitin 1998 është e pasur me hollësi (*p.sh.* në lidhje me emërimin e tij, detyrat, vendet ku shërbeu, funksionimin e policisë ushtarake dhe kujt i raportonte).

<sup>478</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht-3 – B, f. 11-12; 066864-TR-ET Part 1 Revised 1 (Pjesa 1, e rishikuar 1), f. 33-34; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 90-93; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 102-103.

<sup>479</sup> **Dokument i UÇK-Së:** U009-9397-U009-9397-ET Revised (E rishikuar) (përkthimi në anglishte); 066856-066862, f. 066856 (versioni origjinal në shqipe).

<sup>480</sup> Detyrat e tjera përfshinin: organizimi i anëtarëve të UÇK-së për hapjen e istikameve, ruajtja e rendit midis civilëve, stërvitja e rekrutëve të rinj; *shih z. Shala:* T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht-3 – B, f. 6, 10-11, 21-22; T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht – A, f. 42-43; T000-2745-T000-2745-Transkripti shqip dhe anglisht - A, f. 17-20; T001-0105-1-A-TR, f. 77-80, 85-91; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 89, 100.

<sup>481</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht-3 – B, f. 11; T001-0105-1-A-TR, f. 72-77.

<sup>482</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht-3 – B, f. 11; T001-0105-1-A-TR, f. 72-77; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 83-85, 97-110.

<sup>483</sup> **Z. Shala:** T000-2745-T000-2745-Transkripti shqip dhe anglisht-A, f. 26-27.

<sup>484</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht – A, f. 13; T000-2748-T000-2748-Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 27-29; 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 5, rreshti 11 deri në f. 6, rreshti 24.

Kjo vërteton faktin se z. Shala foli me vërtetësi, nga përvoja personale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në deklaratat e z. Shala të viteve 2005, 2007 dhe 2019 në lidhje me këto aspekte.

290. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala u emërua komandant/oficer në policinë ushtarake të UÇK-së në Jabllanicë, në Rrafshin e Dukagjinit, dikur në prill ose maj 1998, dhe shërbeu në policinë ushtarake të UÇK-së deri diku në verë të vitit 1998.

291. Ndonëse anëtarësia e z. Shala në policinë ushtarake të UÇK-së në vitin 1998 është jashtë kuadrit kohor të akuzave, Trupi Gjykses e gjykon këtë pjesë të historisë së tij si të rëndësishme, pasi ndihmon në shpjegimin e pozitës dhe rolit të tij në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, që Trupi Gjykses do t'i shqyrtojë më pas.

### 3. Anëtarësia në UÇK në vitin 1999

292. Sa i përket rolit të z. Shala në UÇK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, Trupi Gjykses vëren se në deklaratat e viteve 2005 dhe 2019, z. Shala e pranoi lirisht se u kthye në Shqipëri nga fundi i marsit 1999, për t'iu bashkuar përsëri UÇK-së.<sup>485</sup> Z. Shala konfirmoi se qëndroi me UÇK-në në Shqipëri gjatë tri ose katër muajve të ardhshëm.<sup>486</sup> Pas përfundimit të konfliktit të armatosur, ai u largua përsëri nga Shqipëria për në Belgjikë, diku në qershor/korrik 1999.<sup>487</sup>

293. Për mendimin e Trupit Gjykses, deklaratat koherente të z. Shala nuk lënë kurrfarë dyshimi se ai iu bashkua përsëri UÇK-së në Shqipëri në fund të marsit 1999 dhe qëndroi me UÇK-në deri diku në qershor/korrik 1999, pas përfundimit të

---

<sup>485</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 67-72, 80-84, 98-99; T000-2748-T000-2748-Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 29-30.

<sup>486</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 117-121.

<sup>487</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 117-121; U009-9245-U009-9258-ET, f. U009-9250, U009-9255.

konfliktit të armatosur. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala ishte anëtar i UÇK-së gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat (afërsisht 17 majit 1999 deri më 5 qershor 1999).

294. Vendndodhja e z. Shala gjatë periudhës që lidhet me akuzat dhe pozita dhe roli i tij në UÇK në FMK, do të shqyrtohen në Pjesët VI.H dhe VI.I të këtij Aktgjykimi.

## B. FABRIKA E METALIT NË KUKËS

295. Në vijim, Trupi Gjykses do të bëjë vlerësimin e provave dhe do të paraqesë konstatime faktike në lidhje me: (i) praninë e një baze të UÇK-së në Kukës në maj – qershor 1999; (ii) vendndodhjen e FMK-së; (iii) përdorimin e FMK-së; (iv) planimetrinë e kompleksit të FMK-së; dhe (v) planimetrinë e brendshme të ndërtesave në FMK.

### 1. Prania e një baze të UÇK-së në Kukës në maj – qershor 1999

296. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se bëri konstatim gjyqësor të faktit të shqyrtuar se një fabrikë në Kukës, Shqipëri, u kthye në bazë ushtarake nga ana e UÇK-së në vitin 1999.<sup>488</sup>

297. Trupit Gjykses i janë paraqitur edhe materiale të tjera që dëshmojnë për praninë e UÇK-së në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Konkretisht, ekzistencën e një baze të UÇK-së në Kukës e pranon edhe z. Shala në deklaratën e vet të vitit 2019, përkatësisht se “ish-uzina mekanike në Kukës”<sup>489</sup> ishte në dispozicion të UÇK-së nga afërsisht 22 marsi 1999, të cilën konfirmon se e vizitoi disa herë “gjatë kohës së

---

<sup>488</sup> [List of Adjudicated Facts](#) (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), Fakti i Shqyrtuar 51.

<sup>489</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 98, rreshti 7 deri në f. 99, rreshti 2.



luftës”,<sup>490</sup> dhe të cilës i referohet gjithashtu me “shtabi i UÇK-së në Kukës”.<sup>491</sup> Sipas Trupit Gjykses, dëshmia e z. Shala është e besueshme sepse ai është i sinqertë dhe dëshmia e tij pa dyshim mbështetet në përvojën personale të tij. Ajo konfirmohet gjithashtu edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Konkretisht, z. Mark Shala - i cili e kishte bazën në FMK si shef i logjistikës për operacionin Shigjeta midis fundit të marsit dhe qershorit 1999<sup>492</sup> - dëshmoi me hollësi se si UÇK-ja e përdori “uzinë[n] e vjetër”.<sup>493</sup> Gjithashtu, në deklaratën e vet, z. Elezaj konfirmoi se ishte pronari i kompleksit (“oficinë[s] mekanike”),<sup>494</sup> që ia kishte lënë në dispozicion UÇK-së për periudhën midis marsit dhe korrikut 1999.<sup>495</sup>

298. Këto dëshmi përputhen me faktin e shqyrtuar të lartpërmendur. Kjo gjithashtu konfirmohet reciprokisht dhe buron nga z. Shala dhe dëshmitarë që e njihnin nga brenda UÇK-në, dhe në veçanti FMK-në. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i gjykon këto dëshmi si të besueshme dhe mbështetet në to.

299. Në bazë të provave të marra në tërësi, Trupi Gjykses është bindur se midis marsit dhe korrikut 1999, UÇK-ja kishte një bazë në FMK në Kukës, Shqipëri.

300. Trupi Gjykses vë në dukje se ka dëgjuar dëshmi reciprokisht konfirmuese për ekzistencën e një vendndodhjeje tjetër në Kukës, një ndërtesë njëkatëshe që përmendet si “shtab nr. 1” ose “reparti numër 1” ose “vendi ku ndodhej Ruzhdi Saramati”, e cila ishte afër FMK-së dhe përdorej nga UÇK-ja për mobilizim.<sup>496</sup> Kjo vendndodhje është

---

<sup>490</sup> **Z. Shala**: 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 124, rreshti 17 deri në f. 125, rreshti 1.

<sup>491</sup> **Z. Shala**: 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 61, rreshtat 8-9.

<sup>492</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2920, rreshtat 7-17; f. 2921, rreshtat 3-8; f. 2982, rreshtat 12-24.

<sup>493</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2922, rreshtat 5-20.

<sup>494</sup> **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 25, rreshti 17.

<sup>495</sup> **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 13, rreshti 17 deri në f. 15, rreshti 7; f. 25, rreshti 5 deri në f. 26, rreshti 17.

<sup>496</sup> **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1092, rreshtat 13-24 (dëshmitari i referohet këtij vendi me “një shtab nr. 1”); **Z. Dervishaj**: T. 2 tetor 2023, publik, f. 2739, rreshti 7-22; f. 2740, rreshti 10 deri në f. 2741, rreshti 1; f. 2752, rreshtat 18-24; f. 2790, rreshtat 3-17 (dëshmitari i referohet këtij vendi me “reparti numër 1);

qartësisht e ndryshme nga FMK-ja, pasi një numër dëshmitarësh përshkruajnë lëvizjen ose zhvendosjen nga njëra bazë në tjetrën për qëllime të ndryshme, për shembull, për ndihmë mjekësore në FMK, e cila nuk ishte e disponueshme në “repartin 1”.<sup>497</sup>

## 2. Vendndodhja e Fabrikës së Metalit në Kukës

301. Dihet gjerësisht se FMK-ja gjendet në periferi të Kukësit, një qytezë në Shqipëri, afërsisht 20 kilometra larg kufirit me Kosovën.<sup>498</sup>

302. Më konkretisht, Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi nga z. Mark Shala se kompleksi i FMK-së gjendej afërsisht 2–2.5 kilometra larg qendrës së Kukësit.<sup>499</sup>

303. Duke u nisur nga gjendja e rrugëve në kohën që lidhet me akuzat, nga FMK-ja në qytetin e Tiranës mund të shkohej për 9 deri në 12 orë me veturë.<sup>500</sup> Trupi Gjykses gjykon se për këto aspekte konkrete mund të mbështetet në dëshminë e z. Mark Shala,<sup>501</sup> pasi informacioni që dha dëshmitari bazohej qartësisht në përvojën e drejtpërdrejtë të tij dhe ishte i llojit që pritet nga një person në pozitën që mbante ai në UÇK dhe që e njihnte FMK-në në atë kohë.

---

**Z. Gashi:** T. 9 janar 2024, publik, f. 3956, rreshtat 22-25; **Z. Kryeziu:** SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016912; SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014092-SITF00014093 (dëshmitari i referohet këtij vendi me “një shtab nr. 1” ose “vendi ku ndodhej Ruzhdi Saramati”); **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013302-SITF00013303; 064716-TR-ET Part 3 RED4 (Pjesa 3 RED4), f. 3, rreshti 1 deri në f. 4, rreshti 9; f. 23, rreshtat 1-13; f. 25, rreshtat 6-22.

<sup>497</sup> **Z. Dervishaj:** T. 2 tetor 2023, publik, f. 2743, rreshtat 3-9; **Z. Kryeziu:** SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016912; **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 3 RED4 (Pjesa 3 RED4), f. 7, rreshti 15 deri në f. 8, rreshti 3; SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013303; 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 1, rreshti 19 deri në f. 2, rreshti 25.

<sup>498</sup> [List of Facts of Common Knowledge](#) (Lista e Fakteve të Njohura Gjerësisht), Faktet 1-2.

<sup>499</sup> **Z. Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3091, rreshti 24 deri në f. 3092, rreshti 7.

<sup>500</sup> **Z. Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3022, rreshtat 2-10.

<sup>501</sup> Për vlerësimin e besueshmërisë së përgjithshme të z. Mark Shala, *shih* Pjesën V.H.13.

304. Për më tepër, provat që iu paraqitën Trupit Gjykues vërtetojnë pa mëdyshje se hyrja e FMK-së ndodhej në rrugën kryesore që shkon nga Kukësi për në Krumë,<sup>502</sup> kurse varreza e Kukësit më poshtë rrugës, në drejtim të Krumës.<sup>503</sup>

305. Trupi Gjykues ka marrë prova të hollësishme, të qarta dhe reciprokisht konfirmuese në lidhje me këto aspekte dhe rrjedhimisht është bindur lidhur me vendndodhjen e përkthuar të FMK-së. Si rezultat, në bazë të provave që iu paraqitën, Trupi Gjykues është bindur se FMK-ja ndodhej rreth 2–2.5 kilometra jashtë Kukësit, në rrugën që shkon në drejtim të Krumës dhe varrezës së Kukësit.

### 3. Përdorimi i Fabrikës së Metalit në Kukës

306. Në lidhje me përdorimin e FMK-së gjatë periudhës që lidhet me akuzat, Trupi Gjykues ka marrë prova të shumta reciprokisht konfirmuese se kompleksi shërbente si shtab i UÇK-së, ndër të tjera për rekrutim, mobilizim dhe operacione logjistike. Disa dëshmitarë dëshmuan se në FMK vinin rregullisht persona për t'u anëtarësuar në UÇK, për t'u pajisur me uniforma dhe/ose armë dhe, pas një kohe të caktuar në kompleks, për t'u dërguar në qendrat stërvitore ose në front (në Kosovë) për të luftuar.<sup>504</sup> Dëshmitarë të tjerë gjithashtu dëshmuan se FMK-ja shërbeu si shtab i

<sup>502</sup> *Shih, për shembull, z. Mark Shala*: T. 24 tetor 2023, publik, f. 3028, rreshti 22 deri në f. 3029, rreshti 1 (përmes fotografisë SPOE00330362-00330362 (e ruajtur si REG00976), z. Mark Shala identifikoi hyrjen e FMK-së, që gjendej në rrugën për në Krumë); **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 56, rreshtat 8-18 and f. 60, rreshtat 8-10 (Z. Elezaj shënoi hyrjen e FMK-së që gjendej në rrugën për në Krumë, në skicën 065435-065435); **TW4-02**: 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 3, rreshtat 11-12, që i referohen skicës 060653-060663, f. 060653; dhe 108837-108849 RED, f. 108839. *Shih gjithashtu shtojcën që i bashkëlidhet këtij Aktgjykimi (Shtojca), f. 2-3.*

<sup>503</sup> **TW4-01**: T. 5 qershor 2023, konfidencial, f. 1753, rreshti 3 deri në f. 1754, rreshti 4; **Z. Hoxha**: T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3334, rreshti 5 deri në f. 3335, rreshti 13 (dëshmitari shënoi varrezën e Kukësit në fotografinë DPS00159-DPS00161, f. DPS00159 (e ruajtur si REG00992)); **TW4-02**: 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 3, rreshtat 16-20.

<sup>504</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2922, rreshtat 23-25; f. 2926, rreshti 24 deri në f. 2927, rreshti 7; f. 2930, rreshtat 2-13; f. 2957, rreshtat 13-22; **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1038, rreshtat 9-11; f. 1090, rreshti 19 deri në f. 1091, rreshti 1; **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 38, rreshtat 6-16; f. 39, rreshtat 5-7; f. 41, rreshtat 1-2; f. 42, rreshtat 1 deri në f. 43, rreshti 6; f. 44,

logjistikës për operacionin Shigjeta, ku merreshin, ruheshin dhe shpërndaheshin mjetet luftarake dhe furnizimet me ushqim.<sup>505</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses rikujton se z. Shala iu referua FMK-së si shtabi i UÇK-së në Kukës.<sup>506</sup>

307. Duke mbajtur parasysh qartësinë, pajtueshmërinë dhe nivelin e përputhshmërisë midis dëshmisë së z. Shala dhe dëshmitarëve në lidhje me këtë aspekt, Trupi Gjykses është bindur se gjatë periudhës që lidhet me akuzat, FMK-ja funksionoi si shtab i UÇK-së, ndër të tjera për rekrutimin, pajisjen dhe mobilizimin e anëtarëve të UÇK-së, si edhe për mbështetje logjistike të frontit në Kosovë. Me fjalë të tjera, përdorej si bazë ushtarake.

308. Krahas funksioneve të lartpërmendura të FMK-së, Trupi Gjykses ka marrë prova të shumta reciprokisht konfirmuese dhe të besueshme se UÇK-ja e përdori FMK-në edhe për ndalimin, përfshirë keqtrajtimin, e të ndaluarve. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses u referohet Pjesëve VI.D dhe VI.E të këtij Aktgjykimi.

---

rreshti 22 deri në f. 45, rreshti 9. *Shih gjithashtu* pllakën përkujtimore në hyrjen e FMK-së, sikurse shihet në fotografinë SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010298.

<sup>505</sup> **Z. Hoxha:** T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3439, rreshti 25 deri në f. 3440, rreshti 14; T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3182, rreshti 24 deri në f. 3183, rreshti 8; f. 3198, rreshtat 11-16; **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2922, rreshtat 11-23; f. 2949, rreshti 23 deri në f. 2950, rreshti 3; f. 2956, rreshti 23 deri në f. 2957, rreshti 3; **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 37, rreshtat 16-22.

<sup>506</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 61, rreshtat 8-9.

#### 4. Planimetria e kompleksit të Fabrikës së Metalit në Kukës

309. Provat që iu paraqitën Trupit Gjykses vërtetojnë qartë se FMK-ja kishte një oborr me disa ndërtesa të ndryshme brenda perimetrit të vet,<sup>507</sup> me rrethojë.<sup>508</sup>

310. *Porta, kabina e rojës, ndërtesa e komandës, kuzhina dhe magazina.* Z. Shala dhe disa dëshmitarë konfirmuan qartësisht se në kompleks hyhej përmes një porte prej metali.<sup>509</sup> Ata gjithashtu deklaruan se te porta bënin rojë me ndërrime<sup>510</sup> anëtarë të UÇK-së, që qëndronin në një ndërtesë të vogël, menjëherë në të majtë pasi të kaloje portën ("kabina e rojës").<sup>511</sup> Trupi Gjykses gjithashtu dëgjoi dëshmi përputhëse se një

---

<sup>507</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 102, rreshtat 14-18; **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1051, rreshti 23 deri në f. 1052, rreshti 5, që i referohet skicës 083536-083536 RED (e ruajtur si REG00947); **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3201, rreshti 25 deri në f. 3202, rreshti 15, që i referohet fotografisë SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010282; shih gjithashtu fotografitë SPOE00330362-00330362 dhe SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010279, dhe skicat 065435-065435-ET dhe SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878. Shih gjithashtu Shtojcën, f. 2.

<sup>508</sup> **W04280:** T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3753, rreshtat 13-21; **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 56, rreshtat 12-15; f. 61, rreshtat 2-3 (dëshmitari shënoi rrethojën e oborrit në skicën 065435-065435); **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 2, rreshtat 11-14. Shih gjithashtu, 065418-065429-ET, f. 065419.

<sup>509</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 100, rreshtat 7-9, që u referohen fotografive në 066883-066886, f. 066884; **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshtat 19-23; f. 1411, rreshtat 7-19 (dëshmitari shënoi portën me shkronjën A në skicën SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (e ruajtur si REG00954)); **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1192, rreshti 3 deri në f. 1193, rreshti 4, që u referohet fotografive në 059341-059350, f. 059342; **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1042, rreshti 17 deri në f. 1043, rreshti 12, që i referohet fotografive në 065594-065596, f. 065596. Shih gjithashtu Shtojcën, f. 3.

<sup>510</sup> Për më shumë në lidhje me sistemin e rojës për të ndaluarit në FMK shih, ndër të tjera, para. 423, 480, 626, 637.

<sup>511</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1043, rreshti 18 deri në f. 1044, rreshti 18 (dëshmitari shënoi kabinën ku bënte roje në skicën 083536-083536 RED (e ruajtur si REG00947)); f. 1044, rreshti 20 deri në f. 1045, rreshti 9 (dëshmitari identifikoi ndërtesën që shihet në fotografinë e sipërme të 065597-065612, f. 065597 si ndërtesa ku ishin të vendosur rojat); **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2962, rreshti 8 deri në f. 2963, rreshti 2 (dëshmitari shënoi me numrin 7 ndërtesën ku rojat bënin rojë, në fotografinë 083525-083534 RED, f. 083526 (e ruajtur si REG00975)).

ndërtesë dykatëshe<sup>512</sup> ndodhej më tej në anën e majtë,<sup>513</sup> ku ishin zyrat e sektorëve të UÇK-së (sektori i operacioneve, i mobilizimit dhe i logjistikës) dhe komanda e logjistikës (“ndërtesa e komandës”).<sup>514</sup> Gjithashtu, provat tregojnë qartë se ngjitur me ndërtesën e komandës ishte një ndërtesë më vete që përdorej si kuzhinë (“kuzhina”).<sup>515</sup> Sipas provave, përbri me kuzhinën dhe përballë portës, matanë oborrit ishte një ndërtesë e gjatë që përdorej si magazinë (“magazina”).<sup>516</sup>

311. Trupi Gjykses ka marrë prova të shumta, të hollësishme dhe reciprokisht konfirmuese për planimetrinë e kompleksit të FMK-së, të cilat nuk lënë hapësirë për asnjë dyshim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur për vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre.

312. *Ndërtesa njëkatëshe – ndërtesa e ndalimit.* Trupi Gjykses ka marrë prova të shumta që tregojnë se në kompleksin e FMK-së ishte një ndërtesë njëkatëshe ku mbaheshin persona (“ndërtesa e ndalimit”). Sipas TW4-01-shit, të ndaluarit (dhe vetë ai) mbaheshin, ndër të tjera, në një ndërtesë të vogël që ishte në mes të oborrit, në anën e

---

<sup>512</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1412, rreshtat 5-11, *i referohet* skicës SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878; **z. Mark Shala:** T. 23 tetorit 2023, publik, f. 2924, rreshti 21 deri në f. 2925, rreshti 2, *i referohet* skicës 083525-083534 RED, f. 083525; **z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3180, rreshti 25 deri në f. 3181, rreshti 16, *i referohet* fotografisë SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010279 (e ruajtur si REG00983). *Shih gjithashtu* Shtojcën, f. 4.

<sup>513</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 103, rreshtat 18-25; **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshti 19 deri në f. 1410, rreshti 6; **z. Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3028, rreshti 15 deri në f. 3029, rreshti 4.

<sup>514</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2924, rreshti 17 deri në f. 2925, rreshti 16; **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3180, rreshti 25 deri në f. 3181, rreshti 16; **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 103, rreshtat 18-25.

<sup>515</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1049, rreshti 20 deri në f. 1050, rreshti 4, *i referohet* skicës 083536-083536 RED; **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshti 12 deri në f. 1410, rreshti 10; *shih gjithashtu* skicën që vizatoi **z. Mark Shala**, 083525-083525-ET.

<sup>516</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshtat 19-25; *shih gjithashtu* skicën që vizatoi dëshmitari (SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878); **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1050, rreshtat 5-8, *i referohet* skicës 083536-083536 RED; **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2956, rreshti 23 deri në f. 2957, rreshti 3, *i referohet* skicës 083525-083534 RED, f. 083525; *shih gjithashtu* shënimet që bëri z. Koçinaj në SPOE00330362-00330362 (e ruajtur si REG00968). *Shih gjithashtu* Shtojcën, f. 5.

djathtë pasi të hyje në kompleks, dhe rreth 40–50 metra larg ndërtesës së komandës.<sup>517</sup> Edhe TW4-11 dëshmoi se u mbajt në një ndërtesë njëkatëshe në anën e djathtë të portës.<sup>518</sup> Edhe TW4-10, ish-rojë e UÇK-së që shërbeu në FMK, e identifikoi të njëjtën ndërtesë (që përshkruan dëshmitarët TW4-01 dhe TW4-11) si një “shtëpi” njëkatëshe, ku “të dyshimtë që vijshin me u kyç në UÇK” mbaheshin për disa orë dhe merreshin në pyetje për lidhjet e tyre me Serbinë.<sup>519</sup> Krahas kësaj, W04733, W01448 dhe TW4-02 në deklaratat e tyre të gjithë dhanë informacion se u mbajtën në një ndërtesë që ishte 50-60 metra larg ndërtesës së komandës.<sup>520</sup> Trupi Gjykses i konsideron këto dëshmi të besueshme, pasi janë të qarta, përrputhëse dhe reciprokisht konfirmuese sa i përket faktit kyç se persona u mbajtën në një ndërtesë njëkatëshe në oborrin e FMK-së. Megjithëse vëren njëfarë mospërrputhje sa i përket largësisë midis kësaj ndërtesë dhe ndërtesës së komandës, Trupi Gjykses nuk gjykon se kjo mospërrputhje ndikon negativisht në besueshmërinë e dëshmimeve, sepse: (i) mospërrputhja është e vogël; (ii) ajo lidhet me një aspekt që nuk ka rëndësi; dhe (iii) të gjithë dëshmitarët e lartpërrmendur konfirmuan ekzistencën e kësaj ndërtesë ku u mbajtën persona, dhe se ajo gjendej në kompleksin e FMK-së.

---

<sup>517</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshti 19 deri në f. 1410, rreshti 10; T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1420, rreshti 5 deri në f. 1421, rreshti 24, i referohet vizatimit SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (i ruajtur si REG00954); T. 30 maj 2023, publik, f. 1423, rreshti 14 deri në f. 1424, rreshti 13 (dëshmitari njohu ndërtesën në fotografinë 074390-074391, f. 074390, si ndërtesa ku u mbajt i ndaluar); T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1554, rreshti 23 deri në f. 1555, rreshti 2.

<sup>518</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1195, rreshti 20 deri në f. 1198, rreshti 13. *Shih gjithashtu*, f. 1204, rreshti 15 deri në f. 1206, rreshti 17, ku dëshmitari njohu dhe shënoi ndërtesën ku u mbajt i ndaluar në të njëjtën fotografi që më parë iu tregua TW4-01-shit, 074390-074391, f. 074390 (e ruajtur si REG00951).

<sup>519</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1052, rreshti 7 deri në f. 1053, rreshti 23, i referohet skicës 083536-083536 RED; *shih gjithashtu*, f. 1054, rreshtat 6-19, ku dëshmitari njohu ndërtesën që shihet në të njëjtën fotografi që iu tregua dëshmitarëve TW4-01 dhe TW4-11 (fotografia 074390-074391, f. 074390) si ndërtesa ku personat merreshin në pyetje para se të anëtarësoheshin në UÇK. Trupi Gjykses vëren se TW4-10 dëshmoi që ndërtesa e identifikuar ishte jo më shumë se 15-20 metra larg ndërtesës së komandës (*shih* f. 1054, rreshtat 16-19).

<sup>520</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 107007; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748; **TW4-02:** 108850-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 10, rreshti 21 deri në f. 11, rreshti 13.

313. Megjithatë, Trupi Gjykues dëgjoi gjithashtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe ish-anëtarëve të UÇK-së – z. Hoxha, z. Mark Shala, z. Koçinaj dhe W04280 - të cilët deklaruan se nuk kishin parë asnjëherë,<sup>521</sup> ose se nuk u kujtohej se ekzistonte një ndërtesë njëkatëshe.<sup>522</sup>

314. Trupi Gjykues vlerëson se këto dëshmi mohuese nuk janë bindëse kur krahasohen me dëshminë e një ish-roje të UÇK-së në FMK (TW4-10) dhe, çka është më e rëndësishme, me ato të pesë viktimave që dëshmuan për rrethanat e ndalimit të tyre (TW4-01, TW4-11, W04733, W01448 dhe TW4-02).<sup>523</sup> Së pari, sikurse u konstatua më lart, dëshmitë e TW4-01-shit, TW4-11-shit, TW4-10-s, W04733-shit, W01448-ës dhe TW4-02-shit për ekzistencën e ndërtesës si dhe identifikimi i saj prej tyre, konfirmojnë njëra-tjetrën dhe rrjedhimisht janë të mbështetshme, veçanërisht duke mbajtur parasysh faktin se TW4-01, TW4-11, TW4-10, të gjithë e njohën ndërtesën nga e njëjta fotografi.<sup>524</sup>

315. Së dyti, lidhur me W04280-n, z. Hoxha, z. Mark Shala dhe z. Koçinaj, të cilët pretenduan se nuk e njihnin ndërtesën në fjalë, Trupi Gjykues konstatoi se ata treguan tendencë të fuqishme për të dhënë dëshmi të favorshme për z. Shala, ose nuk kishin dëshirë të jepnin informacion që mund të çonte në përfundimin se anëtarë të UÇK-së kryen krime në FMK.<sup>525</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është i mendimit se këta

---

<sup>521</sup> **Z. Hoxha:** T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3390, rreshtat 9-15; f. 3391, rreshtat 9-25 (z. Hoxha deklaroi se nuk e kishte parë asnjëherë ndërtesën në fotografinë 074390-074391, f. 074390, të cilën TW4-01 dhe TW4-11 shprehimisht e identifikuan si ndërtesa ku u mbajtën të ndaluar, kurse TW4-10 si ndërtesa ku mbaheshin dhe merreshin në pyetje persona).

<sup>522</sup> **Z. Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3052, rreshti 20 deri në f. 3053, rreshti 23; **Z. Koçinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2870, rreshtat 9-12; f. 2883, rreshti 23 deri në f. 3884, rreshti 5; **W04280:** T. 29 nëntor 2023, konfidencial, f. 3843, rreshtat 8-15. Të tre dëshmitarëve iu tregua gjithashtu edhe fotografia 074390-074391, f. 074390, të cilën nuk e identifikuan. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se z. Elezaj nuk e përfshiu ndërtesën e ndalimit në skicën 065435-065435-ET.

<sup>523</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2, VI.D.4, VI.D.5, VI.D.6 dhe VI.D.9.

<sup>524</sup> Fotografia 074390-074391, f. 074390. *Shih* Shtojcën, f. 6.

<sup>525</sup> *Shih* Pjesët V.H.2, V.H.8, V.H.10 dhe V.H.13.



dëshmitarë kishin motivin për të mohuar ekzistencën e një vendi të mundshëm ndalimi brenda FMK-së.

316. Së treti, Trupi Gjykses i gjykon si jo të besueshme dëshmitë e këtij grupi dëshmitarësh, duke qenë se të gjithë e kishin bazën dhe punonin në FMK gjatë periudhës që mbulon Aktakuza e Konfirmuar, që do të thotë se pretendimet e tyre kategorike se kurrë nuk kishin parë, vënë re ose nuk u kujtohej një ndërtesë në mes të oborrit, nuk mund të jenë të vërteta. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vë në dukje se ka marrë prova dokumentare që vërtetojnë qartë ekzistencën e ndërtesës së ndalimit brenda kompleksit gjatë periudhës që lidhet me akuzat.<sup>526</sup>

317. Së katërti, këta dëshmitarë thjesht mohojnë ekzistencën e një ndërtese njëkatëshe, pa dhënë shpjegime apo përshkrime alternative që mund të lëkundnin besueshmërinë e provave që konfirmojnë ekzistencën e saj. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses nuk ka evidentuar ndonjë faktor të veçantë që do të vinte në dyshim besueshmërinë e TW4-01-shit, TW4-11-shit, TW4-10-s, W04733-shit dhe W01448-ës, të cilët dhanë informacion për ekzistencën e ndërtesës së ndalimit. Rrjedhimisht, provat që mohojnë ekzistencën e ndërtesës njëkatëshe nuk mund të cenojnë vlerën provuese të provave që konfirmojnë ekzistencën e saj.

318. Duke u bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se ndërtesa e ndalimit ishte një ndërtesë e vogël njëkatëshe, sikurse në fotografinë ku e identifikuan TW4-01, TW4-11 dhe TW4-10,<sup>527</sup> e cila ndodhej brenda kompleksit të FMK-së. Ndërtesa e ndalimit ishte midis 40 dhe 60 metra larg ndërtesës së komandës, në anën e djathtë të

---

<sup>526</sup> *Shih* 065437-065439, f. 065437, planimetria e FMK-së, janar 1996, ku ndërtesa e ndalimit mund të shihet ndërmjet ndërtesave të shënuara me numrat 2 dhe 4, bashkë me fotografinë 074390-074391, f. 074390, në të cilën të gjithë dëshmitarët e lartpërmendur (TW4-01, TW4-11 dhe TW4-10) e njohën ndërtesën e ndalimit. *Shih* Shtojcën, f. 6.

<sup>527</sup> Fotografia 074390-074391, f. 074390. *Shih* Shtojcën, f. 6.

kompleksit.<sup>528</sup> Trupi Gjykues vë në dukje se ka marrë prova se ndërtesa e ndalimit nuk ekziston më, meqenëse pjesërisht është rrëzuar dhe shkatërruar.<sup>529</sup>

319. *Banjat*. Trupi Gjykues rikujton se ka bërë konstatim gjyqësor të faktit të shqyrtuar se “tualeti gjendej jashtë [...]. Të ndaluarit është dashur të kërkojnë leje për të shkuar në tualet dhe gjatë kësaj kohe ata shoqëroheshin dhe ruheshin nga ushtarë”.<sup>530</sup>

320. Krahas kësaj, Trupi Gjykues ka marrë prova të shumta sa i përket vendndodhjes së saktë të banjave në FMK. Gjatë dëshmisë së vet në sallën e gjyqit, TW4-01 tha se banjat ishin jashtë ndërtesës së ndalimit, në anën e FMK-së përballë rrugës për në Krumë.<sup>531</sup> Kjo dëshmi konfirmohet gjithashtu edhe nga skicat që vizatuan dëshmitarët TW4-04 dhe W01448, të cilët të dy e identifikuan të njëjtin vend si vendndodhja e banjave.<sup>532</sup> Po ashtu edhe z. Mark Shala konfirmoi se banjat gjendeshin në anën e djathtë të kompleksit të FMK-së.<sup>533</sup>

321. Sa i përket përdorimit të banjave, TW4-01 dëshmoi se banjat i përdornin si të ndaluarit, ashtu edhe anëtarët e UÇK-së.<sup>534</sup> Dëshmia e TW4-01-shit konfirmohet nga

---

<sup>528</sup> *Shih* skicën SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (e ruajtur si REG00954), ku TW4-01 shënoi ndërtesën e ndalimit me numrat 1, 2 dhe 3.

<sup>529</sup> *Shih* fotografitë SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010273, SPOE40010282, SPOE40010285, SPOE40010290, SPOE40010291 (këto fotografi janë bërë më 22 maj 2019 dhe në to shihen rrënojat e ndërtesës së ndalimit); *shih gjithashtu* fotografinë nga ajri SPOE00330362-00330362, së bashku me SPOE00330364-00330364 (ndërtesa e ndalimit nuk ekzistonte më kur u bë fotografia SPOE00330362-00330362 në vitin 2022, ndërkohë që ekzistenca, forma dhe pozita e saj, sikurse konfirmohet nga 065437-065439, f. 065437, janë mbivendosur në SPOE00330364-00330364). *Shih* Shtojcën, f. 6.

<sup>530</sup> List of Adjudicated Facts (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), Fakti i Shqyrtuar 55.

<sup>531</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1445, rreshti 16 deri në f. 1446, rreshti 5. Dëshmitari shënoi banjat me shkronjën T në skicën SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (e ruajtur si REG00954).

<sup>532</sup> **TW4-04**: 08816-108825 RED, f. 108822; **W01448**: U003-2231-U003-2231-ET.

<sup>533</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2958, rreshti 11 deri në f. 2960, rreshti 18, *i referohet* skicës 083525-083534 RED, f. 083525; T. 24 tetor 2023, publik, f. 3037, rreshti 14 deri në f. 3038, rreshti 6, *i referohet* fotografisë SPOE00330362-00330362 (e ruajtur si REG00977). Dëshmitari dëshmoi se shënimi numër 6 në skicë dhe në fotografi, ishte një ndërtesë e vogël me banja të cilat i përdornin të gjithë në FMK dhe gjendeshin deri në 150 metra larg ndërtesës së komandës.

<sup>534</sup> **TW4-01**: transkripti i 30 majit 2023, publik, f. 1445, rreshti 16 deri në f. 1446, rreshti 5; transkripti i 31 majit 2023, konfidencial, f. 1535, rreshtat 1-9.

ajo e z. Mark Shala, i cili tha se ato ishin të vetmet banja të përdorshme në kompleks,<sup>535</sup> si edhe nga deklarata e W04733-shit, i cili konfirmoi se banjat i përdornin të gjithë të pranishmit në FMK, përfshirë të ndaluarit.<sup>536</sup> Trupi Gjykses i konsideron këto dëshmi sa të besueshme aq edhe të drejtpërdrejta, të qarta, përputhëse dhe reciprokisht konfirmuese në lidhje me ekzistencën dhe përdorimin e banjave në FMK.

322. Trupi Gjykses vëren një mospërputhje të vogël sa i përket vendndodhjes së saktë të banjave në krahasim me ndërtesën e ndalimit (sipas TW4-01-shit, TW4-04-ës dhe W01448-ës, banjat ishin në anën e kompleksit në drejtim të rrugës për në Krumë, kurse sipas z. Mark Shala, në të djathtë të ndërtesës së ndalimit), por nuk gjykon se kjo mospërputhje ndikon negativisht në mbështetshmërinë në prova sepse: (i) mospërputhja është e vogël; (ii) ka të bëjë me aspekt të parëndësishëm; dhe (iii) të gjithë dëshmitarët e lartpërmendur janë përputhës sa u përket aspekteve kyçe të përshkrimit të banjave, përfshirë se ishin në anën e djathtë të kompleksit, afër ndërtesës së ndalimit. Çka është me rëndësi, kjo tregon se, për të shkuar në banja, çdokush që vinte nga drejtimi i portës, ndërtesës së komandës, kuzhinës apo magazinës, duhej të kalonte pranë ndërtesës së ndalimit.

323. Nga ana tjetër, dëshmitarët e Mbrojtjes z. Hoxha dhe W04280, pranuan se në kompleksin e FMK-së kishte banja, por atyre nuk u kujtohej se ku ndodheshin saktësisht, as nuk e njohën vendin që përshkruan dëshmitarët e lartpërmendur.<sup>537</sup> Zotit Koçinaj madje nuk i kujtohej nëse kishte pasur banja në FMK.<sup>538</sup>

324. Për arsye të ngjashme si në lidhje me ekzistencën e ndërtesës së ndalimit, Trupi Gjykses i gjykon si jobindëse dëshmitë që mohojnë ekzistencën ose njohuritë për

---

<sup>535</sup> Z. **Mark Shala**: transkripti i 23 tetorit 2023, publik, f. 2959, rreshtat 5-7.

<sup>536</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106990, 107001.

<sup>537</sup> Z. **Hoxha**: transkripti i 21 nëntorit 2023, publik, f. 3376, rreshti 17 deri në f. 3377, rreshti 11; f. 3378, rreshtat 19-24; f. 3387, rreshtat 4-12, i referohet fotografisë SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010289; **W4280**: transkripti i 29 nëntorit 2023, konfidencial, f. 3842, rreshti 22 deri në f. 3843, rreshti 2.

<sup>538</sup> Z. **Koçinaj**: transkripti i 3 tetorit 2023, publik, f. 2844, rreshti 5 deri në f. 2845, rreshti 6; f. 2846, rreshtat 12-13.

vendndodhjen konkrete të banjave në FMK. Sikurse u theksua më lart, Trupi Gjykses ka marrë prova reciprokisht konfirmuese për ekzistencën e banjave dhe vendndodhjen e tyre, të cilat burojnë nga dëshmitë dhe deklaratat e viktimave që përshkruan rrethanat e ndalimit të tyre (TW4-01, W04733, W01448 dhe TW4-04), dhe nga dëshmia e z. Mark Shala, i cili kishte rol komandues në FMK. Gjithashtu Trupi Gjykses vuri re se disa dëshmitarë të Mbrojtjes (z. Hoxha, W04280 dhe z. Koçinaj) kishin motivin për të mohuar njohuritë për ekzistencën e ndonjë ndërtese që mund të zbulonte praktikën e ndalimit në FMK. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton konstatimin e vet se dëshmitarë të caktuar të Mbrojtjes shfaqën tendencë të fuqishme për të dhënë dëshmi të favorshme për z. Shala dhe/ose nuk kishin dëshirë të jepnin informacion që mund të çonte në përfundimin se disa anëtarë të UÇK-së kryen krime.<sup>539</sup> Duke mbajtur parasysh këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se nuk mund të jetë rastësi që shumica e dëshmitarëve të Mbrojtjes janë në gjendje të përcaktojnë me saktësi vendndodhjen e të gjitha ndërtesave në FMK, me përjashtim të vetëm të ndërtesës së ndalimit dhe banjave.<sup>540</sup> Për këtë arsye, dëshmitë që mohojnë se kishte banja apo se ku ndodheshin ato, nuk mund të dëmtojnë vlerën provuese të dëshmimeve që konfirmojnë ekzistencën dhe përdorimin e tyre.

325. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se banjat e vetme të përbashkëta në FMK gjendeshin në anën e djathtë të kompleksit, parë nga porta e hyrjes, dhe ishin jashtë dhe shumë afër ndërtesës së ndalimit, sikurse tregohet në skicën që vizatoi TW4-01.<sup>541</sup>

---

<sup>539</sup> *Shih* Pjesën V.H.13.

<sup>540</sup> *Shih skicën*: SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (e ruajtur si REG00954); skica 083525-083534 RED, f. 083525 (e ruajtur si REG00975); fotografia SPOE00330362-00330362 (e ruajtur si REG00977).

<sup>541</sup> Skica SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (e ruajtur si REG00954). Kjo skicë konfirmohet nga skicat 08816-108825 RED, f. 10882 (që e vizatoi **TW4-04**) dhe U003-2231-U003-2231-ET (që e vizatoi **W01448**).

326. *Përfundim.* Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se provat e paraqitura tregojnë qartë se FMK-ja ishte një kompleks i rrethuar me rrethojë, që kishte një oborr me disa ndërtesa përreth, ndër të cilat: (i) kabina e rojës, ndërtesa e komandës dhe kuzhina, në anën e majtë; (ii) magazina, drejtpërdrejt përballë portës; dhe (iii) ndërtesa e ndalimit dhe banjat, në anën e djathtë të kompleksit.

## 5. Planimetria e brendshme e ndërtesave në Fabrikën e Metalit në Kukës

327. Pasi ka përcaktuar planimetrinë e kompleksit të FMK-së, Trupi Gjykses tani i kthehet ekzaminimit të planimetrisë së brendshme të ndërtesave.

328. *Ndërtesa e komandës.* Sa i përket ndërtesës së komandës, Trupi Gjykses ka marrë dëshmi të qarta dhe reciprokisht konfirmuese, të cilat tregojnë se ndërtesa përbëhej prej dy kateve (kati përdhes dhe kati i parë), të lidhur me shkallë.<sup>542</sup> Në paragrafët vijues, Trupi Gjykses do të diskutojë dhomat në ndërtesën e komandës të cilat janë relevante për konstatimet e mëpasshme.

329. Sipas dëshmitarëve TW4-01, W04733 dhe W01448, në katin përdhes gjendej një dhomë e vogël e cila përdorej për ndalim (dhoma e ndalimit në ndërtesën e komandës).<sup>543</sup> Lloji konfirmues, përputhshmëria dhe përshkrimi i hollësishëm në dëshmitë dhe deklaratat e dëshmitarëve bindin Trupi Gjykses se ata ishin të sinqertë dhe të besueshëm në lidhje me ekzistencën dhe vendndodhjen e dhomës së vogël me tavan të ulët. Trupi Gjykses do të shqyrtojë kushtet e ndalimit të viktimave në lidhje

---

<sup>542</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2925, rreshtat 2-4; **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856.

<sup>543</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1471, rreshtat 2-11; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1915, rreshtat 9-17; **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016229; **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019829-SITF00019830; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013808-SPOE00013809; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 3, rreshtat 19-22.

me dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, në konstatimet faktike të tij (Pikat 2-3).<sup>544</sup>

330. Dëshmitë e dëshmitarëve TW4-01, W01448 dhe W04733 gjithashtu kanë bindur Trupin Gjykes për ekzistencën e një zyre e cila përdorej për t'i marrë në pyetje dhe keqtrajtuar të ndaluarit dhe e cila gjendej në korridorin e katit përdhes në ndërtesën e komandës (zyra).<sup>545</sup> Zyrat e tjera përdreshin për qëllime të tjera,<sup>546</sup> përfshirë për marrje në pyetje.<sup>547</sup> Përshkrimet e tyre janë bindëse dhe të pasura me hollësi dhe konfirmojnë njëra-tjetrën. Trupi Gjykes nuk gjen asnjë arsye për të vënë në dyshim vërtetësinë e përshkrimit të përvojave personale nga dëshmitarët. Trupi Gjykes do të shqyrtojë, ndër të tjera, në lidhje me zyrën në ndërtesën e komandës keqtrajtimin e pretenduar të viktimave, sikurse vlerësohet në konstatimet faktike më poshtë (Pikat 2-3).<sup>548</sup>

331. Së fundi, Trupi Gjykes mbështetet në prova të shumta, të qarta, reciprokisht konfirmuese dhe, rrjedhimisht, të mbështetshme, të cilat vërtetojnë se ka ekzistuar një infermieri në katin përdhes në ndërtesën e komandës,<sup>549</sup> ku ofrohej kujdesi mjekësor

---

<sup>544</sup> *Shih* Pjesën VI.E.1.

<sup>545</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1450, rreshti 4 deri në f. 1451, rreshti 23. Dëshmitari shënoi me rreth zyrën në fotografi 065597-065612, f. 065600 (në fund të fotografisë, ruajtur si REG00956); **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231; **W04733**: SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741, SITF00018746; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019832-SITF00019833; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013810-SPOE00013811, SPOE00013814.

<sup>546</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1412, rreshtat 5-11; **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1046, rreshtat 7-18; f. 1047, rreshtat 3-6; **z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2925, rreshtat 8-16; **z. Hoxha**: T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3181, rreshtat 11-14; **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856.

<sup>547</sup> *Shih* Pjesën VI.E.3.

<sup>548</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(b)-(e).

<sup>549</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1412, rreshtat 5-8, *i referohet* skicës SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (ruajtur si REG00954); **z. Hoxha**: T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3183, rreshti 23 deri në f. 3184, rreshti 11, *i referohet* fotografisë SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010279 (ruajtur si REG00983); f. 3188, rreshtat 8-22 (dëshmitari shënoi me numër 5 infermierinë në fotografinë SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010278 (ruajtur si REG00984)); T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3375,

nga së paku një mjek dhe një infermiere (infermiera).<sup>550</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se, përkundër një mospërputhjeje të vogël në dëshmitë e dëshmitarëve lidhur me katin në të cilin gjendej infermiera në fjalë,<sup>551</sup> nuk ndryshon vlerësimi nga Trupi Gjykses i mbështetshmërisë në prova sepse: (i) mospërputhja është e vogël; (ii) ka të bëjë me një aspekt të parëndësishëm; dhe (iii) të gjithë dëshmitarët e lartpërmendur konfirmuan ekzistencën dhe vendndodhjen e përgjithshme të zyrës në ndërtesën e komandës.

332. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se në ndërtesën e komandës gjendeshin, ndër të tjera: (i) dhoma e ndalimit në ndërtesën e komandës, një dhomë shumë e vogël e cila gjendej në katin e parë; (ii) zyra e cila gjendej në katin përdhes; dhe (iii) infermiera e cila gjendej gjithashtu në katin përdhes.

333. *Magazina*. Sa i takon planimetrisë së brendshme të magazinës, Trupi Gjykses ka marrë prova konfirmuese, të hollësishme dhe të mbështetshme të cilat zbulojnë se ajo përbëhej prej dy pjesëve kryesore, që në brendi lidheshin nga një derë, të cilat së bashku formonin një hapësirë të bashkuar me vetëm një hyrje.<sup>552</sup> Provat tregojnë se në një të pjesë mbaheshin kryesisht uniformat, ndërsa në pjesën tjetër mbahej ushqimi.<sup>553</sup>

---

rreshtat 6-13 (dëshmitari shënoi me numër 4 infermierinë në fotografinë SPOE00330362-00330362 RED (ruajtur si REG00994)); **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1047, rreshtat 9-13.

<sup>550</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1412, rreshti 7; T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1451, rreshtat 12-13; **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1047, rreshtat 7-13; **z. Dervishaj**: T. 2 tetor 2023, publik, f. 2750, rreshti 23 deri në f. 2751, rreshti 1; **z. Koçinaj**: T. 3 tetor 2023, publik, f. 2834, rreshtat 18-23; **z. Hoxha**: T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3183, rreshti 23 deri në f. 3184, rreshti 2; T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3375, rreshti 21 deri në f. 3376, rreshti 10; **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185343; **z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar RED), f. 46, rreshti 7 deri në f. 47, rreshti 26.

<sup>551</sup> TW4-10, në kundërshtim me TW4-01-shin dhe z. Hoxha, thotë se ishte në katin e parë në ndërtesën e komandës.

<sup>552</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshti 19 deri në f. 1410, rreshti 4; f. 1411, rreshti 20 deri në f. 1412, rreshti 4, *i referohet* skicës SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (ruajtur si REG00954); **z. Koçinaj**: T. 3 tetor 2023, publik, f. 2867, rreshti 13 deri në f. 2868, rreshti 16 (dëshmitari shënoi me numër 1 hyrjen në magazinë në fotografinë SPOE00330362-00330362 (ruajtur si REG00968-REG00968)); **z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2956, rreshti 20 deri në f. 2957, rreshti 1, *i referohet* skicës 083525-083534 RED, f. 083525.

<sup>553</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshti 19 deri në f. 1410, rreshti 4; **z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2956, rreshti 20 deri në f. 2957, rreshti 3; *Shih gjithashtu*, skicën SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (ruajtur si REG00954).

Trupi Gjykses ka marrë gjithashtu prova se në objektin e FMK-së ruheshin dhe riparoheshin armë, megjithëse dëshmitë e dëshmitarëve identifikojnë hapësira të ndryshme për magazinim.<sup>554</sup>

334. *Ndërtesa e ndalimit*. Së fundi, sa i takon planimetrisë së brendshme të ndërtesës së ndalimit, provat që dhanë dëshmitarët TW4-01, W01448 dhe TW4-04 zbulojnë se ndërtesa njëkatëshe përbëhet prej tri dhomave (dhoma 1, dhoma 2 dhe dhoma 3) dhe një korridor.<sup>555</sup> Dëshmitë e dëshmitarëve janë të hollësishme dhe të qarta dhe rrjedhimisht, Trupi Gjykses u ka kushtuar peshë të konsiderueshme në vlerësimin e tij. Si rezultat, Trupi Gjykses është bindur nga përshkrimet e lartpërmendura të ndërtesës së ndalimit.

## 6. Përfundim

335. Bazuar në tërësinë e provave të vlerësuara më lart, Trupi Gjykses është bindur se baza e UÇK-së në FMK, sikurse përshkruhet në paragrafët e mëparshëm, përputhet me objektin e përmendur në Aktakuzën e Konfirmuar, si vendngjarja e krimeve të paraqitura në akuza. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të bëjë konstatimin në lidhje me akuzat e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme (Pikat 1-4) duke iu referuar FMK-së si kuadër gjeografik të vërtetuar të akuzave për krime të ngritura kundër z. Shala. Brenda FMK-së janë dy ndërtesa veçanërisht relevante për akuzat në këtë çështje gjyqësore: (i) ndërtesa e ndalimit, ku përfshiheshin dhoma 1

---

<sup>554</sup> **z. Hoxha**: T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3367, rreshtat 3-6, *i referohet* fotografisë SPOE00330362-00330362 RED (ruajtur si REG00994); f. 3371, rreshti 1 deri në f. 3373, rreshti 21; **z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2952, rreshti 17 deri në f. 2953, rreshti 2, *i referohet* fotografisë 083525-083534 RED, f. 083527 (ruajtur si REG00974); **z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 2 Revised (Pjesa 2, e rishikuar), f. 5, rreshtat 1-3; f.10, rreshtat 8-15.

<sup>555</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1420, rreshtat 5-9; T. 30 maj 2023, publik, f. 1421, rreshtat 14-24; f. 1428, rreshtat 14-17 (në të tri fragmentet përmendet skica SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (ruajtur si REG00954), ku dëshmitari shënoi me numrat 1, 2 dhe 3 tri dhomat në ndërtesën e ndalimit); f. 1426, rreshti 14 deri në f. 1427, rreshti 6, *i referohet* skicës 059118-059144 RED2, f. 059119 (ruajtur si REG00955); **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; **TW4-04**: 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 4, rreshtat 6-19; f. 7, rreshti 13 deri në f. 8, rreshti 3.



dhe dhoma 3, ku mbaheshin të ndaluarit dhe dhoma 2 e cila përdorej për marrje në pyetje dhe keqtrajtim; dhe (ii) ndërtesa e komandës, ku përfshihej dhoma e ndalimit në ndërtesën e komandës, e cila përdorej për të mbajtur disa të ndaluar për një kohë të shkurtër para se të transferoheshin në dhomën e ndalimit, dhe zyra e cila përdorej për marrje në pyetje dhe keqtrajtim.

### C. MBAJTJA NË NDALIM NGA UÇK-JA NË FMK

336. Më poshtë, Trupi Gjykes do të diskutojë përdorimin prej UÇK-së të objektit të ndalimit në FMK, duke u përqendruar në: (i) detyrat dhe përgjegjësitë e policisë ushtarake të UÇK-së (përfshirë deklaratat e z. Shala në lidhje me të); (ii) personat e pranishëm në FMK gjatë periudhës relevante dhe të përfshirë në arrestimin, transferimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve; (iii) anëtarësinë e tyre në UÇK, funksionin dhe rolet në FMK; dhe (iv) strukturën sipas së cilës funksiononin ata. Duke mbajtur parasysh se FMK-ja funksiononte edhe si shtab për rekrutim, mobilizim dhe logjistikë,<sup>556</sup> Trupi Gjykes do të përqendrohet vetëm në ata anëtarë të UÇK-së të cilët kryen funksione në lidhje me ndalimin dhe keqtrajtimin e personave në FMK.

337. *Detyrat dhe përgjegjësitë e policisë ushtarake të UÇK-së.* Sikurse u shpjegua më lart, pasi z. Shala u caktua komandant/oficer në policinë ushtarake të UÇK-së në Jabllanicë, në pranverë të vitit 1998, ai mori Rregulloren e UÇK-së, në të cilën përcaktoheshin detyrat dhe përgjegjësitë e policisë ushtarake të UÇK-së.<sup>557</sup> Në këto detyra dhe përgjegjësi, ndër të tjera, përfshiheshin:

- (i) përgjegjësia për të [...] hetuar dhe zbuluar me fakte të bindshme të gjithë ata persona të cilët në çfarëdo mënyre bashkëpunojnë me armikun; dhe

---

<sup>556</sup> *Shih* para. 306-307 më lart.

<sup>557</sup> *Shih* para. 286 më lart.

- (ii) obligimi për të [...] marrë masa ndaj të gjithë atyre që punojnë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.<sup>558</sup>

338. Rregullorja thotë gjithashtu se anëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së duhet të pajisen me tesha të policisë ushtarake dhe duhet të shërbejnë si roje në vendet ku ata veprojnë.<sup>559</sup> Në deklaratat e dhëna në vitet 2005 dhe 2019, z. Shala shpjegoi se policia ushtarake e UÇK-së, në fakt, nuk kishte të njëjtën uniformë (të kamuflimit) sikurse ushtarët e rregullt, por kishte uniformë të zezë me emblemë të UÇK-së dhe të policisë ushtarake.<sup>560</sup> Siç u përmend më lart, ai kujtoi qartë se pasi u caktua në policinë ushtarake, ai u pajis me uniformë të zezë, në vend të uniformës së kamuflimit.<sup>561</sup> Ai shtoi se më vonë uniforma e zezë “është bërë në modë”.<sup>562</sup>

339. Z. Shala shpjegoi gjithashtu se, me kalimin e kohës, Rregullorja e vitit 1998 u bë “pothuajse zyrtarisht” dhe mbeti në fuqi, megjithëse pati disa ndryshime.<sup>563</sup> Ai shtoi se policia ushtarake e UÇK-së u bë më e strukturuar dhe rekrutoi ish-policë dhe ish-gjykatës në radhët e saj.<sup>564</sup> Z. Shala nuk dha periudhë kohore të qartë se kur u bë më e organizuar policia ushtarake UÇK-së, por deklaroi se kjo ndodhi “gjatë luftës”.<sup>565</sup>

340. Trupi Gjykes konstaton se deklaratat e z. Shala në lidhje me policinë ushtarake të UÇK-së janë të besueshme dhe të mbështetshme meqë: (i) ai dha informacionin pa iu kërkuar; (ii) Rregullorja e UÇK-së e konfirmon atë (*p.sh.* se policia ushtarake kishte tjetër uniformë); dhe (iii) aspekte të caktuara të deklaratave të tij (*p.sh.* në lidhje me përdorimin e uniformave të zeza ose rekrutimin e ish-policëve dhe ish-gjykatësve)

---

<sup>558</sup> **Dokumenti:** U009-9397-U009-9397-ET Revised (E rishikuar), pikat 3 dhe 4.

<sup>559</sup> **Dokumenti:** U009-9397-U009-9397-ET Revised (E rishikuar), pikat 9 dhe 10.

<sup>560</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti në shqip dhe anglisht-3 - B, f. 23-24; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 87-88.

<sup>561</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 82-83.

<sup>562</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 87-88.

<sup>563</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 102-103.

<sup>564</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 114-115.

<sup>565</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 114-115.

konfirmohen nga dëshmitarë në këtë çështje gjyqësore sikurse tregohet më poshtë. Z. Shala konfirmoi gjithashtu autenticitetin e Rregullores së UÇK-së, duke thënë se: (i) kishte vulën e UÇK-së, për të cilën ai dinte se përdorej në atë kohë, e cila në fakt duket në Rregullore;<sup>566</sup> dhe (ii) ai mori versionin origjinal gjatë kohës kur ishte në UÇK në vitin 1998.<sup>567</sup> Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjyqësor është bindur se deklaratat e z. Shala të viteve 2005 dhe 2019 në lidhje me policinë ushtarake të UÇK-së janë të besueshme dhe se rregullorja e UÇK-së e vitit 1998 është autentike dhe vendos të mbështetet në këtë material.

341. *Anëtarët e UÇK-së që merreshin me të ndaluarit në FMK.* TW4-01, TW4-11, W04733, W01448, TW4-02, TW4-04 dhe TW4-05, të cilët u mbajtën të ndaluar në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat,<sup>568</sup> dhanë dëshmi lidhur me identitetet e personave të cilët i arrestuan, transferuan, morën në pyetje dhe/ose i keqtrajtuan. Ata identifikuan, ndër të tjerë, personat në vijim me emër ose me pseudonim: Sabit Gecin, Xhemshit Krasniqin, z. Shala ose Ujkun, z. Kryeziu, Sokol Dobrunën, Fatmir Limajn, Bedriun dhe Van Damin.<sup>569</sup> Trupi Gjyqësor do t'i diskutojë me radhë.

342. *Sabit Geci.* Trupi Gjyqësor ka bërë konstatim gjyqësor të faktit të shqyrtuar në procese të tjera se Sabit Geci ishte anëtar i lartë i UÇK-së që kishte rol komandues dhe kishte pushtet dhe kontroll mbi vartësit e tij.<sup>570</sup>

---

<sup>566</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 1 Revised 1 (Pjesa 1, e rishikuar 1), f. 33-34; *shih* versionin origjinal në shqipe: 066856-066862, f. 066856.

<sup>567</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 1 Revised 1 (Pjesa 1, e rishikuar 1), f. 33-34.

<sup>568</sup> *Shih* Pjesën VI.D më poshtë në lidhje me konstatimin e Trupit Gjyqësor se TW4-01, TW4-11, W04733, W01448, TW4-02, TW4-04 dhe TW4-05 u mbajtën të ndaluar në mënyrë arbitrare në FMK gjatë periudhës që ka lidhje me akuzat.

<sup>569</sup> *Shih* Pjesët VI.D, VI.E dhe VI.F më poshtë.

<sup>570</sup> [List of Adjudicated Facts](#), (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), Fakti i Shqyrtuar 59.

343. Trupi Gjykses mori dëshmi reciprokisht konfirmuese edhe nga TW4-01,<sup>571</sup> W01448,<sup>572</sup> TW4-05<sup>573</sup> dhe z. Kryeziu<sup>574</sup>, se Sabit Geci kishte pozitë të lartë në UÇK dhe se kishte pushtet mbi anëtarët e UÇK-së të cilët morën në pyetje dhe keqtrajtuat të ndaluarit në FMK. TW4-01 dha dëshmi se Sabit Geci kishte pushtet të përgjithshëm: “Po kur ka qenë Sabiti aty, ai a kanë kryesori. Se s’kanë guxu me ja luajt asnjëni.” Ai dha dëshmi gjithashtu se të gjithë merrnin urdhra nga Sabit Geci, përfshirë Xhemshit Krasniqin.<sup>575</sup>

344. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka marrë dëshmi nga TW4-10 se Sabit Geci ishte “komandant i policisë i Hashim Thaçit”.<sup>576</sup> W01448 konfirmoi se Sabit Geci ishte “shefi i policisë ushtarake” dhe kujtoi se ai gjithnjë e shihte atë të veshur me uniformë të policisë ushtarake të UÇK-së.<sup>577</sup> TW4-05 tha se – përveç Xhemshit Krasniqit – Sabit Geci ishte “në shërbimin e sigurimit të UÇK-së”, megjithëse ai (vetëm) kishte dëgjuar nga ushtarë, por nuk ishte i sigurt.<sup>578</sup>

<sup>571</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1530, rreshtat 1-8; f. 1559, rreshtat 17-21; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1928, rreshti 18 deri në f. 1930, rreshti 9 (TW4-01 dëshmoi se Sabit Geci sillej si epror ndaj atyre të cilët e morën në pyetje dhe keqtrajtuat dhe e përshkruan si “baba”. Ai tha gjithashtu se Sabit Geci ishte i plotfuqishëm).

<sup>572</sup> **W01448:** SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013836, SITF00013838; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743, SITF00013745, SITF00013763; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231-00016232, SITF00016234; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016148 (W01448 tha se Sabit Geci ishte komandant “shumë i lartë” dhe atij i kujtohet qartë se rrahjet përfunduan kur ai u tha të tjerëve: “mjaf tani”).

<sup>573</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372502, SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013132, SITF00013134 (TW4-05 kujtoi se Sabit Geci kishte rang të lartë dhe “shumë kompetenca [...] ndaj të gjithë të burgosurve”).

<sup>574</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014098; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016918 (z. Kryeziu shpjegoi se Sabit Geci ishte epror dhe se ai vetë ishte vartës i Sabit Gecit dhe Xhemshit Krasniqit).

<sup>575</sup> **TW4-01:** T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1929, rreshti 24 deri në f. 1930, rreshti 9.

<sup>576</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1106, rreshti 21 deri në f. 1107, rreshti 5.

<sup>577</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857, SITF00013864.

<sup>578</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372502; SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013132.

345. Bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se, gjatë periudhës që lidhet me akuzat, Sabit Geci ishte anëtar i rangut të lartë i UÇK-së, i cili kishte rol komandues dhe pushtet të përgjithshëm mbi vartësit e tij dhe veçanërisht mbi anëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së të përfshirë në arrestimin, transferimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK, përfshirë mbi Xhemshit Krasniqin.<sup>579</sup>

346. *Xhemshit Krasniqi*. Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor të faktit të shqyrtuar në procese të tjera se Xhemshit Krasniqi kishte pozitë me pushtet në FMK.<sup>580</sup>

347. Trupi Gjykses ka marrë gjithashtu dëshmi reciprokisht konfirmuese nga TW4-01,<sup>581</sup> TW4-10<sup>582</sup>, W01448<sup>583</sup> dhe TW4-05<sup>584</sup> se Xhemshit Krasniqi ishte komandant në UÇK dhe ishte përgjegjës për objektin e ndalimit dhe të ndaluarit në FMK. TW4-01 shpjegoi se, megjithëse Xhemshit Krasniqi merrte urdhra nga Sabit Geci, ishte ai i cili vizitonte më së shpeshti të ndaluarit.<sup>585</sup> Dëshmia e tij në lidhje me këtë aspekt përforcohet nga z. Kryeziu, i cili shpjegoi se Xhemshit Krasniqi ishte më shumë i pranishëm në FMK sesa Sabit Geci.<sup>586</sup> Dëshmitë e të dy dëshmitarëve konfirmohen fuqimisht nga disa dëshmitarë të cilët identifikuan Xhemshit Krasniqin si anëtari i (një

---

<sup>579</sup> Nga deklaratat e dëshmitarit, kur përshkruan funksionet e Sabit Gecit, del se pushteti i tij shtrihet përtej FMK-së.

<sup>580</sup> [List of Adjudicated Facts](#), (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), Fakti i Shqyrtuar 60.

<sup>581</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1530, rreshtat 1-8; f. 1559, rreshtat 16-21; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1929, rreshtat 17-23.

<sup>582</sup> **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1068, rreshtat 10-16; f. 1104, rreshtat 20-23 (ku përshkruan Xhemshit Krasniqin si “komandant”).

<sup>583</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013860; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013838; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743, SITF00013763; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016148 (ku përshkruan Xhemshit Krasniqin si “komandant”).

<sup>584</sup> **TW4-05**: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013134 (kur kujtoi se Xhemshit Krasniqi kishte pozitë me pushtet kundrejt të ndaluarve në FMK).

<sup>585</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1530, rreshtat 1-8; f. 1559, rreshtat 16-21; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1929, rreshti 17 deri në f. 1930, rreshti 9.

<sup>586</sup> **Z. Kryeziu**: SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014098.

prej anëtarëve të) UÇK-së që arrestuan, morën në pyetje dhe/ose keqtrajtuan ata,<sup>587</sup> çka tregon se ai ishte rregullisht i pranishëm në FMK.

348. Krahas kësaj, Trupi Gjykses ka marrë prova reciprokisht konfirmuese nga W04733, TW4-02 dhe TW4-04 se Xhemshit Krasniqi ishte anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së.<sup>588</sup> TW4-02 shtoi se ai e dinte këtë sepse Xhemshit Krasniqi në krah mbante emblemën e policisë ushtarake të UÇK-së.<sup>589</sup> Ky aspekt i dëshmisë së TW4-02-shit konfirmohet nga z. Shala, i cili në deklaratat më 2005 dhe 2019 shpjegoi se anëtarët e policisë ushtarake mbanin emblemën e policisë ushtarake në pjesën e sipërme të krahut.<sup>590</sup> Gjithashtu, TW4-05 tha se ishte arrestuar nga dy burra të veshur me uniforma të zeza [REDAKTUAR].<sup>591</sup>

349. Bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se, gjatë periudhës që lidhet me akuzat, Xhemshit Krasniqi ishte anëtar i lartë i policisë ushtarake të UÇK-së dhe mbante pozitë me pushtet në FMK, si person (drejtpërdrejt) përgjegjës për të ndaluarit dhe objektin e ndalimit atje.

350. Z. Shala. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm se z. Shala ishte anëtar i UÇK-së gjatë periudhës që lidhet me akuzat.<sup>592</sup> Trupi Gjykses diskuton praninë e tij në FMK, pozitën dhe rolin në Pjesët H dhe I të Aktgjykimit.

351. Osman Kryeziu. Trupi Gjykses rikujton se para periudhës që lidhet me akuzat z. Kryeziu punoi si prokuror në Prishtinë, deri në vitin 1990.<sup>593</sup> Sipas deklaratave të tij, Xhemshit Krasniqi e kontaktoi z. Kryeziu nga fundi i prillit 1999 për t'iu bashkuar

---

<sup>587</sup> [REDAKTUAR].

<sup>588</sup> **W04733:** U003-2283-U003-2289 RED2, f. U003-2284; **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 21, rreshti 23 deri në f. 22, rreshti 10; **TW4-04:** SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014694.

<sup>589</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 21-22.

<sup>590</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht-3-B, f. 23-24; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 87-88.

<sup>591</sup> **TW4-05:** SITF00013125-SITF00013153, RED, f. SIFT00013125.

<sup>592</sup> *Shih* para. 293 më lart.

<sup>593</sup> *Shih* para. 203 më lart.

UÇK-së.<sup>594</sup> Z. Kryeziu shpjegoi se ai ishte i vendosur në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, ku ai kishte një zyrë dhe për detyrë kishte kryerjen e intervistave.<sup>595</sup> Megjithëse, z. Kryeziu tha se ai trajtonte (kryesisht) rastet kur anëtarë të UÇK-së akuzoheshin për dezertim,<sup>596</sup> ai pranoi se kishte dijeni për disa persona të akuzuar për bashkëpunim me autoritetet serbe dhe se ai vetë mori në pyetje TW4-04-ën dhe [REDAKTUAR],<sup>597</sup> për të cilin Trupi Gjykses mendon se është TW4-11.<sup>598</sup>

352. Pranimet e (pjeshme) të z. Kryeziu konfirmohen nga TW4-11, TW4-04 dhe TW4-02 të cilët kujtuan se z. Kryeziu i mori në pyetje kur ishin të ndaluar në FMK.<sup>599</sup> Deklaratat e z. Kryeziu se Xhemshit Krasniqi e kontaktoi në prill 1999 për t'iu bashkuar UÇK-së mbështeten edhe nga deklaratat e z. Shala e vitit 2019, se ndërsa bëhej më e strukturuar, policia ushtarake e UÇK-së rekrutoi ish-policë dhe gjykatës në radhët e veta.<sup>600</sup>

353. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses konstaton se z. Kryeziu ishte anëtar i UÇK-së, i cili punonte me policinë ushtarake të UÇK-së, që gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat ishte i vendosur në FMK dhe kishte për detyrë marrjen në pyetje të të ndaluarve.

---

<sup>594</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014093; *shih gjithashtu*, f. SITF00014097-00014098, ku konfirmon se i referohet Xhemshit Krasniqi; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016912. Sa i takon periudhës se kur iu bashkua z. Kryeziu UÇK-së, *shih* SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014093; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016912, ku thotë se iu bashkua UÇK-së pasi anëtarët e UÇK-së shkuan në Burrel për stërvitje. *Shih gjithashtu*, konstatimin e Trupit Gjykses në para. 860 më poshtë, se kjo ndodhi (më së herëti) nga mesi i prillit 1999.

<sup>595</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014095-96, SITF00014099; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016912-14.

<sup>596</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014095-96; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016913-14.

<sup>597</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014096, SITF00014100-101; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016916-17.

<sup>598</sup> *Shih* para. 164 më lart.

<sup>599</sup> *Shih* para. 433-437, 529-530, 552-555.

<sup>600</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 114-115.

354. *Sokol Dobruna*. W04733 e përshkroi Sokol Dobrunën si “gjykatës” ose “prokuror”, i cili e mori në pyetje gjatë mbajtjes në ndalim në FMK. W04733 përmendi se marrja në pyetje u krye në zyrën në ndërtesën e komandës.<sup>601</sup>

355. Dëshmia e W04733-shit mbështetet nga deklaratat e z. Kryeziu, i cili pohoi se ai nuk ishte i vetmi që kryente intervistat, por ishin pesë a gjashtë të tjerë të cilët bënë të njëjtën punë dhe se ata ndanin një zyrë në FMK.<sup>602</sup>

356. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses është bindur se Sokol Dobruna ishte anëtar i UÇK-së, i cili – sikurse z. Kryeziu – luajti rol në marrjen në pyetje të të ndaluarve në FMK.

357. *Fatmir Limaj, Bedriu dhe Van Dami*. Duke iu referuar dëshmisë së TW4-10-s se Fatmir Limaj ishte komandant në UÇK,<sup>603</sup> Trupi Gjykses është bindur se edhe ai ishte anëtar i UÇK-së. Sa u përket Bedriut dhe Van Damit, Trupi Gjykses thekson se ata ishin pjesë e një grupi, të cilët në raste të ndryshme së bashku me z. Shala dhe/ose Xhemshit Krasniqin, keqtrajtuuan [REDAKTUAR].<sup>604</sup> Duke pasur parasysh se ata vepronin së bashku me z. Shala dhe/ose Xhemshit Krasniqin – të cilët ishin anëtarë të UÇK-së në periudhën përkatëse – Trupi Gjykses është bindur se edhe Bedriu edhe Van Dami ishin anëtarë të UÇK-së gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

358. *Anëtarë (të tjerë) të policisë ushtarake të UÇK-së*. Sikurse shtjellohet hollësisht në Pjesët VI.D dhe VI.E të Aktgjykimit, anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së – ndër të cilët Xhemshit Krasniqi – u përfshinë në arrestimin, transferimin dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK. Për shembull, TW4-01 shpjegoi se personat të cilët e arrestuan kishin të veshur rroba me emblemë të policisë ushtarake të UÇK-së.<sup>605</sup> W04733 tha se dy personat të cilët e arrestuan patën të veshur uniformë të zezë, e cila mbante

---

<sup>601</sup> [REDAKTUAR].

<sup>602</sup> **Z. Kryeziu**: SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014096, SITF00014099.

<sup>603</sup> **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1104, rreshtat 20-25.

<sup>604</sup> [REDAKTUAR].

<sup>605</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1418, rreshtat 11-17.



emblemën e UÇK-së, dhe u prezantuan si anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së.<sup>606</sup> TW4-05 dha dëshmi gjithashtu se personat të cilët e arrestuan dhe transferuan në FMK kishin të veshur uniformë të zezë me emblemë të UÇK-së, duke shtuar se “mi kanë treguar ID e UÇK-së”.<sup>607</sup> Të dy, W01448 dhe W04733 identifikuan disa autorë të keqtrajtimit të tyre si anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së, përmes uniformave të zeza të tyre, “të njëjta sikur ato që kishin veshur policia speciale [e UÇK-së]”.<sup>608</sup> Gjithashtu, W01448 dha dëshmi se personat të cilët keqtrajtuan atë dhe të ndaluarit e tjerë vepruan nën pushtetin dhe sipas urdhrave të Xhemshit Krasniqit.<sup>609</sup>

359. Dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur konfirmohen nga Rregullorja e UÇK-së, e cila përcaktonte se detyrat dhe përgjegjësitë e policisë ushtarake të UÇK-së, ndër të tjera, ishin “të hetojë dhe zbulojë [...] gjithë individët që bashkëpunojnë [...] me armikun” dhe të marrë masa kundër të gjithë atyre që punojnë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.<sup>610</sup> Sikurse jepet në hollësi në Pjesën VI.D, të ndaluarit në FMK u veçuan dhe arrestuan sepse mendohej se ishin “bashkëpunëtorë” të autoriteteve serbe, “spiuna”, “tradhtarë”, simpatizantë të Serbisë, ose se nuk i përkrahnin mjaftueshëm përpjekjet e UÇK-së.<sup>611</sup>

---

<sup>606</sup> **W04733:** SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013805.

<sup>607</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013132.

<sup>608</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013744, SITF00013753; **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013826; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 30, rreshtat 16-19. **W01448** shpjegoi në disa deklaratatë të tij se anëtarët e policisë ushtarake (ose policisë speciale) të UÇK-së mbanin veshur uniforma të zeza; *shih* SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013742, SITF00013744; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856.

<sup>609</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231-00016232; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013836, SITF00013838; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743, SITF00013745; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

<sup>610</sup> **Dokumenti:** U009-9397-U009-9397-ET Revised (I rishikuar), pikat 3 dhe 4.

<sup>611</sup> *Shih gjithashtu*, para. 590 më poshtë.

360. *Anëtarë (të tjerë) të UÇK-së.* Sikurse shtjellohet në Pjesën VI.E të Aktgjykimit, të ndaluarit në FMK u keqtrajtuuan dhe nga anëtarë të ndryshëm (të tjerë) të UÇK-së, disa prej të cilëve ishin të panjohur për të ndaluarit.<sup>612</sup>

361. Trupi Gjykses ka marrë gjithashtu prova nga TW4-11 dhe W04733, sipas të cilëve personat të cilët i keqtrajtuuan ndonjëherë ishin të veshur me rroba civile.<sup>613</sup> Provat e paraqitura Trupit Gjykses tregojnë se, në fakt, anëtarët e UÇK-së ndonjëherë ishin të veshur me rroba civile (përfshirë ata me pozita të larta, si Xhemshit Krasniqi).<sup>614</sup> Kjo vërtetohet nga z. Shala,<sup>615</sup> si dhe nga dëshmitarë të tjerë, konkretisht TW4-11,<sup>616</sup> TW4-10,<sup>617</sup> W01448<sup>618</sup> dhe W04733.<sup>619</sup>

362. Trupi Gjykses ka marrë gjithashtu prova se anëtarë të UÇK-së të cilët ktheheshin nga fronti, ngacmonin të ndaluarit nga dritaret e ndërtesës së ndalimit ose u hynin në dhomë gjatë natës dhe i keqtrajtonin.<sup>620</sup> Kjo i tregon Trupit Gjykses se, në FMK, çdokush lejohej të keqtrajtonte të ndaluarit dhe se përgjegjësit e lejuan këtë.

363. *Përfundim.* Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Sabit Geci dhe (më drejtpërdrejt) Xhemshit Krasniqi ishin përgjegjës për të ndaluarit në FMK. Anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së luajtën rol parësor në arrestimin, transferimin dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së. Përfundimisht, personat të cilët krijuan dhe mbajtën kushtet e ndalimit në

---

<sup>612</sup> *Shih, për shembull,* para. 641-642, 645, 653 më poshtë.

<sup>613</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1231, rreshtat 9-14; f. 1233, rreshtat 19-23; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 30, rreshtat 16-19.

<sup>614</sup> **TW4-10:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1167, rreshtat 3-5; f. 1187, rreshtat 21-24.

<sup>615</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht-3 - B, f. 32.

<sup>616</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1187, rreshtat 21-24.

<sup>617</sup> **TW4-10:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1167, rreshtat 3-5; f. 1187, rreshtat 21-24.

<sup>618</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016234; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013855.

<sup>619</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013809.

<sup>620</sup> *Shih* para. 604 më poshtë.

FMK, ndër të cilët Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi, z. Shala, z. Kryeziu, Sokol Dobruna, Fatmir Limaj, Bedriu dhe Van Dami, që të gjithë ishin anëtarë të UÇK-së.

D. NDALIMI ARBITRAR (PIKA 1)

1. Vërejtje paraprake

364. Në këtë pjesë, Trupi Gjykses do të vlerësojë provat dhe bëjë konstatime faktike në lidhje me Pikën 1 të Aktakuzës së Konfirmuar, nëse së paku nëntë personave<sup>621</sup> iu hoq liria pa proces ligjor të rregullt nga z. Shala dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi dhe anëtarët e UÇK-së me nofkat Bedri dhe Van Dam, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, në FMK.<sup>622</sup>

365. Kur është e mundur, Trupi Gjykses do të bëjë konstatime për secilin të ndaluar veç e veç dhe do të diskutojë: (i) datën dhe rrethanat e arrestimit të parë; (ii) vendin e ndalimit në FMK; (iii) praninë dhe identifikimin e të ndaluarve të tjerë; (iv) rrethanat e lirimit; dhe (v) garancitë procedurale gjatë mbajtjes në ndalim.

366. [REDAKTUAR].<sup>623</sup>

367. Së dyti, Trupi Gjykses vë në dukje se akuzat që lidhen me Pikën 1 (si dhe ato që lidhen me Pikat 2 dhe 3) kanë kuadër kohor specifik, konkretisht afërsisht midis 17 majit dhe 9 qershorit 1999.<sup>624</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses mund të analizojë pretendime ose rrethana faktike jashtë kuadrit kohor të akuzave, në qoftë se ato janë relevante për të vendosur mbi aspekte të cilat përfshihen në kuadrin kohor, sikurse arrestimi për

---

<sup>621</sup> Trupi Gjykses përdor formulimin “së paku nëntë persona” në Aktgjykim, edhe pse identifikon më shumë të ndaluar, meqë kjo pasqyron akuzat e paraqitura nga ZPS-ja dhe të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar. Shih [Confirmed Indictment](#), (Aktakuza e Konfirmuar) para. 14.

<sup>622</sup> [Confirmed Indictment](#), (Aktakuza e Konfirmuar) para. 14-17, 31.

<sup>623</sup> [REDAKTUAR].

<sup>624</sup> [Confirmed Indictment](#), (Aktakuza e Konfirmuar), para. 14-17, 18-25, 26-27, 31.

herë të parë i personave të cilët më pas u mbajtën të ndaluar, ose lirimi i mëpasshëm i tyre. Kjo vlen dhe për pretendime ose rrethana faktike të cilat nuk përfshihen në kuadrin gjeografik të akuzave. Gjithashtu, Trupi Gjykses mund ta përdorë këtë informacion për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit ose për të kuptuar kontestin.<sup>625</sup>

## 2. TW4-01

### (a) Mbërritja në FMK

368. TW4-01 dha dëshmi se ai mbërriti në FMK [REDAKTUAR] maj 1999 [REDAKTUAR]<sup>626</sup> - fakte të cilat Mbrojtja nuk i kundërshton. Sipas dëshmitarit, TW4-01 [REDAKTUAR] kishin për qëllim t'i bashkoheshin UÇK-së, pasi [REDAKTUAR] i dëbuan [REDAKTUAR].<sup>627</sup> TW4-01 tha se [REDAKTUAR] e çoi në FMK, [REDAKTUAR], që asokohe ishte anëtar i UÇK-së.<sup>628</sup>

369. Sipas TW4-01-shit, që ditën e parë ai e pa z. Shala në FMK, të cilin e njohte nga e kaluara dhe i cili e përshëndeti dhe bëri shaka me të.<sup>629</sup> Në lidhje me këtë takim, TW4-01 deklaroi "Po jena përshëndetë edhe jena përqafe si i thojnë të tjerët, kena bo hajgare, muhabet. Nuk e kam pritë se më vjen diçka e rrezikshme, q'ishtu. Mu ka duk e pamundshme".<sup>630</sup> TW4-01 dëshmoi se ai i kaloi tri ditë [REDAKTUAR] në

<sup>625</sup> [Mustafa Trial Judgment](#), (Aktgjykimi *Mustafa*) para. 346.

<sup>626</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1388, rreshtat 17-24; f. 1395, rreshti 5 deri në f. 1402, rreshti 22.

<sup>627</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1387, rreshti 21 deri në f. 1397, rreshti 11; në lidhje me mbërritjen, *shih* f. 1396, rreshti 24 deri në f. 1397, rreshti 3; në lidhje me datën e saktë, *shih* T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1388, rreshtat 22-24. [REDAKTUAR].

<sup>628</sup> [REDAKTUAR].

<sup>629</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1407, rreshti 11 deri në f. 1408, rreshti 16. *Shih gjithashtu* deklaratën e z. **Shala**, e cila konfirmon dëshminë e TW4-01-shit se ata njiheshin me njëri-tjetrin që para lufte, 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 149-150.

<sup>630</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1408, rreshtat 14-16.

magazinën e FMK-së, ndërsa prisnin që UÇK-ja ishin “tuj verifiku për ne”.<sup>631</sup> TW4-01 përmendi se gjatë asaj periudhe, ai kaloi kohën duke luajtur letra me z. Shala, se z. Shala fjeti në magazinë së paku dy ose tri net dhe se z. Shala hynte dhe dilte nga FMK-ja.<sup>632</sup>

370. Dëshmia e TW4-01-shit në lidhje me këtë aspekt, konfirmohet nga TW4-10, i cili shërbente si roje te porta,<sup>633</sup> dhe i cili e pa z. Shala kur mbërriti në FMK, [REDAKTUAR].<sup>634</sup> Ai gjithashtu kujtoi se z. Shala hynte dhe dilte nga FMK-ja pa kërkuar leje nga askush.<sup>635</sup> Rrjedhimisht, dëshmia e tij e bën të besueshëm përkrimin e TW4-01-shit dhe anasjelltas.

371. Mbrojtja kundërshton vërtetësinë e dëshmisë së TW4-01-shit në lidhje me, ndër të tjera, se kush e solli në FMK. Konkretisht, Mbrojtja pretendon se, ndërsa TW4-01 në deklaratat e mëparshme kishte thënë se ishte [REDAKTUAR] që [REDAKTUAR] çoi atë, [REDAKTUAR] në FMK, në një bisedë telefonike me ZPS-në më 2021, disa ditë pas arrestimit të z. Shala në Belgjikë, TW4-01 implikoi z. Shala si personin i cili e kishte çuar në FMK.<sup>636</sup> Gjithashtu, Mbrojtja pretendon se ekzistonte marrëveshje midis TW4-01-shit dhe [REDAKTUAR].<sup>637</sup>

372. Së pari, sa i takon aspektit nëse TW4-01 tentoi të implikonte z. Shala apo jo, Trupi Gjyqësor thekson se TW4-01 dëshmoi qartë se ishte [REDAKTUAR] që [REDAKTUAR]

---

<sup>631</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1403, 1407, 1411, 1413-1414, 1417-1418. Dëshmitari shënoi magazinën me shkronjën B në skicën e tij SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (ruajtur si REG00954).

<sup>632</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1407, rreshti 18 deri në f. 1408, rreshti 16; T. 30 maj 2023, publik, f. 1413, rreshtat 18-23; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1931, rreshti 1 deri në f. 1932, rreshti 4.

<sup>633</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1036, rreshti 13 deri në f. 1038, rreshti 8.

<sup>634</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, konfidencial, f. 1074, rreshti 22 deri në f. 1075, rreshti 16; f. 1078, rreshti 25 deri në f. 1079, rreshti 5.

<sup>635</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, publik, f. 1110, rreshtat 17-25.

<sup>636</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 204. Gjithashtu *shih* **TW4-01:** T. 2 qershor 2023, konfidencial, f. 1630, rreshtat 1-17; f. 1632, rreshti 24 deri në f. 1633, rreshti 16; f. 1636, rreshti 19 deri në f. 1637, rreshti 3.

<sup>637</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 264.

çoi atë, [REDAKTUAR] në FMK.<sup>638</sup> Mospërputhja e pretenduar në dëshminë e TW4-01-shit rrjedh nga informacioni i evidentuar në shënimin e ZPS-së ku përmbledhet një bisedë telefonike midis TW4-01-shit dhe një punonjësi të ZPS-së në vitin 2021.<sup>639</sup> Kur u ballafaqua me këtë mospajtim midis tyre gjatë marrjes në pyetje në sallë të gjyqit, dëshmitari mohoi pretendimin, duke thënë: “Kjo nuk a fjalë e jemja. As kurrë në jetë këtë fjalë s’e kam thënë unë”.<sup>640</sup> Trupi Gjykses nuk ka shpjegim tjetër se pse z. Shala ishte përfshirë në shënimin zyrtar të ZPS-së më 2021. Trupi Gjykses vë në dukje se shënimi i ZPS-së nuk është evidentim tekstual i fjalëve të dëshmitarit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk përjashton mundësinë e një keqkuptimi në telefon midis TW4-01-shit dhe punonjësit të ZPS-së. Sido që të jetë, Trupi Gjykses vë në dukje se në sallë të gjyqit TW4-01 me vendosmëri refuzoi të implikonte z. Shala. Kur e mori në pyetje Mbrojtja, ai dha gjithashtu shpjegime të gjera në lidhje me historinë [REDAKTUAR], që thellon përshtypjen e Trupit Gjykses se ai ishte i gatshëm të sqaronte se nuk kishte identifikuar z. Shala si personin i cili çoi të ndaluarit në FMK.

373. Së dyti, sa i takon aspektit nëse [REDAKTUAR] apo jo, [REDAKTUAR].<sup>641</sup> [REDAKTUAR].<sup>642</sup> [REDAKTUAR].<sup>643</sup> ZPS-ja pyeti shprehimisht dëshmitarin nëse ngjarjet i kujtoheshin atij vetë, gjë që e konfirmoi menjëherë.<sup>644</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se, sikurse TW4-01, ky dëshmitar nuk donte të implikonte më tej z. Shala.

374. Së fundi, Trupi Gjykses vë në dukje se, edhe në qoftë se të dy dëshmitarët përmendën në një moment se z. Shala çoi TW4-01-shin, [REDAKTUAR] në FMK, në sallë të gjyqit që të dy këmbëngulën se ishte [REDAKTUAR] i cili i çoi personat e

---

<sup>638</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1397, 1401-1403; 31 maj 2023, konfidencial, f. 1555, rreshtat 3-18.

<sup>639</sup> **TW4-01:** 093591-093591 RED2.

<sup>640</sup> **TW4-01:** T. 2 qershor 2023, konfidencial, f. 1637, rreshti 2.

<sup>641</sup> [REDAKTUAR].

<sup>642</sup> [REDAKTUAR]

<sup>643</sup> [REDAKTUAR].

<sup>644</sup> [REDAKTUAR].

lartpërmendur në FMK. Megjithëkëtë, sipas mendimit të Trupit Gjykses, Mbrojtja nuk mbështet më tej pretendimin për kundërthënie të mundshme midis TW4-01-shit dhe [REDAKTUAR], por kërkon nga Trupi Gjykses të nxjerrë përfundime nga deklarata të përzgjedhura të dëshmitarëve. Trupi Gjykses nuk gjen tregues të një marrëveshjeje midis tyre, për shembull, nga mënyra që dëshmitarët dëshmuar, përdorimi i gjuhës së njëjtë në përshkrimin e të njëjtave fakte dhe rrethana relevante të tjera. Fakti që një dëshmitar korrigjoi deklaratën e mëparshme dhe që tjetri mohoi në sallë të gjyqit të ketë implikuar z. Shala më parë, nuk mjafton në vetvete për të vërtetuar marrëveshjeje midis tyre. Gjithashtu, kjo nuk hedh dyshim mbi vërtetësinë e përgjithshme të dëshmimeve të dëshmitarëve.

375. Si rezultat, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, Trupi Gjykses nuk sheh arsye për të dyshuar vërtetësinë e përshkrimeve reciprokisht konfirmuese të TW4-01-shit dhe [REDAKTUAR] se [REDAKTUAR] çoi në FMK TW4-01-shin, [REDAKTUAR].

376. Në lidhje me aspektin se a ishte FMK vendi ku mbërriti TW4-01, [REDAKTUAR], Trupi Gjykses vë në dukje se TW4-01 përshkroi gjerësisht objektin, në mënyrë konkrete dhe të hollësishme.<sup>645</sup> Ai gjithashtu identifikoi ndërtesat në një numër fotografish të FMK-së të cilat iu treguan dhe bëri shënime shtesë në një skicë të cilën e vizatoi më parë.<sup>646</sup> Gjithashtu, TW4-01 saktësoi se magazina përdorej për të magazinuar uniformat – hollësi të cilën e konfirmuan dëshmitarët e Mbrojtjes z. Koçinaj, z. Mark Shala dhe z. Hoxha.<sup>647</sup> Kjo tregon qartësisht se TW4-01 ishte me të vërtetë brenda ndërtesës në kohën relevante. Krahas kësaj, sikurse u përmend më lart,

---

<sup>645</sup> *Shih, për shembull, TW4-01*: T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshti 22 deri në f. 1410, rreshti 10.

<sup>646</sup> *Shih, për shembull, TW4-01*: T. 30 maj 2023, publik, f.1409, rreshti 22 deri në f. 1413, rreshti 4; T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1423, rreshti 14 deri në f. 1425, rreshti 2; REG00954.

<sup>647</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1403; **z. Koçinaj**: T. 3 tetor 2023, publik, f. 2816-2817; **z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2956-2957; **z. Hoxha**: T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3198; *Shih gjithashtu, SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (ruajtur si REG00954); shih Pjesën VI.B.3.*

[REDAKTUAR];<sup>648</sup> dhe vetë z. Shala tha se ai takoi në FMK TW4-01-shin, [REDAKTUAR] në maj 1999.<sup>649</sup> Si rezultat, Trupi Gjykses është bindur se vendi ku mbërriti TW4-01, [REDAKTUAR], ishte në fakt FMK-ja.

377. Në lidhje me datën e saktë të mbërritjes së TW4-01-shit, TW4-01 dëshmoi se më [REDAKTUAR] maj 1999, [REDAKTUAR].<sup>650</sup> TW4-01 tha se ai mbërriti në FMK të njëjtën ditë që u dëbua nga Kosova dhe kaloi tri ditë në magazinë para se të arrestohej.<sup>651</sup> Dëshmitari dëshmoi më tej se u keqtrajtua në zyrën e ndërtesës së komandës [REDAKTUAR] pas arrestimit.<sup>652</sup>

378. Trupi Gjykses vëren se, në qoftë se pranohet si e vërtetë se TW4-01 mbërriti në FMK më [REDAKTUAR] maj 1999, kjo do të thotë se dëshmitari u keqtrajtua në zyrë më [REDAKTUAR] maj 1999.<sup>653</sup> Në anën tjetër, Trupi Gjykses vë në dukje se sipas dëshmive reciprokisht konfirmuese të cilat rrjedhin nga W01448 dhe W04733, TW4-01 kësaj date.<sup>654</sup> Konkretisht, Trupi Gjykses vë në dukje se W04733 dëshmoi se natën kur mbërriti në FMK, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, ai u keqtrajtua në zyrë, së bashku me TW4-01-shin;<sup>655</sup> W01448 tha gjithashtu se u keqtrajtua në zyrë, së bashku me TW4-01-shin dhe të tjerët, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>656</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se konfirmimi reciprok i dëshmive të W01448-ës dhe W04733-shit

---

<sup>648</sup> [REDAKTUAR].

<sup>649</sup> **z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 146-147, 152, 169; 066866-066882-ET Revised (E rishikuar), f. 066876-066877.

<sup>650</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1388, rreshtat 19-24.

<sup>651</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1413-1418.

<sup>652</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1450, rreshti 4-f.1452, rreshti 6. Në lidhje me keqtrajtimin e TW4-01-shit në zyrë, *shih* konstatimin e Trupit Gjykses në Pjesën VI.E.2(b).

<sup>653</sup> Po kështu, TW4-01 vlerësoi se atë e vendosën në dhomën 1 më [REDAKTUAR] maj 1999, *shih* **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1422, rreshtat 3-11.

<sup>654</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(b).

<sup>655</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741. *Shih gjithashtu*, **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013742-SITF00013743. Takimi i dy dëshmitarëve diskutohet më në hollësi në Pjesën VI.E.2(b).

<sup>656</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737; SITF00016221-SITF00016285 RED4, f. SITF00016227; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013854; *shih* Pjesën VI.E.2(b).



shërben si shembull i saktësisë së tyre sa i përket kohës së ngjarjeve. Gjithashtu, W01448 dha referenca kohore, sikurse ditë të javës ose festa zyrtare, të cilat ndihmojnë Trupin Gjykses për të vërtetuar mbështetshmërinë në to.<sup>657</sup> Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se është e mundshme që dëshmitari TW4-01 të ketë qenë i pasaktë kur tha se mbërriti në FMK më [REDAKTUAR] maj 1999, veçanërisht duke marrë parasysh se ai e dha deklaratën shumë kohë pas ngjarjeve. Trupi Gjykses konstaton se është e përshtatshme të tolerohet një pasaktësi e tillë, dhe është i mendimit se kjo nuk ndikon në besueshmërinë e dëshmitarit ose mbështetshmërinë në dëshminë e tij në përgjithësi në lidhje me ndalimin e tij në FMK. Për Trupin Gjykses është e qartë se TW4-01 ishte në FMK afërsisht nga mesi i majit 1999. Duke mbajtur parasysh dëshmitë reciprokisht konfirmuese të W01448-ës dhe W04733-shit, rrjedhimisht, Trupi Gjykses e gjykon të pasaktë dëshminë e TW4-01-shit se [REDAKTUAR] maji 1999 ishte data e mbërritjes së tij në FMK.

379. Duke marrë parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se TW4-01 mbërriti në FMK më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.

(b) Arrestimi fillestar

380. Trupi Gjykses tani u kthehet rrethanave të arrestimit të TW4-01-shit në FMK. TW4-01 dëshmoi se ai, [REDAKTUAR] u arrestuan nga policë ushtarak të UÇK-së mbrëmjen e tretë pasi mbërritën në FMK.<sup>658</sup> Kur u pyet shprehimisht se si e dinte ai se këta persona ishin nga policia ushtarake e UÇK-së, TW4-01 tha: “Se ato traktat në krah,

---

<sup>657</sup> W01448 kujton, për shembull, se 13 maji 1999 ishte ditë pushimi zyrtar në Gjermani (W01448: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013854; SITF00016221-SITF00016285 RED4, f. SITF00016227). Sipas kalendarit për vitin 1999, 13 maj 1999 ishte në fakt Dita e Shëlbimit.

<sup>658</sup> TW4-01: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1418, rreshtat 1-14.

në dallim prej UÇK-së".<sup>659</sup> TW4-01 shpjegoi gjithashtu se ia lidhën duart me lidhëse të çizmeve ushtarake dhe e vendosën në një pjesë të magazinës, [REDAKTUAR], ku ata kaluan natën.<sup>660</sup>

381. Kur u pyet nëse i kujtohet se a ishte z. Shala i pranishëm apo jo natën e arrestimit, dëshmitari tha se, me aq sa i kujtohej atij, z. Shala nuk ishte i pranishëm, por se nuk ishte i sigurt.<sup>661</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitari u tregua i rezervuar lidhur me praninë e z. Shala dhe ngurroi ta implikonte qëllimisht z. Shala. Ky aspekt shton vërtetësinë e dëshmisë së tij, sepse dëshmitari qartësisht tentoi t'i qëndronte të vërtetës së përvojës personale të tij.

382. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-01-shit iu hoq liria në FMK, më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.

(c) Vendi i ndalimit në FMK

383. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm se TW4-01 fjeti në magazinë natën e arrestimit më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>662</sup> Të nesërmen në mëngjes, e çuan në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit, ku u mbajt kryesisht deri kur u lirua.<sup>663</sup> TW4-01 tha se i kishte duart e lidhura pothuajse gjatë gjithë kohës në

---

<sup>659</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1418, rreshtat 15-17. Në lidhje me emblemën e uniformës së policisë ushtarake, *shih* **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 22, rreshtat 3-10; **z. Shala:** T000-2742-T000-2742-Transkripti shqip dhe anglisht-3 - B, f. 23-24; 066864-TR-ET Part 2 Revised 1 (Pjesa 2, e rishikuar 1), f. 87-88.

<sup>660</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1418, rreshti 18 deri në f. 1419, rreshti 25.

<sup>661</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1420, rreshtat 1-4.

<sup>662</sup> *Shih* para. 380 më lart.

<sup>663</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshti 19 deri në f. 1410, rreshti 10; T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1420, rreshti 5 deri në f. 1422, rreshti 2, *i referohet* skicës SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (ruajtur si REG00954); T. 30 maj 2023, publik, f. 1423, rreshti 7 deri në f. 1424, rreshti 13 (dëshmitari njohu ndërtesën e cila iu tregua në fotografinë 074390-074391, f. 074390 si ndërtesa e ndalimit); T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1554, rreshti 23 deri në f. 1555, rreshti 2. Në lidhje me rastet kur TW4-01-shin e nxorën nga dhoma 1, *shih* para. 385 më poshtë. Në lidhje me kohëzgjatjen e ndalimit të TW4-01-shit në FMK dhe kohën e përafërme të lirim, *shih* Pjesën VI.D.2(e).

dhomën 1.<sup>664</sup>

384. TW4-01 dëshmoi se ditën kur e çuan në dhomën 1 (d.m.th. më 20 maj 1999, ose rreth asaj date), në mbremje, e nxorën nga dhoma 1 dhe e çuan në zyrën në ndërtesën e komandës, ku anëtarët e UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, e morën në pyetje dhe e rrahën rëndë.<sup>665</sup> TW4-01 dëshmoi se, pas një nate plot rrahje, e kthyen në dhomën 1.<sup>666</sup>

385. Dëshmia e TW4-01-shit lidhur me marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin në zyrë konfirmohet dhe nga dëshmitë e W04733-shit dhe W01448-ës, të cilat, sikurse do të diskutohet më poshtë, Trupi Gjykses konstaton se janë të besueshme dhe të mbështetshme.<sup>667</sup> Sa i takon se ku e çuan TW4-01-shin pas keqtrajtit në zyrë më 20 maj 1999, dëshmia duket kundërthënëse. TW4-01 tha se e kthyen në dhomën 1 [REDAKTUAR].<sup>668</sup> Megjithatë, W04733 dhe W01448 thonë se TW4-01 [REDAKTUAR], u mbajtën në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës disa ditë.<sup>669</sup> Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se: (i) TW4-01 ishte i qartë në dëshminë e tij se, [REDAKTUAR] gjatë ndalimit të tij në FMK, ai nuk e pa atë dhomë;<sup>670</sup> dhe (ii) deklaratat përkatëse të të dyve, W04733-shit dhe W01448-ës nuk përputhen krejtësisht në lidhje me të ndaluarit e tjerë në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës dhe kohën që të gjithë ata kaluan para se t'i çonin në dhomën 1.<sup>671</sup> Trupi Gjykses vëren se TW4-01 gjatë dhënies së dëshmisë ishte përputhës lidhur me vendndodhjen e tij [REDAKTUAR]. Nga ana tjetër, mospërputhjet në deklaratat e W04733-shit dhe W01448-ës, nuk mund të pajtohen me njëra-tjetrën, ose me dëshminë

---

<sup>664</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1447, rreshtat 7-11.

<sup>665</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1450, rreshti 2 deri në f. 1451, rreshti 20; f. 1457, rreshtat 20-22. Dëshmitari shënoi me rreth zyrën në fotografi 065597-065612, f. 065600 (në fund të fotografisë, ruajtur si REG00956); *Shih gjithashtu*, Pjesën VI.E.2(b).

<sup>666</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1459, 1469.

<sup>667</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(b).

<sup>668</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1471, rreshtat 2-11.

<sup>669</sup> [REDAKTUAR].

<sup>670</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1471, rreshtat 2-11.

<sup>671</sup> *Shih* poshtëshënimin 669 më lart.

e TW4-01-shit. Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk u kushton peshë dëshmime të W04733-shit dhe W01448-ës në lidhje me këtë aspekt konkret. Si rezultat, duke parë dëshmitë në tërësinë a tyre, Trupi Gjykses konstaton se TW4-01 nuk u mbajt në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës pas keqtrajtimit, por e kthyen në dhomën 1. Sido që të jetë, Trupi Gjykses është i mendimit se ky është aspekt dytësor, [REDAKTUAR].

386. [REDAKTUAR],<sup>672</sup> [REDAKTUAR].<sup>673</sup>

387. Trupi Gjykses konstaton se gjatë dhënies së dëshmisë, TW4-01 ishte i qartë kur përshkroi dhomat ku u mbajt i ndaluar së bashku me të ndaluarit e tjerë. Gjithashtu, dëshmia e tij konfirmohet reciprokisht nga përshkrimet e një numri dëshmitarësh, ndër të cilët TW4-11, W04733 dhe W01448.<sup>674</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se TW4-01 është i besueshëm dhe mund të mbështetesh në dëshminë e tij lidhur me vendin e ndalimit të tij.

388. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-01 u mbajt i ndaluar në magazinë dhe dhomën 1 gjatë gjithë kohës së ndalimit. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se gjatë kohës që TW4-01 u keqtrajtua dhe u mor në pyetje, ai ndonjëherë u mbajt në zyrë [REDAKTUAR].

(d) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

389. [REDAKTUAR], TW4-01 identifikoi një numër personash të tjerë të cilët mbaheshin të ndaluar në FMK gjatë të gjithë kohës që ishte në ndalim, ndër të cilët:

(i) [REDAKTUAR] (W04733),<sup>675</sup> një “person nga Drenica, i cili kishte ardhur prej

---

<sup>672</sup> [REDAKTUAR].

<sup>673</sup> [REDAKTUAR].

<sup>674</sup> *Shih* Pjesët VI.D.4, VI.D.5, VI.D.6 dhe VI.E.2.

<sup>675</sup> [REDAKTUAR].

Gjermanie” (W01448),<sup>676</sup> “tre muzikantë romë [REDAKTUAR]” ([REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një muzikant rom i tretë),<sup>677</sup> [REDAKTUAR]<sup>678</sup> dhe [REDAKTUAR], “një person nga Suhareka” [REDAKTUAR]<sup>679</sup> dhe “ata të Malishevës, tre vetë janë konë”,<sup>680</sup> të cilët u mbajtën në dhomën 1;<sup>681</sup> dhe (ii) [REDAKTUAR] dhe “dy motra” nga Gjakova në dhomën 3.<sup>682</sup> TW4-01 identifikoi gjithashtu viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe W04733-shin si të ndaluar bashkë me të në zyrë natën e keqtrajtimit më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>683</sup>

390. Trupi Gjykses vë në dukje se W01448, W04733 dhe TW4-01 konfirmojnë njëri-tjetrin lidhur me ndalimin e tyre në dhomën 1 gjatë periudhës përkatëse.<sup>684</sup> W01448 dhe TW4-01 konfirmojnë njëri-tjetrin gjithashtu lidhur me ndalimin e [REDAKTUAR]<sup>685</sup> dhe [REDAKTUAR] në dhomën 1.<sup>686</sup> Gjithashtu, TW4-01, TW4-11, W04733, W01448 dhe dëshmitarë të tjerë konfirmojnë njëri-tjetrin në lidhje me ndalimin e “tre muzikantëve romë [REDAKTUAR]”.<sup>687</sup> Së fundi, përshtkrimi i TW4-

<sup>676</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1440; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013854; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016227; *shih* Pjesën VI.D.6.

<sup>677</sup> *Shih* Pjesën VI.D.10(a).

<sup>678</sup> [REDAKTUAR].

<sup>679</sup> *Shih* Pjesën VI.D.10(c).

<sup>680</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1438, rreshtat 14-15 dhe T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1540, rreshtat 12-20.

<sup>681</sup> [REDAKTUAR].

<sup>682</sup> [REDAKTUAR].

<sup>683</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1452, rreshtat 10-22.

<sup>684</sup> *Shih* Pjesët VI.D.5 dhe VI.D.6.

<sup>685</sup> *Shih* Pjesën VI.D.10(c).

<sup>686</sup> *Shih* Pjesën VI.D.10(e).

<sup>687</sup> *Shih* Pjesën VI.D.10(a).

01-shit lidhur me praninë e viktimës së vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe W04733-shit në zyrë konfirmohet nga deklaratat e W04733-shit dhe W01448-ës.<sup>688</sup>

391. Në lidhje me “ata të Malishevës, tre vetë janë konë” të cilët TW4-01 i përmend si të ndaluar bashkë me të në dhomën 1, për shkak të provave të kufizuara të cilat nuk mundësojnë identifikim të saktë, Trupi Gjykses do t’i trajtojë këto prova në pjesën VI.D.11 më poshtë.<sup>689</sup>

392. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, TW4-01 dëshmoi qartë dhe me shumë hollësi lidhur me praninë dhe identifikimin e të ndaluarve të tjerë në FMK gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat. Gjatë marrjes në pyetje në sallën e gjyqit, dëshmitari iu përmbajt deklaratave të mëparshme të tij. Ai bëri përpjekje të dukshme të përshkruante saktësisht përvojën e tij dhe të kujtonte emrat ose identifikonte hollësi për persona, përkundër kohës që ka kaluar. Çka është me rëndësi, identifikimi prej TW4-01-shit i të ndaluarve të tjerë konfirmohet reciprokisht nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, si W04733, W01448 dhe TW4-11, të cilët thanë se: (i) u mbajtën në të njëjtat vende në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat;<sup>690</sup> (ii) panë TW4-01-shin si të ndaluar bashkë me ta;<sup>691</sup> ose (iii) panë të njëjtit të ndaluar bashkë me ta, të cilët përmendi TW4-01.<sup>692</sup>

---

<sup>688</sup> **W04733:** SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013819; 106978-107020, f. 106985-106986. **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013746-SITF00013747; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016235.

<sup>689</sup> *Shih* para. 589 më poshtë.

<sup>690</sup> [REDAKTUAR].

<sup>691</sup> W04733 dhe W01448 thonë se ishin të ndaluar bashkë me TW4-01-shin dhe viktimën e vrasjes së paligjshme në dhomën 1. *Shih* **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 16; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761-SITF00013762.

<sup>692</sup> W04733 dhe W01448, të dy kujtuan keqtrajtimin e [REDAKTUAR] në zyrë. Ngjashëm me TW4-01-shin, TW4-11-shin, W04733-shin dhe W1448-ën, të gjithë identifikojnë tre “romë [..., po kanë qenë] muzikantë” si të ndaluar bashkë me ta në dhomën 1 (**TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1209-1210; **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 5-6; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761- SITF00013762).

393. Trupi Gjykses i referohet kundërshtimit të Mbrojtjes në lidhje me mospërputhjen midis përshkrimit të TW4-01-shit dhe TW4-02-shit për periudhën e saktë kohore të ndalimit të TW4-02-shit.<sup>693</sup> Sikurse do të diskutohet më poshtë, Trupi Gjykses konstaton se mospërputhja e lartpërmendur rrjedh nga deklarata e pavërtetë e TW4-02-shit lidhur me periudhën kohore të ndalimit në FMK, në të cilën nuk mbështetet Trupi Gjykses.<sup>694</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se kjo nuk ndikon në besueshmërinë dhe mbështetshmërinë në dëshminë e TW4-01-shit sa i takon identifikimit të të ndaluarve të tjerë në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat.<sup>695</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në dëshminë e TW4-01-shit lidhur me praninë dhe identifikimin e të ndaluarve të tjerë në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

394. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses bindet se TW4-01 u mbajt i ndaluar në FMK në periudha përkuese me viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], me së paku dy femra të tjera, W04733-shin, W01448-ën, TW4-02-shin, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një rom tjetër të ndaluar, [REDAKTUAR].

(e) Rrethanat e lirimit

395. TW4-01 dëshmoi se, më [REDAKTUAR] qershor 1999, [REDAKTUAR].<sup>696</sup> [REDAKTUAR].<sup>697</sup> [REDAKTUAR].<sup>698</sup> [REDAKTUAR].<sup>699</sup> Përgjithësisht, Trupi

---

<sup>693</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 218.

<sup>694</sup> *Shih* Pjesën VI.D.9.

<sup>695</sup> *Shih* Pjesën VI.D.9.

<sup>696</sup> [REDAKTUAR].

<sup>697</sup> [REDAKTUAR].

<sup>698</sup> [REDAKTUAR].

<sup>699</sup> [REDAKTUAR].

Gjykues konstaton se përshkrimi i TW4-01-shit ishte i strukturuar, koherent dhe i hollësishëm.

396. Mbrojtja parashtron se përshkrimi i TW4-01-shit lidhur me rrethanat e lirit nuk është i besueshëm për një numër arsyesh. Mbrojtja u referohet, ndër të tjera: (i) mospërputhjeve midis përshkrimit të TW4-01-shit dhe [REDAKTUAR];<sup>700</sup> (iii) mospërputhjeve lidhur me [REDAKTUAR].<sup>701</sup>

397. Në lidhje me mospërputhjen e parë, Trupi Gjykues vëren se, megjithëse TW4-01 tha në fakt se [REDAKTUAR] më [REDAKTUAR] qershor 1999, [REDAKTUAR].<sup>702</sup> [REDAKTUAR].<sup>703</sup> Trupi Gjykues konstaton se pasaktësia në përshkrimin e TW4-01-shit lidhur me datën e lirit të tij është minimale dhe mund t'i atribuohet kohës që ka kaluar. Trupi Gjykues nuk mendon se kjo mospërputhje dytësore ka ndikim më të gjerë në besueshmërinë e TW4-01-shit. [REDAKTUAR].

398. Sa i përket mospërputhjes së pretenduar të dytë, Trupi Gjykues vë në dukje se ky aspekt ka të bëjë me [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR],<sup>704</sup> [REDAKTUAR],<sup>705</sup> [REDAKTUAR].<sup>706</sup>

399. Fillimisht, Trupi Gjykues është i mendimit se [REDAKTUAR] është me rëndësi dytësore dhe nuk është thelbësor për konstatimet të cilat Trupi Gjykues ka për detyrë t'i bëjë, sepse ngjarjet nuk përfshihen në kuadrin gjeografik dhe kohor të Aktakuzës së Konfirmuar. Gjithashtu, Trupi Gjykues thekson se është e kuptueshme që ka dallim midis këndvështrimeve të TW4-01-shit dhe [REDAKTUAR], të cilat si rezultat ndikojnë në dëshmitë e tyre. Këndvështrimi i TW4-01-shit është ai i një të ndaluar i

---

<sup>700</sup> [REDAKTUAR].

<sup>701</sup> [REDAKTUAR].

<sup>702</sup> [REDAKTUAR].

<sup>703</sup> [REDAKTUAR].

<sup>704</sup> [REDAKTUAR].

<sup>705</sup> [REDAKTUAR].

<sup>706</sup> [REDAKTUAR].



cili u mbajt [REDAKTUAR] në FMK, u keqtrajtua rëndë dhe u abuzua psikologjikisht në disa raste. [REDAKTUAR]. Sidoqoftë, Trupi Gjykses konstaton se TW4-01 u përpoq sinqerisht të vlerësonte [REDAKTUAR].<sup>707</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se kjo mospërputhje e vogël, për të cilën Trupi Gjykses gjen shpjegim logjik, nuk ndikon mbi aspektin juridikisht thelbësor se kur u lirua TW4-01 dhe në cilat rrethana u lirua ai.

400. Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se kujtesa e përgjithshme e TW4-01-shit për rrethanat e lirit të tij është përputhëse në vetvete dhe konfirmohet nga përshkrimet dhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Rrjedhimisht, besueshmëria e tij nuk ndikohet nga mospërputhjet e vogla për datën e saktë të lirit, ose mbivlerësimi i [REDAKTUAR].

401. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-01 [REDAKTUAR].

(f) Mungesa e garancive procedurale

402. Trupi Gjykses rikujton se heqja e lirisë cilësohet si arbitrare në qoftë se dhe kur njëra prej tri garancive bazë — që duhet t'u sigurohen të gjithë personave të cilëve u hiqet liria në një konflikt të armatosur — mohohen nga pala ndaluese. Pala ndaluese ka detyrimin: (i) të informojë personin që i është hequr liria lidhur me arsyet për heqjen e lirisë; (ii) ta sjellë personin që i është hequr liria pa vonesë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent; dhe (iii) t'i japë personit që i është hequr liria mundësinë të kundërshtojë ligjshmërinë e ndalimit të tij.<sup>708</sup>

---

<sup>707</sup> [REDAKTUAR].

<sup>708</sup> [Confirmation Decision](#), (Vendimi i Konfirmimit) para. 51; *Shih gjithashtu*, Pjesën VII.B.1. *Shih ngjashëm*, [Mustafa Trial Judgment](#), (Aktgjykimi *Mustafa*) para. 407.

403. Sa i takon detyrimet për të informuar personin që i është hequr liria për arsyet e heqjes së lirisë, Trupi Gjykses në dukje se TW4-01 dëshmoi se në momentin e arrestimit e informuan se ekzistonte një urdhër për arrestimin e tij, të cilin nuk ia treguan kurrë. Kur pyeti shprehimisht se kush urdhëroi arrestimin e tij, i thanë thjesht: “Do ta marrësh vesh më vonë” dhe nuk i dhanë asnjë arsye për arrestimin.<sup>709</sup> TW4-01 dëshmoi më tej se, sipas mendimit të tij, ai mbahej i ndaluar në FMK, sepse ishte “spiun” ose “bashkëpunëtor”.<sup>710</sup> Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se TW4-01 nuk u informua si duhet për arsyet e arrestimit dhe ndalimit.

404. Sa i takon aspektit nëse TW4-01-shin e sollën para një autoriteti tjetër kompetent, ose nëse iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit, Trupi Gjykses në dukje se, gjatë mbajtjes në ndalim, TW4-01 i pati duart e lidhura me lidhëse çizmash dhe se rregullisht u bë objekt i keqtrajtimit të rëndë, përfshirë rrahjen, ngacmimin dhe poshtërimin.<sup>711</sup> Ai nuk pati kontakt as me familjen, as me botën e jashtme. Dëshmitari dëshmoi gjithashtu se, gjatë mbajtjes në ndalim, e morën në pyetje në disa raste, përfshirë në zyrën në ndërtesën e komandës.<sup>712</sup> Në njërin prej këtyre rasteve, teksa po keqtrajtohej, TW4-01 u akuzua nga Xhemshit Krasniqi dhe Sabit Geci, në prani të z. Shala, se [REDAKTUAR] ishte “spiun” dhe për bashkëpunim me policinë serbe.<sup>713</sup> TW4-01 përshkroi marrjen në pyetje kështu: [REDAKTUAR]. ‘Prano edhe pshtojsh’. Nuk mujsha me e pranuar unë atë. Më mirë me vdekë se me e pranuar një send që s’e kam ba.”<sup>714</sup>

405. Bazuar në konstatimet më lart dhe duke marrë parasysh se të ndaluarit nuk u liruan si rezultat i një procesi ligjor të rregullt, [REDAKTUAR], Trupi Gjykses

---

<sup>709</sup> TW4-01: T. 30 maj 2023, publik, f. 1419, rreshtat 8-12.

<sup>710</sup> TW4-01: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1541, 1571, 1598.

<sup>711</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(a), VI.E.2(b) dhe V.E.4.

<sup>712</sup> TW4-01: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1459, rreshti 16 deri në f. 1460, rreshti 4; f. 1477, rreshtat 4-9; T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1510, rreshtat 12-18; f. 1527, rreshtat 3-12.

<sup>713</sup> [REDAKTUAR].

<sup>714</sup> TW4-01: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1527, rreshtat 9-12.

konstaton, në bazë të tërësisë së provave, se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se TW4-01-shin nuk e sollën para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, as nuk i dhanë mundësi për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.

406. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-01 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk e nxorën pa vonesë para një gjykatësi ose autoriteti kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

### 3. Viktima e vrasjes së paligjshme

#### (a) Arrestimi fillestar

407. [REDAKTUAR].<sup>715</sup> [REDAKTUAR].<sup>716</sup> Viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] përfundimisht u arrestua dhe iu hoq liria më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>717</sup>

#### (b) Vendi i ndalimit në FMK

408. Në lidhje me vendin e ndalimit të viktimës së vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR].<sup>718</sup> [REDAKTUAR], disa dëshmitarë, sikurse TW4-01, TW4-11, W01448 dhe W04733, japin përshkrime reciprokisht konfirmuese lidhur me praninë e viktimës së vrasjes së paligjshme në dhomën 1;<sup>719</sup> në zyrë dhe dhomën 2, kur ndodhën

---

<sup>715</sup> [REDAKTUAR].

<sup>716</sup> [REDAKTUAR].

<sup>717</sup> [REDAKTUAR].

<sup>718</sup> [REDAKTUAR].

<sup>719</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1431-1432; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1210, rreshti 2 deri në f. 1215, rreshti 7, i referohet 059341-059350, f. 059349; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761-SITF00013762; **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 16; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186.

incidentet e keqtrajtimit;<sup>720</sup> si dhe në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës.<sup>721</sup>

Dëshmitë janë të qarta dhe reciprokisht konfirmuese lidhur me praninë e viktimës së vrasjes së paligjshme në këto vende midis [REDAKTUAR] majit 1999 dhe datës së vdekjes së tij, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date.<sup>722</sup> [REDAKTUAR].<sup>723</sup>

409. [REDAKTUAR].<sup>724</sup>

410. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se, gjatë gjithë kohës që u keqtrajtua, viktimja e vrasjes së paligjshme u mbajt në vende të ndryshme në FMK, përfshirë në [REDAKTUAR], dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, [REDAKTUAR] ndërtesën e ndalimit, si dhe në zyrë.

(c) Rrethanat e lirimt

411. Trupi Gjykses konstaton se provat tregojnë qartë se viktimja e vrasjes së paligjshme vdiq në FMK më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date.<sup>725</sup>

(d) Mungesa e garancive procedurale

412. Sa i takon detyrimit për të informuar personin të cilit i hiqet liria për arsyet e heqjes së lirisë, Trupi Gjykses ka vërtetuar se anëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së morën në ndalim viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR].<sup>726</sup> Gjithashtu, W01448 dha dëshmi se, gjatë një incidenti të keqtrajtimit në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, viktimën e vrasjes së paligjshme e akuzuan për bashkëpunim dhe

---

<sup>720</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(b).

<sup>721</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013741- SITF00013742; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016145; **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 16; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186.

<sup>722</sup> *Shih* para. 832 më poshtë.

<sup>723</sup> [REDAKTUAR].

<sup>724</sup> [REDAKTUAR].

<sup>725</sup> [List of Adjudicated Facts](#), (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), Fakti i Shqyrtuar 56.

<sup>726</sup> [REDAKTUAR].

lidhje të ngushta me serbë.<sup>727</sup> Trupi Gjykses nuk ka marrë prova të cilat tregojnë se viktima e vrasjes së paligjshme u informua për arsyet e heqjes së lirisë së tij. [REDAKTUAR], Trupi Gjykses është bindur se as viktima e vrasjes së paligjshme nuk u informua si duhet për arsyet e arrestimit dhe ndalimit të tij.

413. Sa i takon detyrimit për ta nxjerrë personin e arrestuar pa vonesë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent si dhe detyrimit për t'i dhënë personit të cilit i është hequr liria mundësinë për të bërë ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tij, Trupi Gjykses i kushton rëndësi faktit se viktima e vrasjes së paligjshme u keqtrajtua rëndë dhe vdiq gjatë mbajtjes në ndalim.<sup>728</sup> Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se, gjatë mbajtjes në ndalim, viktima e vrasjes së paligjshme nuk pati kontakt as me familjen, as me botën e jashtme. Përkundrazi, kur mjeku këshilloi anëtarët e UÇK-së ta çonin në spital viktimën e vrasjes së paligjshme, njëri prej anëtarëve të UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit në FMK nuk e lejoi këtë gjë.<sup>729</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se të ndaluarit e tjerë në atë kohë, ndër të cilët TW4-01, TW4-11, W04733 dhe W01448, nuk u nxorën para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nuk patën mundësi të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre.<sup>730</sup> Duke pasur parasysh provat konfirmuese të cilat vërtetojnë praktikën e mohimit të garancive procedurale për të ndaluarit në FMK, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim logjik që mund të nxirret është se viktima e vrasjes së paligjshme nuk u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

---

<sup>727</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013744.

<sup>728</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(a), VI.E.4 dhe VI.F.8.

<sup>729</sup> **TW4-01**: 31 maj 2023, konfidencial, f.1529, rreshtat 6-16 dhe 20-23; 2 qershor 2023, konfidencial, f.1674, rreshti 24 deri në f. 1675, rreshti 11.

<sup>730</sup> *Shih* konstatimin e Trupit Gjykses për "Mungesën e Garancive Procedurale" në lidhje me TW4-01-shin, TW4-11-shin, W04733-shin, W01448-ën më poshtë.

414. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se viktima e vrasjes së paligjshme nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxor pa vonesë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

#### 4. TW4-11

##### (a) Arrestimi fillestar

415. Dëshmitari dëshmoi se, më 27 prill 1999, ai dhe familja e tij u nisën për në Shqipëri për shkak se paramilitarët serbë ushtruan presion ndaj tyre.<sup>731</sup> Nuk mohohet se TW4-11 dhe familja e tij mbërritën në Kukës [REDAKTUAR].<sup>732</sup>

416. Në lidhje me rrethanat e arrestimit, TW4-11 dëshmoi se e morën në ndalim [REDAKTUAR] dy persona me rroba civile, të cilët “po të kërkojnë”. [REDAKTUAR].<sup>733</sup> [REDAKTUAR].<sup>734</sup> Dëshmitari deklaroi se i kërkuan të shkonte me ta për “me dhanë një deklaratë”.<sup>735</sup> Sipas TW4-11-shit, ata e çuan më pas me veturë në FMK.<sup>736</sup> TW4-11 shpjegoi se nuk i treguan dokument zyrtar, si fletarrestim ose fletëthirrje, as nuk e informuan nëse dyshohej për kryerje të ndonjë krimi.<sup>737</sup>

417. TW4-11 ishte ngurrues dhe ndonjëherë dha përgjigje bishtnuese kur u pyet nëse ai shkoi vullnetarisht me [REDAKTUAR] dhe personin tjetër, ose nëse mendoi se ishte i detyruar të shkonte.<sup>738</sup> Pyetjes së Trupit Gjykses nëse u ndie i detyruar ose kërcënuar

---

<sup>731</sup> TW4-11: T. 2 maj 2023, publik, f. 1185, rreshtat 16-24.

<sup>732</sup> TW4-11: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1185, rreshti 25 deri në f. 1186, rreshti 21.

<sup>733</sup> TW4-11: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1186, rreshti 23 deri në f. 1187, rreshti 24; [REDAKTUAR].

<sup>734</sup> [REDAKTUAR].

<sup>735</sup> TW4-11: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1187, rreshtat 6-7.

<sup>736</sup> *Shih* identifikimin përmes fotografisë së FMK-së nga TW4-11, TW4-11: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1192-1193, *i referohet* 059341-059350, f. 059342.

<sup>737</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1336, rreshtat 11-18.

<sup>738</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1329-1330.

të shkonte me dy personat, dëshmitari iu përgjigj me “jo”.<sup>739</sup> Kur Trupi Gjykues parashtrioi pyetjen tjetër se pse shkoi nëse nuk u ndje i detyruar, TW4-11 pranoi se “u detyrova me shkuje”.<sup>740</sup> Kur Trupi Gjykues u përpoq të sqaronte kundërthëniet, dëshmitari iu kthye qëndrimit fillestar se nuk ndjeu “kurrfarë presioni” të shkonte me ta.<sup>741</sup> Mënyra bishtnuese e përgjigjeve të dëshmitarit nuk i mundëson Trupit Gjykues të arrijë në përfundime konkrete. Megjithatë, bazuar në konstatimet se dy personat e panjohur për TW4-11-shin shkuan ta kërkonin [REDAKTUAR], i thanë që të shkonte me ta për të dhënë një deklaratë dhe e shoqëruan në FMK për këtë qëllim, Trupi Gjykues pranon se ekziston një element detyrimi për TW4-11-shin për të shkuar me ata persona.

418. Trupi Gjykues vë në dukje se TW4-11 nuk dha datë të saktë për arrestimin e tij. Megjithatë, ai tregoi saktësisht mbërritjen në Shqipëri (më 27 prill 1999) dhe dha vlerësime konkrete lidhur me kohën që ai dhe familja e tij kaluan në [REDAKTUAR].<sup>742</sup> Dëshmitari vlerësoi gjithashtu se ai u mbajt i ndaluar për rreth një muaj,<sup>743</sup> [REDAKTUAR].<sup>744</sup> Trupi Gjykues është i vetëdijshëm për faktin se kujtesa e TW4-11-shit mund të jetë zbehur duke pasur parasysh kohën që ka kaluar. Ai i kushton vëmendje gjithashtu faktit se ai është në moshë të shtyrë. Trupi Gjykues vë në dukje favorshëm se TW4-11 ishte në gjendje të jepte një numër të arsyeshëm referencash kohore, përkundër këtyre vështirësive. Trupi Gjykues këtë e konsideron si element sinqeriteti dhe përpjekje të dukshme për të qenë i saktë. Kjo e bën dëshminë e tij të mbështetshme sepse tregon dëshirën për t'i qëndruar besnik përvojës së tij pa shtuar hollësi të mëtejshme ose thjeshtuar gjërat.

---

<sup>739</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1329, rreshtat 6-11.

<sup>740</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1329, rreshtat 12-17.

<sup>741</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1329, rreshti 24 deri në f. 1330, rreshti 2.

<sup>742</sup> *Shih* para. 415 më lart.

<sup>743</sup> TW4-11: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1193, 1195, 1199; T. 3 maj 2023, publik, f. 1266.

<sup>744</sup> [REDAKTUAR].

419. Trupi Gjykues vë në dukje gjithashtu se periudha e ndalimit të TW4-11-shit përputhet afërsisht me dëshmitë që dhanë W04733<sup>745</sup> dhe W01448,<sup>746</sup> të cilët, që të dy, identifikojnë TW4-11-shin si të ndaluar bashkë me ta gjatë periudhës përkatëse të mbajtjes në ndalim në dhomën 1. Në veçanti, dëshmia e TW4-01-shit përputhet me përshkrimin e W01448-ës se TW4-11 u lirua para 17 qershorit 1999, kur W01448 u transferua në Prizren.<sup>747</sup>

420. [REDAKTUAR].<sup>748</sup>

421. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykues konstaton se TW4-11 u arrestua afërsisht nga mesi i majit 1999 dhe u mbajt i ndaluar në FMK për rreth një muaj.

(b) Vendi i ndalimit në FMK

422. Në lidhje me vendin e ndalimit, TW4-11 dëshmoi se e vendosën në dhomën 1 të ndërtesës së ndalimit, ku dhe kaloi gjithë kohën sa u mbajt i ndaluar.<sup>749</sup> TW4-11 dëshmoi gjithashtu se e nxorën nga dhoma 1 një herë, për t'u marrë në pyetje nga z. Kryeziu.<sup>750</sup>

423. Trupi Gjykues konstaton se përshkrimi prej dëshmitarit i ndërtesës së ndalimit është tejet i besueshëm dhe mund të mbështetet në të për arsyet në vijim. Së pari dëshmitari përshkroi saktësisht ndërtesën e ndalimit dhe vendin e saj në raport me ndërtesat e tjera në kompleksin e FMK-së. Së dyti, TW4-11 identifikoi ndërtesën e

---

<sup>745</sup> **W04733**: U003-2283-U003-2289 RED2, f. U0032286; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 21.

<sup>746</sup> **W01448**: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016224-SITF00016225; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016142; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF000138.

<sup>747</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013757; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016142.

<sup>748</sup> [REDAKTUAR].

<sup>749</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1187, 1193-1196, 1199, 1204-1206.

<sup>750</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1222, rreshti 7-24; T. 3 maj 2023, publik, f. 1260, rreshti 18 deri në f. 1261, rreshti 18.



ndalimit nga fotografitë të cilat iu treguan.<sup>751</sup> Së treti, dëshmitari përshkroi vendin, përmasat dhe planimetrinë e dhomës 1 në ndërtesën e ndalimit (duke shënuar të njëjtën fotografi të përmendur më lart),<sup>752</sup> e cila përkon me përshkrimet të cilat i dhanë dëshmitarë të tjerë, konkretisht TW4-01, TW4-02, TW4-05, W04733 dhe W01448.<sup>753</sup> Së katërti, TW4-11 dëshmoi se një rojë ishte e vendosur në hyrje të ndërtesës së ndalimit.<sup>754</sup> Në lidhje me këtë, përshkrimi i dëshmitarit konfirmohet qartë nga dëshmitë e TW4-01-shit, W01448-ës, W04733-shit dhe TW4-02-shit.<sup>755</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitari u përpoq dukshëm të kujtonte emra ose hollësi lidhur me të ndaluar të tjerë bashkë me të cilët u mbajtën në dhomën 1, sikurse shtjellohet më poshtë. Trupi Gjykses konstaton se është e pagjasë që dëshmitari të jetë marrë vesh me të tjerë ose rastësisht dha përshkrim të ngjashëm me dëshmitarë të tjerë në këtë nivel hollësish. Së fundi, Trupi Gjykses nuk sheh arsye për të dyshuar në përshkrimin e dëshmitarit kur e nxorën nga dhoma 1 për t'u marrë në pyetje nga z. Kryeziu, duke pasur parasysh se vetë z. Kryeziu pranoi se kishte marrë në pyetje TW4-11-shin.<sup>756</sup>

424. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se TW4-11 u mbajt i ndaluar në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit në FMK. Trupi Gjykses është bindur

---

<sup>751</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1204, rreshti 15 deri në f. 1206, rreshti 15, *i referohet* fotografisë 074390-074391, f. 074390 (ruajtur si REG00951). *Shih gjithashtu*, **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1423, rreshti 14 deri në f. 1424, rreshti 13, i cili gjithashtu identifikoi ndërtesën e ndalimit në bazë të së njëjtës fotografi.

<sup>752</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1205, rreshti 13 deri në f. 1206, rreshti 25. Dëshmitari përshkroi hyrjen e ndërtesës së ndalimit që çonte drejt një korridorit, dhe dhoma ku u mbajt ai ishte në krah të majtë të korridorit. *Shih gjithashtu*, REG00951, në të cilën TW4-11 shënoi hyrjen e ndërtesës së ndalimit.

<sup>753</sup> **TW4-01:** skica REG00955; **W01448:** skica U003-2231-U003-2231-ET; **TW4-02:** skica 060653-060663-ET, f. 060653. Në lidhje me karakteristikat fizike të dhomës 1, *Shih gjithashtu*, Pjesën VI.E.1(a)(ii).

<sup>754</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1207, rreshtat 1-11; 1219, rreshtat 21-25.

<sup>755</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1445, rreshtat 18-21; f. 1446, rreshtat 22-23; f. 1447, rreshtat 1-6; **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; **W04733:** 106978-107020, f. 106990; **TW4-02:** 108850-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 6-7; 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 4.

<sup>756</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016916.

po ashtu se, gjatë marrjes në pyetje, TW4-11 u mbajt i ndaluar në një vend tjetër në kompleksin e FMK-së.

(c) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

425. TW4-11 dëshmoi se në dhomën 1 ishin shtatë deri në tetë të ndaluar të tjerë, ndër të cilët [REDAKTUAR],<sup>757</sup> dhe tre “muzikantë romë” [REDAKTUAR] (për të cilët dëshmitari tha se i njihje më parë).<sup>758</sup> Në veçanti, TW4-11 njohu njërin nga “muzikantët romë” [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] në bazë të fotografive të cilat iu treguan.<sup>759</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, dëshmia e dëshmitarit është e qartë, e hollësishme dhe jo e dykuptimtë.

426. Sa i takon W04733-shit, TW4-11 dëshmoi se mendon se ky person ishte [REDAKTUAR] sepse këtë ia thanë të ndaluarit e tjerë.<sup>760</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitari fillimisht nuk mundi të jepte shumë hollësi lidhur me W04733-shin, përveç faktit se “ndenji aty shkurt dhe pastaj është liruar”.<sup>761</sup> Gjatë marrjes në pyetje, kur ia treguan fotografinë në të cilën dukej W04733, TW4-11 pranoi menjëherë se nuk e dinte identitetin e personit në fjalë, por konfirmoi se ai ishte personi për të cilin ai mendonte se ishte [REDAKTUAR], i cili ishte i ndaluar bashkë me të.<sup>762</sup> Trupi Gjykses është bindur se ky është identifikim pamor bindës i W04733-shit si i ndaluar bashkë me TW4-11-shin. Fakti që TW4-11 mendoi gabimisht se W04733 ishte [REDAKTUAR]

---

<sup>757</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1211, rreshti 25 deri në f. 1212, rreshti 1.

<sup>758</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1208-1213.

<sup>759</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1208, rreshti 22 deri në f. 1209, rreshti 22, *i referohet* 059341-059350, f. 059348; T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1210, rreshti 2 deri në f. 1215, rreshti 7, *i referohet* 059341-059350, f. 059349.

<sup>760</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1216, rreshtat 7-19.

<sup>761</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1216, rreshtat 12-14.

<sup>762</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1216.

<sup>762</sup> **TW4-11:** T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1308-1318.

bazohet në çfarë dëgjoji nga të tjerët, por mund të shpjegohet edhe nga fakti se disa të ndaluar të mbajtur në FMK ishin [REDAKTUAR] dhe se rrjedhimisht, ai i ngatërroi.<sup>763</sup>

427. Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmia e TW4-11-shit përputhet me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë lidhur me numrin e përafërt dhe identitetet e të ndaluarve të cilët u mbajtën në dhomën 1. Konkretisht, TW4-01, W04733 dhe W01448 thanë se numri i të ndaluarve ishte midis 5 dhe 13.<sup>764</sup> Vlerësimi të cilin dha TW4-11 përputhej me këtë numër.<sup>765</sup> Trupi Gjykses pranon se mund të ketë pasaktësi, sepse duke marrë parasysh kohën që ka kaluar është e natyrshme që të ndodhë kjo. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm gjithashtu për faktin se situata personale e secilit prej dëshmitarëve në atë kohë me gjasë do të ketë ndikuar në aftësinë e tyre për të mbajtur mend rrethanat anësore, si numrin e të ndaluarve të tjerë. Konkretisht, dëshmitarit nuk i kujtohet saktësisht numri i të ndaluarve të tjerë, i cili ndryshonte nga dita në ditë.<sup>766</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses ka marrë dëshmi reciprokisht konfirmuese në lidhje me praninë e të ndaluarve konkretë të cilët i identifikoi TW4-11, konkretisht, [REDAKTUAR], W04733-shin dhe tre “muzikantët romë” ([REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një muzikant rom i tretë).<sup>767</sup>

---

<sup>763</sup> *Shih* Pjesët VI.D.8, VI.D.9 dhe VI.D.10(d).

<sup>764</sup> **TW4-01** dëshmoi se, gjatë kohës që ishte i ndaluar, në dhomën 1 u mbajtën midis 6 dhe 12 të ndaluar (**TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1431, rreshtat 12-16). Në deklaratat përkatëse të tyre, dëshmitarët **W04733** dhe **W01448 përmendin** përkatësisht, 9 dhe 13, si numri i gjithsejtë i të ndaluarve në dhomën 1 (**W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 8-9; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 5; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186; **W01448**: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016225).

<sup>765</sup> TW4-11 dëshmoi se kur mbërriti ai në dhomën 1, atje ishin shtatë ose tetë të ndaluar (**TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1207, rreshtat 12-25).

<sup>766</sup> *Shih* në lidhje me dëshminë e TW4-10-s i cili ishte roje te porta e FMK-së, se “[j]anë sjellë shumë aty” (**TW4-10**: T. 1 maj 2023, konfidencial, f. 1073, rreshtat 7-21). Ngjashëm, *shih* dëshminë e TW4-01-shit se numri i gjithsejtë i të ndaluarve gjatë kohës që ishte i ndaluar ishte “nja katërdhjetë e kusur a -- e më tepër kanë qenë”, sepse ndërkohë që disa persona mbaheshin të ndaluar, të tjerë u liruan (**TW4- 01**: T. 6 qershor 2023, publik, f. 1920, rreshti 15 deri në f. 1921, rreshti 4.).

<sup>767</sup> [REDAKTUAR]. Në lidhje me praninë e [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një romi të tretë të ndaluar, *shih* Pjesët VI.D.2(d) VI.D.10(a).

428. Si rezultat, Trupi Gjykes konstaton se përshkrimi i TW4-11-shit është tejet i mbështetshëm dhe mbështetet në këtë dëshmi gojore për të identifikuar [REDAKTUAR], W04733-shin, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë rom si të ndaluar bashkë me të në dhomën 1.

429. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykes konstaton se TW4-11 u mbajt i ndaluar në FMK në periudha përkuese me [REDAKTUAR], W04733-shin, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë rom.

(d) Rrethanat e lirimit

430. Në lidhje me lirimin, TW4-11 dëshmoi se ai qëndroi në FMK për rreth një muaj.<sup>768</sup> Dëshmitari nuk dha datën e saktë të lirimit, por tha se kur forcat e NATO-s hynë në Kosovë, “u çelën dyrët dhe vetëm kam dalë pi aty”.<sup>769</sup>

431. Trupi Gjykes rikujton se, duke marrë parasysh moshën e shtyrë të dëshmitarit dhe kohën që ka kaluar, ai ka pranuar pasaktësinë sa i takon datës së saktë të arrestimit të tij. Trupi Gjykes është i mendimit se të njëjtat arsye vlejné dhe për datën e lirimit të tij. Çka është me rëndësi, vlerësimi i dëshmitarit se ai u mbajt për rreth një muaj i mundëson Trupit Gjykes të nxjerrë përfundimin se ai u lirua nga mesi i qershorit 1999. Dëshmia e dëshmitarit lidhur me këtë aspekt përputhet me deklaratën e W01448-ës se TW4-11 u lirua para 17 qershorit 1999.<sup>770</sup>

432. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykes konstaton se heqjes së lirisë së TW4-11-shit në FMK i erdhi fundi rreth mesit të qershorit 1999.

---

<sup>768</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1199, rreshtat 106.

<sup>769</sup> **TW4-11**: T. 3 maj 2023, publik, f. 1260, rreshtat 14-17; f. 1306, publik, rreshtat 11-16.

<sup>770</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013757; SITF00016140-SITF00016220 RED3, f. SITF00016142.

## (e) Mungesa e garancive procedurale

433. Sa i takon detyrimin për të informuar personin që i është hequr liria për arsyet e heqjes së lirisë, TW4-11 dëshmoi se kur e arrestuan nuk i dhanë asnjë njoftim lidhur me këtë.<sup>771</sup> Konkretisht, TW4-11 dëshmoi se, në një rast ai u mor në pyetje nga z. Kryeziu, i cili e prezantoi vetën si “gjykatës apo prokuror”<sup>772</sup> – përshkrim ky që konfirmohet nga deklarata e z. Kryeziu.<sup>773</sup> Megjithatë, TW4-11 shpjegoi se as z. Kryeziu, as askush tjetër, nuk ia treguan arsyen e arrestimit dhe ndalimit.<sup>774</sup> Sipas TW4-11-shit, ai kuptoi vetëm nga fundi i ndalimit, se UÇK-ja ishte autoriteti përgjegjës për arrestimin.<sup>775</sup>

434. Trupi Gjykses vë në dukje se gjatë gjithë dëshmisë, dëshmitari kishte kujdes dhe u përpoq t’i qëndronte besnik përvojës së tij gjatë asaj kohe. Trupi Gjykses nuk ka arsye për të dyshuar dëshminë e qartë dhe pa mëdyshje në lidhje me këtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se TW4-11 nuk u informua si duhet për arsyet e arrestimit dhe heqjes së lirisë.

435. Sa i përket detyrimin për ta nxjerrë personin e ndaluar pa vonesë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent dhe detyrimin për t’i dhënë personit të cilit i është hequr liria mundësinë të bëjë ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tij, Trupi Gjykses vë në dukje se afërsisht pas një muaji ndalimi në FMK, TW4-11 u nxor para z. Kryeziu.<sup>776</sup> TW4-11 sqaroi më tej se ai nuk e dinte identitetin e z. Kryeziu në

---

<sup>771</sup> **TW4-11:** T. 3 maj 2023, publik, f. 1266, rreshtat 3-10.

<sup>772</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1222, rreshtat 16-20; T. 3 maj 2023, publik, f. 1261, rreshtat 6-21.

<sup>773</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016916.

<sup>774</sup> **TW4-11:** T. 3 maj 2023, publik, f. 1266, rreshtat 3-10.

<sup>775</sup> **TW4-11:** T. 3 maj 2023, publik, f. 1263, rreshti 11 deri në f. 1265, rreshti 21.

<sup>776</sup> **TW4-11:** T. 3 maj 2023, publik, f. 1261, rreshtat 6-18 dhe f. 1262, rreshtat 10-22. Dëshmitari identifikoi gjithashtu në bazë të pamjes z. Kryeziu në fotografi të cilat iu treguan gjatë dhënies së dëshmisë (*shih* T. 3 maj 2023, publik, f. 1267 dhe SITF00013100-00013122 RED3, f. SITF00013101).

atë kohë, por e mësoi pas ngjarjeve.<sup>777</sup> Sipas TW4-11-shit, z. Kryeziu i bëri disa pyetje, përfshirë në lidhje me profesionin dhe vendndodhjen gjatë konfliktit.<sup>778</sup> Z. Kryeziu në vazhdim i tha “më vjen keq se nuk kam kurrnifarë argumenti ndaj teje”.<sup>779</sup>

436. Trupi Gjykses konstaton se TW4-11 ishte i besueshëm në përshkrimin e tij lidhur me këtë aspekt. Ai përshkroi përvojën në mënyrë të sinqertë, të përmbledhur dhe të gjallë. Dëshmitari ishte gjithashtu i sinqertë gjatë dhënies së dëshmisë, duke specifikuar kur nuk i kujtoheshin hollësitë të cilat iu parashtruan, si për shembull, nëse z. Kryeziu u prezantua si “prokuror i UÇK-së”.<sup>780</sup> TW4-11 vullnetarisht tregoi dhe se ai e mësoi identitetin e z. Kryeziu pas ngjarjeve.<sup>781</sup> Gjithashtu, fakti që z. Kryeziu intervistoi TW4-11-shin konfirmohet nga deklaratat e vetë z. Kryeziu, sikurse shpjegohet më lart.<sup>782</sup> Përgjithësisht, Trupi Gjykses nuk sheh arsye për të dyshuar saktësinë e përshkrimit të TW4-11-shit lidhur me këtë aspekt.

437. Trupi Gjykses vë në dukje se, megjithëse z. Kryeziu u prezantua si gjykatës ose prokuror, provat janë të qarta se ai në fakt nuk kishte mbikëqyrje të pavarur mbi ligjshmërinë e ndalimit të TW4-11-shit ose të të tjerëve.<sup>783</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vëren gjithashtu se dëshmitari nuk konfirmoi, as nuk mohoi nëse lirimi i tij erdhi si rezultat i intervistës së tij me z. Kryeziu.<sup>784</sup>

438. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nxjerr përfundimin se TW4-11 nuk u nxor para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent për të shqyrtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.

---

<sup>777</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1262, rreshti 24 deri në f. 1263, rreshti 5.

<sup>778</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1266, rreshtat 5-6.

<sup>779</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1265, rreshti 22 deri në f. 1266, rreshti 6.

<sup>780</sup> *Shih, për shembull, TW4-11*: T. 3 maj 2023, publik, f. 1261, rreshtat 19-21; f. 1262, rreshtat 10-22.

<sup>781</sup> *Shih, për shembull, TW4-11*: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1262, rreshti 24 deri në f. 1263, rreshti 5.

<sup>782</sup> *Shih* para. 433 më lart.

<sup>783</sup> *Shih gjithashtu*, para. 351-353 më lart.

<sup>784</sup> TW4-11: T. 3 maj 2023, publik, f. 1305, rreshti 25 deri në f.1306, rreshti 16.

439. Nga rrethanat e lirimit të tij, Trupi Gjykses nxjerr përfundimin se TW4-11-shit nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij dhe se ishte në mëshirën e atyre që e morën në ndalim.

440. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-11 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxor pa vonesë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

## 5. W04733

### (a) Arrestimi fillestar dhe transferimi në FMK

441. *Arrestimi në Durrës.* Dëshmitari tha se u arrestua në Durrës, Shqipëri, më 18 maj 1999, nga katër burra të veshur me uniforma të zeza të UÇK-së, me emblemë të UÇK-së.<sup>785</sup> Ai shpjegoi se anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Xhemshit Krasniqi, e kërkonin vazhdimisht, edhe para se ta arrestonin më 18 maj 1999.<sup>786</sup> Në deklaratat e tij, W04733 karakterizoi ngjarjen e 18 majit 1999 si “rrëmbim”,<sup>787</sup> duke theksuar se burrat u identifikuan si policë ushtarak të UÇK-së, e mbajtën nën kërcënim të armëve, urdhëruan të “dorëzoh[ej]” dhe të futej në veturë me ta.<sup>788</sup> Kjo ndodhi në prani të të tjerëve, përfshirë të anëtarëve të familjes së W04733-shit dhe pronarit të shtëpisë ku po qëndronin W04733 dhe familja e tij. Dëshmitari shpjegoi se, njëri prej djemve të tij – TW4-08 – identifikoi njërin nga këta anëtarë të UÇK-së si Bashkim Lama, të cilin e njohte nga e kaluara.<sup>789</sup> Sipas deklaratave të W04733-shit, W04733 njohu vozitësin e

---

<sup>785</sup> **W04733:** SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013804-SPOE00013805; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019827.

<sup>786</sup> **W04733:** SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013183-SITF00013184.

<sup>787</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 51, rreshtat 2-11.

<sup>788</sup> **W04733:** SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184.

<sup>789</sup> **W04733:** SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184; **TW4-08:** 27 mars 2023, publik, f. 659, rreshti 7 deri në f. 660, rreshti 8.

veturës dhe më vonë e pa personin në FMK dhe dëgjoji se i referoheshin si komandant "Loçka".<sup>790</sup> W04733 tha se u ndje i detyruar të futej në veturë me katër anëtarët e UÇK-së. Pasi e futën në veturë, duart i pati në pranga.<sup>791</sup> Dëshmitari e kujtoi këtë incident me hollësi të gjalla:

Meqë personat e UÇK-së ishin të armatosur, unë u detyrova të shkoja me ta, përndryshe ata do të më vrisnin. Sapo hipa në makinë, personat e UÇK-së më vunë prangat. Edhe pronari i shtëpisë hipi në makinë dhe këmbënguli që të më shoqëronte por, kur u nis makina, atë e hodhën jashtë.<sup>792</sup>

442. Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitari përshkroi qartë dhe me kujdes momentin e arrestimit. Ai pranoi menjëherë se fillimisht nuk i njihte personat të cilët e arrestuan dhe shpjegoi se si i mësoi emrat e tyre më vonë. Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në dëshminë e tij, sepse ajo është e besueshme dhe përputhëse në vetvete. Vlen të theksohet se W04733 implikoi një numër personash të tjerë, çka i shtoi përshkrimin komplikim të panevojshëm. Trupi Gjykses vlerësoi deklaratat e mëparshme të W04733-shit së bashku me dëshmi të tjera të dhëna në sallë të gjyqit, duke i mbajtur parasysh ato dëshmi.

443. Sa i takon vendit dhe kohës së arrestimit të W04733-shit, si dhe personave të cilët arrestuan W04733-shin, Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmia e TW4-08-ës, i cili pa arrestimin, konfirmon këto pretendime.<sup>793</sup> Një anëtar tjetër i familjes, TW4-06, i cili nuk e pa arrestimin, por erdhi teksa vetura po largohej me W04733-shin, gjithashtu konfirmoi rrethanat e arrestimit.<sup>794</sup> Krahas kësaj, TW4-08 dëshmoi se babait të tij nuk

---

<sup>790</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184.

<sup>791</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184.

<sup>792</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184.

<sup>793</sup> **TW4-08**: T. 27 mars 2023, publik, f. 659, rreshtat 7-10.

<sup>794</sup> **TW4-06**: T. 28 mars 2023, publik, f. 801-802.



iu tregua asnjë fletarrestim në atë kohë.<sup>795</sup> Përshkrimet e anëtarëve të familjes përputhen dhe janë të drejtpërdrejta.<sup>796</sup>

444. Trupi Gjykses pranon se, sa i takon datës dhe rrethanave të arrestimit, ai kryesisht mbështetet në dëshminë e W04733-shit dhe anëtarëve të familjes së vet. Trupi Gjykses i kushton kujdes faktit që anëtarët e familjes mund të jenë marrë vesh mes veti për këto aspekte. Megjithatë, pas shqyrtimit të kujdesshëm të dëshmive, Trupi Gjykses nuk gjen arsye për të dyshuar vërtetësinë e dëshmisë së W04733-shit dhe anëtarëve të familjes së tij. Çka është me rëndësi, njëri prej anëtarëve të familjes – TW4-08 – i cili ishte dëshmitar okular i arrestimit, konfirmoi në sallë të gjyqit ato që W04733 kishte thënë në deklaratat e tij. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i kushton peshë të veçantë dëshmisë së TW4-08-ës lidhur me këtë aspekt. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se arrestimi i W04733-shit u krye me të njëjtën mënyrë veprimi sikurse për shembull arrestimi i TW4-11-shit, W01448-ës, TW4-05-ës, TW4-04-ës dhe TW4-02-shit, çka mbështet ekzistencën e një praktike arrestimi dhe ndalimi.<sup>797</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në deklaratat e W04733-shit dhe dëshmitë e anëtarëve të familjes sa i takon datës dhe rrethanave të arrestimit të W04733-shit, që janë fakte të cilat ata i dinë personalisht.

445. Si rezultat, Trupi Gjykses është bindur se W04733-shit iu hoq liria më 18 maj 1999, nga anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së, ndër të cilët Bashkim Lama dhe një komandant “Loçka”.

446. *Transferimet: Durrës-Romanat dhe Romanat-FMK.* Në lidhje me transferimin e W04733-shit nga Durrësi në Romanat, W04733 tha se ia lidhën sytë dhe duart dhe

---

<sup>795</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 659, rreshtat 20-22; f. 660, rreshtat 6-8.

<sup>796</sup> **TW4-06:** T. 28 mars 2023, publik, f. 791-792, 801; **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 903, 906; **TW4-09:** T. 30 mars 2023, publik, f. 978- 979.

<sup>797</sup> *Shih* Pjesët VI.D.4(a), VI.D.6(a), VI.D.7(a), VI.D.8(a) dhe VI.D.9(a).

shkurtimisht e çuan në një bunker ushtarak “të Enver Hoxhës”.<sup>798</sup> Më tej ai përshkroi se në Romanat e mbajtën në një vend, për të cilin më vonë kuptoi se ishte objekt i dikurshëm i ushtrisë shqiptare të cilën e përdorte UÇK-ja.<sup>799</sup> Sipas dëshmitarit, komandant “Loçka” dhe komandant Ramadan Selimi e rrahën, e morën në pyetje dhe akuzuan se ishte tradhtar.<sup>800</sup> Dëshmitari tha gjithashtu se komandant Ramadan Selimi u përpoq të detyronte W04733-shin të pranonte se “ke vrrarë 100 vetë. Edhe i ke dhunu 40 femna” – përshkrim ky i cili konfirmohet nga dëshmia gojore e TW4-01-shit, i cili kujtoi pretendime të ngjashme kundër W04733-shit në FMK.<sup>801</sup>

447. Më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, W04733, i veshur me uniformë të policisë ushtarake të UÇK-së, u transportua nga Romanati në FMK me një autobus të vogël nga një grup anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala.<sup>802</sup> Dëshmitari tha se, rrugës për në Kukës, anëtarët e UÇK-së në autobus e quajtën “komandant i serbëve”, dhe e kërcënuan me vdekje në qoftë se do të tentonte të arratisëj.<sup>803</sup> Dëshmitari theksoi se z. Shala, të cilit anëtarët e tjerë të UÇK-së në autobus i drejtoheshin me pseudonimin Ujku, ulërinte si ujk.<sup>804</sup>

448. Provat e administruara prej Trupit Gjykues në lidhje me transferimin e W04733-shit nga Durrësi në Romanat dhe më pas në FMK burojnë kryesisht nga përshkrimi i W04733-shit. Në këtë drejtim, Trupi Gjykues konstaton se deklaratat e W04733-shit janë veçanërisht përputhëse, sidomos përshkrimi i ndërtesës në të cilën e çuan në

---

<sup>798</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 42-43.

<sup>799</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 39-40.

<sup>800</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 43-45.

<sup>801</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 46. **TW4-01**: 30 maj 2023, konfidencial, f. 1455, rreshtat 1-11.

<sup>802</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 3 RED2 (Pjesa 3 RED2), f. 2-11; *Shih gjithashtu*, SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019831, SITF00019836-SITF00019837.

<sup>803</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 3 RED2 (Pjesa 3 RED2), f. 10, 16-17.

<sup>804</sup> **W04733**: SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741 dhe 082892-TR-AT-ET Part 3 RED2 (Pjesa 3 RED2), f. 12.

Romanat,<sup>805</sup> keqtrajtimit dhe kërcënimeve që iu bënë,<sup>806</sup> anëtarëve të UÇK-së përgjegjës,<sup>807</sup> dhe se si ndodhi transportimi nga Romanati në FMK.<sup>808</sup> W04733 dha gjithashtu hollësi konkrete dhe unike, sikurse vendndodhjen e përafërt të vendit në Romanat ku u mbajt ai dhe rrugën që morën anëtarët e UÇK-së të cilët po e transportonin.<sup>809</sup> Po kështu, Trupi Gjykses vëren se përskrimi prej dëshmitarit i ndalimit dhe keqtrajtimit të tij në Romanat ishte i hollësishëm, i gjallë dhe përputhej në të gjitha deklaratat e tij. Dëshmitari përskroi se e goditën me shkop gome në kokë, krahë dhe shputat e këmbëve.<sup>810</sup> Personat që e kishin ndaluar e goditën “sa ç’ka kanë mujtë”<sup>811</sup> dhe përdorën shok elektrik.<sup>812</sup> Kjo e thellon besimin e Trupit Gjykses se W04733 foli nga përvoja personale. Trupi Gjykses konstaton se është e pagjasë që W04733 të ketë trilluar një përskrim me këtë nivel hollësish, duke implikuar një numër personash të tjerë. Përkundrazi, ai nuk identifikon asnjë motiv që dëshmitari ta bënte këtë. Vlen të theksohet se akuzat për vrasje dhe përdhunim të shumë personave dhe se ishte “komandant i serbëve” ishin të ngjashme me akuzat që iu bënë

---

<sup>805</sup> Dëshmitari W04733 saktësoi se ky ishte një bunker ushtarak, *shih W04733: 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 42-43; 106978-107020, f.106991; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184.*

<sup>806</sup> Dëshmitari tha se, në një moment ia lidhën sytë, dhe dëgjoi personat që e kishin ndaluar duke nxjerrë revolet dhe duke i thënë njëri-tjetrit “vraje ti, vraje ti”, *shih W04733: 082892-TR-AT-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 43.*

<sup>807</sup> W04733 identifikoi Ramadan Selimin, ose “komandant Dani”, si komandant në Romanat, *shih W04733: 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 30, rreshtat 19-22.*

<sup>808</sup> Dëshmitari tha se transporti fillimisht u krye me një veturë, deri te një pompë benzine, ku W04733-shin e futën në një “minibus” ose “kombibus”, *shih W04733: 082892-TR-AT-ET PART 3 RED2 (Pjesa 3 RED2), f. 3, rreshti 18 dhe f. 10-11.*

<sup>809</sup> Për shembull, ai saktësoi se vendi ku u mbajt ishte 25-30 minuta larg Durrësit në drejtim të Tiranës dhe se personat të cilët e çuan atje përdorën një rrugë anësore përgjatë bregdetit për të mbërritur te vendi, *shih W04733: 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 30, 40.*

<sup>810</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 44, rreshtat 3-7.

<sup>811</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 44, rreshtat 15-16.

<sup>812</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 44, rreshtat 7-11; f. 46, rreshtat 3-6; f. 47-49 (duke përskruar si i vunë shok elektrik dhe dhimbjen e shkaktuar).

të ndaluarve të tjerë, si TW4-01-shit [REDAKTUAR].<sup>813</sup> Këto ngjashmëri përforcojnë bindjen e Trupit Gjykses se dëshmia që dha W04733 është e vërtetë.

449. Trupi Gjykses vë në dukje, më tej, se anëtarët e familjes së W04733-shit gjithashtu konfirmuan disa hollësi kyçe në lidhje me transferimin, të cilat W04733 ua tregoi atyre, sikurse kohëzgjatjen e përafërt të ndalimit dhe keqtrajtimit të W04733-shit në Romanat dhe kërcënimet kundër tij.<sup>814</sup> Trupi Gjykses kupton se ata personalisht nuk ishin dëshmitarë të transferimit dhe dëshmitë e tyre të dorës së dytë mbështeten kryesisht në ato që u tha W04733 pas ngjarjeve. Pavarësisht nga kjo, Trupi Gjykses vë në dukje, në mënyrë të favorshme, se dëshmitarët bënë qartë dallimin midis çfarë panë personalisht dhe informacionin që u dha W04733. Kjo i bën më të mbështetshme dëshmitë e tyre. Duke pasur parasysh mbështetshmërinë e dëshmisë së W04733-shit në lidhje me transferimin në Romanat dhe në FMK, Trupi Gjykses u kushton njëfarë peshe dëshmive të dorës së dytë të anëtarëve të familjes. Përfundimisht, dëshmia e W04733-shit dhe dëshmitë e familjes së tij përputhen dhe janë reciprokisht konfirmuese.

450. Mbrojtja kundërshton aspekte konkrete të dëshmisë së W04733-shit dhe pretendon se dëshmia e W04733-shit nuk është e mbështetshme, sepse: (i) W04733 bëri përshkrim “krejtësisht të pasaktë” të z. Shala, duke qenë se e përshkroi si person me fytyrë të zeshkët, pothuajse të zezë me vetulla të zeza;<sup>815</sup> (ii) dëshmitari vetëm në vitin 2010 pretendoi se z. Shala ishte i pranishëm në transferimin e tij në Kukës, pavarësisht

---

<sup>813</sup> *Shih* para. 404 më lart; *shih ngjashëm*, para. 656 më poshtë.

<sup>814</sup> **TW4-09**: T. 30 mars 2023, publik, f. 979, rreshtat 4-14 (TW4-09 dëshmoi se W04733 i kishte treguar se fillimisht e kishin çuar në një “kamp të vogël” dhe se “ka pasë ca kërcënime gjatë rrugës”); **TW4-07**: T. 29 mars 2023, publik, f. 903, rreshtat 11-18 (TW4-07 dëshmoi se W04733 i kishte treguar se u mbajt në një vend një natë a dy para se ta çonin në FMK, ku e rrahën dhe keqtrajtuuan). **TW4-06**: T. 28 mars 2023, publik, f. 814, rreshti 5 deri në f. 815, rreshti 6 (TW4-06 dëshmoi se W04733 i kishte treguar se “e kanë torturu” dhe se “edhe me verbale, në mënyrë verbale, fjalë jo njerëzore”, dhe se ata të cilët e mbanin i thanë “vetëm që do ta vrasim, kush po e vranë, vetëm këto”).

<sup>815</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 15, 97, 239.

se kishte pasur mundësi të shumta për ta implikuar më parë,<sup>816</sup> dhe (iii) identifikimi i bërë prej tij ishte ndikuar nga sugjerimet e të paktën TW4-01-shit.<sup>817</sup>

451. Në lidhje me argumentin e parë të Mbrojtjes për identifikim e gabuar të z. Shala prej dëshmitarit, Trupi Gjykses rikujton se W04733 e njihte z. Shala përmes punës së tij si polic para lufte, sepse ai asokohe ishte person nën përcjellje të policisë.<sup>818</sup> Megjithëse W04733 pranoi se ai nuk e kishte takuar z. Shala personalisht para vitit 1998, ai tha se kishte dëgjuar se z. Shala është nga fshati Dujakë dhe se kishte parë një fotografi të z. Shala në fotoalbum të policisë.<sup>819</sup> Gjithashtu, W04733 tha qartësisht se ai e njohu z. Shala “si e [...] pa” në autobus, identifikim ky që mbështetet më tej nga ulërima e dallueshme e z. Shala.<sup>820</sup> Sipas vlerësimit të Trupi Gjykses, nuk ka rëndësi nëse dëshmitari përshkroi saktë dukjen fizike të z. Shala, sepse dukjet ndryshojnë me kohë dhe kujtesa e dëshmitarit mund të ndikohet nga koha që ka kaluar. Trupi Gjykses i kushton më shumë peshë faktit se dëshmitari kujtoi saktë pseudonimin e z. Shala, të cilin e dëgjoi nga anëtarë të tjerë të UÇK-së gjatë transferimit në autobus, dhe “ulërimën” karakteristike të z. Shala. Kjo është me rëndësi sepse vetë z. Shala thotë se pseudonimi i tij gjatë luftës ishte Ujku dhe se “ulërinte si ujku”.<sup>821</sup>

452. Mbrojtja sugjeron gjithashtu se dëshmia e W04733-shit kundërshtohet nga dëshmitë e anëtarëve të familjes të cilët dëshmuuan se nuk patën dijeni për identitetin e z. Shala deri pas lufte. Për këtë qëllim, Mbrojtja mbështetet veçanërisht në dëshminë e TW4-09-shit, sipas të cilit W04733 nuk tha asnjëherë se e njihte z. Shala përmes punës

---

<sup>816</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 15.

<sup>817</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 97.

<sup>818</sup> **W04733**: SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019836-SITF00019837; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741; 082892-TR-AT-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 37-38; 082892-TR-AT-ET Part 3 RED2 (Pjesa 3 RED2), f. 11.

<sup>819</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 37-38.

<sup>820</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 3 RED2 (Pjesa 3 RED2), f. 11-12.

<sup>821</sup> **z. Shala**: 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 132-133.

së tij si polic.<sup>822</sup> Trupi Gjykses konstaton se, edhe në qoftë se është e vërtetë, vlerësimi i një anëtari të familjes, i cili nuk është dëshmitar i drejtpërdrejt i ngjarjeve, nuk ul vlerën e faktit që W04733 mundi të njihje z. Shala në bazë të emrit të tij dhe “ulërimës” karakteristike, duke qenë se dinte për të nga puna si polic. Si rezultat, Trupi Gjykses është bindur se W04733 e identifikoi qartë z. Shala dhe për këtë arsye hedh poshtë kundërshtimin e Mbrojtjes në lidhje me këtë.

453. Në lidhje me sugjerimin e dytë të Mbrojtjes se W04733 për herë të parë përmendi z. Shala më 2010 si të implikuar në transferimin e tij, megjithëse W04733 kishte pasur mundësi ta përmendte në deklaratat e mëparshme, Trupi Gjykses konstaton se ky nivel i ndryshëm i hollësive mund të shpjegohet nga llojet e ndryshme të pyetjeve që parashtrohen nga autoritete të ndryshme. Thënë thjesht, në deklaratat e mëparshme, W04733-shit nuk iu kërkua të jepte hollësi për personat e përfshirë në transferimin e tij, ku pyetjet kryesisht kishin të bënin me autorët e mundshëm në FMK. Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se argumenti i Mbrojtjes është i pabazë.

454. Në lidhje me argumentin e tretë të Mbrojtjes se pretendohet se TW4-01 ndikoi që W04733 të inkriminonte z. Shala, Trupi Gjykses rikujton se W04733 arriti të identifikonte z. Shala me anë të pseudonimit të tij dhe “ulërimës” karakteristike. Mbrojtja nuk paraqet asgjë në mbështetje të pretendimit se TW4-01 dhe W04733 u morën vesh lidhur me këtë aspekt. Si rezultat, Trupi Gjykses nuk pranon sugjerimin e Mbrojtjes se W04733 mësoi identitetin e z. Shala nga TW4-01.<sup>823</sup>

---

<sup>822</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 238 dhe 247, i referohet **TW4-09**: T. 30 mars 2023, publik, f. 1007.

<sup>823</sup> TW4-01 dha dëshmi se, sipas tij “asnjë njeri përveç Xhemshitit edhe Sabitit s'e ka ditë emnin, edhe Pjetër Shalën s'e ka njoftë” (T. 5 qershor 2023, konfidencial, f. 1786-1787). Mbrojtja nga kjo arrin në përfundimin se W04733 nuk e dinte në atë kohë identitetin e z. Shala. Trupi Gjykses vë në dukje se ky nuk është i vetmi deduksion i mundshëm. Konkretisht, TW4-01-shin nuk e pyetën shprehimisht asnjëherë nëse ishte i vetëdijshëm se W04733 e dinte kush ishte z. Shala.

455. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se, W04733 u transferua nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, nga Romanati në FMK, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.

(b) Vendi i ndalimit në FMK

456. Trupi Gjykses vë në dukje se, sipas W04733-shit, para se ta çonin në dhomën 1, ai për një kohë fillimisht u mbajt në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës.<sup>824</sup> Sa u takon të dyja vendeve, përshkrimi i W04733-shit përputhet me dëshmitë gojore të TW4-01-shit dhe TW4-11-shit dhe deklaratave të W01448-ës.<sup>825</sup> Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë të besueshme dhe reciprokisht konfirmuese.

457. W04733 dha gjithashtu dëshmi se natën kur ai mbërriti në FMK, (d.m.th. më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date), e çuan në zyrë, ku e morën në pyetje dhe e rrahën disa anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, sikurse shtjellohet në hollësi më poshtë.<sup>826</sup>

458. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitari u mbajt i ndaluar në FMK në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës dhe dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se W04733 u mbajt gjithashtu në zyrë gjatë kohës që e morën në pyetje dhe e keqtrajtuan.

---

<sup>824</sup> **W04733**: SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019829-SITF00019830; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013808-SPOE00013809; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 3.

<sup>825</sup> Në lidhje me dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, *shih* **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1471, rreshtat 2-11; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1915, rreshtat 9-17; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016229. Në lidhje me dhomën 1, *shih* **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1409, rreshti 19 deri në f. 1410, rreshti 10; T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1420, rreshti 5 deri në f. 1421, rreshti 24, *i referohet* skicës SITF00012876-SITF00012878, f. SITF00012878 (ruajtur si REG00954); **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1193, 1195-1199.

<sup>826</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(c).

## (c) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

459. Trupi Gjykues vë në dukje se W04733 tha se fillimisht e mbajtën në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, së bashku me W01448-ën.<sup>827</sup> W04733 shtoi se afërsisht tri ditë pasi e kishin çuar atje, e dërguan në dhomën 1, ku pa të ndaluar të tjerë, ndër të cilët TW4-01-shin, [REDAKTUAR] (TW4-11), TW4-05-ën, dhe “tre muzikantë romë” [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një muzikant i tretë rom).<sup>828</sup> Së fundi, W04733 kujtoi se [REDAKTUAR] ishte e pranishme në zyrë gjatë keqtrajtimit që ndodhi më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, të cilin Trupi Gjykues e përshkruan më poshtë.<sup>829</sup>

460. Trupi Gjykues konstaton se identifikimi prej W04733-shit i të ndaluarve të tjerë në dhomën 1 përputhet me përshkrimet e TW4-01-shit, TW4-11-shit dhe W01448-ës.<sup>830</sup> Dëshmitarët konfirmojnë praninë e njëri-tjetrit dhe praninë e të tjerëve, si të TW4-05-ës, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantit të tretë rom, në të njëjtin vendndalim ose në të njëjtat vendndalime dhe në të njëjtën kohë, shtojnë hollësi unike dhe konkrete. Rrjedhimisht, dëshmitarët japin dëshmi reciprokisht konfirmuese, të cilat i bëjnë përshkrimet e tyre përkatëse të besueshme, përputhëse dhe të mbështetshme.

461. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykues është bindur se W04733 u mbajt i ndaluar në FMK në të njëjtën kohë me TW4-01-shin,

---

<sup>827</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 16; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013185-SITF00013186. Në lidhje me vlerësimin e Trupit Gjykues të dëshmisë së W04733-shit lidhur me praninë e TW4-01-shit [REDAKTUAR] në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, *shih* para. 385 më lart.

<sup>828</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 5-6, 15-16; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013812-SPOE00013813, SPOE00013821- SPOE00013822; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018744-SITF00018745. *Shih gjithashtu*, Pjesën VI.D.10(a).

<sup>829</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013819; 106978-107020, f. 106987, 106999.

<sup>830</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2(d), VI.D.4(c) dhe VI.D.6(c).



viktimën e vrasjes së paligjshme, TW4-11-shin, W01448-ën, TW4-05-ën, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë rom.

(d) Rrethanat e lirimit

462. W04733 tha se ai u mbajt i ndaluar në FMK afërsisht deri rreth 1 qershorit 1999.<sup>831</sup> Sipas W04733-shit, afërsisht tri ose katër ditë para se të lirohej, ai u mor në pyetje në zyrë nga Xhemshit Krasniqi dhe Sokol Dobruna, të cilin dëshmitari e përshkroi si “gjykatës”.<sup>832</sup> Sipas dëshmitarit, W04733 pa kur z. Shala doli nga porta e objektit dhe pas disa minutash pa kur ai mbërriti në oborr të FMK-së në makinë me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën.<sup>833</sup> [REDAKTUAR].<sup>834</sup> Sipas W04733-shit, këta persona erdhën për ta liruar dhe ta kthenin te familja; megjithatë, ai nuk shkoi me ta atë ditë, sepse nuk dëshironte që familja ta shihte me lëndime.<sup>835</sup> Sipas përshkrimit të W04733-shit, [REDAKTUAR] më 1 qershor 1999 dhe pas një diskutimi të shkurtër me zyrtarë të UÇK-së, e çuan W04733-shin te familja.<sup>836</sup>

463. Trupi Gjykses konstaton se deklaratat e W04733-shit në lidhje me rrethanat e lirimit të tij janë të besueshme dhe kanë vërtetësi, sepse dëshmitari jep përshkrime koherente, kronologjike dhe të hollësishme.

464. Mbrojtja argumenton se dëshmia e W04733-shit në lidhje me rrethanat e lirimit dhe ngjarjet para lirimit është kundërthënëse, mospërputhëse dhe jo e besueshme.<sup>837</sup>

---

<sup>831</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 7 (Pjesa 7), f. 1-2, 6-7, 10-13. *Shih gjithashtu, TW4-08*: 27 mars 2023, publik, f. 666, rreshtat 15-18; **TW4-01**: 30 maj 2023, konfidencial, f. 1456; **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761.

<sup>832</sup> **W04733**: SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013823, SPOE00013825-SPOE00013827; 082892-TR-AT-ET Part 6 (Pjesa 6), f. 2, 4-7; SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185343.

<sup>833</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 6 (Pjesa 6), f. 7-8, 18-19; 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 5.

<sup>834</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 6 (Pjesa 6), f. 12-15; 26.

<sup>835</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 6 (Pjesa 6), f. 15-16.

<sup>836</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 7 (Pjesa 7), f. 1-2.

<sup>837</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 54-57.

Në veçanti, Mbrojtja kundërshton besueshmërinë dhe mbështetshmërinë në dëshminë e W04733-shit me argumentin se: (i) W04733 vetëm në deklaratën e vitit 2018 përmend se kishte parë z. Shala duke dalë nga porta e objektit, para se të kthehej me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën;<sup>838</sup> (ii) përshkrimi i W04733-shit është jo i besueshëm sepse, ndër të tjera, ishte e pamundur ta shihje portën e FMK-së nga dritarja e zyrës;<sup>839</sup> dhe (iii) W04733 kishte mospërputhje në identifikimin e [REDAKTUAR] që ndërhyjnë për lirimin e tij.<sup>840</sup>

465. Në lidhje me faktin se vetëm në deklaratën e tij më 2018, dëshmitari përmendi praninë e z. Shala në FMK, Trupi Gjykses është i mendimit se kjo mund t'i atribuohet llojit të ndryshëm të pyetjeve nga hetues të ndryshëm, e jo mungesës së lidhjes së brendshme logjike të dëshmisë së dëshmitarit. Konkretisht, është me rëndësi të theksohet se është e natyrshme që dëshmitarët, të cilët japin disa deklarata gjatë viteve, t'u shtojnë hollësi përshkrimeve të tyre të mëpasshme. Asnjë dëshmitar nuk mund të përshkruajë ngjarjet në mënyrë të plotë, dhe më vonë t'i paraqesë ato me të njëjtat fjalë, radhitje, strukturë dhe shkallë të hollësive në deklarata të ndryshme. Sido që të jetë, dëshmitarë të tjerë kanë konfirmuar faktin se z. Shala ishte i pranishëm në FMK gjatë periudhës që W04733 u mbajt i ndaluar atje.<sup>841</sup> Rrjedhimisht, nuk është e pagjasë që W04733 të ketë parë z. Shala në FMK afërsisht midis 20 majit 1999 dhe 1 qershorit 1999. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se pretendimi i Mbrojtjes është i pabazë.

466. Gjithashtu, në lidhje me pretendimin e Mbrojtjes se W04733 nuk mund ta shihte portën nga dritarja e zyrës, Trupi Gjykses konstaton se vija e shikimit nga zyra drejt oborrit nuk ishte e penguar. Fotografitë në prova mbështesin konstatimin e Trupit

---

<sup>838</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 6 (Pjesa 6), f. 7-8, 18-19; 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 5.

<sup>839</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 54.

<sup>840</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 55-56.

<sup>841</sup> *Shih* para. 369-370, 707; Pjesën VI.H.

Gjykues.<sup>842</sup> Po ashtu, deklarata e W04733-shit se ai pa z. Shala me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën në oborr është koherente dhe e besueshme. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se Mbrojtja nuk kundërshton praninë e z. Shala, Hashim Thaçit dhe Azem Sylës, por se a mundi apo nuk mundi të shihte W04733 portën nga zyra. Për arsyet e shtjelluara më lart, Trupi Gjykses konstaton se pretendimi i Mbrojtjes është i pabazë.

467. Në lidhje me kundërshtimin e Mbrojtjes ndaj dëshmisë së W04733-shit se e kishte parë z. Shala duke hyrë dhe dalë nga porta, Trupi Gjykses konstaton se, duke qenë se ai ka vërtetuar se W04733 mund ta shihte oborrin dhe se nuk kishte mënyrë tjetër për të hyrë dhe dalë nga FMK-ja, përveç nga porta, veçanërisht me makinë, argumenti i Mbrojtjes nuk ndikon në besueshmërinë e deklaratave të W04733-shit. Për arsyet e shtjelluara më lart, Trupi Gjykses hedh poshtë pretendimin e Mbrojtjes në lidhje me këtë.

468. Së fundi, në lidhje me kundërshtimin e Mbrojtjes se W04733 nuk mundi të identifikonte me saktësi [REDAKTUAR] që ndërhyri për ta liruar atë, Trupi Gjykses është i mendimit se nuk ka nevojë ta vërtetojë këtë fakt. Ajo që është me rëndësi është se W04733 u lirua më 1 qershor 1999, ose rreth kësaj date, jo si rezultat i një vendimi ligjor, por pas [REDAKTUAR]. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses hedh poshtë kundërshtimin e Mbrojtjes.

469. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se W04733 u lirua nga FMK-ja më 1 qershor 1999, ose rreth kësaj date, pas [REDAKTUAR].

---

<sup>842</sup> *Shih, për shembull*, SPOE00330365-00330365 dhe SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010279, në lidhje me 065597-065612, f. 065600 (fotografia poshtë, ruajtur si REG00956), në të cilën dëshmitari shënoi dritaren e zyrës, *shih TW4-01*: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1450, rreshti 4 deri në f. 1451, rreshti 23.

(e) Mungesa e garancive procedurale

470. Sa i takon detyrimet për ta informuar personin që i është hequr liria për arsyet e heqjes së lirisë, sipas W04733-shit, ai nuk u informua për arsyet ose bazën formale të ndalimit të tij.<sup>843</sup> Trupi Gjykses rikujton se dëshmitari u akuzua se ishte “komandant i serbëve” dhe se kishte vrarë dhe përdhunuar shumë njerëz.<sup>844</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se anëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së të cilët arrestuan W04733-shin, ishin të armatosur dhe e kërcënuan me armë, e urdhëruan të “dorëzoh[ej]” dhe të hipte në veturë me ta.<sup>845</sup> Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e W04733-shit lidhur me këtë aspekt është e besueshme, sepse është në vetvete përputhëse dhe konkrete. Informacioni që dha është kaq specifik dhe personal sa që Trupi Gjykses arrin në përfundimin se buronte nga njohuritë e vetë dëshmitarit. Gjithashtu, ajo konfirmohet nga dëshmia e TW4-08-ës, i cili dëshmoi se babait të tij nuk iu tregua fletarrestim në atë kohë.<sup>846</sup> Së fundi, Trupi Gjykses vëren se edhe TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme dhe TW4-11 nuk u informuan për arsyet e heqjes së lirisë, që rrjedhimisht mbështet ekzistencën e një praktike të tillë. Si rezultat, Trupi Gjykses mbështetet në dëshminë e dëshmitarit për të nxjerrë përfundimin se W04733 nuk u informua si duhej për arsyet e arrestimit dhe ndalimit.

471. Sa i takon nëse W04733 u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nëse iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij, Trupi Gjykses vë në dukje se W04733 u keqtrajtua rëndë gjatë mbajtjes në ndalim në FMK.<sup>847</sup> Deklaratat e W04733-shit zbulojnë më tej se ai u mor në pyetje në zyrë disa herë gjatë

---

<sup>843</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 6 (Pjesa 6), f. 4-6.

<sup>844</sup> *Shih* para. 448 më lart.

<sup>845</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013184; **TW4-08**: T. 27 mars 2023, publik, f. 659, rreshtat 16-22.

<sup>846</sup> **TW4-08**: T. 27 mars 2023, publik, f. 659, rreshtat 20-22; f. 660, rreshtat 6-8.

<sup>847</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(c) dhe VI.E.4.

mbajtjes në ndalim.<sup>848</sup> Konkretisht, W04733 dëshmoi se, gjatë keqtrajtimit në zyrë, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit Geci, e morën në pyetje për punën e tij të dikurshme si polic dhe e akuzuan se ishte tradhtar, vrasës, përdhunues dhe për bashkëpunim me serbët.<sup>849</sup> Gjatë këtij incidenti, z. Shala e akuzoi W04733-shin se ishte spiun.<sup>850</sup> Gjithashtu, W04733 tha se Xhemshit Krasniqi dhe Sokol Dobruna e morën në pyetje disa herë në zyrë.<sup>851</sup>

472. Vetë fakti se Sokol Dobruna e mori në pyetje W04733-shin së bashku me Xhemshit Krasniqin, i cili u përfshi drejtpërdrejt në keqtrajtimin e W04733-shit dhe e detyroi të jepte deklarata pranuese, tregon se Sokol Dobruna nuk kishte kompetencë për mbikëqyrje të pavarur të ligjshmërisë së ndalimit të W04733-shit, ose të ndalimit të dikujt tjetër. Gjithashtu, nga provat është e qartë se W04733 u lirua si rezultat i një ndërhyrjeje nga jashtë, dhe jo me vendim të një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent që mbikëqyri ligjshmërinë e ndalimit të tij. Për më tepër, Trupi Gjykues ka konstatuar se edhe të ndaluar të tjerë të cilët u mbajtën në FMK gjatë së njëjtës periudhë, si TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme dhe TW4-11, nuk u nxorën para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe atyre nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre.<sup>852</sup> Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se W04733 nuk u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

---

<sup>848</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106988-106989; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013823, SPOE00013825; 082892-TR-AT-ET Part 6 (Pjesa 6), f. 2, 4-7.

<sup>849</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019841-00019842; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013814-SPOE00013815; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 16- 17, 25.

<sup>850</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 10-11.

<sup>851</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 6 (Pjesa 6), f. 2, 4-7.

<sup>852</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2(f), VI.D.3(d) dhe VI.D.4(d).

473. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se W04733 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxor pa vonesë para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia që të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

## 6. W01448

### (a) Arrestimi fillestar dhe transferimi në FMK

474. Në lidhje me rrethanat e arrestimit, W01448 tha në deklaratat e tij se e morën në ndalim në portin e Durrësit, Shqipëri, pasi mbërriti me traget nga Gjermania (nëpërmes Barit, Itali).<sup>853</sup> Atij i kujtohej qartë se e pyetën për emrin dhe i kërkuan pasaportën para se ta merrnin në ndalim.<sup>854</sup> Mbrojtja nuk e kundërshton këtë fakt dhe Trupi Gjykses nuk ka arsye për të vënë në dyshim dëshminë e dëshmitarit lidhur me këtë aspekt.<sup>855</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se W01448 erdhi me traget nga Gjermania, nëpërmes Barit, Itali, dhe se u mor në ndalim në portin e Durrësit.

475. Në lidhje me datën e arrestimit fillestar, dëshmitari tha se u arrestua në Durrës, ditën e enjte, më 13 ose 14 maj 1999.<sup>856</sup> Dëshmitari konkretisht tha se u nis nga Gjermania atë javë sepse e enjtja e asaj jave ishte ditë feste zyrtare.<sup>857</sup> Trupi Gjykses nuk i kushton shumë rëndësi mospërputhjes së vogël prej një dite në deklaratat e dëshmitarit sa i përket datës së saktë të arrestimit të tij. Ai jep hollësi të mjaftueshme

---

<sup>853</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737;

<sup>854</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013854; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016227.

<sup>855</sup> *Shih gjithashtu* të ndaluarit e tjerë me W01448-ën, të cilët e identifikuan duke iu referuar Gjermanisë dhe mbërritjes së tij nga atje në Durrës, **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013185; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 7-8; **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1440, rreshtat 8-20; **TW4-05**: SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

<sup>856</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013854; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737; SITF00016221-SITF00016285 RED4, f. SITF00016227. Sipas kalendarit vjetor, më 13 maj 1999 në fakt ishte Dita e Shëlbimit.

<sup>857</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737.

që i mundësojnë Trupit Gjykues të nxjerrë përfundim në lidhje me këtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues arrin në përfundimin se dëshmitari u arrestua në Durrës, më 13 maj 1999, ose rreth kësaj date.

476. Në lidhje me personat e përfshirë në ndalimin e tij, W01448 tha se u arrestua nga persona të veshur me tesha civile.<sup>858</sup> Personat nuk u prezantuan dhe e çuan W01448-ën me veturë në një vend në Durrës.<sup>859</sup> Sipas W01448-ës, gjatë rrugës në veturë dhe pas mbërritjes në vendndodhjen e parë në Durrës, e qortuan që nuk kishte dhënë kontribut financiar të mjaftueshëm për UÇK-në – akuzë kjo që u përsërit edhe pas mbërritjes në FMK.<sup>860</sup> Sipas dëshmitarit, ishte pikërisht ky moment kur e kuptoi se këta persona e kishin marrë në ndalim.<sup>861</sup> Në deklaratat e tij, W01448 gjithashtu theksoi se gjatë kësaj periudhe ai vazhdimisht kërkoi ta lironin dhe ta lejonin të bashkohej me familjen në Tiranë, Shqipëri. Megjithatë, ata i thanë se duhej të priste “derisa të zhvillohet një intervistë apo gjykim”.<sup>862</sup> Nga sa më lart, Trupi Gjykues dedukton se dëshmitari nuk ishte i lirë të largohej dhe duhej t’u përmbahej udhëzimeve të personave që e morën.

477. Në lidhje me transferimin në FMK, dëshmitari tha se fillimisht e çuan me veturë në një vend 2 km larg në drejtimin Durrës-Tiranë,<sup>863</sup> ku e mbajtën deri të hënën e javës vijuese, d.m.th. 17 maj 1999.<sup>864</sup> W01448 më tej shtoi se, më të njëjtën ditë, persona të veshur me tesha civile dhe të armatosur, të cilët besonte se ishin të UÇK-së, e çuan në

---

<sup>858</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737.

<sup>859</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737; SITF00016221-SITF00016285 RED4, f. SITF00016227- SITF00016228; SITF00013852-00013869 RED6, SITF00013854.

<sup>860</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737-SITF00013740.

<sup>861</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013738.

<sup>862</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013738.

<sup>863</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013855.

<sup>864</sup> Në njëërën prej deklaratave të tij, W01448 përmend se u transferua në Kukës të hënën, më 18 maj 1999 (**W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013738-SITF00013739). Trupi Gjykues vë në dukje se 17 maji 1999 ishte e hënë dhe rrjedhimisht, konstaton se ishte të hënën, më 17 maj 1999, kur W01448 mbërriti për të parën herë në Kukës.

FMK.<sup>865</sup> Dëshmia e W01448-ës ka ngjashmëri me dëshmitë e W04733-shit dhe TW4-04-ës, të cilët treguan se u arrestuan dhe fillimisht u mbajtën në një vend tjetër para se anëtarët e UÇK-së t'i transferonin në FMK.<sup>866</sup> Dëshmia e W01448-ës në lidhje me rrethanat e arrestimit të tij ka ngjashmëri edhe me dëshmitë e TW4-11-ës dhe TW4-05-ës, të cilët përmendën se anëtarë të UÇK-së erdhën dhe i kërkuan dhe u thanë që të shkonin me ta për t'u "marrë në pyetje" ose "me dhanë një deklaratë".<sup>867</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, dëshmitë e këtyre dëshmitarëve të tjerë janë të besueshme dhe reciprokisht konfirmuese dhe tregojnë se këta dëshmitarë, sikurse edhe W01448, nuk shkuan vullnetarisht, por u arrestuan me forcë dhe u mbajtën kundër dëshirës së tyre.

478. Trupi Gjykses vë në dukje se përshkrimi prej W01448-ës i kronologjisë së këtyre ngjarjeve është i pasur me hollësi, i besueshëm dhe në vetvete përputhës. Gjithashtu, deklarata e W01448-ës se e çuan në FMK më 17 maj 1999, ose rreth kësaj date, përputhet me deklaratat e W04733-shit sipas të cilave zyrtarisht tha se kur e çuan në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, W01448 tashmë ishte atje.<sup>868</sup>

479. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se W01448 u arrestua më 13 maj 1999, ose rreth kësaj date, dhe më pas u transferua në FMK nga anëtarë të armatosur të UÇK-së, më 17 maj 1888, ose rreth kësaj date.

---

<sup>865</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013740.

<sup>866</sup> *Shih* Pjesët VI.D.5(a) dhe VI.D.8(a).

<sup>867</sup> *Shih* para. 416 më lart dhe para. 496 më poshtë.

<sup>868</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013741-SITF00013742; **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 7; SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013185; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013809-SPOE00013810.



## (b) Vendi i ndalimit në FMK

480. Dëshmitari tha se kur mbërriti në FMK, fillimisht e mbajtën në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës.<sup>869</sup> W01448 tha gjithashtu se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, e çuan në zyrë, ku e morën në pyetje dhe e keqtrajtuan së bashku me W04733-shin, TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme dhe [REDAKTUAR].<sup>870</sup> Dëshmitari deklaroi se më pas e zhvendosën në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit,<sup>871</sup> të cilën e përshkroi se ruhej me roje.<sup>872</sup> Krahas kësaj, dëshmitari deklaroi se u mor në pyetje edhe disa herë të tjera, kryesisht në zyrën në ndërtesën e komandës.<sup>873</sup>

481. Përshkrimi prej dëshmitarit i dhomës së ndalimit në ndërtesën e komandës përputhet me përshkrimin që dha W04733, i cili u mbajt i ndaluar atje në të njëjtën kohë me W01448-ën.<sup>874</sup> Ai përputhet gjithashtu edhe me përshkrimin e shkurtër që dha TW4-01 në bazë të asaj që kishte dëgjuar [REDAKTUAR].<sup>875</sup> Gjithashtu, dëshmia e W01448-ës për madhësinë e dhomës 1 dhe se nuk kishte hapësirë të mjaftueshme ku të ndaluarit të mund të pushonin ose flinin, konfirmon dëshmitë e TW4-01-shit, TW4-11-shit, W04733-shit dhe TW4-05-ës.<sup>876</sup> Dëshmia e W01448-ës se ndërtesa e ndalimit ruhej me roje gjithashtu konfirmon edhe dëshmitë e TW4-01-shit, TW4-11-

---

<sup>869</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016229.

<sup>870</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013742-SITF00013747.

<sup>871</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013741; SITF00013748.

<sup>872</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858.

<sup>873</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743-SITF00013744, SITF00013762; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856, SITF00013861.

<sup>874</sup> *Shih* para. 458 më lart. *Shih, në veçanti, W04733:* SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013809-SPOE00013810; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019830-SITF00019831, që konfirmon dëshminë e **W01448-ës** në vijim: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016145.

<sup>875</sup> [REDAKTUAR].

<sup>876</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1431-1432; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1199; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748-SITF00013750; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016145-SITF00016146; **W04733:** 106978-107020, f. 106989-106990; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013822; **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129.

shit, W04733-shit dhe TW4-02-shit, sipas të cilëve të ndaluarit nuk ishin të lirë të dilnin nga ndërtesa e ndalimit.<sup>877</sup> Po ashtu, përshkrimi i zyrës prej W01448-ës përputhet me atë që dhanë W04733 dhe TW4-01, dhe të tre dëshmitarët përshkruajnë gjerësisht keqtrajtimin që pësuan në atë dhomë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>878</sup> Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet më së miri në deklaratat e W01448-ës në lidhje me vendin e ndalimit.

482. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se W01448 u mbajt i ndaluar në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës dhe në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se W01448 u mbajt i ndaluar në zyrë gjatë gjithë kohës që u keqtrajtua më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.

(c) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

483. W01448 identifikoi TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme dhe W04733-shin si të ndaluar bashkë me të në dhomën 1<sup>879</sup> dhe dha emrat e plotë të TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, W04733-shit, çka nuk lë vend për dyshim lidhur me identitetet e tyre.<sup>880</sup> Trupi Gjykses rikujton se TW4-01 dhe W04733 identifikuan W01448-ën si të ndaluar me ta në dhomën 1, bashkë me të tjerë.<sup>881</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë e këtyre tre dëshmitarëve lidhur me këtë aspekt janë përputhëse, të besueshme dhe konfirmojnë njëra-tjetrën.

---

<sup>877</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1445-1447; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1219, rreshtat 21-25; **W04733:** 106978-107020, f. 106990; **TW4-02:** 108850-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 7; 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 4.

<sup>878</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(b) dhe VI.E.2(d).

<sup>879</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761-SITF00013762.

<sup>880</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013762. Në lidhje me të ndaluarit e tjerë në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, *shih* para. 385 më lart.

<sup>881</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2(d) dhe VI.D.5(c).

484. Krahas kësaj, W01448 identifikoi [REDAKTUAR] si të ndaluar bashkë me të në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>882</sup> Në lidhje me këtë, deklaratat e tij janë përputhëse me dëshmitë e TW4-01-shit dhe W04733-shit, të cilët gjithashtu u keqtrajtuuan në zyrë në të njëjtin rast.<sup>883</sup>

485. Si persona të ndaluar në dhomën 1, W01448 identifikoi gjithashtu edhe TW4-05-ën, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe të ndaluarin e tretë rom, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], TW4-11-shin, [REDAKTUAR], një person nga Kruma,<sup>884</sup> një mësues nga Gjakova dhe një person nga Smolica.<sup>885</sup> Dëshmitari identifikoi me emër TW4-05-ën, TW4-11-shin dhe [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe romin e tretë të ndaluar (i cili sipas W01148-ës quhej [REDAKTUAR]).<sup>886</sup> Në lidhje me TW4-11-shin, W01448 përmendi konkretisht edhe profesionin e tij (e përshkroi si [REDAKTUAR]) dhe theksoi se TW4-11 u lirua para tij.<sup>887</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se, megjithëse TW4-11 nuk e përmend W01448-ën si të ndaluar bashkë me të, Trupi Gjykses nuk i kushton shumë rëndësi faktit se TW4-11-shit nuk i kujtohej prania e W01448-ës në dhomë, që mund të jetë pasojë e një numri arsyesh, si koha që ka kaluar, fakti se vazhdimisht sillëshin dhe merreshin të ndaluar, sikurse dëshmoi edhe vetë TW4-11, dhe se gjatë mbajtjes në ndalim, dëshmitari ishte i preokupuar me rrethanat e tij personale. Çka është me rëndësi, W01448 e identifikoi TW4-11-shin me emër dhe profesion dhe se edhe dëshmitari W04733 përmendi W01448-ën dhe TW4-11-shin ndër personat e ndaluar bashkë me të në dhomën 1.<sup>888</sup> Trupi Gjykses e gjykon përgjithësisht të besueshme dëshminë e W01448-ës lidhur me identifikimin e të gjithë të ndaluarve të

---

<sup>882</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013746-SITF00013747.

<sup>883</sup> *Shih* para. 389 dhe 459 më lart; Pjesët VI.E.2(b) dhe VI.E.2(c).

<sup>884</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761-SITF00013762.

<sup>885</sup> **W01448:** SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016141.

<sup>886</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761-SITF00013762.

<sup>887</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013757; SITF00016140-SITF00016220 RED3, f. SITF00016142.

<sup>888</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 5-6.

tjerë në dhomën 1, si dhe të [REDAKTUAR] si të ndaluar bashkë me të në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.

486. Dëshmia e W01448-ës lidhur me të ndaluarit e tjerë konfirmohet edhe nga TW4-01 dhe W04733 (në lidhje me [REDAKTUAR]); nga TW4-01, TW4-11, TW4-05 dhe W04733 (në lidhje me [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe të ndaluarin e tretë rom); nga TW4-02 dhe TW4-04 (në lidhje me [REDAKTUAR]); dhe nga TW4-01 dhe TW4-02 (në lidhje me [REDAKTUAR]).<sup>889</sup> Duke pasur parasysh llojin përputhës dhe reciprokisht konfirmues të dëshmive të lartpërmendura, Trupi Gjykses bën konstatime në lidhje me këtë aspekt.

487. Nga ana tjetër, Trupi Gjykses vëren se W01448 është i vetmi dëshmitar që identifikoi një person nga Kruma, një mësues nga Gjakova dhe një person nga Smolica, si persona të ndaluar bashkë me të. Duke mbajtur parasysh faktin se provat në lidhje me këta persona janë të kufizuara dhe nuk mundësojnë identifikimin e saktë të tyre, Trupi Gjykses do t'i trajtojë ato në Pjesën VI.D.11 më poshtë.<sup>890</sup>

488. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se W01448 u mbajt i ndaluar në FMK në periudha përkuese me, ndër të tjerë, TW4-01-shin, TW4-11-shin, W04733-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe të ndaluarin e tretë rom, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].

---

<sup>889</sup> **W01448:** U003-2232-U003-2232-ET (ku dëshmitari qartë shënon [REDAKTUAR] si persona të ndaluar bashkë me të në dhomën 1); **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016237. *Shih gjithashtu* Pjesën VI.D.10(e).

<sup>890</sup> *Shih* para. 589 më poshtë.

## (d) Rrethanat e lirimit

489. W01448 tha se u lirua nga KFOR-i në Prizren më 18 qershor 1999.<sup>891</sup> [REDAKTUAR].<sup>892</sup> Duke marrë parasysh dëshmitë e tyre përputhëse dhe reciprokisht konfirmuese lidhur me ndalimin e tyre në ndërtesën e MPB-së në Prizren në atë kohë,<sup>893</sup> Trupi Gjykes është bindur se W01448 tregoi të vërtetën dhe nuk ka arsye për të dyshuar në vërtetësinë e deklaratës së W01448-ës lidhur me datën dhe rrethanat e lirimit.

490. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykes konstaton se W01448 u lirua nga KFOR-i, [REDAKTUAR], më 18 qershor 1999, në Prizren.

## (e) Mungesa e garancive procedurale

491. Sa i takon detyrimit për të informuar personin që i është hequr liria për arsyet e heqjes së lirisë, Trupi Gjykes rikujton se W01448 deklaroi se u akuzua se nuk kishte dhënë kontribut financiar për UÇK-në.<sup>894</sup> Po kështu, dëshmitari theksoi se nuk u informua se në emër të kujt vepronin personat e veshur me tesha civile.<sup>895</sup> Për më tepër, në deklaratat e tij, W01448 gjithashtu pohoi se anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, ndër të cilët Fatmir Limaj, e morën në pyetje disa herë, kryesisht në zyrë, në lidhje me të kaluarën, shërbimin ushtarak dhe dijeninë e tij për serbë ose bashkëpunëtorë të serbëve.<sup>896</sup> Ai shpjegoi se në disa prej këtyre marrjeve në pyetje iu kërkua që përgjigjet

---

<sup>891</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016224; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016148.

<sup>892</sup> [REDAKTUAR].

<sup>893</sup> [REDAKTUAR].

<sup>894</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737-SITF00013740; SITF00016221-SITF00016285 RED4, f. SITF00016227

<sup>895</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013737.

<sup>896</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743, SITF00013762; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856, SITF00013861.

t'i jepte në formë të një deklaratë me shkrim.<sup>897</sup> Megjithëse W01448 tha se e morën në pyetje dhe i morën deklaratë,<sup>898</sup> ata nuk e informuan asnjëherë përse ishte çuar në FMK, me përjashtim të disa shpjegimeve të vagullta dhe të përgjithshme me pretekstin se nuk kishte kontribuar në fondin e UÇK-së.

492. Trupi Gjykes konstaton se dëshmia e W01448-ës është e besueshme lidhur me këtë aspekt, sepse është në vetvete përputhëse dhe konkrete. Ai përshkroi qartë rrethanat e arrestimit dhe përjetimet e veta gjatë mbajtjes në ndalim. Informacioni që dha është kaq specifik dhe personal sa që Trupi Gjykes arrin në përfundimin se buron nga njohuritë e vetë dëshmitarit. Çka është me rëndësi, dëshmia e tij ka shumë ngjashmëri me dëshminë e W04733-shit në lidhje me transferimin e tij në FMK. Gjithashtu, deklaratat e W01448-s janë të ngjashme me dëshminë gojore të TW4-01-shit dhe TW4-11-shit sa i përket faktit se as TW4-01, e as TW4-11, as viktimat e vrasjes së paligjshme, as [REDAKTUAR], nuk u informuan si duhet për arsyet e heqjes së lirisë. Duke mbajtur parasysh dëshmitë konfirmuese që vërtetojnë praktikën e mosakordimit të garancive procedurale për të ndaluarit në FMK, Trupi Gjykes konstaton se dëshmia e W01448-ës lidhur me këtë aspekt është e besueshme dhe se mund të mbështetet në të. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes konstaton se W01448 nuk u informua si duhet për arsyen e arrestimit dhe ndalimit të tij.

493. Gjithashtu, sa i takon aspektit nëse W01448 u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nëse iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit, Trupi Gjykes vë në dukje se W01448-ës i thanë se do të lirohej pas një interviste ose gjykimi.<sup>899</sup> Sipas provave të administruara prej Trupit Gjykes, W01448

---

<sup>897</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013762; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016160-00016161; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016235.

<sup>898</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, SITF00013762.

<sup>899</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013738.

nuk u lirua pas intervistës, dhe nuk u zhvillua gjykim.<sup>900</sup> Më tej, Trupi Gjykses rikujton se W01448 u keqtrajtua rëndë gjatë gjithë kohës që u mbajt i ndaluar në FMK.<sup>901</sup> Trupi Gjykses vlerëson dëshminë e W01448-ës kundrejt dëshmive të të ndaluarve të tjerë, si TW4-01, TW4-11 dhe W04733, të cilët po ashtu nuk u nxorën para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre.<sup>902</sup> Duke pasur parasysh se të gjithë të ndaluarit u mbajtën në kushte të ngjashme ndalimi, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm bazuar në tërësinë e provave, është se W01448 nuk u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

494. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se W01448 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxor pa vonesë para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

## 7. TW4-05

### (a) Arrestimi fillestar

495. Sipas deklaratave të tij, TW4-05 mbërriti në qytetin e Kukësit si refugjat pasi [REDAKTUAR] u dëbua nga forcat serbe.<sup>903</sup> Në deklaratën e vitit 2009, dëshmitari tha se u largua për në Shqipëri më [REDAKTUAR] maj 1999 dhe mbërriti në Kukës me familjen “tri (03) ditë më vonë”.<sup>904</sup> Në deklaratën e vitit 2010, dëshmitari shprehimisht

---

<sup>900</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013738-SITF00013739.

<sup>901</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(a), VI.E.2(d) dhe VI.E.4.

<sup>902</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2(f), VI.D.4(e) dhe VI.D.5(e).

<sup>903</sup> **TW4-05**: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013125.

<sup>904</sup> **TW4-05**: SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

përmend datën [REDAKTUAR] maj 1999.<sup>905</sup> Trupi Gjykses është bindur se TW4-05 mbërriti në Kukës më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.

496. Në lidhje me rrethanat e arrestimit, TW4-05 deklaroi se katër ose pesë ditë pas mbërritjes në Kukës, më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date, i shkuan dy ose tre persona, të gjithë të veshur me uniformë të UÇK-së.<sup>906</sup> [REDAKTUAR].<sup>907</sup> Sipas TW4-05-ës, tre anëtarët e UÇK-së e pyetën për emrin dhe i thanë se “duhej të shko[nte] me ata në shtab”<sup>908</sup> për “një bisedë informative”, me çka dëshmitari kuptoi se do të ishte një “marrje në pyetje e shkurtë”.<sup>909</sup> Dëshmitari shpjegoi se, sipas anëtarëve të UÇK-së, arsyeja ishte se TW4-05 “ish[te] shoqëruar me serbët.<sup>910</sup> Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se dëshmitari u ndje i detyruar të bënte si i thanë dhe të shkante me ta.

497. Sipas TW4-05-ës, anëtarët e UÇK-së më pas e çuan me veturë nga qyteti i Kukësit në FMK.<sup>911</sup> Sipas deklaratës së TW4-05-ës, pasi mbërriti në FMK, [REDAKTUAR] dhe “një tjetër që bëhej se ishte jurist apo gjyqtar atje” e morën në pyetje.<sup>912</sup> Gjatë marrjes në pyetje, dëshmitari u akuzua se shoqërohej me serbë, [REDAKTUAR].<sup>913</sup> Sipas dëshmitarit, [REDAKTUAR] ishte “shumë i ashpër” dhe “fliste me zë shumë të lartë”.<sup>914</sup>

---

<sup>905</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013125.

<sup>906</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500; SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013126.

<sup>907</sup> [REDAKTUAR].

<sup>908</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

<sup>909</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013126.

<sup>910</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

<sup>911</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013126; nëse FMK-ja ishte vendi i mbërritjes, *shih* f. SITF00013128.

<sup>912</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013127.

<sup>913</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013127-SITF00013128; *shih, ngjashëm,* SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

<sup>914</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013127.



498. Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e dëshmitarit për datën dhe rrethanat e arrestimit të tij është e besueshme dhe se mund të mbështetet në të. Dëshmia ndjek rrjedhë të qartë kronologjike, është në vetvete përputhëse dhe nuk duket se është ekzagjeruar apo thjeshtuar. Kur krahason deklaratën e TW4-05-ës të vitit 2010 me deklaratën e tij të vitit 2009, Trupi Gjykses vëren se përgjigjet e dëshmitarit në vitin 2010 janë më të hollësishme se në vitin 2009. Trupi Gjykses këtë ia atribuon faktit se organi hetimor i bëri pyetje më të hollësishme në vitin 2010. Deklaratat përgjithësisht përputhëse dhe koherente të TW4-05-ës bindin Trupin Gjykses për vërtetësinë dhe mbështetshmërinë në dëshminë e tij lidhur me këtë aspekt.

499. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-05 u arrestua dhe iu hoq liria në Kukës dhe se tre anëtarë të UÇK-së me uniforma, [REDAKTUAR], e çuan në FMK më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.

(b) Vendi i mbajtjes në ndalim në FMK

500. Para se gjithash, Trupi Gjykses do të trajtojë shkurtimisht dëshminë e TW4-05-ës se gjatë kohës që ishte në FMK, “asnjëherë nuk [ishte] mbajtur në dhomë të mbyllur” dhe se nuk iu kufizua liria e lëvizjes brenda FMK-së.<sup>915</sup> Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet në kuadër të vlerësimit të besueshmërisë së TW4-05-ës se ai dukshëm minimizoi disa aspekte të ndalimit të tij në FMK.<sup>916</sup> Po kështu, Trupi Gjykses është i mendimit se dëshmitari nuk paraqiti drejt mundësinë e tij për të lëvizur lirisht brenda dhe jashtë FMK-së. Dëshmia e dëshmitarit në lidhje me këtë aspekt në vetvete nuk është përputhëse dhe gjithashtu bie ndesh me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, të cilët e identifikuan si të ndaluar bashkë me ta.<sup>917</sup> Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk

---

<sup>915</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500; SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129.

<sup>916</sup> *Shih* para. 141 më lart.

<sup>917</sup> *Shih* para. 459 dhe 485 më lart.

merr parasysh dëshminë e TW4-05-ës se “asnjëherë nuk [ishte] mbajtur në dhomë të mbyllur” dhe konstaton se atij iu hoq liria.

501. Në lidhje me vendin brenda FMK-së ku u mbajt TW4-05, Trupi Gjykses vëren se dëshmitari përshkroi në vija të përgjithshme se u mbajt në një dhomë, pa dhënë hollësi konkrete. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se: (i) dëshmitari i identifikoi W01448-ën dhe [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë rom si të ndaluar të tjerë në dhomën ku u mbajt;<sup>918</sup> (ii) dëshmitari deklaroi se në dhomë ishin gjithsej tetë ose nëntë të ndaluar, çka përputhet me numrin e përafërt që dhanë të ndaluarit e tjerë që u mbajtën në dhomën 1;<sup>919</sup> dhe (iii) dëshmitari W04733 e identifikoi edhe TW4-05-ën si njërin prej të ndaluarve të tjerë në dhomën 1 në atë kohë.<sup>920</sup> Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se përmasat e përafërta të dhomës (5m x 4m) që dha TW4-05 përputhen me ato që dhanë të ndaluarit e tjerë në lidhje me dhomën 1, konkretisht dëshmitarët TW4-01, TW4-11, W01448 dhe W04733.<sup>921</sup>

502. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se TW4-05-ën [REDAKTUAR].<sup>922</sup> Dëshmitari dëshmoi gjithashtu se e çuan disa herë në ndërtesën e komandës, [REDAKTUAR].<sup>923</sup>

503. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se gjatë ndalimit të tij, TW4-05 u mbajt në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit. Trupi Gjykses është bindur se gjithashtu edhe TW4-05 u mbajt i ndaluar në ndërtesën

---

<sup>918</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129, SITF00013131-SITF00013132; SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500-SITF00372501.

<sup>919</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372501; SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129. *Shih gjithashtu* poshtëshënimin 764 më lart.

<sup>920</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818-SPOE00013819.

<sup>921</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129. *Shih gjithashtu*, **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1432, rreshtat 6-11; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1199, rreshtat 12-13; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748; **W04733:** 106978-107020, f. 106990; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013822.

<sup>922</sup> [REDAKTUAR].

<sup>923</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013130-SITF00013131.

e komandës gjatë marrjes në pyetje, si dhe në vende të tjera brenda FMK-së, [REDAKTUAR].

(c) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

504. Sipas TW4-05-ës, gjithsej tetë a nëntë persona u mbajtën në dhomën 1, ndër të cilët W01448 dhe tre muzikantë romë [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom).<sup>924</sup> Trupi Gjykes vë në dukje se TW4-05 e identifikoi W01448-ën me emër si dikush që ishte i ndaluar bashkë me të dhe dha hollësi lidhur me profesionin dhe prejardhjen e të ndaluarve romë. Sipas mendimit të Trupit Gjykes, dëshmia e tij është në vetvete përputhëse dhe e qartë. Për më tepër, Trupi Gjykes vëren se dëshmia e TW4-05-ës konfirmohet mjaftueshëm nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, si TW4-01, TW4-11, W01448 dhe W04733.<sup>925</sup> Krahas kësaj, dëshmitë e TW4-05-ës dhe W01448-ës janë reciprokisht konfirmuese në lidhje me ndalimin e tyre në dhomën 1.<sup>926</sup> Së fundi, dëshmitari W04733 e identifikoi gjithashtu edhe TW4-05-ën si dikush që ishte i ndaluar bashkë me të në dhomën 1.<sup>927</sup> Si rezultat, Trupi Gjykes konstaton se dëshmia e dëshmitarit lidhur me këtë aspekt është e vërtetë dhe mund të mbështetet në të.

---

<sup>924</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129, SITF00013131-SITF00013132; SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372501-SITF00372501.

<sup>925</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129; **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1414, rreshti 16 deri në f. 1417, rreshti 20; *shih, në veçanti*, f. 1417, rreshtat 5-8, ku ZPS-ja i paraqiti deklaratën e mëparshme për t'ia freskuar kujtesën (SITF00012758-SITF00012789 RED2, f. SITF00012763); T. 30 maj 2023, publik, f. 1432, rreshtat 2-5; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1209, rreshtat 7-22; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1340, rreshti 17 deri në f. 1341, rreshti 13; **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016225; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748; **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013811-SPOE00013812, SPOE00013818-SPOE00013819; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 5, rreshti 14 deri në f. 6, rreshti 12.

<sup>926</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748.

<sup>927</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818-SPOE00013819.

505. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se TW4-05 u mbajt i ndaluar, së bashku me W01448-ën, W04733-shin, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], romin e tretë të ndaluar dhe të tjerë në dhomën 1.

(d) Rrethanat e lirit

506. [REDAKTUAR].<sup>928</sup> [REDAKTUAR].<sup>929</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmia e dëshmitarit lidhur me këtë aspekt është në vetvete përputhëse dhe konfirmon [REDAKTUAR].<sup>930</sup> Trupi Gjykses është bindur se dëshmitari është i sinqertë dhe i besueshëm.

507. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm se TW4-05 u ndalua më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>931</sup> [REDAKTUAR],<sup>932</sup> [REDAKTUAR]. I vetëdijshëm për vështirësitë që mund të kenë dëshmitarët kur japin data specifike për ngjarje që kanë ndodhur shumë kohë më parë, Trupi Gjykses nuk merr parasysh dëshminë e dëshmitarit në lidhje me këtë aspekt dhe rrjedhimisht, konstaton se TW4-05 u mbajt në FMK [REDAKTUAR].

508. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-05 u mbajt i ndaluar afërisht [REDAKTUAR].

(e) Mungesa e garancive procedurale

509. Sa i takon detyrimin për ta informuar personin që i është hequr liria për arsyet e heqjes së lirisë, Trupi Gjykses vë në dukje se, sipas TW4-05-ës, nuk i dhanë asnjë arsye për arrestimin e tij, përveç se “ish[te] shoqëruar me serbët” dhe duhej të shkonte në

---

<sup>928</sup> [REDAKTUAR].

<sup>929</sup> [REDAKTUAR].

<sup>930</sup> [REDAKTUAR].

<sup>931</sup> *Shih* para. 499 më lart.

<sup>932</sup> [REDAKTUAR].

FMK për t'u marrë në pyetje lidhur me këtë.<sup>933</sup> Sikurse shtjellohet më lart, kur mbërriti në FMK, dëshmitari u mor në pyetje nga [REDAKTUAR] dhe "një tjetër që bëhej se ishte jurist apo gjyqtar atje", identitetin e të cilit nuk e dinte.<sup>934</sup> Sipas deklaratës së tij, gjatë mbajtjes në ndalim në FMK, TW04-05 u morr në pyetje nga [REDAKTUAR] dhe një anëtar tjetër i UÇK-së, në disa raste në ndërtesën e komandës, çdo herë gjatë natës.<sup>935</sup> TW4-05 shpjegoi se, çdo herë që merrej në pyetje, e pyesnin dhe e akuzonin se kishte lidhje me serbët [REDAKTUAR].<sup>936</sup> TW4-05 deklaroi gjithashtu se, në një moment gjatë ndalimit, ai kishte frikë se mund të vritej si "tradhtar", [REDAKTUAR].<sup>937</sup>

510. Trupi Gjykses vlerëson se dëshmia e dëshmitarit në lidhje me akuzat që iu bënë dhe frikën që përjetoi gjatë kohës që ishte i ndaluar, u dha me vërtetësi dhe është e besueshme. Këtë vlerësim Trupi Gjykses e mbështet në deklaratat e TW4-05-ës në lidhje me këto aspekte, të cilat janë të qarta, koherente dhe përgjithësisht përputhëse me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, si TW4-01, TW4-11 dhe TW4-02, të cilët konfirmuan atmosferën e frikës që mbizotëronte ndër të ndaluarit në FMK.<sup>938</sup> Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e TW4-05-ës është e besueshme, sepse informacioni që dha është kaq specifik dhe personal sa që Trupi Gjykses arrin në përfundimin se e kishte burimin te njohuritë e vetë dëshmitarit. Si rezultat, dhe duke marrë parasysh akuzat e mjegullta që iu bënë në mënyrë të përsëritur, Trupi Gjykses konstaton se TW4-05 nuk u informua si duhej për arsyet e arrestimit dhe ndalimit.

---

<sup>933</sup> *Shih* para. 496 më lart.

<sup>934</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013127; SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

<sup>935</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013130-SITF00013131.

<sup>936</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013127-SITF00013128, SITF00013130; *shih ngjashëm*, SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500.

<sup>937</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013134.

<sup>938</sup> *Shih* para. 649 më poshtë; *shih, ngjashëm*, **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 20, rreshti 23 deri në f. 21, rreshti 11: "Ajo ishte tmerruese psikologjikisht për mua."

511. Sa i takon aspektit nëse TW4-05 u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nëse iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit, Trupi Gjykses vë në dukje se TW4-05 pësoi keqtrajtim të ngjashëm me të ndaluarit e tjerë në FMK dhe u detyrua të kryente punë krahu.<sup>939</sup> Sido që të jetë, nga dëshmia është e qartë se TW4-05 dhe të ndaluarit e tjerë u liruan jo si rezultat i një vendimi të një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent [REDAKTUAR].<sup>940</sup> Gjithashtu, vlen të kujtohet se edhe dëshmitarë të tjerë, si TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, TW4-11, W04733 dhe W01448, nuk u nxorën para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre.<sup>941</sup> Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në tërësinë e provave, është se TW4-05 nuk u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, as nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit.

512. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se sikurse të ndaluarit e tjerë, edhe TW4-05 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxor pa vonesë para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit.

## 8. TW4-04

### (a) Arrestimi fillestar

513. TW4-04 tha se u largua nga Kosova më [REDAKTUAR] mars 1999 për shkak të konfliktit.<sup>942</sup> TW4-04 tha se [REDAKTUAR] dhe një anëtar tjetër i UÇK-së e arrestuan

---

<sup>939</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(i).

<sup>940</sup> [REDAKTUAR].

<sup>941</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2(f), VI.D.3(d), VI.D.4(e), VI.D.5(e) dhe VI.D.6(e).

<sup>942</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013263; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015828; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014673-SPOE00014674; SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013338.

në [REDAKTUAR].<sup>943</sup> Sipas TW4-04-ës, kur e arrestuan i thanë se duhej të shkonte në shtabin e UÇK-së [REDAKTUAR] për “një bisedë”.<sup>944</sup> [REDAKTUAR] dhe anëtari tjetër i UÇK-së ishin me tesha civile, por dëshmitarit iu prezantuan si anëtarë të UÇK-së.<sup>945</sup> TW4-04 gjithashtu deklaroi se, kur e çonin për t’u marrë në pyetje gjatë ditëve të mëpasshme, pyetjet ia bënte një person i cili iu prezantua si “gjykatës [...] i Tiranës”.<sup>946</sup> Sipas dëshmitarit, i kërkuan të bënte një deklaratë me shkrim dhe e pyetën, ndër të tjera, [REDAKTUAR] nëse kishte bashkëpunuar me sigurimin shtetëror serb.<sup>947</sup> [REDAKTUAR].<sup>948</sup> Pas kësaj, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe personeli i policisë ushtarake të UÇK-së e kthyen përsëri në Kukës, në FMK.<sup>949</sup>

514. Trupi Gjykues gjykon se dëshmia e dëshmitarit është e drejtpërdrejtë, koherente dhe në vetvete përputhëse në të gjitha deklaratat e tij në lidhje me rrethanat e arrestimit, përfshirë datën e përafërt të arrestimit, [REDAKTUAR], marrjen e parë në pyetje, ndalimin e mëpasshëm të tij në [REDAKTUAR], dhe transferimin e tij [REDAKTUAR] në FMK. Vlen të theksohet se deklaratat e TW4-04-ës [REDAKTUAR], është e ngjashme me dëshmitë e TW4-11-shit, TW4-02-shit dhe TW4-05-ës. Sikurse TW4-04, edhe këta dëshmitarë pretenduan se kur u arrestuan u thanë se do të

<sup>943</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 8-9.

<sup>944</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 8-9.

<sup>945</sup> **TW4-04:** SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015829.

<sup>946</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 9; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015829; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014677.

<sup>947</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 9, 11.

<sup>948</sup> **TW4-04:** SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013338-SITF00013339; SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013265-SITF00013269; 064716-TR-ET Part 3 RED4 (Pjesa 3 RED4), f. 3-4, 6-8, 20, 22-25; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015829-SITF00015830; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014680-SPOE00014682, SPOE00014687; 064716-TR-ET Part 2 RED3 (Pjesa 2 RED3), f. 10; 064716-TR-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 2.

<sup>949</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013271, SITF00013275, SITF00013277; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014687, SPOE00014689-SPOE00014690; 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 1-3; 108826-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 4; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015843.

merreshin në pyetje. Kjo e bën deklaratën me shkrim të TW4-04-ës edhe më të besueshme.

515. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-04-ës iu hoq liria afërsisht nga [REDAKTUAR] dhe u transferua në FMK afërsisht nga fundi i majit/fillimi i qershorit 1999.

(b) Vendi i ndalimit brenda FMK-së

516. Sipas përshkrimit të TW4-04-ës, ai fillimisht u mbajt në [REDAKTUAR].<sup>950</sup> [REDAKTUAR].<sup>951</sup>

517. Në të gjitha deklaratat e tij, dëshmitari përshkroi me shumë hollësi dhe në mënyrë përputhëse planimetrinë e FMK-së, si dhe planimetrinë e ndërtesës së ndalimit dhe të dhomave brenda saj. Atij iu treguan një numër fotografish dhe harta kadastrale e FMK-së, si dhe vizatoi një skicë të ndërtesës së ndalimit, në të cilën bëri shënime.<sup>952</sup> Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e TW4-04-ës në lidhje me vendin e ndalimit është e besueshme dhe se mund të mbështetet në të, sepse konfirmohet nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, si dhe i konfirmon ato.<sup>953</sup>

518. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se, bazuar në përshkrimin e dëshmitarit, ai u mbajt i ndaluar në [REDAKTUAR] të ndërtesës së ndalimit.<sup>954</sup>

---

<sup>950</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 4-5, 7; SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013272- SITF00013273, SITF00013275; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014690-SPOE00014692; 108826-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 7-8, *i referohet* 108816-108825 RED, f. 108822 (TW4-04 shënoi me numër 1 dhomën ku u mbajt i ndaluar);

<sup>951</sup> [REDAKTUAR].

<sup>952</sup> **TW4-04:** 108826-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 5-9, *i referohet* 108816-108825 RED.

<sup>953</sup> *Shih, për shembull*, para. 486 më lart dhe para. 544 më poshtë.

<sup>954</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013272-SITF00013273, SITF00013275; 108826-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 7-8, *i referohet* 108816-108825 RED, f. 108822 (TW4-04 shënoi me numrin 1 dhomën ku u mbajt i ndaluar); 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 4, 11; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014690-SPOE00014692.



## (c) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

519. Sipas TW4-04-ës, natën e parë të ndalimit në FMK, [REDAKTUAR] një person [REDAKTUAR] i tha: “kur të vijmë [...] këto të luftës natën, [...] kur vin [...] në krizë jemi”.<sup>955</sup> [REDAKTUAR].<sup>956</sup> TW4-04 identifikoi gjithashtu edhe të ndaluarit në vijim, të cilët u sollën në momente të ndryshme në [REDAKTUAR]: [REDAKTUAR];<sup>957</sup> [REDAKTUAR];<sup>958</sup> “bab[ën] me djalë”;<sup>959</sup> dhe TW4-02-shin.<sup>960</sup>

520. TW4-04-ës i kujtohej gjithashtu se pa edhe të ndaluar të tjerë në FMK, ndër të cilët TW4-11-shin, [REDAKTUAR], dhe “tre romë” [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një i ndaluar tjetër rom).<sup>961</sup>

521. Trupi Gjykues konstaton se dëshmia e TW4-04-ës në lidhje me të ndaluarit e tjerë është përputhëse në të gjitha deklaratat e tij, mjaft e hollësishme dhe reciprokisht konfirmuese me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Trupi Gjykues veçanërisht thekson përputhshmërinë midis dëshmive të dëshmitarëve në lidhje me të ndaluarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë rom. Trupi Gjykues pranon se shumë dëshmitarëve nuk u kujtohej që TW4-04 ishte aty gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar në FMK.<sup>962</sup> Kjo mund të shpjegohet nga fakti se ai u mbajt për një kohë relativisht të shkurtër [REDAKTUAR],<sup>963</sup>

---

<sup>955</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 11-12.

<sup>956</sup> [REDAKTUAR].

<sup>957</sup> [REDAKTUAR].

<sup>958</sup> [REDAKTUAR].

<sup>959</sup> **TW4-04:** SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015844, SITF00015846.

<sup>960</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013272, SITF00013278; 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 30; 064716-TR-ET Part 3 RED4 (Pjesa 3 RED4), f. 14; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015844, SITF00015854-SITF00015855; SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013340.

<sup>961</sup> **TW4-04:** SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015846-SITF00015847; SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013340; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014694; 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 27, 31-32. *Shih gjithashtu* Pjesën VI.D.10(a).

<sup>962</sup> [REDAKTUAR].

<sup>963</sup> *Shih* para. 526 më poshtë.

[REDAKTUAR]. Megjithatë, se TW4-04 u mbajt i ndaluar në FMK konfirmohet nga deklaratat e z. Kryeziu.<sup>964</sup>

522. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se deklarata e TW4-04-ës në lidhje me [REDAKTUAR], është e besueshme dhe mund të mbështetet në të, sepse dëshmitari përshkroi disa hollësi dhe rrethana konkrete [REDAKTUAR], çka përforcon mendimin e Trupit Gjykses se dëshmitari përshkroi përvojat personale [REDAKTUAR].<sup>965</sup> Krahas kësaj, kujtesa e tij përputhet me [REDAKTUAR].<sup>966</sup> Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e TW4-04-ës në lidhje me rrethanat e arrestimit, vendin e ndalimit brenda FMK-së dhe identifikimin e të ndaluarve të tjerë, është e vërtetë.

523. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR],<sup>967</sup> [REDAKTUAR],<sup>968</sup> [REDAKTUAR],<sup>969</sup> [REDAKTUAR].<sup>970</sup> [REDAKTUAR].

524. Së fundi, Trupi Gjykses ka vlerësuar dëshminë e TW4-04-ës duke mbajtur parasysh dëshmitë e TW4-11-shit dhe W01448-ës në lidhje me ndalimin e [REDAKTUAR] në FMK,<sup>971</sup> dhe duke mbajtur parasysh konstatimin e Trupit Gjykses se [REDAKTUAR].<sup>972</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se kur TW4-04 përmend

---

<sup>964</sup> **z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100; SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016916.

<sup>965</sup> [REDAKTUAR].

<sup>966</sup> [REDAKTUAR].

<sup>967</sup> [REDAKTUAR].

<sup>968</sup> [REDAKTUAR].

<sup>969</sup> [REDAKTUAR].

<sup>970</sup> [REDAKTUAR].

<sup>971</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1216, rreshtat 1-19; **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858. *Shih gjithashtu*, Pjesën VI.D.10(d).

<sup>972</sup> [REDAKTUAR].

një “babë me djalë” [REDAKTUAR] u referohet [REDAKTUAR], çka konfirmohet nga TW4-01, TW4-02 dhe W01448.<sup>973</sup>

525. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykes është bindur se TW4-04 u mbajt i ndaluar në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, së bashku me TW4-02-shin, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], TW4-11-shin dhe [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë rom.

(d) Rrethanat e lirimit

526. Sa i takon kohëzgjatjes së ndalimit, në dëshminë e dëshmitarit ka një mospërputhje [REDAKTUAR].<sup>974</sup> Sikurse shtjellohet në pjesë të tjera të këtij Aktgjykimi, Trupi Gjykes është i mendimit se TW4-04 minimizon keqtrajtimin që pësoi gjatë mbajtjes në ndalim në FMK.<sup>975</sup> [REDAKTUAR], që sipas gjykimit të Trupit Gjykes i shërbeu dëshmitarit si motiv për të përshtatur dëshminë e vet [REDAKTUAR].<sup>976</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykes e ka të vështirë ta pranojë si të vërtetë vlerësimin e dëshmitarit dhe konstaton se ekziston mundësia që të jetë mbajtur në ndalim për një periudhë më të gjatë, me gjasë [REDAKTUAR]. Trupi Gjykes e mbështet këtë vlerësim në dëshminë se: (i) [REDAKTUAR];<sup>977</sup> dhe (ii)

---

<sup>973</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1433, rreshti 25 deri në f. 1434, rreshti 2; **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016237; **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 8-10. *Shih gjithashtu* Pjesën VI.D.10(e).

<sup>974</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013273-SITF00013274; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015854; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014689-SPOE00014690, SPOE00014692, SPOE00014697; 108826-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 7, 10; 107743-107743 RED, para. 2.

<sup>975</sup> *Shih* para. 132 më lart.

<sup>976</sup> **TW4-04:** SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014705; 064716-TR-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 15-20.

<sup>977</sup> [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR].<sup>978</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se TW4-04 u lirua afërisht nga [REDAKTUAR].

527. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se TW4-04 u lirua nga FMK-ja afërisht nga [REDAKTUAR].

(e) Mungesa a garancive procedurale

528. Sa i takon detyrimin për ta informuar personin që i hiqet liria për arsyet e heqjes së lirisë, Trupi Gjykses vë në dukje se, sipas TW4-04-ës, kur u arrestua ai nuk u informua për arsyet e ndalimit.<sup>979</sup> Trupi Gjykses nuk ka arsye për të vënë në dyshim deklaratën e TW4-04-ës lidhur me këtë aspekt, sepse është e saktë dhe përkon me praktikën e arrestimit të dëshmitarëve të tjerë. Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se TW4-04 nuk u informua si duhet për arsyet e arrestimit dhe ndalimit.

529. Sa i takon aspektin nëse TW4-04 u nxor para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent dhe nëse iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit, Trupi Gjykses vë në dukje deklaratën e TW4-04-ës se, para se ta lironin, atë e çuan në ndërtesën e komandës, te një "gjykatës", të cilin TW4-04 e identifikoi si z. Kryeziu. Z. Kryeziu i kërkoi të jepte një deklaratë me shkrim ku të përfshinte të dhënat personale, informacion për të kaluarën dhe arrestimin e tij.<sup>980</sup> TW4-04 tha se u lirua disa ditë më pas.<sup>981</sup> Sipas TW4-04-ës, kjo procedurë nuk ishte e njëmendtë, sepse z. Kryeziu "veç formalisht ish kon, se s'kishe guxua këto çka kan vendos."<sup>982</sup> TW4-04 shtoi se i thanë se kur të kthehej në Kosovë do të merrte një vërtetim për lirinë e tij.

---

<sup>978</sup> [REDAKTUAR].

<sup>979</sup> *Shih* para. 513 më lart.

<sup>980</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013274; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015854; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE000 14691; 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 2-3, 9-10. *Shih gjithashtu, z. Kryeziu:* SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014100.

<sup>981</sup> **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013273-SITF00013274; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015854; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014691-SPOE00014698.

<sup>982</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 9-10.

TW4-04 deklaroi se në fund mori një “letër” nga z. Kryeziu ku thuhej se ishte “i pastër”.<sup>983</sup>

530. Trupi Gjykues konstaton se dëshmia e mësipërme e TW4-04-ës është e besueshme dhe mund të mbështetet në të, sepse dëshmitari është përputhës dhe koherent dhe jep, pa iu kërkuar, informacion të hollësishëm për kontaktin me z. Kryeziu para se të lirohej. Kjo përforcon mendimin e Trupit Gjykues se në deklaratat e veta dëshmitari përshkroi përjetimet personale. Gjithashtu, dëshmia e TW4-04-ës për përfshirjen e z. Kryeziu në marrjen në pyetje përputhet me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë se nuk u dhanë garanci procedurale gjatë ndalimit.<sup>984</sup> Megjithëse mban parasysh deklaratën e TW4-04-ës se [REDAKTUAR],<sup>985</sup> sipas Trupit Gjykues, kjo tregon se disa të ndaluarve iu bënë favore në bazë të lidhjeve që kishin, e jo se TW4-04-ës dhe të ndaluarve të tjerë iu akorduan garanci procedurale. Sikurse shtjellohet më lart, dëshmia është e qartë për faktin që z. Kryeziu nuk kishte rolin e mbikëqyrësit të pavarur të ligjshmërisë së ndalimit të TW4-04-ës ose të ndaluarve të tjerë. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues i kushton vëmendje gjithashtu edhe faktit se, sikurse u shpreh TW4-04, z. Kryeziu nuk ishte ai që merrte vendimin përfundimtar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues arrin në përfundimin se TW4-04 nuk u nxor para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent.

531. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykues konstaton se TW4-04 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxor pa vonesë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent, dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

---

<sup>983</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 17: “Osmani më dha bile edhe një letër që ti je i pastër, po [...] dikush tjetër më mbante përgjegjës për gjëra”.

<sup>984</sup> *Shih, konkretisht, TW4-11:* T. 3 maj 2023, publik, f. 1265, rreshti 22 deri në f. 1266, rreshti 6.

<sup>985</sup> **TW4-04:** 064716-TR-ET Part 3 RED4 (Pjesa 3 RED4), f. 6; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015843.

## 9. TW4-02

### (a) Arrestimi fillestar

532. Sipas dëshmisë së tij, TW4-02 me familjen mbërritën në Kukës më [REDAKTUAR] maj 1999.<sup>986</sup> [REDAKTUAR].<sup>987</sup> [REDAKTUAR].<sup>988</sup> Sipas TW4-02-shit, ai u arrestua nga Xhemshit Krasniqi afërsisht midis 9 dhe 11 qershorit 1999, [REDAKTUAR].<sup>989</sup> Kur e arrestuan, nuk e informuan për arsyet e arrestimit, por i thanë “kemi një -- bisedë [REDAKTUAR]”.<sup>990</sup> Sipas vetë TW4-02-shit, ai u mbajt i ndaluar disa ditë me akuzën se ishte “spiun” dhe “bashkëpunëtor” i Serbisë.<sup>991</sup>

533. Trupi Gjykses nuk ka arsye për të dyshuar se TW4-02 mbërriti me familjen në Kukës më [REDAKTUAR] maj 1999. Deklarata e dëshmitarit e vitit 2019 bën të qartë se e arrestoi [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>992</sup> Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e TW4-02-shit lidhur me këtë aspekt është e besueshme dhe mund të mbështetet në të. Megjithatë, për arsyet e shtjelluara më poshtë, Trupi Gjykses nuk i gjykon të besueshme deklaratat e TW4-02-shit në lidhje me kohën e arrestimit.

534. Së pari, dëshmia e TW4-02-shit për datat e arrestimit ka mospërputhje të brendshme. Në deklaratat e tij, TW4-02 jep tri periudha të ndryshme lidhur me arrestimin dhe ndalimin: në deklaratën e vitit 2019, ai deklaroi se u arrestua më 11 qershor 1999 dhe u mbajt i ndaluar deri më 14 qershor 1999;<sup>993</sup> në të njëjtën

---

<sup>986</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 18-19; 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 1.

<sup>987</sup> [REDAKTUAR].

<sup>988</sup> [REDAKTUAR].

<sup>989</sup> TW4-02 vetë dha tri data të ndryshme të mundshme të arrestimit të tij: 9, 10 ose 11 qershor 1999; *shih TW4-02:* 108850-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 5; 060664-TR-ET Part 1 RED3 (Pjesa 1 RED3), f. 19; 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 3; 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 2.

<sup>990</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 19.

<sup>991</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 5; 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 13, f. 20, rreshti 24.

<sup>992</sup> [REDAKTUAR].

<sup>993</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 3-4; *Shih gjithashtu,* 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 26, rreshti 25 deri në f. 27, rreshti 1; 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 2.

deklaratë, dëshmitari shtoi se, sipas mendimit të tij, viktimat e vrasjes së paligjshme vdiq “dy, tri ditë përpara, ose kur kam qenë unë aty”, që do të thotë se TW4-02 ishte në FMK të paktën që nga 5 qershori 1999;<sup>994</sup> në deklaratën e vitit 2022, ai pohoi se u mbajt i ndaluar nga 9 ose 10 qershori 1999 deri më 12 qershor 1999, dhe theksoi se u mbajt i ndaluar për vetëm 48 orë.<sup>995</sup> Duke pasur parasysh këto mospërputhje të papajtueshme në deklaratat e tij, Trupi Gjykses nuk mund të mbështetet në asnjërën prej tyre për të përcaktuar saktësisht se kur u arrestua TW4-02.

535. Së dyti, deklaratat e TW4-02-shit në lidhje me periudhën dhe kohëzgjatjen e ndalimit nuk përputhen as në aspekte të tjera dhe janë të papajtueshme me informacionin tejet konkret dhe të hollësishëm që dha për praninë dhe keqtrajtimin e rëndë të të ndaluarve në FMK, të cilët u mbajtën aty para arrestimit të tij që pretendon se ndodhi afërsisht midis 9 dhe 11 qershorit 1999.<sup>996</sup> Konkretisht, duke pasur parasysh se viktimat e vrasjes së paligjshme vdiq më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date,<sup>997</sup> është e pamundur që TW4-02 të ketë qenë në FMK kur vdiq viktimat e vrasjes së paligjshme dhe njëkohësisht të ketë mbërritur atje afërsisht midis 9 dhe 11 qershorit 1999, sikurse deklaroi. Një vështirësi tjetër që krijohet është se, nga deklaratat e tij nuk është gjithmonë e qartë nëse TW4-02 i përshkroi ngjarjet në bazë të njohurive personale, mbështetur në çfarë kishte parë vetë, apo thjesht rikujtoi çfarë kishte dëgjuar nga të tjerët. Megjithatë u shpreh me një gjuhë që sugjeroi se mund të ketë qenë dëshmitar okular i këtyre ngjarjeve, në të gjithë deklaratën dhënë ZPS-së më 2019, dëshmitari këmbënguli se nuk kishte parë e as dëgjuar asgjë vetë dhe se nuk kishte qenë atje.<sup>998</sup>

---

<sup>994</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 23, rreshtat 14-17.

<sup>995</sup> **TW4-02:** 108850-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 5, rreshtat 1-6.

<sup>996</sup> *Shih, për shembull, TW4-02:* 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 5, rreshtat 1-6.

<sup>997</sup> *Shih* para 832 më poshtë.

<sup>998</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 5, rreshtat 1-7: Mirëpo, [REDAKTUAR], nuk i kam pa -- nuk i kam pa, por edhe kanë eliminu njerëz. Po, edhe kanë malltretu fizikisht, tmerrësisht shumë njerëz. Për shembull, një [REDAKTUAR], që ka vdek ... mbiemrin [e padëgjueshme] ... [REDAKTUAR], vdiq në – në dhomë nga torturat dhe nga plagët. Ama unë nuk e kam pa. Unë nuk mund të them diçka që

Ai gjithashtu këmbënguli se për këto ngjarje mësoi nga bisedat me të ndaluarit e tjerë pas luftës, edhe pse në të njëjtën kohë pretendoi se nuk kishte biseduar kurrë me të tjerë për gjëra që lidheshin me ndalimin e tij.<sup>999</sup> Duke pasur parasysh këto mospërputhje të papajtueshme, Trupi Gjykses nuk mund të mbështetet në informacionin që dha dëshmitari në lidhje me praninë dhe keqtrajtimin e rëndë të të ndaluarve të tjerë në FMK për të konfirmuar periudhën kur u arrestua, edhe pse ky informacion sugjeron fuqimisht se ai ishte në FMK para 9 qershorit 1999, madje që nga 5 qershori 1999, ose rreth kësaj date.

536. Së treti, dëshmia e TW4-02-shit bie ndesh me dëshminë e TW4-01-shit që tregon për praninë e tij (TW4-02-shit) në FMK para 5 qershorit 1999. Në lidhje me këtë, Mbrojtja kundërshtoi besueshmërinë e TW4-01-shit bazuar në mospërputhjen midis dëshmimeve të TW4-01-shit dhe TW4-02-shit [REDAKTUAR], dhe duke propozuar që Trupi Gjykses të mbështetet në dëshminë e TW4-02-shit.<sup>1000</sup> [REDAKTUAR].<sup>1001</sup> Trupi Gjykses rikujton se dëshminë e TW4-01-shit e gjykon të vërtetë, të besueshme dhe që mbështetet në të, veçanërisht në lidhje me praninë e të ndaluarve të tjerë në atë kohë, si viktimat e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], W04733, W01448, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe i ndaluarit i tretë rom. Vlen të theksohet se dëshmia e tij dhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë në lidhje me këtë aspekt janë përputhëse dhe konfirmojnë njëra-tjetrën. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, TW4-01 nuk kishte arsye për të shtuar në dëshminë e vet se TW4-02 ishte në FMK nëse nuk e kishte parë në FMK gjatë periudhës në fjalë. Kur krahason dëshmitë e dy dëshmitarëve, Trupi Gjykses e ka të vështirë të mbështetet në dëshminë e TW4-02-shit lidhur me

---

s'është [e padëgjueshme] ...". *Shih, ngjashëm, TW4-02: 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 4, rreshtat 6-11: "PY. Për të qenë i qartë, [...], a jeni ju dëshmitar i vdekjes së [REDAKTUAR] në çfarëdolloj mënyre? PË. Po unë nuk e kam pa, as që kam qenë në dhomë. Si mund të jem dëshmitar kur s'kam qenë prezent fare? Si mund të dëshmoj kur nuk di? S'kam qenë, s'kam pa. Sepse nuk vlen dëshmia ime."*

<sup>999</sup> TW4-02: 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 2, rreshti 15 deri në f. 3, rreshti 8.

<sup>1000</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 218.

<sup>1001</sup> [REDAKTUAR].



periudhën kur u arrestua, sidomos kur nuk mund të pajtojë as: (i) mospërputhjet në vetë deklaratën ose deklaratat e TW4-02-shit lidhur me datën e arrestimit; dhe (ii) pretendimet kundërthënëse të tij lidhur me praninë e të ndaluarve të tjerë dhe si mësoi për keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë në FMK. Së fundi, Trupi Gjykses u ka kushtuar vëmendje shqetësimeve që shprehu ky dëshmitar për sigurinë e tij dhe të familjes. Megjithëse nuk u provuan dhe verifikuan në sallë të gjyqit, Trupi Gjykses gjithsesi thekson se këto shqetësime mund ta kenë motivuar TW4-02-shin për të minimizuar disa aspekte të dëshmisë së vet.<sup>1002</sup>

537. Krahas kësaj, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta se sipas dëshmisë së TW4-04-ës, TW4-02 ishte në [REDAKTUAR],<sup>1003</sup> – për të cilën Trupi Gjykses konstatoi se TW4-04 është i besueshëm. Kjo do të thotë se TW4-02 ishte i ndaluar [REDAKTUAR] para se të vdiste viktima e vrasjes së paligjshme më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date. Kjo periudhë konfirmohet nga [REDAKTUAR], sikurse shtjellohet më lart.

538. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, në deklaratat e tij, TW4-02 dha qëllimisht periudhë të shkurtër lidhur me ndalimin e tij në FMK për të shmangur dhënien e dëshmisë lidhur me ngjarje të caktuara.

539. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses nuk mbështetet në deklaratat e dëshmitarit se u arrestua afërsisht midis 9 dhe 11 qershorit 1999. Përkundrazi, bazuar në dëshminë e [REDAKTUAR] dhe informacionin e hollësishëm që dha TW4-02 lidhur me keqtrajtimin që pësuan të ndaluarit e tjerë në FMK, Trupi Gjykses konstaton se TW4-02 u arrestua dhe u çua në FMK [REDAKTUAR] para asaj periudhe, afërsisht më [REDAKTUAR].

---

<sup>1002</sup> TW4-02: 108850-TR-ET Part 1 RED (Pjesa 1 RED), f. 13.

<sup>1003</sup> [REDAKTUAR].

## (b) Vendi i ndalimit brenda FMK-së

540. Dëshmitari tha se pas arrestimit e çuan menjëherë në “zyrat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me një magazinë, me një magazinë të keqe aty”.<sup>1004</sup> Dëshmitari vizatoi një skicë që ka shumë ngjashmëri me planimetrinë e FMK-së, si dhe e identifikoi si vendin ku u mbajt në bazë të fotografive që iu treguan.<sup>1005</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk ka asnjë dyshim se dëshmitari përshkroi FMK-në si vendi ku u mbajt i ndaluar.

541. Përshkrimi prej TW4-02-shit i dhomës ku u vendos në FMK, përputhet me atë të [REDAKTUAR] në ndërtesën e ndalimit.<sup>1006</sup> Edhe TW4-01 dhe TW4-04 thanë se TW4-02 u mbajt në [REDAKTUAR] në ndërtesën e ndalimit.<sup>1007</sup> Dëshmitari gjithashtu dëshmoi se e çuan disa herë në ndërtesën e komandës, ku z. Kryeziu e mori në pyetje.<sup>1008</sup>

542. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-02 u mbajt [REDAKTUAR] në ndërtesën e ndalimit gjatë gjithë kohës që ishte i ndaluar. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se TW4-02 u mbajt i ndaluar në ndërtesën e komandës gjatë kohës që u mor në pyetje.

## (c) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

543. Në deklaratën e tij, TW4-02 tha se gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, [REDAKTUAR] ishin edhe të ndaluarit e tjerë në vijim: [REDAKTUAR],<sup>1009</sup> një person

---

<sup>1004</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 3, rreshtat 17-18.

<sup>1005</sup> **TW4-02:** 060653-060663; 060653-060663-ET; 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 1-14.

<sup>1006</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 3, rreshtat 19-22: “Aty ishin dy dhoma, një korridor një në të djathtë ... Një në të majtë, [REDAKTUAR]”.

<sup>1007</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1008</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 11-12; 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 26, rreshtat 19-21; 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 18, rreshti 16 deri në f. 19, rreshti 15; 108850-TR-ET Part 1 (Pjesa 1), f. 10-11.

<sup>1009</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 23, rreshti 21 deri në f. 24, rreshti 17; 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 5, rreshtat 13-22.

nga Mitrovica,<sup>1010</sup> “nji i fshatit Shirokë te Suhareka”,<sup>1011</sup> dhe një person me emrin [REDAKTUAR].<sup>1012</sup> Në lidhje me personat e lartpërmendur, TW4-02 tha se “aty i kam gjet këta edhe aty i kam lanë”, duke sqaruar se ata ishin ndaluar para mbërritjes së tij në FMK dhe mbetën aty edhe pas lirimit të tij.<sup>1013</sup> Dëshmitari shtoi se i pa edhe “të Suharekës ([REDAKTUAR]), edhe këtë [REDAKTUAR]” pas lufte, dhe se të dy kanë ndërruar jetë ([REDAKTUAR]).<sup>1014</sup>

544. Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në dëshminë e TW4-02-shit në lidhje me praninë e [REDAKTUAR], sepse dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, konkretisht të W01448-ës dhe TW4-04-ës, konfirmojnë atë të TW4-02-shit.<sup>1015</sup> Ngjashëm, bazuar në provat e administruara në këtë gjykim, Trupi Gjykses konstaton se personi të cilin TW4-02 e përshkroi si “nji i fshatit Shirokë te Suhareka” është në fakt [REDAKTUAR].<sup>1016</sup> Rrjedhimisht, duke mbajtur parasysh dëshmitë përputhëse dhe reciprokisht konfirmuese të dëshmitarëve, Trupi Gjykses është bindur se provat tregojnë se TW4-02 u mbajt i ndaluar së bashku me [REDAKTUAR].

---

<sup>1010</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 23, rreshti 21 deri në f. 24, rreshti 17; 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 11, rreshtat 3-16.

<sup>1011</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 23, rreshti 21 deri në f. 24, rreshti 17; 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 12, rreshtat 2-9.

<sup>1012</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 23, rreshti 21 deri në f. 24, rreshti 17; 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 8, rreshtat 4-15.

<sup>1013</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 24, rreshti 4.

<sup>1014</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 24, rreshtat 5-10.

<sup>1015</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013272, SITF00013277-SITF00013278; 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 30-31; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015844, SITF00015854; SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013340.

<sup>1016</sup> Dëshmitari W01448 e identifikoi [REDAKTUAR] si dikush që ishte i ndaluar bashkë me të dhe dha hollësi të tjera lidhur me të, përfshirë se [REDAKTUAR]. **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013848-00013851 RED2, f. SITF0013848.

545. Sa i takon personit tjetër, përkatësisht personit nga Mitrovica, meqë nuk ka dëshmi të mjaftueshme në dispozicion, Trupi Gjykses do ta trajtojë këtë dëshmi në Pjesën VI.D.11 më poshtë.<sup>1017</sup>

546. Krahas të ndaluarve të lartpërmendur, TW4-02 deklaroi se gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, ndër të ndaluarit e tjerë ishin edhe TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, TW4-04, TW4-11 dhe dy vëllezër romë. [REDAKTUAR].<sup>1018</sup> [REDAKTUAR].<sup>1019</sup>

547. Trupi Gjykses vë në dukje se TW4-02 dha mjaft hollësi lidhur me të ndaluarit e tjerë, të cilat i dhanë dhe dëshmitarë të tjerë. Për shembull, TW4-02 tha se: (i) e dinte se [REDAKTUAR] dhe viktima e vrasjes së paligjshme (që e identifikoi me emër) ishin ndaluar dhe se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq gjatë kohës që ishte i ndaluar, në dhomën 1 ([REDAKTUAR]), ndërsa të ndaluarit e tjerë u torturuan dhe keqtrajtuuan në FMK;<sup>1020</sup> (ii) TW4-11 ishte [REDAKTUAR];<sup>1021</sup> dhe (iii) vëllezërit romë "[k]anë qenë gjithmonë burra të mirë".<sup>1022</sup> Trupi Gjykses e gjykon të pagjasë që TW4-02 të mund t'i identifikonte dhe përshkruante me aq hollësi personat të cilët nuk i kishte parë kurrë dhe/ose me të cilët nuk kishte pasur kontakt, edhe nëse supozohet se mund të ketë pasur biseda në lidhje me ta pas ngjarjeve, gjë që ai e mohoi. Gjithashtu, sikurse shtjellohet më lart, pretendimi i TW4-02-shit se nuk e kishte parë kurrë asnjërin prej të ndaluarve të tjerë të lartpërmendur, kundërshtohet nga TW4-01 dhe TW4-04, të cilët secili e identifikuan TW4-02-shin si të ndaluar në FMK gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar.<sup>1023</sup> Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se

---

<sup>1017</sup> *Shih* para. 589 më poshtë.

<sup>1018</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1019</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1020</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 5.

<sup>1021</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 1, rreshti 19-20.

<sup>1022</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 1, rreshtat 20-21.

<sup>1023</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1434, rreshtat 4-7; **TW4-04:** SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013272, SITF00013278; 064716-TR-ET Part 3 RED4 (Pjesa 3 RED4), f. 14; 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 30; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015844, SITF00015854-SITF00015855; SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013340.

vetë dëshmia e TW4-02-shit në fakt konfirmon se u mbajt i ndaluar në FMK në të njëjtën kohë me TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, vëllezërit romë [REDAKTUAR] dhe TW4-04-ën.

548. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se TW4-02 u mbajt i ndaluar në FMK në periudha përkuese me [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], TW4-04-ën dhe TW4-11-shin.

(d) Rrethanat e lirit

549. Sipas dëshmisë së TW4-02-shit, ai qëndroi në FMK vetëm dy ose tri ditë para se të lirohej.<sup>1024</sup> Trupi Gjykses rikujton konstatimin më lart se TW4-02 me gjasë u ndalua afërsisht më [REDAKTUAR]. Sikurse shtjellohet më lart, Trupi Gjykses e gjykon jo të besueshme dëshminë e TW4-02-shit për kohëzgjatjen e qëndrimit të tij në FMK.<sup>1025</sup> Gjithashtu, megjithëse pranon se TW4-02 u lirua para TW4-04-ës, Trupi Gjykses vë në dukje se nuk mund të mbështetet në dëshminë e TW4-04-ës për të konfirmuar atë të TW4-02-shit lidhur me kohëzgjatjen e ndalimit, sepse dëshmia e TW4-04-ës nuk është e mbështetshme as në lidhje me këtë aspekt.<sup>1026</sup> Në dallim nga kjo, Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në dëshminë e [REDAKTUAR], sepse dëshmia e dëshmitarit lidhur me këtë pikë u verifikua në sallë të gjyqit dhe ai dha shpjegim të qartë dhe bindës [REDAKTUAR].<sup>1027</sup>

---

<sup>1024</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 3, rreshtat 21-22; f. 4, rreshtat 23-24; 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 2, rreshtat 4-8; 108850-TR-ET Part 1 (Pjesa 1), f. 5, rreshti 6.

<sup>1025</sup> *Shih* Pjesën VI.D.9(a).

<sup>1026</sup> *Shih* para. 136 më lart.

<sup>1027</sup> [REDAKTUAR].

550. Ngjashëm, në lidhje me rrethanat e lirimit të tij, Trupi Gjykses vëren pretendimin e dëshmitarit se [REDAKTUAR].<sup>1028</sup> Dëshmitari shtoi: “përndryshe do – do të isha eliminu”.<sup>1029</sup> [REDAKTUAR].<sup>1030</sup> [REDAKTUAR].<sup>1031</sup> [REDAKTUAR].

551. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se TW4-02 u lirua afërsisht nga mesi i qershorit 1999.

(e) Mungesa e garancive procedurale

552. Sa i takon detyrimit për ta informuar personin që i hiqet liria për arsyet e heqjes së lirisë, Trupi Gjykses vë në dukje se sipas TW4-02-shit, atij nuk i paraqitën asnjëherë ndonjë dokument me pretendime ose akuza kundër tij.<sup>1032</sup> Po kështu, Trupi Gjykses vëren se dëshmitari theksoi se gjatë mbajtjes në ndalim, z. Kryeziu - të cilin e njihje personalisht prej më parë<sup>1033</sup> - e mori në pyetje disa herë në një të njërit prej zyrave në ndërtesën e komandës. Në një nga marrjet në pyetje, dëshmitari tha se z. Kryeziu u përpoq ta ndihmonte duke e këshilluar të heshte dhe gjithsesi të mos pranonte asgjë; me fjalët e vetë dëshmitarit: “duke më njoft mirë, dhe më thoshte mua, ‘[REDAKTUAR], mbylle, mbylle sepse këtu nuk e din se çka po ndodh’”.<sup>1034</sup> Sipas TW4-02-shit, z. Kryeziu e informoi se do të lirohej dhe se ishte kryer një procedurë verifikimi për të “kot fare”; më pas, z. Kryeziu e liroi TW4-02-shin.<sup>1035</sup>

---

<sup>1028</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1029</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 4. *Shih, ngjashëm*, 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 16.

<sup>1030</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1031</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1032</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 18.

<sup>1033</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 11-12; 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 26, rreshtat 19-21; 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 18, rreshti 16 deri në f. 19, rreshti 15; 108850-TR-ET Part 1 (Pjesa 1), f. 10-11.

<sup>1034</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 2 (Pjesa 2), f. 11, rreshtat 7-8. Thelbi i kësaj deklarate përsëritet në deklaratën e mëpasshme të **TW4-02-shit:** 108850-TR-ET Part 1 (Pjesa 1), f. 10.

<sup>1035</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 17.

553. Trupi Gjykues e gjykon dëshminë e TW4-02-shit bindëse, pasi është konkrete dhe e hollësishme, që tregon se TW4-02 e përjetoi vetë këtë ngjarje. Nga dëshmia e dëshmitarit, Trupi Gjykues dedukton se z. Kryeziu nuk kishte funksionin e një gjykatësi apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent kundrejt TW4-02-shit, por ishte thjesht një shok ose i njohur nga e kaluara. Çka është me rëndësi, përfshirja e z. Kryeziu në intervistimin dhe marrjen në pyetje të të ndaluarve në FMK është vërtetuar nëpërmjet vlerësimit të dëshmive të TW4-04-ës dhe TW4-11-shit.<sup>1036</sup>

554. Rrjedhimisht, sipas vlerësimit të Trupi Gjykues, dëshmia tregon qartë se TW4-02 nuk u informua si duhet për arsyet e heqjes së lirisë.

555. Sa i takon aspektit nëse TW4-02 u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent dhe nëse iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij, Trupi Gjykues vë në dukje se z. Kryeziu mori në pyetje TW4-02-shin. Sikurse përcaktohet më lart, dëshmia tregon qartë se z. Kryeziu nuk kishte rolin e mbikëqyrësit të pavarur të ligjshmërisë së ndalimit të TW4-02-shit, sepse nuk kishte as pushtetin, as funksionin për ta bërë këtë; përkundrazi, ai u përfshi aktivisht në nxjerrjen e informacionit nga të ndaluarit dhe ishte i pranishëm kur ata u keqtrajtuuan.<sup>1037</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykues vëren gjithashtu se dëshmitari nuk sugjeroi se u lirua si rezultat i bisedës me z. Kryeziu, por se z. Kryeziu, në rastin më të mirë, e paralajmëroi për aktivitetet kriminale që kryheshin në FMK dhe e këshilloi të heshte për sigurinë e tij. Si rezultat, Trupi Gjykues arrin në përfundimin se TW4-02 nuk u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent për të kontrolluar ligjshmërinë e ndalimit të tij.

556. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykues konstaton se TW4-02 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxor pa vonesë

---

<sup>1036</sup> *Shih* Pjesët VI.D.4(e) dhe VI.D.8(e).

<sup>1037</sup> *Shih* para. 351-353, 437 dhe 530 më lart.

para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, dhe nuk iu dha mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.

## 10. Të ndaluarit e tjerë

557. Trupi Gjykses rikujton se në Aktakuzën e Konfirmuar, ZPS-ja pretendon se afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së u hoqën lirinë së paku nëntë personave pa proces ligjor të rregullt në FMK.<sup>1038</sup> Trupi Gjykses ka marrë prova se krahas personave të diskutuar më lart, u mbajtën edhe persona të tjerë në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Më poshtë, Trupi Gjykses do të bëjë konstatime në lidhje me të ndaluarit e tjerë që u mbajtën në FMK gjatë asaj periudhe.

(a) [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe i ndaluarit i tretë rom

558. Trupi Gjykses ka marrë dëshmi të shumta dhe përputhëse nga dëshmitarë, përfshirë nga TW4 01,<sup>1039</sup> TW4-11,<sup>1040</sup> TW4-10,<sup>1041</sup> W04733,<sup>1042</sup> W01448,<sup>1043</sup> TW4-05<sup>1044</sup> dhe TW4-04,<sup>1045</sup> në lidhje me “tre muzikantë romë” që u mbajtën të ndaluar në FMK gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat. “Tre muzikantë[t] romë” ishin

<sup>1038</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 14.

<sup>1039</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1414, rreshti 16 deri në f. 1417, rreshti 20; *shih* në veçanti f. 1417, rreshtat 5-8, ku ZPS-ja i paraqiti dëshmitarit deklaratën e mëparshme të tij për t’ia freskuar kujtesën; f. 1431-1432.

<sup>1040</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1208-1209; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1340-1341.

<sup>1041</sup> **TW4-10:** T. 1 maj 2023, konfidencial, f. 1098. rreshtat 5-19, i referohet një personi rom i cili u mbajt i ndaluar në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit.

<sup>1042</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013812-SPOE00013813, SPOE00013818-SPOE00013819; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 5-6.

<sup>1043</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858. *Shih gjithashtu*, SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016141, SITF00016143.

<sup>1044</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129-SITF00013130, SITF00013132; SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500-SITF00372501.

<sup>1045</sup> **TW4-04:** SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015846; SITF00013336-00013347 RED, f. SITF00013340; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014694-SPOE000146945; 064716-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 27.



[REDAKTUAR].<sup>1046</sup> Së pari, Trupi Gjykses rikujton se ka bërë konstatim gjyqësor të faktit të shqyrtuar se [REDAKTUAR] u mbajtën të ndaluar në FMK.<sup>1047</sup> Gjithashtu, dëshmitarët në këtë çështje gjyqësore dhanë dëshmi të hollësishme dhe përputhëse për ndalimin dhe mënyrën si u trajtuan këta tre persona në FMK. Megjithëse jo të gjithë dëshmitarët i identifikuan me emër, shumë prej tyre dhanë për ta të dhëna identifikuese, të cilat ishin reciprokisht konfirmuese.<sup>1048</sup> Gjatë dëshmisë gojore, një prej dëshmitarëve e identifikoi njërin prej tyre në bazë të pamjes.<sup>1049</sup> Trupi Gjykses konstaton se, duke pasur parasysh se dëshmitarët i përshkruan në mënyrë të gjallë, përputhëse dhe të hollësishme këta tre persona, nuk ka arsye të dyshojë në saktësinë e dëshmive të tyre. Rrjedhimisht, duke mbajtur parasysh dëshmitë e TW4-01-shit, TW-11-shit, TW4-10-s, W04733-shit, W01448-ës, TW4-05-ës dhe TW4-04-ës, Trupi Gjykses konstaton se [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u mbajtën të ndaluar në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

559. Në lidhje me arrestimin fillestar, kohëzgjatjen e ndalimit dhe lirimin e tyre, Trupi Gjykses ka marrë prova të paplota. Sipas dëshmive të disa dëshmitarëve, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë romë ishin tashmë të pranishëm në FMK kur mbërritën të ndaluarit të cilët diskutohen në këtë

---

<sup>1046</sup> Trupi Gjykses vëren se W01448 identifikon tre persona me emër; *shih, për shembull, W01448: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016225; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748.*

<sup>1047</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1048</sup> Ato përfshijnë, ndër të tjera, faktin se ishin [REDAKTUAR] (**W01448: SITF00013852-00013869 RED6, f. 000013858**); se ishin [REDAKTUAR] (**W04733: U003-2283-U003-2289 RED2, f. U0032286; SPOE0013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013812-SPOE00013813**); se bënë muzikë në dasma (**TW4-11: T. 2 maj 2023, publik, f. 1208-1209; W01448: SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013836-SITF00013837; W04733: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341-SPOE00185342**); emrin e babait [REDAKTUAR] (**W01448: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858**); dhe dëshminë e dorës së dytë lidhur me arsyet pse dyshohej se mbaheshin në FMK (**TW4-01: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1417: "Mua më thanë që ata e njihnin njërin prej tyre si paramilitar sepse e kishin parë në një xhip ushtarak"**).

<sup>1049</sup> **TW4-11: T. 2 maj 2023, publik, f. 1209, rreshtat 7-22, i referohet 059341-059350, f. 059348.**

Aktgjykim.<sup>1050</sup> Në lidhje me lirimin e tyre, Trupi Gjykses vëren një mospërputhje midis dëshmisë së TW4-05-ës në njërën anë ([REDAKTUAR]), dhe dëshmisë së W01448-ës, në anën tjetër (ku thuhet se ata ishin liruar një ditë më parë nga FMK-ja).<sup>1051</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses është i mendimit se nuk është e nevojshme të vërtetohet data e saktë e lirit dhe se mospërputhja është e vogël dhe e parëndësishme. Me rëndësi është nëse provat mund të vërtetojnë se këta tre persona në fakt u mbajtën të ndaluar në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

560. Në lidhje me vendin e ndalimit brenda FMK-së, sipas disa dëshmitarëve, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u mbajtën të ndaluar në magazinën dhe në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit.<sup>1052</sup> Ata u çuan edhe në ndërtesën e komandës për t'u marrë në pyetje.<sup>1053</sup> [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u detyruan të kryenin punë krahu në magazinë dhe në oborr.<sup>1054</sup>

561. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u mbajtën të ndaluar në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se ata u mbajtën të ndaluar dhe në vende të tjera në FMK, sikurse përshkruhet më lart, gjatë marrjes në pyetje dhe teksa kryenin punë të detyruar.

---

<sup>1050</sup> *Shih, për shembull, TW4-11*: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1208-1209; **W04733**: SPOE0013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013822; **W01448**: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016236.

<sup>1051</sup> *Shih TW4-05*: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013135; SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372502; *Krahaso W01448*: SITF00016140-00016220 RED 3, f. SITF00016155.

<sup>1052</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1414-1415, 1431-1433; **TW4-11**: 2 maj 2023, publik, f. 1208, rreshti 22 deri në f. 1209, rreshti 22; **W01448**: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016225, SITF00016236; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858, SITF00013861; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748, SITF00013761-SITF00013762; U003-2232-U003-2232-ET; **W04733**: SPOE0013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013822; **TW4-02**: 060664-TR-ET Part 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 1; **TW4-10**: 1 maj 2023, publik, f. 1098. *Shih gjithashtu, [List of Adjudicated Facts](#)*, (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), Fakti i Shqyrtuar 53.

<sup>1053</sup> **TW4-05**: SITF00013123-SITF00013131 RED, f. SITF000131329-SITF00013130.

<sup>1054</sup> *Shih Pjesën VLE.2(i).*

562. Sa i takon mungesës së garancive procedurale, Trupi Gjykses vë në dukje se ka konstatuar tashmë se TW4-01-shit, TW4-11-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, W04733-shit, W01448-ës, TW4-05-ës, TW4-04-ës dhe TW4-02-shit iu hoq liria në FMK në kohë të ndryshme gjatë periudhës që lidhet me akuzat, pa iu akorduar asnjë garanci bazë sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare. Duke mbajtur parasysh dëshmitë e shumta të të ndaluarve të tjerë për këtë aspekt, si edhe se [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u mbajtën të ndaluar në të njëjtën kohë dhe në kushte të ngjashme me të ndaluarit e lartpërmendur, Trupi Gjykses është bindur se, në bazë të tërësisë së provave, i vetmi përfundim i arsyeshëm është se nuk u ndërmer asnjë masë për akordimin e garancive bazë këtyre tre të ndaluarve. Përkundrazi, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom iu nënshtruan kushteve të mjerueshme të ndalimit, rrahjeve, marrjeve në pyetje, punës së detyruar dhe formave të tjera të keqtrajtimit.<sup>1055</sup>

563. Duke pasur parasysh sa më lart dhe bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe muzikantit të tretë rom nuk iu dha asnjë garanci procedurale bazë themelore të cilat kërkohen sipas së drejtës humanitare ndërkombëtare.

(b) [REDAKTUAR] dhe femrat e tjera të ndaluara

564. [REDAKTUAR].<sup>1056</sup> [REDAKTUAR],<sup>1057</sup> [REDAKTUAR]. Ajo u arrestua në FMK më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1058</sup> [REDAKTUAR].<sup>1059</sup>

565. Në lidhje me vendin ku u mbajt e ndaluar në FMK, Trupi Gjykses ka marrë dëshmi të besueshme se ajo u mbajt në një vend veças nga dhoma 1 në ndërtesën e

---

<sup>1055</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(g) dhe VI.E.2(i).

<sup>1056</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1057</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1058</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1059</sup> [REDAKTUAR].

ndalimit.<sup>1060</sup> Trupi Gjykses rikujton se, [REDAKTUAR], pasi u arrestua, [REDAKTUAR] u mbajt një natë në magazinë.<sup>1061</sup> Krahas kësaj, sipas TW4-04-ës, një ditë në maj 1999, një grua të re [REDAKTUAR] e sollën në [REDAKTUAR] dhomën 3 në ndërtesën e ndalimit.<sup>1062</sup> Trupi Gjykses gjykon se ajo ishte [REDAKTUAR], duke pasur parasysh se nuk kishte shumë femra të ndaluara në FMK. Dëshmia e W01448-ës se [REDAKTUAR] u mbajt në një dhomë veças nga dhoma 1 përputhet me këtë përshkrim.<sup>1063</sup> Ajo përforcohet më tej nga dëshmia e TW4-01-shit se [REDAKTUAR] u mbajt në një vend tjetër.<sup>1064</sup>

566. Krahas dhomës 3, Trupi Gjykses ka dëgjuar dëshmi se [REDAKTUAR] u mbajt në një vend afër kuzhinës.<sup>1065</sup>

567. Sikurse konstatohet me hollësi në analizën e provave nga Trupi Gjykses lidhur me Pikat 2 dhe 3, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] u çua në zyrë, ku u mor në pyetje dhe u keqtrajtua rëndë.<sup>1066</sup> Rrjedhimisht, duke mbajtur parasysh dëshmitë e TW4-01-shit, TW4-04-ës dhe W01448-ës, Trupi Gjykses konstaton se [REDAKTUAR] u mbajt e ndaluar në vende të ndryshme në FMK, përfshirë në magazinë, në zyrën në ndërtesën e komandës, në dhomën 3 në ndërtesën e ndalimit (një natë), dhe në një vend afër kuzhinës.

568. Sa i takon kohëzgjatjes së ndalimit [REDAKTUAR] dhe rrethanave dhe datës së lirimit të saj, Trupi Gjykses ka marrë dëshmi të pakta dhe të paplota. Dëshmitarët e përmendin kur përshkruajnë të ndaluarit që ishin të pranishëm gjatë kohës që u

---

<sup>1060</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1421-1422, 1452.

<sup>1061</sup> *Shih* para. 380 më lart.

<sup>1062</sup> **TW4-04**: 064716-TR-ET PART 5 RED4 (Pjesa 5 RED4), f. 28-29; SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013272- SITF00013273; SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015844; *Shih gjithashtu*, para. 523 më lart.

<sup>1063</sup> **W01448**: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016225, SITF00016235.

<sup>1064</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1421-1422.

<sup>1065</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1563, rreshtat 9-19; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1916, rreshtat 2-19. [REDAKTUAR].

<sup>1066</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(e).

mbajtën të ndaluar. Nuk është evidentuar se kur u lirua saktësisht [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses bën vlerësim të kufizuar dhe konstaton se [REDAKTUAR] u mbajt e ndaluar gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar edhe dëshmitarët TW4-01, TW4-02, dhe W01448, dhe rrjedhimisht gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

569. Në lidhje me mungesën e garancive procedurale, Trupi Gjykses vëren se sipas dy dëshmitarëve, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] e akuzuan se kishte lidhje me serbë, teksa po e keqtrajtonin.<sup>1067</sup> Gjatë këtij incidenti, sikurse shtjellohet gjetkë në Aktgjykim,<sup>1068</sup> z. Shala i kërkoi [REDAKTUAR], teksa po keqtrajtohej nga anëtarë të tjerë të UÇK-së, të bënte deklaratë pranuese [REDAKTUAR].<sup>1069</sup> Bazuar në sa më lart dhe duke pasur parasysh tërësinë e provave, të cilat vërtetojnë se ajo u mbajt e ndaluar në të njëjtën kohë dhe në kushte të ngjashme me të ndaluarit e lartpërmendur, Trupi Gjykses konstaton se gjatë gjithë kohës që u mbajt e ndaluar në FMK, [REDAKTUAR] nuk iu akorduan garancitë procedurale bazë të përcaktuara në të drejtën humanitare ndërkombëtare.

570. Trupi Gjykses ka marrë dëshmi se krahas [REDAKTUAR], në ndërtesën e ndalimit u mbajtën të ndaluara edhe femra të tjera. Sipas TW4-01-shit, “dy motra” nga Gjakova, në të njëzetat, u mbajtën, u keqtrajtuuan dhe u morën në pyetje në ndërtesën e ndalimit.<sup>1070</sup> Dëshmitari dëshmoi se i pa shkurtimisht nga dritarja e ndërtesës së ndalimit teksa po dilnin jashtë. TW4-01-shit i kujtohej se “i kanë pas rrahur” dhe se i kishte dëgjuar duke qarë.<sup>1071</sup> Sikurse TW4-01, edhe dëshmitari W01448 tha se “dy femra... të cilat ishin afër dhomës tonë janë rrahur gjithashtu, ne kemi dëgjuar ato

---

<sup>1067</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013747.

<sup>1068</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(b) dhe VI.E.2(e).

<sup>1069</sup> *Shih* para. 720 më poshtë.

<sup>1070</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1565-1567.

<sup>1071</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1565-1566.

duke bërtitur".<sup>1072</sup> Trupi Gjykues nuk ka marrë dëshmi të tjera në lidhje me këto dy femra të ndaluara që do të mundësonin një konstatim të mëtejshëm në lidhje me identitetet e tyre, kohëzgjatjen e ndalimit ose rrethanat e lirit të tyre.

571. Trupi Gjykues gjithashtu vë në dukje se W01448 deklaroi në mënyrë përputhëse dhe të hollësishme se një e ndaluar femër (tjetër) me emrin [REDAKTUAR], u keqtrajtua në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1073</sup> Trupi Gjykues nuk mund të përcaktojë përfundimisht nëse [REDAKTUAR] ishte njëra nga "motra[t] nga Gjakova" ose një e ndaluar tjetër.

572. Megjithëse nuk mund të bëjë konstatime të hollësishme në lidhje me identitetet e grave të lartpërmendura, periudhën e ndalimit të tyre ose vendin ku u mbajtën të ndaluara në FMK, Trupi Gjykues megjithatë është bindur - në bazë të provave të administruara në këtë gjykim - se krahas [REDAKTUAR], një femër me emrin [REDAKTUAR] dhe së paku një femër tjetër, u mbajtën të ndaluara në ndërtesën e ndalimit ose diku tjetër në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

(c) [REDAKTUAR]

573. Disa dëshmitarë, ndër të cilët TW4-01, W01448, dhe TW4-02, e identifikojnë [REDAKTUAR] si të ndaluar bashkë me ta gjatë periudhave përkatëse të ndalimit të tyre në FMK. Ndërsa TW4-01 dëshmoi se nuk i kujtohej emri i tij, ai tha se ky person ishte nga Suhareka, i gjatë, me mustaqe dhe në të 50-at.<sup>1074</sup> W01448 e identifikoi këtë

---

<sup>1072</sup> **W01448:** SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837.

<sup>1073</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013746-SITF00013747; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016235.

<sup>1074</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1538, rreshtat 23-24.

person si [REDAKTUAR] dhe përmendi disa të dhëna personale në lidhje me të, ndër të tjera se [REDAKTUAR].<sup>1075</sup> Kjo përputhet me dëshminë e TW4-02-shit.<sup>1076</sup>

574. Në lidhje me vendin ku u mbajt i ndaluar, dëshmitarët e identifikojnë [REDAKTUAR] si person të ndaluar në dhomën 1 dhe dhomën 3 në ndërtesën e ndalimit.<sup>1077</sup> Duke mbajtur parasysh provat në tërësi, Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR] me të vërtetë u mbajt i ndaluar në dhomën 1 dhe dhomën 3 në ndërtesën e ndalimit në FMK, gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

575. Në lidhje me kohëzgjatjen e ndalimit dhe rrethanat e lirit të tij, Trupi Gjykses vë në dukje se nuk mori prova për ndonjë datë konkrete, por se W01448 deklaroi se [REDAKTUAR] u lirua nga Xhemshit Krasniqi para datës 17 maj 1999.<sup>1078</sup> Bazuar në provat në tërësi, Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar në FMK brenda periudhës së Aktakuzës së Konfirmuar.

576. Në lidhje me aspektin e garancive procedurale, Trupi Gjykses së pari vë në dukje se nuk ka marrë prova për rrethanat e arrestimit të [REDAKTUAR]. Sidoqoftë, Trupi Gjykses mban parasysh dëshminë e TW4-01-shit se [REDAKTUAR] mbahej në bazë të akuzave se kishte “ndenjtur me serbë”, ndërsa “djalin e kishte pasur të veshur në UÇK”.<sup>1079</sup> Sipas TW4-01-shit, gjatë marrjes në pyetje, atij iu tha: “Qysh, djalin në luftë e ke, me ne është duke luftuar, e ti duke ndenjtur me serbë?”<sup>1080</sup> Ngjashëm, edhe TW4-02 deklaroi se [REDAKTUAR] mbahej në FMK sepse “gjoja ka bashkëpunu me serbë”.<sup>1081</sup> Bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur, për të cilat Trupi

---

<sup>1075</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; *shih, ngjashëm*, SITF00013848-00013851 RED2, f. SITF0013848.

<sup>1076</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Pjesa 4, f. 12; 060664-TR-ET Pjesa 3, f. 24.

<sup>1077</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1538; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013762; **TW4-02:** 060664-TR-ET Pjesa 2, f. 3 dhe 060664-TR-ET Pjesa 3, f. 24.

<sup>1078</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013757.

<sup>1079</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1556, rreshtat 12-13.

<sup>1080</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1556, rreshtat 18-19.

<sup>1081</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Pjesa 4, f. 12, rreshtat 8-9.

Gjykues konstaton se janë të besueshme dhe mund të mbështetet në to dhe duke pasur parasysh se [REDAKTUAR] u ndalua sipas së njëjtës praktikë ndalimi si të tjerët që u mbajtën në FMK në bazë të akuzave se ishin spiunë ose bashkëpunëtorë, Trupi Gjykes konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm bazuar në tërësinë e provave është se as [REDAKTUAR] nuk u informua si duhet për arsyet e arrestimit dhe mbajtjes në ndalim. Gjithashtu, Trupi Gjykes vë në dukje dëshminë e TW4-01-shit për keqtrajtimin e rëndë që pësoi [REDAKTUAR] gjatë mbajtjes në ndalim.<sup>1082</sup> Bazuar në (i) keqtrajtimin e cituar më lart, (ii) faktin se asnjërit prej të ndaluarve të tjerë nuk iu akorduan garanci procedurale, dhe (iii) rrethanat e lirit të tij, Trupi Gjykes konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm bazuar në tërësinë e provave është se [REDAKTUAR] nuk u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, dhe nuk iu dha mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.

577. Bazuar në sa më lart, dhe duke marrë parasysh provat në tërësi, Trupi Gjykes konstaton se gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, [REDAKTUAR] nuk iu dhanë garancitë bazë të përcaktuara në të drejtën humanitare ndërkombëtare.

(d) [REDAKTUAR]<sup>1083</sup>

578. Dëshmitarët W01448, TW4-02, dhe TW4-04 dhanë dëshmi që konfirmojnë njëra-tjetrën në lidhje me mbajtjen në ndalim të [REDAKTUAR] gjatë periudhës së akuzave.<sup>1084</sup>

579. Në lidhje me vendin ku mbajt i ndaluar, Trupi Gjykes vë në dukje se W01448, TW4-02 dhe TW4-04 e identifikuan [REDAKTUAR] si dikush që u mbajt në dhomën 1 dhe në dhomën 3. Sipas deklaratave të W01448-ës, [REDAKTUAR] ishte i ndaluar

---

<sup>1082</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1538, rreshtat 12-24.

<sup>1083</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1084</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; **TW4-02:** 060664-TR-ET Pjesa 3, f. 23-24; 060664-TR-ET Pjesa 4, f. 5-7.



bashkë me të në dhomën 1,<sup>1085</sup> të cilin më vonë e zhvendosën në dhomën që W01448 e quajti “dhoma e vajzave”<sup>1086</sup> – që sipas interpretimit të Trupit Gjykses i referohet dhomës 3.<sup>1087</sup> Sipas dëshmisë së TW4-04-ës, [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar në dhomën 3, [REDAKTUAR].<sup>1088</sup> Siç është shtjelluar më lart, Trupi Gjykses mbështetet në dëshminë e TW4-04-ës në lidhje me këtë aspekt dhe rrjedhimisht konstaton se gjatë kohës që ishte në FMK, Ali Shehu u mbajt i ndaluar në dhomën 3.

580. Sa i përket kohëzgjatjes së ndalimit dhe rrethanave të lirimit, ndërsa nuk mund të përcaktojë përfundimisht datën e fillimit të mbajtjes në ndalim, bazuar në provat e paraqitura, Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR] u lirua prej ndërtesës së MPB-së në Prizren nga KFOR-i më 18 qershor 1999, bashkë me të ndaluar të tjerë.<sup>1089</sup>

581. Në lidhje me aspektin e garancive procedurale, duke pasur parasysh se të gjithë të ndaluarit e tjerë u arrestuan dhe u mbajtën në kushte të ngjashme ndalimi duke zbatuar të njëjtën praktikë veprimi, dhe ngjashëm me W01448-ën [REDAKTUAR] u liruan gjatë të njëjtit operacion në Prizren, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm bazuar në provat në tërësi është se as [REDAKTUAR] nuk u informua si duhet për arsyet e arrestimit dhe mbajtjes në ndalim, nuk u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, dhe nuk iu dha mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.

---

<sup>1085</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761-SITF00013762.

<sup>1086</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858.

<sup>1087</sup> **W01448** përshkruan “dhomën e çikave” se ndodhej matanë korridorit nga dhoma 1, që përkon me vendndodhjen e dhomës 3. Referenca e tij ndaj dhomës ku mbaheshin të ndaluarat femra përputhet me dëshminë e TW4-01-shit se “dy motra” nga Gjakova u morën në pyetje në dhomën 3 dhe u rrahën në dhomën 2. *Shih TW4-01-shin*: 31 maj 2023, konfidencial, f. 1565, rreshti 18 deri f. 1566, rreshti 24. [REDAKTUAR].

<sup>1088</sup> **TW4-04**: SITF00015825-00015925 RED, f. SITF00015844, SITF00015846.

<sup>1089</sup> [REDAKTUAR]; **W01448**: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016225; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858, SITF00013861, SITF00013863; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013756; 064716-TR-ET Pjesa 5 RED4, f. 30-31.

(e) [REDAKTUAR]<sup>1090</sup> dhe [REDAKTUAR]<sup>1091</sup>

582. Trupi Gjykses vëren se TW4-01 iu referua [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si dy të ndaluar të tjerë që u mbajtën në të njëjtën dhomë me të (dhoma 1).<sup>1092</sup> Edhe TW4-02 e përshkroi [REDAKTUAR] si të ndaluar bashkë me të në dhomën 3, dhe përmendi të dhëna të tjera në lidhje me të, si vendi nga ishte, nofka që kishte dhe me çfarë ishte marrë para konfliktit, që e bën të besueshme dëshminë e tij.<sup>1093</sup> Edhe W01448 në deklaratat e tij përmend [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si të ndaluar të tjerë në dhomën 1, së bashku me TW4-01-shin dhe viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>1094</sup> Bazuar në dëshmitë e këtyre tre dëshmitarëve të cilat i gjykon të besueshme dhe te të cilat mund të mbështetet në lidhje me këtë aspekt, Trupi Gjykses është bindur se gjatë periudhës që lidhet me akuzat, [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar në dhomat 1 dhe 3, kurse [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit në FMK.

583. Trupi Gjykses vë në dukje se nuk ka marrë asnjë provë në lidhje me rrethanat e arrestimit të këtyre personave, kohëzgjatjen e ndalimit, apo hollësitë e lirit të tyre. Sidoqoftë, së paku një dëshmitar konfirmoi se [REDAKTUAR] u keqtrajtua gjatë mbajtjes në ndalim.<sup>1095</sup> Trupi Gjykses e gjykon këtë dëshmi të besueshme, veçanërisht për arsyen se përputhet me praktikën e keqtrajtimit të të gjithë të ndaluarve të tjerë që u mbajtën në ndërtesën e ndalimit. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh praktikën e veprimit që u zbatua për arrestimin dhe ndalimin e të gjithë të ndaluarve në FMK, Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nuk u informuan

---

<sup>1090</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1091</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1092</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1433, rreshti 15 deri f. 1434, rreshti 2.

<sup>1093</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Pjesa 4, f. 5, 8-11.

<sup>1094</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016237; U003-2232-U003-2232-ET.

<sup>1095</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Pjesa 4, f. 10.

për arsyet e arrestimit dhe ndalimit të tyre dhe nuk iu dha mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tyre.

(f) Të ndaluarit e tjerë të pretenduar

584. *Luftëtarë të FARK-ut ose të UÇK-së.* Trupi Gjykses mori dëshmi nga TW4-01 dhe W01448 se në një moment gjatë periudhës së Aktakuzës së Konfirmuar, një grup luftëtarësh të FARK-ut<sup>1096</sup> ose UÇK-së<sup>1097</sup> u mbajtën të ndaluar për një kohë të shkurtër në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit.<sup>1098</sup> Ata u akuzuan për dezertim dhe u keqtrajtuuan rëndë.<sup>1099</sup>

585. *Të ndaluarit serbë.* Trupi Gjykses vë në dukje se krahas të ndaluarve të tjerë të diskutuar më lart, TW4-01 dëshmoi për praninë e mundshme të të ndaluarve serbë gjatë periudhës së ndalimit të tij në FMK.<sup>1100</sup> Ngjashëm, W04379 deklaroi se një anëtar i pretenduar i një njësie paramilitare serbe u mbajt i ndaluar në FMK.<sup>1101</sup>

586. Në lidhje me të ndaluarit e lartpërmendur, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka marrë prova të mjaftueshme që do t'i mundësonin nxjerrjen e konstatimeve për Pikën 1 të Aktakuzës së Konfirmuar.

## 11. Përfundim

587. Duke marrë parasysh të gjitha provat në tërësi, Trupi Gjykses konstaton se afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, anëtarë të UÇK-së në FMK u hoqën

---

<sup>1096</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016238; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013860;

<sup>1097</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1507, rreshtat 6-15; f. 1512, rreshtat 2-11; SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014095-SITF00014096;

<sup>1098</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00016908-00016964 RED, f. SITF00016913-SITF00016914; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013754.

<sup>1099</sup> **TW4-01:** 31 maj 2023, konfidencial, f. 1507, 1512; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013860; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016238; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013759.

<sup>1100</sup> **TW4-01:** T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1913.

<sup>1101</sup> **W04379:** 060124-TR-ET Pjesa 2 Rishikuar RED4, f. 56-66.

lirinë këtyre personave: TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, TW4-11-shit, W04733-shit, W01448-ës, TW4-05-ës, TW4-04-ës, TW4-02-shit, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe të ndaluarit të tretë rom, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe së paku edhe një femre tjetër të ndaluar, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

588. Në lidhje me vendin e ndalimit, provat tregojnë se për mbajtjen e të ndaluarve u përdorën disa vende në FMK. Të ndaluarit kryesisht u mbajtën në ndërtesën e ndalimit. Dhoma 1 në ndërtesën e ndalimit ishte dhoma ku mbaheshin më shumë të ndaluar; dhoma 2 u përdor si vend për marrje në pyetje/keqtrajtim; dhoma 3 ishte një dhomë tjetër ndalimi ku mbaheshin më pak të ndaluar. Meqenëse në zyrën e ndërtesës së komandës personat merreshin në pyetje dhe rriheshin për një kohë më të gjatë, edhe ky objekt ishte faktikisht vend për ndalim. Trupi Gjykses gjithashtu ka konstatuar se dëshmitarët W04733, W01448 dhe viktima e vrasjes së paligjshme u mbajtën për një kohë të shkurtër në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës. Së fundi, duke marrë parasysh provat në tërësi, Trupi Gjykses vlerëson se është plotësisht e besueshme që edhe dhoma ose vende të tjera në FMK, si magazina ose vendi afër kuzhinës, të jenë përdorur si vende për ndalim. Po kështu edhe oborri ku [REDAKTUAR] dhe i ndaluari i tretë rom u detyruan të punonin, ishte vend i mbajtjes në ndalim.

589. Sa i përket numrit të gjithsejtë të të ndaluarve që u mbajtën në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, Trupi Gjykses konstaton se provat vërtetojnë pa mëdyshje se persona u mbajtën dhe u liruan në vazhdimësi në FMK. Disa u mbajtën për disa ditë, kurse disa të tjerë edhe deri në një muaj. Edhe pse nuk dihet numri i gjithsejtë i personave që u mbajtën të ndaluar në FMK gjatë periudhës që lidhet me

akuzat, vlerësohet se ishin rreth 40 persona.<sup>1102</sup> Në disa raste, në një dhomë të vetme u mbajtën deri në 13 persona.<sup>1103</sup>

590. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, për arrestimin dhe ndalimin e personave që u mbajtën në FMK u zbatua një praktikë veprimi: të ndaluarit u arrestuan në vendin e banimit, në rrugë, me të arritur në portin e Durrësit, [REDAKTUAR] apo kudo që kishin gjetur strehim pas dëbimit nga Kosova. Rrethanat e arrestimit të një numri të ndaluarish sugjerojnë se hetimet për vendndodhjen e tyre ishin bërë kohë më parë. Të ndaluarit u transferuan në FMK ose u arrestuan kur ishin brenda FMK-së. Ata u arrestuan dhe u morën në pyetje bazuar në pretendime të mjegullta se përkrahnin ose ndryshe, kishin lidhje me Serbinë, “serbët” apo autoritetet serbe, ose se ishin “tradhtarë” apo “bashkëpunëtorë”, ose se nuk përkrahnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së, financiarisht, ushtarakisht apo politikisht. Sikurse shtjellohet edhe në Pikat 2 dhe 3, këta persona u keqtrajtuuan dhe u mbajtën në ndalim deri kur personat përgjegjës për ndalimin e tyre vendosnin se mund të liroheshin, ose deri në lirim të tyre përmes ndërhyrjeve nga jashtë.<sup>1104</sup> Gjatë kohës së mbajtjes në ndalim, personat e lartpërmendur iu nënshtruan kushteve të ngjashme të ndalimit dhe keqtrajtimit, duke filluar nga kushtet mizore në dhomat e ndalimit e deri në rrahjen dhe qëllimin e tyre me armë zjarri.<sup>1105</sup>

591. Së fundi, Trupi Gjykses konstaton se disa të ndaluarve, ndër të cilët TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, TW4-11, W04733, W01448, TW4-05, TW4-04, TW4-02, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe i ndaluarit i tretë rom, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe së paku edhe një tjetër femër e ndaluar, [REDAKTUAR],

---

<sup>1102</sup> *Shih* poshtëshënimin 766 më lart. Trupi Gjykses vë në dukje se një numër dëshmitarësh përmendën se në FMK u mbajtën edhe të ndaluar të tjerë, për të cilët Trupi Gjykses nuk ka bërë konstatime të mëtejshme (shih para. 391 dhe 487 më lart). Bazuar në provat në tërësi, Trupi Gjykses është i mendimit se në FMK u mbajtën më shumë të ndaluar se personat që diskutohen në këtë Aktgjykim.

<sup>1103</sup> *Shih* para. 427 më lart.

<sup>1104</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2 dhe VI.E.4.

<sup>1105</sup> *Shih* Pjesët VI.E.1, VI.E.2(a) dhe VI.E.4.

[REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar nuk iu dha asnjë garanci procedurale bazë që u takonte në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Konkretisht, ata nuk u informuan si duhet për arsyet e heqjes së lirisë, nuk u nxorën pa vonesë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent, dhe nuk iu dha mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tyre.

#### E. TRAJTIMI MIZOR DHE TORTURA (PIKAT 2 DHE 3)

592. Në vijim, Trupi Gjykues do të vlerësojë provat dhe do të nxjerrë konstatime faktike në lidhje me Pikat 2 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar, konkretisht nëse afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, të ndaluarit në FMK – ndër të cilët TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, W04733, W01448, [REDAKTUAR] dhe një femër tjetër e ndaluar – u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe u keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht nga z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së.<sup>1106</sup> Trupi Gjykues do të diskutojë: (i) kushtet e ndalimit që mbizotëronin në FMK; dhe (ii) keqtrajtimin fizik dhe psikologjik të të ndaluarve.

#### 1. Kushtet e ndalimit

593. Trupi Gjykues do të diskutojë me radhë: (a) kushtet e jetesës dhe të fjetjes; (b) dhënien e ushqimit dhe të ujit; (c) kushtet higjienike dhe përdorimin e pajisjeve sanitare; (d) disponueshmërinë e ndihmës mjekësore; dhe (e) deri në çfarë mase lejoheshin të ndaluarit të komunikonin dhe flisnin me njëri-tjetrin gjatë mbajtjes në ndalim.

---

<sup>1106</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 18-24, 26.

(a) Kushtet e jetesës dhe të fjetjes

594. Në konstatimet e veta faktike në lidhje me ndalimin arbitrar (Pika 1), Trupi Gjykses konstatoi se TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, TW4-11, W04733, W01448, TW4-05, TW4-04, TW4-02, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom, [REDAKTUAR], dhe së paku edhe një femër tjetër e ndaluar, u mbajtën në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, në dhomat 1 dhe 3 në ndërtesën e ndalimit, si dhe në vende të tjera në kompleksin e FMK-së.<sup>1107</sup>

595. Në nxjerrjen e konstatimeve faktike në lidhje me kushtet e ndalimit, Trupi Gjykses vë në dukje kushtet e ndalimit në ndërtesën e ndalimit, veçanërisht në dhomën 1, ku u mbajtën shumica e të ndaluarve.<sup>1108</sup>

i. Kushtet në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës

596. Trupi Gjykses rikujton se, gjatë periudhës që lidhet me akuzat, në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës u mbajtën të ndaluar një numër i kufizuar personash, konkretisht viktima e vrasjes së paligjshme, W04733 dhe W01448.<sup>1109</sup>

597. Gjatë dëshmisë së vet, TW4-01 shpjegoi se, edhe pse vetë nuk e kishte parë dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, viktima e vrasjes së paligjshme ia kishte përshkruar si “ndër shkallët një dhomë e vogël”.<sup>1110</sup> Këtë informacion të dorës së dytë që dha TW4-01, të cilin e mësoi nga viktima e vrasjes së paligjshme në atë kohë, Trupi Gjykses e konsideron dëshmi të bazuar meqenëse konfirmohet nga W01448 dhe W04733, deklaratat e të cilëve në lidhje me këtë aspekt janë më të hollësishme. Në veçanti, W01448 dhe W04733 e përshkruan dhomën e ndalimit në ndërtesën e

---

<sup>1107</sup> *Shih* para. 587-588 më lart.

<sup>1108</sup> *Shih* para. 588 më lart.

<sup>1109</sup> *Shih* para. 588 më lart.

<sup>1110</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1471, rreshtat 2-11; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1915, rreshtat 9-17.

komandës në mënyrë përputhëse si një dhomë shumë të vogël, pa orendi.<sup>1111</sup> Sipas W01448-ës, të ndaluarit nuk kishin hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur dhe kur donin të shtriheshin, duhej ta bënin këtë me radhë.<sup>1112</sup> Përshkrimi që i bëri W04733 dhomës është domethënës: “Jo dhomë e vogël, por dhomë shumë e vockël”.<sup>1113</sup> Gjithashtu, W01448-ës dhe W04733-shit u kujtohej qartë se dhoma e ndalimit në ndërtesën e komandës kishte tavan shumë të ulët.<sup>1114</sup> W01448 shpjegoi se, për pasojë, të ndaluarit nuk mund të qëndronin drejt në këmbë.<sup>1115</sup> Duke pasur parasysh hollësitë e dëshmive të tyre dhe meqenëse dëshmitarët i konfirmojnë dëshmitë e njëri-tjetrit, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka arsye që të dyshojë në përjetimet personale të W04733-shit dhe W01448-ës.

598. Gjithashtu, sipas deklaratave të W04733-shit dhe W01448-ës, në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës nuk kishte rrymë, as dritare dhe, rrjedhimisht, nuk kishte dritë.<sup>1116</sup> Siç shpjegoi W04733, “e vetmja dritë ka ardhur nga pjesa e nënderës,

<sup>1111</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016229; **W04733:** SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019829; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013809; 082892-TR-AT-ET Pjesa 5 RED2, f. 3, rreshtat 19-22.

<sup>1112</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016145.

<sup>1113</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013809.

<sup>1114</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013741; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016144; **W04733:** SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019830. Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitë e dëshmitarëve dallojnë sa i përket nëse dhoma ishte me tavan të ulët për shkak se ndodhej nën shkallë apo nën çati. Trupi Gjykses gjykon se këto dallime midis deklaratave të dëshmitarëve janë rezultat i natyrshëm i kalimit të kohës dhe pasqyrojnë kujtimet personale të secilit dëshmitar në lidhje me strukturën fizike të dhomës, që dallojnë për secilin dëshmitar varësisht nga përjetimi traumatik i keqtrajtimit. Sido që të jetë, kjo mospërputhje nuk ka ndikim në konstatimet e Trupit Gjykses, pasi dëshmitë e dëshmitarëve përputhen për aspekte kyçe të përshkrimit të dhomës, përfshirë madhësinë e saj dhe se ndodhej në katin e parë të ndërtesës së komandës. Nëse dhoma ndodhej nën shkallë ose thjesht nën çati, është e rëndësishme dytësore për vendimin mbi akuzat.

<sup>1115</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016229; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016144-SITF00016145.

<sup>1116</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016145; **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013809; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019831.



nga korridori".<sup>1117</sup> Në deklaratën e vet, W01448 gjithashtu tregoi se, kur mbërriti në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, aty gjeti shishe të mbushura me urinë dhe batanije të pista.<sup>1118</sup> Ai më tutje deklaroi se kur binte shi jashtë, dhoma ishte e ftohtë, por më vonë gjatë mbajtjes së tij në ndalim, temperaturat në dhomë ishin shumë të larta.<sup>1119</sup> Trupi Gjykses konstaton se këto dëshmi janë të besueshme meqenëse dëshmitarët e përshkruan dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës në mënyrë të besueshme, të hollësishme dhe të qartë.

599. Trupi Gjykses vëren se deklaratat e dëshmitarëve dallojnë, por shumë pak, sa u përket kushteve të fjetjes. W01448 përshkroi se në dhomë kishte dyshekë të hollë sfungjeri,<sup>1120</sup> kurse W04733 deklaroi se të ndaluarit flinin mbi mushama.<sup>1121</sup> Trupi Gjykses gjykon se këto dallime janë pasojë e natyrshme e kalimit të kohës dhe pasqyrojnë kujtesën personale të secilit dëshmitar të ngjarjeve traumatike që përjetuan. Nga ky këndvështrim, këto dallime nuk e zvogëlojnë, por përkundrazi e përforcojnë besueshmërinë e dëshmitarëve. Gjithashtu, Trupi Gjykses është i mendimit se këto mospërputhje nuk kanë të bëjnë me aspekte të rëndësishme dhe nuk ndikojnë në mbështetshmërinë në dëshmitë e dëshmitarëve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se të dy dëshmitarët dëshmuan të vërtetën në lidhje me kushtet e fjetjes në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës.

---

<sup>1117</sup> **W04733:** SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019831.

<sup>1118</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013741; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016229; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016144.

<sup>1119</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016145.

<sup>1120</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016229; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016144.

<sup>1121</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 21, rreshtat 1-3.

## ii. Kushtet në dhomën 1

600. Siç është konstatuar nga Trupi Gjykes në lidhje me Pikën 1, shumica e të ndaluarve u mbajtën në dhomën 1.

601. Dëshmitë që dhanë TW4-01, W04733, W01448, TW4-11 dhe TW4-05 në lidhje me madhësinë e dhomës 1 tregojnë se të ndaluarit nuk kishin hapësirë të mjaftueshme për të pushuar ose fjetur, sidomos kur merret parasysh se, sipas provave të administruara prej Trupit Gjykes, në një kohë, numri i të ndaluarve në këtë dhomë arriti në 13.<sup>1122</sup> Ngjashëm, të gjithë dëshmitarët thanë se në dhomën 1 nuk kishte orendi dhe se dyshemeja ishte prej betoni.<sup>1123</sup> TW4-01 shpjegoi se ndërtesa ishte aq e vjetër sa që dyshemeja prej betoni ishte e thyer, një hollësi e dallueshme e konfirmuar nga deklarata e W01448-ës.<sup>1124</sup> Dëshmitarët gjithashtu në mënyrë përputhëse dëshmuan se dhoma kishte dy dritare me shufra hekuri dhe pa xhama.<sup>1125</sup> W01448 shpjegoi se dhoma 1 ishte “tepër e nxehtë”.<sup>1126</sup> “Për njerëzit e moshuar ishte vështirë [...] Jam

<sup>1122</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1431, rreshtat 15-16; f. 1432, rreshtat 8-11; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1199, rreshtat 12-13; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748, SITF00013750; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016145-SITF00016146; SITF00374558-00374558, f. SITF00374558; **W04733:** 106978-107020, f. 106990; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013822; **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129. Në lidhje me numrin e të ndaluarve në veçanti, *shih* ndër të tjerë **TW4-01-shin:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1431, rreshtat 15-16; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837.

<sup>1123</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1430, rreshtat 19-21; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1218, rreshtat 11-12; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013749; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146; **W04733:** 106978-107020, f. 106990; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013822; **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013130.

<sup>1124</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1430, rreshtat 19-21; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013749.

<sup>1125</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1423, rreshtat 16-22; T. 30 maj 2023, publik, f. 1430, rreshtat 22-24; f. 1431, rreshti 1; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1199, rreshti 12; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013749; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016147; **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013130. Në kundërshtim me dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve të tjerë, TW4-11 dëshmoi se kishte vetëm një dritare. Trupi Gjykes nuk e gjykon problematike kujtesën e TW4-11-shit në lidhje me këtë dhe vlerëson se fakti nëse dhoma kishte një apo dy dritare, nuk ndikon në konstatimet e Trupit Gjykes në lidhje me akuzat.

<sup>1126</sup> **W01448:** SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016147.

alivanosur disa herë aty për shkak të temperaturës së nxehtë brenda”, shtoi ai.<sup>1127</sup> Kur u pyet për kushtet e jetesës në dhomën 1, W04733 u përgjigj: “kanë qenë në atë mënyrë që as kafshët apo bagëtitë nuk do të qëndronin aty”.<sup>1128</sup> Dëshmitë përputhëse të dëshmitarëve e bindin Trupin Gjykses se ata ishin të sinqertë dhe të besueshëm në lidhje me veçoritë e dhomës 1.

602. Sa u përket kushteve të fjetjes, TW4-01 dëshmoi se, edhe pse të ndaluarve fillimisht u ishin dhënë batanije për të fjetur, këto batanije më vonë u hoqën nga dhoma.<sup>1129</sup> Dëshmia e TW4-11-shit është e ngjashme. Ai dëshmoi në sallën e gjyqit se, krahas batanijeve të ndaluarve iu dhanë edhe dyshekë të hollë nga sfungjeri,<sup>1130</sup> dhe se të dyja më vonë u hoqën nga dhoma.<sup>1131</sup> Edhe dëshmitë e TW4-05-ës dhe W04733-shit konfirmojnë se kishte dyshekë të hollë dhe batanije.<sup>1132</sup> Në lidhje me këtë, W04733 dëshmoi: “Dy apo tre prej neve ndanim nga një plaf”.<sup>1133</sup> Trupi Gjykses gjykon se mund të mbështetet në dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur sepse konfirmojnë njëra-tjetrën.

603. Sidoqoftë, Trupi Gjykses gjithashtu dëgjoi dëshminë paksa të ndryshme të W01448-ës, sipas të cilit të ndaluarit flinin në dyshemënë prej betoni, pa dyshekë e batanije.<sup>1134</sup> Trupi Gjykses konstaton se kjo mospërputhje është e shkëputur, nuk ka të bëjë me aspekte të rëndësishme dhe, rrjedhimisht, nuk ndikon në mbështetshmërinë në dëshminë e dëshmitarit. Për pasojë, Trupi Gjykses mbështetet në dëshminë e

---

<sup>1127</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750.

<sup>1128</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106990.

<sup>1129</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1430, rreshti 17; f. 1431, rreshtat 3-7; f. 1432, rreshtat 16-20.

<sup>1130</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1218, rreshtat 8-16.

<sup>1131</sup> **TW4-11:** T. 3 maj 2023, publik, f. 1241, rreshtat 17-19; f. 1289, rreshtat 10-13.

<sup>1132</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106990, 106708; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013822; 082892-TR-AT-ET Pjesa 9 RED2, f. 8, rreshti 22 deri f. 9, rreshtat 1-7; **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129.

<sup>1133</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013822.

<sup>1134</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013749; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858.

W01448-ës, i cili konfirmon qartë kushtet e mjerueshme të jetesës dhe të fjetjes që mbizotëronin në dhomën 1.

604. Trupi Gjykues gjithashtu mori prova të shumta se të ndaluarit në dhomën 1 nuk ishin në gjendje të flinin gjatë natës sepse anëtarë dhe luftëtarë të ndryshëm të UÇK-së që ktheheshin nga fronti i ngacmonin nga dritarja ose hynin në dhomë dhe i keqtrajtonin deri në orët e hershme të mëngjesit.<sup>1135</sup> Dëshmia e TW4-01-shit është domethënëse: “na u mshelshin sytë po gjumi nuk na zejke. Nuk e di a kemi ba ka pesë minuta, flej njeni, pesë minuta. Kur kalojke dikush a dilshin te dritarja të bërtitshin, na shajshin, na ofendojshin. [...] Veç tuj prit kur po kris dera. Kur a çelë dera e kemi ditë se dajaki krisi”.<sup>1136</sup> W04733 gjithashtu shpjegoi në një deklaratë të tij se anëtarë të UÇK-së “do të vinin brenda [në dhomën 1] dhe na thoshin që të mos flinim, na thoshin që të ngrihemi dhe na rrihnin”.<sup>1137</sup> Duke dëshmuar më tej për keqtrajtimit që pësuan, W01448 kujtoi: “kjo ka ndodhur çdo natë, [anëtarët e UÇK-së] duke na detyruar që të rraheshim mes vete edhe ata na rrahnin. Ata vinin të dehur”.<sup>1138</sup>

605. Duke pasur parasysh dëshmitë e tyre të hollësishme që konfirmojnë njëra-tjetrën, Trupi Gjykues është bindur se TW4-01, W04733, W01448, TW4-11 dhe TW4-05 përshkruan me vërtetësi përjetimet e tyre personale.

iii. Kushtet në dhomën 3

606. [REDAKTUAR], të cilit ishin në mesin e të ndaluarve të mbajtur në dhomën 3 gjatë periudhës që lidhet me akuzat, dhanë dëshmi reciprokisht konfirmuese për kushtet në dhomën 3.

---

<sup>1135</sup> *Shih* para. 641-643, 648 më poshtë dhe referencat aty.

<sup>1136</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1539, rreshtat 5-14.

<sup>1137</sup> **W04733**: SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013825.

<sup>1138</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013754.

607. Më konkretisht, [REDAKTUAR] e përshkroi dhomën 3 si një dhomë të vjetër, të vogël dhe të lagësht, pa rrymë elektrike.<sup>1139</sup> I kujtohej se dhoma 3 kishte dritare të mëdha.<sup>1140</sup> [REDAKTUAR] gjithashtu dëshmoi se, ndryshe nga të ndaluarit e tjerë në dhomat 1 dhe 3, të cilët flinin në dysheme, atij i dhanë dyshek për të fjetur.<sup>1141</sup> Trupi Gjykses gjithashtu dëgjoi dëshminë [REDAKTUAR] i cili, ngjashëm me [REDAKTUAR], deklaroi se të ndaluarit në dhomën 3 flinin në dyshemenë prej çimentoje, duke përdorur vetëm disa batanije.<sup>1142</sup> Dëshmitarit gjithashtu i kujtohej se dhoma 3 nuk kishte as orendi, as krevate dhe se ishte “[t]merrësisht ngrohtë”.<sup>1143</sup> Ai gjithashtu mbante mend se kishte një dritare të vogël me shufra hekuri.<sup>1144</sup>

608. Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR] dhanë informacion të dorës së parë bazuar në përvojat personale, dhe mbështetet në dëshmitë e tyre në lidhje me karakteristikat fizike të dhomës 3. Trupi Gjykses konstaton se mospërputhjet në dëshmitë e dëshmitarëve në lidhje me ekzistencën e një apo më shumë dritareve nuk kanë të bëjë me aspekte të rëndësishme dhe, rrjedhimisht, nuk ndikojnë në mbështetshmërinë në dëshmitë e dëshmitarëve.

#### iv. Vendet e tjera

609. Trupi Gjykses rikujton se [REDAKTUAR] u mbajtën [REDAKTUAR] në magazinë, dhe se [REDAKTUAR] u mbajt edhe në një vend tjetër afër kuzhinës.<sup>1145</sup> Trupi Gjykses gjykon se, në vetvete këto ndërtesa nuk ishin të përshtatshme për të mbajtur të ndaluar. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se nuk mori prova të mjaftueshme

---

<sup>1139</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1140</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1141</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1142</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1143</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1144</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1145</sup> [REDAKTUAR].

për kushtet e jetesës dhe të fjetjes në magazinë dhe në kuzhinë, Trupi Gjykses nuk do të bëjë konstatime në lidhje me këtë.

610. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se më lart konstatoi se një e ndaluar femër, e quajtur [REDAKTUAR], u mbajt në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Trupi Gjykses vë në dukje se nuk mori prova se ku saktësisht mbahej [REDAKTUAR] dhe në çfarë kushtesh ndalimi.<sup>1146</sup> Sidoqoftë, duke pasur parasysh provat e shumta që konfirmojnë njëra-tjetrën, të cilat vërtetojnë se të ndaluarit në FMK u mbajtën në kushte të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për jetesë dhe fjetje, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se [REDAKTUAR] u mbajt në kushte të ngjashme, sidomos duke mbajtur parasysh se, sikurse të ndaluarit e tjerë, [REDAKTUAR] u keqtrajtua rëndë, u mor në pyetje dhe kundër saj u bënë akuza gjatë mbajtjes në ndalim në FMK.<sup>1147</sup>

v. Komente përmbyllëse dhe përfundim

611. Mbrojtja parashtron se kushtet e strehimit ishin të këqija edhe për vetë anëtarët e UÇK-së, dhe këtë argument e bazon në dëshminë e z. Mark Shala, sipas të cilit, “shumë pak ka pas krevate”.<sup>1148</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se kushtet e mjerueshme të jetesës dhe të fjetjes për të ndaluarit nuk kishin të bënin vetëm me mungesën e krevateve dhe dyshekëve. Dhoma e ndalimit në ndërtesën e komandës ishte aq e vogël sa që ishte e pamundur për të ndaluarit të qëndronin në këmbë apo të shtriheshin. Nuk kishte dritare dhe, si rezultat, as dritë. Gjithashtu, dhoma 1 ishte e tejmbushur dhe të ndaluarit nuk ishin në gjendje të pushonin apo të flinin si duhet. Edhe pse të ndaluarve dikur u dhanë dyshekë të hollë dhe batanije, ato ua morën më

---

<sup>1146</sup> *Shih* para. 571-5 më lart.

<sup>1147</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(e).

<sup>1148</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 107, *ku citohet z. Mark Shala*: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2957, rreshti 13 deri në f. 2958, rreshti 10.

vonë. Të ndaluarit gjithashtu nuk mund të flinin për shkak të keqtrajtimit të vazhdueshëm fizik dhe psikologjik që përjetuan, sidomos natën.

612. Nga ana tjetër, dëshmitë e z. Mark Shala dhe z. Hoxha vënë në dukje se, edhe pse numri i krevateve në FMK nuk ishte i mjaftueshëm për të gjithë anëtarët e UÇK-së, kushtet e jetesës dhe të fjetjes për ta nuk ishin të njëjta me ato të të ndaluarve. Më saktësisht, sipas z. Mark Shala dhe z. Hoxha, anëtarët e lartë të UÇK-së flinin në krevate në zyrat e ndërtesës së komandës.<sup>1149</sup> Sa u përket anëtarëve të tjerë të UÇK-së në FMK, z. Mark Shala dëshmoi se, megjithëse nuk kishte krevate për të gjithë, ata kishin dyshekë, thasë për fjetje, batanije dhe jastëkë.<sup>1150</sup> Duke marrë parasysh dëshmitë e diskutuara më lart, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se kushtet e jetesës dhe të fjetjes të të ndaluarve në asnjë mënyrë nuk mund të krahasoheshin me ato të anëtarëve të UÇK-së.

613. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në tërësinë e provave Trupi Gjykses konstaton se kushtet e jetesës dhe të fjetjes në FMK, përfshirë në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës dhe në dhomat 1 dhe 3 në ndërtesën e ndalimit, ishin krejtësisht të papërshtatshme dhe poshtëruese.

(b) Ushqimi dhe uji i pijshëm

614. TW4-01, W04733, W01448 dhe veçanërisht TW4-04, dhanë dëshmi tejet të hollësishme, të gjalla dhe përputhëse për ushqimin që u dhanë në FMK gjatë asaj periudhe. TW4-01 dëshmoi: “kur kam pasë hëngër, ndoshta një herë në dy javë, ndoshta në javë [...] një grimë, por s’e mbaj mend çfarë kam hëngër”.<sup>1151</sup> Edhe dëshmitarë të tjerë përshkruan mungesën e ushqimit. Në deklaratën e vet, W01448

---

<sup>1149</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2924, rreshti 24 deri në f. 2926, rreshti 4; f. 2926, rreshtat 18-23; **z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3181, rreshti 17 deri në f. 3182, rreshti 10; f. 3214, rreshtat 11-22.

<sup>1150</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2957, rreshti 13 deri f. 2958, rreshti 10.

<sup>1151</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1431, rreshtat 8-11.

shpjegoi se kishte ditë kur të ndaluarve nuk u sillnin asgjë për të ngrënë, kurse në ditë të tjera hanin ushqimin që tepronte nga anëtarët e UÇK-së.<sup>1152</sup> Dëshmia e tij është domethënëse: “Ndodhte nganjëherë kur dy persona e ndanin një vezë të zier”.<sup>1153</sup> Edhe W01448 edhe W04733 kujtuan se, në disa raste, të ndaluarve u jepnin të hanin vetëm konserva peshku.<sup>1154</sup> W04733 shtoi: “[...] njëherë na kanë pru gjellë. Tuj hangër gjellë, sa e kemi nisë me hangër, edhe kishte pas pasul, njëherë krejt, ka hi një ushtar i UÇK-së i çmendun krejt [...] e ka godit pjatën ku hajsha, ma ka qitë krejt gjellën edhe më ka goditë me shkelm”.<sup>1155</sup> Dëshmia e tij konfirmohet nga W01448 që ishte i pranishëm gjatë këtij incidenti.<sup>1156</sup>

615. TW4-01, W01448 dhe W04733 shpjeguan më tej me fjalë të ngjashme se uji që u jepnin nuk mjaftonte për të gjithë të ndaluarit.<sup>1157</sup> TW4-01 dëshmoi: “Ujë na i kanë lënë do shishe aty. S’kemi pas, pak krejt. Jemi kanë gjashtë-shtatë vetë, ka i herë nëntë, ka i herë 12 veta të burgosur. Tri-katër shishe si kanë dalë kujna”.<sup>1158</sup> Duke iu referuar ndalimit të vet në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, në deklaratën e vet W04733 shpjegoi: “Ujë bijshin nga një gastare, qysh me të thanë nga një shishe të plastikës. Edhe qe kështu kalonte koha tri ditë aty”<sup>1159</sup> Në lidhje me disponueshmërinë e ujit, W01448 deklaroi: “Ne ishim të frikësuar të kërkonim ujë në dhomën e parë;

---

<sup>1152</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013751.

<sup>1153</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013751.

<sup>1154</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013751; **W04733:** 106978-107020, f. 106990; 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 21, rreshtat 4-6; 082892-TR-AT-ET Pjesa 9 RED2, f. 15, rreshtat 14-15.

<sup>1155</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Pjesa 9 RED2, f. 9, rreshtat 8-18. *Shih gjithashtu*, SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185339; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013841.

<sup>1156</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013761.

<sup>1157</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1431, rreshtat 14-17; **W04733:** 106978-107020, f. 106990; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013823; 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 21, rreshtat 8-9; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752.

<sup>1158</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1431, rreshtat 14-17.

<sup>1159</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 21, rreshtat 8-9.



duhej të kërkoje përmes disa personave derisa e sillnin nga kamioni cisternë”.<sup>1160</sup> TW4-01 dhe W01448 dëshmuan më tej se, gjatë ndalimit në dhomën 1, të ndaluarit shkonin jashtë te një cisternë për të mbushur disa shishe me ujë dhe i sillnin.<sup>1161</sup> Në lidhje me nëse anëtarët e UÇK-së që i ruanin i lejonin t'i mbushnin shishet, TW4-01 u përgjigj: “varet kur deshini me na dhonë. Krejt varej prej tyne”.<sup>1162</sup> Në lidhje me këtë, W01448 dëshmoi se, duke shkuar te cisterna me ujë, që ishte afër banjave, të ndaluarit rriheshin dhe ngacmoheshin nga një anëtar i UÇK-së.<sup>1163</sup> Ai kujtoi: “nëse ne donim të pinim ujë, ne duhej të shkonim në toalet, dhe nëse shkonim andej, ai na therte me thikë. Pra, ne preferonim më mirë që të qëndronim të etur vetëm e vetëm për të mos u ballafaquar me të”.<sup>1164</sup> Dëshmia e W01448-ës konfirmohet nga TW4-02, i cili gjithashtu dëshmoi se ngacmohej kur shkonte në banjë.<sup>1165</sup>

616. Duke pasur parasysh dëshmitë e tyre të hollësishme dhe reciprokisht konfirmuese, Trupi Gjykes nuk ka arsye të dyshojë në vërtetësinë e përjetimeve personale që rrëfyan TW4-01, TW4-02, W04733 dhe W01448.

617. TW4-01, W04733 dhe W01448 shpjeguan më tej se, për shkak të mungesës së ushqimit dhe ujit, ata humbën shumë peshë gjatë mbajtjes në ndalim.<sup>1166</sup> Në lidhje me këtë, TW4-01 dëshmoi: “Unë kur kam ardhur në shtëpinë time, nuk i kam pasur as 45

---

<sup>1160</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752.

<sup>1161</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1431, rreshtat 13-21; **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013752; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146. *Shih gjithashtu, TW4-11*: T. 2 maj 2023, publik, f. 1207, rreshtat 6-7.

<sup>1162</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1431, rreshtat 20-21.

<sup>1163</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750, SITF00013752; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146-SITF00016147; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013838.

<sup>1164</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750.

<sup>1165</sup> **TW4-02**: 060664-TR-ET Pjesa 3, f.27.

<sup>1166</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, publik, f. 1552, rreshti 22; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013751; **W04733**: SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013823.

kile, 50 s'i kam pas".<sup>1167</sup> Rënia drastike në peshë që pësoi TW4-01 konfirmohet nga [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>1168</sup> Sipas W01448-ës, edhe ai humbi 14 deri 17 kilogram gjatë mbajtjes në ndalim në FMK.<sup>1169</sup> Ai shpjegoi: "Mund ta shihja atë në trupin tim, por kur kemi ardhur në kishë në Prizren e kam kontrolluar peshën".<sup>1170</sup> Ngjashëm, W04733 deklaroi: "Ishim të uritur e pastaj ushqeheshim [...] I kam humbur mbi 16 kg për 10 ditë".<sup>1171</sup> Dëshmia e tij konfirmohet nga anëtarët e familjes së tij.<sup>1172</sup> TW4-09 dëshmoi për momentin kur pa babanë për herë të parë pas lirimit: "Ka qenë shumë më i madh, më i gjanë. Kish hup shumë në peshë edhe i thyshëm në trup".<sup>1173</sup> Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi të ngjashme edhe nga TW4-04, i cili tregoi se kishte humbur shumë peshë gjatë mbajtjes në ndalim.<sup>1174</sup> Në lidhje me ushqimin, ai shpjegoi: "Nuk ishte i mirë fare, supra plot me ujë".<sup>1175</sup> "Unë haja vetëm një herë në ditë", shtoi ai.<sup>1176</sup>

618. Trupi Gjykses konstaton se humbja e peshës nga TW4-01, W04733, W01448 dhe TW4-04 i atribuohet mungesës së ushqimit dhe ujit të mjaftueshëm gjatë mbajtjes së tyre në ndalim në FMK. Rënia në peshë e TW4-01-shit dhe W04733-shit konfirmohet në mënyrë të pavarur nga të afërmit e [REDAKTUAR] W04733-shit, përkatësisht [REDAKTUAR], TW4-06, TW4-07, TW4-08 dhe TW4-09, të cilët panë të ndaluarit pas lirimit të tyre. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se mund të mbështetet në

<sup>1167</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, publik, f. 1552, rreshti 22.

<sup>1168</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1169</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013751; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858.

<sup>1170</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013751.

<sup>1171</sup> **W04733**: SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013823.

<sup>1172</sup> **TW4-08**: T. 27 mars 2023, publik, f. 667, rreshtat 9, 17; **TW4-06**: T. 28 mars 2023, konfidencial, f. 824, rreshti 13. **TW4-07**: T. 29 mars 2023, publik, f. 911, rreshti 7; **TW4-09**: T. 30 mars 2023, publik, f. 988, rreshtat 24-25.

<sup>1173</sup> **TW4-09**: T. 30 mars 2023, publik, f. 988, rreshtat 24-25.

<sup>1174</sup> **TW4-04**: SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013275; SPOE00014669-00014751 RED, f. SPOE00014692.

<sup>1175</sup> **TW4-04**: SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013275.

<sup>1176</sup> **TW4-04**: SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013275.

dëshmitë në lidhje me humbjen e peshës që pësuan TW4-01, W04733, W01448 dhe TW4-04.

619. Mbrojtja argumenton se TW4-01,<sup>1177</sup> W04733, TW4-05, TW4-10 dhe z. Mark Shala dhanë dëshmi kundërthënëse në lidhje me sasinë e ushqimit të disponueshëm në FMK.<sup>1178</sup> Mbrojtja citon dëshminë e z. Mark Shala dhe veçanërisht të TW4-10-s dhe argumenton se edhe anëtarët e UÇK-së në FMK vuajtën nga mungesa e ushqimit.<sup>1179</sup>

620. Trupi Gjykses nuk bindet nga parashtrimet e Mbrojtjes se provat në lidhje me ushqimin e disponueshëm në FMK janë kundërthënëse. TW4-01, W04733, W01448 dhe TW4-04 dhanë dëshmi të qarta dhe përputhëse se u dhanë sasi të pamjaftueshme ushqimi dhe nganjëherë as nuk u dhanë ushqim, dhe si rezultat i kësaj humbën shumë peshë. Nga ana tjetër, shefi i logjistikës në FMK z. Mark Shala dëshmoi se, edhe pse kishte raste kur nuk kishte ushqim të gatuar për anëtarët e UÇK-së, ata prapëseprapë kishin në dispozicion konserva, “ato çka kemi pas në magazinë”.<sup>1180</sup> Ai gjithashtu konfirmoi se kishte një kuzhinë me “kuzhinierë edhe njerëz të tjerë që kanë -- njerëz ndihmës që kanë ndihmu” në përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit për anëtarët e UÇK-së.<sup>1181</sup> Se kishte një kuzhinë të organizuar mirë, konfirmohet edhe nga dëshmia e z. Hoxha i cili punonte në magazinë nën mbikëqyrjen e z. Mark Shala.<sup>1182</sup> Në fakt, gjatës dëshmisë së tij në sallën e gjyqit, z. Hoxha deklaroi: “[...] jemi ushqy, pa ndërprerje. Me drekë, me darkë, me mëngjes, me krejt i kemi pas në kazermë. Në uzinë faktikisht”.<sup>1183</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, megjithëse nuk kishte çdo

---

<sup>1177</sup> Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja mbështetet në një deklaratë të TW4-01-shit të përfshirë në një shënim zyrtar të ZPS-së që iu nxor Mbrojtjes, Mbrojtësit të Viktimave dhe Trupit Gjykses. Sidoqoftë Trupi Gjykses thekson se ky dokument nuk është në dispozicion për t’u shqyrtuar në kontekstin e këtij Aktgjykimi, pasi as palët, e as Mbrojtësi i Viktimave, nuk kërkuan pranimin e tij si provë në bazë të rregullave të përcaktuara në [Framework Decision on Evidence](#) (Vendimi Kornizë mbi Provat).

<sup>1178</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 109.

<sup>1179</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 109.

<sup>1180</sup> **Z. Mark Shala**: T. 25 tetor 2023, publik, f. 3143, rreshtat 11-14.

<sup>1181</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2951, rreshtat 2-8.

<sup>1182</sup> **Z. Hoxha**: T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3175, rreshtat 19-21.

<sup>1183</sup> **Z. Hoxha**: T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3351, rreshti 25 deri f. 3352, rreshti 2.

herë ushqim të gatuar, nuk kishte mungesë ushqimi në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses nuk ka kurrfarë dyshimi se sasia e pamjaftueshme e ushqimit për të ndaluarit në fakt nuk ishte pasojë e nevojës, por politikë që zbatonin anëtarët e UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit.

621. Sa u përket parashtrimeve të Mbrojtjes se, kur ishte e mundshme, të ndaluarit kishin ujë të pijshëm, Mbrojtja i referohet një raporti të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian të datës 24 maj 1999, që dokumenton mungesën e ujit në qytetin e Kukësit në atë kohë.<sup>1184</sup> Trupi Gjykses gjykon se, ndryshe nga parashtrimet e Mbrojtjes, nuk ka prova që sugjerojnë se kishte mungesë të ujit në FMK apo se furnizimi me ujë në kompleks ishte i pamjaftueshëm. Përkundrazi, siç shtjellohet më lart, provat që iu paraqitën Trupit Gjykses tregojnë se cisterna e ujit ndodhej mu jashtë ndërtesës së ndalimit dhe se kishte ujë. Duke pasur këto parasysh, Trupi Gjykses konstaton se fakti që të ndalurve iu kufizua përdorimi i ujit, nuk ishte pasojë e nevojës por politikë që zbatonin anëtarët e UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses hedh poshtë parashtrimet e Mbrojtjes.

622. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në provat që iu paraqitën, Trupi Gjykses konstaton se, gjatë gjithë kohës që u mbajtën në FMK, të ndaluarve iu dha ushqim dhe ujë i pamjaftueshëm dhe i papërshtatshëm, edhe pse kishte ujë dhe ushqim të mjaftueshëm për përdorim.

(c) Kushtet higjienike dhe përdorimi i pajisjeve sanitare

623. *Kushtet higjienike.* [REDAKTUAR] dhe W01448 dhanë dëshmi reciprokisht përputhëse se u lejuan të laheshin e pastroheshin vetëm një herë pas vdekjes së

---

<sup>1184</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 111 i referohet SPOE00305297-00305298, f. SPOE00305298.

viktimës së vrasjes së paligjshme, që ndodhi disa javë pasi ishin marrë në ndalim.<sup>1185</sup>

Po ashtu edhe [REDAKTUAR] shpjegoi se mundi të lahej e pastrohej vetëm pas vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1186</sup> Kur u pyet nëse i dhanë fuqë dhëmbësh gjatë mbajtjes në ndalim, TW4-01 u përgjigj: “S’kem pa asigjo me sy na.”<sup>1187</sup> TW4-01 dhe W01448 gjithashtu dëshmuuan se të ndaluarve nuk u dhanë tesha për t’u ndërruar dhe nuk i lejonin t’i pastronin teshat e veta.<sup>1188</sup>

624. Dëshmitë e [REDAKTUAR] të W01448-ës konfirmohen nga W04733, i cili u lirua nga FMK-ja para vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, që do të thotë se ai nuk u lejua të lahej e pastrohej asnjëherë gjatë kohës që u mbajt i ndaluar.<sup>1189</sup> “Na vinte era si shtazëve”, tha ai në një rën prej deklaratave të tij.<sup>1190</sup> Atij gjithashtu i kujtohej qartë se, me të arritur në FMK, i dhanë tesha të palara për të veshur, të cilat i mbajti veshur deri në lirim.<sup>1191</sup> Duke përshkruar më tej kushtet e këqija higjienike, W04733 tha: “Pastërtia nuk ka përmbushur asnjë kërkesë. Për shkak të dukjes sime, kur jam liruar më vinte turp të shkoj në shtëpinë time”.<sup>1192</sup> Dëshmia e W04733-shit konfirmohet nga djali i tij, TW4-08, i cili tha hapur në sallën e gjyqit: “Babai im kur e kanë sjellë ka qenë në kushte tërësisht jonjerëzore. Kundërmonte erë të keqe. Domethënë, mos – papastërti”.<sup>1193</sup> Edhe TW4-06 - gruaja e W04733-shit - dëshmoi në lidhje me herën e

<sup>1185</sup> [REDAKTUAR]; **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016148. Siç do të diskutohet më poshtë, pas vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, u vendosën roja të reja si përgjegjës në ndërtesën e ndalimit, që rezultoi në ndryshimin e kushteve të ndalimit. Në lidhje me përmirësimin e kushteve të ndalimit në FMK pas 5 qershorit 1999, *shih* para. 637 më poshtë.

<sup>1186</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1187</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1448, rreshti 3.

<sup>1188</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1448, rreshtat 4-5; **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016148.

<sup>1189</sup> **W04733**: SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013823.

<sup>1190</sup> **W04733**: SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013823.

<sup>1191</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013810; 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 19, rreshti 22 deri në f. 20, rreshti 13.

<sup>1192</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106990.

<sup>1193</sup> **TW4-08**: T. 27 mars 2023, publik, f. 667, rreshtat 7-8.

parë që pa burrin e vet pas lirit të tij. Ajo kujtoi qartë: “E kemi pranë, e kemi marrë. I palarë, i përgjakun, era e rrobave. [...]aty kemi pas një gjendje shumë të vështirë, psiqike, morale, të gjitha. Kanë qajt djali dhe vajza e vogël. [...] e kemi pastru”.<sup>1194</sup> Trupi Gjykes është bindur se W04733 dëshmoi me vërtetësi për kushtet e papërshtatshme higjienike dhe konstaton se dëshmia e tij në lidhje me këtë aspekt konfirmohet edhe nga anëtarët e familjes, konkretisht nga TW4-08 dhe TW4-06, të cilët e panë W04733-shin menjëherë pas lirit të tij.

625. Trupi Gjykes vëren se TW4-01, W04733, W01448 dhe [REDAKTUAR] e dhanë këtë informacion në mënyrë të sinqertë dhe koherente dhe konstaton se mund të mbështetet në dëshmitë e tyre në lidhje me kushtet higjienike që mbizotëronin në FMK.

626. *Përdorimi i banjave.* Trupi Gjykes rikujton se ka bërë konstatim gjyqësor të faktit të shqyrtuar se “[t]ë ndaluarit është dashur të kërkojnë leje për të shkuar në tualet dhe gjatë kësaj kohe ata shoqëroheshin dhe ruheshin nga ushtarë”,<sup>1195</sup> gjë që konfirmohet pastaj nga dëshmitë e TW4-01-shit, TW4-11-shit, W01448-ës dhe W04733-shit.<sup>1196</sup> Sipas W01448-ës: “Ne duhet të raportojmë tek roja dhe ai do të na urdhëronte ti vëmë duart pas dhe të ecim në drejtim të tualetit”.<sup>1197</sup> Sipas W01448-ës, banjat gjithashtu ishin në gjendje të keqe.<sup>1198</sup> Trupi Gjykes është bindur se dëshmitarët i përshkruan në mënyrë të sinqertë kushtet dhe përdorimin e banjave. Dëshmitë e tyre janë përputhëse dhe Trupi Gjykes i gjykon të besueshme dhe rrjedhimisht mbështetet në to.

---

<sup>1194</sup> **TW4-06:** T. 28 mars 2023, publik, f. 809, rreshtat 4-9, 13.

<sup>1195</sup> [List of Adjudicated Facts](#) (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), Fakti i Shqyrtuar 55.

<sup>1196</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1445, rreshtat 18-19; f. 1446, rreshtat 22-23; f. 1447, rreshtat 1-6; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1219, rreshtat 21-25; **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; **W04733:** 106978-107020, f. 106990.

<sup>1197</sup> **W01448:** SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146.

<sup>1198</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013749.

627. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në provat që iu paraqitën, Trupi Gjykses konstaton se kushtet higjienike dhe sanitare në të cilat u mbajtën të ndaluarit në FMK, ishin krejtësisht të pamjaftueshme dhe poshtëruese.

(d) Kujdesi mjekësor

628. Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar më parë se në katin përdhes të ndërtesës së komandës kishte një infermieri ku ofrohej kujdes mjekësor nga së paku një mjek dhe një infermier.<sup>1199</sup> Në fakt, TW4-10 dëshmoi në sallën e gjyqit se kishte mjekë që kujdeseshin për anëtarët e sëmurë të UÇK-së.<sup>1200</sup> Prandinë e personelit mjekësor në FMK e konfirmoi edhe dëshmitari i Mbrojtjes, z. Hoxha, i cili i identifikoi “motrat medicinale që ua kanë dhënë ndihmën e parë ushtarëve” në një video që u transmetua dhe diskutua në sallën e gjyqit.<sup>1201</sup> Po kështu, dëshmitari i Mbrojtjes W04280 dëshmoi se “shpesh herë edhe vijshin edhe njerëzit prej të plagosurve nga terreni”, duke iu referuar infermierisë në FMK.<sup>1202</sup>

629. Megjithatë, [REDAKTUAR] dhe W04733 dëshmuan se, kur personeli mjekësor thirrej për t’u kujdesur për të ndaluarit, anëtarët e UÇK-së pengonin ofrimin e ndihmës mjekësore ose shpërfillnin këshillat e personelit mjekësor.<sup>1203</sup> Konkretisht, W04733 dëshmoi se gjatë kohës që u mbajt i ndaluar nuk u trajtua për sëmundjen që kishte nga më parë: “[REDAKTUAR]”.<sup>1204</sup> W04733 gjithashtu përshkroi një incident

---

<sup>1199</sup> *Shih* Pjesën VI.B.5.

<sup>1200</sup> **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1047, rreshtat 7-13. TW4-10 deklaroi në sallën e gjyqit: “Ka pasë mjekë që na këqyrshin”. Duke qenë se TW4-10 ishte anëtar i UÇK-së që shërbente si rojë në FMK, Trupi Gjykses vlerëson se me “na” dëshmitari u referohet anëtarëve të UÇK-së të pranishëm në FMK.

<sup>1201</sup> **Z. Hoxha**: T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3291, rreshti 19 deri në f. 3292, rreshti 18, që i referohet **videos** 078252-01.

<sup>1202</sup> **W04280**: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3824, rreshti 18 deri në f. 3825, rreshti 4.

<sup>1203</sup> [REDAKTUAR]; **W04733**: 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 32-33; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013828-SPOE00013829.

<sup>1204</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 33, rreshtat 12-16. *Shih gjithashtu*, SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013829; 082892-TR-AT-ET Pjesa 8 RED2, f. 6.

ku mjeku dhe infermieret u thirrën të mjekonin një plagë në kokën e tij.<sup>1205</sup> Ai dëshmoi: “Pasi që isha i mbuluar me gjak dhe pasi që vazhdimisht kisha gjakderdhje nga balli, mjeku më lidhi kokën me fashë mirëpo posa që mjeku më lidhi kokën një person tjetër erdhi me një thikë në dorë dhe i preu fashat nga koka ime”.<sup>1206</sup> Ai shtoi se personeli mjekësor përsëri ia lidhi kokën me fashë dhe i njëjti anëtar i UÇK-së përsëri e preu fashën.<sup>1207</sup> Në mënyrë të ngjashme, [REDAKTUAR], pasi viktima e vrasjes së paligjshme u keqtrajtua rëndë dhe u qëllua me armë zjarri në këmbë – incident ky që do të diskutohet më poshtë – anëtarët e UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit refuzuan transferimin e tij në spital, në kundërshtim me këshillat e mjekut që ishte i pranishëm në FMK.<sup>1208</sup>

630. Duke pasur parasysh dëshmitë e tyre të hollësishme, Trupi Gjykes është bindur se [REDAKTUAR] dhe W04733 dhanë informacion të dorës së parë që mbështetet në përjetimet e tyre personale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes konstaton se dëshmitë e [REDAKTUAR] dhe W04733-shit janë të vërteta dhe mund të mbështetet në to. Trupi Gjykes gjykon se shembujt e mësipërm pasqyrojnë qëndrimin e anëtarëve të UÇK-së në FMK në lidhje me kujdesin mjekësor për të ndaluarit.

631. Trupi Gjykes hedh poshtë parashtrimet e Mbrojtjes se të ndaluarve iu ofrua kujdes mjekësor.<sup>1209</sup> Thjesht prania e mjekëve në FMK dhe matja e tensionit të gjakut ose nivelit të sheqerit në gjak të ndaluarve, nuk përmbushin asnjë standard të pranueshëm të kujdesit mjekësor, sidomos duke mbajtur parasysh shkallën e keqtrajtimit që pësuan të ndaluarit, kushtet e ndalimit dhe kohëzgjatjen e ndalimit të tyre.

---

<sup>1205</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106979; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019842; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013826; 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 30.

<sup>1206</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106979.

<sup>1207</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013826; 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 32.

<sup>1208</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1209</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 110.



632. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në provat që iu paraqitën, Trupi Gjykses konstaton se të ndaluarve në FMK nuk iu ofrua kujdes i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm mjekësor dhe në disa raste iu refuzua plotësisht kujdesi i nevojshëm.

(e) Ndalimi i komunikimit me njëri-tjetrin

633. Dëshmitë që dhanë TW4-01, W04733, W01448 dhe TW4-04 tregojnë se të ndaluarit nuk lejoheshin të flisnin me njëri-tjetrin, dhe si pasojë, ata kishin frikë ta bënin këtë.<sup>1210</sup> TW4-01, në veçanti, shpjegoi: “Me fol tinëz se ashiqare fort me fol kanë mujt me na maltretu”.<sup>1211</sup> Sipas W01448-ës: “Nuk na kanë lejuar të flasim njëri me tjetrin. Derisa ishim shtrirë të molisur në dyshtemenë e fortë, bisedonim duke pëshpëritur”.<sup>1212</sup> Ngjashëm, TW4-04 deklaroi: “Nuk na lejonin që të bisedonim, edhe sikur të na kishin lejuar ne nuk do të guxonim të flisnim, sepse ushtarët ishin afër dritares”.<sup>1213</sup> Trupi Gjykses është bindur se dëshmitarët folën me vërtetësi për përjetimet e tyre, sidomos duke pasur parasysh se konfirmojnë njëri-tjetrin në këtë aspekt.

634. Konstatimi i mësipërm nuk cenohet nga deklaratat e ndryshme të dëshmitarëve të tjerë, si për shembull TW4-05 dhe TW4-11, dëshmitë e të cilëve bëjnë të ditur se ndonjëherë dëshmitarët mund të kenë pasur mundësi të flisnin shkurtimisht me njëri-tjetrin.<sup>1214</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, nuk është me rëndësi fakti nëse të ndaluarit mund të bisedonin me njëri-tjetrin shkurtimisht apo tinëz, por nëse mund të bisedonin lirisht, që, sipas dëshmive, nuk ishte e mundur.

---

<sup>1210</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1448, rreshtat 8-13; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341; **TW4-04**: SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013272.

<sup>1211</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, publik, f. 1448, rreshtat 8-9.

<sup>1212</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

<sup>1213</sup> **TW4-04**: SITF00013262-00013315 RED, f. SITF00013272.

<sup>1214</sup> **TW4-05**: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013131; **TW4-11**: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1216, rreshtat 17-19; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1328, rreshtat 8-9.

635. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues, bazuar në provat që iu paraqitën, konstaton se të ndaluarit në FMK nuk ishin në gjendje të komunikonin lirisht me njëri-tjetrin, gjë që shtoi frikën dhe ankthin e tyre.

(f) Komete përfundimtare

636. Mbrojtja argumenton se kushtet e ndalimit në përgjithësi ishin të ngjashme me ato të anëtarëve të UÇK-së dhe ishin pasojë e mundësive dhe furnizimeve të pakta në FMK, apo e mungesës së tyre.<sup>1215</sup> Ky argument nuk e bind aspak Trupin Gjykues. Siç u konstatua më lart, të ndaluarit u mbajtën në dhoma të tejmbushura dhe nuk mund të flinin për shkak të keqtrajtimit të vazhdueshëm fizik dhe psikologjik të tyre. Për më tepër, të ndaluarve nuk iu dha ushqim dhe ujë i mjaftueshëm, edhe pse në FMK kishte ushqim dhe ujë. Për më tepër, kushtet higjienike dhe sanitare në të cilat u mbajtën të ndaluarit ishin krejtësisht të papërshtatshme dhe poshtëruese. Gjithashtu, me gjithë praninë e personelit mjekësor në FMK, anëtarët e UÇK-së i penguan mjekët dhe infermierët që t'u jepnin ndihmë mjekësore të ndaluarve, ose shpërfillën plotësisht këshillat mjekësore që ata dhanë. Gjithashtu, ata e kishin të ndaluar të komunikonin dhe flisnin me njëri-tjetrin, gjë që shtoi shqetësimet e tyre psikologjike. Çka është e rëndësishme, të ndaluarit u keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht nga anëtarë të UÇK-së në FMK, sikurse do të konstatohet më poshtë.

637. Gjithashtu, Trupi Gjykues ka dëgjuar dëshmi të mjaftueshme nga [REDAKTUAR], W01448 dhe [REDAKTUAR] se menjëherë pas vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, më 5 qershor 1999 ose rreth kësaj date,<sup>1216</sup> u caktuan roje të tjerë përgjegjës për ndërtesën e ndalimit dhe se kushtet e të ndaluarve u

---

<sup>1215</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 111.

<sup>1216</sup> Në lidhje me vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, *shih* Pjesën VI.F.8.

përmirësuan.<sup>1217</sup> Të ndaluarve u dhanë batanije dhe i lejuan të laheshin e pastroheshin.<sup>1218</sup> Dëshmitë gjithashtu tregojnë se të ndaluarit nuk u keqtrajtuan më fizikisht dhe ishin në gjendje të flinin.<sup>1219</sup> Kjo e përforcon mendimin e Trupit Gjykses se kushtet poshtëruese të ndalimit që mbizotëronin në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, nuk ishin pasojë e nevojës, por e një praktike të institucionalizuar që zbatuan anëtarët e UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit. Duke pasur parasysh këto rrethana, Trupi Gjykses hedh poshtë argumentin e Mbrojtjes.

638. Bazuar në provat që iu paraqitën, Trupi Gjykses konstaton se TW4-01, TW4-11, W04733, W01448, TW4-05, TW4-04 dhe TW4-02 u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Duke pasur parasysh provat e shumta dhe përputhëse që konfirmojnë kushtet poshtëruese të ndalimit, Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se, meqenëse viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom, [REDAKTUAR], dhe së paku edhe një femër tjetër e ndaluar, gjithashtu u mbajtën në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, edhe ata u mbajtën në të njëjtat kushte çnjerëzore dhe poshtëruese të ndalimit.

## 2. Keqtrajtimi

639. Në vijim, Trupi Gjykses do të diskutojë: (a) keqtrajtimin e vazhdueshëm fizik dhe psikologjik që iu bë të ndaluarve bashkërisht, sidomos në dhomën 1; (b) keqtrajtimin konkret që pësuan disa të ndaluar; dhe (c) punën e detyruar që kryen [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom gjatë ndalimit të tyre.

---

<sup>1217</sup> [REDAKTUAR]; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013860; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146; [REDAKTUAR].

<sup>1218</sup> [REDAKTUAR]; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013860; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146.

<sup>1219</sup> [REDAKTUAR]; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013860; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146.

## (a) Keqtrajtimi i të ndaluarve bashkërisht

640. *Keqtrajtimi fizik.* Trupi Gjykues u jep shumë peshë dëshmive të TW4-01-shit, TW4-11-shit, W04733-shit dhe W01448-ës, të cilat tregojnë se të ndaluarit pësuan keqtrajtim fizik të përditshëm në FMK, sidomos në dhomën 1, ku u mbajtën shumica e të ndaluarve për pjesën më të madhe të ndalimit të tyre.

641. Në veçanti, TW4-01 dëshmoi në sallën e gjyqit se të gjithë të ndaluarit u rrahën çdo ditë në dhomën 1 nga anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, ndër të cilët Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi.<sup>1220</sup> Ai kujtoi: “I kanë rreh ata. E mue. Persona tjerë si janë kanë kur kanë hi n’dhomë përgjithësi na kanë rreh të tanëve. Nuk ka pshtu kush pa u rreh”.<sup>1221</sup> Ai shtoi: “kena pas maltrajtime ne gati çdo ditë aty. [...] Kanë hup kohën q’aty me ne”.<sup>1222</sup> Ngjashëm, TW4-11 dëshmoi në sallën e gjyqit se u rrah secili i ndaluar që u mbajt në dhomën 1 “me rend, pa dallim”.<sup>1223</sup> W04733 dhe W01448 dhanë dëshmi të ngjashme, të cilat gjithashtu konfirmojnë keqtrajtimet e përditshme të të ndaluarve nga disa anëtarë të UÇK-së.<sup>1224</sup> Të dy shpjeguan se rrahjet fillonin në mesnatë dhe zgjatnin deri në mëngjes.<sup>1225</sup> Në veçanti, deklarata e W01448-ës konfirmon dëshminë e TW4-01-shit se Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi ishin në mesin e anëtarëve të UÇK-së që keqtrajtuan fizikisht të ndaluarit në dhomën 1 çdo ditë.<sup>1226</sup> Për më tepër, edhe TW4-11 dhe W01448 dëshmuuan qartë se anëtarë të ndryshëm të UÇK-së hynin shpesh

---

<sup>1220</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1511, rreshti 23 deri f. 1512, rreshti 1; konfidencial, f. 1524, rreshti 20 deri f. 1525, rreshti 2.

<sup>1221</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1512, rreshtat 18-20.

<sup>1222</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1524, rreshti 22 deri page 1525, rreshti 1.

<sup>1223</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1222, rreshtat 2-3. *Shih më tej*, T. 2 maj 2023, publik, f. 1231, rreshtat 21-24.

<sup>1224</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750, SITF00013753-SITF00013754; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745; 106978-107020, f. 106987-106989; 082892-TR-AT-ET Pjesa 8 RED2, f. 29.

<sup>1225</sup> **W01448:** SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013754; **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745-00018746; 106978-107020, f. 106989.

<sup>1226</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750, SITF00013754.

në dhomën 1, i urdhëronin të ndaluarit të ktheheshin nga muri dhe pastaj i rrihnin me shkopinj.<sup>1227</sup> W04733 dha dëshmi të ngjashme: “nga të gjithë kanë kërkuar t’i zgjasim duart në mënyrë që ata të na rrihnin”.<sup>1228</sup>

642. Dëshmitë e TW4-01-shit, W04733-shit dhe W01448-ës tregojnë se të ndaluarit në dhomën 1 u rrahën nga anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, disa prej të cilëve ishin të panjohur për të ndaluarit.<sup>1229</sup> TW4-01 në lidhje me këtë dëshmoi: “Sa herë kanë ardhë këta të mëdhenjtë Xhemshita, e Sabita, e këta, sa herë kanë ardhë, pa na hy në dhomë me na rreh, nuk e kanë lënë. Me ushtarë kanë ardhë, me gjind”,<sup>1230</sup> “pesëqind herë kena pas rrahje. Herë kanë ardhë do, herë do të tjerë”.<sup>1231</sup> W01448 shpjegoi ngjashëm: “ata vinin nga katër apo pesë persona”, “[a]ta ishin ushtarë me uniforma të UÇK-së dhe gjithashtu civil me rroba civile dhe kishte edhe me uniforma te zeza”.<sup>1232</sup> Në pyetjen nëse ishte në gjendje t’i njihnte anëtarët e UÇK-së që sulmuan fizikisht të ndaluarit në dhomën 1, W04733 u përgjigj: “Jo, ata të gjithë ishin të rinj dhe fytyra të panjohura”.<sup>1233</sup>

643. Përveç rrahjeve nga anëtarë të UÇK-së, TW4-01, TW4-11 dhe W01448 dëshmuan se të ndaluarit u detyruan vazhdimisht të godisnin dhe të qëllonin me shuplakë njëri-tjetrin.<sup>1234</sup> TW4-11 shpjegoi se në një rast, dy anëtarë të UÇK-së urdhëruan të ndaluarit

<sup>1227</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1220, rreshtat 1-10 dhe f. 1231, rreshtat 2-4; **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013753.

<sup>1228</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106989.

<sup>1229</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1512, rreshti 25 deri në f. 1513, rreshti 3; f. 1524, rreshtat 23-25; **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013753-SITF00013754; **W04733:** 106978-107020, f. 106987-106988; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013824-SPOE00013825; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018746.

<sup>1230</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1524, rreshtat 23-25.

<sup>1231</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1513, rreshtat 1-3.

<sup>1232</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013753.

<sup>1233</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018746.

<sup>1234</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1512, rreshti 22; f. 1513, rreshti 3; **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1233, rreshtat 19-23; **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013754; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016237.

të qëllonin me shuplakë njëri-tjetrit “sa të mujshim sa më shumë mujsh me i ra”.<sup>1235</sup> W01448 dha përshkrim të gjallë të kësaj në një nga deklaratat e veta: “Ata urdhëronin të parin që të shkonte dhe t’i rrahte me shuplaka secilin me rend, dhe pastaj i vinte radha tjetrit. Dhe nëse ne e rrahim me shuplaka jo të forta, ata na rrahin tani neve”.<sup>1236</sup>

644. Trupi Gjykues konstaton se dëshmitë reciprokisht konfirmuese të TW4-01-shit, W01448-ës, W04733-shit dhe TW4-11-shit në lidhje me keqtrajtimin e tyre dhe keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë, janë shumë të besueshme.

645. *Keqtrajtimi psikologjik.* TW4-01, TW4-11, W04733 dhe W01448 dhanë përshkrime të hollësishme dhe të gjalla të keqtrajtitit psikologjik që pësuan gjatë ndalimit në FMK. Siç është thënë më lart, të ndaluarit ishin dëshmitarë të keqtrajtitit të përditshëm të personave të ndaluar bashkë me ta në dhomën 1. Natyra arbitrare dhe pa dallim e këtyre rrahjeve, si dhe fakti që u kryen nga kaq shumë anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, të cilët ndonjëherë ishin të panjohur për të ndaluarit, përkeqësoi gjendjen tejet të rëndë psikologjike të të ndaluarve. Të ndaluarit gjithashtu u detyruan të shihnin rrahjet brutale të kryera nga anëtarë të UÇK-së në zyrë dhe në dhomën 2, siç do të tregohet më poshtë.<sup>1237</sup>

646. Dhuna e skajshme e kryer ndaj një grupi luftëtarësh të UÇK-së ose FARK-ut që u mbajtën të ndaluar për kohë të shkurtër në dhomën 1, është shembull i keqtrajtitit që të ndaluarit u detyruan të shihnin rregullisht. TW4-01-shit dhe W01448-ës u kujtohej qartë ky incident. TW4-01 dëshmoi në sallën e gjyqit se këta luftëtarë u rrahën para të ndaluarve në dhomën 1 nga disa anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit Geci, me shkopinj gome, shufra metali dhe shkopinj.<sup>1238</sup> “I kanë rreh para, në prezencë

---

<sup>1235</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1233, rreshtat 19-23.

<sup>1236</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013754.

<sup>1237</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1238</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1512, rreshtat 2-14.

tonën. Deri sa i kanë këputë palicën, shufrën këto të gomës, të policisë se kanë qenë më përpara, deri sa ja kanë këput në kry,” tha TW4-01.<sup>1239</sup> Edhe W01448-ës i kujtohej e njëjta gjë: “Rrahja ishte aq e rëndë sa që shkopi i gomës u thye në 2 pjesë”.<sup>1240</sup> Duke treguar për egërsinë e keqtrajtimit që pa, W01448 kujtoi: “nuk e di se si kanë mbijetuar atë natë”.<sup>1241</sup>

647. Edhe kur nuk ishin dëshmitarë të keqtrajtimit të të tjerëve, të ndaluarit përsëri mund të shihnin lëndimet që iu ishin shkaktuar të ndaluarve të tjerë dhe gjendjen në të cilën ishin kur i kthenin në dhomat e ndalimit: të mavijosur, të mbuluar në gjak, me duar dhe këmbë të ënjtura dhe me dhëmbë të thyer.<sup>1242</sup> TW4-01 përshkroi qartë në lidhje me [REDAKTUAR]: “kur ka ardhë në dhomë vonë dikur, kur ja kam hek bluzën për me ja hek ju ka hek me gjithë lëkurë gati”.<sup>1243</sup> Ulërimat e atyre që rriheshin, si dhe zhurma e krismave të armëve në afërsi, u shkaktonin edhe më shumë frikë të ndaluarve.<sup>1244</sup>

648. Përveç që u detyruan të shihnin dhe dëgjonin dhunën fizike që kryhej kundër të ndaluarve të tjerë, të ndaluarit edhe vetë u ngacmuan dhe kërcënuan me dhunë ose vdekje.<sup>1245</sup> “Kur kalojshin njerëz nga dritaret spiuna, na shajshin nënën e tërë të zezat”,

---

<sup>1239</sup> TW4-01: T. 31 maj 2023, publik, f. 1512, rreshtat 8-9.

<sup>1240</sup> W01448: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013860.

<sup>1241</sup> W01448: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013759. *Shih më tej*, SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016238.

<sup>1242</sup> TW4-01: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1538, rreshtat 18-24; T. 6 qershor 2023, konfidencial, f. 1919, rreshtat 13-17; TW4-11: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1228, rreshtat 16-25; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1256, rreshtat 10-23; f. 1258, rreshtat 15-21; f. 1344, rreshti 3 deri f. 1345, rreshti 3; W01448: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858-SITF00013859; W04733: 106978-107020, f. 106987; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013820-SPOE00013821; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018744; 082892-TR-AT-ET Pjesa 5 RED2, f. 13, rreshtat 1-4; [REDAKTUAR].

<sup>1243</sup> TW4-01: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1538, rreshtat 21-23.

<sup>1244</sup> TW4-01: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1477, rreshtat 20-24; T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1530, rreshtat 9-13; TW4-11: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1342, rreshtat 13-15; W01448: SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837; TW4-05: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013134; [REDAKTUAR].

<sup>1245</sup> TW4-01: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1466, rreshtat 18-22; T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1525, rreshti 19 deri f. 1526, rreshti 2; W01448: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750,

kujtoi TW4-01.<sup>1246</sup> Sipas W01448-ës, të ndaluarit meshkuj u poshtëruan edhe më shumë nga një anëtar i UÇK-së i cili u kërkoi të rrihnin njëri-tjetrin në organet gjentitale dhe të shtreshin sikur bënë marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin.<sup>1247</sup> “Është shumë e turpshme edhe për t’u rrëfyer”, pranoi W01448.<sup>1248</sup> Mohimi për një kohë të gjatë i gjumit dhe fakti që nuk lejoheshin të flisnin me njëri-tjetrin, rëndoi edhe më shumë gjendjen psikologjike të të ndaluarve.

649. Është e qartë se duke iu nënshtruar këtyre kushteve, të ndaluarit përjetuan presion të jashtëzakonshëm psikologjik që mund të përshkruhet si atmosferë terrori dhe frikësimi. Ata kishin frikë se në çdo moment mund të keqtrajtoheshin fizikisht, ose edhe të vriteshin.<sup>1249</sup> “Veç minutat i pritshim kur të vdesim”, shpjegoi TW4-01 në sallën e gjyqit.<sup>1250</sup> TW4-11 gjithashtu përshkroi bindshëm se si ndjehej në ndalim: “Po normal që jam ndi i frikësuar. Jam ndi i frikësuar shka do të ndodhë edhe me mu. Se e dijsa shka i ka ndodhë atyne, po shka të më ndodhë edhe mu”.<sup>1251</sup> Duke përshkruar më tej atmosferën e terrorit dhe pasigurinë që ndjente gjatë gjithë kohës që u mbajt i ndaluar, W01448 tha në njërin prej deklaratave të tij se: “jeta ishte në rrezik ato ditë”.<sup>1252</sup>

---

SITF00013752, SITF00013754; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016146-SITF00016147; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858, SITF00013859; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013838. [REDAKTUAR].

<sup>1246</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1466, rreshtat 18-22.

<sup>1247</sup> **W01448**: SITF00013848-00013851, f. SITF00013849; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013750.

<sup>1248</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858.

<sup>1249</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1525, rreshti 19 deri në f. 1526, rreshti 2; publik, f. 1539, rreshtat 5-14; **TW4-11**: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1229, rreshtat 5-8; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1259, rreshtat 17-20; **W01448**: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231-SITF00016232; **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013185; 082892-TR-AT-ET Pjesa 4 RED3, f. 7, 10-11; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013809.

<sup>1250</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1539, rreshtat 8-9.

<sup>1251</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, konfidencial, f. 1229, rreshtat 5-7.

<sup>1252</sup> **W01448**: SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016158.



650. Dëshmitë reciprokisht konfirmuese të TW4-01-shit, TW4-11-shit, W04733-shit dhe W01448-ës të përmendura më lart janë kaq të gjalla dhe të hollësishme sa që Trupi Gjykses nuk ka dyshim se dëshmitarët i treguan ngjarjet me vërtetësi, bazuar në përjetimet e tyre personale.

651. Vlerësimi nga Trupi Gjykses i dëshmimeve nuk ndikohet nga dëshmia e TW4-05-ës, që dukshëm ndryshon nga dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur. TW4-05 deklaroi se, gjatë kohës që u mbajt i ndaluar u trajtua shumë mirë dhe kurrë nuk u keqtrajtua fizikisht.<sup>1253</sup> Edhe pse pranoi se të ndaluarit e tjerë merreshin nga dhoma 1 gjatë natës për t'u marrë në pyetje, TW4-05 mohoi se kishte parë apo dëgjuar dikë duke e rrahur.<sup>1254</sup> Ai shpjegoi: "Unë kam dëgjuar fjalë se ata po i torturojnë dhe po i rrahin ata, por unë kurrë nuk e kam pa ketë".<sup>1255</sup>

652. Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e TW4-05-ës përgënjeshtrohet qartë nga dëshmitë koherente dhe të besueshme të TW4-01-shit, TW4-11-shit, W04733-shit dhe W01448-ës, të cilët ishin të ndaluar bashkë me të dhe dhanë dëshmi tejet përputhëse se u rrahën rregullisht në dhomën 1, në praninë e të ndaluarve të tjerë. Trupi Gjykses e gjykon jo të besueshme që TW4-05 të mos i ketë parë ose dëgjuar të ndaluarit e tjerë duke u keqtrajtuar, sidomos duke pasur parasysh madhësinë e dhomës ku u mbajtën dhe shkallën e dhunës kundër të ndaluarve të tjerë.<sup>1256</sup> Është gjithashtu jo e besueshme që TW4-05 të mos ketë parë rrahjen brutale të [REDAKTUAR].<sup>1257</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses e gjykon jo të besueshëm pretendimin e TW4-05-ës se nuk kishte njohuri personale për rrahjet por vetëm kishte dëgjuar thashetheme për to, sidomos duke pasur parasysh se dëshmitari e pranoi vetë se shpesh i bisedonte me [REDAKTUAR]

---

<sup>1253</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500-SITF00372502.

<sup>1254</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013129-SITF00013131, SITF00013134.

<sup>1255</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013134.

<sup>1256</sup> *Shih* para. 601, 641-643 më lart.

<sup>1257</sup> [REDAKTUAR].

këto tema, përfshirë marrjet në pyetje të [REDAKTUAR] gjatë periudhës që ishin të ndaluar.<sup>1258</sup> Gjithashtu, dëshmia e TW4-05-ës se e trajtuan “shumë mirë” nuk përputhet me disa deklaratatë tjera të tij që vënë në dukje ndjenjën e dëshpërimit dhe pafuqisë. Për shembull, TW4-05 deklaroi: “Njëri nga ushtarët më ka provokuar duke më thanë se të gjithëve do të na vrasin. Unë i kam thanë ‘pse do të na kishin vra pa pas seancë’? Unë e kam thanë këtë lirshëm, sepse veten e kam llogaritur si të vdekur”.<sup>1259</sup> Duke iu referuar një takimi që kishte pasur me Sabit Gecin, TW4-05 deklaroi: “Jam frikuar se do të më vras”.<sup>1260</sup> Së fundi, Trupi Gjykses ka marrë dëshmi të besueshme nga W04733 dhe W01448, që tregojnë se edhe TW4-05 u keqtrajtua në dhomën 1, mu sikur të ndaluarit e tjerë.<sup>1261</sup> Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses nuk e konstaton të besueshme dëshminë e TW4-05-ës në lidhje me keqtrajtimin që pësuan ai dhe të ndaluarit e tjerë në FMK, dhe nuk i jep peshë asaj. Trupi Gjykses gjithashtu është bindur - duke pasur parasysh dëshmitë e dhëna nga W04733 dhe W01448 - se edhe TW4-05 u keqtrajtua në dhomën 1.

653. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në provat në tërësi, Trupi Gjykses është bindur se të gjithë të ndaluarit në dhomën 1 keqtrajtoheshin fizikisht dhe psikologjikisht për çdo ditë nga disa anëtarë të UÇK-së. Ata gjithashtu rriheshin gjatë natës deri në orët e hershme të mëngjesit, detyroheshin të godisnin me shuplaka njëri-tjetrin dhe, në rastin e të ndaluarve meshkuj, të shtreshin sikur bënë marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin. Po ashtu, ata u detyruan të shihnin dhe dëgjonin keqtrajtimin fizik të të ndaluarve të tjerë. Të ndaluarit gjithashtu i ngacmuan brenda dhe jashtë dhomës 1, i gënjen dhe i kërcënuan me dhunë dhe vdekje. Si pasojë, ata jetonin në

---

<sup>1258</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013133.

<sup>1259</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013134.

<sup>1260</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013133.

<sup>1261</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818-SPOE00013819; **W01448:** SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013836; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013758.

frikë të vazhdueshme dhe mendonin se në çdo moment mund të keqtrajtoheshin fizikisht, apo edhe të vriteshin.

(b) TW4-01 dhe viktimat e vrasjes së paligjshme

654. *Keqtrajtimi dhe marrja në pyetje në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.* TW4-01 dëshmoi se, [REDAKTUAR], atë dhe viktimën e vrasjes së paligjshme, një rojë dhe një anëtar tjetër i UÇK-së, i çuan në zyrë në ndërtesën e komandës.<sup>1262</sup> Në zyrë, TW4-01 ishte dëshmitar i keqtrajtimit dhe marrjes në pyetje të W04733-shit, i cili kishte qenë në zyrë që më parë kur arritën TW4-01 dhe viktimat e vrasjes së paligjshme.<sup>1263</sup> TW4-01 dëshmoi se z. Shala, Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi dhe tre anëtarë të tjerë të UÇK-së ishin të pranishëm në zyrë dhe kryenin rrahjet.<sup>1264</sup>

655. TW4-01 dëshmoi se, kur përfundoi keqtrajtimi fizik dhe marrja në pyetje e W04733-shit, ai (d.m.th. W04733) u nxor nga zyra dhe filloi keqtrajtimi i tij.<sup>1265</sup> Atij i kujtohej qartë se i pari që e goditi me shufër gome ishte z. Shala.<sup>1266</sup> [REDAKTUAR].<sup>1267</sup> TW4-01 dëshmoi se anëtarët e UÇK-së të pranishëm në zyrë filluan ta rrihnin me radhë, duke përdorur sende të ndryshme, përfshirë shufra metali, shkopinj bejsbolli dhe shkopinj gome.<sup>1268</sup> Duke iu referuar z. Shala, TW4-01 dëshmoi: “me na rrah, na ka rrah sa ka mujt”<sup>1269</sup> dhe “me buzëqeshje na ka rrahur”.<sup>1270</sup> [REDAKTUAR].<sup>1271</sup>

<sup>1262</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1450, rreshti 4 deri në f. 1451, rreshti 23; f. 1452, rreshtat 3-12. Dëshmitari e rrethoi me laps zyrën në fotografinë 065597-065612, f. 065600 (fotografia në fund të faqes, e ruajtur si REG00956).

<sup>1263</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1452, rreshtat 18-22; f. 1454, rreshtat 3-19; f. 1455, rreshtat 1-11.

<sup>1264</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1452, rreshti 25 deri f. 1453, rreshti 11.

<sup>1265</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1457, rreshtat 17-20.

<sup>1266</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1457, rreshtat 20-22.

<sup>1267</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1457, rreshti 22; f. 1458, rreshtat 10-12.

<sup>1268</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1457, rreshtat 22-24; f. 1458, rreshtat 15-19.

<sup>1269</sup> **TW4-01:** T. 2 qershor 2023, konfidencial, f. 1691, rreshti 22 deri në f. 1692, rreshti 1.

<sup>1270</sup> **TW4-01:** T. 2 qershor 2023, konfidencial, f. 1690, rreshtat 22-23.

<sup>1271</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1457, rreshti 24 deri në f. 1458, rreshti 1; f. 1459, rreshtat 9-15.

[REDAKTUAR].<sup>1272</sup> [REDAKTUAR].<sup>1273</sup> TW4-01 saktësoi më tej: “[REDAKTUAR]. Kanë ba çka kanë mujt mu. Çka ju ka ardhë për dore”.<sup>1274</sup> Ai shtoi: “[REDAKTUAR]. Më kanë rreh sikur qenin”.<sup>1275</sup>

656. TW4-01 gjithashtu dëshmoi se, gjatë asaj nate, u mor në pyetje [REDAKTUAR] në lidhje me disa persona, [REDAKTUAR].<sup>1276</sup> Dëshmitari shpjegoi se e akuzuan [REDAKTUAR].<sup>1277</sup> Ai më tej shpjegoi se e akuzuan gjithashtu edhe për bashkëpunim me policinë serbe dhe e quajtën spiun.<sup>1278</sup>

657. Sipas dëshmisë, pasi e pyetën dhe keqtrajtuat për disa orë, TW4-01-shin [REDAKTUAR].<sup>1279</sup> [REDAKTUAR].<sup>1280</sup> [REDAKTUAR].<sup>1281</sup>

658. [REDAKTUAR], filloi keqtrajtimi fizik i viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1282</sup> [REDAKTUAR] shpjegoi se, edhe pse nuk e pa viktimën e vrasjes së paligjshme teksa e rrihnin, ai mund t’i dëgjonte ulërimat [REDAKTUAR].<sup>1283</sup> Ai dëshmoi: “Ai hiç me mos bërtit, vllavi, veç të ramet kur krisnin i nijsha, të ramet se të bërtimat s’po flas hiç”.<sup>1284</sup>

659. Në lidhje me këtë incident, Trupi Gjykses gjithashtu merr parasysh dëshminë përputhëse të W01448-ës, i cili ishte i pranishëm në zyrë gjatë keqtrajtimit të TW4-01-

---

<sup>1272</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1457, rreshti 24 deri në f. 1458, rreshti 1.

<sup>1273</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1464, rreshtat 9-24.

<sup>1274</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1465, rreshtat 7-15.

<sup>1275</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1458, rreshti 19.

<sup>1276</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1459, rreshti 16 deri në f. 1460, rreshti 4; f. 1477, rreshtat 4-9.

<sup>1277</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1459, rreshti 16 deri në f. 1460, rreshti 4.

<sup>1278</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1459, rreshti 21 deri në f. 1460, rreshti 2; f. 1476, rreshtat 6-11.

<sup>1279</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1467, rreshti 20 deri në f. 1468, rreshti 24.

<sup>1280</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1467, rreshti 20 deri në f. 1468, rreshti 20 deri f. 1468, rreshti 6.

<sup>1281</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1467, rreshti 20 deri në f. 1468, rreshti 20 deri f. 1468, rreshti 14.

<sup>1282</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1283</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1284</sup> [REDAKTUAR].

shit dhe të viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1285</sup> Më konkretisht, W01448 shpjegoi në deklaratën e vet se, pasi W04733 u nxor nga zyra, filloi keqtrajtimi i TW4-01-shit, dhe më pas keqtrajtimi i viktimës së vrasjes së paligjshme, çka konfirmon dëshminë e TW4-01-shit në lidhje me radhën e rrahjeve atë natë.<sup>1286</sup> Duke përshkruar keqtrajtimin fizik që pa, W01448 tha: “Ata [TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme] u rrahën më keq se unë. Ata ishin të përgjakur, dhe për t’i rrahur ata përdornin shkopinj të dhe gjithçka tjetër”,<sup>1287</sup> “Ata klithnin e bërtitnin”.<sup>1288</sup> [REDAKTUAR].<sup>1289</sup> [REDAKTUAR].<sup>1290</sup> W01448 gjithashtu dha dëshmi që konfirmon faktin se si TW4-01, ashtu edhe viktima e vrasjes së paligjshme, u akuzuan për bashkëpunim dhe lidhje të ngushta me serbët.<sup>1291</sup>

660. Në lidhje me kryesit e rrahjeve, W01448 shpjegoi në të gjitha deklaratat e tij se TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme u keqtrajtuan fizikisht dhe psikologjikisht nga disa anëtarë të UÇK-së, [REDAKTUAR], të cilët i rrahën me radhë me mjete të ndryshme deri në orët e hershme të mëngjesit.<sup>1292</sup> Sipas deklaratave të W01448-ës, me përjashtim të Sabit Gecit, të gjithë anëtarët e tjerë të UÇK-së të pranishëm në zyrë morën pjesë në rrahjen e TW4-01-shit dhe viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1293</sup> Nga deklaratat e W01448-ës Trupi Gjykes dedukton se z. Shala mori pjesë në rrahjen e TW4-01-shit dhe viktimës së vrasjes së paligjshme, pasi ai ishte pjesë e grupit të

<sup>1285</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013744.

<sup>1286</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

<sup>1287</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016232.

<sup>1288</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016232.

<sup>1289</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743.

<sup>1290</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016232; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743, SITF00013747.

<sup>1291</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013744.

<sup>1292</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016232; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743-SITF00013745.

<sup>1293</sup> **W01448:** SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231-00016232, SITF00016234; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743-SITF00013744.

anëtarëve të UÇK-së të pranishëm në zyrë atë natë, dhe ato rrjedhimisht konfirmojnë dëshminë e TW4-01-shit.

661. Trupi Gjykes i konstaton të besueshme dëshminë e TW4-01-shit dhe deklaratat e W01448-ës, pasi të dy dëshmitarët përshkruan në mënyrë bindëse, të hollësishme, të gjallë, të saktë dhe tejet përputhëse keqtrajtimin që pësuan TW4-01 [REDAKTUAR] në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes gjykon se mund të mbështetet në dëshminë e TW4-01-shit dhe deklaratat e W01448-ës në lidhje me këtë incident, që janë fakte që ata i dinin personalisht.

662. Në lidhje me parashtrimet e Mbrojtjes se W04733 dha dëshmi kundërthënëse në lidhje me keqtrajtimin e TW4-01-shit dhe viktimës së vrasjes së paligjshme,<sup>1294</sup> Trupi Gjykes vë në dukje si në vijim. Në të gjitha deklaratat e tij, W04733 vazhdimisht ka dëshmuar se krahas W01448-ës, edhe TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme u sollën në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1295</sup> Trupi Gjykes vë në dukje më tutje se, me përjashtim të deklaratës që dha në vitin 2010, W04733 ka deklaruar vazhdimisht gjatë viteve se i pa TW4-01-shin dhe/ose viktimën e vrasjes së paligjshme duke u keqtrajtuar në zyrë nga anëtarë të UÇK-së, përfshirë nga z. Shala.<sup>1296</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykes konstaton se dëshmia e W04733-shit konfirmon dëshmitë e dhëna nga [REDAKTUAR] W01448 në lidhje me keqtrajtimin e TW4-01-shit dhe të viktimës së vrasjes së paligjshme në zyrë dhe, rrjedhimisht, mbështetet në dëshminë e W04733-shit në lidhje me këtë aspekt. Argumenti i Mbrojtjes hidhet poshtë.

---

<sup>1294</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 132.

<sup>1295</sup> **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818-SPOE00013819; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018742.

<sup>1296</sup> **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185340-00185341; 106978-107020, f. 106984-106985; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013820-SPOE00013821; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 12-14.

663. Mbrojtja gjithashtu parashtron se TW4-01 është i vetmi dëshmitar që identifikoi z. Shala si një nga anëtarët e UÇK-së që keqtrajtoi atë [REDAKTUAR] në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1297</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet më lart se W04733 dha dëshmi të besueshme që vërteton faktin se i pa TW4-01-shin [REDAKTUAR] teksa rriheshin nga z. Shala. Trupi Gjykses rikujton më tutje se, sipas deklaratave të W01448-ës, me përjashtim të Sabit Gecit, anëtarët e tjerë të UÇK-së të pranishëm në zyrë, përfshirë z. Shala, morën pjesë në rrahjen e TW4-01-shit [REDAKTUAR]. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses hedh poshtë argumentin e Mbrojtjes se asnjë dëshmitar tjetër nuk ka dhënë dëshmi për pjesëmarrjen e z. Shala në keqtrajtimin e TW4-01-shit [REDAKTUAR].

664. *Incidenti i dytë i keqtrajtimit* [REDAKTUAR]. TW4-01 dëshmoi se, [REDAKTUAR], ku e rrahën rëndë përsëri.<sup>1298</sup> Dëshmia e TW4-01-shit vë në dukje se, sikurse më parë, e rrahën përsëri me mjete të ndryshme gjatë tërë natës, deri në orët e hershme të mëngjesit të nesërm.<sup>1299</sup> Dëshmitari theksoi se nuk i kujtoheshin emrat e anëtarëve të UÇK-së që e keqtrajtuan në këtë rast, dhe shtoi: “E di se janë kanë grup e kësi të mëdhej janë kanë, po me emna i kam harru për besë. E kam pasë shumë maltratime shpesh. Nuk po i di atëherë kur, qysh”.<sup>1300</sup> [REDAKTUAR].<sup>1301</sup> Ai shpjegoi se nuk i kujtohej nëse z. Shala ishte i pranishëm.<sup>1302</sup> Kur u ballafaqua me deklaratat e mëparshme ku kishte deklaruar se z. Shala kishte qenë i pranishëm gjatë atij incidenti, TW4-01 theksoi se nuk i kujtohej pas gjithë atyre viteve.<sup>1303</sup>

---

<sup>1297</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1298</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1471, rreshti 22 deri në f. 1472, rreshti 2; T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1497, rreshtat 20-24; f. 1498, rreshtat 2-4.

<sup>1299</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1507, rreshti 19 deri në f. 1508, rreshti 3; konfidencial, 1510, rreshtat 6-11.

<sup>1300</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1507, rreshtat 19-23.

<sup>1301</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1498, rreshtat 17-20.

<sup>1302</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1498, rreshtat 17-20.

<sup>1303</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1505, rreshti 17 deri në f. 1506, rreshti 24; f. 1508, rreshti 22 deri në f. 1510, rreshti 3 që i referohet Deklaratave të Mëparshme të TW4-01-shit: SITF00012758-SITF00012789, SITF00019151-SITF00019195 RED, 083219-TR-ET Part 4.

665. Trupi Gjykues i kushton vëmendje faktit se, në kundërshtim me deklaratat e tij të mëparshme, dëshmitari nuk ishte në gjendje të konfirmonte në sallën e gjyqit nëse z. Shala ishte i pranishëm gjatë incidentit të dytë [REDAKTUAR]. Trupi Gjykues e pranon shpjegimin e dëshmitarit se kalimi i kohës e bën më të vështirë kujtimin e ngjarjeve. Trupi Gjykues gjithashtu vë në dukje konfirmimin nga dëshmitari të pranisë së [REDAKTUAR], pa e implikuar qëllimisht z. Shala. Fakti që TW4-01 e pranoi menjëherë dhe pa druajtje se nuk i kujtohej prania e z. Shala, përforcon përshtypjen e përgjithshme të Trupit Gjykues se TW4-01 përshkroi me vërtetësi përjetimet personale në lidhje me incidentin e dytë të keqtrajtimit [REDAKTUAR]. Pamundësinë e TW4-01-shit për të konfirmuar deklaratat e veta të mëparshme në lidhje me praninë e z. Shala, Trupi Gjykues nuk e gjykon aq të rëndësishme sa për të hedhur dyshim mbi vërtetësinë e dëshmisë së dëshmitarit në tërësi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues mbështetet në dëshminë e TW4-01-shit në lidhje me incidentin e dytë.

666. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>1304</sup> [REDAKTUAR].<sup>1305</sup> [REDAKTUAR].<sup>1306</sup> [REDAKTUAR].<sup>1307</sup>

667. [REDAKTUAR].<sup>1308</sup> [REDAKTUAR].<sup>1309</sup> [REDAKTUAR].<sup>1310</sup> [REDAKTUAR].<sup>1311</sup> [REDAKTUAR].<sup>1312</sup> [REDAKTUAR].<sup>1313</sup>

---

<sup>1304</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1305</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1306</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1307</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1308</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1309</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1310</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1311</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1312</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1313</sup> [REDAKTUAR].



668. [REDAKTUAR].<sup>1314</sup> [REDAKTUAR].<sup>1315</sup> [REDAKTUAR].<sup>1316</sup>

669. [REDAKTUAR].<sup>1317</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>1318</sup> [REDAKTUAR].<sup>1319</sup>

670. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>1320</sup> [REDAKTUAR].<sup>1321</sup> [REDAKTUAR].<sup>1322</sup>  
[REDAKTUAR].<sup>1323</sup> [REDAKTUAR].<sup>1324</sup> [REDAKTUAR].<sup>1325</sup> [REDAKTUAR].  
[REDAKTUAR].<sup>1326</sup> [REDAKTUAR].

671. [REDAKTUAR].

672. [REDAKTUAR].<sup>1327</sup> [REDAKTUAR].<sup>1328</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].  
[REDAKTUAR].

673. [REDAKTUAR].

674. *Keqtrajtimi në dhomën 2 më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date – incidenti i qëllimit me armë zjarri në këmbë.* [REDAKTUAR] viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] morën [REDAKTUAR] nga dhoma 1 dhe [REDAKTUAR] çuan në dhomën 2, [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] keqtrajtuat dhe morën në pyetje.<sup>1329</sup> [REDAKTUAR] z. Shala,<sup>1330</sup> Xhemshit Krasniqi, Bedriu, Van Dami dhe së paku edhe tre apo katër

---

<sup>1314</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1315</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1316</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1317</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1318</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1319</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1320</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1321</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1322</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1323</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1324</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1325</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1326</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1327</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1328</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1329</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1330</sup> Prania e z. Shala gjatë këtij incidenti diskutohet me më shumë hollësi në Pjesën VI.F.4.

anëtarë të tjerë të UÇK-së ishin të pranishëm në dhomë atë natë.<sup>1331</sup> [REDAKTUAR] viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] keqtrajtuuan fizikisht me sende të ndryshme nga anëtarët e UÇK-së të pranishëm në dhomën 2, [REDAKTUAR].<sup>1332</sup> [REDAKTUAR]: “[REDAKTUAR]”,<sup>1333</sup> “[REDAKTUAR]”,<sup>1334</sup> “[REDAKTUAR]”,<sup>1335</sup> “[REDAKTUAR]”,<sup>1336</sup> “[REDAKTUAR]”.<sup>1337</sup>

675. [REDAKTUAR] u detyrua të pranonte se [REDAKTUAR].<sup>1338</sup> [REDAKTUAR].<sup>1339</sup> [REDAKTUAR].<sup>1340</sup>

676. [REDAKTUAR] viktima e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri në këmbë, nën gju.<sup>1341</sup> Trupi Gjykues do ta diskutojë qëllimin me armë zjarri të viktimës së vrasjes së paligjshme më me hollësi në Pjesën VI.F.1 më poshtë.

677. [REDAKTUAR].<sup>1342</sup> Sipas tij: “kanë fillu prapë tuj na rreh, [REDAKTUAR]. Deri në mëngjes, [REDAKTUAR]”.<sup>1343</sup> [REDAKTUAR].<sup>1344</sup> [REDAKTUAR].<sup>1345</sup>

678. [REDAKTUAR]. Më konkretisht, TW4-11 dëshmoi se një ditë gjatë periudhës që ishin të ndaluar, viktimën e vrasjes së paligjshme e morën nga dhoma 1.<sup>1346</sup> Pak më

---

<sup>1331</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1332</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1333</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1334</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1335</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1336</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1337</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1338</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1339</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1340</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1341</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1342</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1343</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1344</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1345</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1346</sup> **TW4-11**: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1245, rreshtat 16-20.

pas, TW4-11 dëgjoi një krismë arme pak më larg.<sup>1347</sup> [REDAKTUAR].<sup>1348</sup> Dëshmitari shpjegoi më tutje se, kur viktimën e vrasjes së paligjshme e kthyen në dhomën 1 të nesërmen në mëngjes, ai kishte një plagë nga armë zjarri mbi gju, që rridhte gjak.<sup>1349</sup> [REDAKTUAR].<sup>1350</sup>

679. [REDAKTUAR].<sup>1351</sup> [REDAKTUAR].<sup>1352</sup> [REDAKTUAR].<sup>1353</sup> W01448 tregoi më tutje se anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Xhemshit Krasniqi, morën nga dhoma 1 [REDAKTUAR] viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>1354</sup> W01448 deklaroi se nga dhoma 1 ishte në gjendje të dëgjonte “britmat e [...] zëshme” të viktimës së vrasjes së paligjshme teksa e rrihnin anëtarë të UÇK-së.<sup>1355</sup> Pas kësaj, W01448 dëgjoi një krismë arme zjarri afër derës.<sup>1356</sup> Ai dëshmoi se Xhemshit Krasniqi, së bashku me dy anëtarë të tjerë të UÇK-së, e kthyen viktimën e vrasjes së paligjshme në dhomën 1.<sup>1357</sup> W01448 pa se

<sup>1347</sup> **TW4-11**: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1246, rreshtat 3-6; f. 1246, rreshti 15 deri në f. 1248, rreshti 19, që i referohet deklaratës së mëparshme të TW4-11-shit : SITF00013047-SITF00013060 RED5; f. 1249, rreshtat 3-5, 20-22.

<sup>1348</sup> **TW4-11**: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1245, rreshti 25 deri f. 1246, rreshti 2.

<sup>1349</sup> **TW4-11**: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1244, rreshti 25 deri f. 1245, rreshti 24; f. 1253, rreshti 24 deri në f. 1255, rreshti 6, që i referohet deklaratës së mëparshme të TW4-11-shit : 059351-TR-ET Part 2; T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1255, rreshti 23 deri në f. 1256, rreshti 23, që i referohet deklaratës së mëparshme të TW4-11-shit : SITF00019898-00019956 RED4.

<sup>1350</sup> **TW4-11**: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1258, rreshtat 15-21.

<sup>1351</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013755.

<sup>1352</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013755.

<sup>1353</sup> **W01448**: SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013838; SITF00013848-00013851 RED2, f. SITF00013848; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013755.

<sup>1354</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013755.

<sup>1355</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859.

<sup>1356</sup> **W01448**: SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016238.

<sup>1357</sup> **W01448**: SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013838.

viktima e vrasjes së paligjshme “kishte një plagë nga plumbi në pjesën e poshtme të këmbës së djathtë”,<sup>1358</sup> nën gju, dhe ishte i “mbuluar me gjak”.<sup>1359</sup>

680. Pavarësisht nga disa dallime në dëshmitë e tyre, që do të diskutohen më hollësisht më poshtë,<sup>1360</sup> Trupi Gjykses vëren se dëshmia e TW4-11-shit dhe deklaratat e W01448-ës konfirmojnë [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

681. [REDAKTUAR],<sup>1361</sup> [REDAKTUAR].<sup>1362</sup> [REDAKTUAR].<sup>1363</sup>

682. [REDAKTUAR].<sup>1364</sup>

683. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

684. *Pasojat e keqtrajtimit*. Provat që iu paraqitën Trupit Gjykses tregojnë se keqtrajtimi që TW4-01 pësoi gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, siç u analizua më lart, i shkaktoi dëshmitarit lëndime fizike dhe psikologjike afatgjata. Konkretisht, TW4-01 dëshmoi se edhe sot e kësaj dite ka dhimbje në brinjë dhe eshtra [REDAKTUAR].<sup>1365</sup> Dëshmitari gjithashtu shpjegoi se ende ka vraga të dukshme [REDAKTUAR] nga keqtrajtimi fizik që pësoi.<sup>1366</sup>

685. TW4-01 gjithashtu dëshmoi në hollësi për pasojat psikologjike të keqtrajtimit të tij dhe deklaroi se vuan nga stresi dhe çrregullime nervore.<sup>1367</sup> Ai shpjegoi: “Nganjëherë trembem në gjumë, kërcej trupi, apo më del gjumi”.<sup>1368</sup> Gjithashtu, ai

---

<sup>1358</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859.

<sup>1359</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013753; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016239.

<sup>1360</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1361</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1362</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1363</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1364</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1365</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1523, rreshtat 15-17.

<sup>1366</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1458, rreshti 12; f. 1467, rreshti 22 deri në f. 1468, rreshti 3; f. 1474, rreshti 11 deri f. 1475, rreshti 10.

<sup>1367</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, publik, f. 1570, rreshtat 8-12.

<sup>1368</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, publik, f. 1572, rreshtat 17-18.

pohoi: “[...] mua më kanë vrarë. [...] Mua këta ma kanë nxjerrë shpirtin ngadalë- ngadalë, [...] [REDAKTUAR], e di çka është dajaku, di se dhimbje më të madhe s’ka”.<sup>1369</sup> TW4-01 theksoi se edhe sot nuk ndjehet i sigurt dhe ka frikë se mund të vritet.<sup>1370</sup> [REDAKTUAR].<sup>1371</sup> Si pasojë e frikës, TW4-01 aktualisht nuk punon [REDAKTUAR].<sup>1372</sup>

686. Dëshmia e TW4-01-shit në lidhje me lëndimin që pësoi [REDAKTUAR], konfirmohet nga konstatimet e dr. Gasiorit i cili bëri ekzaminimin fizik të dëshmitarit [REDAKTUAR].<sup>1373</sup> Raporti i përgatitur nga dr. Gasiori si dhe dëshmia e dr. Gasiorit në sallën e gjyqit tregojnë se, në momentin e ekzaminimit, TW4-01 kishte [REDAKTUAR].<sup>1374</sup>

687. Gjithashtu, dëshmia e TW4-01-shit për pasojat psikologjike që vuan konfirmohet fuqimisht nga ekzaminimi fizik i kryer nga znj. Duhne-Prinsen dhe dr. Lozano Parra. Aktekspertiza e tyre tregon se TW4-01 vuan nga çrregullimi i stresit pastraumatik (ÇSPT), përjeton fanitje dhe ndjen ankth dhe zemërim në lidhje me keqtrajtimin [REDAKTUAR].<sup>1375</sup> Sipas konstatimeve të znj. Duhne-Prinsen dhe dr. Lozano Parra, këto simptoma specifike të ÇSPT-së përputhen me keqtrajtimin e dëshmitarit gjatë mbajtjes në ndalim në FMK.<sup>1376</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjyqësor vë në dukje se Mbrojtja nuk kundërshtoi konstatimet e ekspertëve. Përkundrazi, duke tentuar të kundërshtojë kujtesën e TW4-01-shit për ngjarjet për shkak të ÇSPT-së,<sup>1377</sup> Mbrojtja i

<sup>1369</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1570, 23 deri në f. 1571, rreshti 3.

<sup>1370</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1576, rreshti 23 deri në f. 1577, rreshti 15.

<sup>1371</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1576, rreshti 25 deri në f. 1577, rreshti 2.

<sup>1372</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1577, rreshti 16 deri në f. 1578, rreshti 19.

<sup>1373</sup> **Dr. Gasior**: T. 27 qershor 2023, konfidencial, f.215, rreshti 16 deri në f. 2117, rreshti 17.

<sup>1374</sup> **Dr. Gasior**: T. 27 qershor 2023, konfidencial, f. 2119, rreshti 5 deri në f. 2120, rreshti 21 *që i referohet Aktekspertizës*: SITF00019134-SITF00019147 RED2, f. SITF00019137, SITF00019139.

<sup>1375</sup> **Aktekspertiza**: V4010023-V4010044, f. V4010037.

<sup>1376</sup> **Aktekspertiza**: V4010023-V4010044, f. V4010041, V4010043.

<sup>1377</sup> *Shih, për shembull, Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Mbrojtjes, para. 188.*

pranon konstatimet e ekspertëve në lidhje me pasojat fizike dhe psikologjike të keqtrajtimit të tij.

688. *Përfundim.* Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes është bindur se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, një grup anëtarësh të UÇK-së, që përfshinte z. Shala, [REDAKTUAR], keqtrajtoi fizikisht dhe psikologjikisht TW4-01-shin dhe viktimën e vrasjes së paligjshme. Në atë rast, TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme u morën në pyetje dhe u akuzuan se bashkëpunonin me serbët dhe ishin spiunë. Trupi Gjykes gjithashtu është bindur se, [REDAKTUAR], TW4-01 u keqtrajtua në [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Trupi Gjykes gjithashtu është bindur se më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] viktima e vrasjes së paligjshme u morën në pyetje dhe u keqtrajtuat fizikisht dhe psikologjikisht në dhomën 2 nga z. Shala, Xhemshit Krasniqi, Bedriu, Van Dami dhe së paku tre ose katër anëtarë të tjerë të UÇK-së. [REDAKTUAR]. Trupi Gjykes do të bëjë konstatimet e veta në lidhje me qëllimin me armë zjarri të viktimës së vrasjes së paligjshme në Pjesën VI.F. më poshtë.

(c) W04733

689. *Keqtrajtimi dhe marrja në pyetje në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.* Më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, katër anëtarë të UÇK-së e morën W04733-shin nga dhoma e ndalimit në ndërtesën e komandës dhe e çuan në zyrë,<sup>1378</sup> ku ai pa z. Shala, Xhemshit Krasniqin, Sabit Gecin, Fatmir Limajn dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së.<sup>1379</sup> Sipas dëshmisë së W04733-shit, ai ishte i ndaluar i parë që u çua në zyrë dhe u

---

<sup>1378</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019832-00019833; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013811; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 24.

<sup>1379</sup> **W04733:** SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 22; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018741; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013811.

keqtrajtua atë natë, i vijuar nga W01448, TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme.<sup>1380</sup>

690. Deklaratat e dëshmitarit përshkruajnë në hollësi keqtrajtimin fizik që ai pësoi atë mbrëmje. Më konkretisht, sipas W04733-shit, pasi hyri në dhomë, e ulën në një karrige druri para Sabit Gecit, i cili e mori në pyetje.<sup>1381</sup> Pas dëshmitarit qëndronin Xhemshit Krasniqi dhe z. Shala, dy anëtarët e UÇK-së të cilët, sipas W04733-shit, e keqtrajtuuan më së shumti.<sup>1382</sup> W04733 dëshmoi në veçanti se z. Shala përdori një shkop gome dhe një shkop bejsbolli për ta goditur në të gjithë trupin dhe në kokë, si edhe në duar dhe shputa, të cilat iu ënjtën si pasojë.<sup>1383</sup> Në një prej deklaratave të tij, W04733 deklaroi: “Pjetër Shala më ka goditur në mënyrën më çnjerëzore të mundshme”.<sup>1384</sup> Dëshmitari gjithashtu ka përshkruar në mënyrë përputhëse në të gjitha deklaratat e veta se z. Shala e urdhëroi [REDAKTUAR] që ta rrihnin, [REDAKTUAR].<sup>1385</sup> Po kështu, W04733 ka deklaruar në të gjitha deklaratat e veta se Xhemshit Krasniqi e goditi në kokë me armë, i fiku cigare në trup dhe ia theu bërrylin pasi e goditi me shkop gome.<sup>1386</sup> Ai saktësoi më tej se Xhemshit Krasniqi i futi një shkop në gojë, që i theu dhëmbët dhe i shkaktoi gjakderdhje nga goja.<sup>1387</sup>

691. W04733 shpjegoi se, përkundër faktit se ishte dukshëm i lënduar nga rrahjet që pësoi para mbërritjes në FMK, të gjithë personat e pranishëm në dhomë, përfshirë z.

<sup>1380</sup> **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818-SPOE00013819; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018742.

<sup>1381</sup> **W04733**: SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019841; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 23; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019841-SITF00019842.

<sup>1382</sup> **W04733**: SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019846.

<sup>1383</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106980; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 10-12; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018743; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019844.

<sup>1384</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106980.

<sup>1385</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 11; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018743; 106978-107020, f. 106981.

<sup>1386</sup> **W04733**: SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018742-00018743; 106978-107020, f. 106982-106983.

<sup>1387</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013187; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 7-8; 106978-107020, f. 106982.

Shala, Xhemshit Krasniqi dhe Fatmir Limaj, e keqtrajtuat.<sup>1388</sup> “[K]am marrë goditje me shkelma, me grushta, me shufër, me bejsbolla a me çka kanë mujtë me më ra”, dëshmoi ai.<sup>1389</sup> Ai shtoi: “Dukej sikur të gjithë donin të më godisnin, sikur fitonin njëfarë kënaqësie nga një gjë e tillë”.<sup>1390</sup> Si pasojë e rrahjeve që pësoi, W04733 humbi vetëdijen dhe i hodhën ujë që ta sillnin në vete.<sup>1391</sup> Ai shpjegoi më tutje se për shkak të goditjeve të rënda në kokë, filloi t’i rridhte gjak.<sup>1392</sup> Edhe pse mjeku erdhi dy herë dhe i lidhi kokën me fashë, një anëtar i UÇK-së ia hoqi fashat me thikë të dy herët.<sup>1393</sup>

692. Krahas rrahjes, W04733 deklaroi se u mor në pyetje nga Sabit Geci dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së të pranishëm në zyrë dhe u akuzua vazhdimisht se ishte përdhunues, vrasës, tradhtar dhe spiun, sepse kishte punuar për serbët.<sup>1394</sup> W04733 dëshmoi konkretisht se, teksa e rrihte, z. Shala e akuzoi se ishte spiun.<sup>1395</sup> Ai më tutje deklaroi qartë: “Do atëherë të vetshin, u dujke me u përgjigj këtijne, ta bëjke pyetjen ky. Ti ju përgjigjshe këtijne, t’thojke pse s'më përgjigjesh mu. [...] U kthejshe me folë me këtë, pa mbaru bisedën me këtë, pse s'po m'përgjigjesh mu, të bike tjetri”.<sup>1396</sup> Dëshmitari gjithashtu tha se i kërkuan të këndonte një këngë serbe.<sup>1397</sup>

693. W04733 tregoi se kishte qenë i ndaluar i parë që u nxor nga zyra atë natë dhe shpjegoi se, teksa po e nxirrnin jashtë, personat e pranishëm në zyrë vazhduan të

<sup>1388</sup> **W04733**: SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019841-SITF00019842; 082892-TR-AT-ET Part 8 RED2 (Pjesa 8 RED2), f. 14; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018743-00018744; U003-2283-U003-2289 RED2, f. U0032284, U0032286.

<sup>1389</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 25, rreshtat 24-25.

<sup>1390</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186.

<sup>1391</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106979; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818.

<sup>1392</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106979; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 32.

<sup>1393</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106979; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019841-00019842; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013826; 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 30, 32.

<sup>1394</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186; SITF00019824-00019876 RED2, f. SITF00019841-00019842; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013814.

<sup>1395</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 10, rreshtat 23-24.

<sup>1396</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 8 RED 2, f. 14, rreshtat 2-7.

<sup>1397</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186.



keqtrajtonin të ndaluar të tjerë, përfshirë W01448-ën, TW4-01-shin dhe viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>1398</sup> Dëshmitari shtoi se, kur po e çonin lart në dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, një anëtar i UÇK-së vazhdoi ta rrihte dhe ia preu kyçin e dorës me thikë, që W04733-shit i shkaktoi gjakderdhje të madhe.<sup>1399</sup>

694. Dëshmia e W04733-shit në lidhje me keqtrajtimin e tij më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, konfirmohet fuqishëm nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, përfshirë nga dëshmia në sallën e gjyqit e TW4-01-shit dhe deklarata e W01448-ës. Në dëshminë e tij para Trupit Gjyqësor, TW4-01 përshkroi qartë se kur hyri në zyrë, pa W04733-shin të ulur në karrige, me kokën e mbuluar në gjak dhe fasha, një hollësi e dallueshme që W01448 gjithashtu e përmendi në deklaratat e veta.<sup>1400</sup> Po ashtu edhe TW4-01, edhe W01448, ishin dëshmitarë të rrahjes së W04733-shit me shufra druri, shufra gome dhe shkopinj.<sup>1401</sup> TW4-01 dëshmoi se z. Shala ishte në mesin e anëtarëve të UÇK-së që rrahën W04733-shin.<sup>1402</sup> “Po është konë i përgjakur e i lodhën. Ai nuk dike as me kajt, asgjë. Veç ne jke tuj qesh, sikur me pas hup prej traumave”, kujtoi TW4-01.<sup>1403</sup> [REDAKTUAR].<sup>1404</sup> TW4-01 dhe W01448 gjithashtu dëshmuan se i hodhën kripë në sy dhe në plagë, [REDAKTUAR].<sup>1405</sup> Duke konfirmuar brutalitetin e keqtrajtimit të W04733-shit, në deklaratën e vet W01448 tregoi: “Duke parë [W04733-shin] në atë pozitë, më dukeshë se po vdes”,<sup>1406</sup> “Dukej se po garonin duke e rrahur dhe nënçmuar.

---

<sup>1398</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 106985; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013821.

<sup>1399</sup> **W04733**: SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013186; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018744; 106978-107020, f. 106983-106984. *Shih gjithashtu*, SITF00390625-00390626, f. SITF00390626.

<sup>1400</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1452, rreshtat 19-22; f. 1453, rreshtat 15-17; T. 31 maj 2023, konfidencial, f. 1491, rreshti 25 deri në f. 1492, rreshti 9; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856-SITF00013857.

<sup>1401</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1454, rreshtat 3-17.

<sup>1402</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1454, rreshtat 8-11.

<sup>1403</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1452, rreshtat 11-12.

<sup>1404</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1454, rreshtat 4-7.

<sup>1405</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1454, rreshtat 14-19; **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743-SITF00013745; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016232. [REDAKTUAR].

<sup>1406</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

Më në fund kur torturuesit [e W04733-shit] e larguan nga dhoma, ai nuk ishte në gjendje të ecë".<sup>1407</sup> TW4-01 dhe W01448 gjithashtu dhanë dëshmi se W04733 u mor në pyetje për punën e tij të dikurshme si polic dhe konfirmuan se ai u akuzua vazhdimisht se kishte bashkëpunuar me serbë dhe kishte përdhunuar gra.<sup>1408</sup>

695. W04733 dha dëshmi të gjallë dhe tejet të hollësishme për keqtrajtimin fizik që pësoi gjatë kohës kur ishte i ndaluar në FMK, që e bind Trupin Gjykues se ai foli me vërtetësi për përjetimet e tij personale, sidomos kur vlerësohet së bashku me dëshmitë konfirmuese që dhanë TW4-01 dhe W01448.

696. Mbrojtja argumenton se asnjë dëshmitar tjetër nuk konfirmoi në mënyrë të besueshme dhe të pavarur pretendimin e W04733-shit se z. Shala e keqtrajtoi në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1409</sup> Mbrojtja më tutje kundërshton besueshmërinë e dëshmisë së W04733-shit në lidhje me këtë incident, duke argumentuar se: (i) në deklaratën që dha në vitin 2002, W04733 nuk dha asnjë hollësi në lidhje me keqtrajtimin që pësoi nga z. Shala;<sup>1410</sup> dhe (ii) W04733 nuk ka dhënë gjithmonë dëshmi përputhëse në lidhje me personat që e dogjën me cigare dhe i thyen dhëmbët.<sup>1411</sup> Trupi Gjykues do t'i shqyrtojë këto kundërshtime më poshtë.

697. Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se asnjë dëshmitar tjetër nuk konfirmoi dëshminë e W04733-shit se u keqtrajtua fizikisht nga z. Shala, Trupi Gjykues rikujton konstatimin e vet më lart se TW4-01 dha dëshmi tejet konfirmuese në lidhje me keqtrajtimin e W04733-shit, duke konfirmuar, në veçanti, se ishte dëshmitar kur z. Shala rrahu W04733-shin. Gjithashtu, W01448 ka dhënë dëshmi se më 20 maj 1999, ose

---

<sup>1407</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

<sup>1408</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1455, rreshtat 1-11; **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856-SITF00013857; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013744.

<sup>1409</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 137.

<sup>1410</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 235.

<sup>1411</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 235.

rreth kësaj date, të gjithë anëtarët e UÇK-së të pranishëm në zyrë, përveç Sabit Gecit, i rrihnin të ndaluarit.<sup>1412</sup> Dëshmia e W01448-ës në lidhje me këtë përrputhet me dëshminë e TW4-01-shit, i cili gjithashtu deklaroi se të gjithë anëtarët e UÇK-së të pranishëm në zyrë e rrahën me radhë atë (d.m.th. TW4-01-shin) atë natë.<sup>1413</sup> Duke iu referuar W04733-shit në veçanti, në një nga deklaratat e veta W01448 tha: “Kushdo që donte të [...] rrahte, atë e bënte”.<sup>1414</sup> Trupi Gjykses nuk ka dyshim se z. Shala, i cili ishte i pranishëm në zyrë atë natë, e keqtrajtoi fizikisht W04733-shin. Rrjedhimisht, argumenti i Mbrojtjes hidhet poshtë.

698. Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se, në dallim nga deklarata e tij e vitit 2003, në vitin 2002 W04733 nuk dha dëshmi të hollësishme për keqtrajtimin që pësoi nga z. Shala, Trupi Gjykses para së gjithash sqaron se fakti që dëshmitarët japin shkallë të ndryshme hollësish në kohë të ndryshme, në vetvete nuk do të thotë se ata janë kontradiktorë ose se në dëshmitë e tyre nuk mund të mbështetesh. Shkalla e hollësive në deklaratën e W04733-shit thjesht pasqyron mënyrën se si u mor dhe u regjistrua deklarata e tij në atë kohë. Faktikisht, Trupi Gjykses vëren se në vitin 2003, hetuesit e TPNJ-së i kërkuan W04733-shit t’u përgjigjej disa pyetjeve shtesë në lidhje me deklaratën që i kishte dhënë të njëjtit autoritet në vitin 2002. Rrjedhimisht, është e natyrshme që deklarata e tij e vitit 2003 të jetë më e hollësishme se ajo e vitit 2002. Duke pasur këtë parasysh, Trupi Gjykses nuk pajtohet me Mbrojtjen se dallimet në shkallën e hollësive midis dy deklaratave hedhin dyshim mbi mbështetshmërinë në dëshminë e W04733-shit.

699. Së fundi, Trupi Gjykses vë në dukje se, me përjashtim të deklaratës që dha në vitin 2010, në vitet 2002, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe 2019 W04733 ka dhënë

---

<sup>1412</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013744-SITF00013745; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231.

<sup>1413</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1459, rreshtat 9-15.

<sup>1414</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013745.

vazhdimisht dëshmi se personi që i futi shkopin në gojë dhe që për pasojë i theu dhëmbët, ishte Xhemshit Krasniqi, dhe këtë dëshmi e konfirmoi edhe W01448.<sup>1415</sup> Ngjashëm, në të gjitha deklaratat në vitin 2009, 2010 dhe [REDAKTUAR], W04733 ka identifikuar Xhemshit Krasniqin si personi që përdori cigare për ta djegur në shpatulla. Është e vërtetë se [REDAKTUAR] dëshmitari fillimisht e identifikoi z. Shala si anëtarin e UÇK-së që e dogji me cigare, por Trupi Gjykses vë në dukje se ai e korrigjoi menjëherë këtë gabim.<sup>1416</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, ndryshe nga pretendimet e Mbrojtjes, W04733 ka dhënë dëshmi përrputhëse dhe të hollësishme për llojet konkrete të keqtrajtimit që pësoi. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se mospërrputhja në deklaratën e W04733-shit të vitit 2010 është rast i izoluar dhe nuk ndikon në besueshmërinë e përgjithshme të tij, duke pasur parasysh në veçanti faktin se dëshmitari ka dhënë deklarata të shumta përrputhëse gjatë shumë viteve.

700. *Pasojat e keqtrajtimit.* Provat që mori Trupi Gjykses tregojnë se W04733 vuajti pasoja afatgjata fizike dhe psikologjike nga lëndimet që pësoi gjatë mbajtjes në ndalim në FMK. Në veçanti, W04733 shpjegoi se keqtrajtimi që pësoi gjatë mbajtjes në ndalim e la me lëndime dhe vragë të shumta, përfshirë një vragë në ballë,<sup>1417</sup> shenja djegieje në gjoks dhe shpatulla,<sup>1418</sup> bërryl të lënduar,<sup>1419</sup> dhe dhëmbë të thyer.<sup>1420</sup>

<sup>1415</sup> **W04733:** SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013187; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 7-8; 106978-107020, f. 106982; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818; **W01448:** SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837.

<sup>1416</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106980.

<sup>1417</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013814; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018742-SITF00018743; SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185340.

<sup>1418</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018742-SITF00018743; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013816; SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185340.

<sup>1419</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018742; 106978-107020, f. 106982; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013817.

<sup>1420</sup> **W04733:** SITF00013181-SITF00013189 RED3, f. SITF00013187; 082892-TR-AT-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 7-8; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018743; 106978-107020, f. 106982; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013818.

701. Kur përshkroi pasojat psikologjike të ndalimit dhe keqtrajtimit të tij, W04733 deklaroi: “Ëndrra të vështira. Po. Megjithëse edhe tash i shoh. Po. Krejt më vinë ndjenja me të vdekun, nuk e di se kanë vdekë. Po. Nuk e di si kanë vdekë. Po. Po kam dëgjume, atëherë e di qe janë të vdekun”.<sup>1421</sup> Dëshmitari shpjegoi më tej se, pas liritimit prej FMK-së, ai jetonte vazhdimisht me stres, i frikësuar edhe të vizitonte mjekun, me gjithë lëndimet e rënda që kishte pësuar në FMK.<sup>1422</sup> “Tuj ndi, ku bukur vonë, e ndijsha një farë frike mbas shpine se po më avitet”, tha ai në një nga deklaratat e tij.<sup>1423</sup> Sipas W04733-shit, ajo që përjetoi në FMK ndikoi edhe në jetën e familjes së tij. Dëshmitari shpjegoi se [REDAKTUAR], dhe se djemtë ose nipat e tij duhej ta shoqëronin kudo që shkonte.<sup>1424</sup>

702. Dëshmia e W04733-shit për lëndimet që pësoi konfirmohet fuqishëm nga konstatimet e dr. Gasiorit i cili e ekzaminoi fizikisht W04733-shin më 10 nëntor 2010.<sup>1425</sup> Aktekspertiza e përgatitur nga dr. Gasior si dhe dëshmia e tij në sallën e gjyqit tregojnë se W04733-shit iu shkaktua një vrugë prej 4.5 centimetrash në ballë, e cila ishte “pasoje e një lëndimi të rëndë [...] të shkaktuar me send të fortë, të rëndë, dhe me ushtrim të njëfarë force”.<sup>1426</sup> Dëshmia e dr. Gasiorit dhe aktekspertiza e tij në lidhje me W04733-shin gjithashtu tregojnë se bërryli i majtë i W04733-shit ishte deformuar pakëz dhe se aftësia e tij për ta drejtuar atë bërryl ishte kufizuar deri në dhjetë për qind.<sup>1427</sup> Së fundi, aktekspertiza dhe dëshmia e dr. Gasiorit konfirmojnë se W04733 pësoi vrugë

<sup>1421</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 24.

<sup>1422</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 18-19, 23; SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185337; SITF00390625-00390626, f. SITF00390626.

<sup>1423</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 24.

<sup>1424</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 10 RED2 (Pjesa 10 RED2), f. 24, 29-30. *Shih gjithashtu*, SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185337.

<sup>1425</sup> **Dr. Gasior:** T. 27 qershor 2023, konfidencial, f. 2126, rreshti 12 deri f. 2127, rreshti 15. *Shih gjithashtu*, SITF00019793-SITF00019810 që përmban aktekspertizën e ekzaminimit fizik të W04733-shit.

<sup>1426</sup> **Aktekspertiza:** SITF00019793-SITF00019810, f. SITF00019794-SITF00019795, SITF00019797; T. 27 qershor 2023, publik, f. 2128, rreshti 13 deri në f. 2129, rreshti 9.

<sup>1427</sup> **Aktekspertiza:** SITF00019793-SITF00019810, f. SITF00019795, SITF00019800; T. 27 qershor 2023, publik, f. 2130, rreshtat 5-14

lineare në kyçin e dorës së majtë si pasojë e një lëndimi të shkaktuar me mjet të mprehtë.<sup>1428</sup>

703. Edhe anëtarët e familjes së W04733-shit dhanë dëshmi të shumta në sallën e gjyqit që konfirmuan lëndimet fizike të W04733-shit që i panë vetë pas lirimit të tij, si dhe të vuajtjeve mendore që pati për vite më pas.<sup>1429</sup> Ata përshkruan qartë se pas kthimit W04733 ishte i zbehtë,<sup>1430</sup> i mbuluar në gjak,<sup>1431</sup> kishe plagë në tërë trupin<sup>1432</sup> dhe kishte humbur shumë peshë.<sup>1433</sup> TW4-08, TW4-07 dhe TW4-09 në veçanti e përshkruan babain e tyre si “i shkatërrim”,<sup>1434</sup> “në agresivitet”,<sup>1435</sup> “jo ashtu si e kam njoftë unë ma herët”,<sup>1436</sup> “i thyer”.<sup>1437</sup> Gruaja e W04733-shit, TW4-06, foli gjerësisht për makthet dhe vështirësitë që kishte për të fjetur pas lirimit të tij.<sup>1438</sup> Në mënyrë të ngjashme TW4-08 konfirmoi për babain e tij: “Domethënë gjatë natës ka pasë traumatizime derisa – në gjendjen jo sikur ma herët para lufte”.<sup>1439</sup>

<sup>1428</sup> **Aktekspertiza:** SITF00019793-SITF00019810, f. SITF00019795, SITF00019801; T. 27 qershor 2023, publik, f. 2131, rreshti 8 deri në f. 2132, rreshti 5.

<sup>1429</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 667, rreshtat 8-11; f. 677, rreshtat 15-17; f. 683, rreshtat 5-6; f. 686, rreshtat 14-16, 19-22; f. 687, rreshtat 4-6 dhe 14-17; **TW4-06:** T. 28 mars 2023, konfidencial, f. 824, rreshtat 17-18, 23; f. 825, rreshtat 1-2, 16; T. 29 mars 2023, publik, f. 844, rreshtat 15-17; f. 845, rreshtat 1-11, 17-20; **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 911, rreshti 7-17; f. 912, rreshtat 2-6; **TW4-09:** T. 30 mars 2023, publik, f. 989, rreshtat 6-9, 12-13.

<sup>1430</sup> **TW4-06:** T. 28 mars 2023, publik, f. 824, rreshtat 11-14.

<sup>1431</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 683, rreshtat 2-6; **TW4-06:** T. 28 mars 2023, publik, f. 824, rreshtat 11-21.

<sup>1432</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 667, rreshtat 6-11; **TW4-06:** T. 28 mars 2023, konfidencial, f. 824, rreshtat 11-24; **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 911, rreshtat 6-17; **TW4-09:** T. 30 mars 2023, publik, f. 989, 4-9.

<sup>1433</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 667, rreshtat 6-9; **TW4-06:** T. 28 mars 2023, publik, f. 824, rreshtat 11-13; **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 911, rreshtat 6-7; **TW4-09:** T. 30 mars 2023, publik, f. 988, rreshtat 21-25.

<sup>1434</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 686, rreshtat 14-16.

<sup>1435</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 687, rreshtat 3-4.

<sup>1436</sup> **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 911, rreshtat 23-24.

<sup>1437</sup> **TW4-09:** T. 30 mars 2023, publik, f. 989, rreshtat 12-13.

<sup>1438</sup> **TW4-06:** T. 28 mars 2023, publik, f. 825, rreshtat 1-2; T. 29 mars 2023, publik, f. 844, rreshti 18 deri f. 846, rreshti 2.

<sup>1439</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 686, rreshtat 15-16; f. 687, rreshtat 15-17.

704. Gjithashtu, anëtarët e familjes konfirmuan dhe plotësuan dëshminë e W04733-shit në lidhje me pasojat afatgjata të ndalimit dhe keqtrajtimit për jetën e familjes. TW4-08, TW4-06, TW4-07 dhe TW4-09 përshkruan bindshëm se si familja ndau barrën e vuajtjeve që W04733 solli me vete.<sup>1440</sup> Sipas fjalëve të TW4-08-ës: “Përvoja ka qenë e hidhur pse jemi përball gjithë familja”, “ndijshim shpirtnisht për ato çka kishin bërë, në atë gjendje që e shifshim babain”.<sup>1441</sup> TW4-08, TW4-06 dhe TW4-07 dëshmuar më tutje se familja nuk ndjehej e sigurt, sepse kishin frikë se mund t’i shkaktohej më shumë dëm familjes.<sup>1442</sup> Gruaja e W04733-shit, TW4-06, gjithashtu shpjegoi se [REDAKTUAR] sepse familja brengosej për sigurinë e tyre.<sup>1443</sup> Në lidhje me këtë, TW4-07 deklaroi: “Po edhe te ne [REDAKTUAR], tjetër perspektivë si një familje”, “[Ne] për disa gjind janë konë që -- si familje, si i thojnë, spiun. Prej kësaj që çka ka ndodhë te baba”.<sup>1444</sup> Dëshmia e TW4-06-ës tregon se dëmi që iu shkaktua familjes vazhdon deri në ditët e sotme: “Me strese, unë dhe gjithë fëmijët. Shumë kohë, shumë kohë, as sot nuk mund t’i shlyjmë ato brenga nga që çka kemi përjetue”.<sup>1445</sup>

705. Trupi Gjykes gjithashtu i kushton vëmendje faktit se përshkrimi nga W04733 i vuajtjes mendore që përjetoi pas keqtrajtimit fizik që pësoi në FMK është jashtëzakonisht i ngjashëm me atë të TW4-01-shit. Në veçanti, të dy dëshmitarët treguan se ndalimi dhe keqtrajtimi i tyre në FMK i la me ndjenjë pasigurie dhe frike se do t’u ndodhte ndonjë gjë e keqe. Gjithashtu, të dy dëshmuar se kishin vështirësi

<sup>1440</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 677, rreshtat 10-23; f. 687, rreshti 7 deri f. 689, rreshti 12; **TW4-06:** T. 29 mars 2023, publik, f. 846, rreshti 3 deri f. 848, rreshti 6; **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 912, rreshtat 8-23; f. 913, rreshti 13 deri f. 914, rreshti 12; **TW4-09:** f. 989, rreshti 22 deri f. 990, rreshti 23.

<sup>1441</sup> **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 687, rreshtat 9-10, 14-15.

<sup>1442</sup> **TW4-06:** T. 29 mars 2023, publik, f. 847, rreshti 20 deri f. 848, rreshti 6; **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 677, rreshtat 10-23; f. 687, rreshti 7 deri f. 689, rreshti 2; **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 912, rreshtat 8-23; **TW4-09:** T. 30 mars 2023, publik, f. 989, rreshti 22 deri f. 990, rreshti 23.

<sup>1443</sup> **TW4-06:** T. 29 mars 2023, publik, f. 847, rreshtat 10-19. *Shih më tutje*, **TW4-08:** T. 27 mars 2023, publik, f. 688, rreshtat 1-13; **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 912, rreshtat 11-17.

<sup>1444</sup> **TW4-07:** T. 29 mars 2023, publik, f. 912, rreshtat 18-21. *Shih më tej*, **TW4-09:** T. 30 mars 2023, publik, f. 960, rreshti 14 deri në f. 962, rreshti 2.

<sup>1445</sup> **TW4-06:** T. 28 mars 2023, publik, f. 825, rreshti 24 deri në f. 826, rreshti 1.

të flinin për shkak të ngjarjeve traumatike që përjetuan gjatë ndalimit të tyre. Trupi Gjykues gjykon se kjo i jep besueshmëri dëshmisë së W04733-shit në deklaratat e tij në lidhje me efektin psikologjik të keqtrajtimit të tij. Po ashtu, kjo e përforcon dëshminë e dhënë nga TW4-01.

706. *Përfundim.* Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, një grup anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, Fatmir Limaj dhe Xhemshit Krasniqi, keqtrajtoi fizikisht dhe psikologjikisht W04733-shin. Në atë rast, disa anëtarë të UÇK-së, përfshirë Sabit Gecin, gjithashtu e morën në pyetje dëshmitarin në lidhje me punën e tij të dikurshme si polic dhe e akuzuan se ishte tradhtar, vrasës, përdhunues dhe se kishte bashkëpunuar me serbë. Trupi Gjykues gjithashtu është bindur se gjatë këtij incidenti, z. Shala e akuzoi W04733-shin se ishte spiun.

(d) W01448

707. *Keqtrajtimi dhe marrja në pyetje në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.* Më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, W01448-ën e morën nga dhoma e ndalimit në ndërtesën e komandës dhe e çuan në zyrë, ku ai pa se ishin mbledhur së paku dhjetë anëtarë të UÇK-së, përfshirë z. Shala, Xhemshit Krasniqi dhe Sabit Geci.<sup>1446</sup> Ai shpjegoi se pas keqtrajtimit të W04733-shit, TW4-01-shit dhe viktimës së vrasjes së paligjshme, që pa me sytë e vet, filloi keqtrajtimi i tij.<sup>1447</sup> Në veçanti, W01448 përshkroi se u godit më së shumti me shkop gome, kryesisht në pjesën e sipërme të trupit dhe në duar.<sup>1448</sup> Si

---

<sup>1446</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743-SITF00013744; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231. Trupi Gjykues vë në dukje se, në përputhje me dëshmitë e TW4-01-shit dhe W04733-shit, W01448 dëshmoi se në atë kohë Sabit Geci ishte i lënduar dhe përdorte paterica, çka e bën dëshmitarin edhe më të besueshëm (*shih* SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857).

<sup>1447</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

<sup>1448</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743, SITF00013747.



pasojë iu ënjtën duart.<sup>1449</sup> Ai tregoi më tutje se një anëtar i UÇK-së i pranishëm në zyrë e kërcënoi se do t'ia rripte lëkurën me thikë.<sup>1450</sup> "Xhemshit KRASNIQI më goditi me shkop gome në hundë dhe si rezultat i kësaj më ra të fikët. Hodhën një kovë me ujë në fytyrën time që të më sjellin në vete", dëshmoi ai.<sup>1451</sup> W01448 gjithashtu shpjegoi se, ashtu si në rrahjet e TW4-01-shit dhe W04733-shit, të gjithë anëtarët e UÇK-së të pranishëm në dhomë morën pjesën në rrahjen e tij.<sup>1452</sup> Sidoqoftë, në të gjitha deklaratat, W01448 e bëri të qartë se më së shumti e rrahu z. Shala.<sup>1453</sup>

708. Të njëjtën natë, W01448 u mor në pyetje nga Xhemshit Krasniqi në lidhje me të kaluarën e tij, shërbimin ushtarak, vendndodhjen para lufte dhe marrëdhëniet e tij me serbët.<sup>1454</sup> Ai shpjegoi se e urdhëruan t'i shkruante përgjigjet në letër.<sup>1455</sup>

709. Dëshmia e W01448-ës konfirmohet nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Më konkretisht, Trupi Gjykses gjykon se, në të gjitha deklaratat e veta, W04733 dëshmoi se pa W01448-ën duke u rrahur nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi.<sup>1456</sup> Në veçanti, W04733 dëshmoi se si Sabit Geci e goditi me grusht dhe me shuplakë W01448-ën.<sup>1457</sup> W04733 gjithashtu konfirmoi dëshminë e W01448-ës se u rrah me shkopinj në shputat e këmbëve dhe të duarve.<sup>1458</sup> Përveç ngjarjeve që pa në zyrë, W04733 gjithashtu shpjegoi se kur W01448-ën e kthyen në

---

<sup>1449</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

<sup>1450</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013746.

<sup>1451</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

<sup>1452</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013744.

<sup>1453</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743, SITF00013746.

<sup>1454</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013746.

<sup>1455</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013746.

<sup>1456</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018744; 106978-107020, f. 106984-106985.

<sup>1457</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018742, SITF00018744; 106978-107020, f. 106984-106985, 106999.

<sup>1458</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106984-106985, 106999.

dhomën e ndalimit në ndërtesën e komandës, ai pa shenja keqtrajtimi në trupin e tij, ndër të cilat mavijosje dhe shputa të duarve dhe të këmbëve të ënjtura.<sup>1459</sup>

710. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se, [REDAKTUAR], marrja në pyetje dhe keqtrajtimi [REDAKTUAR]: ata u keqtrajtuuan në zyrë nga të njëjtët anëtarë të UÇK-së, përfshirë z. Shala, duke përdorur të njëjtat mjete, të dy humbën vetëdijen dhe iu hodh ujë, u detyruan të shihnin keqtrajtimin fizik të të ndaluarve të tjerë dhe, së fundi, të dy u morën në pyetje për hollësi të jetës së tyre private.<sup>1460</sup> [REDAKTUAR].

711. Duke pasur parasysh hollësitë e dëshmisë së tij dhe dëshmitë konfirmuese të dhëna nga W04733 [REDAKTUAR], Trupi Gjykses është bindur se deklaratat e W01448-ës në lidhje me keqtrajtimin e tij nga anëtarë të UÇK-së, përfshirë nga z. Shala, kanë mbështetshmëri të lartë.

712. Mbrojtja kundërshton identifikimin e z. Shala nga W01448 dhe parashtron se në të nuk mund të mbështetesh sepse: (i) W01448 nuk e njohte z. Shala para ndalimit të tij në FMK; (ii) W01448 e mësoi identitetin e z. Shala nga të ndaluar të tjerë, [REDAKTUAR]; dhe (iii) gjatë procedurës së identifikimit me anë të fotografive të kryer në vitin 2010, W01448 identifikoi dikë tjetër si z. Shala.<sup>1461</sup> Mbrojtja parashtron se kjo bën që në dëshminë e tij në lidhje me përfshirjen e z. Shala në keqtrajtimin e tij nuk mund të mbështetesh.<sup>1462</sup>

713. Trupi Gjykses vë në dukje se W01448, i cili nuk e njohte z. Shala para ndalimit të tij në FMK, e identifikoi atë me emrin e plotë dhe me nofkën (komandant) "Ujku", dhe e përshkroi si katolik, me origjinë nga Dushanova ose që jetonte në fshatin Dushanovë,

---

<sup>1459</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106986-106987, 106999; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013820.

<sup>1460</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1461</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 101-102, 138.

<sup>1462</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 101-102.

Prizren.<sup>1463</sup> Në deklaratat e tij W01448 sqaroi se e mori këtë informacion nga [REDAKTUAR].<sup>1464</sup> Duke pasur parasysh të dhënat identifikuese që dha W01448, që ishin më shumë se thjesht emri dhe nofka e z. Shala, [REDAKTUAR],<sup>1465</sup> Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR] i treguan W01448-ës identitetin e z. Shala. Trupi Gjykses nuk sheh arsye të konstatojë se [REDAKTUAR], do të jepnin informacion të rremë në lidhje me identitetin e z. Shala. Fakti që W01448 e identifikoi një person tjetër si z. Shala në mesin e një sere fotografish – asnjë prej të cilave nuk ishte në fakt e z. Shala – nuk ndikon në konstatimin e Trupit Gjykses, sidomos duke pasur parasysh se W01448 nuk e njohte z. Shala para ndalimit të tij, si dhe faktin se identifikimi u krye në vitin 2010, 11 vjet pas ngjarjeve. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses hedh poshtë argumentin e Mbrojtjes se në dëshminë e W01448-ës në lidhje me incidentin më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, nuk mund të mbështetesh. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar më parë se z. Shala ishte i pranishëm në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, dhe mori pjesë aktivisht në rrahjen e të ndaluarve, bazuar në dëshmitë e TW4-01-shit dhe W04733-shit.

714. *Përfundim.* Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, një grup anëtarësh të UÇK-së, që përfshinte z. Shala, Sabit Gecin dhe Xhemshit Krasniqin, keqtrajtoi fizikisht dhe psikologjikisht W01448-ën. Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se, në të njëjtin rast, W01448 u mor në pyetje në lidhje me të kaluarën e tij, shërbimin ushtarak, vendndodhjen para lufte dhe marrëdhëniet e tij me serbët dhe se i kërkuan t'i jepte përgjigjet në një deklaratë me shkrim.

---

<sup>1463</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013836; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016231-00016232.

<sup>1464</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743; SITF00016221-00016285, f. SITF00016231.

<sup>1465</sup> [REDAKTUAR].

(e) [REDAKTUAR]

715. TW4-01 dëshmoi se, kur e çuan në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] e gjeti aty.<sup>1466</sup> Dëshmitari shpjegoi se, pasi përfundoi keqtrajtimi i tij atë natë, ai u nxor në korridorin jashtë zyrës, [REDAKTUAR].<sup>1467</sup> Ai dëshmoi se edhe pse nuk pa keqtrajtimin e [REDAKTUAR], ai i dëgjoi britmat e saj teksa e rrihnin.<sup>1468</sup>

716. W01448, i cili ishte ende në zyrë pasi TW4-01 u nxor jashtë, dha dëshmi të hollësishme për keqtrajtimin fizik që pësoi [REDAKTUAR] së bashku me një të ndaluar tjetër femër, të cilën ai e identifikoi me emrin [REDAKTUAR]. Sipas W01448-ës, dy gratë u rrahën rëndë nga anëtarë të UÇK-së të pranishëm në zyrë, ndër të cilët Xhemshit Krasniqi, i cili i goditi me shuplaka, grushte e shkelma.<sup>1469</sup> W01448 gjithashtu shpjegoi se dy të ndaluarat femra ishin akuzuar se kishin marrëdhënie me serbë.<sup>1470</sup>

717. Trupi Gjykses konstaton se nuk ka arsye për të dyshuar në besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve dhe mbështetet në dëshmitë e tyre që konfirmojnë njëra-tjetrën në lidhje me keqtrajtimin [REDAKTUAR] më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.

718. Trupi Gjykses gjithashtu dëgjoi dëshmi nga W01448 dhe W04733 se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR], një person, të cilin W01448 e identifikoi si "hetuesi", i kërkoi [REDAKTUAR] që të pranonte se [REDAKTUAR] ishin bashkëpunëtorë të serbëve.<sup>1471</sup> W01448 shtoi në deklaratën e vet: "Kur ajo tha se nuk kishte lidhje me këtë, Xhemshit KRASNIQI e kishte rrahur aq shumë sa që ajo kishte

---

<sup>1466</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1452, rreshtat 13-15.

<sup>1467</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1467, rreshtat 22-23; f. 1469, rreshtat 10-13.

<sup>1468</sup> **TW4-01**: T. 30 maj 2023, konfidencial, f. 1477, rreshtat 17-22.

<sup>1469</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013746-SITF00013747; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016235.

<sup>1470</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013747.

<sup>1471</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857; **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341.

lagur vendin kur e larguan".<sup>1472</sup> Edhe W04733 dha dëshmi në lidhje me këtë, por versioni i tij është pak më ndryshe. Në veçanti, W04733 dëshmoi se [REDAKTUAR] pranoi, pas përdorimit të forcës, se [REDAKTUAR] bashkëpunonin me serbë.<sup>1473</sup> Çka është e rëndësishme, ai identifikoi z. Shala dhe Xhemshit Krasniqin si anëtarët e UÇK-së që morën në pyetje [REDAKTUAR] dhe e detyruan të pranonte se [REDAKTUAR] ishin bashkëpunëtorë të serbëve.<sup>1474</sup> Ai tha: "Ata e sollën atë aty. 'Ujku' i tha asaj 'thuaje atyre në fytyrë se çfarë kanë bërë ata', Unë isha aty".<sup>1475</sup>

719. Trupi Gjykes konstaton se dëshmitë që dhanë W04733 dhe W01448 janë shumë të hollësishme, të gjalla dhe konfirmojnë njëra-tjetrën, dhe, rrjedhimisht, në to mund të mbështetesh. Fakti nëse [REDAKTUAR] vërtet pranoi apo jo nën përdorimin e forcës se [REDAKTUAR] bashkëpunonin me serbët, nuk është juridikisht thelbësor për konstatimet e Trupit Gjykes. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes nuk gjykon se kjo mospërputhje është aq e rëndësishme sa të vërë në dyshim besueshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarëve në lidhje me këtë aspekt. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes mbështetet në dëshminë e TW4-01-shit dhe deklaratat e W01448-ës dhe W04733-shit në lidhje me këtë aspekt.

720. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes është bindur se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, anëtarë të UÇK-së të pranishëm në zyrë, ndër të cilët Xhemshit Krasniqi, keqtrajtuari [REDAKTUAR] dhe i akuzuan se kishin marrëdhënie me serbë. Trupi Gjykes gjithashtu është bindur se, teksa po keqtrajtohej nga anëtarë të tjerë të UÇK-së, z. Shala e mori në pyetje [REDAKTUAR] dhe i kërkoi që të pranonte se [REDAKTUAR] ishin bashkëpunëtorë të serbëve.

---

<sup>1472</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013857.

<sup>1473</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106987; SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013819; SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341.

<sup>1474</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106987; SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341.

<sup>1475</sup> **W04733:** SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185341.

## (f) TW4-11

721. TW4-11 dëshmoi për dy raste kur u keqtrajtua në dhomën 1. Më konkretisht, dëshmitari dëshmoi se në një rast u godit me shkop gome në shpatullën e djathtë teksa ishte i kthyer me fytyrë nga muri.<sup>1476</sup> TW4-11 rrëfeu më tej se tri apo katër ditë pas këtij incidenti, tre persona të veshur me tesha civile hynë në dhomën 1.<sup>1477</sup> Ata i akuzuan të ndaluarit se ishin spiunë dhe tradhtarë dhe njëri prej tyre e goditi TW4-11-shin në sy me grusht.<sup>1478</sup> Dëshmitari dëshmoi se goditja e la me sy të mavijosur dhe me dhimbje dhe se edhe sot e kësaj dite ka probleme me atë sy.<sup>1479</sup> Dëshmia e tij konfirmohet nga W01448 dhe W04733, të cilët dëshmuar se, si të gjithë të ndaluarit e tjerë, edhe TW4-11 u keqtrajtua në dhomën 1.<sup>1480</sup>

722. Duke pasur parasysh dëshminë e hollësishme të TW4-11-shit, Trupi Gjykses është bindur se dëshmitari foli me vërtetësi për përjetimet e tij personale, sidomos kur vlerësohet së bashku me dëshmitë konfirmuese të W01448-ës dhe W04733-shit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses mbështetet në dëshmitë e TW4-11-shit, W01448-ës dhe W04733-shit në këtë aspekt.

723. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se, krahas keqtrajtimit të vazhdueshëm fizik dhe psikologjik që pësoi, TW4-11 u keqtrajtua edhe fizikisht nga anëtarë të UÇK-së në këto dy raste.

## (g) [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom

724. Trupi Gjykses gjithashtu mori prova se [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u keqtrajtuar nga anëtarë të UÇK-së gjatë mbajtjes në ndalim. Në veçanti, TW4-01

---

<sup>1476</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1230, rreshtat 12-20; f. 1231, rreshti 4.

<sup>1477</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1230, rreshtat 6-9; f. 1231, rreshtat 9-11.

<sup>1478</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1231, rreshtat 12-20.

<sup>1479</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1232, rreshtat 6-15.

<sup>1480</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013757; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016142; **W04733**: SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745.

dëshmoi se, sikurse të ndaluarit e tjerë, edhe [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u rrahën rregullisht, përfshirë në dhomën 1.<sup>1481</sup> Gjithashtu, kur përshkroi rrahjet që pa në dhomën 1, TW4-11 dëshmoi se [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë rom “ma tepër i kanë rrahur me shufër gome”.<sup>1482</sup> Tërheq vëmendjen përshkrimi i W04733-shit në deklaratën e vet se ata i rrahën “sikur kuajt. Sikur me kon kafshë”.<sup>1483</sup>

725. Duke pasur parasysh dëshmitë e tyre të gjalla dhe që konfirmojnë njëra-tjetrën, Trupi Gjykses është bindur se TW4-01, W04733 dhe TW4-11 dëshmuuan me vërtetësi për keqtrajtimin e [REDAKTUAR] dhe muzikantit të tretë rom.

726. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u keqtrajtuuan rregullisht, përfshirë në dhomën 1, nga anëtarë të UÇK-së.

(h) Të ndaluarit e tjerë

727. Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi se edhe TW4-04, TW4-02, [REDAKTUAR], si dhe së paku një femër tjetër e ndaluar, u keqtrajtuuan nga anëtarë të UÇK-së gjatë kohës që mbaheshin të ndaluar.

728. Konkretisht, [REDAKTUAR] dëshmoi se TW4-02 u keqtrajtua fizikisht gjatë ndalimit, por se nuk dinte më shumë hollësi për keqtrajtimin e TW4-02-shit.<sup>1484</sup> Edhe [REDAKTUAR] deklaroi se mësoi se TW4-04 u keqtrajtua rëndë gjatë mbajtjes në ndalim në FMK, por nuk tregoi burimin e informacionit.<sup>1485</sup> Sa i përket [REDAKTUAR], TW4-01 dhe W01448 dhanë dëshmi se ai u keqtrajtua në dhomën 1

---

<sup>1481</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1417, rreshtat 13-18; T. 31 maj 2023, publik, 1512, rreshtat 15-20.

<sup>1482</sup> **TW4-11:** T. 2 maj 2023, publik, f. 1220, rreshti 6.

<sup>1483</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 4 RED3 (Pjesa 4 RED3), f. 5.

<sup>1484</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1485</sup> [REDAKTUAR].

dhe jashtë saj.<sup>1486</sup> Dëshmitë e tyre konfirmohen edhe nga TW4-02, i cili dëshmoi se, ndërsa ai dhe [REDAKTUAR] ishin në dhomën 3, vetë [REDAKTUAR] i tregoi se ishte keqtrajtuar.<sup>1487</sup> Sa i përket [REDAKTUAR], W01448 shpjegoi në deklaratat e tij se atë e rrahën jashtë dhomës 1 dhe ia thyen dhëmbët, gjë që W01448 vuri re kur [REDAKTUAR] u kthye në dhomën 1.<sup>1488</sup> Edhe dëshmia e TW4-02-shit konfirmon se [REDAKTUAR] u keqtrajtua gjatë mbajtjes në ndalim.<sup>1489</sup> Po ashtu, TW4-02 deklaroi se, [REDAKTUAR] i tha se ai [REDAKTUAR] ishte keqtrajtuar gjatë mbajtjes në ndalim në FMK.<sup>1490</sup> Së fundi, Trupi Gjykses rikujton se, [REDAKTUAR], së paku edhe dy femra të tjera që mbaheshin të ndaluara në ndërtesën e ndalimit, u morën në pyetje dhe u keqtrajtuat gjatë periudhës që lidhet me akuzat.<sup>1491</sup> Duke qenë se Trupi Gjykses nuk mund të përcaktojë në mënyrë përfundimtare nëse [REDAKTUAR] (e cila u keqtrajtua së bashku me [REDAKTUAR] më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date) ishte njëra prej dy femrave që mbaheshin të ndaluara në ndërtesën e ndalimit,<sup>1492</sup> Trupi Gjykses konstaton se, krahas [REDAKTUAR], së paku edhe një femër tjetër që mbahej e ndaluar u mor në pyetje dhe u keqtrajtua në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

729. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm për faktin se dëshmitë e [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në lidhje me keqtrajtimin përkatësisht të TW4-02-shit dhe TW4-04-ës, përbëjnë dëshmi të dorës së dytë. Trupi Gjykses gjithashtu është i vetëdijshëm se si TW4-02, ashtu edhe TW4-04, mohuan se u keqtrajtuat gjatë ndalimit të tyre në

---

<sup>1486</sup> **TW4-01:** T. 31 maj 2023, publik, f. 1538, rreshti 15 deri në f. 1539, rreshti 3; **W01448:** SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837; SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013753.

<sup>1487</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 12.

<sup>1488</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013760-SITF00013761.

<sup>1489</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 7.

<sup>1490</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 4 (Pjesa 4), f. 10.

<sup>1491</sup> *Shih* para. 570 më lart.

<sup>1492</sup> *Shih* para. 571 më lart.



FMK.<sup>1493</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitë përkatëse të [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] se TW4-02 dhe TW4-04 u keqtrajtuuan gjatë ndalimit të tyre në FMK, janë përputhëse me prova të tjera të besueshme që iu paraqitën Trupit Gjykses, të cilat vërtetojnë keqtrajtimin e vazhdueshëm të të gjithë të ndaluarve që u mbajtën në ndërtesën e ndalimit. Gjithashtu, kur dhanë këto dëshmi, [REDAKTUAR] bënë dallim të qartë midis asaj që panë vetë dhe informacionit që morën prej të tjerëve, që i bënë edhe më të besueshme dëshmitë e tyre. Çka është e rëndësishme, Trupi Gjykses rikujton se, siç u konstatua më lart, TW4-02 dhe TW4-04 minimizuan trajtimin që pësuan gjatë ndalimit të tyre në FMK, dhe se ai nuk u jep peshë deklaratave të tyre në lidhje me këtë aspekt.<sup>1494</sup> Duke pasur këtë parasysh, Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në dëshmitë e dorës së dytë të [REDAKTUAR] në lidhje me keqtrajtimin e TW4-02-shit dhe TW4-04-ës gjatë ndalimit të tyre në FMK.

730. Trupi Gjykses më tutje vë në dukje se nuk ka marrë prova konkrete në lidhje me keqtrajtimin e djalit të [REDAKTUAR], i cili u mbajt në dhomën 1.<sup>1495</sup> Sidoqoftë, duke pasur parasysh dëshmitë dhe deklaratat reciprokisht konfirmuese të TW4-01-shit, TW4-11-shit, W04733-shit dhe W01448-ës, sipas të cilëve të gjithë të ndaluarit që u mbajtën në dhomën 1 u keqtrajtuuan para të ndaluarve të tjerë, dhe duke qenë se [REDAKTUAR] u mbajt në dhomën 1, Trupi Gjykses gjykon se përfundimi i vetëm i arsyeshëm bazuar në provat është se [REDAKTUAR] u keqtrajtua gjatë kohës që u mbajt i ndaluar në FMK.

731. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në provat në tërësi, Trupi Gjykses konstaton se TW4-04, TW4-02, [REDAKTUAR], dhe së paku edhe një femër tjetër e ndaluar, u keqtrajtuuan gjatë mbajtjes së tyre në ndalim në FMK.

---

<sup>1493</sup> **TW4-02:** 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 26; **TW4-04:** SITF00013336-00013347 RED, f. SITF0001339.

<sup>1494</sup> *Shih* Pjesët V.F.2 dhe V.F.3.

<sup>1495</sup> *Shih* Pjesën VI.D.10(e).

## (i) Puna e detyruar

732. Trupi Gjykues ka marrë prova se, gjatë kohës që lidhet me akuzat, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom ishin të vetmit të ndaluar që mund të largoheshin nga dhoma 1, pasi u detyruan të bënin punë krahu në FMK.

733. Në veçanti, TW4-01 dëshmoi se [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë rom “i kanë shti me bajt mallra ushqimore, këto, me i mbush kamionët te magazina”,<sup>1496</sup> dhe shtoi se: “sa herë ka pas nevojë magazina për ushqim, me i mbush kamionët, ose me palu diçka, kur kanë prurë ushqim, të gjithë i kanë marrë ata [romët]”.<sup>1497</sup> Dëshmia e TW4-11-shit dhe dëshmitë e W04733-shit dhe W01448-ës gjithashtu vërtetojnë faktin se [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u detyruan të punonin gjatë gjithë kohës së ndalimit të tyre.<sup>1498</sup> Deklarata e W04733-shit në lidhje me këtë është domethënëse: “Romët nuk flinin tërë natën. Ata i pastronin toaletet. Ata i trajtonin më keq. Ata ishin të diskriminuar, sepse ishin romë”.<sup>1499</sup> “Gjatë ditës deri në 10 kamiona vinin aty dhe e zbraznin mallin nga kamioni dhe pas mesnatës pastronin toaletet”, shpjegoi ai.<sup>1500</sup>

734. [REDAKTUAR].<sup>1501</sup> [REDAKTUAR].<sup>1502</sup> W01448, dëshmia e të cilit konfirmon se [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u detyruan të punonin gjatë gjithë kohës së ndalimit të tyre, dha një shembull të detyrave poshtëruese që ata detyroheshin të kryenin: “Këto toaleta ishin në kushte të mjerueshme, nuk mundje as t'i përdorje. Ishin shumë të papastra dhe ata i urdhëronin [REDAKTUAR] dhe romët që t'i

---

<sup>1496</sup> **TW4-01**: T. 6 qershor 2023, publik, f. 1918, rreshtat 10-14.

<sup>1497</sup> **TW4-01**: T. 6 qershor 2023, publik, f. 1918, rreshtat 15-17.

<sup>1498</sup> **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1219, rreshtat 4-13; **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185342; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745-00018746; 106978-107020, f. 106989; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013748.

<sup>1499</sup> **W04733**: SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185342.

<sup>1500</sup> **W04733**: 106978-107020, f. 107001.

<sup>1501</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1502</sup> [REDAKTUAR].

pastronin".<sup>1503</sup> Sipas W01448-ës: "Ata i dërgonin *vetëm* romët dhe [REDAKTUAR] t'i pastrojnë tualetet si dhe të ngarkojnë dhe zbarkojnë kamionët".<sup>1504</sup>

735. Deklaratat e W04733-shit dhe W01448-ës tregojnë më tej se, edhe ndërsa punonin, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom keqtrajtoheshin rëndë.<sup>1505</sup> Në një nga deklaratat e W04733-shit thuhet: "[REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom] rriheshin edhe gjatë ditës, derisa bënë punë të rënda fizike në oborr, ngarkonin dhe shkarkonin kamionë të mëdhenj. [...] Ata ankoheshin se rriheshin".<sup>1506</sup> Në një deklaratë tjetër, W04733 ngjashëm thotë: "Ata ishin të detyruar [të punonin] dhe të fyer", "Ata po shkarkonin kamionë dhe po rriheshin gjersa e bënë atë".<sup>1507</sup> Sipas W04733-shit, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom ishin të lënduar nga rrahjet e pësuar dhe i detyronin të punonin ashtu të lënduar.<sup>1508</sup> Ngjashëm, W01448 deklaroi se [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom ishin "të rrahur dhe shtyrë të punojnë në oborr".<sup>1509</sup> Në fund, Trupi Gjykes vë në dukje se W04733 deklaroi se z. Shala u përfshi në keqtrajtimin e [REDAKTUAR] dhe muzikantit të tretë rom, duke i rrahur dhe detyruar t'i pastronin banjat dhe shkarkonin kamionët.<sup>1510</sup>

736. Trupi Gjykes është i vetëdijshëm për një mospërputhje në deklaratat e W04733-shit në lidhje me nëse pa [REDAKTUAR] dhe muzikantin e tretë romë duke u keqtrajtuar gjatë kohës që punonin në oborrin e FMK-së,<sup>1511</sup> apo nëse ata i treguan se i kishin rrahur.<sup>1512</sup> Megjithatë, Trupi Gjykes vëren se deklaratat e W04733-shit gjatë

<sup>1503</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013749.

<sup>1504</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013858 (theksimi i shtuar).

<sup>1505</sup> **W01448:** SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016143; **W04733:** SPOE00185335-00185363 RED3, f. SPOE00185342; SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745-00018746; 106978-107020, f. 106989.

<sup>1506</sup> **W04733:** SITF00018740-00018767 RED, f. SITF00018745-00018746.

<sup>1507</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013824.

<sup>1508</sup> **W04733:** SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013824.

<sup>1509</sup> **W01448:** SITF00016140-00016220 RED 3, f. SITF00016143.

<sup>1510</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 6-7. Trupi Gjykes nuk bën konstatim faktik në lidhje me pjesëmarrjen e z. Shala në këtë aspekt.

<sup>1511</sup> **W04733:** 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 7.

<sup>1512</sup> **W04733:** 106978-107020, f. 106989.

viteve janë përputhëse sa i përket faktit se [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u keqtrajtuuan gjatë kohës që bënë punë të detyruar, dhe se për keqtrajtimin që pësonin u ankoheshin të ndaluarve të tjerë në dhomën 1. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se mospërputhja e përmendur më lart nuk ndikon mbështetshmërinë në dëshminë e W04733-shit në lidhje me këtë aspekt.

737. Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë e TW4-01-shit dhe TW4-11-shit dhe deklaratat e [REDAKTUAR], W04733-shit dhe W01448-ës janë tejet përputhëse sa i përket detyrave që [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom kryen gjatë mbajtjes në ndalim në FMK. Gjithashtu, Trupi Gjykses i gjykon përputhëse dëshmitë e TW4-01-shit, W01448-ës dhe W04733-shit se [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom nuk punuan me dëshirën e vet, por u detyruan, dhe se u keqtrajtuuan gjatë kryerjes së punës. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses mbështetet në dëshmitë reciprokisht konfirmuese, të hollësishme dhe të gjalla të TW4-01-shit, TW4-11-shit, [REDAKTUAR], W04733-shit dhe të W01448-ës sa i përket punës së krahut që [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u detyruan të bënin dhe keqtrajtimin të tyre.

738. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në provat e paraqitura, Trupi Gjykses konstaton se gjatë ndalimit të tyre në FMK, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u detyruan të bënin punë krahu. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u keqtrajtuuan gjatë kryerjes së punës së krahut.

### **3. Qëllimi i shkaktimit të dhimbjeve dhe vuajtjeve**

739. Provat e paraqitura para Trupit Gjykses tregojnë se të ndaluarit, përfshirë TW4-01, viktimat e vrasjes së paligjshme, TW4-11, W04733, W01448, TW4-05, TW4-04, TW4-02, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom, [REDAKTUAR], dhe së paku edhe një femër tjetër e ndaluar, u morën në pyetje nga anëtarë të UÇK-së, zakonisht gjatë natës, në një nga zyrat e ndërtesës së komandës ose në dhomën 2.

740. Më konkretisht, siç u konstatua nga Trupi Gjykses më lart, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme u morën në pyetje nga anëtarë të UÇK-së në zyrë dhe u akuzuan se bashkëpunonin me serbë dhe se ishin spiunë.<sup>1513</sup> Në veçanti, TW4-01 u mor në pyetje nga [REDAKTUAR] dhe u akuzua se [REDAKTUAR].<sup>1514</sup> TW4-01 u çua [REDAKTUAR] dy herë të tjera për t'u marrë në pyetje.<sup>1515</sup> Gjithashtu [REDAKTUAR], ndërsa po e keqtrajtonin, TW4-01-shin e detyruan të pranonte [REDAKTUAR].<sup>1516</sup>

741. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka konstatuar se edhe W04733 u mor në pyetje në zyrë disa herë, përfshirë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi dhe Sokol Dobruna.<sup>1517</sup> Dëshmitari u mor në pyetje në lidhje me punën e tij të dikurshme si polic dhe u akuzua se ishte tradhtar, vrasës, përdhunues dhe se bashkëpunonte me serbë.<sup>1518</sup> Për më tepër, ndërsa W04733 po merrej në pyetje dhe keqtrajtohej më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, z. Shala e akuzoi se ishte spiun.<sup>1519</sup>

742. Ngjashëm, Trupi Gjykses konstatoi se W01448 u mor në pyetje në zyrë shumë herë, përfshirë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, ndër të tjerë nga Fatmir Limaj, për aspekte si e kaluara e tij, shërbimi ushtarak, vendndodhja para lufte dhe marrëdhëniet e tij me serbët.<sup>1520</sup> Dëshmitarit iu kërkua që t'i jepte përgjigjet në deklaratë me shkrim.<sup>1521</sup>

---

<sup>1513</sup> *Shih* para. 656 më lart.

<sup>1514</sup> *Shih* para. 656 më lart.

<sup>1515</sup> *Shih* para. 404 më lart.

<sup>1516</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1517</sup> *Shih* para. 471 më lart.

<sup>1518</sup> *Shih* para. 471 më lart.

<sup>1519</sup> *Shih* para. 706 më lart.

<sup>1520</sup> *Shih* para. 491 më lart.

<sup>1521</sup> *Shih* para. 491 më lart.

743. Sa i përket TW4-05-ës, Trupi Gjykses konstatoi se [REDAKTUAR].<sup>1522</sup> Dëshmitari u mor në pyetje edhe tri herë të tjera në ndërtesën e komandës, gjithmonë gjatë natës. Gjatë të gjitha herëve, TW4-05 u mor në pyetje [REDAKTUAR], me pjesëmarrjen e anëtarëve të tjerë të UÇK-së. Secilën herë, dëshmitari u pyet dhe u akuzua se kishte lidhje shoqërore me serbët, [REDAKTUAR].<sup>1523</sup>

744. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] i sollën në zyrë dhe ndërsa i keqtrajtonin fizikisht, i akuzuan se kishin marrëdhënie me serbë.<sup>1524</sup> Në të njëjtin rast, [REDAKTUAR] e mori në pyetje z. Shala, i cili i kërkoi të pranonte se [REDAKTUAR] ishin bashkëpunëtorë të serbëve.<sup>1525</sup>

745. Siç konstatoi Trupi Gjykses, gjatë mbajtjes në ndalim TW4-02-shin e akuzuan se ishte “spion” dhe “bashkëpunëtor” i Serbisë.<sup>1526</sup> Atë e mori në pyetje në disa raste edhe z. Kryeziu, në një nga zyrat në ndërtesën e komandës.<sup>1527</sup> Z. Kryeziu gjithashtu mori në pyetje TW4-04-ën dhe TW4-11-shin. Në veçanti, z. Kryeziu mori në pyetje TW4-04-ën dhe i kërkoi të jepte deklaratë me shkrim, me të dhënat e tij personale dhe informacion për të kaluarën dhe arrestimin e tij.<sup>1528</sup> Sa i përket TW4-11-shit, z. Kryeziu e mori në pyetje për profesionin e tij para lufte, si dhe për vendndodhjen e tij gjatë luftës.<sup>1529</sup>

746. Së fundi, Trupi Gjykses konstatoi se gjatë mbajtjes në ndalim, [REDAKTUAR] u mor në pyetje dhe u akuzua se bashkëpunonte me serbë.<sup>1530</sup> Sikurse të ndaluarit e tjerë,

---

<sup>1522</sup> *Shih* para. 497 më lart.

<sup>1523</sup> *Shih* para. 509 më lart.

<sup>1524</sup> *Shih* para. 720 më lart.

<sup>1525</sup> *Shih* para. 720 më lart.

<sup>1526</sup> *Shih* para. 532 më lart.

<sup>1527</sup> *Shih* para. 552 më lart.

<sup>1528</sup> *Shih* para. 529 më lart.

<sup>1529</sup> *Shih* para. 435 më lart.

<sup>1530</sup> *Shih* para. 576 më lart.

[REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom u morën në pyetje gjatë mbajtjes në ndalim në FMK, siç ka konstatuar Trupi Gjykes gjetiu.<sup>1531</sup>

747. Trupi Gjykes vë në dukje se nuk mori prova konkrete në lidhje me marrjen në pyetje të [REDAKTUAR]. Sidoqoftë, Trupi Gjykes i kushton vëmendje të veçantë dëshmime të TW4-11-shit, W04733-shit, W01448-ës dhe TW4-05-ës se gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar, të gjithë të ndaluarit u morën dhe çuan për t'u marrë në pyetje.<sup>1532</sup> Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, marrë së bashku, vërtetojnë praktikën e marrjes së të ndaluarve nga dhomat 1 dhe 3, shpeshherë gjatë natës, për t'u marrë në pyetje në ndërtesën e komandës ose në dhomën 2, ku disa prej tyre u keqtrajtuuan rëndë. Duke pasur këto parasysh, Trupi Gjykes gjykon se i vetmi përfundim i arsyeshëm bazuar në provat është se [REDAKTUAR] u morën në pyetje në FMK.

#### 4. Përfundim

748. Duke pasur parasysh të gjitha provat e diskutuara më lart marrë në tërësi, Trupi Gjykes konstaton se afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, të ndaluarit në FMK, ndër të cilët TW4-01, viktimat e vrasjes së paligjshme, TW4-11, W04733, W01448, TW4-05, TW4-04, TW4-02, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom, [REDAKTUAR], dhe së paku edhe një i ndaluar tjetër, u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese. Të ndaluarit u mbajtën në dhoma të vogla pa krevate. Anëtarë të UÇK-së nuk i linin të flinin, i ngacmonin nga dritaret ose u hynin në dhomë gjatë natës dhe i keqtrajtonin. Të ndaluarve gjithashtu nuk iu dha ushqim dhe ujë i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, dhe nuk u lejuan të laheshin ose t'i ndërronin teshat. Ata duhej të merrnin leje për të përdorur banjat, të cilat ishin në gjendje të keqe, dhe gjithmonë i

---

<sup>1531</sup> *Shih* para. 560 më lart.

<sup>1532</sup> **W04733**: SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013823; 106978-107020, f. 106988; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013856; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743; **TW4-11**: T. 2 maj 2023, publik, f. 1222, rreshtat 16-24; **TW4-05**: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013131.

shoqëronin kur shkonin atje. Të ndaluarve nuk iu dha ndihmë mjekësore e mjaftueshme ose iu refuzua ndihma mjekësore. Midis të tjerash, të ndaluarve nuk iu lejua të komunikonin dhe flisnin me njëri-tjetrin.

749. Të ndaluarit, ndër të cilët TW4-01, viktimi e vrasjes së paligjshme, TW4-11, W04733, W01448, TW4-05, TW4-04, TW4-02, [REDAKTUAR] dhe muzikanti i tretë rom, [REDAKTUAR], dhe së paku edhe një femër tjetër e ndaluar, u keqtrajtuat fizikisht dhe psikologjikisht nga disa anëtarë të UÇK-së. Nganjëherë të ndaluarit i rrihnin gjatë natës deri në orët e hershme të mëngjesit, i detyronin të godisnin njëri-tjetrin, ndër të tjera me shuplaka, dhe, në rastin e të ndaluarve meshkuj, të shtireshin sikur bënin marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin. Ata gjithashtu u detyruan të shihnin dhe të dëgjonin të ndaluarit e tjerë që keqtrajtoheshin fizikisht. Ata u ngacmuan, u gënjyen dhe u kërcënuan me dhunë ose me vdekje. Si pasojë, të ndaluarit jetonin në frikë të vazhdueshme se mund të keqtrajtoheshin fizikisht ose edhe të vriteshin në çdo moment.

750. Gjithashtu, të ndaluarit u morën në pyetje, më së shpeshti gjatë natës, në zyrat e ndërtesës së komandës ose në dhomën 2. Ata u pyetën për vendin e punës, vendndodhjen gjatë dhe para luftës, nëse njihnin apo kishin lidhje me serbë dhe bashkëpunëtorë të serbëve. Ata u akuzuan se ishin spiunë, tradhtarë, vrasës, përdhunues, ose se ishin bashkëpunëtorë të pretenduar të serbëve. Disa u detyruan të jepnin deklaratat me shkrim me këtë informacion. Gjatë këtyre marrjeve në pyetje, disa prej të ndaluarve, konkretisht TW4-01, viktimi e vrasjes së paligjshme, W04733 dhe W01448, u rrahën brutalisht dhe u keqtrajtuat në forma të tjera nga anëtarë të UÇK-së: ata u rrahën me shkopinj gome dhe shkopinj bejsbolli në të gjithë trupin, u goditën me shkelma dhe me grushte, u prenë me thika, u dogjën me cigare, iu hodh kripë në plagë dhe u qëlluan me armë zjarri. Keqtrajtimi i tyre vazhdoi derisa u mavijosën dhe mbuluan në gjak, humbën vetëdijen dhe/ose nuk mund të qëndronin në këmbë.



751. Keqtrajtimi dhe ngacmimi i të ndaluarve vazhdonte gjatë ditës dhe kryhej edhe në vende të tjera brenda parametrimit të FMK-së krahas ndërtesës së komandës dhe ndërtesës së ndalimit. Të ndaluarit ngacmoheshin kur shkonin në banjë dhe disa prej tyre u rrahën gjatë kohës kur bënin punë të detyruar.

752. Duke pasur parasysh të gjitha provat e diskutuara më lart marrë në tërësi, Trupi Gjyqësor konstaton se kushtet çnjerëzore të ndalimit dhe keqtrajtimi fizik dhe psikologjik i të ndaluarve kishin për qëllim marrjen e informacionit ose të deklaratave pranuese prej tyre dhe/ose ndëshkimin, frikësimin, shtrëngimin dhe/ose diskriminimin e tyre për arsye politike.

753. Tortura fizike dhe psikologjike, si dhe kushtet çnjerëzore të ndalimit u shkaktuan të ndaluarve lëndime afatgjata fizike dhe mendore, si: lëndime në kokë, djegie, bërryl të thyer, dhëmbë të thyer, dhimbje të madhe e të vazhdueshme në tërë trupin, ndjenjë të turpërimit, frikë (*p.sh.* për të shkuar në punë ose për të dalë jashtë vetëm) dhe cenueshmëri (në lidhje me veten ose me anëtarë të familjes) dhe ÇSPT (makthe, fanitje të ngjarjeve traumatike dhe kujtime tronditëse të pavullnetshme).

#### F. VRASJA E PALIGJSHME (PIKA 4)

754. Në këtë pjesë, Trupi Gjyqësor do të vlerësojë provat dhe do të bëjë konstatime faktike në lidhje me Pikën 4 të Aktakuzës së Konfirmuar, nëse viktima e vrasjes së paligjshme u vra nga disa anëtarë të caktuar të UÇK-së në FMK, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1533</sup>

755. Trupi Gjyqësor do të trajtojë me radhë: (i) qëllimin me armë zjarri të viktimës së vrasjes së paligjshme, që ndodhi më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, dhe rrethanat e vdekjes së tij më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date; (ii) shkakun e vdekjes; (iii) [REDAKTUAR]; (iv) praninë dhe rolin e z. Shala në dhomën 2 natën kur viktima

---

<sup>1533</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 28, 31.

e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri; (v) praninë dhe rolin e anëtarëve të tjerë të UÇK-së, veçanërisht të Xhemshit Krasniqit; (vi) identifikimin e kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme; dhe (vii) [REDAKTUAR].

## 1. Qëllimi me armë zjarri i viktimës së vrasjes së paligjshme dhe rrethanat e vdekjes së tij

756. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se ka bërë konstatim gjyqësor të faktit të shqyrtuar në procese të tjera se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur mbahej në ndalim në FMK.<sup>1534</sup> Ky fakt u shqyrtua nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë në gjykimin *Sabit Geci dhe të tjerët*<sup>1535</sup> dhe nuk u apelua.<sup>1536</sup> Në vijim, Trupi Gjykses do të diskutojë provat e paraqitura në këtë çështje gjyqësore në lidhje me rrethanat e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.

757. Trupi Gjykses ka konstatuar më lart se mbrëmjen e 4 qershorit 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] u keqtrajtoi fizikisht gjatë tërë natës nga një grup anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala, Xhemshit Krasniqi, Bedriu, Van Dami dhe së paku tre ose katër anëtarë të tjerë të UÇK-së.<sup>1537</sup>

---

<sup>1534</sup> [List of Adjudicated Facts](#) (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), fakti i shqyrtuar 56.

<sup>1535</sup> [Sabit Geci et al. Verdict](#) (Aktgjykimi në çështjen *Sabit Geci dhe të tjerët*), para. 122.

<sup>1536</sup> Gjykata e Apelit të Kosovës, *Prokurori kundër Sabit Gecit dhe të tjerëve*, PAKR 966/2012, [Judgment](#) (Aktgjykimi) 11 shtator 2013, para. 69-74.

<sup>1537</sup> *Shih* para. 674-683, 688 më lart. Të gjitha referencat në këtë pjesë ndaj anëtarëve të UÇK-së të pranishëm në dhomën 2 në natën 4 qershorit 1999, ose rreth kësaj date, kur viktima e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri, i referohen këtij grupi të anëtarëve të UÇK-së. Kur dëshmitarët identifikuan anëtarë të veçantë të UÇK-së që luajtën role të veçanta, Trupi Gjykses e ka specifikuar këtë.

758. [REDAKTUAR]<sup>1538</sup> – [REDAKTUAR] viktimën e vrasjes së paligjshme e qëlluan me armë zjarri në këmbë, nën gju.<sup>1539</sup> [REDAKTUAR].<sup>1540</sup> [REDAKTUAR],<sup>1541</sup> [REDAKTUAR].<sup>1542</sup>

759. Siç është përshkruar më lart, [REDAKTUAR] viktimën e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] çuan përsëri në dhomën 1, ku mbaheshin shumica e të ndaluarve të tjerë.<sup>1543</sup> [REDAKTUAR] gjendjen në të cilën ishte viktimja e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] kthyen në dhomën 1. Ai shpjegoi se viktimës së vrasjes së paligjshme i rridhte gjak nga plaga me armë zjarri dhe se gjakderdhja nuk ndalej, me gjithë përpjekjet e disa të ndaluarve të tjerë për t'ia lidhur plagën me këmishët e tyre.<sup>1544</sup> [REDAKTUAR] gjithashtu përshkroi në mënyrë të gjallë se si viktimja e vrasjes së paligjshme nuk ishte në gjendje të ecte nga keqtrajtimi, se kishte mavijosje në të gjithë trupin, dhe se “u ënjt në bark” sepse nuk mund të urinonte.<sup>1545</sup>

760. [REDAKTUAR], më vonë erdhi një mjek dhe u përpoq ta ndihmonte viktimën e vrasjes së paligjshme të urinonte artificialisht, duke përdorur “cevat”, dhe i vuri këmbën në gips për të ndalur gjakderdhjen, por asnjëra procedurë nuk pati sukses.<sup>1546</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se mjeku i këshilloi anëtarët e UÇK-së të pranishëm që ta çonin viktimën e vrasjes së paligjshme në spitalin e Kukësit, se përndryshe nuk do të mbijetonte.<sup>1547</sup> Megjithatë, [REDAKTUAR], “Xhemshiti e këta” – siç tha ai – nuk lejuan të çohet në spital, duke thënë: “S’ja kena bo këtë dajak, tha, për me e çu tek mjeku”.<sup>1548</sup>

---

<sup>1538</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1539</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1540</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1541</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1542</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1543</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1544</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1545</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1546</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1547</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1548</sup> [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR] nuk mbante mend se kush saktësisht refuzoi transferimin e viktimës së vrasjes së paligjshme në spital. Ai tha se ishin “këta të mëdhejt”, “Xhemshiti e këta”, “shtabi”.<sup>1549</sup> Kur e pyetën se kush mendonte se ishte përgjegjës, [REDAKTUAR] shpjegoi se përgjegjës për të ndaluarit ishte Xhemshit Krasniqi, por kurdo që Sabit Geci ishte aty, ai (d.m.th. Sabit Geci) ishte përgjegjës.<sup>1550</sup>

761. [REDAKTUAR] viktimia e vrasjes së paligjshme vdiq të nesërmen, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, në dhomën 1, kur mbahej në ndalim.<sup>1551</sup> [REDAKTUAR].<sup>1552</sup>

762. [REDAKTUAR] konfirmohet pjesërisht nga W01448 dhe TW4-11, të cilët e panë viktimën e vrasjes së paligjshme pasi e sollën në dhomën 1 dhe dëshmuan se kishte një plagë nga armë zjarri afër gjurit dhe kishte gjakderdhje.<sup>1553</sup> W01448 përshkroi në mënyrë të gjallë këto ngjarje: “Gjithë natën, [viktimia e vrasjes së paligjshme] nuk mund të flinte. Ka pasur gjakderdhje të madhe. Ne u munduam të vendosim disa qebe në plagët e tij por gjakderdhja nuk po ndalej. Qebet u bënë të kuqe”.<sup>1554</sup> [REDAKTUAR] ai tha se viktimia e vrasjes së paligjshme nuk mund të urinonte dhe pasi piu ujë, “stomaku i [...] është fryrë si i demit”.<sup>1555</sup> W01448-ës nuk i kujtohej të kishte parë ndonjë mjek,<sup>1556</sup> por tha se viktimia e vrasjes së paligjshme vdiq një apo dy ditë pasi ishte qëlluar me armë zjarri, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur mbahej ende në ndalim në dhomën 1.<sup>1557</sup> Sipas W01448-ës, viktimia e vrasjes së

<sup>1549</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1550</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1551</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1552</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1553</sup> *Shih* para. 678-680 më lart.

<sup>1554</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859. *Shih gjithashtu*, SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013753; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016239.

<sup>1555</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859. *Shih gjithashtu*, SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013755; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016238.

<sup>1556</sup> **W01448**: SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013756.

<sup>1557</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859; SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013749, SITF00013755; SITF00016221-00016285 RED4, f. SITF00016238; SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016141, SITF00016158.

paligjshme i kishte thënë se në këmbë e qëllloi me armë zjarri Lima(n) Geci.<sup>1558</sup> TW4-11-shit i kujtohej – ashtu sikurse TW4-01-shit – se erdhi një mjek,<sup>1559</sup> por se viktima a vrasjes së paligjshme vdiq pak më pas kur ende mbahej i ndaluar në dhomën 1.<sup>1560</sup>

763. Trupi Gjykues konstaton se dëshmitë e [REDAKTUAR], TW4-11-shit dhe W01448-ës në lidhje me rrethanat e qëllimit me armë zjarri dhe vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme janë tejet të besueshme dhe në to mund të mbështetesh. Së pari, përshkrimet e hollësishme dhe të gjalla të dhëna nga këta dëshmitarë tregojnë se ata i përjetuan personalisht këto ngjarje. Për shembull, që të tre dëshmitarët dëshmuuan se viktima e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri afër gjurit. Kjo është një hollësi që asnjëri prej tyre nuk ka mundur ta dinte po të mos kishte qenë vet i pranishëm [REDAKTUAR] dhomën 1 ku u soll pas qëllimit me armë zjarri. Siç [REDAKTUAR] konfirmoi dr. Gasiori, kur ishte në dhomën 1, viktimës së vrasjes së paligjshme i vendosën fashë gjipsi në këmbë, e cila nuk ishte hequr deri në vitin 2009, kur u krye autopsia e kufomës së tij.<sup>1561</sup>

764. Së dyti, dëshmitarët dhanë dëshmi dhe/ose deklaratat përrputhëse, që përforcon bindjen e Trupit Gjykues se dëshmitë e tyre u dhanë me vërtetësi. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues vë në dukje se Mbrojtja ka kundërshtime në lidhje me hollësitë e pakta të dhëna nga [REDAKTUAR] në një nga deklaratat e tij të mëparshme për trajtimin mjekësor që iu ofrua viktimës së vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR].<sup>1562</sup> Trupi Gjykues kujton se fakti që dëshmitarët japin shkallë të ndryshme të hollësive në kohë të ndryshme në vetvete nuk do të thotë se dëshmitë e tyre janë mospërrputhëse ose se

---

<sup>1558</sup> **W01448:** SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859; SITF00374558-00374558 RED, para. 3; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837.

<sup>1559</sup> **TW4-11:** T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1253, rreshtat 5-8; f. 1257, rreshtat 2-12.

<sup>1560</sup> **TW4-11:** T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1257, rreshti 13 deri në f. 1258, rreshti 14, që i referohet deklaratës së mëparshme të TW4-11-shit : SITF00019898-00019956 RED4, f. SITF00019909.

<sup>1561</sup> *Shih* para.768 më poshtë; **Dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, publik, f. 2075, rreshti 17 deri në f. 2076, rreshti 1 (“U gjet një fashë gjipsi në këmbën e djathtë. Fasha e gjipsit u hoq”); **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031051 (“Gjipsi u hoq”).

<sup>1562</sup> [REDAKTUAR].

në to nuk mund të mbështetesh. Në rastin konkret, është e pritshme [REDAKTUAR] të jetë më e hollësishme se [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk gjykon se fakti që [REDAKTUAR] shtoi disa hollësi [REDAKTUAR] ndikon në besueshmërinë e tij.

765. Së treti dhe më e rëndësishmja, dëshmitarët konfirmojnë njëri-tjetrin për faktet dhe rrethanat kyçe në lidhje me vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme: (i) fakti që viktima e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri në këmbë, afër gjurit,<sup>1563</sup> [REDAKTUAR];<sup>1564</sup> (ii) fakti që ai kishte gjakderdhje nga plaga e shkaktuar me armë zjarri dhe nuk mund të urinonte; dhe (iii) fakti që ai vdiq jo shumë kohë pasi ishte qëlluar me armë zjarri, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur mbahej ende në ndalim në dhomën 1. Shkalla e hollësive dhe përputhshmëria e dëshmive të [REDAKTUAR], TW4-11-shit dhe W01448-ës në lidhje me faktet kyçe, shumë vite pas ngjarjeve, e bindin Trupin Gjykses se kjo nuk mund të jetë thjesht rastësi.

766. Mbrojtja ka kundërshtim edhe për faktin se disa hollësi (të tjera) të dhëna nga [REDAKTUAR] nuk konfirmohen as nga TW4-11, e as nga W01448, si fakti se anëtarë të UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit refuzuan transferimin e viktimës së vrasjes së paligjshme në spital.<sup>1565</sup> Trupi Gjykses vëren se TW4-11 dhe W01448 në fakt konfirmojnë [REDAKTUAR] se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq kur ende mbahej i ndaluar në dhomën 1. Rrjedhimisht, qëndron fakti se ai nuk u çua në spital dhe se vdiq në ndalim në FMK.

---

<sup>1563</sup> Nuk ka rëndësi nëse plaga nga arma e zjarrit ishte mbi gju, siç dëshmoi TW4-11, apo nën gju, siç deklaroi W01448. Kjo mospërputhje nuk është aq e rëndësishme sa të hedhë dyshime në besueshmërinë e dëshmive të dëshmitarëve në lidhje me këtë aspekt. Të dy dëshmitarët dëshmuuan se plaga ishte rreth gjurit, një aspekt që – siç do të tregohet më poshtë – konfirmohet nga provat mjekoligjore.

<sup>1564</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1565</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 172.

767. Trupi Gjykues është i vetëdijshëm edhe për hollësi të tjera në të cilat dallojnë dëshmitë e dëshmitarëve. Për shembull, dëshmia e TW4-11-shit në lidhje me ndërhyrjen e mjekut përmban më pak hollësi se [REDAKTUAR], ndërsa W01448-ës nuk i kujtohej fare prania e mjekut.<sup>1566</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykues nuk konstaton se kjo ndikon në besueshmërinë e tyre në lidhje me aspektet thelbësore të dëshmive. Siç e pranoi edhe vetë, TW4-11 nuk ishte – në atë kohë – afër viktimës së vrasjes së paligjshme,<sup>1567</sup> kështu që është e natyrshme që mbante mend më pak hollësi. [REDAKTUAR]. Trupi Gjykues kujton se dëshmitarët i përjetojnë dhe perceptojnë ngjarjet në mënyrë të ndryshme, që mund të jetë sepse nuk janë në gjendje fizikisht t'i perceptojnë të gjitha hollësitë, ose sepse u japin rëndësi të ndryshme ngjarjeve që perceptojnë.<sup>1568</sup> Sidoqoftë, shumica e mospërputhjeve midis dëshmive të dëshmitarëve janë të vogla dhe me pak ose fare pa relevancë ([REDAKTUAR]).<sup>1569</sup> Në fakt, ato i bëjnë dëshmitë e tyre më të besueshme. Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes<sup>1570</sup> dhe siç argumentohet me të drejtë nga ZPS-ja,<sup>1571</sup> kjo tregon se dëshmitë e tyre nuk janë përputhëse në atë masë që të shkaktojnë dyshime për marrëveshje.

768. Së fundi, dëshmitë e dëshmitarëve konfirmohen në masë të konsiderueshme edhe nga provat e ekspertit mjekoligjor. Aktautopsia e dr. Gasiorit (“Aktautopsia”) dhe dëshmia gojore e tij vërtetojnë se viktima e vrasjes së paligjshme pësoi plagë nga armë zjarri në këmbën e djathtë, afër gjurit, të përputhshme me tre plumba, që goditën femurin dhe tibian.<sup>1572</sup> Aktautopsia gjithashtu vë në dukje se në kufomën e viktimës

---

<sup>1566</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 166-170; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 166-167.

<sup>1567</sup> **TW4-11**: T. 3 maj 2023, konfidencial, f. 1245, rreshtat 9-10; f. 1249, rreshtat 18-19; f. 1254, rreshtat 3-4; f. 1257, rreshtat 6-12.

<sup>1568</sup> *Shih* para. 83 më lart.

<sup>1569</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1570</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 255-265.

<sup>1571</sup> T. 15 prill 2024, publik, f. 4118, rreshtat 1-24.

<sup>1572</sup> **Aktautopsia**: 031049-031095 RED2, f. 031051, 031055, 031059, 031065-031069 (fotografitë 29-53), 031091; **Dr. Gasior**: T. 26 qershor 2023, publik, f. 2087, rreshti 1 deri në f. 2089, rreshti 10; f. 2092, rreshti

së vrasjes së paligjshme, dr. Gasiori gjeti: (i) një kateter/tub që shkonte në fshikëzën e urinës, me qese mjekësore për mbledhjen e urinës;<sup>1573</sup> dhe (ii) fashë gjipsi në këmbën e viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1574</sup> Qesja mjekësore dhe fasha e gjipsit shihen në fotografitë e kufomës të bëra gjatë autopsisë.<sup>1575</sup> Rrjedhimisht, dëshmia si ekspert e dr. Gasiorit konfirmon fuqimisht [REDAKTUAR], TW4-11-shit dhe W01448-ës se viktimia e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri dhe u plagos afër gjurit.<sup>1576</sup> Ajo gjithashtu konfirmon dëshminë e TW4-01-shit se erdhi një mjek i cili u përpoq ta ndihmonte viktimën e vrasjes së paligjshme që të urinonte artificialisht, duke përdorur “ceva”, dhe i vendosi fashë gjipsi në këmbë për t’i ndalur gjakderdhjen. Siç është përmendur më lart, prania e këtyre elementeve bindëse [REDAKTUAR] përputhet me dëshminë e dikujt që i përjetoi personalisht ngjarjet, dhe Aktautopsia e përforcon plotësisht [REDAKTUAR] në këtë aspekt.

769. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se dëshmitë e [REDAKTUAR], TW4-11-shit dhe W01448-ës në lidhje me faktet dhe rrethanat e qëllimit me armë zjarri dhe të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme janë të besueshme dhe në to mund të mbështetesh. Përveç dëshmive të tre dëshmitarëve, Trupi Gjykues gjithashtu mbështetet në dëshminë e dëshmitarit ekspert, dr. Gasiorit, e cila i konfirmon ato.

---

10 deri në f. 2093, rreshti 25, që i referohet Aktautopsisë: 031049-031095 RED2, f. 031065 (fotografia 29, e ruajtur si REG00960), f. 031068 (fotografitë 43, 44); T. 3 korrik 2023, publik, f. 2170, rreshtat 8-11.

<sup>1573</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031050; **Dr. Gasior:** T. 3 korrik 2023, publik, f. 2165, rreshti 18 deri në f. 2166, rreshti 21, që i referohet Aktautopsisë: 031049-031095 RED2, f. 031063 (fotografitë 15, 16); f. 2188, rreshti 19 deri në f. 2189, rreshti 25.

<sup>1574</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031051; **Dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, publik, f. 2075, rreshti 17 deri në f. 2078, rreshti 22, që i referohet Aktautopsisë: 031049-031095 RED2, f. 301056, 301057 (ruajtur si REG00959, ku Dr. Gasior shënoi fashën e gjipsit në fotografi të kufomës), f. 031062 (fotografia 12), f. 031063 (fotografitë 13, 14).

<sup>1575</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031056-031058, 031060, 031062-031064 (fotografitë 11-22), 031070 (fotografia 57).

<sup>1576</sup> [REDAKTUAR].



770. Trupi Gjykues gjithashtu mori dëshminë e TW4-05-ës se nuk pa askënd të vdiste dhe as dëgjoi se ndokush kishte vdekur në FMK, [REDAKTUAR].<sup>1577</sup> Sidoqoftë, dëshmia e tij nuk ndryshon konstatimet e mëparshme të Trupit Gjykues për arsyet në vijim. Së pari, fakti që viktimja e vrasjes së paligjshme vdiq në dhomën 1 në ndërtesën e ndalimit më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, është vërtetuar nga dëshmitë reciprokisht konfirmuese dhe përputhëse të [REDAKTUAR], TW4-11-shit dhe W01448-ës, dhe nuk është kontestuar.

771. Së dyti, deklarata e TW4-05-ës se nuk pa askënd të vdiste në FMK përgënjeshtrohet nga W01448, i cili konfirmoi në një nga deklaratat e tij me shkrim se TW4-05 në fakt ishte në dhomën 1 kur vdiq viktimja e vrasjes së paligjshme.<sup>1578</sup> [REDAKTUAR].<sup>1579</sup> [REDAKTUAR].<sup>1580</sup> [REDAKTUAR].

772. Së treti, deklarata e TW4-05-ës se nuk dëgjoi që ndokush të kishte vdekur në FMK, është jo e besueshme.<sup>1581</sup> Siç është konstatuar më lart, TW4-05 u mbajt në dhomën 1,<sup>1582</sup> ku mbaheshin shumica e të ndaluarve, ndër të cilët viktimja e vrasjes së paligjshme. Kur vdiq viktimja e vrasjes së paligjshme, TW4-05 ishte ende i ndaluar në FMK.<sup>1583</sup> Edhe po të supozohet se TW4-05 nuk ishte në dhomën 1 kur vdiq viktimja a vrasjes së paligjshme, ai duhet të ketë vënë re se viktimja e vrasjes së paligjshme nuk ishte më i pranishëm pas afërsisht 5 qershorit 1999, [REDAKTUAR]. Ai gjithashtu duhet të ketë mësuar për vdekjen e tij prej të ndaluarve të tjerë. Vdekja e viktimës së

---

<sup>1577</sup> **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372501; SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013133-SITF00013134.

<sup>1578</sup> **W01448:** SITF00016140-00016220 RED3, f. SITF00016141, që i referohet TW4-05-ës si dëshmitari G.

<sup>1579</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1580</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1581</sup> **TW4-05:** SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013133-SITF00013134.

<sup>1582</sup> *Shih* para. 503 më lart; *shih gjithashtu*, **TW4-05:** SITF00372498-00372510 RED4, f. SITF00372500-SITF00372501; SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013128-SITF00013129, SITF00013131-SITF00013132, ku shpjegon se qëndroi në dhomë së bashku me “këta romë [muzikantë]” dhe W01448-ën.

<sup>1583</sup> *Shih* para. 506-508 më lart.

vrasjes së paligjshme duhet të ketë qenë ngjarje e rëndësishme për ta, duke pasur parasysh se – siç pranoi edhe vetë TW4-05 – jetonin në frikë të vazhdueshme se do të vriteshin.<sup>1584</sup>

773. Së fundi, Trupi Gjykses rikujton se TW4-05 minimizoi shkallën e keqtrajtimit që pësuan ai dhe të ndaluarit e tjerë.<sup>1585</sup> Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se TW4-05 nuk është i besueshëm dhe nuk i jep peshë dëshmisë së tij në lidhje me këtë aspekt.

## 2. Shkaku i vdekjes

774. Siç është diskutuar më lart, dëshmitë përputhëse dhe reciprokisht konfirmuese të [REDAKTUAR], TW4-11-shit dhe W01448-ës konfirmojnë se viktimi e vrasjes së paligjshme pati gjakderdhje të madhe nga plaga me armë zjarri në këmbë. Dëshmitë e tyre konfirmohen nga provat mjekoligjore të dr. Gasiorit.

775. Gjithashtu, sipas Aktautopsisë së dr. Gasiorit, shkaku i vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme ishte “goditje me armë zjarri në këmbën e djathtë”.<sup>1586</sup> Gjatë dëshmisë, dr. Gasiori shpjegoi me më shumë hollësi se plumbat goditën një arterie që kalon nëpër një hapësirë në gju (*intercondylar fossa*), e cila furnizon me gjak gjithë këmbën, dhe shkaktuan shkatërrimin e plotë të arteries dhe gjakderdhjen.<sup>1587</sup> Ai shtoi se lëndime të tilla të shkaktuara me armë zjarri, në qoftë se nuk trajtohen shpejt dhe si

---

<sup>1584</sup> *Shih* para. 649, 652 më lart; **TW4-05**: SITF00013123-SITF00013153 RED, f. SITF00013134 (“veten e kam llogaritë si të vdekur”).

<sup>1585</sup> *Shih* para. 141 më lart.

<sup>1586</sup> **Aktautopsia**: 031049-031095 RED2, f. 031052.

<sup>1587</sup> **Dr. Gasior**: T. 26 qershor 2023, publik, f. 2094, rreshti 6 deri në f. 2095, rreshti 5; T. 3 korrik 2023, publik, f. 2201, rreshtat 6-8; SPOE00332269-00332269; SPOE00332272-00332272.

duhet, shkaktojnë vdekjen si rezultat i gjakderdhjes ose ndërlikimeve të tjera nga lëndimet e pësuar.<sup>1588</sup>

776. Dr. Gasiori gjithashtu dëshmoi se fasha e gjipsit nuk mund ta ndalte “gjakderdhjen e madhe nga arteria e dëmtuar” dhe se “vetëm ndërhyrja e duhur dhe e shpejtë kirurgjike [...] mund të krijonte mundësi për ta shpëtuar pacientin”.<sup>1589</sup>

777. Po aq me rëndësi, dr. Gasiori vlerësoi se koha nga goditja me armë zjarri deri në vdekje ishte “e shkurtër”,<sup>1590</sup> “maksimumi pak ditë”,<sup>1591</sup> pasi ai nuk kishte parë prova se kocka kishte filluar të shërohej.<sup>1592</sup> Në këtë aspekt, dëshmia e tij konfirmon fuqishëm dëshmitë e [REDAKTUAR], TW4-11-shit dhe W01448-ës se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq një apo dy ditë pasi ishte qëlluar me armë zjarri.

778. Aktautopsia e qartë e dr. Gasiorit dhe dëshmia e tij e qartë dhe e drejtpërdrejtë si ekspert, së bashku me dëshmitë e [REDAKTUAR], TW4-11-shit dhe W01448-ës, të cilat konfirmojnë njëra-tjetrën, vërtetojnë se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq nga pasojat e plagës me armë zjarri në këmbë dhe refuzimit të trajtimit mjekësor të duhur.

### 3. [REDAKTUAR]

779. [REDAKTUAR],<sup>1593</sup> [REDAKTUAR].<sup>1594</sup>

---

<sup>1588</sup> **Dr. Gasior:** T. 27 qershor 2023, publik, f. 2113, rreshtat 13-25; *shih gjithashtu*, T. 3 korrik 2023, publik, f. 2173, rreshtat 17-19; f. 2201, rreshtat 6-8.

<sup>1589</sup> **Dr. Gasior:** T. 3 korrik 2023, publik, f. 2201, rreshti 9 deri në f. 2202, rreshti 2.

<sup>1590</sup> **Dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, publik, f. 2094, rreshti 6 deri në f. 2095, rreshti 5.

<sup>1591</sup> **Dr. Gasior:** T. 3 korrik 2023, publik, f. 2172, rreshti 12 deri në f. 2173, rreshti 16.

<sup>1592</sup> **Dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, publik, f. 2095, rreshtat 3-4.

<sup>1593</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1594</sup> [REDAKTUAR].

780. [REDAKTUAR];<sup>1595</sup> [REDAKTUAR]<sup>1596</sup> [REDAKTUAR];<sup>1597</sup> [REDAKTUAR].<sup>1598</sup>  
[REDAKTUAR].

781. [REDAKTUAR];<sup>1599</sup> [REDAKTUAR].<sup>1600</sup> [REDAKTUAR].<sup>1601</sup> [REDAKTUAR].<sup>1602</sup>  
[REDAKTUAR].

782. [REDAKTUAR].<sup>1603</sup> [REDAKTUAR].<sup>1604</sup> [REDAKTUAR].

783. Së treti, në kundërshtim me parashtrimin e Mbrojtjes, [REDAKTUAR] konfirmohet dhe është në përputhje me dëshmitë e ekspertëve të paraqitur nga të dy palët në këtë çështje. Siç u tha më lart, dr. Gasiori konstatoi plagë nga armë zjarri në këmbën e djathtë të viktimës së vrasjes së paligjshme, që kishin dëmtuar femurin dhe tibian.<sup>1605</sup> Gjithashtu, z. De Villiers Horne, ekspert kriminalistik armësh i thirrur nga Mbrojtja,<sup>1606</sup> konstatoi se trajektorja e njërit prej plumbave të përshkruar në aktautopsinë e dr. Gasiorit përputhej [REDAKTUAR] se “pushka ishte ngjitur me këmbën”.<sup>1607</sup> Ai gjithashtu konstatoi se, duke pasur parasysh trajektoret e ndryshme të tre plumbave, “duhet të ketë pasur lëvizje ose të personit që ka shtënë, ose të

---

<sup>1595</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1596</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1597</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1598</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1599</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1600</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1601</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1602</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1603</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1604</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1605</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031051, 031055, 031059, 031065-031069 (fotografitë 29-53), 031091; **Dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, publik, f. 2087, rreshti 3 deri f. 2089, rreshti 10; f. 2092, rreshti 10 deri f. 2093, rreshti 25, që i referohet Aktautopsisë: 031049-031095 RED2, f. 031065 (fotografia 29, ruajtur si REG00960), f. 031068 (fotografitë 43, 44); T. 3 korrik 2023, publik, f. 2170, rreshtat 8-11.

<sup>1606</sup> **Aktekspertiza:** DPS00864-DPS00875, f. DPS00865; **z. De Villiers Horne:** T. 27 nëntor 2023, publik, f. 3642, rreshti 14 deri f. 3643, rreshti 20.

<sup>1607</sup> **Z. De Villiers Horne:** T. 27 nëntor 2023, konfidencial, f. 3688, rreshti 18 deri f. 3689, rreshti 14, që i referohet Aktekspertizës: DPS00864-DPS00875, f. DPS00870.

viktimës, ose të të dyve në mes të të shtënave".<sup>1608</sup> Ai shpjegoi se supozonte që viktima e vrasjes së paligjshme lëvizi pasi u qëllua, sidomos nëse u godit në asht, pasi dhimbja nga kjo mund të jetë shumë e madhe.<sup>1609</sup> Dëshmia si ekspert e dr. Gasiorit dhe konstatimet e z. De Villiers Horne konfirmojnë dhe e bëjnë të besueshme [REDAKTUAR] se plumbi goditi ashtin dhe se viktima e vrasjes së paligjshme ra nga karrigia pasi u qëllua [REDAKTUAR].<sup>1610</sup>

784. [REDAKTUAR]<sup>1611</sup> [REDAKTUAR].<sup>1612</sup> [REDAKTUAR].<sup>1613</sup> [REDAKTUAR].

785. [REDAKTUAR].

#### 4. Prania dhe roli i z. Shala gjatë qëllimit me armë zjarri të viktimës së vrasjes së paligjshme

786. Prania e z. Shala gjatë qëllimit me armë zjarri të viktimës së vrasjes së paligjshme më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, u diskutua gjerësisht gjatë gjykimit dhe është një nga pikat faktike qendrore për të cilën ka mospajtim midis palëve. ZPS-ja pretendon se z. Shala ishte i pranishëm në dhomën 2 kur viktima e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri, dhe se mori pjesë në rrahjet.<sup>1614</sup> Mbrojtja

---

<sup>1608</sup> **Z. De Villiers Horne**: T. 27 nëntor 2023, konfidencial, f. 3660, rreshti 19 deri f. 3661, rreshti 6, që i referohet Akt ekspertizës: DPS00864-DPS00875, f. DPS00871.

<sup>1609</sup> **Z. De Villiers Horne**: T. 27 nëntor 2023, konfidencial, f. 3691, rreshti 21 deri f. 3692, rreshti 16.

<sup>1610</sup> Asnjëri ekspert nuk ishte në gjendje të përcaktonte nëse viktima e vrasjes së paligjshme ishte ulur apo në këmbë kur u qëllua me armë zjarri; **Dr. Gasior**: T. 27 qershor 2023, publik, f. 2112, rreshti 22 deri f. 2113, rreshti 11; **Akt ekspertiza**: DPS00864-DPS00875, f. DPS00870 ("Viktima mund të ketë qenë ulur ose në këmbë").

<sup>1611</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1612</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1613</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1614</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar) para. 23, 28; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 160, 369; T. 15 prill 2024, konfidenciale, f. 4114, rreshti 20 deri f. 4116, rreshti 3.

parashtron se z. Shala nuk ishte i pranishëm [REDAKTUAR].<sup>1615</sup> [REDAKTUAR].<sup>1616</sup>  
[REDAKTUAR].<sup>1617</sup>

787. [REDAKTUAR].<sup>1618</sup> [REDAKTUAR].<sup>1619</sup> [REDAKTUAR].<sup>1620</sup> [REDAKTUAR].<sup>1621</sup>  
[REDAKTUAR].<sup>1622</sup>

788. [REDAKTUAR].

789. [REDAKTUAR].<sup>1623</sup> [REDAKTUAR].<sup>1624</sup> [REDAKTUAR].<sup>1625</sup> [REDAKTUAR] të  
gjithë kanë marrë pjesë në rrahje. Kush kishte mujt, sa më shumë kanë rreh. Me  
përrjashtim të Sabitit i cili po qëndronte me ato patericat te dera".<sup>1626</sup>

790. [REDAKTUAR].<sup>1627</sup> [REDAKTUAR].<sup>1628</sup>

791. [REDAKTUAR].<sup>1629</sup> [REDAKTUAR].<sup>1630</sup>

792. [REDAKTUAR].<sup>1631</sup> [REDAKTUAR].<sup>1632</sup> [REDAKTUAR].<sup>1633</sup> [REDAKTUAR].

---

<sup>1615</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1616</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1617</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1618</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1619</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1620</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1621</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1622</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1623</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1624</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1625</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1626</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1627</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1628</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1629</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1630</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1631</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1632</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1633</sup> [REDAKTUAR].

793. [REDAKTUAR].<sup>1634</sup> [REDAKTUAR].<sup>1635</sup> [REDAKTUAR].<sup>1636</sup> [REDAKTUAR].<sup>1637</sup>  
[REDAKTUAR].<sup>1638</sup> [REDAKTUAR].<sup>1639</sup> [REDAKTUAR].

794. [REDAKTUAR].<sup>1640</sup>

795. [REDAKTUAR].<sup>1641</sup> [REDAKTUAR].<sup>1642</sup> [REDAKTUAR].

796. [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala ishte i pranishëm në dhomën 2 në ndërtesën e ndalimit, më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur viktimja e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri në këmbë.

##### 5. Prania dhe roli i anëtarëve të UÇK-së natën kur viktimja e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri

797. *Xhemshit Krasniqi*. Trupi Gjykses ka marrë prova që nuk përputhen me njëra-tjetrën në lidhje me identitetin e personit që qëlloi me armë zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date. [REDAKTUAR] se ishte Xhemshit Krasniqi.<sup>1643</sup> Nga ana tjetër, W01448 deklaroi në mënyrë të vazhdueshme në deklaratat e tij me shkrim se kishte qenë Lima(n) Geci. W01448 shpjegoi se këtë e mësoi nga vetë viktimja e vrasjes së paligjshme, i cili i tha se kishte qenë Lima(n) Geci, pasi e kishin sjellë përsëri në dhomën 1.<sup>1644</sup>

---

<sup>1634</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1635</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1636</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1637</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1638</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1639</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1640</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1641</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1642</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1643</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1644</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859; SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837; SITF00374558-00374558 RED, para. 3.

798. [REDAKTUAR].<sup>1645</sup> [REDAKTUAR].

799. [REDAKTUAR].<sup>1646</sup> [REDAKTUAR]<sup>1647</sup> – [REDAKTUAR].<sup>1648</sup>

800. Së dyti, [REDAKTUAR] konfirmohet nga deklaratat e W01448-ës në lidhje me praninë e Xhemshit Krasniqit në ndërtesën e ndalimit atë natë. Më konkretisht, W01448 dëshmoi se Xhemshit Krasniqi ishte ndër anëtarët e UÇK-së që e morën viktimën e vrasjes së paligjshme nga dhoma 1 dhe e kthyen aty pasi ishte qëlluar me armë zjarri.<sup>1649</sup> [REDAKTUAR],<sup>1650</sup> [REDAKTUAR].<sup>1651</sup>

801. Së treti, [REDAKTUAR] W01448 [REDAKTUAR], dhe ai dëshmoi se emrin e Lima(n) Gecit e mësoi nga viktimja e vrasjes së paligjshme. Megjithatë, [REDAKTUAR] sipas W01448-ës, [REDAKTUAR], viktimja e vrasjes së paligjshme ishte në jerm pas plagosjes me armë zjarri dhe mezi ishte në gjendje të fliste. Sipas fjalëve të vetë W01448-ës, ai: “thoshte gjëra, fliste fjalë pa e ditur se ç'thonte, sikur ishte duke folur në gjumë”.<sup>1652</sup> [REDAKTUAR].<sup>1653</sup> Versionet [REDAKTUAR] W01448-ës për këtë pikë janë përputhëse me dëshminë konfirmuese të TW4-11-shit, që vërteton gjendjen e rëndë në të cilën ishte viktimja e vrasjes së paligjshme pasi ishte qëlluar me armë zjarri, që po i rridhte gjak nga plaga me armë zjarri.<sup>1654</sup> Kjo është gjithashtu në përputhje me konstatimet e dr. Gasiorit.<sup>1655</sup>

---

<sup>1645</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1646</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1647</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1648</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1649</sup> **W01448:** SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013837-00013838.

<sup>1650</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1651</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1652</sup> **W01448:** SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013755.

<sup>1653</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1654</sup> *Shih* para. 678 më lart.

<sup>1655</sup> *Shih* para. 775-776 më lart.



802. Së katërti, [REDAKTUAR].<sup>1656</sup> [REDAKTUAR].<sup>1657</sup> [REDAKTUAR].<sup>1658</sup>

803. Së pesti, deklaratat me shkrim të W01448-ës në lidhje me rolin që kishte luajtur Lima(n) Geci në FMK nuk përputhen me provat e tjera që ka marrë Trupi Gjykses. W01448 e përshkroi Lima(n) Gecin si person me kompetenca të konsiderueshme mbi të ndaluarit në FMK. Sipas tij, Lima(n) Geci jo vetëm që e kishte qëlluar me armë zjarri në këmbë viktimën e vrasjes së paligjshme, por gjithashtu ishte personi që: (i) i refuzoi ndihmën mjekësore viktimës së vrasjes së paligjshme;<sup>1659</sup> dhe (ii) kërcënoi W01448-ën, TW4-01-shin dhe TW4-11-shin se ata e kishin radhën pas tij, duke thënë: “Sonte do të merrem me juve tre”.<sup>1660</sup> Sipas Trupit Gjykses, një anëtar i UÇK-së me këtë shkallë pushteti mbi fatin e të ndaluarve duhet të zinte vend më të theksuar në dëshmitë e dëshmitarëve të ndaluar në FMK. Megjithatë, Lima(n) Geci nuk përmendet nga asnjë dëshmitar tjetër që ka dëshmuar ose ka dhënë deklaratë me shkrim në këtë çështje. Përkundrazi, është Xhemshit Krasniqi që përmendet vazhdimisht nga shumë dëshmitarë, përfshirë W01448-ën, si personi që kishte rol komandues dhe pushtet mbi fatin e të ndaluarve në FMK, nën pushtetin e përgjithshëm të Sabit Gecit.<sup>1661</sup> [REDAKTUAR] se Xhemshit Krasniqi qëlloi me armë zjarri viktimën e vrasjes së

---

<sup>1656</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1657</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1658</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1659</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859 (“Ai kërkoi një mjek pasi që nuk mund të urinonte. Pas kësaj, Liman GECI në mënyre sarkastike tha: ‘Do të sjelli një mjek për të ta prerë organin tënd dhe kështu do ta kesh më lehtë të urinosh’”); SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013755-00013756.

<sup>1660</sup> **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013859.

<sup>1661</sup> **TW4-01**: T. 31 maj 2023, publik, f. 1530, rreshtat 1-8; T. 6 qershor 2023, publik, f. 1929, rreshtat 17-25; **W01448**: SITF00013852-00013869 RED6, f. SITF00013860 (duke deklaruar se “Xhemshit KRASNIQI [...] ishte komandant i kazermave në Kukës”); SITF00013833-00013847 RED4, f. SITF00013838 (PY. “Kush ishte komandant i kampit? A ju kujtohet? PË. Dukej se ishin dy, ishin Krasniqi dhe Sabit Geci. Ata ishin udhëheqës të lartë aty”); SITF00013736-SITF00013800 RED5, f. SITF00013743; **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1068, rreshtat 10-16; **W04848**: SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014098; **TW4-02**: 060664-TR-ET Part 3 (Pjesa 3), f. 21, rreshti 21 deri f. 23, rreshti 5.

paligjshme përputhet me rolin e përgjithshëm që luajti Xhemshit Krasniqi në këto ngjarje.<sup>1662</sup>

804. Së gjashti, Trupi Gjykses gjithashtu mori dëshmi nga W04733, i cili dëshmoi se W01448 i kishte thënë në një bisedë telefonike se viktimën e vrasjes së paligjshme e kishte vrarë Xhemshit Krasniqi.<sup>1663</sup> Deklarata me shkrim e W04733-shit konfirmon dhe shton besueshmërinë e [REDAKTUAR].

805. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e W01448-ës se viktimën e vrasjes së paligjshme e qëllloi me armë zjarri në këmbë Lima(n) Geci nuk është e besueshme dhe në të nuk mund të mbështetesh. Në vend të saj, Trupi Gjykses i jep peshë [REDAKTUAR] dhe deklaratës me shkrim të W04733-shit dhe konstaton se Xhemshit Krasniqi qëllloi me armë zjarri në këmbë viktimën e vrasjes së paligjshme më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date.

806. *Sabit Geci*. [REDAKTUAR].<sup>1664</sup> [REDAKTUAR].<sup>1665</sup>

807. Trupi Gjykses thekson se nuk është e nevojshme që të konstatojë nëse Sabit Geci ishte fizikisht i pranishëm [REDAKTUAR] ose se cili ishte roli i tij, për të arritur në konstatimet e veta në lidhje me akuzën e vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do të merret më tej me kundërshtimin e Mbrojtjes.

## 6. Identifikimi i kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme

808. Mbrojtja parashton se ZPS-ja nuk ka provuar se kufoma së cilës dr. Gasior i bëri autopsinë është kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme. Në veçanti, Mbrojtja

---

<sup>1662</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1663</sup> **W04733**: SPOE00013793-SPOE00013847 RED2, f. SPOE00013845, që i referohet W01448-shit si "dëshmitari A"; në lidhje me identifikimin e dëshmitarit A si W01448, shih f. SPOE00013809.

<sup>1664</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1665</sup> [REDAKTUAR].

kundërshton provat e identifikimit përmes ADN-së nga dëshmitari ekspert, kolonel Dolejsi, që, sipas saj, nuk janë prova në të cilat mund të mbështetesh.<sup>1666</sup>

809. Fillimisht, Trupi Gjyqësor vë në dukje se provat që kanë të bëjnë me identifikimin e kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme nuk janë vetëm provat e identifikimit përmes ADN-së të paraqitura nga kolonel Dolejsi,<sup>1667</sup> por në to përfshihen edhe: (i) [REDAKTUAR];<sup>1668</sup> (ii) Raportin e Zhvarrosjes;<sup>1669</sup> (iii) Aktautopsinë e përgatitur nga dr. Gasiorit; dhe (iv) së fundi, provat e ADN-së të paraqitura nga dëshmitari ekspert, dr. Guduin.<sup>1670</sup> Trupi Gjyqësor do t'i diskutojë këto prova me radhë.

810. [REDAKTUAR],<sup>1671</sup> [REDAKTUAR].<sup>1672</sup> [REDAKTUAR].<sup>1673</sup> [REDAKTUAR].<sup>1674</sup> [REDAKTUAR].<sup>1675</sup>

811. [REDAKTUAR]<sup>1676</sup>, [REDAKTUAR].<sup>1677</sup> [REDAKTUAR].

812. [REDAKTUAR].<sup>1678</sup> [REDAKTUAR].

---

<sup>1666</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 173-177.

<sup>1667</sup> Dy raporte: SITF00012456-SITF00012458-ET, përgatitur në vitin 2009; 110670-110674, i përgatitur në vitin 2023; dhe dëshmia e tij para Trupit Gjyqësor (T. 16 qershor 2023, konfidencial, f. 1952-2017). Në raportin e tij të vitit 2023, kolonel Dolejsi bëri analizë të re të profileve të njëjta të ADN-së duke përdorur program kompjuterik më të avancuar; *shih kolonel Dolejsi*: T. 16 qershor 2023, publik, 1956, rreshti 9 deri f. 1957, rreshti 19; f. 1969, rreshti 13 deri f. 1971, rreshti 4; f. 1982, rreshti 17 deri f. 1983, rreshti 10.

<sup>1668</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1669</sup> Raporti i Zhvarrosjes i është bashkëngjitur Aktautopsisë së Dr. Gasiorit; *shih* 031049-031095 RED2, f. 031092-031095.

<sup>1670</sup> Dy raporte: 103373-103387 RED, të përgatitura në vitin 2021; dhe 111160-111162, i përgatitur në vitin 2023; dhe dëshmia e tij para Trupit Gjyqësor (T. 4 korrik 2023, publik, f. 2214-2246).

<sup>1671</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1672</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1673</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1674</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1675</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1676</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1677</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1678</sup> [REDAKTUAR].

813. *Zhvarrosja nga EULEX-i në vitin 2009.* [REDAKTUAR], në Raportin e Zhvarrosjes thuhet se [REDAKTUAR] kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme u zhvarros nga [REDAKTUAR].<sup>1679</sup> Në Raport gjithashtu thuhet se zhvarrosja u krye në kontekstin e hetimit në kryerje e sipër (në atë kohë) nga EULEX-i për krimet që pretendohet se ishin kryer në FMK në vitin 1999 ([REDAKTUAR]). Zhvarrosjen e urdhëroi një gjykatës i procedurës paraprake i EULEX-it me qëllim të kryerjes: (i) së autopsisë, për të përcaktuar, ndër të tjera, shkakun kryesor të vdekjes, që duhej të kryhej nga ekspertë të Zyrës për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore; dhe (ii) të çdo ekzaminimi dhe analize që konsiderohej e domosdoshme për përcaktimin e identitetit të kufomës, përfshirë analizën e ADN-së.<sup>1680</sup>

814. Mbrojtja nuk ka kundërshtuar autenticitetin e Raportit të Zhvarrosjes apo mbështetshmërinë në të. Trupi Gjykes nuk ka arsye për të dyshuar autenticitetin apo mbështetshmërinë në të, duke pasur parasysh se ai: (i) është përgatitur nga EULEX-i gjatë një hetimi penal zyrtar; (ii) mban stemën e EULEX-it dhe datën; dhe (iii) përfshin urdhrin përkatës të gjykatësit të procedurës paraprake, që mban nënshkrimin, vulën dhe datën. [REDAKTUAR].<sup>1681</sup> [REDAKTUAR].<sup>1682</sup>

815. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes mbështetet në Raportin e Zhvarrosjes, [REDAKTUAR].

816. *Autopsia.* Ndonëse dr. Gasiori nuk ishte në gjendje të komentonte në lidhje me identitetin e kufomës që ekzaminoi,<sup>1683</sup> Aktautopsia e tij përmban tre tregues të rëndësishëm se kufoma që ekzaminoi ishte me të vërtetë kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme.

---

<sup>1679</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031092.

<sup>1680</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031092, 031094-031095.

<sup>1681</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1682</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1683</sup> **Dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, publik, f. 2071, rreshti 7 deri f. 2072, rreshti 10.

817. Së pari, thesi i kufomës që ai mori, dhe që shihet në fotografitë që përmban Aktautopsia,<sup>1684</sup> mban të njëjtën etiketë hetimi nr. [REDAKTUAR] si Raporti i Zhvarrosjes. I njëjti thes i kufomës gjithashtu shihet në fotografitë e bëra pas zhvarrosjes dhe që janë përfshirë në Raportin e Zhvarrosjes.<sup>1685</sup>

818. Së dyti, Aktautopsia u përgatit nën kujdesin e Zyrës për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore,<sup>1686</sup> siç urdhëroi gjykatësi i procedurës paraprake i EULEX-it kur urdhëroi zhvarrosjen,<sup>1687</sup> dhe mban stemën dhe vulën e EULEX-it.<sup>1688</sup> Data e autopsisë, [REDAKTUAR], është menjëherë pas datës së zhvarrosjes, [REDAKTUAR].<sup>1689</sup>

819. Së treti, siç është përshkruar më lart, Aktautopsia dhe dëshmia e dr. Gasiorit tregojnë se: (i) në kufomë u gjend një kateter që shkonte në fshikëzën e urinës; (ii) këmba e djathtë e viktimës ishte mbështjellë me fashë gjipsi, [REDAKTUAR]; dhe (iii) viktima e vrasjes së paligjshme kishte një plagë nga armë zjarri në gjurin e djathtë, sikurse dëshmuan që të tre, TW4-01, TW4-11 dhe W01448.<sup>1690</sup> Këto janë tipare shumë të dallueshme dhe identifikuese dhe përputhen me dëshmitë e TW4-01-shit, TW4-11-shit dhe W01448-ës në lidhje me momentet e fundit të viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1691</sup>

820. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues mbështetet në Aktautopsinë, ku thuhet se kufoma e ekzaminuar nga dr. Gasiori ishte kufoma që u zhvarros nga EULEX-i [REDAKTUAR].

---

<sup>1684</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031061 (fotografitë 01-03).

<sup>1685</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031093 (fotografia 5).

<sup>1686</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031049; *shih më tej*, **dr. Gasior:** T. 26 qershor 2023, publik, f. 2066, rreshti 24 deri f. 2067, rreshti 7 (ku konfirmon që kishte punuar për EULEX-in si ekspert mjekoligjor, nga viti 2008 deri në vitin 2012).

<sup>1687</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031094-031095.

<sup>1688</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031052-031054.

<sup>1689</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031049, 031092.

<sup>1690</sup> *Shih* para. 768 më lart.

<sup>1691</sup> *Shih* para. 758-762 më lart.

821. *Provat e identifikimit me anë të ADN-së.* Analiza e ADN-së e kryer nga kolonel Dolejshi, nga një fragment ashti e marrë nga kufoma a zhvarrosur, përcaktoi se gjasa ishte 99.99998% që profili i ADN-së i atij fragmenti të ashtit i përkiste pasardhësit biologjik të [REDAKTUAR],<sup>1692</sup> të cilët janë prindërit e viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1693</sup> Dr. Guduin i shpjegoi Trupit Gjykses se kjo ishte “provë tejet e fortë” në mbështetje të sugjerimit se [REDAKTUAR] ishin prindërit biologjikë të kontribuuesit të fragmentit të ashtit.<sup>1694</sup>

822. Mbrojtja kundërshton mbështetshmërinë në dëshminë si ekspert të kolonel Dolejshit duke parashtruar se: (i) nuk ka informacion të disponueshëm se si dhe nga kush u morën, ruajtën dhe transferuan fragmenti i ashtit nga kufoma e zhvarrosur dhe mostrat nga prindërit; (ii) kolonel Dolejshi nuk ka përvojë të mjaftueshme në analizimin e lidhjeve biologjike familjare; dhe (iii) metodologjisë së tij i mungon rigoroziteti shkencor.<sup>1695</sup>

823. Trupi Gjykses i shqyrtoi parashtrimet e Mbrojtjes, por nuk vjen në përfundimin se identifikimi përmes ADN-së nga kolonel Dolejshi nuk është dëshmi në të cilën nuk mund të mbështetesh. Së pari, nga Raporti i Zhvarrosjes Trupi Gjykses mund të nxjerrë përfundimin se fragmenti i ashtit u mor pas zhvarrosjes nga EULEX-i [REDAKTUAR]. Qëllimi i zhvarrosjes ishte, pjesërisht, që të identifikohesh kufoma dhe të konfirmohesh nëse i përkiste [REDAKTUAR] (viktimës së vrasjes së paligjshme), përfshirë përmes analizës së ADN-së.<sup>1696</sup> Data kur instituti i kolonel Dolejshit, Instituti i Policisë Kriminalistike i Çekisë, i mori mostrat, [REDAKTUAR], është shumë afër

---

<sup>1692</sup> **Aktekspertiza:** 110670-110674, f. 110670; **kolonel Dolejshi:** T. 16 qershor 2023, publik, f. 1971, rreshtat 5-21; f. 1976, rreshti 12 deri f. 1979, rreshti 6.

<sup>1693</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1694</sup> **Dr. Guduin:** T. 4 korrik 2023, publik, f. 2222, rreshti 20 deri f. 2223, rreshti 14.

<sup>1695</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 173-177.

<sup>1696</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031092, 031094-031095.

datës së zhvarrosjes, [REDAKTUAR].<sup>1697</sup> Nga Raporti i Zhvarrosjes, Trupi Gjykses gjithashtu mund të nxjerrë përfundimin se mostra e ashtit ishte marrë, ruajtur dhe transferuar për analizim nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës e EULEX-it, dhe Njësia Kriminalistike e Policisë, pasi këto ishin subjektet e autorizuara nga gjykatësi i procedurës paraprake i EULEX-it për të kryer analizën.<sup>1698</sup> E njëjta gjë është e vërtetë për mostrat e marra nga prindërit. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se kolonel Dolejshi i mori mostrat në “gjendje të padëmtuar”.<sup>1699</sup> Trupi Gjykses nuk ka arsye për të dyshuar në integritetin e këtij procesi, duke pasur parasysh se ai u krye në kontekstin e një hetimi kriminal zyrtar nga autoritete kompetente.

824. Së dyti, Trupi Gjykses konstaton se kolonel Dolejshin nuk i mungon përvoja e mjaftueshme për analizimin e lidhjes gjenetike duke pasur parasysh se: (i) ai ka diplomë universitare në fushën e diagnostikimit molekular dhe qelizor, si dhe diplomë pasuniversitare (magjistër) në biologji molekulare dhe gjenetikë, që përfshin studimin e materialeve gjenetike dhe të ADN-së njerëzore; (ii) ai punon në Institutin e Policisë Kriminalistike në Çeki që nga viti 2004 dhe aktualisht është shef i departamentit të gjenetikës; (iii) Instituti i Policisë Kriminalistike është anëtar i Rrjetit Evropian të Institucioneve Shkencore të Kriminalistikës (ENFSI) dhe bën, midis të tjerash analiza, deklarata dhe mendime eksperte; dhe (iv) kolonel Dolejshi ka dhënë edhe më parë dëshmi si ekspert në gjykime në lidhje me analizën e ADN-së.<sup>1700</sup> Në

---

<sup>1697</sup> **Aktekspertiza:** SITF00012456-SITF00012458-ET, f. SITF00012457; **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031092.

<sup>1698</sup> **Aktautopsia:** 031049-031095 RED2, f. 031094.

<sup>1699</sup> **Aktekspertiza:** SITF00012456-SITF00012458-ET, f. SITF00012457; **kolonel Dolejshi:** T. 16 qershor 2023, publik, f. 1959, rreshti 21 deri f. 1960, rreshti 6.

<sup>1700</sup> **Jetëshkrimi:** 108634-108634 RED; **kolonel Dolejshi:** T. 16 qershor 2023, publik, f. 1952, rreshti 14 deri f. 1956, rreshti 6; f. 1984, rreshti 11 deri f. 1985, rreshti 14.

bazë të jetëshkrimit dhe dëshmisë së kolonel Dolejshit, Trupi Gjykues nuk gjykon se ekspertiza e tij ka mangësi që mund të venë në dyshim analizën dhe përfundimet e tij.

825. Së treti, dr. Guduin – të cilit iu kërkua të komentonte raportet e kolonel Dolejshit dhe ekspertizën e të cilit Mbrojtja nuk e kundërshton<sup>1701</sup> – ka dëshmuar para Trupit Gjykues se metodologjia e përdorur nga kolonel Dolejshi është “metodologji shumë standarde që përdoret në gjenetikën mjekoligjore” dhe se nuk kishte arsye të mendonte se ishin bërë gabime, bazuar në çfarë kishte parë.<sup>1702</sup> Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues është mbështetur në provat e identifikimit përmes ADN-së të paraqitura nga kolonel Dolejshi.

826. *Përfundim.* Duke pasur parasysh provat në tërësi, Trupi Gjykues nuk ka asnjë dyshim se kufoma së cilës dr. Gasiori i bëri autopsi është kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme.

## 7. [REDAKTUAR]

827. [REDAKTUAR].<sup>1703</sup>

828. [REDAKTUAR].<sup>1704</sup>

[...]

Se me pasë ligj, shtet na, ish kry atje, e kishin kry Kosova. Po kush me e kry? Se s’ka guxu kurrkush me i marrë lëndë napër dorë”.<sup>1705</sup>

---

<sup>1701</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 175.

<sup>1702</sup> **Dr. Guduin:** T. 4 korrik 2023, publik, f. 2216, rreshtat 3-8; f. 2243, rreshtat 11-15.

<sup>1703</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1704</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1705</sup> [REDAKTUAR].



829. [REDAKTUAR] për të më e keqja ishte se nuk mund të fliste publikisht në Kosovë për ato që kishin ndodhur në FMK dhe nuk mundej “me ua nxjerrë marren” anëtarëve të UÇK-së që ishin përfshirë për atë që kishin bërë, [REDAKTUAR].<sup>1706</sup>

## 8. Përfundim

830. Bazuar në të gjitha provat e diskutuara më lart marrë në tërësi, Trupi Gjykses konstaton se, më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date – gjatë keqtrajtimit në dhomën 2 në ndërtesën e ndalimit në FMK<sup>1707</sup> – viktima e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri në këmbë, afër gjurit, nga Xhemshit Krasniqi. Anëtarët e tjerë të UÇK-së të pranishëm në dhomën 2 në momentin e gjuajtjes me armë zjarri ishin: z. Shala, Bedriu, Van Dami dhe së paku edhe tre ose katër anëtarë të UÇK-së. Megjithëse z. Shala nuk e qëlloi me armë zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme, ai mori pjesë në keqtrajtimin e tij, si para, ashtu edhe pasi viktima e vrasjes së paligjshme ishte qëlluar me armë zjarri.<sup>1708</sup>

831. Pas qëllimit me armë zjarri dhe keqtrajtimit, viktimën e vrasjes së paligjshme e çuan përsëri në dhomën 1, në të njëjtën ndërtesë të ndalimit. Keqtrajtimi e kishte lënë me mavijosje në tërë trupin, të paaftë të ecte dhe të urinonte, dhe kishte gjakderdhje të madhe nga plagët në këmbë, të shkaktuara me armë zjarri. Disa nga të ndaluarit e tjerë u përpoqën t’ia ndalin gjakderdhjen, duke ia lidhur plagët me bluzat e veta, por gjakderdhja nuk u ndal. Erdhi një mjek dhe u përpoq ta ndihmonte viktimën e vrasjes së paligjshme që të urinonte artificialisht, duke përdorur kateterin, dhe i vendosi fashë gjipsi në këmbë për t’i ndalur gjakderdhjen, por asnjëra nga këto procedura nuk ishte e suksesshme. Mjeku i këshilloi anëtarët e UÇK-së ta çonin viktimën e vrasjes së paligjshme në spitalin e Kukësit, se përndryshe nuk do të mbijetonte. Por një nga

---

<sup>1706</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1707</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1708</sup> [REDAKTUAR].

anëtarët e UÇK-së që ishte përgjegjës për të ndaluarit në FMK nuk e lejoi këtë, duke thënë: “S’ja kena bo këtë dajak [...] për me e çu tek mjeku”.

832. Viktima e vrasjes së paligjshme vdiq të nesërmen, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur ishte ende në ndalim në FMK në dhomën 1, nga pasojat e plagës me armë zjarri në këmbë dhe refuzimit të trajtimit mjekësor të duhur.

G. ANALIZË E PËRGJITHSHME E MBAJTJEVE NË NDALIM NGA UÇK-JA NË FMK DHE RRETHINA

833. Pas dhënies së konstatimeve në lidhje me krimet në aktakuzë, Trupi Gjykses do të paraqesë analizën e vet të përgjithshme të organizimit të aktiviteteve të UÇK-së në FMK dhe rreth saj, në lidhje me personat e ndaluar aty gjatë periudhës së Aktakuzës së Konfirmuar. Trupi Gjykses kujton se individë ishin arrestuar dhe ndaluar nga anëtarë të Policisë Ushtarake të UÇK-së, përfshirë anëtarin e lartë Xhemshit Krasniqi, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, nën autoritetin e Sabit Gecit.<sup>1709</sup> Më poshtë Trupi Gjykses do të diskutojë: (i) kërkimin, arrestimin dhe transferimin e të ndaluarve në FMK; dhe (ii) organizimin e mbajtjes në ndalim, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK.

834. *Kërkimi, arrestimi dhe transferimi.* Viktimat kanë përshkruar se si u arrestuan në vende të ndryshme në Shqipërinë veriore, si [REDAKTUAR], (portin) në Durrës, dhe [REDAKTUAR].<sup>1710</sup> Trupi Gjykses kujton se persona të caktuar u identifikuan para arrestimit bazuar në profilin e tyre (d.m.th. personat që perceptoheshin se kishin bashkëpunuar, ishin shoqëruar ose kishin simpati për autoritetet serbe, ose ata që nuk përkrahnin mjaftueshëm përpjekjet e UÇK-së).<sup>1711</sup> Bazuar në konstatimet e Trupit Gjykses të përmendura më lart, Trupi Gjykses gjykon se praktika e identifikimit

---

<sup>1709</sup> *Shih* Pjesën VI.C.

<sup>1710</sup> *Shih* para. 590 më lart.

<sup>1711</sup> *Shih* para. 590 më lart.

paraparak duhet të ketë kërkuar njëfarë forme dhe shkalle të mbledhjes së informacionit, sidomos duke marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të personave të dëbuar nga Kosova në atë kohë, që po kërkonin strehim në Shqipëri ose donin t'i bashkoheshin UÇK-së. Viktimat përshkruan transferimin e tyre, me vetura dhe autobusë, nga vendi i arrestimit në vende ndalimi (të përkohshme) në Shqipërinë veriore (në Romanat, Durrës, në aksin Durrës-Tiranë, ose në [REDAKTUAR]), si dhe transferimin e tyre të fundit në vendin e ndalimit në FMK.<sup>1712</sup> Duke u bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses gjykon se për t'i kërkuar, arrestuar dhe transferuar këta të ndaluar nevojitej një shkallë e konsiderueshme organizimi, si dhe logjistikë dhe personel të konsiderueshëm.

835. *Ndalimi, marrja në pyetje dhe keqtrajtimi.* Ngjashëm, provat sugjerojnë se për mënyrën se si ishte organizuar ndalimi, marrja në pyetje dhe keqtrajtimi i të ndaluarve në FMK nevojitej personel i konsiderueshëm dhe një strukturë e përhershme në atë vend. Ky përfundim mbështetet në këto rrethana: (i) në FMK silleshin dhe merreshin të ndaluar të ndryshëm, të cilët mandej merreshin në pyetje dhe keqtrajtoheshin; (ii) të ndaluarit mbaheshin nën vëzhgim të vazhdueshëm në vende të ndryshme ndalimi brenda kompleksit të FMK-së; (iii) anëtarët e UÇK-së në FMK ishin përgjegjës për t'i çuar dhe për t'i marrë të ndaluarit nga dhomat e marrjes në pyetje; dhe (iv) një numër i madh anëtarësh të UÇK-së në FMK u përfshinë në keqtrajtimin e të ndaluarve, të cilët përshkruan se si 10 apo më shumë persona merrnin pjesë përnjëherë në keqtrajtimin e tyre<sup>1713</sup> dhe se në keqtrajtimin e tyre përfshiheshin kaq shumë anëtarë të UÇK-së, sa që nuk mund t'i njihnin.<sup>1714</sup> Së fundi, përfshirja e Sabit Gecit, si anëtar i lartë i UÇK-së, pasqyron rëndësinë e atyre aktiviteteve.

---

<sup>1712</sup> *Shih* Pjesën VI.D.

<sup>1713</sup> *Shih* para. 707 më lart.

<sup>1714</sup> *Shih* para. 642 më lart.

## H. VENDNDODHJA E Z. SHALA GJATË PERIUdhËS SË AKUZAVE

836. Prania e z. Shala në FMK gjatë periudhës së akuzave ishte objekt mospajtimi midis palëve gjatë tërë gjykimit. ZPS-ja pretendoi se z. Shala ishte i pranishëm në FMK: (i) më 17 maj 1999, ose rreth kësaj date, kur mori pjesë në transferimin e W04733-shit nga një vend në Durrës ose afër tij për në FMK;<sup>1715</sup> (ii) më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, kur mori pjesë në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin fizik dhe psikologjik të së paku gjashtë të ndaluarve, përfshirë TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, W04733-shin, W01448-ën, [REDAKTUAR] dhe një tjetër femër të ndaluar;<sup>1716</sup> dhe (iii) më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur mori pjesë në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e [REDAKTUAR] viktimës së vrasjes së vrasjes së paligjshme.<sup>1717</sup>

837. Ndonëse Mbrojtja nuk ofroi zyrtarisht alibi,<sup>1718</sup> ajo parashtrroi se gjatë kohës që z. Shala ishte në Shqipëri në vitin 1999 – d.m.th. nga fundi i marsit 1999 deri në qershor/korrik 1999 – ai ishte kryesisht në vijën e frontit. Sipas Mbrojtjes, z. Shala shkoi në FMK gjatë kësaj kohe, por vetëm në pak raste të izoluara dhe për kohë të shkurtër, për të marrë furnizime. Mbrojtja nguli këmbë se z. Shala nuk ishte i pranishëm në FMK në fund të majit dhe/ose në qershor 1999 (d.m.th. gjatë kohës relevante për akuzat).<sup>1719</sup>

838. Për përcaktimin e vendndodhjes së z. Shala gjatë kohës që lidhet me akuzat, Trupi Gjyqësor do të diskutojë me radhë: (i) provat për praninë e z. Shala në FMK;

---

<sup>1715</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 15.

<sup>1716</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 21.

<sup>1717</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 23, 28.

<sup>1718</sup> KSC-BC-2020-04, F00477, Mbrojtja, *Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtjes në lidhje me Alibinë*, 5 prill 2023, publike.

<sup>1719</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 2-27, në veçanti, para. 4-5, 8-9, 18-19; T. 16 prill 2024, publik, f. 4239, rreshtat 24-25.

(ii) deklaratat dhe pranimet e vetë z. Shala; (iii) provat për praninë e z. Shala në vijën e frontit; dhe (iv) provat e tjera në të cilat mbështetet Mbrojtja.

## 1. Provat për praninë e z. Shala në FMK

839. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta të mëhershme si në vijim.

840. *Prania në FMK afërsisht midis datave* [REDAKTUAR] maj 1999. TW4-01 e pa z. Shala ditën e parë në FMK,<sup>1720</sup> që Trupi Gjykses konstatoi se ishte më [REDAKTUAR] maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1721</sup> Trupi Gjykses rikujton më tej shpjegimin e TW4-01-shit se kaloi kohë me z. Shala në ditët në vijim, duke luajtur me letra në magazinë. TW4-01 vuri në dukje se z. Shala fjeti në magazinë së paku dy prej tri netëve kur ishte i pranishëm edhe TW4-01.<sup>1722</sup> Gjatë tërë kësaj periudhe, z. Shala hynte dhe dilte në FMK.<sup>1723</sup>

841. TW4-10 – i cili shërbente si rojë në portën kryesore të FMK-së<sup>1724</sup> – gjithashtu e pa z. Shala që mbërriti në FMK [REDAKTUAR].<sup>1725</sup> Ai kujtoi më tej se z. Shala mund të hynte dhe të dilte në FMK pa kërkuar leje nga askush.<sup>1726</sup> Kjo dëshmi – për të cilën Trupi Gjykses konstaton se është e besueshme dhe në të cilën mund të mbështetesh – e vendos z. Shala në FMK më së paku afërsisht midis datave [REDAKTUAR] maj 1999 dhe [REDAKTUAR] maj 1999.

---

<sup>1720</sup> *Shih* para. 369 më lart.

<sup>1721</sup> *Shih* para. 369 më lart.

<sup>1722</sup> *Shih* para. 369 më lart.

<sup>1723</sup> *Shih* para. 369 më lart.

<sup>1724</sup> **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1036, rreshti 13 deri f. 1038, rreshti 8.

<sup>1725</sup> [REDAKTUAR]. TW4-10 dëshmoi gjithashtu se e pa z. Shala përsëri në FMK, së paku edhe një herë, dikur ose në maj ose në qershor 1999; **TW4-10**: T. 1 maj 2023, publik, f. 1081, rreshti 5 deri f. 1083, rreshti 11.

<sup>1726</sup> *Shih* para. 370 më lart; *shih gjithashtu, z. Elezaj*: 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar, RED4), f. 14, rreshtat 17-26, ku thuhet se luftëtarëve të zakonshëm u duhet leje për të dalë, qoftë edhe vetëm për disa orë.

842. *Prania në FMK më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.* W04733 e pa z. Shala më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, kur z. Shala, së bashku me një grup anëtarësh të UÇK-së, transferoi W04733-shin nga Romanati në FMK.<sup>1727</sup> Trupi Gjykses rikujton se e konstatoi dëshminë e W04733-shit në lidhje me transferimin e tij nga Romanati në FMK dhe identifikimin e z. Shala prej tij si dëshmi të besueshme dhe në të cilën mund të mbështetesh.<sup>1728</sup>

843. Më të njëjtën ditë, TW4-01, W04733 dhe W01448 e panë z. Shala në zyrën e ndërtesës së komandës, kur z. Shala, së bashku me disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, mori pjesë në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, W04733-shit, W01448-ës, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].<sup>1729</sup> Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij se dëshmitë e TW-01-shit, W04733-shit dhe W01448-ës në lidhje me këtë incident, përfshirë në lidhje me praninë e z. Shala gjatë tij, konfirmojnë njëra-tjetrën dhe kanë besueshmëri dhe mbështetshmëri të lartë.<sup>1730</sup>

844. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala ishte i pranishëm në FMK më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.

845. *Prania në FMK më 28 ose 29 maj 1999, ose rreth atyre datave.* W04733 e pa z. Shala përsëri në FMK kur u mor në pyetje nga Xhemshit Krasniqi dhe Sokol Dobruna në zyrë. Nga dritarja e hapur e zyrës në drejtim të oborrit, W04733 e pa z. Shala duke u larguar nga FMK-ja përmes portës dhe duke u kthyer disa minuta më vonë me makinë me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën.<sup>1731</sup> Kjo ndodhi tri apo katër ditë para lirimit të

---

<sup>1727</sup> *Shih* Pjesën VI.D.5(a).

<sup>1728</sup> *Shih* Pjesën VI.D.5(a).

<sup>1729</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(b)-(e).

<sup>1730</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(b)-(e).

<sup>1731</sup> *Shih* para. 462.

tij.<sup>1732</sup> Trupi Gjykses kujton në lidhje me këtë se W04733 u lirua më 1 qershor 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1733</sup>

846. Dëshmitë e TW4-01-shit dhe TW4-10-s e bëjnë të besueshme dëshminë e W04733-shit dhe anasjelltas, pasi që të dy pohuan se z. Shala hynte dhe dilte në FMK pa pasur nevojë të kërkonte leje.<sup>1734</sup> Siç është shpjeguar gjetkë, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë e TW4-01-shit dhe TW4-10-s konfirmojnë njëra-tjetrën, janë dhënë me vërtetësi dhe janë të besueshme në lidhje me këtë pikë.<sup>1735</sup>

847. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala ishte i pranishëm në FMK më 28 ose 29 maj 1999, ose rreth kësaj date dhe ishte në gjendje të hynte dhe të dilte lirisht në FMK.

848. *Prania në FMK më 31 maj 1999, ose rreth kësaj date.* Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje deklaratën e z. Elezaj, i cili ishte pronar i FMK-së në kohën relevante.<sup>1736</sup> Z. Elezaj kujtoi se e kishte parë z. Shala në FMK “para se me përfundim lufta”, kur solli anëtarë të plagosur dhe të vdekur të UÇK-së që kishin rënë në betejën e Gorozhupit në spitalin e Kukësit.<sup>1737</sup> Z. Elezaj nuk saktësoi se kur saktësisht e kishte parë z. Shala, por kujtoi se beteja e Gorozhupit u zhvillua midis 25 ose 26 majit 1999 dhe 31 majit 1999.<sup>1738</sup>

849. Deklarata me shkrim e z. Elezaj mbështetet nga dëshmia e z. Hoxha, si dhe nga audio dhe videoincizimet e përfshira si prova në dokumentacionin e çështjes. Z. Hoxha kujtoi se anëtarët e plagosur dhe të vdekur të UÇK-së, që kishin rënë në betejën e Gorozhupit, ishin transportuar me kamionë në spitalin e Kukësit dhe pastaj

---

<sup>1732</sup> *Shih* para. 462.

<sup>1733</sup> *Shih* para. 469.

<sup>1734</sup> *Shih* para. 369-370 më lart.

<sup>1735</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2(a) dhe VI.D.5(d). Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, *shih* T. 17 prill 2024, publik, f. 4303, rreshtat 9-16.

<sup>1736</sup> **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 1 Revised RED (Pjesa 1, e rishikuar, RED), f. 5-15.

<sup>1737</sup> **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar, RED4), f. 141-145.

<sup>1738</sup> **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 2 Revised RED4 (Pjesa 2, e rishikuar, RED4), f. 66, rreshti 18 deri f. 67, rreshti 11.

kamionët ishin parkuar në FMK. Ai dëshmoi se kjo ngjarje ndodhi ose më 30 ose më 31 maj 1999, duke përfunduar: “31 maj më duket”.<sup>1739</sup> Trupi Gjykses gjithashtu mori një videoincizim të bërë nga z. Hoxha gjatë varrimit të tre anëtarëve të vrarë të UÇK-së, ku një folës deklaroi: “Dje me 31 maj 1999 në vijën e parë të frontit [...] ranë heroikisht dëshmorët e lirisë”.<sup>1740</sup> Dëshmia e z. Hoxha dhe data e përmendur në videoincizim e bëjnë të besueshme deklaratën e z. Elezaj se kishte parë z. Shala në FMK, që sipas Trupit Gjykses ishte më 31 maj 1999, ose rreth kësaj date.

850. Trupi Gjykses gjithashtu mori dëshmi nga z. Shala, në deklaratën e 2019-ës, se ai kurrë nuk kishte transportuar anëtarë të plagosur të UÇK-së.<sup>1741</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses konstaton se deklarata e 2019-ës nuk është e besueshme në lidhje me këtë pikë. Siç shpjegohet më hollësisht më poshtë, Trupi Gjykses gjykon se z. Shala kishte motiv të gënjente dhe të distanconte veten nga FMK-ja dhe krimet e kryera aty.<sup>1742</sup>

851. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala ishte i pranishëm në FMK më 31 maj 1999, ose rreth kësaj date.

852. *Prania në FMK më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date.* Trupi Gjykses kujton konstatimin e vet se [REDAKTUAR] z. Shala në FMK, më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur z. Shala – së bashku me disa anëtarë të tjerë të UÇK-së – keqtrajtoi [REDAKTUAR] viktimën e vrasjes së paligjshme në dhomën 2 të ndërtesës së ndalimit.<sup>1743</sup> [REDAKTUAR].<sup>1744</sup>

---

<sup>1739</sup> **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3226, rreshti 5 deri f. 3228, rreshti 6, që i referohet **Videos:** 075138-01, at 00:00-00:24.

<sup>1740</sup> **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3257, rreshti 18 deri f. 3258, rreshti 12, që i referohet **Videos:** DPS00879, at 02:43-04:07; **Transkriptit:** DPS00879-TR-ET.

<sup>1741</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 131, rreshtat 21-25.

<sup>1742</sup> *Shih* para. 871 më poshtë.

<sup>1743</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1744</sup> [REDAKTUAR].



## 2. Deklaratat dhe pranimet e z. Shala në lidhje me praninë e tij në FMK dhe në vijën e frontit

853. Përveç konstatimeve të Trupit Gjykses të shtjelluara më lart, Trupi Gjykses vë në dukje se vetë z. Shala pranoi se kishte qenë në FMK gjatë periudhës së akuzave. Z. Shala pranoi vullnetarisht, si në deklaratën e 2005-ës edhe në deklaratën e 2019-ës se, pasi u kthye në Shqipëri nga fundi i marsit 1999, shkoi në FMK.<sup>1745</sup> Sidoqoftë, z. Shala dha deklarata mospërputhëse në lidhje me sa kohë kishte qëndruar në FMK, që Trupi Gjykses do t'i diskutojë me radhë.

854. *Deklarata e 2005-ës.* Në deklaratën e 2005-ës, z. Shala shpjegoi se kishte qëndruar në FMK deri kur ishte dërguar në Burrel për stërvitje.<sup>1746</sup> Ndonëse jo fort i gatshëm të jepte informacion në lidhje me këtë pikë, z. Shala shtoi se pastaj kishte qëndruar në Burrel deri kur ishte arrestuar sepse “po kishte ndodh një vrasje...”.<sup>1747</sup> Ai u lirua më vonë për shkak se “kushëri [i cili], ishte komandant, kishte marrë post të lartë”.<sup>1748</sup> Nga informacioni, Trupi Gjykses nxjerr përfundimin se paraburgimi i z. Shala pas arrestimit nuk ishte i gjatë. Faktikisht, kur një hetues e pyeti z. Shala se çfarë kishte ndodhur pas arrestimit të tij, ai u përgjigj menjëherë: “jam lirue”.<sup>1749</sup>

855. Edhe pse z. Shala nuk u tregua i gatshëm të jepte hollësi në lidhje me arrestimin e vet, ai dha hollësi për kohën që kishte kaluar në Burrel, që e bën Trupin Gjykses të nxjerrë përfundimin se ai fliste nisur nga përvoja e vet (për shembull, ai shpjegoi se kampi ushtarak ku kishte qëndruar “ishte shtëpia e oficerave, oficerave, djathtas prej

<sup>1745</sup> **Z. Shala:** T000-2748-T000-2748-Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 29-30; 066864-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar) 1, f. 38-42; 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 83-84, 98-99.

<sup>1746</sup> **Z. Shala:** T000-2748-T000-2748-Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 31-32. *shih më tutje, Z. Mark Shala:* T. 23 tetor 2023, publik, f. 2983, rreshtat 9-10, ku shpjegohet se Burreli gjendet në jug të Kukësit, midis Kukësit dhe Tiranës.

<sup>1747</sup> **Z. Shala:** T000-2748-T000-2748-Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 31-33.

<sup>1748</sup> **Z. Shala:** T000-2748-T000-2748- Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 39-40.

<sup>1749</sup> **Z. Shala:** T000-2748-T000-2748-Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 39-40.

shtëpisë” dhe e korrigjoi hetuesin kur sugjeroi se kampi ishte në qytetin e Burrelit, duke sqaruar se ishte në rrethinë).<sup>1750</sup> Z. Mark Shala gjithashtu dëshmoi se z. Shala “ka qenë një kohë [...] në qendrën stërvitore në Burrel”.<sup>1751</sup> Më e rëndësishmja, dëshmitari shtoi se pastaj, z. Shala “ka ardhë në Kukës. Edhe unë në Kukës. Ai ka qenë në Kukës”.<sup>1752</sup> Dëshmia e z. Mark Shala e bën të besueshme deklaratën e 2005-ës të z. Shala dhe anasjelltas.

856. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vë në dukje se z. Shala nuk tregoi se kur saktësisht ishte larguar nga Kukësi për në Burrel dhe kur ishte kthyer. Në lidhje me këtë pikë, Trupi Gjykses mbështetet në dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes z. Dervishaj dhe deklaratën me shkrim të z. Kryeziu.<sup>1753</sup> Z. Dervishaj dëshmoi se edhe ai kishte qenë në Burrel për stërvitje, me anëtarë të tjerë të UÇK-së që u larguan nga Kukësi.<sup>1754</sup> Ai shpjegoi se kishte qëndruar në Burrel afërsisht 12 deri 14 ditë, kur UÇK-ja ishte detyruar të tërhiqej sepse “u vra një ushtar” dhe ata u kthyen në Kukës. Sipas z. Dervishaj, kjo ngjarje ndodhi në fillim të majit 1999.<sup>1755</sup> Rrjedhimisht, sipas tij, anëtarët e UÇK-së u larguan nga Kukësi për në Burrel rreth datës 20 prill 1999 dhe u kthyen në Kukës në fillim të majit 1999.

857. Ngjashëm, z. Kryeziu kujtoi në deklaratën e vet me shkrim se kishte shkuar për t’iu bashkuar UÇK-së rreth 20 deri 30 ditë pasi kishte filluar bombardimi i NATO-s më 24 mars 1999 (d.m.th. afërsisht midis datave 13 dhe 23 prill 2022).<sup>1756</sup> Pak kohë pas kësaj, anëtarë të UÇK-së shkuan në Burrel për stërvitje, ndërsa z. Kryeziu mbeti në

---

<sup>1750</sup> Z. Shala: T000-2748-T000-2748-Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 38.

<sup>1751</sup> Z. Mark Shala: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2966, rreshtat 24-25; f. 2978, rreshtat 14-15; f. 2980, rreshti 10 deri f. 2982, rreshti 8; f. 2983, rreshtat 7-13.

<sup>1752</sup> Z. Mark Shala: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2966, rreshti 25 deri f. 2967, rreshti 1.

<sup>1753</sup> Z. Kryeziu: SITF00014088-00014120 RED.

<sup>1754</sup> Z. Dervishaj: T. 2 tetor 2023, publik, f. 2738, rreshtat 9-11; f. 2751, rreshtat 9-13.

<sup>1755</sup> Z. Dervishaj: T. 2 tetor 2023, publik, f. 2760, rreshti 12 deri f. 2764, rreshti 21.

<sup>1756</sup> Z. Kryeziu: SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014089-SITF00014093, ku shpjegon se kishte kërkuar t’i bashkohej UÇK-së në Kukës, në shtabin ku ishte Ruzhdi Saramati. Trupi Gjykses kupton se këtu i referohet “shtabit nr. 1” ose “repartit numër 1”; *shih* para. 300 më lart.

Kukës.<sup>1757</sup> Rrjedhimisht, sipas z. Kryeziu, anëtarët e UÇK-së u larguan nga Kukësi për në Burrel afërsisht diku midis datave 13 dhe 23 prill 1999.

858. Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në dëshminë e z. Dervishaj dhe deklaratën e z. Kryeziu për të përcaktuar se kur shkuan anëtarët e UÇK-së në Burrel dhe kur u kthyen pasi: (i) të dy dëshmitarët dhanë kronologji koherente të ngjarjeve; (ii) ata konfirmuan njëri-tjetrin në lidhje me kohën e largimit të anëtarëve të UÇK-së për të shkuar në Burrel; (iii) z. Dervishaj ishte i pranishëm në Burrel dhe foli nga përvoja personale; dhe (iv) kujtesa e z. Dervishaj për “ushtarin” e vrarë konfirmohet nga z. Shala. Dëshmia e z. Dervishaj dhe deklarata e z. Kryeziu gjithashtu e bëjnë të besueshme deklaratën e z. Shala dhe dëshminë e z. Mark Shala se z. Shala shkoi nga Kukësi në Burrel dhe pastaj u kthye në Kukës.

859. Trupi Gjykses gjithashtu mori dëshmi nga z. Mark Shala se z. Shala u kthye në Kukës nga Burreli “në fillim të prillit” ose “nga 10 deri 15 prill”, edhe pse dëshmitari nuk e mbante mend saktësisht.<sup>1758</sup> Trupi Gjykses nuk e merr parasysh dëshminë e z. Mark Shala për këtë pikë, pasi ajo kundërshtohet edhe nga z. Dervishaj edhe nga z. Kryeziu.

860. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton, bazuar në dëshmitë e z. Dervishaj dhe z. Kryeziu, që konfirmojnë njëra-tjetrën, se anëtarë të UÇK-së u larguan nga Kukësi për në Burrel për stërvitje, për një kohë të shkurtër, në mes të prillit (më së hershmi) dhe u kthyen në Kukës diku në fillim të majit 1999. Bazuar në deklaratën e 2005-ës të z. Shala dhe dëshminë e z. Mark Shala, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala u largua nga Kukësi për në Burrel me anëtarët e tjerë të UÇK-së në mes të prillit (më së hershmi) dhe u kthye në Kukës diku në fillim të majit 1999. Ndonëse dëshmitë e diskutuara më lart kanë të bëjnë me ngjarje që janë jashtë kuadrit

---

<sup>1757</sup> **Z. Kryeziu:** SITF00014088-00014120 RED, f. SITF00014093.

<sup>1758</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2966, rreshti 24 deri f. 2967, rreshti 3; f. 2969, rreshtat 9-13; f. 2980, rreshti 10 deri f. 2982, rreshti 8.

kohor të Aktakuzës së Konfirmuar, ato vërtetojnë se z. Shala u kthye në Kukës në fillim të majit 1999.

861. *Deklarata e 2019-ës.* Në kundërshtim me deklaratën e 2005-ës, në deklaratën e 2019-ës, z. Shala pohoi se, pasi mbërriti në Kukës në fund të marsit 1999, ai qëndroi në FMK dy ditë dhe pastaj u largua për në vijën e frontit, që gjendej përgjatë kufirit midis Shqipërisë dhe Kosovës.<sup>1759</sup> Ai shtoi se gjithmonë kishte qëndruar në anën shqiptare të vijës së frontit.<sup>1760</sup> Z. Shala pretendoi se vazhdoi të ishte i inkuadruar në UÇK në vijën e frontit deri në fund të konfliktit të armatosur, dhe pastaj u kthye në Belgjikë, dikur në qershor/korrik 1999.<sup>1761</sup>

862. Duke folur për rolin e vet gjatë kësaj periudhe, z. Shala deklaroi se detyrat e tij ishin të përforconte pozicionet e UÇK-së dhe të organizonte transportimin e vullnetarëve nga pikat e mbërritjes në Shqipëri deri në vijën e frontit.<sup>1762</sup> Në këtë kontekst, z. Shala pranoi se ishte kthyer në FMK shpesh për të marrë furnizime dhe për të takuar njerëz.<sup>1763</sup> Ai gjithashtu pranoi se në këto raste kishte takuar TW4-01-shin dhe viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] në oborrin e FMK-së.<sup>1764</sup> [REDAKTUAR].<sup>1765</sup> [REDAKTUAR].<sup>1766</sup> Z. Shala pranoi se, i shtyrë nga ky informacion, i kishte goditur TW4-01-shin dhe viktimën e vrasjes së paligjshme me një copë druri, u kishte dhënë “disa goditje” dhe u kishte rënë me shuplakë. Ai shtoi se

---

<sup>1759</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 103, 112-121.

<sup>1760</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 118, rreshtat 11-23; f. 121, rreshtat 6-14; f. 124, rreshtat 13-16.

<sup>1761</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 117-121.

<sup>1762</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 121, rreshtat 15-25; f. 127-131.

<sup>1763</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 124, rreshti 17 deri f. 125, rreshti 1; f. 131, rreshtat 2-9. Për lidhjet e tij me Kukësin, Z. Shala pohoi se kishte miq aty, të cilët kishin një restorant në qendër të qytetit, dhe se ai rrinte aty: “Kam pirë tek ata dhe nëse kam pasur nevojë, kam fjetur sipër”; *shih f. 141, rreshtat 11-18.*

<sup>1764</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 146-147, 169-170.

<sup>1765</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1766</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 146-157, 161-165.

nuk i kishte parë më asnjëherë pas këtij incidenti.<sup>1767</sup> Gjatë deklaratës përmbyllëse të tij, z. Shala konfirmoi deklaratën e 2019-ës (pjesë të saj), duke konfirmuar se i kishte dhënë TW4-01-shit dhe viktimës së vrasjes së paligjshme “do shuplaka”.<sup>1768</sup> Z. Shala gjithashtu pranoi në deklaratën e 2019-ës se, në një rast tjetër kur kishte shkuar në FMK në vitin 1999, e kishte parë W04733-shin që “i shërbente kafe” Bislim Zyrapit dhe z. Mark Shala. Z. Shala shtoi se kishte dëgjuar thashetheme se W04733 “ishte në kërkim” sepse ai dhe/ose djemtë e tij ishin bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe.<sup>1769</sup>

863. Ndonëse Trupi Gjykses nuk konstaton se deklarata e 2019-ës e z. Shala është tërësisht e besueshme – për arsyet e dhëna më poshtë – ai vëren se z. Shala pranoi se i kishte parë TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe W04733-shin në FMK diku në vitin 1999, dhe konfirmoi akuzat kundër tyre. Trupi Gjykses konstaton se mund të mbështetet në pranimet e z. Shala për këtë aspekt sepse: (i) ai ua dha këtë informacion vullnetarisht autoriteteve belge; (ii) Trupi Gjykses ka konstatuar në Pjesën VI.D më lart se TW4-01, viktimia e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe W04733 me të vërtetë ishin në FMK gjatë kohës që mbulon Aktakuza, por si të ndaluar; dhe (iii) z. Shala konfirmoi saktësisht akuzat e bëra kundër TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme dhe W04733-shit (d.m.th. se ata ishin bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe [REDAKTUAR]).<sup>1770</sup>

864. Edhe pse z. Shala nuk saktësoi se kur në vitin 1999 i kishte parë TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe W04733-shin në FMK, pranimet e tij megjithatë shërbejnë për të përcaktuar praninë e tij në FMK në dy raste të veçanta afërsisht midis datave [REDAKTUAR] maj 1999 dhe 5 qershor 1999, kur katër të

---

<sup>1767</sup> Z. Shala: 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 154-158, 161-163.

<sup>1768</sup> T. 17 prill 2024, publik, f. 4372, rreshtat 12-17.

<sup>1769</sup> Z. Shala: 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 60-61, 65, 180-182.

<sup>1770</sup> Shih Pjesët VI.D.2, VI.D.3, VI.D.5, VI.D.10(b) Pjesët VI.E.2(b) dhe (c).

ndaluarit mbaheshin aty.<sup>1771</sup> Rrjedhimisht, parashtrimi i Mbrojtjes së z. Shala nuk ishte në FMK në fund të majit dhe/ose në qershor 1999 kundërshtohet nga vetë deklarata e z. Shala.<sup>1772</sup>

865. Sa i përket pjesës së mbetur të deklaratës së 2019-ës të z. Shala, Trupi Gjykses nuk e konsideron atë të besueshme sa u përket: (i) rrethanave të takimit të tij me TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe W04733-shin; dhe (ii) faktit që ai ishte në vijën e frontit nga fundi i marsit 1999 deri në fund të konfliktit të armatosur, për arsyet në vijim.

866. Së pari, Trupi Gjykses gjykon se përshkrimi nga z. Shala i rrethanave në të cilat takoi TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe W04733-shin është jo i besueshëm. Siç kujtohet më lart, z. Shala pohoi se, [REDAKTUAR], TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme ishin bashkëpunëtorë serbë [REDAKTUAR].<sup>1773</sup> Në të njëjtën kohë, z. Shala insistoi se ata të dy nuk ishin privuar nga liria dhe lëviznin lirshëm në FMK.<sup>1774</sup> Pyetjet që iu bënë z. Shala gjatë intervistës janë domethënëse:

- [Prokurori]: [REDAKTUAR]?
- [Z. Shala]: Po. [...] Njerëzit shpjegonin – sepse kishte akuza [...] kishin vjedhur nga njerëz në bashkëpunim me serbët [...]. Ata janë /parë/ mbi tanke serbe, me shamia në kokë [...]. Gjithë farë akuzash!
- [Prokurori]: Pra, kishte shumë akuza kundër tyre?
- [Z. Shala]: Po, por!
- [Prokurori]: Dhe përsëri, ti thua se ata lëviznin rreth e rrotull lirisht? [...]
- [Z. Shala]: Po.

<sup>1771</sup> Duke pasur parasysh se periudhat që ata kaluan në ndalim ishin të ndryshme, Trupi Gjykses merr [REDAKTUAR] majin 1999, ose një datë rreth saj, si pikë reference, sepse kjo është data kur TW4-01, [REDAKTUAR] mbërritën në FMK. 5 qershori 1999, ose një datë rreth saj, shërben si pika e fundit e referencës, sepse është data kur vdiq viktima e vrasjes së paligjshme. Sidoqoftë, W04733 u lirua më herët, më 1 qershor 1999, ose rreth kësaj date; *shih* Pjesët VI.D.2(a), VI.D.5(d) dhe VI.F.8.

<sup>1772</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 8 (“I akuzuari nuk ishte i pranishëm në fabrikë në fund të majit dhe/ose qershor 1999”).

<sup>1773</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 146-157, 161-165.

<sup>1774</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 155-158.

- [Prokurori]: Pa u privuar nga liria?
- [Z. Shala]: Po, në oborr, ata ishin aty dhe pinin cigare. Ata pinin cigare!<sup>1775</sup>

867. Trupi Gjykses konstaton se është tërësisht e pagjasë, duke pasur parasysh provat në dokumentacionin e çështjes,<sup>1776</sup> që TW4-01 dhe viktima a vrasjes së paligjshme ishin të lirë të lëviznin nëpër FMK kur dyshoheshin se kishin bashkëpunuar me autoritetet serbe [REDAKTUAR]. E njëjta gjë vlen edhe për W04733-shin. Trupi Gjykses e konstaton të pagjasë që W04733 t'u "shërbente kafe" komandantëve të UÇK-së në atmosferë miqësore, kur "ishte në kërkim" për bashkëpunim me autoritetet serbe.

868. Së dyti, Trupi Gjykses vëren se, edhe pse pretendoi se kishte qenë në vijën e frontit nga fundi i marsit 1999 deri në fund të konfliktit të armatosur, z. Shala nuk ofroi asnjë informacion apo hollësi për kohën që kishte kaluar aty (për shembull, kush ishin eprorët e tij, vendi ku ishte mobilizuar, apo ku kishte fjetur). Përsëri, pyetjet që iu bënë atij janë domethënëse:

- [Prokurori]: A keni patur urdhërvendim nga dikush për të bërë këtë përforsim?
- [Z. Shala]: Jo, nuk ka qenë e nevojshme.
- [Prokurori]: Na shpjegoni, ju lutem?
- [Z. Shala]: Kisha një armë të mirë dhe secili donte një armë shumë afër.
- [Prokurori]: Pra, keni qenë përforsim që të gjithë dëshironin të kishin?
- [Z. Shala]: po, i kërkuar nga të gjithë.
- [Prokurori]: gjithandej?
- [Prokurori]: Kush dëshironte të kishte me vete?
- [Z. Shala]: Kushdo që me shihte.<sup>1777</sup>

Marrja në pyetje vazhdoi:

- [Prokurori]: pra, gjatë kësaj periudhe keni vepruar si ushtar i vërtetë?
- [Z. Shala]: Po
- [Prokurori]: Në front?
- [Z. Shala]: Po [...]
- [Prokurori]: dhe jeni mobilizuar në pika të ndryshme?

<sup>1775</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 156, rreshti 16 deri f. 158, rreshti 2.

<sup>1776</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2, VI.D.3 dhe VI.E.2(a)-(b).

<sup>1777</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 122, rreshtat 4-12; *shih gjithashtu*, f. 127, rreshtat 11-13.

- [Z. Shala]: Për tu mobilizuar në Shqipëri nuk kam pasur nevojë as për para, as për... Madje dija edhe kohën! Ishte e lehtë të mobilizoheshe.
- [Prokurori]: Ku keni fjetur gjatë kësaj periudhe?
- [Z. Shala]: Kudo!
- [Prokurori]: Kudo?
- [Z. Shala]: Kudo.
- [Prokurori]: Për shembull?
- [Z. Shala]: Mali ka qenë vend për të fjetur dhe i sigurt!<sup>1778</sup>

869. Trupi Gjykses priste që z. Shala, si anëtar me përvojë i UÇK-së, të ofronte më shumë informacion dhe hollësi për kohën që kishte kaluar në vijën e frontit. Në vend të kësaj, ai e zhvendoste vëmendjen nga pyetjet ose jepte përgjigje të përgjithshme, që nuk e bindin Trupin Gjykses se ai tregonte të vërtetën apo se fliste bazuar në përvojën personale. Ndryshe nga kjo, në deklaratën e 2005-ës dhe në deklaratën e vitit 2007, z. Shala dha lirisht një mori hollësish në lidhje me kohën që kishte kaluar në UÇK nga marsi 1998 deri në verën e vitit 1998 (kujt i raportonte, ku e kishte bazën, ku ishte dërguar dhe ku flinte).<sup>1779</sup>

870. Së treti, pretendimi i z. Shala në deklaratën e 2019-ës se u largua për në vijën e frontit dy ditë pasi kishte arritur në Kukës<sup>1780</sup> kundërshtohet nga vetë ai në deklaratën e 2005-ës, ku shpjegoi se kishte qëndruar në Kukës, derisa ishte dërguar në Burrel për stërvitje. Në lidhje me këtë pikë, deklarata e 2019-ës e z. Shala kundërshtohet edhe nga dëshmia e z. Mark Shala, siç shpjegohet më lart.<sup>1781</sup> Gjithashtu, edhe në vetë deklaratën e 2019-ës e z. Shala ka mospërputhje të brendshme. Në një pjesë tjetër të deklaratës së 2019-ës, z. Shala shpjegoi se kishte udhëtuar brenda Shqipërisë për të organizuar dhe

<sup>1778</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 123-124.

<sup>1779</sup> **Z. Shala:** T000-2742-T000-2742- Transkripti shqip dhe anglisht – A, f. 33-35, 44-51; T000-2742-T000-2742- Transkripti shqip dhe anglisht-3 – B, f. 2-8; T001-0105-1-A-TR, f. 85-88.

<sup>1780</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 103, rreshtat 12-14; f. 112-121.

<sup>1781</sup> **Z. Shala:** T000-2748-T000-2748-Transkripti shqip dhe anglisht-1, f. 31-32; **z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2966, rreshtat 23-25; f. 2983, rreshtat 7-13.



transportuar vullnetarë nga pika e mbërritjes deri në vijën e frontit dhe pranoi se ishte kthyer në FMK shumë shpesh për të marrë furnizime dhe për të takuar njerëz.<sup>1782</sup>

871. Së katërti, Trupi Gjykses vëren se kur dha deklaratën e 2019-ës, z. Shala e kishte të qartë se krimet (e pretenduara) të kryera në qendrat e ndalimit në Shqipëri po hetoheshin, dhe se dëshmitarë e kishin përmendur me emër si bashkëkryes.<sup>1783</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se në vitin 2019 z. Shala kishte motiv të gënjente dhe të pretendonte se kishte qenë në vijën e frontit, për ta distancuar veten nga FMK-ja dhe krimet e kryera aty. Ky nuk ishte rasti në lidhje me deklaratën e 2005-ës, që ishte deklarata e parë e dhënë nga Z. Shala.

872. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e trajton deklaratën e 2019-ës të z. Shala me kujdes dhe i jep më shumë peshë deklaratës së 2005-ës në lidhje me aspektet relevante. Trupi Gjykses mbështetet në deklaratën e 2019-ës të z. Shala vetëm në atë masë që konfirmohet nga dëshmi të tjera.

873. Sidoqoftë, as deklarata e 2005-ës, as deklarata e 2019-ës e z. Shala nuk zhvlerësojnë dëshmitë përputhëse, koherente dhe konfirmuese të njëra-tjetrës, që janë pjesë e dokumentacionit të çështjes, të dhëna sidomos nga TW4-01, W04733 dhe W01448, si dhe nga z. Elezaj, se z. Shala ishte në FMK në disa raste afërsisht midis datave [REDAKTUAR] maj 1999 dhe 4 qershor 1999 dhe mori pjesë në keqtrajtimin e të ndaluarve. Përkundrazi, pranimi nga z. Shala në deklaratën e 2019-ës se: (i) gjatë kohës që kishte kaluar në UÇK në vitin 1999 ai ishte tërë kohën në Shqipëri;<sup>1784</sup> (ii) ai shkante shumë shpesh në FMK, kur të donte;<sup>1785</sup> dhe (iii) ai ishte aty në së paku dy

---

<sup>1782</sup> *Shih* para. 862 më lart.

<sup>1783</sup> **Z. Shala:** 066864-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar) 1, f. 9-14.

<sup>1784</sup> *Shih* para. 861 më lart.

<sup>1785</sup> *Shih* para. 862 më lart.

raste midis datave [REDAKTUAR] maj 1999 dhe 5 qershor 1999,<sup>1786</sup> mbështet dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur.

### 3. Dëshmi të tjera sipas të cilave z. Shala ishte në vijën e frontit

874. Krahas deklaratës së 2019-ës të z. Shala që u diskutua më lart, Trupi Gjykses mori dëshmi edhe nga z. Mark Shala dhe z. Elezaj që sugjerojnë se z. Shala ishte në vijën e frontit gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Trupi Gjykses do t'i shtjellojë një nga një dëshmitë e tyre.

875. *Z. Mark Shala*. Z. Mark Shala dëshmoi para Trupit Gjykses se e kishte takuar dy herë z. Shala “gjatë luftës”.<sup>1787</sup> Hera e parë ishte në FMK, pasi z. Shala u kthye nga Burreli,<sup>1788</sup> për të cilën Trupi Gjykses konstatoi se ishte aty nga fillimi i majit 1999.<sup>1789</sup> Z. Mark Shala saktësoi se z. Shala erdhi në FMK dhe shprehu synimin për të shkuar në vijën e frontit dhe për të qëndruar atje deri në përfundim të luftës. Sipas z. Mark Shala, ai kërkoi një armë dhe më pas “ka marrë rrugën për vijë të parë të frontit”.<sup>1790</sup>

876. Z. Mark Shala shtoi se nuk e pa më z. Shala deri kur u takuan për herë të dytë “kah përfundimi i luftës”, “dikund para mbarimit të luftës, në qershor [1999]”.<sup>1791</sup> Kur u pyet nga ZPS-ja se çfarë nënkuptonte me “fundi i luftës”, z. Mark Shala shpjegoi se fundi i luftës u shënua me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës,<sup>1792</sup> që Trupi Gjykses vëren se ishte më 9 qershor 1999.<sup>1793</sup> Duke folur për këtë takim të dytë, z. Mark

<sup>1786</sup> *Shih* para. 862 më lart.

<sup>1787</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2966, rreshtat 18-19.

<sup>1788</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2966, rreshti 18 deri në f. 2969, rreshti 7.

<sup>1789</sup> *Shih* para. 860 më lart.

<sup>1790</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2966, rreshti 18 deri në f. 2969, rreshti 3; f. 2984, rreshtat 5-11.

<sup>1791</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 2969, rreshtat 18-19; T. 24 tetor 2023, publik, f. 3069, rreshtat 8-18.

<sup>1792</sup> **Z. Mark Shala**: T. 24 tetor 2023, publik, f. 3074, rreshti 16 deri në f. 3075, rreshti 5.

<sup>1793</sup> [List of Facts of Common Knowledge](#) (Lista e Fakteve të Njohura), Fakti 14.

Shala deklaroi në sallën e gjyqit se me z. Shala u takua rastësisht në një kafene në qendër të Kukësit. Ai shtoi se ata patën një “takim [...] më të relaksumë” pasi “ishim të vetëdijshëm të dy që lufta është kah mbaron”.<sup>1794</sup> Në atë takim, Z. Shala i tha atij se “e krevë misionin tim” “ta sheh Kosovën të çlirume” dhe se po kthehej në Belgjikë.<sup>1795</sup>

877. Gjatë pyetjeve të saj, ZPS-ja e ballafaqoi z. Mark Shala me një deklaratë të mëhershme<sup>1796</sup> ku ai kishte deklaruar ndryshe, në veçanti në lidhje me takimin e dytë të tij me z. Shala.<sup>1797</sup> Në deklaratën e mëhershme të tij, z. Mark Shala pohoi se e kishte parë z. Shala për herë të dytë në FMK aty nga fundi i majit apo fillimi i qershorit 1999, para përfundimit të operacionit Shigjeta:

[ai] u paraqit dhe tha, “Duhet të shkoj në vijë të frontit’. Ka fjetë një natë aty, dhe pastaj është largu. Dhe prej asaj kohe s’e kam pa ma. Kam dëgju se pas përfundimit të operacionit Shigjeta, ai u kthye në Kosovë, dhe pastaj shkoi diku në Perëndim”.<sup>1798</sup>

878. Ndonëse Trupi Gjyqësor e konsideron të pranueshme mundësinë e ndonjë pasaktësie në lidhje me datën e takimit, ai vëren se dëshmia e z. Mark Shala nuk përputhet me deklaratën e mëhershme të tij lidhur me natyrën e takimit me z. Shala. Para Trupit Gjyqësor, z. Mark Shala këmbënguli se takimi i dytë i tyre ndodhi në një kafene në Kukës, se ata e dinin se luftës po i vinte fundi, se z. Shala i kishte thënë se e kishte përmbushur misionin e tij për çlirimin e Kosovës dhe se po planifikonte të kthehej në Belgjikë. Për dallim nga këto, në deklaratën e mëhershme të tij, z. Mark Shala tha se ky takim ndodhi në FMK, jo në një kafene në Kukës, se operacioni Shigjeta

---

<sup>1794</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2969, rreshti 16 deri në f. 2970, rreshti 24; T. 24 tetor 2023, publik, f. 3070, rreshtat 1-7.

<sup>1795</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2969, rreshti 16 deri në f. 2970, rreshti 24; T. 24 tetor 2023, publik, f. 3070, rreshtat 1-7.

<sup>1796</sup> *Shih* deklaratën e mëparshme: 083524-TR-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2).

<sup>1797</sup> **Z. Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3059, rreshti 18 deri në f. 3091, rreshti 20, *që i referohet* deklaratës së mëparshme: 083524-TR-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 23-27.

<sup>1798</sup> **Z. Mark Shala:** T. 24 tetor 2023, publik, f. 3067, rreshti 21 deri në f. 3068, rreshti 6, *ku citohet* deklarata e mëparshme: 083524-TR-ET Part 5 RED2 (Pjesa 5 RED2), f. 26, rreshtat 2-6.

ende vazhdonte, dhe se z. Shala shprehu synimin për të shkuar në vijën e frontit, jo në Belgjikë.<sup>1799</sup> Ndonëse iu bënë pyetje të shumta nga ZPS-ja në lidhje me këtë pikë, dëshmitari vijoi të jepte përgjigje dredhuese, të mjegullta dhe nga pozita mbrojtëse. Ai nuk dha ndonjë shpjegim bindës apo të besueshëm për këto mospërputhje dhe nuk u përpoq të pajtonte dy versionet e tij.<sup>1800</sup>

879. Duke marrë parasysh provat në tërësi, për Trupin Gjykues është e qartë se z. Mark Shala u përpoq ta distancoje z. Shala nga FMK-ja gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Kjo dëmton besueshmërinë e dëshmitarit dhe Trupi Gjykues nuk mund ta besojë dëshminë e tij se z. Shala ishte në vijën e frontit gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk mbështetet në dëshminë e z. Mark Shala për këtë aspekt.

880. *Z. Elezaj*. Z. Elezaj në deklaratën me shkrim pohoi se z. Shala “në Kukës pak ka nejt”, “punë dy, tre ditësh”, “qe pas hy në front si gjithë ushtarët e tjerë”. Dëshmitari shpjegoi se z. Shala në vijën e frontit ishte me “batalionin Atlantiku”, nën komandën e Gani Elezit, si pjesë e Brigadës 128 ose e Brigadës 136, të komanduara përkatësisht nga Ruzhdi Saramati dhe Binak Gashi.<sup>1801</sup>

881. Trupi Gjykues vëren se deklarata e z. Elezaj përputhet me deklaratën e 2019-ës të z. Shala se pas mbërritjes në Kukës, ai qëndroi për dy ditë në FMK dhe më pas u largua për në vijën e frontit.<sup>1802</sup> Megjithatë, pjesa tjetër e dëshmisë së z. Elezaj se z. Shala ishte pjesë e Brigadës 128 ose 136: (i) nuk përputhet me deklaratën e 2019-ës

---

<sup>1799</sup> *Shih gjithashtu, Z. Hoxha*: T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3174, rreshtat 12-18, ku shpjegon se më 6 ose 7 qershor 1999, ai u largua nga Kukësi me detyrën për t’u kthyer në Gjermani “për me ble do pajisje [...] që na u nevojitshin” dhe se “nuk e kam ditë që përfundon lufta ato katër-pesë ditë”. Kjo e bën edhe më pak të besueshme dëshminë e z. Mark Shala se kur u takuan në kafene në Kukës, ai dhe z. Shala e dinin se lufta po mbaronte.

<sup>1800</sup> *Z. Mark Shala*: T. 24 tetor 2023, publik, f. 3059, rreshti 18 deri në f. 3091, rreshti 20.

<sup>1801</sup> *Z. Elezaj*: 060124-TR-ET Part 2 Revised RED 4 (Pjesa 2, e rishikuar, RED4), f. 139-143.

<sup>1802</sup> *Shih* paragrafin 861 më lart.

të z. Shala, sipas së cilës ai nuk ishte asnjëherë pjesë e Brigadës 128,<sup>1803</sup> (ii) bie ndesh me dëshminë e dhënë nga dëshmitari i Mbrojtjes, z. Dervishaj, i cili ishte në vijën e frontit në periudhën në fjalë si anëtar i Brigadës 128 dhe dëshmoi se nuk kishte dëgjuar për z. Shala (“nuk ka pasë Pjetër Shala”);<sup>1804</sup> dhe (iii) sa i përket qenies së z. Shala anëtar i Brigadës 136, kjo nuk mbështetet nga provat në dokumentacionin e çështjes. Në lidhje me këtë pikë, Trupi Gjykses i jep më shumë peshë dëshmive së z. Shala dhe z. Dervishaj, se sa dëshmisë së z. Elezaj, që z. Shala nuk ishte pjesë e Brigadës 128 pasi dëshmitë e z. Elezaj dhe z. Shala konfirmojnë njëra-tjetrën. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se nuk mund ta besojë deklaratën e z. Elezaj se z. Shala ishte në vijën e frontit gjatë periudhës që lidhet me akuzat, as me Brigadën 128, as me Brigadën 136.

882. *Përfundim.* Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë e z. Mark Shala dhe z. Elezaj se z. Shala ishte (kryesisht) në vijën e frontit, nuk hedhin dyshim mbi dëshmitë tejet përputhëse dhe konfirmuese TW4-01-shit, TW4-10-s, W04733-shit, W01448-ës dhe z. Elezaj, i cili e pa personalisht z. Shala në FMK afërsisht midis datave [REDAKTUAR] maj 1999 dhe 4 qershor 1999.

#### 4. Dëshmi të tjera

883. Krahas dëshmive të z. Shala, z. Mark Shala dhe z. Elezaj të diskutuara më lart, Mbrojtja mbështetet edhe në: (i) dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së: TW4-11, TW4-02 dhe TW4-04, të cilët u mbajtën të ndaluar në FMK dhe dëshmuan apo deklaruan se nuk njihnin askënd me emrin Pjetër Shala;<sup>1805</sup> dhe (ii) dëshmitarët e Mbrojtjes

---

<sup>1803</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 76-83, 110-116 (PY: “Ju nuk e kishit gjetur akoma 128-ën? PË: Jo, kjo kuptohet tashmë se ishte gënjeshërë dhe se donin të më hiqnin qafe.”).

<sup>1804</sup> **Z. Dervishaj:** T. 2 tetor 2023, publik, f. 2753, rreshti 4 deri në f. 2754, rreshti 18; f. 2773, rreshtat 10-25; f. 2777, rreshtat 7-14.

<sup>1805</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 20; T. 16 prill 2023, publik, f. 4241, rreshtat 7-14.

z. Kocinaj, z. Hoxha dhe W04280, që ishin në FMK gjatë periudhës përkatëse dhe dëshmuan se nuk njihnin askënd me emrin Pjetër Shala apo me nofkën “Ujku”.<sup>1806</sup> Trupi Gjykses do t'i trajtojë këto dëshmi në vijim.

884. TW4-11, TW4-02 dhe TW4-04. Së pari, në lidhje me dëshmitarët e ZPS-së TW4-11, TW4-02 dhe TW4-04, Trupi Gjykses vë në dukje se: (i) ata u mbajtën të ndaluar në ndërtesën e ndalimit, në dhomën 1 ([REDAKTUAR]) dhe/ose në dhomën 3 ([REDAKTUAR]);<sup>1807</sup> (ii) nuk ka prova që sugjerojnë – dhe as nuk ka pasur pretendime – se z. Shala i keqtrajtoi të ndaluarit brenda dhomave 1 ose 3, madje as që hyri ndonjëherë në dhomat 1 ose 3; dhe (iii) edhe pse dëshmitarët çoheshin për t'u marrë në pyetje në ndërtesën e komandës,<sup>1808</sup> nuk ka prova që sugjerojnë – dhe as nuk ka pasur pretendime – se ata u keqtrajtuuan në mënyrë të ngjashme me TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, W04733-shin dhe W01448-ën. Rrjedhimisht, është tërësisht e besueshme se TW4-11, TW4-02 dhe TW4-04 nuk do ta kishin takuar z. Shala në FMK, edhe në qoftë se ai do të ishte atje në të njëjtën kohë me ta.

885. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë e TW4-11-shit, TW4-02-shit dhe TW4-04-ës: (i) nuk mund të vërtetojnë se z. Shala nuk ishte i pranishëm në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat; dhe (ii) nuk vënë në dyshim besueshmërinë e TW4-01-shit, TW4-10-s, W04733-shit, W01448-ës dhe z. Elezaj dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre se z. Shala ishte i pranishëm në FMK gjatë periudhës përkatëse.

886. Z. Kocinaj. Z. Kocinaj, i cili ishte në FMK gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat,<sup>1809</sup> dëshmoi se nuk kishte takuar dhe as kishte dëgjuar për ndonjë person me emrin Pjetër Shala apo me nofkën “Ujku”.<sup>1810</sup> Trupi Gjykses vëren se z. Kocinaj

---

<sup>1806</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 22, 24-25.

<sup>1807</sup> *Shih* Pjesët VI.D.4, VI.D.8 dhe VI.D.9.

<sup>1808</sup> *Shih* Pjesën VI.E.3.

<sup>1809</sup> **Z. Kocinaj**: T. 3 tetor 2023, publik, f. 2816, rreshti 2 deri në f. 2817, rreshti 22; f. 2839, rreshtat 14-21.

<sup>1810</sup> **Z. Kocinaj**: T. 3 tetor 2023, publik, f. 2831, rreshtat 2-7; f. 2882, rreshtat 18-23.

dëshmoi edhe se: (i) nuk e njihte z. Mark Shala;<sup>1811</sup> (ii) nuk njihte asnjë ndërtesë brenda territorit të FMK-së përveç magazinës ku kishte punuar;<sup>1812</sup> dhe (iii) nuk kishte përdorur asnjëherë banjën brenda kompleksit të FMK-së, pasi sa herë që kishte nevojë të shkonte në banjë, ai shkonte në Kukës në shtëpinë e tij.<sup>1813</sup>

887. Trupi Gjykses konstaton se është tejet e pagjasë që z. Kocinaj të mos e njihte z. Mark Shala, i cili ishte “udhëheqës i logjistikës” në FMK<sup>1814</sup> dhe, rrjedhimisht, epror i z. Kocinaj gjatë periudhës përkatëse.<sup>1815</sup> Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se pretendimet e z. Kocinaj se nuk i njihte ndërtesat e ndryshme në FMK, nuk janë të besueshme, duke pasur parasysh se ai qëndroi në FMK për disa muaj<sup>1816</sup> dhe, sipas vetë dëshmisë së tij, shkonte e vinte në FMK shumë herë gjatë ditës.<sup>1817</sup> Përkundër pritshmërisë së arsyeshme se z. Kocinaj duhej t’i dinte këto fakte, kur u ballafaqua me to, ai nuk qe në gjendje të jepte shpjegim të besueshëm se pse nuk i dinte këto detaje. Në vend të kësaj, z. Kocinaj u shmangej pyetjeve dhe vazhdimisht përsëriste se i kujtohej vetëm puna që kishte bërë dhe asgjë tjetër.<sup>1818</sup> Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se është veçanërisht e pagjasë që z. Kocinaj të mos ketë përdorur asnjëherë banjën e FMK-së e të ketë shkuar në shtëpinë e tij në Kukës (e cila ishte jo më pak se 10 minuta larg) sa herë që kishte nevojë të shkonte në banjë.<sup>1819</sup> Sidomos sepse nga dëshmi të tjera të besueshme në këtë çështje është vërtetuar se për të shkuar në banjë

---

<sup>1811</sup> **Z. Kocinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2880, rreshtat 23-24.

<sup>1812</sup> **Z. Kocinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2821-2822, 2842-2843.

<sup>1813</sup> **Z. Kocinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2844, rreshti 5 deri në f. 2846, rreshti 13.

<sup>1814</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2921, rreshtat 3-10.

<sup>1815</sup> *Shih gjithashtu, Z. Hoxha:* T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3175, rreshtat 4-21, ku shpjegon se ai ishte “mjeshër për riparimin e armatimit” në FMK dhe se eprori i tij ishte z. Mark Shala.

<sup>1816</sup> **Z. Kocinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2816, rreshti 5 deri në f. 2817, rreshti 10; f. 2835, rreshtat 2-6; f. 2839, rreshtat 18-21; f. 2847, rreshti 16 deri në f. 2848, rreshti 2.

<sup>1817</sup> **Z. Kocinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2839, rreshtat 22-25; f. 2843, rreshtat 4-15; f. 2844, rreshti 5 deri në f. 2845, rreshti 1.

<sup>1818</sup> **Z. Kocinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2845-2848, 2853-2856, 2870, 2881-2884.

<sup>1819</sup> **Z. Kocinaj:** T. 3 tetor 2023, publik, f. 2844, rreshti 5 deri në f. 2845, rreshti 1.

duhej të kaloje nga ndërtesa e ndalimit,<sup>1820</sup> ku mbaheshin dhe keqtrajtoheshin të ndaluarit.<sup>1821</sup>

888. Trupi Gjykses konstatoi te z. Kocinaj një synim të qartë për t'u distancuar nga çdo praktikë ndalimi dhe keqtrajtimi në FMK. Z. Kocinaj nuk bëri asnjë përpjekje për të bërë dallimin mes fakteve në dëshminë e tij; përkundrazi, gjatë dëshmisë ai i bëri bisht në mënyrë strategjike aspekteve që kishin të bënin me praktikën e ndalimit dhe keqtrajtimin në FMK për të mbrojtur interesat e tij dhe të personave të tjerë të pranishëm në FMK gjatë periudhës përkatëse. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se z. Kocinaj nuk tregoi të vërtetën dhe, rrjedhimisht, nuk i jep peshë dëshmisë së tij se nuk kishte takuar asnjëherë askënd me emrin Pjetër Shala apo me nofkën "Ujku" në FMK.

889. Z. Hoxha. Z. Hoxha, i cili gjithashtu e kishte bazën në FMK gjatë periudhës përkatëse,<sup>1822</sup> dëshmoi në mënyrë të ngjashme se nuk e kishte takuar Pjetër Shalën dhe nuk kishte dëgjuar për ndonjë person me nofkën "Ujku".<sup>1823</sup> Trupi Gjykses vëren se z. Hoxha gjithashtu dëshmoi se: (i) nuk e njihnte ndërtesën e ndalimit, duke deklaruar se në oborr ishin tre ose katër kamionë të prishur që "nuk kanë lëvizë fare" dhe pengonin pamjen;<sup>1824</sup> dhe se (ii) nuk i kujtohej se ku ishte banja brenda kompleksit të FMK-së.<sup>1825</sup> Gjatë pyetjeve të saj, ZPS-ja e ballafaqoi atë me deklaratën që kishte dhënë më herët,

---

<sup>1820</sup> *Shih* para. 319-322.

<sup>1821</sup> *Shih* para. 588, 653.

<sup>1822</sup> **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3173-3175, 3196-3197; T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3317, rreshti 9 deri në f. 3319, rreshti 18.

<sup>1823</sup> **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3219, rreshti 18 deri në f. 3220, rreshti 5.

<sup>1824</sup> **Z. Hoxha:** T. 20 nëntor 2023, publik, f. 3208-3209, 3211-3212, kur i tregohet **fotografia:** SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010282 (e ruajtur si REG00989); T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3379-3394, kur i tregohen **fotografite:** SPOE40010264-40010559, f. SPOE40010282, SPOE40010289, SPOE40010290; 074390-074391; *shih gjithashtu*, T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3434-3437.

<sup>1825</sup> **Z. Hoxha:** T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3376, rreshti 17 deri në f. 3379, rreshti 5.



ku kishte përmendur se në oborr ishte një kamion i prishur (e jo tre apo katër) dhe se “ka pasur shpesh kamionë që hynin e dilnin”.<sup>1826</sup>

890. Së pari, Trupi Gjykses vëren se z. Hoxha, kur u pyet, nuk dha shpjegim për mospërputhjet në deklaratën e tij. Në vend të kësaj, ai ose e ndryshoi dëshminë e tij, ose këmbënguli se këto mospërputhje nuk ekzistonin. Së dyti, Trupi Gjykses konstaton se është e pagjasë që, duke pasur parasysh përmasat e oborrit, aty të ketë pasur pandërprerë aq shumë kamionë të prishur, pasi në oborr duhej të parkoheshin kamionët (e tjerë) që sillnin furnizime për t’u shkarkuar.<sup>1827</sup> Së treti, dëshmia e z. Hoxha bie ndesh me dëshminë e TW4-01-shit, i cili dëshmoi se nga dritarja e dhomës 1 e ndërtesës së ndalimit, me pamje nga oborri, ai mund të shihte “komplet shtabin”, çka vërteton faktin se fushëpamja e hapësirës midis ndërtesës së ndalimit dhe oborrit nuk ishte e bllokuar.<sup>1828</sup> Së fundi, edhe nëse pranohet se aty kanë qenë disa kamionë, është krejtësisht jo e besueshme që një person, i cili punonte dhe flinte<sup>1829</sup> në magazinë dhe në oborrin e FMK-së, të mos ketë pasur dijeni për ekzistencën e strukturave përreth – d.m.th. për ndërtesën e ndalimit, që ndodhej në mes të oborrit.

891. Si dhe në rastin e z. Kocinaj, Trupi Gjykses konstatoi një synim të qartë të z. Hoxha për t’u distancuar nga çdo praktikë ndalimi dhe keqtrajtimi në FMK. Kjo duket qartë si nga fakti që ai mohoi se e njihnte ndërtesën e ndalimit, ashtu edhe nga dëshmia e tij se nuk i kujtohej vendndodhja e banjës. Z. Hoxha në dëshminë e tij iu shmang në mënyrë strategjike aspekteve që kishin të bënin me praktikën e ndalimit dhe keqtrajtimit në FMK, për të mbrojtur interesat e tij dhe të personave të tjerë të

---

<sup>1826</sup> **Z. Hoxha:** T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3393-3395, 3401; T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3417- 3420, që i referohen deklaratës së mëparshme: 077857-TR-ET Part 2 RED2 (Pjesa 2 RED2), f. 5, 21-23; f. 3424, rreshtat 1-10.

<sup>1827</sup> **Z. Hoxha:** T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3394, rreshtat 15-18; T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3424, rreshtat 1-10; *Shih* Pjesët VI.B.3 dhe VI.E.2(i).

<sup>1828</sup> **TW4-01:** T. 30 maj 2023, publik, f. 1424, rreshtat 1-7.

<sup>1829</sup> **Z. Hoxha:** T. 22 nëntor 2023, publik, f. 3438, rreshtat 1-11.

pranishëm në FMK në atë kohë. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se z. Hoxha nuk tha të vërtetën dhe, rrjedhimisht, nuk i jep peshë dëshmisë së tij se ai nuk kishte takuar asnjëherë askënd me emrin Pjetër Shala apo me nofkën “Ujku” në FMK.

892. W04280. Ngjashëm me z. Kocinaj dhe z. Hoxha, edhe W04280, [REDAKTUAR],<sup>1830</sup> dëshmoi se nuk njihte dhe nuk kishte dëgjuar për askënd me emrin Pjetër Shala apo me nofkën “Ujku”.<sup>1831</sup> Trupi Gjykses vëren se gjatë gjithë dëshmisë së tij, W04280 deklaroi në mënyrë të përsëritur edhe se nuk i kujtohej se si i ishte bashkuar UÇK-së, apo se ku i kishte ushtruar detyrat [REDAKTUAR] brenda FMK-së, duke përmendur problemet që kishte me shëndetin dhe kujtesën.<sup>1832</sup> Kur u pyet nëse kishte parë ndonjë person të ndaluar, W04280 u përgjigj se nuk kishte parë.<sup>1833</sup>

893. Trupi Gjykses konstaton se është e pamundshme që, pavarësisht nga koha që ka kaluar, W04280 të mos mbajë mend aspekte kyçe nga koha kur ishte në UÇK dhe në FMK. Vlen të theksohet se W04280 gjithashtu nuk bëri asnjë përpjekje për t’i kujtuar këto fakte apo për të bërë dallimin mes aspekteve të përvojave të tij që i kujtoheshin dhe atyre që nuk i mbante mend. Gjithashtu, dëshmia e tij se nuk kishte parë askënd që mbahej i ndaluar kundërshtohet qartë nga dëshmitë reciprokisht konfirmuese dhe në të cilat mund të mbështetesh të TW4-01-shit, TW4-04-ës dhe TW4-02-shit, [REDAKTUAR].<sup>1834</sup>

894. Edhe në këtë rast, Trupi Gjykses vuri re një synim të qartë të W04280 për t’u distancuar nga çdo praktikë ndalimi dhe keqtrajtimi në FMK. Edhe ai, për të mbrojtur interesat e tij, në dëshminë që dha iu shmang në mënyrë strategjike aspekteve që kishin të bënin me ndalimin dhe keqtrajtimin në FMK. Për këto arsye, Trupi Gjykses

---

<sup>1830</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1831</sup> **W04280**: T. 28 nëntor 2023, publik, f. 3778, rreshti 20 deri në f. 3779, rreshti 2.

<sup>1832</sup> **W04280**: T. 28 nëntor 2023, konfidencial, f. 3751, rreshti 7 deri në f. 3755, rreshti 7.

<sup>1833</sup> **W04280**: T. 28 nëntor 2023, publik, f. 3784, rreshti 7-17.

<sup>1834</sup> [REDAKTUAR].

konstaton se W04280 nuk tha të vërtetën për këtë aspekt dhe nuk i jep peshë dëshmisë së tij se nuk takoi asnjëherë askënd me emrin Pjetër Shala apo me nofkën "Ujku" në FMK.

895. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë e TW4-11-shit, TW4-02-shit, TW4-04-ës, të z. Kocinaj, z. Hoxha dhe W04280-s se ata nuk e njihnin ose nuk kishin dëgjuar asnjëherë për z. Shala apo për dikë me nofkën "Ujku", nuk vënë në dyshim dëshmitë tejet përputhëse dhe që konfirmojnë njëra-tjetrën të TW4-01-shit, TW4-10-s, W04733-shit, W01448-ës dhe z. Elezaj, të cilët e panë personalisht z. Shala në FMK gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Trupi Gjykses më tej rikujton se vetë z. Shala konfirmoi se kishte qenë rregullisht i pranishëm në FMK gjatë asaj periudhe.

## 5. Përfundim

896. Duke pasur parasysh sa më lart, bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses konstaton se pas mbërritjes së tij në Kukës në fund të marsit 1999, z. Shala shkoi në Burrel për stërvitje (jo më herët se) në mes të prillit 1999. Ai u kthye nga Burreli në Kukës diku aty nga fillimi i majit 1999.

897. Gjatë periudhës që lidhet me akuzat, z. Shala ishte fizikisht i pranishëm në FMK në disa raste, përfshirë më së paku: (i) afërsisht midis datave [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] maj 1999; (ii) më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date; (iii) më 28 ose 29 maj 1999, ose rreth këtyre datave; (iv) më 31 maj 1999, ose rreth kësaj date; dhe (v) më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se z. Shala hynte dhe dilte nga FMK-ja shumë shpesh dhe këtë e bënte pa kufizime, siç deklaroi vetë në deklaratën e 2019-ës. Si rezultat, Trupi Gjykses konstaton se provat nuk mbështesin përfundimin se z. Shala ishte në vijën e frontit, përgjatë kufirit mes Kosovës dhe Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat.

## I. POZITA DHE ROLI I Z. SHALA NË FABRIKËN E METALIT NË KUKËS

### 1. Pozita e z. Shala në radhët e UÇK-së në fabrikën e metalit në Kukës

898. Në deklaratën e 2019-ës, z. Shala konfirmoi se kur u kthye nga Shqipëria në mars 1999, ai mori një autorizim – me sa duket nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së – për të marrë komandën e Brigadës 128 në vijën e frontit.<sup>1835</sup> Ky dokument disponohet si provë edhe nga Trupi Gjykses.<sup>1836</sup> Z. Shala më tej shpjegoi se shpejt kishte kuptuar se, në fakt, autorizimi nuk pasqyronte realitetin, pasi komandant i Brigadës 128 tashmë ishte Ruzhdi Saramati.<sup>1837</sup> Ai shtoi se vullnetarët me të cilët i ishte bashkuar UÇK-së që në Belgjikë, të cilët z. Shala i konsideronte si “ushtarët” e tij”, vazhduan për në vijën e frontit nën komandën e Nasim Haradinajt.<sup>1838</sup> Z. Shala përfundoi duke thënë se, për këtë arsye, kishte “rënë (në gradë), [ishte] bërë ushtar...”<sup>1839</sup> pa një zonë të caktuar përgjegjësie apo anëtarë të UÇK-së nën komandën e tij.

899. Deklarata e 2019-ës e z. Shala konfirmohet nga z. Mark Shala dhe z. Elezaj, të cilët të dy e përshkruajnë z. Shala si “ushtar i thjeshtë”.<sup>1840</sup> Gjithashtu, z. Mark Shala dëshmoi se autorizimi që mori z. Shala për të marrë komandën e Brigadës 128 nuk ishte i vlefshëm apo autentik, pasi nuk përputhej me realitetet në terren.<sup>1841</sup> Rrjedhimisht, z. Mark Shala konfirmoi deklaratën e 2019-ës të z. Shala në këtë aspekt.

---

<sup>1835</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 71-83; 066866-066882-ET Revised RED (e rishikuar RED), f. 066872-066874.

<sup>1836</sup> U009-9398-U009-9398-ET.

<sup>1837</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 71-83; 066866-066882-ET Revised RED (e rishikuar RED), f. 066872-066874.

<sup>1838</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 111.

<sup>1839</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 126, rreshtat 24-25.

<sup>1840</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2970, rreshti 25 deri në f. 2971, rreshti 5; f. 2978, rreshtat 7-9; **Z. Elezaj:** 060124-TR-ET Part 2 Revised RED 4 (Pjesa 2, e rishikuar, RED4), f. 147, rreshti 23 deri në f. 148, rreshti 2.

<sup>1841</sup> **Z. Mark Shala:** T. 23 tetor 2023, publik, f. 2974, rreshti 19 deri në f. 2978, rreshti 20.

Trupi Gjykses konstaton se dëshmitë e dhëna nga z. Shala, z. Mark Shala dhe z. Elezaj në lidhje me këtë pikë janë të besueshme dhe në to mund të mbështetesh, pasi ato konfirmojnë njëra-tjetrën.

900. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se dëshmitë e tyre vetëm vërtetojnë se z. Shala nuk kishte një pozitë zyrtare apo gradë të veçantë në UÇK. Ato nuk qartësojnë pozitën dhe rolin *de facto* të tij gjatë kësaj kohe. Z. Mark Shala dhe z. Elezaj nuk dhanë hollësi në këtë aspekt. Sa i përket z. Shala, Trupi Gjykses rikujton se në vitin 2019, atij i interesonte të minimizonte rolin e tij në FMK dhe ta distancohte veten nga çdo formë përgjegjësie apo pjesëmarrjeje në krimet e kryera atje.<sup>1842</sup>

901. Për të përcaktuar pozitën dhe rolin *de facto* të z. Shala në UÇK gjatë periudhës që lidhet me akuzat, Trupi Gjykses përsërit konstatimet e mëhershme të tij. Trupi Gjykses rikujton se z. Shala hynte dhe dilte rregullisht nga FMK-ja, pa kërkuar leje nga askush.<sup>1843</sup> Sipas z. Elezaj, anëtarët e thjeshtë të UÇK-së duhej të merrnin leje për t'u larguar, qoftë edhe për disa orë.<sup>1844</sup> Trupi Gjykses konstaton se ky është tregues i shkallës së autonomisë që gëzonte ai.

902. Trupi Gjykses i kushton vëmendje edhe rolit të z. Shala në kryerjen e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat, që gjithashtu tregon se ai kishte një shkallë autonomie dhe autoriteti në kuadër të UÇK-së në FMK, veçanërisht në marrjet në pyetje dhe keqtrajtimet e të ndaluarve. Këtë Trupi Gjykses e shtjellon më poshtë.

---

<sup>1842</sup> *Shih* para. 871 më lart.

<sup>1843</sup> *Shih* para. 897 më lart.

<sup>1844</sup> **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 2 Revised RED 4 (Pjesa 2, e rishikuar, RED4), f. 14, rreshtat 17-26.

## 2. Roli i z. Shala në kryerjen e krimeve të përfshira në Aktakuzë

903. Trupi Gjykues rikujton se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, z. Shala, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, mori pjesë në transferimin nën rojë të W04733-shit, nga vendi ku mbahej i ndaluar në Romanat për në FMK.<sup>1845</sup>

904. Po atë ditë, z. Shala, së bashku me Sabit Gecin, Xhemshit Krasniqin, Fatmir Limajn dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, mori pjesë aktive në rrahjen e TW4-01-shit, të viktimës së vrasjes së paligjshme, W04733-shit dhe W01448-ës në zyrën e ndërtesës së komandës.<sup>1846</sup> Më konkretisht, bazuar në dëshmitë, z. Shala ishte i pari që e goditi TW4-01-shin me një shkop gome, çka tregon se ai kishte pushtet për të marrë iniciativën, veçanërisht kur keqtrajtohe të ndaluarit.<sup>1847</sup> Trupi Gjykues rikujton dëshminë e TW4-01-shit se: “[Pjetër Shala] na ka rrah sa ka mujt” dhe “me buzëqeshje na ka rrahur”, çka dëshmon më tej brutalitetin e tij.<sup>1848</sup> Ai mori pjesë edhe në rrahjen e viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1849</sup> Sa i përket W04733-shit, z. Shala e goditi atë me shkop gome dhe shkop bejsbolli në të gjithë trupin dhe në kokë, si dhe në duar dhe këmbë, të cilat për pasojë iu ënjtën.<sup>1850</sup> Së bashku me Xhemshit Krasniqin, ai ishte anëtari i UÇK-së që e keqtrajtoi më së shumti W04733-shin atë natë.<sup>1851</sup> Edhe një herë, fjalët e W04733-shit dëshmojnë brutalitetin e z. Shala: “Pjetër Shala më ka goditur në mënyrën më çnjerëzore të mundshme”.<sup>1852</sup> Z. Shala ishte gjithashtu anëtari i UÇK-së që e rrahu më shumë W01448-ën atë natë.<sup>1853</sup>

---

<sup>1845</sup> *Shih* para. 455 më lart.

<sup>1846</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2 (b), VI.E.2 (c) dhe VI.E.2 (d).

<sup>1847</sup> *Shih* para. 655 më lart.

<sup>1848</sup> *Shih* para. 655 më lart.

<sup>1849</sup> *Shih* para. 660 më lart.

<sup>1850</sup> *Shih* para. 690 më lart.

<sup>1851</sup> *Shih* para. 690 më lart.

<sup>1852</sup> *Shih* para. 690 më lart.

<sup>1853</sup> *Shih* para. 707 më lart.

905. Krahas rrahjes të të ndaluarve, z. Shala e akuzoi W04733-shin si “spiun”, teksa e rrihte.<sup>1854</sup> Ai gjithashtu urdhëroi [REDAKTUAR] të rrihnin W04733-shin, çka tregon edhe një herë se ai kishte një shkallë të caktuar pushteti.<sup>1855</sup> Më tej, teksa [REDAKTUAR] keqtrajtohej nga anëtarë të tjerë të UÇK-së, z. Shala e mori atë në pyetje dhe i kërkoi të jepte deklaratë pranuese, ku të thoshte se [REDAKTUAR] ishin bashkëpunëtorë të serbëve.<sup>1856</sup>

906. Gjithashtu, në deklaratën e tij të vitit 2018 për ZPS-në, W04733 kujtoi se z. Shala në një moment i tha: “Kemi me të vra [...]. Kemi me të ekzekutu”.<sup>1857</sup> Trupi Gjykses konstaton se në këtë aspekt, deklarata e W04733-shit është e besueshme dhe në të mund të mbështetesh, pasi përputhet me: (i) faktin se W04733 u kërcënua nga anëtarë të UÇK-së se do të vritej edhe gjatë transferimit të tij në FMK;<sup>1858</sup> dhe (ii) mënyrën se si u rrah në zyrë më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, veçanërisht në kokë.<sup>1859</sup> Trupin Gjykses nuk e bindin parashtrimet e Mbrojtjes se, fakti që W04733 e përmendi këtë vetëm në deklaratën që i dha ZPS-së në vitin 2018, vë në dyshim besueshmërinë e tij.<sup>1860</sup> Përkundrazi, kjo pasqyron faktin se në vitin 2018 pyetjet u përqendruan më shumë te z. Shala dhe roli i tij, në krahasim me pyetjet që i ishin bërë më parë.

907. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij se më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, z. Shala, së bashku me një grup anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët Xhemshit Krasniqi, “Bedriu” dhe “Van Dami”, morën pjesë aktive në rrahjen e rëndë të [REDAKTUAR] viktimës së vrasjes së paligjshme në dhomën 2 të ndërtesës së

---

<sup>1854</sup> *Shih* para. 692 më lart.

<sup>1855</sup> *Shih* para. 690 më lart.

<sup>1856</sup> *Shih* para. 720 më lart.

<sup>1857</sup> **W04733**: 082892-TR-AT-ET Part 9 RED2 (Pjesa 9 RED2), f. 5, rreshtat 6-14.

<sup>1858</sup> *Shih* para. 447 më lart.

<sup>1859</sup> *Shih* para. 690, 691, 693, 694 më lart.

<sup>1860</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 119.

ndalimit.<sup>1861</sup> [REDAKTUAR].<sup>1862</sup> Z. Shala vazhdoi të merrte pjesë në keqtrajtimin [REDAKTUAR] edhe pasi [REDAKTUAR] viktimë e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] qëlluan me armë [REDAKTUAR].<sup>1863</sup>

908. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses vëren se, në rrahjet e të ndaluarve së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi, z. Shala mori pjesë me vullnet të lirë dhe pa asnjë kufizim, në të njëjtën mënyrë si anëtarët e lartpërmendur të UÇK-së. Këtë e mbështet edhe dëshmia e TW4-01-shit, i cili, i pyetur se çfarë marrëdhënies kishte z. Shala me Xhemshit Krasniqin, deklaroi: “me siguri se i kanë pasë të mira qysh se kanë vepru tani përnjeheri të gjitha qata emnat kanë vepru bashkë në maltretime dhe në tjera gjëra.”<sup>1864</sup>

909. Shkallën e pushtetit të tij e tregon edhe fakti se z. Shala u angazhua brutalisht në keqtrajtimet dhe marrjen në pyetje të të ndaluarve pa pasur frikë për pasojat, siç bëri me TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, W04733-shin, W01448-ën dhe [REDAKTUAR]. Veprimet e tij jo vetëm u lejuan, por edhe u pranuan me lehtësi nga zyrtarët e UÇK-së Xhemshit Krasniqi dhe Sabit Geci, që ishin përbri tij.

910. Trupi Gjykses vë në dukje se në deklaratën e 2019-ës, z. Shala deklaroi se nuk mori pjesë asnjëherë në transferimin, ndalimin apo keqtrajtimin e ndonjë personi në FMK.<sup>1865</sup> Në lidhje me këtë, z. Shala shpjegoi se nuk mund ta kishte bërë këtë pasi ishte i pirë gjatë gjithë kohës.<sup>1866</sup>

911. Trupi Gjykses konstaton se, në këtë aspekt, deklarata e tij e 2019-ës nuk është e besueshme për arsyet e mëposhtme. Së pari, deklarata e z. Shala bie ndesh me

---

<sup>1861</sup> *Shih* [REDAKTUAR] Pjesën VI.F.4.

<sup>1862</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1863</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1864</sup> **TW4-01**: T. 6 qershor 2023, publik, f. 1928, rreshtat 1-13.

<sup>1865</sup> **Z. Shala**: 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 137-138, 178-179, 189-191.

<sup>1866</sup> **Z. Shala**: 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 137-141.



dëshmitë që konfirmojnë njëra-tjetrën ose deklaratat me shkrim të TW4-01-shit, W04733-shit dhe W01448-ës, se ai i keqtrajtoi ata në FMK gjatë kohës që mbaheshin të ndaluar atje. Ajo bie ndesh edhe me deklaratën me shkrim të W04733-shit se z. Shala mori pjesë në transferimin e tij në FMK.<sup>1867</sup>

912. Së dyti, shpjegimi i z. Shala se ishte i dehur gjatë gjithë kohës, bie ndesh me deklaratën e tij se nuk pinte deri në atë pikë sa të humbte vetëdijen. Në fakt, z. Shala shpjegoi se ai pinte “për të qenë pak më në formë” dhe për të pasur më pak frikë nga lufta, dhe se ishte plotësisht në gjendje të kryente funksionet e tij dhe vazhdoi të ishte aktiv.<sup>1868</sup> Z. Shala ra në kundërshtim me veten edhe në lidhje me aspekte të tjera. Për shembull, kur u ballafaqua me deklaratën e W04733-shit se ulërinte si ujk gjatë transferimit të W04733-shit nga Romanati në FMK, z. Shala e mohoi këtë dhe tha se vetëm në front “ndoshta mund të ulëras”.<sup>1869</sup> Kjo bie ndesh me atë që kishte pranuar me parë se ulërima ishte pjesë e personalitetit të tij.<sup>1870</sup> Mohimi i tij hidhet poshtë edhe nga W04733 dhe z. Elezaj, të cilët konfirmuan ulërimën karakteristike të z. Shala.<sup>1871</sup> Për më tepër, z. Shala mohoi se e njihte Xhemshit Krasniqin, me gjithë dëshmitë e shumta për të kundërtën, përfshirë ato të TW4-01-shit, W04733-shit dhe W01448-ës, se ata ishin përfshirë bashkë në keqtrajtimin e të ndaluarve.<sup>1872</sup>

913. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk mund të mbështetet në deklaratën e 2019-ës të z. Shala, ku ai mohon apo minimizon çdo përfshirje në krimet e kryera në FMK, pasi z. Shala e zvogëlon qëllimisht rolin e tij. Deklarimet e tij nuk vënë në dyshim dëshmitë tejet përputhëse dhe që konfirmojnë njëra-tjetrën të

---

<sup>1867</sup> *Shih* para. 447 më lart.

<sup>1868</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 137-141.

<sup>1869</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 190, rreshtat 2-20.

<sup>1870</sup> *Shih* para. 285 më lart.

<sup>1871</sup> *Shih* para. 285 më lart.

<sup>1872</sup> **Z. Shala:** 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 141, rreshti 21 deri në f. 142, rreshti 15.

dëshmitarëve TW4-01, W04733 dhe W01448, të cilët u mbajtën të ndaluar në FMK dhe u keqtrajtuuan prej tij. Përkundrazi, ato pjesë të deklaratës së 2019-ës të z. Shala që janë në përputhje me dëshmitë e këtyre dëshmitarëve i konfirmojnë fuqishëm ato dhe përforcojnë vërtetësinë e tyre, sikurse u shpjegua më lart.<sup>1873</sup>

### 3. Përfundim

914. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykes konstaton se në periudhën që lidhet me akuzat, z. Shala, si anëtar i UÇK-së, lëvizte lirisht brenda dhe jashtë FMK-së dhe kishte një shkallë të caktuar autonomie dhe pushteti, veçanërisht sa i takon keqtrajtimit dhe marrjes në pyetje të të ndaluarve. Ai u angazhua aktivisht me anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër më kryesorët Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi, të cilët mbanin poste me pushtet dhe kishin kontroll në FMK. Ai mori pjesë aktivisht në transferimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve, pa iu druajtur pasojave.

## VII. KONSTATIMET LIGJORE

### A. KONFLIKTI I ARMATOSUR

#### 1. Ekzistenca e konfliktit të armatosur

##### (a) Kriteret ligjore

915. Trupi Gjykes rikujton konstatimet e tij në Aktgjykimin *Mustafa* në lidhje me kornizën ligjore që përcakton ekzistencën e konfliktit të armatosur.<sup>1874</sup> Neni 14(2) i Ligjit përcakton se konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar

---

<sup>1873</sup> *Shih* para. 862-864 më lart.

<sup>1874</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 696-700, dhe referencat aty.

ndodhin në territorin e një shteti kur ekziston një konflikt i armatosur i zgjatur midis organeve të pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara, ose midis grupeve të tilla.<sup>1875</sup> Konfliktet e armatosura karakterizohen nga shpërthimi i luftimeve që ndodhin në territorin e një shteti.<sup>1876</sup>

916. Në lidhje me palët në luftime, neni 14(2) i Ligjit përmend dy kategori të palëve të mundshme në konflikt të armatosur që duhet të interpretohen në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare. “Organet shtetërore” përfshijnë autoritetet qeveritare, si forcat e rregullta të armatosura, njësitë e policisë, gardat kombëtare ose autoritete të tjera të një natyre të ngjashme,<sup>1877</sup> ndër të cilët edhe grupet e armatosura dhe forca të mbrojtjes territoriale të përfshira në forcat e armatosura.<sup>1878</sup> Termi “grupe të armatosura të organizuara” nënkupton një shkallë organizimi, por ato “jo domosdoshmërisht duhet të jenë po aq të organizuara sa forcat e armatosura të një shteti”.<sup>1879</sup> Nuk është e nevojshme që ato të kryejnë operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të bashkërenduara, por duhet të jenë mjaftueshmërisht të organizuara për t’u përballur me njëra-tjetrën me mjete ushtarake.<sup>1880</sup> Në përcaktimin nëse një entitet joshtetëror mund të kryejë dhunë të armatosur për një kohë të zgjatur, mund të merren parasysh faktorët tregues të mëposhtëm: (i) ekzistenca e një strukture komanduese, ku përfshihen ekzistenca e një selie të shtabit, e një shtabi të përgjithshëm ose komande të lartë, e gradave dhe posteve të identifikueshme, dhe e një rregulloreje të brendshme; (ii) lëshimi i deklaratave politike ose komunikatave dhe

---

<sup>1875</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 696, dhe referencat aty.

<sup>1876</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 696.

<sup>1877</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 697. *Shih gjithashtu*, TPNJ, *Prokurori kundër Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, IT-04-82-T, Trial Chamber II, [Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), 10 korrik 2008, para 178, 195.

<sup>1878</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 697. *Shih gjithashtu*, nenin 43(3) të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli Shtesë I), të 8 qershorit 1977.

<sup>1879</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 697, dhe referencat aty.

<sup>1880</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 697. *Shih gjithashtu*, ICTY, [Boškoski and Tarčulovski Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 197-198.

përdorimi i zëdhënësve; (iii) kapaciteti operativ dhe aftësia për kryerjen e operacioneve ushtarake; (iv) kapaciteti logjistik që përfshin disponueshmërinë e armëve dhe pajisjeve dhe kapaciteti për të lëvizur trupat dhe për të rekrutuar dhe stërvitur personelin; (v) kontrolli territorial që përfshin ndarjen në zona të përgjegjësive; (vi) sistemi i brendshëm disiplinor që përfshin zbatimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare në radhët e grupit të armatosur; dhe (vii) aftësia për të folur me një zë të vetëm në emër të grupit të armatosur, për shembull në negociata politike apo marrëveshje armëpushimi.<sup>1881</sup>

917. Në lidhje me nivelin e intensitetit të konfliktit, neni 14(2) i Ligjit kërkon që luftimet ndërmjet palëve duhet të arrijnë një shkallë të caktuar intensiteti që shkon përtej prishjes së rendit dhe tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprimet e izoluara apo sporadike të dhunës apo veprime të tjera të një natyre të ngjashme.<sup>1882</sup> Në këtë kontekst, nocioni i “dhunës së armatosur të zgjatur” shërben për përkufizimin e standardit të intensitetit, sepse i referohet “më tepër intensitetit të dhunës së armatosur se sa kohëzgjatjes së saj”.<sup>1883</sup> Intensiteti mund të deduktohet, për shembull nga (i) ashpërsia dhe shpeshhtësia e sulmeve; (ii) përhapja e tyre në hapësirën territoriale dhe gjatë një periudhe kohe, dhe nëse janë lëshuar urdhra armëpushimi; (iii) shtimi dhe numri i forcave të dislokuara; (iv) mobilizimi dhe shpërndarja e armëve ndër palët në konflikt; (v) lloji i armëve të përdorura, në veçanti përdorimi i artilerisë së rëndë; (vi) përdorimi i mjeteve luftarake, në veçanti përdorimi i tankeve;

---

<sup>1881</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 697. *Shih gjithashtu*, nenin 1(1) 1(1) të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli Shtesë II), të 8 qershorit 1977. *Shih gjithashtu*, ICTY, [Boškosi and Tarčulovski Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 194-203. Megjithatë, shkalla e organizimit të një grupi të armatosur në një konflikt për të cilin është i zbatueshëm neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës, nuk është e nevojshme të jetë në nivelin e organizimit që kërkohet për palët në konfliktet e armatosura për të cilat është i zbatueshëm Protokolli Shtesë II, *shih* TPNJ, [Boškosi and Tarčulovski Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 197.

<sup>1882</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 698.

<sup>1883</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 698, dhe referencat aty.

(vii) nëse situata ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave të tjera ndërkombëtare; (viii) ndikimet në popullatën civile, shkalla e shkatërrimit dhe numri i personave të vrarë ose të zhvendosur; dhe (ix) mënyra në të cilën është trajtuar grupi i armatosur nga aktorë të tjerë ndërkombëtarë dhe cilat janë ligjet sipas të cilave pretendon se ka vepruar.<sup>1884</sup>

918. Së fundi, kuadri kohor dhe gjeografik i konflikteve të armatosura me karakter jondërkombëtar i kapërcen kufijtë e kohës dhe vendit të saktë të luftimeve; rregullat e zbatueshme veprojnë edhe pas pushimit të luftimeve deri në arritjen e një zgjidhjeje paqësore.<sup>1885</sup> Rrjedhimisht, normat e së drejtës humanitare ndërkombëtare janë të zbatueshme pavarësisht nëse faktikisht po ndodhin apo nuk po ndodhin veprimtari luftarake në një vendndodhje të caktuar.<sup>1886</sup> Në rastin e personave të cilëve u është kufizuar liria, e drejta humanitare ndërkombëtare vazhdon të zbatohet deri në momentin kur përfundon heqja apo kufizimi i lirisë.<sup>1887</sup>

#### (b) Konstatime

919. Trupi Gjykses rikujton se ka bërë konstatim gjyqësor në lidhje me disa fakte që kanë të bëjnë me ekzistencën e një konflikti të armatosur ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, edhe gjatë periudhës që mbulojnë akuzat, si dhe për cilësimet e tyre përkatëse si grup i armatosur i organizuar dhe si organ shtetëror, sipas nenit 14(2) të Ligjit.<sup>1888</sup> Trupi Gjykses rikujton se duke bërë konstatim gjyqësor një fakti të shqyrtuar, ai ka

---

<sup>1884</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 698, dhe referencat aty.

<sup>1885</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 700, dhe referencat aty.

<sup>1886</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 700, dhe referencat aty.

<sup>1887</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 700. *Shih gjithashtu*, International Committee of the Red Cross (ICRC), *Commentary on Geneva Convention III relative to the Treatment of Prisoners of War*, 2020, Article 3(4), para. 533, 535; *Commentary on the Additional Protocols to the Geneva Conventions*, 1987, Article 2(2) of Additional Protocol II, para. 4493-4496.

<sup>1888</sup> [Decision on Facts of Common Knowledge and Adjudicated Facts](#) (Vendimi mbi Faktet e Njohura dhe Faktet e Shqyrtuara), para. 33(c). *Shih, në veçanti*, [List of Adjudicated Facts](#) (Lista e Fakteve të Shqyrtuara), faktet 1-29, 34-50.

përcaktuar një prezumim të bazuar mirë për saktësinë e këtij fakti, i cili, për rrjedhojë, nuk është e nevojshme të provohet sërish në gjykim.<sup>1889</sup> Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se gjatë gjykimit Mbrojtja nuk paraqiti ndonjë provë për të kundërshtuar saktësinë e konstatimit për ekzistencën e një konflikti të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe në kohën e kryerjes së krimeve për të cilat janë ngritur akuzat, dhe, rrjedhimisht, nuk u zhvilluan debate juridike gjatë gjykimit në lidhje me këtë aspekt.

920. Krahas këtyre fakteve të shqyrtuara, Trupi Gjykses mori dëshmi të shumta dhe përputhëse, gojore dhe dokumentare, që vërtetojnë nivelin e intensitetit të konfliktit në periudhën që mbulojnë akuzat. Provat tregojnë se forcat serbe dhe UÇK-ja u përfshinë në luftime të armatosura që rezultuan me granatime të rënda dhe viktime. Luftimet e armatosura sollën si rezultat edhe zhvendosjen e një numri të konsiderueshëm shqiptarësh të Kosovës brenda territorit të Kosovës, përgjatë kufirit me Shqipërinë dhe në Shqipëri,<sup>1890</sup> ku ushtria jugosllave ngriti pika kontrolli për të penguar kalimin e kufirit.<sup>1891</sup>

921. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses, bazuar në Vendimin mbi Faktet e Njohura dhe Faktet e Shqyrtuara dhe provat e disponueshme në dokumentacionin

---

<sup>1889</sup> [Decision on Facts of Common Knowledge and Adjudicated Facts](#) (Vendim mbi Faktet e Njohura dhe Faktet e Shqyrtuara), para. 24.

<sup>1890</sup> **Z. Mark Shala**: T. 23 tetor 2023, publik, f. 3000, rreshtat 6-10; **Z. Gashi**: T. 9 janar 2024, publik, f. 3975, rreshtat 6-15; **Z. Hoxha**: T. 21 nëntor 2023, publik, f. 3362, rreshti 5 deri në f. 3363, rreshti 6; **Z. Elezaj**: 060124-TR-ET Part 2 Revised RED 4 (Pjesa 2, e rishikuar, RED4), f. 66, rreshti 18 deri në f. 67, rreshti 12; SPOE00305286-00305288, f. SPOE00305287; SPOE00305289-00305292, f. SPOE00305289, SPOE00305291; IT-05-87 4D00320-E; IT-05-87.1 D00675.E, f. 1-3; SITF00078771-00078781, f. SITF00078773; SPOE00305297-00305298, f. SPOE00305298; 075007-075129, f. 075041, 075087; 074222-074225, f. 074222; SPOE00055399-SPOE00055399-ET; SPOE00133848-00133849, f. SPOE00133848.

<sup>1891</sup> 074222-074225, f. 074222; 075007-075129, f. 075051.

e lëndës, konstaton se në periudhën që mbulojnë akuzat, ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe ekzistonte një konflikt i armatosur jondërkombëtar.<sup>1892</sup>

## 2. Lidhja me konfliktin e armatosur jondërkombëtar

### (a) Kriteret ligjore

922. Krimet për të cilat ngrihen akuza duhet të kenë lidhje të mjaftueshme me konfliktin e armatosur. Nuk është e nevojshme që konflikti i armatosur të ketë shkaktuar kryerjen e krimit për të cilin është ngritur akuzë, por ai duhet të ketë luajtur më së paku një rol të konsiderueshëm në aftësinë e kryesit për kryerjen e krimit, vendimin e tij apo të saj për ta kryer atë, mënyrën se si u krye krimi, ose qëllimin për të cilin u krye ai.<sup>1893</sup> Në përcaktimin e ekzistencës së lidhjes ndërmjet krimit(krimeve) dhe konfliktit të armatosur duhet t'i kushtohet vëmendje: (i) statusit të kryesit dhe të viktimës; (ii) nëse akti i shërbente qëllimit përfundimtar të fushatës ushtarake; ose (iii) nëse akti u krye si pjesë e detyrave zyrtare të kryesit apo në kontekstin e tyre.<sup>1894</sup>

### (b) Konstatime

923. Trupi Gjykues konstaton se kur kryen ndalimin arbitrar dhe torturimin e viktimave si dhe vrasjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së vepruan në kontekstin e detyrave zyrtare të tyre në UÇK. Ata shfrytëzuan statusin e tyre si anëtarë të UÇK-së kur i arrestuan viktimat dhe përdorën

---

<sup>1892</sup> *Shih, ngjashëm, [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 710. Shih gjithashtu, Prokurori kundër Gjorgjeviqit, IT-05-87/1-T, Dhoma Gjyqësore II, [Judgement](#) (Aktgjykim), para. 1579-1580; Prokurori kundër Gjorgjeviqit, IT-05-87/1-A, Dhoma e Apelit, [Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit Gjorgjeviq), 27 janar 2014, para. 521; *Prosecutor v. Milutinović et al.*, IT-05-87-T, Trial Chamber, [Judgement](#), Vol. 1, para. 841; Gjykata e Qarkut të Prishtinës, Prokurori kundër Latif Gashit dhe të tjerëve, C. Nr. 425/2001, [Verdict](#) (Aktgjykim), 16 korrik 2003, f. 4-5, 11-13; *Sabit Geci et al. Verdict* (Aktgjykimi Sabit Geci dhe të tjerët), para. 44; Gjykata Themelore e Mitrovicës, Prokurori kundër Xh. K.-së, P. Nr. 184/15, [Judgment](#) (Aktgjykim), 8 gusht 2016, para. 162.*

<sup>1893</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 712, dhe referencat aty.

<sup>1894</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 712, dhe referencat aty.

fabrikën e metalit në Kukës si vend i caktuar për kryerjen e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat, pavarësisht nëse FMK-ja përdorej edhe për qëllime të tjera nga kryerja e krimeve të përfshira në Aktakuzë.<sup>1895</sup>

924. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstaton se konflikti i armatosur jondërkombëtar që po zhvillohej luajti rol të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve për të cilat u ngritën akuzat, pasi të ndaluarit u mbajtën, u morën në pyetje, u keqtrajtuat dhe u vranë (në rastin e viktimës së vrasjes së paligjshme) mbi bazën, ndër të tjera, të akuzave se ishin “spiunë”, apo “tradhtarë”, se bashkëpunonin me autoritetet serbe, apo se nuk e përkrahnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së.<sup>1896</sup>

925. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se është përmbushur kriteri i lidhjes me konfliktin për krimet e përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar.

### **3. Dijenia për ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe statusin e viktimave**

#### **(a) Kriteret ligjore**

926. Kryesi duhet të ketë dijëni për rrethanat faktike që vërtetojnë konfliktin e armatosur me karakter jondërkombëtar.<sup>1897</sup> Nuk është e nevojshme që kryesi të ketë njohuri për klasifikimin e saktë ligjor të konfliktit të armatosur.<sup>1898</sup>

927. Gjithashtu, të gjitha krimet e luftës duhet të kryhen kundër personave të mbrojtur. Pjesa e përgjithshme e nenit 14(1)(c) të Ligjit që i referohet nenit të përbashkët 3(1) të Konventave të Gjenevës, kërkon që viktima të mos ketë qenë duke marrë pjesë aktivisht në luftime në kohën e kryerjes së veprës penale.<sup>1899</sup> Pjesëmarrje

---

<sup>1895</sup> *Shih* para. 306-307.

<sup>1896</sup> *Shih* para. 750.

<sup>1897</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 718, dhe referencat aty.

<sup>1898</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 718, dhe referencat aty.

<sup>1899</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 719, dhe referencat aty.



aktive në luftime do të thotë kryerje – në kuadrin e luftimeve – të akteve, lloji dhe qëllimi i të cilave synon t'i shkaktojë dëmtim faktik personelit ose pajisjeve të palës kundërshtare.<sup>1900</sup> Personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ndër të cilët edhe anëtarë të forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata që janë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit, apo çfarëdo shkakut tjetër, janë të mbrojtur sipas nenit të përbashkët 3. Kryesi duhet të dijë ose duhet të ketë ditur për statusin e viktimave si persona që nuk marrin pjesë aktive në luftime.<sup>1901</sup>

(b) Konstatime

928. Trupi Gjykes rikujton konstatimet e tij në lidhje me funksionet e FMK-së, pozitën dhe rolin e z. Shala brenda UÇK-së, dhe praninë e tij në FMK gjatë periudhës kur u kryen krimet për të cilat u ngritën akuzat.<sup>1902</sup> Në këtë aspekt, Trupi Gjykes ka konstatuar se FMK-ja funksiononte si shtab i UÇK-së, ku, ndër të tjera, kryheshin rekrutimi, mobilizimi dhe operacione logjistike. Në FMK vinin rregullisht persona për t'u anëtarësuar në UÇK, për të marrë uniforma dhe/ose armatim dhe më pas dërgoheshin drejtpërdrejt nga FMK-ja në qendrat e stërvitjes ose për të luftuar në vijën e frontit (në Kosovë). Mbi bazën e provave, Trupi Gjykes gjithashtu arriti në përfundimin se FMK-ja funksiononte si shtab logjistik për operacionin Shigjeta, ku merreshin, ruheshin dhe shpërndaheshin pajisje ushtarake dhe furnizime ushqimore.<sup>1903</sup> Trupi Gjykes gjithashtu vërtetoi se në kohën kur u kryen krimet për të cilat janë ngritur akuzat, z. Shala ishte anëtar i UÇK-së dhe hynte e dilte lirisht nga FMK-ja.<sup>1904</sup>

---

<sup>1900</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 719, dhe referencat aty. *Shih gjithashtu*, nenin 13(3) të Protokollit Shtesë II.

<sup>1901</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 719, dhe referencat aty.

<sup>1902</sup> *Shih* para. 306-308, 836-897, 898-902.

<sup>1903</sup> *Shih* para. 306 më lart.

<sup>1904</sup> *Shih* para. 914 më lart.

929. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi se z. Shala: (i) ishte i pranishëm në FMK në disa raste gjatë kohës kur u kryen krimet për të cilat janë ngritur akuzat; (ii) mori pjesë, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së në transferimin e një viktime në FMK; (iii) u angazhua aktivisht me policinë ushtarake të UÇK-së; dhe (iv) mori pjesë dhe pa nga afër keqtrajtimin e viktimave, të cilave iu ishte hequr arbitrarisht liria në FMK, ndër to dhe viktima e vrasjes së paligjshme.<sup>1905</sup>

930. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së të pranishëm në FMK gjatë kohës kur u kryen krimet e përfshira në Aktakuzë, kishin dijeni për ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, pasi në FMK kryheshin aktivitete që kishin lidhje me konfliktin.

931. Lidhur me statusin e mbrojtur të viktimave, Trupi Gjykses konstaton se të ndaluarit nuk merrnin pjesë aktive në luftime për shkak se mbaheshin të ndaluar në FMK dhe, si rezultat, ishin të mbrojtur nga neni i përbashkët 3. Në këtë aspekt, z. Shala dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së kishin njohuri për statusin e mbrojtur të viktimave, duke pasur parasysh dijeninë e tyre për praninë e të ndaluarve në FMK dhe pjesëmarrjen personale të tyre në ndalimin dhe keqtrajtimin e zgjatur të viktimave, përfshirë vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme.

## B. NDALIMI ARBITRAR (PIKA 1)

### 1. Kriteret ligjore

#### (a) Baza ligjore

932. Mbrojtja parashtrohet se ndalimi arbitrar nuk përbënte vepër penale sipas ligjit që ishte në fuqi në Kosovë në kohën që mbulojnë akuzat dhe se ndjekja penale e z. Shala

---

<sup>1905</sup> *Shih* para. 897, 903-909, 914 më lart.

për këtë krim lufte është një shkelje e qartë e parimit të ligjshmërisë dhe e të drejtave të tij sipas neneve 6 dhe 7 të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ).<sup>1906</sup>

933. ZPS-ja përgjigjet se argumenti i Mbrojtjes në lidhje me këtë pikë është një përpjekje për të debatuar edhe një herë juridikisht aspekte të cilat janë debatuar dhe për të cilat është vendosur më parë në apel, dhe se kjo çështje tashmë është zgjidhur.<sup>1907</sup>

934. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se Mbrojtja e ka ngritur edhe më parë këtë aspekt juridik në mocionin paraprak të saj për kundërshtimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara.<sup>1908</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit e shqyrtoi këtë kundërshtim dhe konfirmoi se: (i) Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi ndalimin arbitrar si krim lufte i kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit; dhe (ii) ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar ekzistonte si krim lufte sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara.<sup>1909</sup>

935. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se ndalimi arbitrar i kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar penalizohej sipas ligjit që ishte në fuqi në

---

<sup>1906</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 28; T. 16 prill 2024, publik, f. 4269-4273.

<sup>1907</sup> T. 17 prill 2024, publik, f. 4315, rreshtat 10-15, që i referohen KSC-BC-2020-04, IA002-F00010, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Pjetër Shala's Appeal Against Decision on Motion Challenging the Establishment and Jurisdiction of the Specialist Chambers](#) (Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 04), 11 shkurt 2022, publik, para. 47. *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-06, IA009-F00030, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Appeals Against "Decision on Motions Challenging the Jurisdiction of the Specialist Chambers"](#) (Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), 23 dhjetor 2021, publik, para. 86-89, 94-102, 106-111.

<sup>1908</sup> KSC-BC-2020-04, F00054, Mbrojtja, [Preliminary Motion of the Defence of Pjetër Shala to Challenge the Jurisdiction of the KSC](#) (Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Pjetër Shalës që Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së (Mocioni Paraprak i Mbrojtjes në lidhje me Juridiksionin), 12 korrik 2021, publik, para. 47.

<sup>1909</sup> [Case 04 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 04), para. 44-46; *shih gjithashtu*, [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit Mustafa), para. 430; [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 106-111.

Kosovë në kohën e akuzave të paraqitura në Aktakuzë, dhe penalizimi për këtë veprë penale ishte i disponueshëm dhe i parashikueshëm për z. Shala në periudhën përkatëse. Rrjedhimisht, rrëzohet kundërshtimi i Mbrojtjes në lidhje me këtë pikë.

(b) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

936. Trupi Gjykses rikujton se krimi i luftës i ndalimit arbitrar, sipas kuptimit të nenit 14(1)(c) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi apo mosveprimi që sjell si pasojë heqjen e lirisë së një personi që nuk merr pjesë në luftime, pa bazë ligjore dhe pa përmbushur garancitë procedurale bazë.<sup>1910</sup>

937. Heqja e lirisë është pa bazë ligjore nëse nuk përlligjet as prej procesit penal dhe as prej arsyeve për të besuar se heqja e lirisë është absolutisht e domosdoshme për arsye sigurie.<sup>1911</sup>

938. Garancitë procedurale bazë përfshijnë, në veçanti: (i) detyrimin për të informuar çdo person të cilit i është hequr liria për arsyet pse i është hequr liria; (ii) detyrimin për të nxjerrë pa vonesë çdo person të cilit i është hequr liria para një gjykatësi apo një autoriteti tjetër kompetent; dhe (iii) detyrimin për t'i dhënë çdo personi të cilit i është hequr liria mundësinë për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.<sup>1912</sup>

939. Arsyeja e dhënies së garancive procedurale bazë qëndron në faktin se, në atë moment, personi të cilit i është hequr liria është jashtë luftimeve dhe, rrjedhimisht,

---

<sup>1910</sup> Ngjashëm, [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 646.

<sup>1911</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 50; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 647. *Shih gjithashtu*, ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (Delalić et al. Appeal Judgement), 20 February 2001, paras 320-322; *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14-A/2-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (Kordić and Čerkez Appeal Judgement), 17 December 2004, paras 72-73; ECCC, *Co-Prosecutors v. Kaing*, 001/18-07-2007/ECCC/TC, Trial Chamber, [Judgement](#), 26 July 2010 (*Duch Trial Judgment*), para. 465.

<sup>1912</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 51; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 648. *Shih gjithashtu*, nenin 5(4) të KEDNJ-së.

duke qenë se është i ndaluar, nuk paraqet asnjë kërcënim për autoritetet që e kanë ndaluar.<sup>1913</sup>

940. Në kryerjen e vlerësimit nëse janë përmbushur garancitë procedurale bazë, nuk ka rëndësi nëse: (i) heqja e lirisë ishte fillimisht e përligjur;<sup>1914</sup> ose (ii) kryesi është personalisht përgjegjës për mosrespektimin e të drejtave të të ndaluarit.<sup>1915</sup>

941. Detyrimi për të informuar personin për arsyet e heqjes së lirisë synon që personit të cilit i është hequr liria t'i jepet mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit. Rrjedhimisht, personi duhet të informohet si duhet, d.m.th. pa vonesë dhe t'i jepen hollësi të mjaftueshme, për arsyet e ndalimit të tij. Kjo bëhet pavarësisht nëse ndalimi lidhet me një vepër penale apo me një aspekt sigurie.<sup>1916</sup> Ndonëse në të drejtën humanitare ndërkombëtare nuk përmendet niveli i saktë i hollësive apo metoda që duhet të përdoret kur personi informohet për arsyet e arrestimit apo ndalimit, kjo garanci mundëson që personi të kuptojë arsyet bazë për heqjen e lirisë. Pa këtë informacion, garancitë e tjera procedurale bëhen joefektive.

---

<sup>1913</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 649.

<sup>1914</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 52; ICTY, [Delalić et al. Appeal Judgement](#), para. 322. *Shih gjithashtu*, ICTY, [Kordić and Čerkez Appeal Judgement](#), para. 73; ECCC, [Duch Trial Judgment](#), para. 465.

<sup>1915</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 52; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 650. *Shih gjithashtu*, ICTY, [Delalić et al. Appeal Judgement](#), para. 379.

<sup>1916</sup> *Shih* ICRC, [Customary International Humanitarian Law Database](#), rregulla 99; neni 75 i Protokollit Shtesë I, që konsiderohet se pasqyron të drejtën zakonore ndërkombëtare; neni 6 të Protokollit Shtesë II (në lidhje me ndjekjet penale). *Shih gjithashtu*, United Nations General Assembly (UNGA), [Body of Principles for the Protection of All Persons under Any Form of Detention or Imprisonment](#) (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 dhjetor 1988 me rezolutën 43/173, parimet 10 dhe 13. Në komentin e përgjithshëm të tij mbi nenin 9 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP), Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut theksoi se: “nëse zbatohet i ashtuquajti paraburgim parandalues, për arsye të sigurisë publike, ai duhet të kontrollohet nga të njëjtat dispozita, d.m.th. duhet të jepet informacion për arsyet”, *shih* UN Human Rights Committee, [CCPR General Comment No. 8: Article 9 \(Right to Liberty and Security of Persons\)](#), miratuar më 30 qershor 1982, para. 4.

942. Në lidhje me detyrimin për ta nxjerrë pa vonesë personin para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent, Trupi Gjykses vëren se kjo garanci kërkon, më së paku, që një autoritet i pavarur nga ai që urdhëron ndalimin e rishikon ndalimin dhe është i aftë të vlerësojë ligjshmërinë e tij, pra nëse ndalimi vazhdon të jetë i domosdoshëm dhe nëse i ndaluari duhet të lirohet.<sup>1917</sup> Kryerja e kësaj pa vonesë i mundëson personit të kundërshtojë në mënyrë efektive ligjshmërinë e ndalimit të tij.<sup>1918</sup> Nxjerrja para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent shërben edhe si garanci mbrojtëse e rëndësishme kundër shkeljeve të tjera, si shkeljet ndaj të drejtës për jetë apo ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.<sup>1919</sup>

943. Lidhur me detyrimin për t'i dhënë personit të ndaluar mundësinë për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit, Trupi Gjykses thekson se qëllimi i kësaj garancie është shmangia e heqjes arbitrare të lirisë. Kjo arrihet duke siguruar që të

---

<sup>1917</sup> *Shih* ICRC, [CIHL Study](#), rule 99; *shih gjithashtu*, European Court of Human Rights (ECtHR), *Lawless v. Ireland (No. 3)*, Application No. 332/57, [Judgment](#), 1 July 1961, para. 14. Për rastet e ndjekjeve penale në konflikte të armatosura jondërkombëtare, *shih* nenin 75(4) të Protokollit Shtesë I, ku përmendet “një gjykatë e paanshme dhe e themeluar në mënyrë të rregullt”; nenin 6 të Protokollit Shtesë II, ku përmendet “një gjykatë që ofron garancitë themelore të pavarësisë dhe paanësisë”; UNGA, [Body of Principles for the Protection of All Persons under Any Form of Detention or Imprisonment](#), parimi 32. Në komentin e përgjithshëm të tij mbi nenin 4 të KNDCP-së, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut përcaktoi se e drejta për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të një personi nuk mund të anashkalohet, veçanërisht kur shërben për të mbrojtur të drejta të tjera absolute, si e drejta për jetë apo ndalimi i torturës trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, *shih* UN Human Rights Committee, [CCPR General Comment No. 29: Article 4: Derogations during a State of Emergency](#), miratuar më 31 gusht 2001, para. 11, 15-16.

<sup>1918</sup> *Shih* ICRC, [CIHL Study](#), rule 99; UNGA, [Body of Principles for the Protection of All Persons under Any Form of Detention or Imprisonment](#), parimi 11. Në komentin e përgjithshëm të tij mbi nenin 9 të KNDCP-së, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut theksoi se nxjerrja pa vonesë e personit para një autoriteti gjyqësor nënkupton se “vonesat nuk duhet të jenë më shumë se disa ditë”, *shih* UN Human Rights Committee, [General Comment No. 8 on Article 9 of the ICCPR](#), para. 2.

<sup>1919</sup> UNGA, [Body of Principles for the Protection of All Persons under Any Form of Detention or Imprisonment](#), parimet 33 dhe 34; *shih gjithashtu*, parimin 21 në lidhje me deklaratat pranuese të marra me detyrim.

kryhet rishikimi fillestar të ndalimit dhe mbikëqyrja e vazhdueshme gjatë kohës së ndalimit të personit.<sup>1920</sup>

(c) Elementet mendore (synimi kriminal)

944. Sjellja e kryesit duhet të ketë qenë e qëllimshme. Ekzistenca e synimit për kryerjen e kimit mund të deduktohet nga dijenia e të akuzuarit se po kryhen krime dhe nga pjesëmarrja e tij në vetë kryerjen e këtyre krimeve.<sup>1921</sup> Gjithashtu, nuk duhet të ekzistojnë arsye që kryesi të besojë se ndalimi është absolutisht i domosdoshëm për shkak të shqetësimeve të palëve në konflikt për sigurinë, ose kryesi duhet ta dijë se të ndaluarve nuk u janë akorduar garancitë e duhura procedurale, ose të tregojë neglizhencë të qëllimshme nëse këto garanci janë akorduar apo jo.<sup>1922</sup>

## 2. Konstatime

(a) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

945. Trupi Gjykues ka konstatuar se afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, në FMK, anëtarë të UÇK-së u hoqën lirinë së paku këtyre personave: TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, TW4-11-shit, W04733-shit, W01448 -ës, TW4-05-ës, TW4-04-ës, TW4-02-shit, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një muzikanti të tretë rom, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe së paku një femre tjetër të ndaluar, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].<sup>1923</sup>

<sup>1920</sup> *Shih* ICRC, [CIHL Study](#), rule 99; UNGA, [Body of Principles for the Protection of All Persons under Any Form of Detention or Imprisonment](#), parimi 32.

<sup>1921</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 651. *Ngjashëm*, ICTR, *Karemara and Ngirumpatse v. Prosecutor*, ICTR-98-44-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 29 September 2014, para. 632; ICTY, *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Kvočka et al. Appeal Judgement*), 28 February 2005, paras 109-110.

<sup>1922</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 53; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 651. *Shih gjithashtu*, ICTY, [Delalić et al. Appeal Judgement](#), para. 378.

<sup>1923</sup> *Shih* para. 587 më lart.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se është përmbushur elementi i parë material i ndalimit arbitrar si krim lufte.

946. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka konstatuar se gjatë ndalimit të tyre, të ndaluarve në asnjë moment nuk iu akorduan garancitë bazë, të cilat sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare duhet t'i jepen çdo personi të cilit i hiqet liria.

947. Së pari, asnjë prej të ndaluarve nuk u informua pa vonesë për arsyet e heqjes së lirisë.<sup>1924</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, ata nuk u mbajtën në FMK në bazë të ndonjë akuze penale dhe nuk kishte shqetësime për sigurinë që e bënin ndalimin e tyre absolutisht të domosdoshëm. Përkundrazi, ata u arrestuan dhe u mbajtën të ndaluar me akuza të paqarta si “bashkëpunëtorë”, “spiunë”, “tradhtarë”, apo sepse nuk kishin mbështetur mjaftueshëm luftën e UÇK-së.<sup>1925</sup>

948. Së dyti, gjatë kohës që u mbajtën në FMK, të ndaluarit nuk u nxorën pa vonesë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent dhe atyre nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre. Në këtë aspekt, as anëtari i UÇK-së z. Kryeziu, i cili u prezantua para të ndaluarve si “gjykatës” ose “prokuror”, as Sokol Dobruna apo ndonjë anëtar tjetër i UÇK-së, nuk ushtroi funksionet e një “gjykatësi” apo autoriteti “kompetent” për përmbushjen e kësaj garancie procedurale.<sup>1926</sup> Z. Kryeziu dhe Sokol Dobruna jo vetëm nuk ushtuan funksionet e një autoriteti të pavarur që mbikëqyr ligjshmërinë e ndalimit të personit; ata morën pjesë aktive në marrjet në pyetje dhe nuk kishin kompetencë të urdhëronin në mënyrë të pavarur lirimin e ndonjërit prej tyre.<sup>1927</sup> Çka është më kryesore, gjatë gjithë ndalimit të tyre, një numër të ndaluarish u keqtrajtuuan rëndë nga anëtarë të UÇK-së, ndër ta dhe z.

---

<sup>1924</sup> *Shih* para. 591 më lart.

<sup>1925</sup> *Shih* para. 590 më lart.

<sup>1926</sup> *Shih* para. 472, 530 më lart.

<sup>1927</sup> *Shih* para. 422, 541 më lart.



Shala.<sup>1928</sup> Disa u detyruan të japin deklarata pranuese,<sup>1929</sup> dhe një prej tyre u vra.<sup>1930</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se është përmbushur elementi i dytë material i ndalimit arbitrar si krim lufte.

949. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se janë përmbushur elementet materiale të ndalimit arbitrar si krim lufte.

(b) Elementet mendore (synimi kriminal)

950. *Kundërshtimet e Mbrojtjes*. Mbrojtja parashton se ZPS-ja nuk ka paraqitur prova të besueshme që tregojnë se z. Shala mori pjesë në ndonjë veprim për zbatimin dhe vazhdimin e ndalimit arbitrar në FMK, dhe/ose se ka pasur dijeni për ndonjë person të ndaluar arbitrarisht në FMK, ose se ka marrë pjesë apo ka qenë i përfshirë në ndonjë mënyrë në arrestimin, transferimin, ndalimin arbitrar ose vazhdimin e ndalimit arbitrar të paligjshëm ose në lirimin e ndonjë personi në FMK.<sup>1931</sup> Në veçanti, Mbrojtja argumenton se ZPS-ja nuk ka paraqitur prova se z. Shala kishte dijeni për ndonjë person të ndaluar në FMK pa qenë i akuzuar zyrtarisht apo pa një vendim se ekzistonin arsye për të besuar se ndalimi i tij ishte absolutisht i domosdoshëm për arsye sigurie; apo se ai tregoi neglizhencë të qëllimshme lidhur me nëse ndonjë person ishte ndaluar pa iu akorduar garancitë procedurale bazë.<sup>1932</sup> Së dyti, Mbrojtja argumenton se ZPS-ja nuk ka paraqitur prova se z. Shala kishte pushtet apo kontroll mbi vendimet lidhur me arrestimin, vazhdimin e ndalimit, lirimin apo kushtet e ndalimit të ndonjë personi në FMK. Këto pika Trupi Gjykses do t'i trajtojë më poshtë.

951. *Vlerësimi i Trupit Gjykses*. Trupi Gjykses konstaton se kryesit, ndër të cilët edhe z. Shala, vepruan në mënyrë të qëllimshme. Gjatë periudhës që mbulojnë akuzat, ata

---

<sup>1928</sup> *Shih* para. 749-750 më lart dhe konstatimet në Pjesën VI.I.

<sup>1929</sup> *Shih* para. 656, 675, 718, 830-832 më lart.

<sup>1930</sup> *Shih* para. 830-832 më lart.

<sup>1931</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 47.

<sup>1932</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 72.

ishin të pranishëm në FMK, arrestuan të ndaluarit, i keqtrajtuat ata rregullisht dhe vazhdimisht në mënyra të ndryshme, i morën në pyetje, i mbajtën të mbyllur në FMK në disa dhoma që përdorshin për ndalimin e personave, dhe morën vendime sipas dëshirës për fatin apo lirimin e të ndaluarve.<sup>1933</sup>

952. Z. Shala në veçanti e dinte se po kryheshin ndalim arbitrar dhe krime të tjera dhe me pjesëmarrjen e tij në to synoi kryerjen e këtyre krimeve.<sup>1934</sup> Konkretisht, z. Shala mori pjesë në transferimin nën rojë të W04733-shit nga Romanati në FMK.<sup>1935</sup> Gjithashtu, në disa raste, në maj dhe qershor 1999, ai ishte i pranishëm në FMK, përfshirë edhe në momentet kritike: (i) më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, kur keqtrajtoi personalisht TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, W04733-shin dhe W01448-ën, dhe kur mori në pyetje [REDAKTUAR], dhe i kërkoi të jepte deklaratë pranuese;<sup>1936</sup> dhe (ii) më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, gjatë incidentit të gjuajtjes me armë zjarri që çoi në vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, kur ai keqtrajtoi personalisht [REDAKTUAR] viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>1937</sup>

953. Gjithashtu, kryesit, ndër ta dhe z. Shala, nuk kishin arsye të besonin se ndalimi i këtyre personave ishte absolutisht i domosdoshëm për shkak të shqetësimeve për sigurinë. Sa i përket TW4-01-shit dhe viktimës së vrasjes së paligjshme, vetë z. Shala, kur i pa në oborrin e FMK-së, vlerësoi se nuk paraqisnin ndonjë rrezik për sigurinë. Për më tepër, z. Shala ishte në dhomë kur ndaj të ndaluarve, ndër ta W04733 dhe TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, W01448 dhe [REDAKTUAR], u bënë akuza, ndërkohë që i rrihnin.<sup>1938</sup> Madje z. Shala personalisht bëri akuza ndaj disa prej të ndaluarve.<sup>1939</sup> Rrjedhimisht, ai kishte dijeni të plotë se këta persona nuk mbaheshin në

---

<sup>1933</sup> *Shih* konstatimet në Pjesët VI.D., VI.E., VI.I.2.

<sup>1934</sup> *Shih* konstatimet në Pjesën VI.I.2.

<sup>1935</sup> *Shih* para. 903 më lart.

<sup>1936</sup> *Shih* para. 905 më lart.

<sup>1937</sup> *Shih* para. 907 më lart.

<sup>1938</sup> *Shih* para. 904-907 më lart.

<sup>1939</sup> *Shih* para. 905 më lart.

FMK për akuza konkrete dhe ndalimi i tyre nuk ishte absolutisht i domosdoshëm për arsye sigurie.

954. Duke pasur parasysh se z. Shala mori pjesë në keqtrajtimin e [REDAKTUAR], pretendimi i Mbrojtjes se ai nuk kishte dijeni për ndalimin e tyre është i pabazë. Duke pasur parasysh rrethanat, kryesit, përfshirë z. Shala, e dinin se të ndaluarve nuk u ishin akorduar garancitë procedurale të nevojshme.

955. Pjesëmarrja personale dhe e përsëritur e z. Shala në keqtrajtimin e të ndaluarve, së bashku me dijeninë e tij se në FMK mbaheshin persona të ndaluar, tregojnë se ai mori pjesë në heqjen e qëllimshme të lirisë së këtyre personave dhe e dinte se atyre nuk u ishin dhënë garanci bazë gjatë kohës së ndalimeve përkatëse të tyre. Rrjedhimisht, argumenti i Mbrojtjes rrëzohet.

956. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se është vërtetuar elementi mendor i ndalimit arbitrar si krim lufte.

## C. TRAJTIMI MIZOR (PIKA 2)

### 1. Kriteret ligjore

#### (a) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

957. Trupi Gjykses në vijim rikujton konstatimet e tij në lidhje me elementet materiale dhe mendore të këtij krimi, dhe jurisprudencën mbështetëse përkatëse të shtjelluar në Aktgjykimin *Mustafa*. Rrjedhimisht, trajtimi mizor si krim lufte, sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet përmes një veprimi ose mosveprimi që shkakton vuajtje ose lëndim të rëndë mendor ose fizik, ose që përbën cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor.<sup>1940</sup>

---

<sup>1940</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 660, dhe referencat aty.

958. Shkalla e rëndësisë së dëmit ose lëndimit duhet vlerësuar rast pas rasti, duke marrë parasysh faktorë si: (i) ashpërsia e sjelljes së pretenduar; (ii) lloji i veprimit ose mosveprimit; (iii) konteksti në të cilin ka ndodhur sjellja; (iv) kohëzgjatja dhe/ose përsëritja e sjelljes; (v) ndikimi fizik dhe mendor i sjelljes mbi viktimën; dhe (vi) rrethanat personale të viktimës, ndër të cilat mosha, gjinia dhe gjendja shëndetësore.<sup>1941</sup>

959. Vuajtja e shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi mbi viktimën nuk është e nevojshme të jetë afatgjatë, me kusht që të jetë reale dhe e rëndë.<sup>1942</sup>

(b) Elementet mendore (synimi kriminal)

960. Kryesi duhet të ketë vepruar në mënyrë të qëllimshme ose me dijeninë se vuajtja apo lëndimi i rëndë mendor ose fizik, ose cenimi i rëndë i dinjitetit njerëzor, ishte pasojë e mundshme e veprimit ose mosveprimit.<sup>1943</sup>

## 2. Lidhja ndërmjet trajtimit mizor dhe torturës

961. Trupi Gjykues e ka shtjelluar më parë aspektin e lidhjes ndërmjet krimeve të luftës së trajtimit mizor dhe torturës në Aktgjykimin *Mustafa* dhe më poshtë do të rikujtojë konstatimet e bëra.<sup>1944</sup> Në të, Trupi Gjykues u shpreh se, për hir të drejtësisë, vetëm krime të veçanta mund të përlligjin verdikte fajësie të shumëfishtë.<sup>1945</sup> Trupi Gjykues gjykon se, kur dy vepra penale, dispozitat për të cilat mbrojnë të njëjtën vlerë (vlera) apo interes (interesa) shoqërore, verdiktet për fajësi të shumëfishtë për të dyja

---

<sup>1941</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 661, dhe referencat aty.

<sup>1942</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 662, dhe referencat aty.

<sup>1943</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 663, dhe referencat aty.

<sup>1944</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 664-667.

<sup>1945</sup> *Shih gjithashtu*, ICTY, [Delalić et al. Appeal Judgement](#), para. 412; *Prosecutor v. Kunarac et al.*, IT-96-23 & IT-96-23/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Kunarac et al. Appeal Judgement*), 12 June 2002, para. 169.

veprat bazuar në të njëjtën sjellje, në parim nuk janë të lejueshme.<sup>1946</sup> Nëse e njëjta sjellje përmbush kushtet e dy dispozitave të ndryshme ligjore, të cilat të dyja mbrojnë të njëjtën vlerë (vlera) apo interes (interesa), mbizotëron dispozita më specifike.<sup>1947</sup> Nëse njëra, dhe vetëm njëra, dispozitë kërkon një element shtesë që nuk kërkohet nga tjetra, dispozita e parë zakonisht do të ishte ajo më specifike dhe do të mbizotëronte,<sup>1948</sup> pasi në raste të tilla nuk është e mundur të kryhet vepra më specifike pa kryer gjithashtu (dhe njëkohësisht) veprën më pak specifike.<sup>1949</sup> Me fjalë të tjera, vepra penale më specifike përfshin ose mbulon plotësisht veprën më pak specifike.<sup>1950</sup>

962. Neni 14(1)(c) i Ligjit që trajton torturën dhe trajtimin mizor mbron të njëjtën vlerë (vlera) ose interes (interesa) shoqërore, në veçanti, integritetin fizik dhe mendor dhe dinjitetin njerëzor të personave që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime.<sup>1951</sup> Gjithashtu,

<sup>1946</sup> Në lidhje me “standardin e vlerës”, shih ICTY, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (*Kupreškić et al. Trial Judgement*), 14 January 2000, paras 692-695; *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-T, Trial Chamber, [Decision on Defence Challenges to Form of the Indictment](#), 15 May 1998, para. 6 (lidhur me atë nëse Prokurori mund të paraqesë akuza të shumëfishta ose jo); ICTR, *Prosecutor v. Akayesu*, ICTR-96-4-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 2 September 1998, para. 468; Stuckenberg, C.-F., “Multiplicity of Offences: Concursum Delictorum”, in Fischer H. et al. (eds), *International and National Prosecution of Crimes Under International Law: Current Developments*, Berlin: Verlag Arno Spitz (2001), pp. 582, 586.

<sup>1947</sup> Shih gjithashtu, ICTY, [Kupreškić et al. Trial Judgement](#), paras 683-685.

<sup>1948</sup> Ngjashëm, ICTY, [Delalić et al. Appeal Judgement](#), para. 413; [Kordić and Čerkez Appeal Judgement](#), para. 1032; [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 168; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2792; [Bemba et al. Trial Judgment](#), para. 951; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 1202; [Katanga Trial Judgment](#), para. 1695; [Bemba Trial Judgment](#), paras 747-748; [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 750. Dispozita të qarta të legjislacionit shtetëror në lidhje me këtë aspekt mund të gjenden, për shembull në [Article 55\(2\) of the Criminal Code of the Kingdom of the Netherlands](#) dhe [Article 15 of the Italian Criminal Code](#).

<sup>1949</sup> Ngjashëm, ICTY, [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 170; *Prosecutor v. Krstić*, IT-98-33-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 19 April 2004, para. 218.

<sup>1950</sup> Shih gjithashtu, ICTY, [Kupreškić et al. Trial Judgement](#), paras 662, 665, 680-692, 707; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2796; [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 751. Nga legjislacionet shtetërore, një dispozitë e qartë dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me këtë aspekt mund të gjendet, për shembull, në [Article 8\(3\) of the Spanish Criminal Code](#).

<sup>1951</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 665. Shih gjithashtu, ICRC, *Commentary on Geneva Convention I or the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field*, 2016, neni 3, para. 590; ICTY, *Prosecutor v. Aleksovski*, IT-95-14/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 25 June 1999, para. 49; *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (*Delalić et al. Trial Judgement*), 16 November 1998, para. 551.

siç konstatohet më poshtë, për torturën nevojitet një element shtesë, konkretisht që kryesi duhet ta ketë shkaktuar dhimbjen ose vuajtjen jo vetëm qëllimisht, por edhe me synime të tilla si marrja e informatave ose e një deklaratë pranuese, ose ndëshkimi, frikësimi, shtrëngimi ose diskriminimi, për çfarëdo arsyeje, i viktimës ose një personi të tretë.<sup>1952</sup> Siç u konstatua më lart, ky element mendor shtesë nuk kërkohet për krimin e trajtimit mizor – për trajtimin mizor, në krahasim me torturën, nuk nevojitet një element shtesë.<sup>1953</sup> Me fjalë të tjera, elementet ligjore të trajtimit mizor mbulohen tërësisht nga elementet ligjore të torturës.<sup>1954</sup>

963. Trupi Gjykses thekson se faktet në të cilat bazohet akuza për trajtim mizor (Pika 2) dhe faktet në të cilat bazohet akuza për torturë (Pika 3) janë të njëjta.<sup>1955</sup> Në vlerësimin e peshës ose shkallës së dëmit ose vuajtjes që u është shkaktuar të ndaluarve, Trupi Gjykses ka marrë parasysh në tërësi të gjitha veprimet dhe mosveprimet e z. Shala dhe anëtarëve të tjerë të UÇK-së në FMK gjatë periudhës që mbulojnë akuzat, përfshirë kushtet e ndalimit, keqtrajtimin psikologjik të pësuar nga të ndaluarit dhe keqtrajtimin fizik që iu bë atyre në vende të ndryshme brenda territorit të FMK-së.

964. Rrjedhimisht, meqenëse kriteret e trajtimit mizor dhe torturës si krime lufte përmbushen mbi bazën e së njëjtës sjellje, dhe tortura është vepra penale më specifike, akuza për trajtim mizor nuk do të shqyrtohet më tej në kuadër të përcaktimit të dënimit.<sup>1956</sup> Akuza e trajtimit mizor mbulohet plotësisht nga akuza e torturës dhe

---

<sup>1952</sup> *Shih* Pjesën VII.D.1(b).

<sup>1953</sup> *Shih* Pjesën VII.C.1(b). *Shih gjithashtu*, TPNJ, Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve, IT-04-84-T, Dhoma Gjyqësore I, [Judgement](#) (Aktgjykim), 3 prill 2008, para. 480; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2835.

<sup>1954</sup> *Shih gjithashtu*, ICTY, [Kupreškić et al. Trial Judgement](#), paras 679, 690-692, me referenca nga ECtHR, *Aksoy v. Turkey*, Application No. 21987/93, [Judgment](#), 18 December 1996, para. 64; [Delalić et al. Trial Judgement](#), para. 442.

<sup>1955</sup> *Shih* [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 18-24, 26.

<sup>1956</sup> *Shih gjithashtu*, ICTY, [Kupreškić et al. Trial Judgement](#), para. 719; [Dorđević Appeal Judgment](#), dhe referencat aty.

përgjegjësia penale individuale e z. Shala pasqyrohet plotësisht në një verdikt fajësie për torturën.

#### D. TORTURA (PIKA 3)

##### 1. Kriteret ligjore

###### (a) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

965. Trupi Gjykues rikujton më poshtë konstatimet e tij në lidhje me elementet materiale dhe mendore të torturës si krim lufte dhe jurisprudencën mbështetëse përkatëse të shtjelluar në Aktgjykimin *Mustafa*. Rrjedhimisht, tortura si krim lufte sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që shkakton dhimbje ose vuajtje të rëndë, qoftë fizike apo mendore, tek një person tjetër.<sup>1957</sup> Duhet të shqyrtohet rast pas rasti nëse veprimi apo mosveprimi i përmbush kriteret e aktit të torturës,<sup>1958</sup> duke marrë parasysh, për shembull (i) llojin dhe rrethanat e shkakimit të dhimbjes; (ii) paramendimin dhe institucionalizimin e keqtrajtimit; (iii) gjendjen fizike të viktimës; (iv) moshën, gjininë dhe gjendjen shëndetësore të viktimës; (v) mënyrën dhe metodat e përdorura; (vi) pozitën inferiore të viktimës; (vii) shkallën e keqtrajtimit të individit për një periudhë të zgjatur kohe; dhe (viii) nëse viktima është bërë objekt i formave të përsëritura ose të ndryshme të keqtrajtimit të cilat janë të ndërlidhura, kryhen sipas një praktike të caktuar sjelljeje, ose bëhen për arritjen e të njëjtit qëllim të ndaluar, rast në të cilin pesha e veprimeve duhet të vlerësohet në tërësi.<sup>1959</sup>

---

<sup>1957</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 668, dhe referencat aty. *Shih gjithashtu, Mustafa Appeal Judgment* (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 404, dhe referencat aty.

<sup>1958</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 668, dhe referencat aty.

<sup>1959</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 668, dhe referencat aty.

966. Kushtet e imponuara gjatë ndalimit si rrahjet, dhuna seksuale, pamundësimi për një kohë të gjatë i gjumit, ushqimit, higjienës dhe ndihmës mjekësore, si dhe kërcënimet me torturë, përdhunim ose vrasje të afërme, janë vlerësuar mjaftueshëm të rënda sa të përbëjnë torturë.<sup>1960</sup> Më konkretisht, kërcërimi i një personi me vdekje, ekzekutim, torturë ose vuajtje, ose në përgjithësi ngjallja e frikës të ndaluarit për shkak të kushteve të ndalimit, mund të shkaktojë ankth të rëndë mendor ose vuajtje dhe/ose trauma psikologjike.<sup>1961</sup> Në veçanti, dhimbja ose vuajtja e rëndë mendore mund të shkaktohet kur të ndaluarit detyrohen të jetojnë në një atmosferë të vazhdueshme frike dhe ankthi se mund të bëhen objekt i keqtrajtimit fizik, apo edhe të vriten. Kjo ndodh sidomos kur të ndaluarit: (i) janë dëshmitarë, shohin ose dëgjojnë të tjerët duke u rrahur ose keqtrajtuar; (ii) shohin personat e tjerë kur merren për qëllime të tilla – që mund të shoqërohet me një përzgjedhje (në dukje) arbitrare të të ndaluarve për keqtrajtim; dhe/ose (iii) shohin më pas lëndimet e shkaktuara.<sup>1962</sup> Veprime të tilla mund të përbëjnë torturë,<sup>1963</sup> me kusht që të vërtetohet elementi i nevojshëm mendor.

967. Në mënyrë të ngjashme, *detyrimi* i dikujt për të parë ose dëgjuar keqtrajtimin e personave të tjerë, qoftë vrasje, ekzekutim, rrahje, torturim apo përdhunim i tyre, mund të shkaktojë dhimbje, vuajtje dhe/ose keqtrajtim psikologjik të rëndë,<sup>1964</sup> dhe mund të përbëjë torturë, me kusht që të përmbushet elementi i nevojshëm mendor.<sup>1965</sup>

968. Nuk është e nevojshme që pasojat e veprimit ose mosveprimit të jenë të dukshme te viktima që të përbëjnë torturë, dhe as nuk është kusht që lëndimi të jetë i

---

<sup>1960</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 669, dhe referencat aty.

<sup>1961</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 669, dhe referencat aty.

<sup>1962</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 669.

<sup>1963</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 669, dhe referencat aty.

<sup>1964</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 670, dhe referencat aty.

<sup>1965</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 670, dhe referencat aty.



përhershëm.<sup>1966</sup> Gjithashtu, nuk është kusht që kryesi të ketë vepruar në cilësinë e një zyrtari publik apo të një personi me pozitë eprorë.<sup>1967</sup>

(b) Elementet mendore (synimi kriminal)

969. Kryesi duhet ta ketë shkaktuar dhimbjen ose vuajtjen në mënyrë të qëllimshme dhe për qëllime të tilla si marrja e informatave ose e një deklaratë pranuese, ose ndëshkimi, frikësimi, shtrëngimi ose diskriminimi, për çfarëdo arsyeje, i viktimës ose një personi të tretë.<sup>1968</sup> Sidoqoftë, kjo listë qëllimesh nuk është shteruese.<sup>1969</sup> Mjafton që një prej qëllimeve të ndaluara të jetë pjesë e motivimit për sjelljen; nuk është e nevojshme që të jetë “qëllimi mbizotërues ose i vetëm” në shkaktimin e dhimbjes apo vuajtjes së rëndë.<sup>1970</sup> Në qoftë se sjellja përmbush një qëllim të ndaluar, nuk është juridikisht thelbësor fakti që ajo sjellje synonte të arrinte edhe një qëllim tjetër.<sup>1971</sup>

970. Qëllimi i frikësimit, për shembull, mund të përmbushet në qoftë se një person detyrohet të shohë ekzekutimin e personave të tjerë.<sup>1972</sup> Qëllimi i frikësimit mund të përmbushet edhe në qoftë se, për shembull, në mjediset e një kampi burgimi një person i armatosur ushtron dhunë ndaj një të ndaluarit dhe të ndaluarit e tjerë e dinë se po ushtrohet një dhunë e tillë, pasi kjo gjë mund të krijojë një atmosferë frike dhe pafuqie mes të ndaluarve.<sup>1973</sup> Gjithashtu, simulimi i ekzekutimit të një personi mund të jetë tregues i qëllimit të frikësimit dhe mund të përbëjë torturë, pasi rrit në

---

<sup>1966</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 671, dhe referencat aty.

<sup>1967</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 671, dhe referencat aty.

<sup>1968</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 672, dhe referencat aty. *Shih gjithashtu, [Mustafa Appeal Judgment](#)* (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 404, dhe referencat aty.

<sup>1969</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 672, dhe referencat aty.

<sup>1970</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 672, dhe referencat aty.

<sup>1971</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 672, dhe referencat aty.

<sup>1972</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 673.

<sup>1973</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 673, dhe referencat aty.

përgjithësi ankthin që ndjen viktima gjatë kohës së ndalimit të tij ose të saj në lidhje me mundësinë e ekzekutimit të tij ose të saj.<sup>1974</sup>

## 2. Konstatime

### (a) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

971. Në konstatimet faktike të tij, Trupi Gjykes ka arritur në përfundimin se gjatë periudhës afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, të ndaluarit në FMK u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese, për shkak të kushteve krejtësisht të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme të jetesës dhe fjetjes, ofrimit të pamjaftueshëm dhe të papërshtatshëm të ushqimit dhe ujit të pijshëm, kushteve të pamjaftueshme dhe poshtëruese higjienike dhe sanitare, dhe kujdesit të pamjaftueshëm dhe të papërshtatshëm mjekësor ose refuzimit të tij.<sup>1975</sup>

972. Krahas kushteve të mjerueshme të ndalimit, Trupi Gjykes ka konstatuar se gjatë periudhës që mbulojnë akuzat, të ndaluarit në FMK u keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht, disa prej tyre (në dhomën 1), çdo ditë.<sup>1976</sup> Siç shtjellohet më hollësisht në konstatimet faktike të Trupit Gjykes, TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, W04733 dhe W01448 u keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht në shumë raste nga anëtarë të UÇK-së, përfshirë nga z. Shala. Këta të ndaluar u morën në pyetje dhe u akuzuan për bashkëpunim me serbët dhe si tradhtarë, spiunë, përdhunues dhe vrasës.<sup>1977</sup> Ata u rrahën duke u goditur në të gjithë trupin me sende të ndryshme, si shkopinj gome dhe bejsbolli, u goditën me grushte, u prenë me thika, u dogjën me cigare dhe iu hodh kripë në plagë.<sup>1978</sup> Keqtrajtimi i tyre vazhdoi derisa u mbuluan në

---

<sup>1974</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 673. *Shih gjithashtu*, ECtHR, *Ilaşcu and Others v. Moldova and Russia*, Application No. 48787/99, [Judgment](#), 8 July 2004, paras 435, 440.

<sup>1975</sup> *Shih* Pjesën VI.E.1.

<sup>1976</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(a)-(i).

<sup>1977</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(a)-(d).

<sup>1978</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(b)-(d).

gjak dhe mavijosje, humbën ndjenjat ose nuk ishin në gjendje të qëndronin në këmbë.<sup>1979</sup> [REDAKTUAR],<sup>1980</sup> [REDAKTUAR].<sup>1981</sup>

973. Të ndaluarit e tjerë gjithashtu u keqtrajtuan dhe u morën në pyetje (disa prej tyre disa herë) nga anëtarë të UÇK-së, si dhe nga z. Shala, në momente të ndryshme gjatë periudhës që mbulojnë akuzat.<sup>1982</sup> Këta të ndaluar u pyetën për aspekte të tilla si punët që kishin pasur më parë, vendndodhja dhe aktiviteti e tyre gjatë luftës, a njihnin serbë ose bashkëpunëtorë të serbëve, dhe u akuzuan, ndër të tjera, për marrëdhënie të ngushta ose për bashkëpunim me serbët.<sup>1983</sup> Disa të ndaluar u detyruan të bënin edhe punë krahu brenda FMK-së.<sup>1984</sup>

974. Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se, krahas keqtrajtimit fizik, të ndaluarit në FMK u keqtrajtuan psikologjikisht në mënyra të ndryshme nga anëtarë të UÇK-së. Konkretisht, të ndaluarit shpesh qenë dëshmitarë të keqtrajtimit të të ndaluarve të tjerë, ndonjëherë çdo ditë.<sup>1985</sup> Ky keqtrajtim u krye nga anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, të cilët ndonjëherë ishin të panjohur më parë për të ndaluarit.<sup>1986</sup> Sipas Trupit Gjykses, kjo e përkeqësoi vuajtjen psikologjike të tyre, pasi të ndaluarit nuk dinin se çfarë të prisnin dhe sa brutalë do të ishin anëtarët e rinj të UÇK-së. Të ndaluarit dëgjonin gjithashtu keqtrajtimin që u bëhej të ndaluarve të tjerë, siç qe rasti kur [REDAKTUAR] dëgjoji britmat [REDAKTUAR] vetëm pak metra më tej.<sup>1987</sup> Trupi Gjykses rikujton se edhe kur të ndaluarit nuk shihnin ose dëgjonin keqtrajtimin e të tjerëve, ata shihnin lëndimet që u ishin shkaktuar atyre kur i kthenin në dhomat e

---

<sup>1979</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(b)-(d).

<sup>1980</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1981</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1982</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(a), (e)-(i) dhe VI.E.3.

<sup>1983</sup> *Shih* Pjesën VI.E.3.

<sup>1984</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(i).

<sup>1985</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(a).

<sup>1986</sup> *Shih* para. 642.

<sup>1987</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(a); para. 715.

ndalimit.<sup>1988</sup> Gjithashtu, lënia në përgjithësi pa gjumë dhe ndalimi i bisedave me njëri-tjetrin ndikoi më tej në gjendjen psikologjike të të ndaluarve.<sup>1989</sup> Praktika e zbatuar nga disa prej anëtarëve të UÇK-së, të cilët i ngacmonin të ndaluarit kur ata lejoheshin të shkonin te depozita e ujit për të marrë ujë, e shtoi edhe më tej vuajtjen psikologjike të tyre.<sup>1990</sup> Këto ngacmime dhe frika e keqtrajttimeve të mëtejshme i detyruan të ndaluarit të braktisin përpjekjet për të plotësuar nevojën e tyre bazë për ujë.<sup>1991</sup>

975. [REDAKTUAR]. Në një incident, mjeku kujdestar në FMK u rekomandoi anëtarëve të UÇK-së që ta çonin viktimën e vrasjes së paligjshme në spital, për shkak të gjendjes me rrezik për jetën. Këshilla e mjekut u shpërfill nga anëtarët e UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit, të cilët e lanë viktimën e vrasjes së paligjshme të vdiste në dhomën 1.<sup>1992</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>1993</sup>

976. Këto keqtrajttime fizike dhe psikologjike, së bashku me kushtet çnjerëzore të paraburgimit në FMK, u shkaktuan të ndaluarve lëndime afatgjata, si fizike ashtu dhe mendore: lëndime në kokë, lëndime nga djegiet, bërryla dhe/ose dhëmbë të thyer, dhimbje të vazhdueshme dhe të forta në të gjithë trupin, ndjenjë turpi, frikë (për shembull, për të shkuar në punë ose për të dalë jashtë i pashoqëruar), ndjenjë pasigurie (në lidhje me veten ose anëtarët e familjes së tyre) dhe çrregullime të stresit pastraumatik (makthe, fanitje të ngjarjeve traumatike dhe kujtime tronditëse të pavullnetshme).<sup>1994</sup>

977. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se anëtarët e UÇK-së në FMK, ndër ta dhe z. Shala, u shkaktuan dhimbje dhe vuajtje të rënda fizike dhe mendore të ndaluarve, përfshirë TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, TW4-11-shit,

---

<sup>1988</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(a); para. 678-679, 762.

<sup>1989</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(a).

<sup>1990</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(a).

<sup>1991</sup> *Shih* Pjesët VI.E.1(b) dhe VI.E.2(a).

<sup>1992</sup> *Shih* Pjesën VI.F.1.

<sup>1993</sup> *Shih* para. 667.

<sup>1994</sup> *Shih* VI.E.2.

W04733-shit, W01448-ës, TW4-05-ës, TW4-04-ës, TW4-02-shit, [REDAKTUAR] dhe një muzikanti të tretë rom, [REDAKTUAR] dhe së paku një femre tjetër të ndaluar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se është përmbushur elementi material i torturës si krim lufte.

(b) Elementet mendore (synimi kriminal)

978. Trupi Gjykses ka konstatuar se z. Shala mori pjesë personalisht në keqtrajtimin fizik dhe/ose psikologjik të: (i) TW4-01-shit dhe viktimës së vrasjes së paligjshme më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date [REDAKTUAR]; (ii) W04733-shit më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date; dhe (iii) W01448-ës më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>1995</sup>

979. Trupi Gjykses gjithashtu ka konstatuar se anëtarë të tjerë të UÇK-së të pranishëm në FMK: (i) keqtrajtuat TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, TW4-11-shin, W04733-shin, W01448-ën, TW4-05-ën, TW4-04-ën, TW4-02-shin, [REDAKTUAR] dhe një muzikant të tretë rom, [REDAKTUAR], dhe së paku një femër tjetër të ndaluar, në mënyra të ndryshme, siç detajohet përkatësisht në konstatimet faktike;<sup>1996</sup> dhe (ii) i mbajtën të ndaluarit në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi sa u takon kushteve të jetesës dhe fjetjes, ushqimit dhe ujit të pijshëm, higjienës dhe kujdesit mjekësor, gjatë gjithë kuadrit kohor të akuzave.<sup>1997</sup>

980. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se, bazuar në tërësinë e provave, i vetmi përfundim i arsyeshëm është se gjatë periudhës që mbulojnë akuzat, z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së në FMK u shkaktuan qëllimisht dhimbje dhe vuajtje të rënda të ndaluarve, përfshirë përmes mbajtjes së tyre në kushte çnjerëzore ndalimi.

981. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka konstatuar se z. Shala: (i) mori pjesë në marrjen në pyetje të W04733-shit dhe e akuzoi atë si “spion” më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date,

---

<sup>1995</sup> *Shih* para. 688, 706, 714.

<sup>1996</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(a).

<sup>1997</sup> *Shih* Pjesët VI.E.1 dhe VI.E.2.

gjatë së cilës W04733 u akuzua edhe se kishte vrarë dhe përdhunuar njerëz dhe për bashkëpunim me serbët; dhe (ii) mori në pyetje personalisht [REDAKTUAR] dhe i kërkoi asaj të jepte deklaratë pranuese, ku të thoshte se [REDAKTUAR] ishin bashkëpunëtorë të serbëve.<sup>1998</sup>

982. Trupi Gjykses gjithashtu ka konstatuar se anëtarë të tjerë të UÇK-së në FMK: (i) i morën në pyetje të ndaluarit për aspekte të ndryshme, si punët që kishin pasur më parë në organet e rendit dhe ligjit, njohjen ose lidhjet e tyre me serbë ose bashkëpunëtorë të serbëve, dhe i akuzuan ata si tradhtarë, spiunë, bashkëpunëtorë të serbëve, përdhunues ose vrasës; (ii) i detyruan të shikonin ose të dëgjonin keqtrajtimin fizik të të ndaluarve të tjerë; dhe (iii) i detyruan të jetonin me frikën e vazhdueshme se mund të keqtrajtoheshin fizikisht në çdo moment.<sup>1999</sup>

983. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se, bazuar në tërësinë e provave, i vetmi përfundim i arsyeshëm është se gjatë periudhës që mbulojnë akuzat, z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së në FMK u shkaktuan të ndaluarve dhimbje ose vuajtje për të marrë prej tyre informata ose deklaratat pranuese, për t'i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar dhe/ose diskriminuar ata për arsye politike.

984. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton, bazuar në provat në tërësi, se janë përmbushur elementet mendore të torturës si krim lufte, konkretisht se kryesit shkaktuan qëllimisht dhimbje ose vuajtje me synim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese, duke i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar ose duke i diskriminuar të ndaluarit.

---

<sup>1998</sup> *Shih* para. 706, 720.

<sup>1999</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(a) dhe VI.E.3.

E. VRASJA E PALIGJSHME (PIKA 4)

1. Kriteret ligjore

(a) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

985. Krimi i vrasjes së paligjshme si krim lufte, sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që çon në vdekjen e një personi.<sup>2000</sup> Veprimi ose mosveprimi mund të përfshijë, për shembull, shkaktimin e një dëmtimi të rëndë fizik ose mosdhënien/refuzimin e ndihmës mjekësore një të ndaluar.<sup>2001</sup>

986. Kushti që vdekja duhet të ketë ndodhur “si rezultat” i veprimit ose mosveprimit të kryesit, nuk nënkupton që sjellja e kryesit duhet të jetë shkaku i vetëm i vdekjes së viktimës. Mjafton që sjellja e kryesit, më së paku, të ketë kontribuar në mënyrë të qenësishme në vdekjen e personit.<sup>2002</sup>

(b) Elementet mendore (synimi kriminal)

987. Kryesi duhet ta ketë vrarë personin në mënyrë të qëllimshme ose t'i ketë shkaktuar qëllimisht dëmtim të rëndë fizik, ose qëllimisht të mos t'i ketë dhënë ose t'i ketë refuzuar ndihmën mjekësore një të ndaluar, çka kryesi logjikisht duhej ta kishte ditur se mund të çonte në vdekje.<sup>2003</sup>

---

<sup>2000</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 686; ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Judgment](#) (*Karadžić Trial Judgment*), 24 March 2016, para. 446; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), paras 259-261.

<sup>2001</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 351; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 686; ICTY, [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 270.

<sup>2002</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 344, 350-351, dhe referencat aty; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 687, dhe referencat aty; ICTY, [Karadžić Trial Judgment](#), para. 446.

<sup>2003</sup> [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 388, 392, dhe referencat aty; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 688, dhe referencat aty.

## 2. Konstatime

### (a) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

988. Trupi Gjykues ka konstatuar se, më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, viktimat e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri në këmbë nga Xhemshit Krasniqi, në dhomën 2 të ndërtesës së ndalimit.<sup>2004</sup> Trupi Gjykues gjithashtu ka konstatuar se plumbat goditën një arterie në këmbën e viktimës së vrasjes së paligjshme, e cila furnizonte me gjak gjithë këmbën. Plumbat shkaktuan shkatërrimin e plotë të arteries dhe gjakderdhje.<sup>2005</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues ka konstatuar se pas gjuajtjes me armë zjarri, një prej anëtarëve të UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit në FMK, refuzoi transferimin e viktimës së vrasjes së paligjshme në spital për t'iu dhënë trajtimi i duhur mjekësor. Ky refuzim u bë përkundër faktit që viktimat e vrasjes së paligjshme kishte gjakderdhje të madhe dhe në kundërshtim me këshillën e mjekut se për të mbijetuar ai duhej të dërgohej në spitalin e Kukësit.<sup>2006</sup> Së fundi, Trupi Gjykues ka konstatuar se viktimat e vrasjes së paligjshme vdiq me 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, kur ende mbahej i ndaluar në FMK, si pasojë e plagëve të shkaktuara me armë zjarri, ndërthurur me refuzimin e trajtimit të duhur mjekësor.<sup>2007</sup>

989. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se Xhemshit Krasniqi dhe anëtari i UÇK-së i cili nuk lejoi transferimin e viktimës së vrasjes së paligjshme në spital, i shkaktuan dëmtim të rëndë fizik viktimës së vrasjes së paligjshme dhe nuk lejuan që t'i jepej trajtimi (i duhur) mjekësor. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se është përmbushur elementi material i vrasjes së paligjshme si krim lufte.

---

<sup>2004</sup> *Shih* Pjesët VI.F.1, VI.F.5, VI.F.8.

<sup>2005</sup> *Shih* Pjesën VI.F.2.

<sup>2006</sup> *Shih* para. 759-760, 762 më lart dhe Pjesën VI.F.8.

<sup>2007</sup> *Shih* para. (e), 832 më lart.



(b) Elementet mendore (synimi kriminal)

990. Trupi Gjykues konstaton, për arsyet në vijim, se Xhemshit Krasniqi dhe anëtari i UÇK-së që nuk lejoi çuarjen në spital të viktimës së vrasjes së paligjshme, e vranë qëllimisht viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>2008</sup> Së pari, [REDAKTUAR].<sup>2009</sup> Së dyti, [REDAKTUAR].<sup>2010</sup> Së treti, siç përmendëm më lart, një prej anëtarëve të UÇK-së që ishte përgjegjës për të ndaluarit në FMK, qëllimisht nuk lejoi trajtimin mjekësor të viktimës së vrasjes së paligjshme. Kjo u bë përkundër faktit se viktima e vrasjes së paligjshme kishte gjakderdhje të madhe (që ishte e dukshme) dhe në kundërshtim me këshillën që mjeku u dha anëtarëve të UÇK-së për ta çuar atë në spital, pasi përndryshe viktima nuk do të mbijetonte.<sup>2011</sup> Synimi për të vrarë është i qartë në fjalët e anëtarit në fjalë të UÇK-së: “s’ja kena bo këtë dajak për me e çu tek mjeku”.<sup>2012</sup> Së fundi, [REDAKTUAR].<sup>2013</sup> Kjo nuk lë asnjë dyshim te Trupi Gjykues se Xhemshit Krasniqi dhe anëtari i UÇK-së që nuk lejoi transferimin në spital të viktimës së vrasjes së paligjshme, dëshiruan që vdekja e viktimës së vrasjes së paligjshme të ishte rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tyre dhe e kryen krimin e vrasjes së paligjshme me synim të drejtpërdrejtë.<sup>2014</sup>

991. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se është vërtetuar elementi mendor i vrasjes së paligjshme si krim lufte.

---

<sup>2008</sup> Elementi mendor i z. Shala në lidhje me përgjegjësinë penale të tij për vrasjen e paligjshme si krim lufte trajtohet në paragrafët 1031-1036 më poshtë, ku Trupi Gjykues diskuton nëse z. Shala kishte synimin e përbashkët me anëtarët e tjerë të NKP-së për kryerjen e krimin të vrasjes së paligjshme.

<sup>2009</sup> [REDAKTUAR].

<sup>2010</sup> [REDAKTUAR].

<sup>2011</sup> *Shih* para. 759-760, 762 më lart dhe Pjesën VI.F.8.

<sup>2012</sup> *Shih* para. 760 më lart.

<sup>2013</sup> [REDAKTUAR].

<sup>2014</sup> *Shih më tej*, [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 390, dhe referencat aty.

## F. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE

### 1. Vërejtje paraprake

992. Trupi Gjykses rikujton se, kur akuzat janë për një numër formash të përgjegjesisë penale, në qoftë se përgjegjësia penale individuale e të akuzuarit përfshihet plotësisht në një formë të përgjegjesisë penale, Trupi Gjykses nuk analizon përgjegjësinë e tij sipas formave të tjera të përgjegjesisë penale të paraqitura në Aktakuzë.<sup>2015</sup>

993. ZPS-ja e ka akuzuar z. Shala, sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, për: (i) kryerje fizike, si kryes i drejtpërdrejtë, të krimeve të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturës; (ii) kryerje, përmes pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje kriminale të përbashkët, të krimeve të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme (NKP I ose, si alternativë, NKP III për krimin e vrasjes së paligjshme); dhe/ose (iii) ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme.<sup>2016</sup> Trupi Gjykses vëren se veprimet dhe mosveprimet në bazë të të cilave ZPS-ja e ka akuzuar z. Shala si kryes të drejtpërdrejtë, janë të njëjtat veprime dhe mosveprime që përbëjnë bazën e pjesëmarrjes së tij në NKP.<sup>2017</sup> Më tej, edhe format e përgjegjesisë penale për NKP III dhe ndihmë e inkurajim, të përfshira në aktakuzë si alternativë e NKP I (NKP III në lidhje me krimin e vrasjes së paligjshme dhe ndihma dhe inkurajimi në lidhje me të gjitha krimet e përfshira në aktakuzë) janë ngritur si akuza mbi bazën e të njëjtave veprime dhe mosveprime.<sup>2018</sup>

994. Në rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore, Trupi Gjykses vlerëson se përgjegjësia penale individuale e z. Shala përfshihet plotësisht – dhe pasqyrohet më së miri – në

<sup>2015</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 725, dhe referencat aty.

<sup>2016</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 8-13, 30-31.

<sup>2017</sup> *Shih* [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 13, 30 (në lidhje me kryerjen fizike), që u referohen paragrafëve 15-16, 20-23, 26; para. 11 (ku përcaktohet kontributi i tij në qëllimin e përbashkët), që u referohet, ndër të tjerë, paragrafëve 15-16, 20-23, 26.

<sup>2018</sup> *Shih gjithashtu*, [Decision on Motion Challenging the Form of the Indictment](#) (Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës), para. 80, 90.

formën e përgjegjesisë penale të NKP-së, konkretisht të NKP I, siç shtjellohet më poshtë. Duke marrë parasysh se z. Shala akuzohet si kryes i drejtpërdrejtë ose si ndihmës dhe inkurajues në bazë të të njëjtave veprime dhe mosveprime që përbëjnë bazën e pjesëmarrjes së tij në NKP, Trupi Gjykses nuk do të shqyrtojë përgjegjësinë e z. Shala sipas këtyre formave të përgjegjesisë penale. E njëjta gjë vlen edhe për NKP III.

## 2. Ndërmarrja kriminale e përbashkët

### (a) Kundërshtimet e Mbrojtjes

995. Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimet e Mbrojtjes se do të ishte në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë që z. Shala të dënohej në bazë të NKP-së, pasi kjo formë e përgjegjesisë penale: (i) nuk ekzistonte në legjislacionin penal që ishte në fuqi në Kosovë në kohën kur u kryen krimet; (ii) është përjashtuar në mënyrë specifike nga Ligji për Dhomat e Specializuara; (iii) nuk ishte e kodifikuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare në vitin 1999; dhe (iv) nuk ishte e parashikueshme dhe e disponueshme për z. Shala.<sup>2019</sup>

996. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja i ka ngritur më parë këto pika juridike në mocionin paraprak të saj që kundërshton juridiksionin e Dhomave të Specializuara.<sup>2020</sup> Argumentet e Mbrojtjes janë trajtuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>2021</sup> si dhe nga Paneli i Gjykatës së Apelit, që konfirmoi se: (i) Ligji e parashikon përgjegjësinë

---

<sup>2019</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 266-274; T. 17 prill 2024, publik, f. 4285, rreshti 12 deri në f. 4287, rreshti 10.

<sup>2020</sup> [Defence Preliminary Motion on Jurisdiction](#) (Mocioni Paraprak i Mbrojtjes mbi Juridiksionin), para. 20-45.

<sup>2021</sup> KSC-BC-2020-04, F00088, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Motion Challenging the Establishment and Jurisdiction of the Specialist Chambers](#) (Vendim mbi Mocionin që Ngren Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara), 18 tetor 2021, publik, para. 90-97.

penale në bazë të NKP-së si formë kryerjeje; (ii) NKP-ja – në formën e saj të parë dhe të tretë – është dhe ishte formë përgjegjësie penale sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën kur u kryen krimet; dhe (iii) përgjegjësia penale në bazë të NKP-së ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për z. Shala.<sup>2022</sup>

997. Mbrojtja po përpiqet të rihapë debate juridike për aspekte që tashmë janë zgjidhur në jurisprudencën e Dhomave të Specializuara.<sup>2023</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykyes nuk do t'i trajtojë më tej këto parashtrime.

(b) Kriteret ligjore

i. Elementet objektive

998. Për NKP I – si dhe për të gjitha format e NKP-së – kërkohet ekzistenca e elementeve objektive në vijim: (i) një shumësi personash që veprojnë në bazë të një qëllimi të përbashkët; (ii) një qëllim i përbashkët i cili përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi të përcaktuar në Ligj; dhe (iii) pjesëmarrja e kryesit në realizimin e projektit ose qëllimit të përbashkët.<sup>2024</sup>

999. *Shumësi personash*. NKP-ja ekziston kur një shumësi personash merr pjesë në realizimin e një objektivi kriminal të përbashkët.<sup>2025</sup> Nuk është e nevojshme që personat pjesëmarrës në ndërmarrjen kriminale të jenë të organizuar në një strukturë

---

<sup>2022</sup> [Case 04 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 04), para. 32-40.

<sup>2023</sup> *Shih gjithashtu*, [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 04), para. 135-144, 162-172, 186-196; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 735.

<sup>2024</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 737, dhe referencat aty.

<sup>2025</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 738, dhe referencat aty.

ushtarake, politike ose administrative.<sup>2026</sup> Megjithatë, ata duhet të identifikohen konkretisht, për shembull, përmes emrit ose kategorive ose grupeve të personave.<sup>2027</sup>

1000. *Qëllimi i përbashkët që përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi.* Nuk është e nevojshme që ky plan, projekt, ose qëllim të jetë organizuar ose formuluar më herët. Plani ose qëllimi i përbashkët mund të materializohet spontanisht dhe deduktohet nga fakti se një shumësi personash veprojnë së bashku për të realizuar një ndërmarrje kriminale të përbashkët,<sup>2028</sup> ose mund të deduktohet nga synimi i personit.<sup>2029</sup> Qëllimi i përbashkët nuk presupozon planifikim përgatitor ose marrëveshje të shprehur ndërmjet pjesëmarrësve në NKP, ose ndërmjet pjesëmarrësve në NKP dhe personave të tretë.<sup>2030</sup> Për më tepër, NKP-ja mund të ekzistojë edhe nëse asnjë, ose vetëm disa, prej kryesve fizikë të krimeve janë anëtarë të NKP-së, por përdoren nga një ose më shumë anëtarë të NKP-së për të kryer krimet sipas qëllimit të përbashkët.<sup>2031</sup>

1001. *Kontributi.* Kryesi duhet të ketë marrë pjesë në realizimin e qëllimit të përbashkët mbi të cilin bazohet NKP-ja duke ndihmuar ose duke kontribuar për zbatimin e planit ose qëllimit të përbashkët, por nuk është e nevojshme të ketë kryer ndonjë pjesë të veprimit të fajshëm të krimin për të cilin akuzohet.<sup>2032</sup> Ligjërisht, nuk është e nevojshme që kontributi i kryesit në NKP të jetë i domosdoshëm ose i

---

<sup>2026</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 738, dhe referencat aty.

<sup>2027</sup> [Decision on Appeal against Decision on Motion Challenging the Form of the Indictment](#) (Vendim mbi Apelin kundër Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës), para. 16. [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 738, dhe referencat aty.

<sup>2028</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 739, dhe referencat aty.

<sup>2029</sup> *Ngjashëm*, ICC, [Lubanga Appeal Judgment](#), para. 446 (“Sipas Dhomës së Apelit, ishte e drejtë të mbahej parasysh neni 30 i Statutit, sepse kjo dispozitë përshkruan elementin mendor përkatës dhe, për këtë arsye, mund të shërbejë edhe si matës për të përcaktuar nëse dy ose më shumë persona janë marrë vesh për të kryer një krim”).

<sup>2030</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 739, dhe referencat aty.

<sup>2031</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 739, dhe referencat aty.

<sup>2032</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 740, dhe referencat aty.

konsiderueshëm, por duhet të jetë më së paku kontribut i qenësishëm në krimet për të cilat ai ose ajo konstatohet se është përgjegjës.<sup>2033</sup> Nuk është e nevojshme që kontributi në vetvete të jetë kriminal.<sup>2034</sup>

## ii. Elementet subjektive

1002. Sa i përket NKP I, kryesi duhet të ketë të njëjtin synim me pjesëmarrësit e tjerë për kryerjen e krimeve që janë pjesë e qëllimit të përbashkët, duke përfshirë edhe synimin konkret.<sup>2035</sup>

## 3. Konstatime

### (a) Elementet objektive

1003. *Shumësi personash*. Trupi Gjykses konstatoi, në bazë të provave, se krimet për të cilat janë ngritur akuzat u kryen nga disa anëtarë të UÇK-së, ndër ta: Xhemshit Krasniqi, Sabit Geci, z. Shala, z. Kryeziu, anëtarët e UÇK-së me pseudonimet “Bedriu” dhe “Van Dami”, Fatmir Limaj, anëtarë (të tjerë) të policisë ushtarake të UÇK-së dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së (anëtarët e NKP-së).<sup>2036</sup>

1004. Trupi Gjykses ka konstatuar në bazë të provave se Xhemshit Krasniqi – i cili ishte personi përgjegjës për të ndaluarit në FMK<sup>2037</sup> – luajti rol të rëndësishëm në arrestimin, transferimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve, si dhe në vrasjen e paligjshme të njërit prej tyre (viktima e vrasjes së paligjshme).<sup>2038</sup> Xhemshit Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të këtij grupi vepronin nën pushtetin e

---

<sup>2033</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 740, dhe referencat aty.

<sup>2034</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 740, dhe referencat aty.

<sup>2035</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 741, dhe referencat aty.

<sup>2036</sup> *Shih* Pjesët VI.D, VI.E, VI.F.

<sup>2037</sup> *Shih* para. 349 më lart.

<sup>2038</sup> *Shih, për shembull*, para. 416, 462, 496, 497, 499, 502, 509, 513-514, 532-533, 641, 706, 714, 720 dhe 805.

përgjithshëm të Sabit Gecit,<sup>2039</sup> i cili përfshihej gjithashtu drejtpërdrejt në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve kur ishte i pranishëm në FMK.<sup>2040</sup> Z. Shala u përfshi drejtpërdrejt në transferimin e të ndaluarve në FMK, në marrjen në pyetje dhe në keqtrajtimin e tyre, dhe bëri akuza ndaj tyre.<sup>2041</sup> Z. Kryeziu i mori në pyetje të ndaluarit pas mbërritjes së tyre në FMK;<sup>2042</sup> “Bedriu” dhe “Van Dami” u përfshinë në keqtrajtimin e të ndaluarve;<sup>2043</sup> Fatmir Limaj u përfshi si në marrjen në pyetje, ashtu edhe në keqtrajtimin e tyre.<sup>2044</sup> Së fundi, anëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së<sup>2045</sup> u përfshinë qartazi në arrestimin, transferimin dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK, krahas anëtarëve të tjerë të UÇK-së.<sup>2046</sup>

1005. Trupi Gjykes gjykon se të gjithë individët e lartpërmendur anëtarë të NKP-së janë identifikuar në bazë të provave me konkretësi të mjaftueshme, qoftë me emër, pseudonim apo sipas lidhjes së tyre me policinë ushtarake të UÇK-së ose me UÇK-në në përgjithësi. Individët e mësipërm janë të gjithë të lidhur me njëri-tjetrin për faktin se qendra e veprimtarive të tyre ishte FMK-ja, dhe ata morën pjesë së bashku në arrestimin, transferimin dhe/ose keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK.

1006. Mbrojtja kundërshton faktin që z. Shala ishte anëtar i NKP-së, dhe parashtron se: (i) nuk janë paraqitur prova se ai kishte lidhje me personat e tjerë të evidentuar si anëtarë të NKP-së; dhe (ii) nuk janë paraqitur prova se ai mori pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në kryerjen e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat.<sup>2047</sup>

---

<sup>2039</sup> *Shih* para. 345 më lart.

<sup>2040</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2 (a), (b), (c), (d).

<sup>2041</sup> *Shih* Pjesën VI.I.2.

<sup>2042</sup> *Shih* para. 433-437, 529-530, 552-555 më lart.

<sup>2043</sup> *Shih* para. 668, 674, 688 më lart.

<sup>2044</sup> *Shih* para. 491, 689, 691, 706 më lart.

<sup>2045</sup> Për detyrat e policisë ushtarake të UÇK-së, *shih* para. 337-340 më lart.

<sup>2046</sup> *Shih* Pjesët VI.D dhe VI.E.

<sup>2047</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 77, 82, 85, 144.

1007. Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se nuk ka pasur lidhje zyrtare ndërmjet z. Shala dhe anëtarëve të tjerë të NKP-së, Trupi Gjykses rikujton se kjo nuk është e nevojshme.<sup>2048</sup> Trupi Gjykses dedukton se z. Shala ishte anëtar i NKP-së nga fakti se: (i) ai ishte anëtar i UÇK-së gjatë gjithë kornizës kohore të akuzave;<sup>2049</sup> (ii) qendra e aktiviteteve të tij ishte FMK-ja, që e tregon fakti se ai ishte i pranishëm fizikisht në FMK në disa raste, dhe shkonte e vinte rregullisht dhe pa kufizime;<sup>2050</sup> (iii) ai mori pjesë personalisht në transferimin, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në FMK dhe bëri akuza ndaj tyre;<sup>2051</sup> dhe, çka është më e rëndësishme, (iv) këto i bëri së bashku me anëtarët e tjerë të NKP-së, kryesisht me Sabit Gecin dhe Xhemshit Krasniqin, duke marrë pjesë lirisht dhe pa asnjë kufizim në to, në të njëjtën mënyrë si ata të dy.<sup>2052</sup> Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se kundërshtimi i Mbrojtjes është i pabazë dhe e rrëzon atë.

1008. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ekzistonte një shumësi personash brenda kuptimit të NKP-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se është përmbushur elementi i parë objektiv i NKP I.

1009. *Qëllimi i përbashkët që përbën ose përfshin kryerjen e një krimi.* Trupi Gjykses rikujton se nuk është e nevojshme që qëllimi i përbashkët të formulohet shprehimisht, por mund të deduktohet nga fakti se anëtarët e lartpërmendur të NKP-së vepruan së bashku me synimin për të realizuar një ndërmarrje kriminale të përbashkët, siç tregohet më poshtë.

1010. Në bazë të provave, Trupi Gjykses nxjerr përfundimin se anëtarët e NKP-së kishin qëllimin e përbashkët për të ndaluar arbitrarisht, marrë në pyetje, torturuar dhe vrarë të ndaluarit në FMK, të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin, ishin të lidhur

---

<sup>2048</sup> *Shih* para. 999 më lart.

<sup>2049</sup> *Shih* Pjesën VI.A.3.

<sup>2050</sup> *Shih* Pjesën VI.H.

<sup>2051</sup> *Shih* Pjesën VI.I.2.

<sup>2052</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2 (b), (c), (d), (e) dhe VI.F.1, 4- 5.



me autoritetet serbe ose i simpatizonin ato, ose se nuk mbështesnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së. Trupi Gjykses konstatoi se gjatë kornizës kohore të akuzave, në FMK u mbajtën të ndaluar një numër i konsiderueshëm personash, ndër të cilët: TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, TW4-11, W04733, W01448, TW4-05, TW4-02, TW4-04, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe një i ndaluar/muzikant i tretë rom, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe së paku një femër tjetër e ndaluar, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Ndalimi dhe keqtrajtimi i tyre në FMK nuk ishin ngjarje të rastësishme, të paorganizuara dhe të izoluara, por u realizuan përmes të njëjtës praktikë.

1011. Trupi Gjykses dedukton ekzistencën e qëllimit të përbashkët nga sa vijon. Arrestimi fillestar i të ndaluarve u bë sipas të njëjtës praktikë dhe mënyre veprimi të organizuar. Të ndaluarit u shënjestruan para arrestimit të tyre për faktin se konsideroheshin se bashkëpunonin, ishin të lidhur me autoritetet serbe, ose i simpatizonin ato, ose se nuk mbështesnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së. Për shembull, TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme dhe [REDAKTUAR] u arrestuan pasi UÇK-ja kreu “verifikime” dhe ata u evidentuan si bashkëpunëtorë ose mbështetës të supozuar të autoriteteve serbe.<sup>2053</sup> TW4-11, W04733, W01448, TW4-05, TW4-02 dhe TW4-04 u shënjestruan që të gjithë para arrestimit të tyre, për shkak se konsideroheshin si “bashkëpunëtorë” të autoriteteve serbe, “spiunë”, “tradhtarë”, simpatizues të Serbisë, apo se nuk mbështesnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së.<sup>2054</sup> Të ndaluarit nuk u arrestuan rastësisht, por u shënjestruan, siç dëshmohet nga kërkimet për persona të caktuar që kryenin anëtarë të UÇK-së para arrestimit. Konkretisht, TW4-11 u arrestua [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe një person tjetër, të cilët “kërkonin [atë]” specifikisht.<sup>2055</sup> Anëtarët e UÇK-së, ndër ta dhe Xhemshit Krasniqi, e kërkuan

---

<sup>2053</sup> *Shih* Pjesët VI.D.2, VI.D.3 dhe VI.D.10(b).

<sup>2054</sup> *Shih* Pjesët VI.D.4, VI.D.5, VI.D.6, VI.D.7, VI.D.8 dhe VI.D.9.

<sup>2055</sup> *Shih* Pjesën VI.D.4(a).

vazhdimisht W04733-shin para se ta arrestonin.<sup>2056</sup> Anëtarët e UÇK-së që arrestuan W01448-ën po e prisnin atë në portin e Durrësit, kur po vinte nga Gjermania, dhe e pyetën për emrin e i kërkuan pasaportën para se ta arrestonin.<sup>2057</sup> TW4-05 gjithashtu u arrestua pasi iu kërkua të identifikohet kush ishte.<sup>2058</sup> TW4-05-ës, TW4-02-shit dhe TW4-04-ës iu tha pas arrestimit se duhej të merreshin në pyetje.<sup>2059</sup> Arrestimi dhe/ose transferimi i të ndaluarve në FMK u krye nga anëtarë të NKP-së të cilët punuan së bashku, ndër të cilët z. Shala, Xhemshit Krasniqi, anëtarë (të tjerë) të policisë ushtarake të UÇK-së dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së.<sup>2060</sup>

1012. Në FMK, mbajtja në ndalim e viktimave ishte e institucionalizuar dhe zgjati për një kohë të caktuar. Disa prej të ndaluarve u mbajtën për një kohë të shkurtër në vende të ndryshme brenda FMK-së (p.sh. në magazinë, ose në dhomën e ndalimit të ndërtesës së komandës), por (pothuajse të gjithë) më pas u çuan në ndërtesën e ndalimit, ku u mbajtën për pjesën më të madhe të periudhës së paraburgimit të tyre.<sup>2061</sup> Ndërtesa e ndalimit ishte caktuar specifikisht për këtë qëllim dhe nuk kishte asnjë funksion tjetër përveç mbajtjes së të ndaluarve. Jashtë derës së hyrjes kishte gjithmonë roja.<sup>2062</sup>

1013. Është e qartë se ndalimi i viktimave ishte institucionalizuar në kuadër të funksioneve të FMK-së, pasi dihej gjerësisht se për çfarë qëllimi shërbente ndërtesa e ndalimit. Kjo dëshmohet nga fakti se: (i) anëtarët dhe luftëtarët e UÇK-së që ktheheshin nga fronti, i ngacmonin dhe i kërcënonin të ndaluarit me dhunë nga

---

<sup>2056</sup> *Shih* Pjesën VI.D.5(a).

<sup>2057</sup> *Shih* Pjesën VI.D.6(a).

<sup>2058</sup> *Shih* Pjesën VI.D.6(a).

<sup>2059</sup> *Shih* Pjesët VI.D.7(a), VI.D.8(a) dhe VI.D.9(a).

<sup>2060</sup> *Shih* VI.D.2(b), VI.D.4(a), VI.D.5(a), VI.D.6(a), VI.D.7(a), VI.D.8(a), VI.D.9(a) dhe VI.D.10.

<sup>2061</sup> *Shih* para. 588 më lart.

<sup>2062</sup> *Shih* para. 423, 480, 626, 637 më lart.

dritarja e dhomës 1;<sup>2063</sup> dhe (ii) anëtarët e UÇK-së hynin në dhomën 1 dhe i akuzonin të ndaluarit si spiunë dhe tradhtarë.<sup>2064</sup>

1014. Të ndaluarit merreshin në pyetje sistematikisht nga anëtarët e NKP-së, shpesh në mbrëmje ose gjatë natës.<sup>2065</sup> Ata pyeteshin për lidhjet e tyre me autoritetet serbe, për njohuritë e tyre për “bashkëpunëtorët”, ose akuzoheshin vetë si “bashkëpunëtorë”, “spiunë”, “tradhtarë”, ose se nuk mbështesnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së.<sup>2066</sup> Marrjet në pyetje kryheshin nga anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, ndër ta: Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi, z. Kryeziu dhe Fatmir Limaj.<sup>2067</sup> Z. Shala ishte gjithashtu i pranishëm gjatë disa prej këtyre marrjeve në pyetje dhe, në disa raste, i mori vetë në pyetje të ndaluarit.<sup>2068</sup> W04733 e përshkroi kështu koordinimin mes anëtarëve të NKP-së: “Do atëherë të vrevshin u dujke me u përgjigj këtijne, ta bëjke pyetjen në ky. Tyj ju përgjigjshe këtijne, thojke pse s’mu përgjigjesh mu. [...] të rreke, tyj folë me këtë të rreke ky. U kthejshe me folë me këtë, pa mbaru bisedën me këtë, pse s’po përgjigjesh mu, të bike tjetri”.<sup>2069</sup>

1015. Keqtrajtimi i të ndaluarve në FMK ishte sistematik, me rrahje të përditshme, forma të tjera të keqtrajtimit fizik dhe psikologjik dhe kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi.<sup>2070</sup> Vlen të kujtohet dëshmia e TW4-01-shit, në të cilën ai përshkroi natyrën e përsëritur dhe sistematike të keqtrajttimeve: “Kur kanë hi në dhomë n’përgjithësi na kanë rreh të tanëve”.<sup>2071</sup> Disa prej të ndaluarve, konkretisht TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, W04733, W01448 dhe [REDAKTUAR],

---

<sup>2063</sup> *Shih* para. 648 më lart.

<sup>2064</sup> *Shih* para. 721 më lart.

<sup>2065</sup> *Shih* Pjesën VI.E.3.

<sup>2066</sup> *Shih* Pjesën VI.E.3.

<sup>2067</sup> *Shih* Pjesën VI.E.3.

<sup>2068</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2(e).

<sup>2069</sup> *Shih* para. 692 më lart.

<sup>2070</sup> *Shih* para. 638, 653 më lart.

<sup>2071</sup> *Shih* para. 641 më lart.

pësuan rrahje veçanërisht brutale, të cilat u kryen nga anëtarë të NKP-së që bashkëvepronin dhe ndërroheshin me njëri-tjetrin gjatë rrahjeve të të ndaluarve.<sup>2072</sup>

1016. Fakti që vrasja e paligjshme ishte pjesë e qëllimit të përbashkët duket qartë nga: (i) mënyra e qëllimshme si u keqtrajtuat (disa nga) të ndaluarit; (ii) deklaratat e bëra nga anëtarët e NKP-së, përfshirë z. Shala, që tregojnë qartë qëllimin për të vrarë të ndaluarit; dhe (iii) refuzimi i qëllimshëm i trajtimit mjekësor për viktimën e vrasjes së paligjshme, siç shtjellohet më poshtë.

1017. Së pari, disa anëtarë të NKP-së keqtrajtuat brutalisht TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme dhe W04733-shin, duke përdorur mjete të rrezikshme, duke u ndërruar me njëri-tjetrin gjatë rrahjeve dhe duke bashkëvepruar si grup. Konkretisht, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, z. Shala përdori shkop gome dhe shkop bejsbolli për ta goditur W04733-shin në të gjithë trupin, përfshirë në kokë.<sup>2073</sup> Xhemshit Krasniqi gjithashtu e goditi W04733-shin në kokë me armë.<sup>2074</sup> Si pasojë, W04733-shit filloi t'i rridhte gjak. Kur mjeku ia lidhi kokën me fashë, një anëtar i NKP-së ia hoqi fashën.<sup>2075</sup> Po kështu, pasi z. Shala e goditi TW4-01-shin me një shufër gome, [REDAKTUAR].<sup>2076</sup> [REDAKTUAR].<sup>2077</sup> [REDAKTUAR], humbën ndjenjat si pasojë e keqtrajtimit të rëndë që pësuan.<sup>2078</sup> Tregues i qëllimit të anëtarëve të NKP-së është dhe fakti se ata që ishin të pranishëm, ndër ta dhe z. Shala, vazhduan rrahjen [REDAKTUAR] edhe pasi humbën ndjenjat. Një trajtim i ngjashëm iu bë dhe viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>2079</sup> Vlen të kujtohet deklarata e W01448-ës në lidhje me TW4-01-shin dhe viktimën e vrasjes së paligjshme: “[ata] u rrahën më keq se unë. Ata

---

<sup>2072</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2(b)-(e).

<sup>2073</sup> *Shih* para. 690 më lart.

<sup>2074</sup> *Shih* para. 690 më lart.

<sup>2075</sup> *Shih* para. 691 më lart.

<sup>2076</sup> *Shih* para. 655 më lart.

<sup>2077</sup> *Shih* para. 657 më lart.

<sup>2078</sup> [REDAKTUAR].

<sup>2079</sup> [REDAKTUAR].

ishin të përgjakur, dhe për t'i rrahur ata përdornin shkopinj të dhe gjithçka tjetër".<sup>2080</sup> Gjithashtu, [REDAKTUAR] më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, Xhemshit Krasniqi [REDAKTUAR], qëlluan me armë zjarri [REDAKTUAR] viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>2081</sup> [REDAKTUAR].<sup>2082</sup> Duke pasur parasysh mënyrën si u keqtrajtuat TW4-01, viktimë e vrasjes së paligjshme dhe W04733, Trupi Gjykses konstaton se vrasja e paligjshme ishte pjesë e qëllimit të përbashkët qysh më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.

1018. Së dyti, deklaratat e bëra nga anëtarë të NKP-së, ndër ta dhe z. Shala, zbulojnë qartë synimin e tyre për të kryer vrasje. Vetë z. Shala i tha W04733-shit në një moment: "Kemi me të vra. Kemi me të ekzekutu".<sup>2083</sup> [REDAKTUAR].<sup>2084</sup>

1019. Së treti, synimi për të vrrarë manifestohet edhe nga fakti se viktimës së vrasjes së paligjshme iu refuzua qëllimisht trajtimi mjekësor.<sup>2085</sup> Kjo u bë megjithëse viktimë e vrasjes së paligjshme kishte gjakderdhje të madhe (çka ishte e dukshme) dhe, çka është me rëndësi, me gjithë këshillën e mjekut për ta transferuar atë në spital pasi përndryshe nuk do të mbijetonte.<sup>2086</sup> Veprimi i anëtarëve të NKP-së që refuzuan transferimin e viktimës së vrasjes së paligjshme u shoqërua me fjalët: "s'ja kena bo këtë dajak [...], për me e çu tek mjeku".<sup>2087</sup> Kjo nuk lë asnjë dyshim se vrasja ishte pjesë e qëllimit të përbashkët. [REDAKTUAR].<sup>2088</sup>

1020. Mbrojtja parashton se ZPS-ja nuk ka demonstruar që anëtarët e pretenduar të NKP-së ishin marrë vesh të zbatonin një plan kriminal të përbashkët, që përfshinte

---

<sup>2080</sup> *Shih* para. 659 më lart.

<sup>2081</sup> *Shih* Pjesën [REDAKTUAR] Pjesët VI.F.1, VI.F.4.

<sup>2082</sup> [REDAKTUAR].

<sup>2083</sup> *Shih* para. 906 më lart.

<sup>2084</sup> [REDAKTUAR].

<sup>2085</sup> *Shih* para. 760 më lart.

<sup>2086</sup> *Shih* para 759-760, 762 më lart dhe Pjesën VI.F.8.

<sup>2087</sup> *Shih* para. 760 më lart.

<sup>2088</sup> [REDAKTUAR].

kryerjen e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat, në veçanti, krimin e vrasjes së paligjshme.<sup>2089</sup> Konkretisht, Mbrojtja parashtron se: (i) nuk ka prova që tregojnë për komunikime të drejtpërdrejta ose të tërthorta të anëtarëve të NKP-së me njëri-tjetrin; (ii) nuk ka prova se z. Shala u mor vesh me të tjerët për të zbatuar ndonjë plan kriminal, përfshirë ndonjë plan kriminal për të kryer trajtim mizor dhe/ose torturë; (iii) anëtarët e NKP-së nuk vepruan së bashku, por individualisht, për të marrë hak për mëri personale; (iv) pas vrasjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, personat përgjegjës morën masa për të siguruar që të ndaluarit të trajtoheshin njerëzisht, çka tregon se ata nuk donin t'i vrisnin të ndaluarit, u erdhi keq për atë që ndodhi me viktimën e vrasjes së paligjshme dhe morën masa të menjëhershme për të siguruar që kjo të mos ndodhte më; dhe (v) viktimës së vrasjes së paligjshme iu dha trajtimi mjekësor që ishte i disponueshëm, që tregon se grupi nuk donte ta vriste apo ta linte atë të vdiste.<sup>2090</sup>

1021. Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se nuk ka prova që tregojnë se anëtarët e NKP-së patën komunikime të drejtpërdrejta ose të tërthorta me njëri-tjetrin, dhe se nuk ka prova për ndonjë marrëveshje nga ana e z. Shala me anëtarët e NKP-së, Trupi Gjykses rikujton se për ekzistencën e NKP-së nuk është e nevojshme që plani, projekti, ose qëllimi të jetë organizuar ose formuluar më herët. Qëllimi i përbashkët mund të nënkuptohet dhe deduktohet nga fakti se një shumësi personash veprojnë së bashku për të realizuar një ndërmarrje kriminale të përbashkët.<sup>2091</sup> Trupi Gjykses dedukton ekzistencën e qëllimit të përbashkët nga veprimet dhe deklaratat e përbashkëta të anëtarëve të NKP-së – përfshirë të z. Shala – siç u shpjegua më lart. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do ta trajtojë më tej këtë argument dhe rrëzon kundërshtimin e Mbrojtjes.

---

<sup>2089</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 77, 81, 179-181.

<sup>2090</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 77-81, 179-181; T. 16 prill 2024, publike, f. 4277, rreshti 21 deri në f. 4278, rreshti 19; T. 17 prill 2024, publik, f. 4287, rreshti 11 deri në f. 4289, rreshti 7.

<sup>2091</sup> *Shih* para. 1000 më lart.

1022. Lidhur me argumentin e Mbrojtjes se anëtarët e NKP-së nuk vepruan së bashku, por individualisht, për të marrë hak për mëri personale, Trupi Gjykses vë në dukje se ky argument kundërshtohet nga fakti se: (i) të ndaluarit u arrestuan pasi u shënjestruan sepse konsideroheshin “bashkëpunëtorë” të autoriteteve serbe, “spiunë”, “tradhtarë”, simpatizues të Serbisë, apo se nuk e mbështetnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së; (ii) arrestimi i tyre u bë sipas të njëjtës praktikë dhe mënyre veprimi; (iii) ndalimi i tyre në FMK ishte institucionalizuar; dhe (iv) keqtrajtimi i tyre ishte sistematik dhe u krye nga disa anëtarë të NKP-së që vepronin në bashku. Në këtë kontekst, është krejtësisht e pamundur që të gjithë anëtarët e NKP-së të kenë vepruar individualisht, të pavarur nga njëri-tjetri, siç sugjerohet nga Mbrojtja. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se parashtrimi i Mbrojtjes është i pabazë dhe e rrëzon atë.

1023. Së fundi, në lidhje me parashtrimin e Mbrojtjes se anëtarët e NKP-së nuk donin ta vrisnin viktimën e vrasjes së paligjshme, Trupi Gjykses konstaton se ky parashtrim kundërshtohet nga: (i) vetë deklaratat e bëra nga po këta anëtarë të NKP-së, siç u përmend më lart; dhe (ii) fakti se ata i refuzuan trajtimin mjekësor viktimës së vrasjes së paligjshme, megjithëse e dinin se kjo do të çonte në vdekjen e tij, duke pasur parasysh llojin e lëndimeve dhe këshillën e mjekut. Sugjerimi i Mbrojtjes se anëtarëve të NKP-së u erdhi keq për atë që ndodhi me viktimën e vrasjes së paligjshme dhe morën masa të menjëhershme, është i pabazë dhe thjesht kundërshtohet nga faktet e qarta të kësaj çështjeje gjyqësore: viktima e vrasjes së paligjshme nuk u çua në spital dhe vdiq në ndalim në FMK. Fakti se kushtet e ndalimit u përmirësuan më pas nuk e ndryshon këtë. Rrjedhimisht, argumenti i Mbrojtjes është i pabazë dhe Trupi Gjykses e rrëzon atë.

1024. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se anëtarët e NKP-së kishin qëllimin e përbashkët të ndalimit arbitrar, marrjes në pyetje, torturimit dhe vrasjes së të ndaluarve në FMK, të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin, kishin lidhje ose

simpatizonin autoritetet serbe, ose se nuk mbështesnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së. Rrjedhimisht, përmbushet edhe elementi i dytë objektiv i NKP I.

1025. *Kontributi i qenësishëm i z. Shala.* Gjatë gjithë kuadrit kohor të akuzave, z. Shala dha kontribut të qenësishëm në krimet për të cilat janë ngritur akuzat përmes: (i) pjesëmarrjes në transferimin nën rojë të W04733-shit, nga vendi i ndalimit në Romanat për në FMK,<sup>2092</sup> (ii) vazhdimet dhe zbatimit të ndalimit arbitrar të TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, W04733-shit dhe W01448-ës, përmes keqtrajtimit fizik të tyre më 20 maj 1999 dhe 4 qershor 1999, ose rreth këtyre datave, duke zbatuar kështu sistemin e ndalimit të krijuar nga anëtarët e NKP-së në FMK; (iii) keqtrajtimit personalisht prej tij të TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, W04733-shit dhe W01448-ës, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date;<sup>2093</sup> (iv) akuzimit të W04733-shit si “spion”, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date;<sup>2094</sup> (v) urdhërimit [REDAKTUAR] që të rrihnin W04733-shin, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date;<sup>2095</sup> (vi) marrjes në pyetje [REDAKTUAR] më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, si dhe kërkimit që [REDAKTUAR] të jepte deklaratë pranuese se [REDAKTUAR] ishin bashkëpunëtorë të serbëve;<sup>2096</sup> dhe (vii) keqtrajtimit brutal që u bëri personalisht [REDAKTUAR] viktimës së vrasjes së paligjshme më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date.<sup>2097</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, kontributet e z. Shala në realizimin e planit të përbashkët për të ndaluar, marrë në pyetje, keqtrajtuar dhe vrarë të ndaluarit, ishin të qenësishme.

1026. Mbrojtja parashtron se: (i) ZPS-ja nuk ka paraqitur prova që sugjerojnë se z. Shala kishte pozitë me përgjegjësi, pushtet ose kontroll mbi vendimet lidhur me

---

<sup>2092</sup> *Shih* para. 903 më lart.

<sup>2093</sup> *Shih* para. 904 më lart.

<sup>2094</sup> *Shih* para. 905 më lart.

<sup>2095</sup> *Shih* para. 905 më lart.

<sup>2096</sup> *Shih* para. 905 më lart.

<sup>2097</sup> *Shih* para. 907 më lart.



arrestimin, vazhdimin e mbajtjes në ndalim, lirimin ose kushtet e ndalimit të ndonjë personi në FMK; (ii) ZPS-ja nuk ka paraqitur prova se ai kishte pushtet mbi personat që kryen ndalimin arbitrar; dhe (iii) ZPS-ja nuk ka demonstruar se z. Shala kishte detyrimin të vepronte në ndonjë mënyrë konkrete ndaj të ndaluarve në FMK.<sup>2098</sup>

1027. Trupi Gjykses rikujton se, që një i akuzuar të konstatohet penalisht përgjegjës në bazë të përgjegjësisë penale për NKP, duhet që ai të ketë marrë pjesë në realizimin e planit ose qëllimit të përbashkët të NKP-së, duke dhënë kontribut të qenësishëm në zbatimin e tij.<sup>2099</sup> Përtej kësaj, ligji nuk parashikon lloje konkrete sjelljesh që të konsiderohen (ose jo) si kontribute në NKP. Pozita me pushtet ose ushtrimi i kontrollit prej një të akuzuari, ose ekzistenca e detyrimit ligjor për të vepruar, mund të jenë faktorë që duhen marrë parasysh për të përcaktuar se i akuzuari dha kontribut të qenësishëm në NKP, por nuk janë kritere ligjore. Përcaktimi se çfarë përbën kontribut të qenësishëm është çështje faktesh për të cilat duhet të vendoset rast pas rasti.<sup>2100</sup> Si rrjedhojë, nuk është relevante nëse z. Shala kishte pozitë me përgjegjësi, pushtet apo kontroll, apo nëse kishte detyrimin të vepronte në ndonjë mënyrë konkrete ndaj të ndaluarve në FMK. Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes rrëzohen.

1028. Në këtë çështje gjyqësore, Trupi Gjykses ka konstatuar se z. Shala dha kontribut të qenësishëm në krimet për të cilat janë ngritur akuzat, ndër të tjera, me kryerjen fizike dhe pjesëmarrjen e tij në ndalimin arbitrar, marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e rëndë dhe brutal të të ndaluarve. Z. Shala kishte njëfarë autonomie dhe pushteti në FMK, veçanërisht kur keqtrajtonte të ndaluarit.<sup>2101</sup> Në kundërshtim me parashtrimet e

---

<sup>2098</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 73, 76, 86, 122, 128-129; T. 16 prill 2024, publike, f. 4275, rreshtat 6-14; f. 4276, rreshtat 9-11; f. 4277, rreshtat 15-20.

<sup>2099</sup> *Shih* para. 1001 më lart.

<sup>2100</sup> *Shih ngjashëm*, ICTY, *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 30 June 2016, para. 110.

<sup>2101</sup> *Shih* Pjesët VI.I.2-3.

Mbrojtjes,<sup>2102</sup> kontributi i z. Shala e tejkaloi ndjeshëm kriterin për përmbushjen e këtij elementi.<sup>2103</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se është përmbushur edhe elementi i tretë objektiv i NKP I.

(b) Elementet subjektive

1029. *Synimi i kryerjes së krimeve të ndalimit arbitrar dhe torturës.* Trupi Gjykses rikujton konstatimet e bëra më lart se z. Shala kishte synimin kriminal të nevojshëm për kryerjen e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1) dhe torturës (Pika 3).<sup>2104</sup> Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala, së bashku me anëtarët e tjerë të NKP-së, kishte qartazi synimin për të kryer ndalim arbitrar dhe torturë.

1030. Duke qenë se Mbrojtja përsërit të njëjtat argumente që paraqiti në lidhje me synimin kriminal për krimin e ndalimit arbitrar,<sup>2105</sup> Trupi Gjykses i referohet konstatimit të bërë më lart prej tij.<sup>2106</sup>

1031. *Synimi i kryerjes së krimit të vrasjes së paligjshme.* Trupi Gjykses dedukton synimin e z. Shala për kryerjen e krimit të vrasjes së paligjshme nga sa vijon.

1032. Së pari, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, z. Shala mori pjesë aktive në rrahjen e TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, W04733-shit dhe W01448-ës<sup>2107</sup> dhe, veçanërisht, ai e goditi W04733-shin në kokë me shkop gome.<sup>2108</sup> Gjatë këtij incidenti, një numër anëtarësh të NKP-së nxorën armët dhe i përdorën ato për të goditur të ndaluarit në kokë.<sup>2109</sup> Z. Shala ishte gjithashtu dëshmitar i dhunës së skajshme të ushtruar nga anëtarë të tjerë të NKP-së, veçanërisht ndaj TW4-01-shit, viktimës së

---

<sup>2102</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 90, 145.

<sup>2103</sup> *Shih* para. 1001 më lart.

<sup>2104</sup> *Shih* Pjesët VII.B.2 (b) dhe VII.D.2 (b).

<sup>2105</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 87-89.

<sup>2106</sup> *Shih* Pjesën VII.B.2 (b).

<sup>2107</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2 (b), VI.E.2 (c) dhe VI.E.2 (d).

<sup>2108</sup> *Shih* para. 690 më lart.

<sup>2109</sup> *Shih* para. 655, 690 më lart.

vrasjes së paligjshme dhe W04733-shit, si dhe i pasojave të saj, ndër të cilat: gjakderdhje (përfshirë nga koka) dhe lëndime aq të rënda sa viktimat nuk mund të ecnin më dhe humbën vetëdijen.<sup>2110</sup> Shkalla e dhunës së përdorur dhe fakti se z. Shala ishte dëshmitar i saj por megjithatë vazhdoi të merrte pjesë në keqtrajtimin e të ndaluarve edhe pasi atyre filloi t'u dilte gjak ose humbën ndjenjat, tregon qartë se më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, ai e kishte synimin për të kryer vrasje.

1033. Së dyti, deklarata që z. Shala i bëri W04733-shit: "Kemi me të vra. Kemi me të ekzekutu" zbulon qartë synimin e tij për të vrarë,<sup>2111</sup> që nuk mundi të realizohej për shkak të ndërhyrjes nga jashtë të një autoriteti shqiptar që siguroi lirimin e W04733-shit.<sup>2112</sup> Kjo deklaratë tregon se z. Shala kishte synim të drejtpërdrejtë.

1034. Së treti, më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, z. Shala mori pjesë në keqtrajtimin e [REDAKTUAR] viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>2113</sup> Ai ishte i pranishëm kur anëtarë të tjerë të NKP-së qëlluan me armë zjarri [REDAKTUAR] viktimën e vrasjes së paligjshme, dhe ishte dëshmitar i pasojave të kësaj.<sup>2114</sup> [REDAKTUAR], viktimë e vrasjes së paligjshme pati gjakderdhje të madhe.<sup>2115</sup> Fakti që z. Shala vazhdoi të merrte pjesë në keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], tregon se ai kishte synimin e përbashkët për të vrarë.<sup>2116</sup>

1035. Mbrojtja parashtron se nuk është paraqitur asnjë provë që tregon se z. Shala donte të vraste viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>2117</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjyqësor i referohet konstatimit të bërë më lart prej tij dhe nuk do ta trajtojë më tej këtë argument.

---

<sup>2110</sup> *Shih* Pjesët VI.E.2 (b) dhe VI.E.2 (c).

<sup>2111</sup> *Shih* para. 906 më lart.

<sup>2112</sup> *Shih* para. 469 më lart.

<sup>2113</sup> *Shih* Pjesën VI.E.2 (b): *Keqtrajtimi në dhomën 2 më 4 qershor 1999 ose rreth kësaj date.*

<sup>2114</sup> *Shih* Pjesën VI.F.4.

<sup>2115</sup> *Shih* para. 759, 762, 775, 776 më lart.

<sup>2116</sup> [REDAKTUAR].

<sup>2117</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 183; T. 17 prill 2024, konfidencial, f. 4289, rreshti 8 deri në f. 4290, rreshti 4.

Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se z. Shala nuk mund të mbajë përgjegjësi për krimin e vrasjes së paligjshme, pasi nuk ishte i pranishëm gjatë incidentit të gjuajtjes me armë zjarri që çoi në vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme,<sup>2118</sup> Trupi Gjykses i referohet gjithashtu konstatimit të mëhershëm të tij se ai, në fakt, ishte i pranishëm.<sup>2119</sup> Gjithsesi, vlen të theksohet se, për të pasur përgjegjësi në bazë të NKP-së, nuk është e nevojshme që i akuzuari të ketë qenë i pranishëm në momentin kur u krye krimi nga kryesi i drejtpërdrejtë.<sup>2120</sup> Çka nevojitet është që i akuzuari të ketë dhënë kontribut të qenësishëm në qëllimin e përbashkët dhe, në rastin e NKP I, të ketë pasur synimin e përbashkët për të kryer krimin me anëtarët e tjerë të NKP-së.<sup>2121</sup> Kjo ishte ajo që ndodhi në këtë rast. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rrëzon argumentet e Mbrojtjes.

1036. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se z. Shala, bashkë me anëtarët e tjerë të NKP-së, kishte synimin e përbashkët për kryerjen e krimeve të ndalimit arbitrar (Pika 1), torturës (Pika 2) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), duke përmbushur kështu elementin subjektiv të NKP I.

#### G. PËRFUNDIM

1037. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton jashtë dyshimit të arsyeshëm se — në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe dhe duke qenë në dijeni të rrethanave që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe të statusit të viktimave— z. Shala është fajtor për Pikën 1 të Aktakuzës së Konfirmuar, për kryerje, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj (NKP I), sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, të ndalimit arbitrar si krim lufte, sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, ndaj së paku 18 (tetëmbëdhjetë) personave, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 në fabrikën e metalit në

---

<sup>2118</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 160-164, 179.

<sup>2119</sup> *Shih* Pjesën VI.F.4.

<sup>2120</sup> ICTY, *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 17 September 2003, para. 81.

<sup>2121</sup> *Shih* para. 1002 më lart.

Kukës, siç është konstatuar nga Trupi Gjykses në Pjesët VII.A, B dhe F të këtij Aktgjykimi.

1038.Trupi Gjykses gjithashtu konstaton jashtë dyshimit të arsyeshëm se — në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, duke qenë në dijeni të rrethanave që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe statusin e viktimave — z. Shala është fajtor për Pikën 3 të Aktakuzës së Konfirmuar, për kryerje, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj (NKP I), sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, të torturës si krim lufte, sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, ndaj së paku 18 (tetëmbëdhjetë) personave, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 në fabrikën e metalit në Kukës, siç është konstatuar nga Trupi Gjykses në Pjesët VII.A, D dhe F të këtij Aktgjykimi.

1039.Trupi Gjykses gjithashtu konstaton jashtë dyshimit të arsyeshëm se — në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, duke qenë në dijeni të rrethanave që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe statusin e viktimave — z. Shala është fajtor për Pikën 4 të Aktakuzës së Konfirmuar, për kryerje, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në formën bazë të saj (NKP I), sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, të vrasjes së paligjshme si krim lufte, sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, ndaj 1 (një) personi, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, në fabrikën e metalit në Kukës, siç është konstatuar nga Trupi Gjykses në Pjesët VII.A, E dhe F të këtij Aktgjykimi.

## VIII. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

1040.Pasi ka konstatuar se z. Shala është fajtor për Pikat 1, 3 dhe 4, tani Trupi Gjykses do të përcaktojë dënimin e duhur.

1041.Kjo pjesë e Aktgjykimit trajton vetëm përcaktimin e dënimit sipas nenit 44(1) të Ligjit.

1042. Trupi Gjykses do të nxjerrë më vonë një Urdhër për Zhdëmtim sipas neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit dhe ruan juridiksionin e nevojshëm në lidhje me këtë.<sup>2122</sup>

#### A. PARASHTRIMET

##### 1. ZPS-ja

1043. Duke mbajtur parasysh se Trupi Gjykses ka kompetencë të gjerë diskrecionale në përcaktimin e dënimit të duhur, që mund të jetë deri me burgim të përjetshëm,<sup>2123</sup> ZPS-ja parashtron se, në bazë të nenit 44(2) të Ligjit, të Ligjit, Trupi Gjykses, merr parasysh – pa qenë i detyruar t'u përmbahet – edhe: (i) shkallëzimet e dënimeve të përcaktuara në legjislacionin e Kosovës për veprat penale në kohën e kryerjes së tyre; dhe (ii) çdo shkallëzim tjetër më të butë të përcaktuar më vonë në legjislacionin e Kosovës për veprat penale, si dhe dispozitat përkatëse të instrumenteve ligjore të përmendura në nenin 44(2), paragrafin (c) të Ligjit.<sup>2124</sup> ZPS-ja parashtron se ligji relevant që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale për të cilat janë ngritur akuzat ishte Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ).<sup>2125</sup> Sipas ZPS-së, z. Shala e dinte, ose duhet ta kishte ditur se, bazuar në dispozitat e KPRSFJ-së mbi dënimet, për krimet e luftës jepeshin dënime të rënda.<sup>2126</sup>

1044. ZPS-ja gjithashtu parashtron se në përcaktimin e dënimit të duhur, Trupi Gjykses mund marrë parasysh praktikat e dhënies së dënimeve nga gjykatat shtetërore dhe ndërkombëtare në çështje të ngjashme.<sup>2127</sup> Sa u përket çështjeve

---

<sup>2122</sup> *Shih* KSC-BC-2020-04, F00421, Trupi Gjykses I, [Decision on reparation proceedings](#) (Vendim mbi Procesin e Zhdëmtimit), 9 shkurt 2023, publik, para. 25(b).

<sup>2123</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 379.

<sup>2124</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 380.

<sup>2125</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 381-382.

<sup>2126</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 383.

<sup>2127</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 384.

gjqësore ndërkombëtare, ZPS-ja u referohet çështjeve *Stakiq, Krstiq dhe Blashkiq*, në secilën prej të cilave u dhanë dënime fillestare me më shumë se 20 vjet burgim.<sup>2128</sup>

Lidhur me çështjet gjyqësore në Kosovë, ZPS-ja vë në dukje se dy anëtarë të NKP-së të përmendur në Aktakuzën e Konfirmuar kundër z. Shala, tashmë janë shpallur fajtorë në Kosovë për disa prej veprave penale për të cilat janë ngritur akuza në këtë çështje: (i) Sabit GECI u dënua me 15 vjet burgim në lidhje me akuzat e trajtimit çnjerëzor, cenimit të integritetit trupor, dhe torturës, që është dënimi më i lartë që gjykatësit çmuan se mund të jepej sipas ligjit në fuqi në Kosovë; dhe (ii) Xhemshit Krasniqi u dënua me 8 vjet burgim – që në apel iu ul në 7 vjet – dënim ky që sipas ZPS-së, “është në mesin e shkallëzimit të dënimit që mund të jepte Trupi Gjyqësor”.<sup>2129</sup>

1045. Lidhur me faktorët që duhet të merren parasysh në përcaktimin e dënimit, ZPS-ja parashtron se dënimi duhet të pasqyrojë:<sup>2130</sup> (i) në radhë të parë, peshën e krimeve të kryera nga z. Shala, veçanërisht brutalitetin e tyre;<sup>2131</sup> (ii) ndikimin e krimeve mbi viktimat dhe të afërmit e tyre;<sup>2132</sup> (iii) pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë dhe të qëllimshme të z. Shala në kryerjen e krimeve;<sup>2133</sup> (iv) praninë e faktorëve të shumtë rëndues, në veçanti cenueshmërinë e viktimave<sup>2134</sup> dhe kryerjen e krimeve në një mënyrë

---

<sup>2128</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 383, dhe referencat aty.

<sup>2129</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 385, dhe referencat aty. ZPS-ja vë në dukje se në dënimet përkatëse të Sabit Gecit dhe Xhemshit Krasniqit nuk u përfshi vepra penale e vrasjes së paligjshme.

<sup>2130</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 386-410.

<sup>2131</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 387, 389-394.

<sup>2132</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 388, 395-396; T. 15 prill 2024, publik, f. 4162, rreshti 17 deri në f. 4164, rreshti 3.

<sup>2133</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 402-403; T. 15 prill 2024, publik, f. 4085, rreshti 18 deri në f. 4086, rreshti 2; f. 4165, rreshti 1 deri në f. 4166, rreshti 18.

<sup>2134</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 397-398.

veçanërisht mizore dhe ndaj një numri viktimash;<sup>2135</sup> dhe (v) mungesën e faktorëve lehtësues.<sup>2136</sup>

1046. Duke nënvizuar rëndësinë e parandalimit,<sup>2137</sup> ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykses të japë dënimet e mëposhtme me burgim për z. Shala: (i) ndalim arbitrar (Pika 1): 8 vjet; (ii) trajtim mizor (Pika 2): 15 vjet; (iii) torturë (Pika 3): 20 vjet; dhe (iv) vrasje e paligjshme (Pika 4): 26 vjet.<sup>2138</sup> ZPS-ja kërkon që z. Shala t'i jepet një dënim i njësuar me 28 vjet burgim, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale të tij.<sup>2139</sup>

## 2. Mbrojtja

1047. Duke iu referuar nenit 44(2) të Ligjit dhe Aktgjykimit të Apelit *Mustafa*,<sup>2140</sup> Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh praktikën e përcaktimit të dënimeve në Kosovë në lidhje me shkallëzimet e dënimeve, si dhe vendimet e dënimeve të shqiptuara më parë në çështje gjyqësore të tjera për sjellje të pretenduara të ngjashme, të kryera në rrethana thelbësisht të ngjashme.<sup>2141</sup>

1048. Në lidhje me peshën e krimeve dhe pasojat e tyre, Mbrojtja parashtron se, ndonëse padyshim të rënda, krimet e paraqitura në Aktakuzë janë të kufizuara për nga shtrirja, shkalla, dhe numri i viktimave të tyre (tetë viktima pjesëmarrëse në proces dhe një viktimë e vrarë), dhe rrjedhimisht kanë peshë shumë më të ndryshme

---

<sup>2135</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 399-401; T. 15 prill 2024, publik, f. 4164, rreshtat 4-12.

<sup>2136</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 404-408; T. 15 prill 2024, publik, f. 4166, rreshti 19 deri në f. 4167, rreshti 7.

<sup>2137</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 409-410, dhe referencat aty.

<sup>2138</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 411; T. 15 prill 2024, publik, f. 4167, rreshtat 8-13.

<sup>2139</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 412-413.

<sup>2140</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 372.

<sup>2141</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 374, dhe referencat aty.



në krahasim me çështje gjyqësore të tjera të gjykuara në tribunalë penale ndërkombëtare.<sup>2142</sup>

1049. Në lidhje me llojin dhe shkallën e përfshirjes së z. Shala në krimet e pretenduara, Mbrojtja parashtron se ai nuk ishte udhëheqës apo komandant, dhe as kishte pushtet apo pozitë të lartë; përkundrazi, ai ishte “ushtar i thjeshtë [i UÇK-së]”.<sup>2143</sup>

1050. Sa u përket rrethanave personale të z. Shala, Mbrojtja i sjell në vëmendje Trupit Gjykses aktekspertizën psikologjike të znj. Milaco, që përmban një vlerësim të rrethanave personale, shëndetit mendor dhe sjelljes së z. Shala, pas ngjarjeve të pretenduara e deri më sot.<sup>2144</sup> Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh sa vijon: (i) kontekstin në të cilin u rrit z. Shala, përfshirë dhunën dhe traumat që përjetoi në Kosovë para vitit 1999;<sup>2145</sup> dhe (ii) problemet shëndetësore të tij.<sup>2146</sup>

1051. Në lidhje me rrethanat lehtësuese, Mbrojtja parashtron se duhet të merren parasysh sa vijon: (i) gjendja familjare aktuale e z. Shala;<sup>2147</sup> (ii) sjellja e mirë e z. Shala gjatë kohës së kaluar në paraburgim;<sup>2148</sup> (iii) një sërë shkeljesh të pretenduara të së drejtës së tij për gjykim të drejtë gjatë gjykimit, për të cilat Mbrojtja argumenton se janë të një “natyre të veçantë”, dhe për ligjin uljen e dënimit;<sup>2149</sup> dhe (iv) koha që ka kaluar ndërmjet periudhës kur u kryen krimet e pretenduara të paraqitura në

---

<sup>2142</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 354.

<sup>2143</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 355; T. 16 prill 2024, publik, f. 4277, rreshtat 15-20.

<sup>2144</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 356; DPS01735-DPS01757.

<sup>2145</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 357-359.

<sup>2146</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 356. Si faktor lehtësues është paraqitur edhe gjendja e keqe shëndetësore e z. Shala, *shih* Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të Mbrojtjes, para. 362.

<sup>2147</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 360-361.

<sup>2148</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 366-367.

<sup>2149</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 368-369.

Aktakuzën e Konfirmuar dhe këtij procesi, e cila sipas mendimit të Mbrojtjes ka pasur ndikim të dëmshëm në cilësinë dhe disponueshmërinë e provave.<sup>2150</sup>

1052. Në lidhje me dënimin që mund t'i jepet z. Shala, Mbrojtja i sjell në vëmendje Trupit Gjykses çështjet gjyqësore *Sabit Geci dhe të tjerët dhe Xhemshit Krasniqi*.<sup>2151</sup> Mbrojtja rikujton se: (i) Sabit Geci u dënua me 15 vjet burgim për tri akuza për krime lufte (Kukës), një akuzë për krim lufte (Cahan), dhe një akuzë për posedim të paautorizuar të armëve;<sup>2152</sup> dhe (ii) Xhemshit Krasniqi u dënua me 8 vjet burgim për ndalim të paligjshëm, torturë, cenim të integritetit trupor ose shëndetit të dëshmitarëve dhe civilëve të panjohur (Kukës).<sup>2153</sup> Mbrojtja argumenton se, për dallim nga Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi, z. Shala nuk kishte pozitë komanduese në FMK, dhe se çfarëdo dënimi që mund të shqiptohet duhet të pasqyrojë rolin më të vogël që i atribuohet z. Shala në Aktakuzën e Konfirmuar dhe provat e paraqitura nga ZPS-ja.<sup>2154</sup> Në rast të shpalljes fajtor të tij në bazë të përgjegjësisë penale për NKP, Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykses të marrë parasysh si rrethanë lehtësuese pozitën e ulët të z. Shala krahasuar me anëtarët e tjerë të NKP-së.<sup>2155</sup> Gjatë deklaratave përmbyllëse të saj, Mbrojtja deklaroi se dënimi i kërkuar nga ZPS-ja është i tepruar

---

<sup>2150</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 370; T. 16 prill 2024, publik, f. 4220, rreshti 21 deri në f. 4223, rreshti 16; f. 4230, rreshtat 1-8.

<sup>2151</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 375-377.

<sup>2152</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 376. Mbrojtja nënvizon se: (i) u konstatua se Sabit Geci kishte pozitë komanduese si anëtar i UÇK-së; (ii) ai u shpall i pafajshëm për akuzën e vrasjes së paligjshme dhe (iii) dy akuzat e fundit nuk janë të krahasueshme me akuzat e ngritura ndaj z. Shala. Mbrojtja shton se Sabit Geci gjithashtu u dënua me gjobë (4000 euro).

<sup>2153</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 377. Mbrojtja nënvizon se Xhemshit Krasniqi u shpall i pafajshëm për akuzën e vrasjes së paligjshme dhe gjithashtu u dënua me gjobë (1500 euro). Mbrojtja parashtron se Xhemshit Krasniqi u lirua në shtator 2020, pasi kishte kryer pesë vjet burg. Trupi Gjykses vë në dukje se në apel dënimi i Xhemshit Krasniqit u ul në 7 vjet burgim.

<sup>2154</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 378-379.

<sup>2155</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 379.

dhe joproportional, dhe se buronte nga tendenca për ta trajtuar dënimin si masë shtypëse.<sup>2156</sup>

1053. Duke ritheksuar se rehabilitimi dhe riintegrimi në shoqëri janë faktorë të detyrueshëm që duhen marrë parasysh në përcaktimin e dënimit,<sup>2157</sup> Mbrojtja gjithashtu argumenton se dënimi duhet të japë një mesazh të caktuar humanizues.<sup>2158</sup> Ajo parashtron se në rast të shpalljes fajtor, dënimi duhet të jetë i drejtë dhe proporcional.<sup>2159</sup>

1054. Së fundi, Mbrojtja gjithashtu kërkon që Trupi Gjykses të llogarisë kohën e kaluar në paraburgim nga z. Shala.<sup>2160</sup>

### 3. Mbrojtësi i Viktimave

1055. Duke iu referuar Ligjit, Rregullores dhe konstatimeve përkatëse në çështjen gjyqësore *Mustafa*,<sup>2161</sup> Mbrojtësi i Viktimave parashtron se për përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses merr parasysh: (i) peshën e krimeve dhe pasojat afatgjata të tyre të viktimat dhe të afërmit e tyre;<sup>2162</sup> dhe (ii) kontributin personal të z. Shala në krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>2163</sup> Në lidhje me faktorin e parë, në deklaratat përmbyllëse të tij, Mbrojtësi i Viktimave kundërshtoi qëndrimin e Mbrojtjes se krimet kishin shkallë dhe shtrirje të kufizuar, dhe theksoi vlerat që mbrohen nga dispozitat në lidhje me krime të tilla si ndalimi arbitrar tortura dhe vrasja e paligjshme, si edhe

---

<sup>2156</sup> T. 17 prill 2024, publik, f. 4341, rreshtat 6-12; f. 4343, rreshtat 12-17; f. 4344, rreshtat 3-12.

<sup>2157</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 353.

<sup>2158</sup> T. 17 prill 2024, publik, f. 4344, rreshtat 4-12.

<sup>2159</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 380.

<sup>2160</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 371.

<sup>2161</sup> Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 184-188.

<sup>2162</sup> Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 189-194; T. 16 prill 2024, publik, f. 4212, rreshti 19 deri në f. 4213, rreshti 12.

<sup>2163</sup> Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 195.

ndikimin transformues që këto krime patën në jetën e viktimave dhe familjet e tyre.<sup>2164</sup>

Në lidhje me faktorin e dytë, ndonëse vuri në dukje se roli i tij nuk ishte ai i një komandanti, Mbrojtësi i Viktimave parashtron se z. Shala mori pjesë aktive në dhunën e ushtruar ndaj të ndaluarve në FMK dhe nuk ndërhyri në asnjë moment për ta parandaluar apo kufizuar atë.<sup>2165</sup>

1056. Gjithashtu, Mbrojtësi i Viktimave thekson se krimet u kryen në një mënyrë veçanërisht mizore ndaj personave krejtësisht të pambrojtur, të cilët ishin tërësisht në mëshirën e atyre që i ndaluan.<sup>2166</sup> Po kështu, Mbrojtësi i Viktimave thekson se z. Shala nuk tregoi asnjë shenjë pendese dhe nuk u kërkoi falje viktimave.<sup>2167</sup>

1057. Në deklaratat përmbyllëse, Mbrojtësi i Viktimave iu përgjigj disa prej argumenteve të Mbrojtjes në lidhje me rrethanat personale dhe lehtësuese. Mbrojtësi i Viktimave vuri në pikëpyetje relevancën e përmendjes prej Mbrojtjes të moshës së z. Shala dhe jetës së tij në Kosovë para vitit 1999.<sup>2168</sup> Gjithashtu, Mbrojtësi i Viktimave parashtrroi se problemet shëndetësore dhe rrethanat familjare të një personi të shpallur fajtor mund të merren parasysh si rrethana lehtësuese vetëm në rrethana të veçanta.<sup>2169</sup> Në lidhje me parashtrimet e Mbrojtjes për sjellje të mirë, Mbrojtësi i Viktimave deklaroi se në rastin e z. Shala nuk mund të flitet për bashkëpunim të lirë dhe të ofruar vullnetarisht prej tij.<sup>2170</sup> Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se shkeljet e të drejtës për gjykim të drejtë përlligjin uljen e dënimit, Mbrojtësi i Viktimave argumenton se: (i) ankesat për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të bëra nga Mbrojtja janë të pabaza; dhe (ii) Mbrojtja ngatërron uljen e mundshme të dënimit si masë ndreqëse për

---

<sup>2164</sup> T. 16 prill 2024, publik, f. 4213, rreshtat 6-12.

<sup>2165</sup> Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 195.

<sup>2166</sup> Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 189, 194, 197.

<sup>2167</sup> Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 196.

<sup>2168</sup> T. 16 prill 2024, publik, f. 4206, rreshtat 4-24.

<sup>2169</sup> T. 16 prill 2024, konfidencial, f. 4206, rreshti 25 deri në f. 4209, rreshti 11.

<sup>2170</sup> T. 16 prill 2024, publik, f. 4209, rreshti 17 deri në f. 4210, rreshti 1.

shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, me rrethanat lehtësuese.<sup>2171</sup> Në lidhje me kohën që ka kaluar ndërmjet ngjarjeve të pretenduara dhe procesit aktual, Mbrojtësi i Viktimave parashtrori se Mbrojtja nuk ka ofruar ndonjë referencë apo shpjegim në mbështetje të këtij parashtrimi.<sup>2172</sup>

1058. Duke rikujtuar se qëllimet e dënimit është ndëshkimi, parandalimi por dhe “parandalimi afirmativ”,<sup>2173</sup> Mbrojtësi i Viktimave nuk kërkon dënim të veçantë për secilën akuzë, por argumenton se dënimi duhet të jetë “i konsiderueshëm”.<sup>2174</sup>

1059. Së fundi, Mbrojtësi i Viktimave përsërit kërkesën e tij që në aktgjykim Trupi Gjykses të përfshijë një vendim lidhur me shkallën dhe masën e dëmit, të humbjeve dhe lëndimeve që u janë shkaktuar viktimave ose që lidhen me to, edhe në rast të një verdikti pafajësie.<sup>2175</sup>

## B. KUADRI LIGJOR

### 1. Qëllimet e dënimit

1060. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se qëllimet parësore të dënimit janë parandalimi dhe ndëshkimi; rehabilitimi është i rëndësishëm por nuk duhet të luajë rol mbizotërues.<sup>2176</sup> Sa i përket parandalimit, Trupi Gjykses rikujton se dënimi duhet të jetë i tillë që të shkurajojë përsëritjen e krimit nga personi i dënuar (parandalimi individual), si dhe të synojë të shkurajojë kryes të tjerë të mundshëm nga kryerja e krimeve të njëjta apo të ngjashme (parandalimi i përgjithshëm).<sup>2177</sup> Ndëshkimi

---

<sup>2171</sup> T. 16 prill 2024, publik, f. 4210, rreshti 2 deri në f. 4211, rreshti 25.

<sup>2172</sup> T. 16 prill 2024, publik, f. 4212, rreshtat 1-4.

<sup>2173</sup> Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 198.

<sup>2174</sup> T. 16 prill 2024, publik, f. 4213, rreshtat 13-19.

<sup>2175</sup> Deklarata e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 199.

<sup>2176</sup> *Shih [Mustafa Appeal Judgment](#)* (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 451, dhe referencat aty; *Mustafa Trial Judgment* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 772.

<sup>2177</sup> *Shih [Mustafa Appeal Judgment](#)* (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 452, dhe referencat aty.

kuptohtet si dhënie e dënimit të duhur që pasqyron fajësinë e personit të dënuar, por nuk duhet të shprehë hakmarrje apo shpagim.<sup>2178</sup> Rehabilitimi përqendrohet në riintegrimin e personit të dënuar në shoqëri.<sup>2179</sup>

1061. Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes për mbajtjen parasysh të rehabilitimit të z. Shala Trupi Gjykues thekson se, ndonëse rehabilitimi ka marrë më shumë rëndësi se më parë në juridiksionet shtetërore dhe në disa instrumente rajonale të të drejtave të njeriut,<sup>2180</sup> aspekteve të rehabilitimit nuk mund t'u jepet rëndësi e tepruar, duke pasur parasysh peshën e veprave penale që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

1062. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se me themelimin e Dhomave të Specializuara është njohur rëndësia e nxjerrjes para drejtësisë e kryesve të krimeve të rënda që përbëjnë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare në tërësi, për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë – edhe dekada pas ngjarjeve në fjalë dhe përkundër ekzistencës prej kohësh e atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.<sup>2181</sup>

1063. Dënimi duhet gjithashtu të pasqyrojë thirrjen për drejtësi nga personat që kanë qenë – drejtpërdrejt ose tërthorazi – viktimat e krimeve. Një qëllim tjetër i rëndësishëm i dënimit është njohja e dëmit dhe vuajtjeve që u janë shkaktuar atyre dhe shoqërisë.<sup>2182</sup>

---

<sup>2178</sup> *Shih [Mustafa Appeal Judgment](#)* (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 452, dhe referencat aty.

<sup>2179</sup> *Shih [Mustafa Appeal Judgment](#)* (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 452, dhe referencat aty.

<sup>2180</sup> ECtHR, *Murray v. The Netherlands*, Application No. 10511/10, Grand Chamber, [Judgment](#), 26 April 2016, paras 101-102; *Khoroshenko v. Russia*, Application No. 41418/04, Grand Chamber, [Judgment](#), 30 June 2015, para. 121; *shih edhe* Council of Europe, [Recommendation Rec\(2006\)2-rev of the Committee of Ministers to member States on the European Prison Rules](#), miratuar më 11 janar, rishikuar dhe ndryshuar më 1 korrik 2020; UN Human Rights Committee, [CCPR General Comment No. 21: Article 10 \(Humane Treatment of Persons Deprived of Their Liberty\)](#), miratuar më 10 prill 1992, paras 10, 13.

<sup>2181</sup> *Shih* para. 96-97 më lart; *shih gjithashtu, [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 773; [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 577-578.

<sup>2182</sup> *Shih* nenin 38(1)(1.3) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074 (2019 KCC), ku thuhet se një nga qëllimet e dënimit është “të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale”. *Shih gjithashtu, [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 774.

1064. Gjithashtu, qëllimi i dënimit të dhënë nga Trupi Gjykses është që të bëjë më se të qartë se rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare duhet të respektohen në të gjitha rrethanat dhe në të gjitha vendet.<sup>2183</sup>

1065. Së fundi, Trupi Gjykses gjykon se një qëllim tjetër i dënimit në çështjen në fjalë është zbatimi i parimit të barazisë para ligjit.<sup>2184</sup>

## 2. Përcaktimi i dënimit

1066. Për përcaktimin e dënimit, në bazë të nenit 3(2)(b)-(c) dhe (4) të Ligjit, Trupi Gjykses zbaton dispozitat e neneve 44(1), (2) dhe (5) të Ligjit dhe rregullat 159(6) dhe 163(1), (3), (4) dhe (6) të Rregullores.

1067. Në bazë të nenit 44(1) të Ligjit, Trupi Gjykses mund të shqiptojë kundër personit të shpallur fajtor dënim maksimal me burgim të përjetshëm.

1068. Në bazë të nenit 44(2) të Ligjit, për përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses duhet të “marrë parasysh”<sup>2185</sup> edhe dënimet e përcaktuara për ato vepra penale në ligjin që ishte në fuqi në Kosovë në kohën e kryerjes së krimeve të shqyrtuara dhe, në veçanti, çdo dënim më të butë të mëvonshëm. Gjithsesi, aspekte të tilla nuk kanë fuqi detyruese mbi Trupin Gjykses.<sup>2186</sup>

---

<sup>2183</sup> *Shih gjithashtu, [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 776. Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. Aleksovski*, IT-95-14/A-1, Appeals Chamber, [Judgement](#), 24 March 2000, para. 185; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-T, Trial Chamber III, [Judgement](#), Vol. 4 (*Prlić et al. Trial Judgement*), 29 May 2013, para. 1276; ICTR, *Prosecutor v. Kambanda*, ICTR-97-23-S, Trial Chamber I, [Judgement and Sentence](#), 4 September 1998, para. 28.*

<sup>2184</sup> *Shih gjithashtu, [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 777, dhe referencat aty.*

<sup>2185</sup> Nga ana tjetër, në kontekstin e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë, neni 44(4) i Ligjit përcakton se dënimet për “krimet sipas nenit 15(2), janë në përputhje me dënimin për krimet e përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, Ligji nr. 04/L-082” (theksimi i shtuar), që nënkupton se ky është kriter i detyrueshëm. *Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 941.*

<sup>2186</sup> *[Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit Mustafa), para. 466; shih gjithashtu, [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 780.*

1069. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konstaton se në kohën e kryerjes së veprave penale të shqyrtuara, në Kosovë zbatoheshin dispozitat ligjore përkatëse të Kodit Penal të RSFJ-së. Ai vë në dukje se neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së i titulluar “Krime lufte kundër popullatës civile” parashikonte ose “burgim me jo më pak se pesë vjet ose [...] dënim me vdekje” dhe se neni 38 i Kodit Penal të RFSJ-së i titulluar “Burgimi” parashikonte se “dënimi me burgim nuk mund të jetë më i gjatë se 15 vjet” por [mund të jepej] “një dënim me 20 vjet burg për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me vdekje”.<sup>2187</sup> Trupi Gjykses thekson se, më pas, me Rregulloren nr. 1999/24 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dënimi me vdekje u anulua<sup>2188</sup> pa specifikuar një shkallëzim alternativ dënimi, që çoi në zbatimin e një shkallëzimi dënimesh nga pesë deri në 15 vjet burgim sipas neneve 38 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së.<sup>2189</sup> Trupi Gjykses gjithashtu thekson se në ligjet apo kodet përkatëse të miratuara më vonë në Kosovë parashikohen shkallëzime dënimesh të njëjta ose më të rënda, dhe, në veçanti, në to përcaktohen dënime maksimale më të rënda.<sup>2190</sup>

1070. Në lidhje me praktikën shtetërore dhe atë ndërkombëtare të përcaktimit të dënimeve, Trupi Gjykses përfshin përmes referimit përshkrimin e hollësishëm të

---

<sup>2187</sup> [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 781.

<sup>2188</sup> *Shih* UNMIK/REG/1999/24, 12 dhjetor 1999, Pjesën 1(1.5).

<sup>2189</sup> *Shih* [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 473, dhe referencat aty, në veçanti Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të 31 marsit 2022, para. 48, 50, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të 20 marsit 2023, f. 8 (versioni në anglishte).

<sup>2190</sup> *Shih* shkallëzimet e mëposhtme të dënimeve të përcaktuara më vonë në kodet penale të Kosovës, në lidhje me veprat penale sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit: (i) nenin 120 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, UNMIK/REG/2003/25, 6 korrik 2003 (KPPK-ja e vitit 2003), lexuar së bashku me nenet 37(2) dhe 38(1) të KPPK-së së vitit 2003 PKCC, që përcakton një dënim me 5 deri në 20 vjet burgim, ose me 21 deri në 40 vjet burgim; (ii) nenin 152 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, Kodi nr. 04/L-082 (KPK-ja e vitit 2012), që përcakton, lexuar së bashku me nenin 45(1) të KPK-së së vitit 2012, dënim me 5 deri në 25 vjet burgim, ose dënim me burgim të përjetshëm; dhe (iii) nenin 146 të KPK-së së vitit 2019, që përcakton, lexuar së bashku me nenin 42(1)-(2) të KPK-së së vitit 2019, dënim me 5 deri në 25 vjet burgim ose dënim me burgim të përjetshëm, ku ky i fundit mund të zëvendësohet me një dënim me deri në 35 vjet burgim. *Shih* [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 474.



këtyre praktikave të cituara në Aktgjykimin e Apelit *Mustafa*.<sup>2191</sup> Krahas çështjeve gjyqësore të cituara nga Paneli i Gjykatës së Apelit (ku përfshihet dhe çështja *Sabit Geci dhe të tjerët*), Trupi Gjykses mban parasysh edhe çështjen *Xhemshit Krasniqi*, e cila lidhet me krimet e kryera në FMK në vitin 1999 nga Xhemshit Krasniqi, një prej anëtarëve të NKP-së në këtë çështje.<sup>2192</sup> Theksojmë se praktikat e përcaktimit të dënimeve të gjykatave të tjera, ndërkombëtare apo shtetërore, nuk kanë fuqi detyruese për Trupin Gjykses,<sup>2193</sup> pasi ai duhet ta marrë vendimin duke mbajtur parasysh një sërë faktorësh konkretë të çështjes gjyqësore, në veçanti, veprimet e personit të shpallur fajtor, rrethanat personale të tij, dhe ekzistencën e rrethanave lehtësuese dhe/ose rënduese, nëse ka.<sup>2194</sup>

### 3. Faktorët relevantë në përcaktimin e dënimit

1071. Trupi Gjykses së pari evidenton faktorët relevantë në bazë të nenit 44(5) të Ligjit dhe rregullës 163(1) të Rregullores dhe, së dyti, i peshon dhe balancon të gjithë këta faktorë dhe përcakton dënimin.

#### (a) Evidentimi i faktorëve relevantë

1072. Faktorë relevantë për përcaktimin e dënimit janë: (i) në radhë të parë, pesha e krimin dhe pasojat e tij; (ii) kontributi personal i personit të shpallur fajtor në krim; (iii)

---

<sup>2191</sup> *Shih [Mustafa Appeal Judgment](#)* (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 478, me poshtëshënimet shoqëruese 1292 dhe 1293.

<sup>2192</sup> Në këtë çështje, Xhemshit Krasniqi u shpall fajtor për bashkëkryerje me Sabit Gecin dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, për këto akuza për krime lufte: (i) ndalim i paligjshëm; (ii) cenim i dinjitetit personal, në veçanti, trajtim mizor, poshtësues dhe degradues, dhe (iii) dhunë ndaj jetës dhe personit. Xhemshit Krasniqi u shpall fajtor edhe për posedim të paautorizuar të armëve. Ai u shpall i pafajshëm për akuzën e vrasjes së paligjshme si krim lufte. Në apel, Xhemshit Krasniqit iu dha dënim i njësuar me shtatë (7) vjet burgim dhe me gjobë (1200 euro). *Shih Gjykata e Apelit të Kosovës, Prokurori kundër Xh. K., Çështja nr. 648/16, [Judgment](#)* (Aktgjykim), 22 qershor 2017.

<sup>2193</sup> *Shih [Mustafa Appeal Judgment](#)* (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 477-479.

<sup>2194</sup> Neni 44(5) i Ligjit.

rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor; dhe (iv) rrethanat lehtësuese dhe rënduese që lidhen me këta faktorë, nëse ka.<sup>2195</sup>

(b) Balancimi i faktorëve relevantë

1073. Trupi Gjykes ka kompetencë diskrecionale për të peshuar dhe balancuar faktorë të ndryshëm për përcaktimin e dënimit.<sup>2196</sup> Këta faktorë, të cilët shtjellohen më tej më poshtë dhe përmenden në mënyrë joshteruese në nenin 44(5) të Ligjit dhe rregullën 163(1) të Rregullores, do të trajtohen më poshtë në tri kategori: (i) pesha e veprës (veprave) penale dhe pasojat e saj; (ii) kontributi personal i personit të shpallur fajtor në krim (krime); dhe (iii) rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor.<sup>2197</sup>

1074. Trupi Gjykes mund të shqyrtojë rrethanat rënduese dhe lehtësuese sipas cilësdo prej këtyre tri kategorive. Bazuar në rrethanat e çështjes, Trupi Gjykes ka një shkallë të konsiderueshme diskrecioni (i) për të përcaktuar çfarë përbën rrethanë lehtësuese apo rënduese, krahas atyre të përcaktuara shprehimisht në rregullën 163(1) të Rregullores, si dhe (ii) për të vendosur se sa peshë do t'u jepet atyre – nëse do t'u jepet peshë.<sup>2198</sup>

1075. Gjithashtu, Trupi Gjykes duhet të shpjegojë peshën që u është dhënë këtyre rrethanave dhe provat konkrete mbi të cilat është mbështetur.<sup>2199</sup> Po kështu, personi i shpallur fajtor duhet të vihet mjaftueshëm në dijeni për faktet që janë marrë parasysh për rëndimin e dënimit.<sup>2200</sup>

---

<sup>2195</sup> Shih [Mustafa Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*), para. 451; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 783.

<sup>2196</sup> Shih, *ndër të tjera*, nenin 44(5) të Ligjit; rregullën 163(1)(a)-(b) dhe (3) të Rregullores.

<sup>2197</sup> Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 784.

<sup>2198</sup> Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 785.

<sup>2199</sup> Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 786, dhe referencat aty.

<sup>2200</sup> Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 786, dhe referencat aty.

i. Pesha e veprës penale dhe pasojat e saj

1076. Trupi Gjykes thekson se pesha e veprës penale dhe pasojat e saj janë faktorë kyç për dhënien e dënimit. Trupi Gjykes do të shqyrtojë përmasat cilësore dhe sasiore të peshës së veprës penale në fjalë. Ai do të shqyrtojë llojin, kuadrin, si dhe rrethanat dhe pasojat e saj.<sup>2201</sup>

1077. Pesha matet *in abstracto*, duke analizuar llojin e veprës penale në terma të përgjithshme dhe *in concreto*, duke vlerësuar rrethanat konkrete të çështjes. Jo të gjitha veprat penale që krijojnë arsye për dënim kanë domosdoshmërisht peshë të njëjtë dhe Trupi Gjykes duhet të peshojë secilën prej tyre.<sup>2202</sup>

1078. Treguesit e peshës së veprës penale përfshijnë, ndër të tjera, shkallën e krimit, numrin e viktimave, cenueshmërinë e viktimave, moshën e viktimave, shkallën e vuajtjes së viktimave dhe ndikimin tek të afërmit. Faktorët që merren parasysh si elemente të peshës së krimit nuk mund merren parasysh edhe si rrethana rënduese më vete dhe anasjellas.<sup>2203</sup>

ii. Kontributi personal në krim

1079. Në lidhje me kontributin personal në krim, Trupi Gjykes shqyrton rolin dhe pozitën e personit të shpallur fajtor, mjetet e përdorura për kryerjen e krimit dhe shkallën e synimit.<sup>2204</sup>

---

<sup>2201</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 787.*

<sup>2202</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 788.*

<sup>2203</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 789. Ngjashëm, ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-3484-tENG-Corr, Trial Chamber II, [Decision on Sentence pursuant to article 76 of the Statute](#) (Katanga Sentencing Decision), 23 May 2014, para. 35.*

<sup>2204</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa), para. 790, dhe referencat aty.*

### iii. Rrethanat individuale

1080. Në lidhje me rrethanat individuale, Trupi Gjykses shqyrton rrethanat personale të personit të shpallur fajtor, siç janë mosha, gjendja shëndetësore, gjendja familjare, arsimimi, precedentët e mëhershëm penalë<sup>2205</sup> ose karakteri.<sup>2206</sup>

### iv. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

1081. Rrethanat lehtësuese duhet të lidhen drejtpërdrejt me personin e shpallur fajtor; sidoqoftë, nuk është nevoja që ato të lidhen drejtpërdrejt me krimin dhe nuk kufizohen në kuadrin e akuzës.<sup>2207</sup> Trupi Gjykses duhet të bindet për ekzistencën e rrethanave lehtësuese në bazë të tërësisë së gjasave.<sup>2208</sup> Ekzistenca e rrethanave lehtësuese nuk e pakëson peshën e krimit, por është relevante për uljen e dënimit.<sup>2209</sup>

1082. Rrethanat rënduese duhet kenë lidhje me krimin për të cilin personi është shpallur fajtor ose me vetë personin.<sup>2210</sup> Trupi Gjykses duhet të bindet për ekzistencën e rrethanave rënduese jashtë dyshimit të arsyeshëm.<sup>2211</sup> Mungesa e rrethanave lehtësuese nuk shërben si rrethanë rënduese.<sup>2212</sup> Së fundi, një element i krimit ose formë e përgjegjësisë penale nuk mund të konsiderohet në të njëjtën kohë edhe si rrethanë rënduese e po atij krimi.<sup>2213</sup>

---

<sup>2205</sup> Rregulla 163(3) e Rregullores.

<sup>2206</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 791.

<sup>2207</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 792, dhe referencat aty.

<sup>2208</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 792, dhe referencat aty.

<sup>2209</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 792, dhe referencat aty.

<sup>2210</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 793, dhe referencat aty.

<sup>2211</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 793, dhe referencat aty.

<sup>2212</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 793, dhe referencat aty.

<sup>2213</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#)* (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 793, dhe referencat aty.

#### 4. Përcaktimi i dënimit dhe zbritja e kohës së kaluar në paraburgim

1083. Në përcaktimin dënimit të duhur, Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale të konsiderueshme dhe mund të marrë parasysh praktikat e dënimit të gjykatave shtetërore dhe ndërkombëtare për krime të ngjashme.<sup>2214</sup>

1084. Në bazë të rregullës 163(4) të Rregullores, Trupi Gjykses përcakton dënimin në lidhje me çdo akuzë të Aktakuzës së Konfirmuar, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe jep një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të personit të shpallur fajtor. Dënimi i njësuar nuk duhet të jetë më i lehtë se dënimi më i rëndë i përcaktuar për cilëndo prej akuzave.<sup>2215</sup>

1085. Së fundi, në bazë të rregullës 163(6) të Rregullores, gjatë dhënies së dënimit me burgim, Trupi Gjykses zbret kohën gjatë së cilës personi i shpallur fajtor është mbajtur në paraburgim, në rast se është mbajtur në paraburgim para ose gjatë gjykimit.<sup>2216</sup>

### C. KONSTATIME

#### 1. Faktorë relevantë

(a) Pesha e veprave penale dhe pasojat e tyre

i. Pesha e veprave penale

1086. Trupi Gjykses thekson se z. Shala është shpallur fajtor, si anëtar i NKP-së, për veprat penale të ndalimit arbitrar (Pika 1), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), si krime lufte të kryera në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.

---

<sup>2214</sup> Shih para. 1070 më lart; [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 794.

<sup>2215</sup> Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 795.

<sup>2216</sup> Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 795.

1087. *Ndalimi arbitrar*. Ndalimi arbitrar është vepër penale e rëndë sepse i bën viktimat të cënueshme ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut.<sup>2217</sup> Në këtë çështje, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së u hoqën lirinë këtyre personave në FMK: TW4-01-shit, viktimës së vrasjes së paligjshme, TW4-11-shit, W04733-shit, W01448-ës, TW4-05-ës, TW4-04-ës, TW4-02-shit, [REDAKTUAR] dhe një muzikanti të tretë rom, [REDAKTUAR] dhe së paku një femre tjetër të ndaluar, [REDAKTUAR]. Askujt prej tyre nuk iu dha asnjë prej tri garancive bazë që duhet t'u jepen të gjithë personave të cilëve iu hiqet liria në një konflikt të armatosur. Siç rikujtohet më poshtë, të ndaluarit në FMK u mbajtën të ndaluar në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese dhe u keqtrajtuuan rregullisht psikologjikisht dhe fizikisht.

1088. *Tortura*. E drejta për të mos u torturuar njihet si normë e *jus cogens*.<sup>2218</sup> Krimi i torturës përfaqëson cenim të dinjitetit, sigurisë, dhe mirëqenies mendore dhe fizike të njeriut. Në këtë çështje, të paktën 18 individë u mbajtën të ndaluar në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese në FMK. Të ndaluarit u mbajtën në kushte krejtësisht të papërshtatshme dhe poshtëruese jetese dhe fjetjeje; ata u mbajtën në dhoma të vogla pa shtretër; iu dha ujë dhe ushqim i pamjaftueshëm dhe i papërshtatshëm; nuk iu lejua të laheshin ose të ndërronin teshat; ata duhej të kërkonin leje për të përdorur banjat, që ishin në gjendje të keqe dhe ishin gjithmonë të shoqëruar; atyre nuk iu ofrua kujdes i duhur mjekësor dhe, në disa raste, iu refuzua tërësisht ndihma mjekësore; ata nuk lejoheshin të komunikonin dhe të flisnin me njëri-tjetrin.<sup>2219</sup>

1089. Gjithashtu, të ndaluarit jetonin me frikën e vazhdueshme se mund të bëheshin në çdo moment objekt i keqtrajtimit fizik, ose edhe të vriteshin.<sup>2220</sup> Ata i detyruan të

---

<sup>2217</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa)*, para. 796.

<sup>2218</sup> *Shih [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Mustafa)*, para. 797, dhe referencat aty.

<sup>2219</sup> *Shih* para. 748 dhe 971 më lart.

<sup>2220</sup> *Shih* para. 749 më lart.

shihnin dhe dëgjonin keqtrajtimin fizik të të ndaluarve të tjerë dhe i panë ata të mavijosur, të mbuluar në gjak, me duar dhe këmbë të ënjtura dhe dhëmbë të thyer.<sup>2221</sup> [REDAKTUAR]. Disa të ndaluar, ndër ta TW4-01, viktima e vrasjes së paligjshme, W04733, W01448, TW4-11, TW4-05, [REDAKTUAR] dhe një muzikant i tretë rom, u keqtrajtuuan rregullisht fizikisht dhe psikologjikisht.<sup>2222</sup> Gjatë gjithë kohës së mbajtjes në ndalim, të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan si “bashkëpunëtorë” të autoriteteve serbe, “spiunë”, “tradhtarë”, simpatizues të Serbisë, ose se nuk e përkrahnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së.<sup>2223</sup> Kushtet çnjerëzore të ndalimit dhe keqtrajtimet fizike dhe psikologjike të të ndaluarve kishin për qëllim marrjen e informatave ose të deklaratave pranuese prej tyre dhe/ose ndëshkimin, frikësimin, detyrimin dhe/ose diskriminimin e tyre për arsye politike.<sup>2224</sup>

1090. *Vrasja e paligjshme*. Vrasja e paligjshme është vetiu një nga krimet më të rënda,<sup>2225</sup> sepse vlera që mbrohet është jeta e njeriut. Për më tepër, të afërmit e lënë pas, mbeten pa një anëtar të familjes, dhe, rrjedhimisht, pa dashurinë dhe kujdesin, pa mbështetjen financiare, fizike, emocionale, psikologjike, morale apo të ndonjë lloji tjetër. Në këtë çështje, viktima e vrasjes së paligjshme vdiq gjatë kohës që ishte ende i ndaluar në FMK, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, nga pasojat e plagëve të shkaktuara nga gjuajtjet me armë zjarri në këmbë, shoqëruar me refuzimin e trajtimit të duhur mjekësor.<sup>2226</sup>

1091. Trupi Gjyqësor e konsideron numrin e viktimave si pjesë të peshës së krimeve, dhe, rrjedhimisht, nuk do ta marrë parasysh si faktor rëndues.

---

<sup>2221</sup> *Shih* para. 647, 749 më lart.

<sup>2222</sup> *Shih* para. 653 më lart dhe Pjesën VI.E.2.

<sup>2223</sup> *Shih* para. 590 më lart dhe Pjesën VI.E.3.

<sup>2224</sup> *Shih* Pjesën VI.E.3 dhe para. 752 më lart.

<sup>2225</sup> *Shih* [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 798, dhe referencat aty.

<sup>2226</sup> *Shih* para. (e), 832 më lart.

1092. Trupi Gjykues arrin në përfundimin se aspektet e mësipërme janë relevante për vlerësimin e peshës së veprave penale.

ii. Pasojat e krimeve

1093. Trupi Gjykues vëren se si pasojë e ndalimit arbitrar dhe torturës, viktimat patën pasoja afatgjata nga lëndimet, si fizike ashtu edhe mendore, ndër të cilat: lëndime në kokë, lëndime nga djegiet, thyerje të krahëve dhe/ose dhëmbëve, dhimbje të vazhdueshme dhe të forta në të gjithë trupin; ndjenja të turpfit, dhe simptoma të çrregullimit të stresit pastraumatik. Ato gjithashtu përjetuan pasoja negative në jetën e tyre sociale dhe familjare.<sup>2227</sup> Disa viktima humbën aftësinë për të fituar jetesën, për të mbështetur financiarisht familjet e tyre ose për të rifituar pavarësinë financiare.<sup>2228</sup> Familja e W04733-shit ndau me të barrën e vuajtjeve që ai solli me vete. Jeta e tyre u ndikua nga dijenia për atë që i kishin bërë atij, dhe disa anëtarë të familjes u detyruan të ndërprisnin shkollimin ose karrierën, sepse shiheshin si familje spiuni nga disa persona, ose konsideroheshin të tillë për shkak të asaj që i ndodhi W04733-shit.<sup>2229</sup>

1094. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR], TW4-01 ka vuajtur nga çrregullimi i stresit pastraumatik, për shkak të të cilit ai ka kufizime të mëdha në funksionet e tij sociale dhe profesionale.<sup>2230</sup>

1095. Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se krimet nën shqyrtim shkaktuan pasoja të konsiderueshme dhe afatgjata: materiale, fizike dhe psikologjike të viktimat e ndaluara; dhe pasoja materiale dhe psikologjike tek anëtarët e familjes [REDAKTUAR].

---

<sup>2227</sup> *Shih* para. 684-687, 700-705, 753 më lart.

<sup>2228</sup> *Shih* para. 685 më lart.

<sup>2229</sup> *Shih* para. 701, 703-704 më lart.

<sup>2230</sup> [REDAKTUAR].



iii. Faktor rëndues: kryerja e torturës në mënyrë veçanërisht  
mizore<sup>2231</sup>

1096. Trupi Gjykses rikujton se në disa raste rrahjet e të ndaluarve u kryen në grup<sup>2232</sup> dhe/ose zgjatën me orë të tëra.<sup>2233</sup> Rrahjet ishin aq brutale sa disa të ndaluar ishin krejt të mavijosur dhe/ose të mbuluar në gjak, humbën ndjenjat,<sup>2234</sup> ose më pas nuk ishin në gjendje të ecnin.<sup>2235</sup> Rrahjet gjithashtu shkaktuan dëmtime të rënda dhe afatgjata mendore.<sup>2236</sup>

1097. Në veçanti, Trupi Gjykses rikujton se: TW4-01 dhe viktima e vrasjes së paligjshme u goditën me shkopinj dhe “gjithçka tjetër”; [REDAKTUAR]; gjatë rrahjeve, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] W04733-shit u hodhën kripë në plagë; në po atë rast, z. Shala përdori një shkop gome dhe një shkop bejsbolli për të goditur W04733-shin në të gjithë trupin dhe në kokë, përfshirë në duar dhe në këmbë, të cilat iu ënjtën dhe mavijosën.<sup>2237</sup> [REDAKTUAR].<sup>2238</sup> Viktima e vrasjes së paligjshme vdiq pas një agonie të zgjatur në rrethana të tmerrshme – atij iu fry barku, nuk mund të urinonte dhe pati gjakderdhje të madhe.<sup>2239</sup> [REDAKTUAR] ai do të vdiste, për shkak të refuzimit të anëtarëve të UÇK-së përgjegjës për të ndaluarit për t’i dhënë ndihmën e duhur mjekësore. Trupi Gjykses e konsideron këtë si një aspekt veçanërisht mizor në kryerjen e krimit të vrasjes së paligjshme në këtë çështje.

1098. Trupi Gjykses mban gjithashtu parasysh natyrën degraduese dhe poshtëruese të keqtrajtimit që pësuan viktimat, siç ishte p.sh. urdhërimi i tyre që të rrihnin njëri-

<sup>2231</sup> Rregulla 163(1)(b)(iv) e Rregullores. *Shih* Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, para. 376-377.

<sup>2232</sup> *Shih, për shembull*, para 641, 654, 690, 707, 716 më lart.

<sup>2233</sup> *Shih, për shembull*, para. 653, 749 më lart.

<sup>2234</sup> *Shih, për shembull*, para. 709, 714, 750 më lart.

<sup>2235</sup> *Shih* para. 531, 535, 546, 578, 586, 679, 680.

<sup>2236</sup> *Shih, për shembull*, para. 753 më lart.

<sup>2237</sup> *Shih* para. 690 më lart.

<sup>2238</sup> *Shih* para. 668 më lart.

<sup>2239</sup> *Shih* para. 831-832 më lart.

tjetrin, ose detyrimi, mbi baza diskriminuese, i muzikantëve romë që të bënin punë krahu.<sup>2240</sup>

1099.Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se është vërtetuar rrethana rënduese sipas rregullës 163(1)(b)(iv) të Rregullores.

iv. Faktor rëndues: Viktima veçanërisht të cenueshme ose të pambrojtura<sup>2241</sup>

1100.Trupi Gjykses rikujton se të ndaluarit u arrestuan befas dhe u shkëputën nga jeta e tyre e përditshme, pa ditur arsyen për të cilën u ndaluan, sa do të zgjaste ndalimi ose kur do të kishin mundësi t'i kontaktonin ose t'i shihnin sërish familjet e tyre.<sup>2242</sup> Ata ishin në mëshirën e atyre që i mbanin të ndaluar dhe objekt i zemërimit dhe dhunës së luftëtarëve që ktheheshin nga vijat e frontit.<sup>2243</sup>

1101.Për këto arsye, si rrethanë rënduese sipas rregullës 163(1)(b)(iii) të Rregullores, Trupi Gjykses konstaton faktin se viktimat në këtë çështje gjyqësore ishin veçanërisht të cenueshme dhe të pambrojtura.

v. Përfundim

1102.Duke marrë parasysh llojin dhe rrethanat e krimeve, shkallën e vuajtjes së viktimave, si dhe dy rrethanat rënduese të lartpërmendura, Trupi Gjykses e vlerëson peshën e krimeve të shqyrtuara si të rëndë.

---

<sup>2240</sup> *Shih* para. 749, 751 më lart.

<sup>2241</sup> *Shih* Rregullën 163(1)(b)(iv) të Rregullores. Si ZPS-ja ashtu dhe Mbrojtësi i Viktimave kërkuan që Trupi Gjykses ta merrte parasysh këtë faktor si rëndues, *shih* Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, para. 397-398; Deklaratën e Mbrojtësit të Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 189 dhe 194.

<sup>2242</sup> *Shih* konstatimet në Pjesën VI.D.

<sup>2243</sup> *Shih* konstatimet në Pjesën VI.E.

## (b) Kontributi personal në krime

1103. Trupi Gjykses rikujton se z. Shala, kreu krimet e ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme si anëtar i një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, me anëtarë të tjerë të UÇK-së.<sup>2244</sup>

1104. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se z. Shala luajti një rol aktiv brenda grupit të anëtarëve të UÇK-së të cilët ndaluan arbitrarisht, torturuan dhe vranë personat e ndaluar. Ai kishte një shkallë autonomie dhe pushteti brenda UÇK-së në FMK, por pa pasur rol komandues.<sup>2245</sup>

1105. Së pari, z. Shala pa dhe e dinte se afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 në FMK u mbajtën persona të ndaluar dhe kontribuoi qëllimisht në planin për t'u hequr atyre lirinë gjatë kësaj periudhe.<sup>2246</sup> Në lidhje me W04733-shin në veçanti, më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date, z. Shala mori pjesë, së bashku me një grup anëtarësh të UÇK-së, në transferimin e tij në FMK nga vendi ku mbahej i ndaluar në Romanat.<sup>2247</sup>

1106. Së dyti, z. Shala personalisht dhe qëllimisht keqtrajtoi rëndë TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, W04733-shin dhe W01448-ën më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date. Z. Shala ishte ai që e goditi i pari TW4-01-shin me një shkop gome. Së bashku me Xhemshit Krasniqin, z. Shala ishte anëtari i UÇK-së që më së shumti i rrahu W04733-shin dhe W01448-ën më 20 maj 1999, ose rreth kësaj date.<sup>2248</sup> Ai gjithashtu urdhëroi [REDAKTUAR] të rrihnin W04733-shin. Gjithashtu, ai mori në pyetje [REDAKTUAR] dhe i kërkoi asaj të jepte deklaratë pranuese.

---

<sup>2244</sup> *Shih* para. 1037-1039 më lart.

<sup>2245</sup> *Shih* para. 900 dhe 914 më lart.

<sup>2246</sup> *Shih* para. 951-956 më lart.

<sup>2247</sup> *Shih* para. 455 më lart.

<sup>2248</sup> *Shih* para. 690 dhe 707 më lart.

1107. Së treti, në lidhje me viktimën e vrasjes së paligjshme, z. Shala mori pjesë në keqtrajtimin e tij më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, dhe ishte i pranishëm në dhomë kur viktima e vrasjes së paligjshme u qëllua me armë zjarri. [REDAKTUAR].

1108. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses e vlerëson shkallën e kontributit personal të z. Shala në krimet e shqyrtuara, si dhe synimin e tij, si të lartë, por merr parasysh edhe faktin se ai nuk kishte rol komandues zyrtar.

(c) Rrethanat personale

1109. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se në kohën kur u kryen krimet për të cilat është shpallur fajtor, z. Shala ishte 35 vjeç.<sup>2249</sup> Sipas Mbrojtjes ai u rrit në rrethana të pasigurta dhe të paqëndrueshme në Kosovë; para luftës, z. Shala u mbajt në një burg të Serbisë si i burgosur politik, dhe ai vetë dhe familja e tij patën viktima gjatë konfliktit.<sup>2250</sup>

1110. Sipas Trupit Gjykses, jeta e vështirë që z. Shala kishte pasur më herët në Kosovë dhe burgimi i tij në Serbi, në vetvete, nuk përlligjin në asnjë mënyrë kryerjen e krimeve. Ai i kreu krimet në fjalë në kohën kur ishte në moshë të rritur dhe plotësisht i përgjegjshëm. Vlen të theksohet se nuk janë paraqitur rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale sipas Ligjit. Në këto rrethana, ndonëse pranon se z. Shala ka kaluar përvoja të vështira si pasojë e konfliktit, Trupi Gjykses u jep pak peshë këtyre ngjarjeve sa i takon zbutjes së dënimit të z. Shala.

1111. *Rrethanat familjare.* Trupi Gjykses thekson se z. Shala është 60 vjeç,<sup>2251</sup> ka një partnere dhe dy fëmijë në të njëzetat.<sup>2252</sup> Sipas Mbrojtjes: (i) fëmijët dhe partnerja e z.

---

<sup>2249</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 357.

<sup>2250</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 357-358.

<sup>2251</sup> *Shih* para. 284 më lart.

<sup>2252</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 360.

Shala marrin trajtim mjekësor;<sup>2253</sup> (ii) ai ka shqetësime reale për mirëqenien e saj dhe të fëmijëve të tij;<sup>2254</sup> dhe (iii) mënyra traumatizuese se si u arrestua ndikoi te anëtarët e familjes dhe ka çuar në stigmatizimin shoqëror të familjes së tij në komunitetin shumë të vogël ku jeton.<sup>2255</sup>

1112. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm për faktin se mbajtja në paraburgim e z. Shala pa dyshim që ka ndikuar në jetën e anëtarëve të familjes së tij. Ky faktor është i njëjtë për shumë persona që mbahen në paraburgim në kontekstin e proceseve penale. Trupi Gjykses rikujton se standardi se çfarë përbën “rrethana të veçanta familjare” për zbutjen e dënimit, është i lartë.<sup>2256</sup> Trupi Gjykses konstaton se faktorët e renditur nga Mbrojtja nuk e përmbushin këtë standard, as më vete, dhe as të marrë së bashku. Rrjedhimisht, në këtë çështje, Trupi Gjykses nuk mund t’u japë peshë si rrethanë lehtësuese.

1113. *Problemet shëndetësore.* Në aktekspertizën e ekspertës së Mbrojtjes, znj. Milaco, përmendet se z. Shala vuan nga vetëvlerësimi i ulët, ankthi dhe probleme somatike për të cilat duhet të marrë mjekim.<sup>2257</sup> Së pari, vihet në dukje se çdo personi që mbahet në paraburgim nga Dhomat e Specializuara, i ofrohet vazhdimisht kujdesi i duhur mjekësor.<sup>2258</sup> Në fakt, Mbrojtja pranon se z. Shala po trajtohet me barna.<sup>2259</sup> Në përputhje me jurisprudencën penale ndërkombëtare, problemet shëndetësore mund

---

<sup>2253</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 361, dhe referencat aty; **z. Shala**: T. 17 prill 2024, publik, f. 4369, rreshtat 6-7.

<sup>2254</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 361.

<sup>2255</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 361.

<sup>2256</sup> Rrethanave familjare u jepet pak ose aspak peshë në përcaktimin e dënimit, përveç nëse ato janë të veçanta. *Shih* ICC, [Katanga Sentencing Decision](#), paras 88, 144; ICTR, *Ntabakuze v. Prosecutor*, ICTR-98-41A-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 8 May 2012, para. 284; ICTY, *Prosecutor v. Babić*, IT-03-72-A, Appeals Chamber, [Judgment on Sentencing Appeal](#) (*Babić Judgment on Sentencing Appeal*), 18 July 2005, paras 50-51.

<sup>2257</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 362; DPS01735-DPS01757, f. 6, 17, 18.

<sup>2258</sup> *Shih* KSC-BD-08-Rev1, Administratorja, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative: Rregullorja e paraburgimit, 23 shtator 2020, publik, rregullat 30-37.

<sup>2259</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 362.

të përbëjnë faktor lehtësues vetëm në rrethana të veçanta ose të rralla.<sup>2260</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se Mbrojtja nuk mund të ngrejë argumentin e rrethanave të veçanta në lidhje me gjendjen aktuale shëndetësore të z. Shala, sikurse është paraqitur. Më gjerësisht, Trupi Gjykses vëren se gjendja shëndetësore e personit të shpallur fajtor ka të bëjë kryesisht me aspektin e zbatimit të dënimit të dhënë, dhe jo faktor që ndikon në përcaktimin e kohëzgjatjes së tij.<sup>2261</sup> Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses nuk mund t'i japë peshë si rrethanë lehtësuese gjendjes shëndetësore aktuale të z. Shala.

1114. *Sjellja e mirë*. Mbrojtja pretendon se z. Shala: (i) i është përgjigjur të gjitha fletëthirrjeve për t'u paraqitur si dëshmitar ose si i dyshuar në TPNJ dhe në Dhomat e Specializuara; dhe (ii) nuk ka shkelur asnjë urdhër të Trupit Gjykses dhe ka bashkëpunuar me Dhomat e Specializuara.<sup>2262</sup>

1115. Trupi Gjykses rikujton se nga çdo person pritët që të veprojë në përputhje me ligjin ose me urdhrat e nxjerra nga gjykata, dhe, për këtë arsye, në vetvete kjo nuk përbën rrethanë lehtësuese, përveçse në raste të veçanta.<sup>2263</sup> Në kundërshtim me pretendimin e Mbrojtjes, Trupi Gjykses rikujton se z. Shala jo gjithmonë ka treguar respekt ndaj gjykatës. Në të paktën një rast gjatë procesit, z. Shala e ndërpreu seancën dhe u largua nga salla e gjyqit pa leje nga Trupi Gjykses dhe për këtë iu tërhoq vërejtje nga Kryegjykatësja.<sup>2264</sup> Sido që të jetë, Trupi Gjykses nuk është bindur se sjellja përgjithësisht e mirë e z. Shala në paraburgim apo bashkëpunimi i tij me Dhomat e

---

<sup>2260</sup> ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-1819-Red, Trial Chamber IX, [Sentence](#) (Ongwen Sentencing), 6 May 2021, para. 103; *shih ngjashëm*, Mekanizmi Përmbyllës Ndërkombëtar për Tribunalët Penalë, *Prosecutor v. Mladić*, MICT-13-56-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 8 June 2021, para. 554; ICTY, *Prosecutor v. Šainović et al.*, IT-05-87-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 23 January 2014, para. 1827; [Prlić et al. Trial Judgement](#), para. 1288; *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 30 November 2006, para. 436; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 29 July 2004, para. 696; [Babić Judgment on Sentencing Appeal](#), para. 43.

<sup>2261</sup> [Ongwen Sentencing](#), para. 103.

<sup>2262</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 366.

<sup>2263</sup> *Shih* [Mustafa Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Mustafa*), para. 824, dhe referencat aty.

<sup>2264</sup> T. 23 nëntor 2023, konfidencial, f. 3600, rreshti 16 deri në f. 3603, rreshti 2.

Specializuara, kanë qenë të veçanta. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do ta marrë parasysh këtë faktor për uljen e dënimit të tij.

1116. *Dosja penale*. Në lidhje me rregullën 163(3) të Rregullores, Trupi Gjykses mban parasysh, se z. Shala nuk ka precedentë penalë të mëhershëm në Shqipëri.<sup>2265</sup> Ai ka një dënim për një vepër penale të dhunshme të goditjes me thikë në vitin 2018, në një ambient publik në Belgjikë.<sup>2266</sup>

1117. *Pendesa*. Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimin e Mbrojtësit të Viktimave se, gjatë gjithë procesit, z. Shala nuk ka shprehur ose shfaqur asnjëherë keqardhje për viktimat.<sup>2267</sup> Në vend të keqardhjes, z. Shala deklaroi: “Nuk i kem dëmtu këta persona. As nuk i kam vu në rrezik”.<sup>2268</sup> Po kështu, në deklaratën përmbyllëse, Mbrojtja deklaroi se qëndrimi i saj ishte se “çfarëdo që ka ndodhur në Kukës asokohe, Pjetër Shala nuk kishte asnjë rol, dhe nuk mori pjesë në të”.<sup>2269</sup> Në deklaratën e tij të 2019-ës, z. Shala jo vetëm që nuk shprehu keqardhje për rrahjen e TW4-01-shit dhe viktimës së vrasjes së paligjshme në FMK, por madje deklaroi: “edhe nëse duhet ta bëj përsëri, e bëj pa asnjë hezitim”.<sup>2270</sup> Trupi Gjykses konstaton se z. Shala nuk ka treguar pendesë e as keqardhje për viktimat. Ndonëse në vetvete nuk është faktor rëndues, Trupi Gjykses vë në dukje mungesën e shprehjes së çfarëdolloj keqardhjeje për viktimat.

---

<sup>2265</sup> 119389-119390; *shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-04, F00806, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në vijim të Parashtrimit të Prokurorisë F00798 dhe Urdhrit F00795*, 6 mars 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 8 mars 2024, [F00806/RED](#).

<sup>2266</sup> 118356-118384-ET, f. 118364-118371.

<sup>2267</sup> Rregulla 163(a)(ii) e Rregullores.

<sup>2268</sup> T. 17 prill 2024, publik, f. 4370, rreshtat 21-22.

<sup>2269</sup> T. 16 prill 2024, publik, f. 4240, rreshtat 10-12.

<sup>2270</sup> Z. **Shala**: 066888-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1, e rishikuar), f. 155, rreshtat 2-3.

1118. *Përfundim*. Si përfundim, ndonëse pranon se z. Shala ka kaluar përvoja të vështira si pasojë e konfliktit, Trupi Gjykses u jep pak peshë këtyre ngjarjeve dhe nuk ka evidentuar rrethana të tjera individuale që përlligjin uljen e dënimit të tij.

(d) Shkelja e së drejtës për gjykim të drejtë si rrethanë lehtësuese

1119. Në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes që Trupi Gjykses të marrë parasys shkeljet “e jashtëzakonshme” të së drejtës së z. Shala për gjykim të drejtë si rrethanë lehtësuese,<sup>2271</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se i ka trajtuar argumentet e Mbrojtjes në lidhje me një sërë shkeljesh të së drejtës për gjykim të drejtë më lart në këtë Aktgjykim.<sup>2272</sup> Trupi Gjykses nuk konstatoi shkelje të të drejtave të z. Shala.<sup>2273</sup> Rrjedhimisht, ai nuk ka nevojë ta diskutojë më tej këtë faktor si rrethanë lehtësuese për zbutjen e dënimit.

## **2. Përcaktimi i dënimit për secilën vepër penale më vete dhe i dënimit të njësuar**

1120. Duke qenë se z. Shala është shpallur fajtor për më shumë se një vepër penale, Trupi Gjykses do të vijojë së pari me përcaktimin e dënimit për secilën vepër penale për të cilën është dhënë vendim fajësie dhe, së dyti, me përcaktimin e dënimit të njësuar për sjelljen kriminale të z. Shala në tërësi.

1121. Pasi ka peshuar dhe balancuar të gjithë faktorët e përmendur më lart, ndër ta peshën e krimeve dhe pasojat e tyre, kontributin personal të z. Shala në krime, dhe rrethanat personale të z. Shala, si edhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese; si dhe pasi ka marrë parasys qëllimet e lartpërmendura të dënimit, Trupi Gjykses është

---

<sup>2271</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 368, poshtëshënimi 791. Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykses të marrë parasys si rrethana lehtësuese (i) shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë të z. Shala, dhe (ii) të drejtën e tij për mjet juridik efektiv të garantuar sipas neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së, neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 21(2) të Ligjit.

<sup>2272</sup> *Shih* Pjesën IV.

<sup>2273</sup> *Shih* para. 73 më lart.



i mendimit se dënimi me burgim me kohëzgjatje të konsiderueshme është dënimi i duhur dhe, rrjedhimisht, e dënon z. Shala:

- (i) me 6 (gjashtë) vjet burgim për krimin e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1);
- (ii) me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim për krimin e luftës të torturës (Pika 3); dhe
- (iii) me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pika 4).

1122. Pasi ka përcaktuar këto dënime, Trupi Gjykses jep një dënim të njëzuar me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim për krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të z. Shala dhe krimet e kryera prej tij.

### 3. Koha e mbetur e burgimit

1123. Sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim, Trupi Gjykses thekson se z. Shala u arrestua më 16 mars 2021 në Belgjikë<sup>2274</sup> dhe është mbajtur në paraburgim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara që nga data 15 prill 2021.<sup>2275</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses zbret nga dënimi i dhënë kohën e kaluar në paraburgim që nga 16 marsi 2021.

## IX. VENDIM

1124. Për arsyet e lartpërmendura, bazuar në tërësinë e provave ekzistuese si dhe në parashtrimet e bëra para Trupit Gjykses në gjykim, në bazë të nenit 43 të Ligjit dhe rregullës 158 të Rregullores, Trupi Gjykses e shpall:

---

<sup>2274</sup> Njoftimi i Arrestimit, para. 1, 5.

<sup>2275</sup> Njoftimi i Pranimi, para. 2.

**z. PJETËR SHALA**

- a) **FAJTOR** për **Pikën 1** të Aktakuzës së Konfirmuar, **ndalim arbitrar** si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit, të kryer afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 në fabrikën e metalit në Kukës;
- b) **FAJTOR** për **Pikën 3** të Aktakuzës së Konfirmuar, **torturë** si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, të kryer afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 në fabrikën e metalit në Kukës; dhe
- c) **FAJTOR** për **Pikën 4** të Aktakuzës së Konfirmuar, **vrasje e paligjshme** si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, të kryer më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date në fabrikën e metalit në Kukës; dhe
- d) **TË PAFAJSHËM** për krimin e luftës të **trajtimit mizor** sipas **Pikës 2** të Aktakuzës së Konfirmuar.

1125. Z. Shala dënohet me dënim të njësuar me **18 (tetëmbëdhjetë) vjet** burgim, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

1126. Trupi Gjykses **urdhëron** Administratoren t'u caktojë numra prove të gjitha materialeve të shënuara më herët për evidentim, me qëllim dokumentimin e saktë të procesit, në përputhje me nenin 40(5) të Ligjit dhe rregullën 24(1) të Rregullores.

1127. Trupi Gjykses gjithashtu **vendos** të ruajë juridiksionin në këtë çështje në lidhje me lëshimin më pas të Urdhrit për Zhdëmtim, ku do të saktësohet kompensimi i përshtatshëm për viktimat ose në lidhje me to, në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**

**Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Zhilber Biti**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Roland Dekers**

E martë, 16 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.